JETA PROFETIKE

Sikur të jetoje me të

ABDULVEHAB TUREJRI

Furkan ISM

ABDULVEHAB TUREJRI

JETA PROFETIKE

Sikur të jetoje me të

Shkup, 2025

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

929Мухамед, пророк

TUREJRI, Abdulvehab
Jeta profetike : sikur të jetoje me të / Abdulvehab Turejri ;
përktheu nga arabishtja Agim Elezi. - Shkup : Furkan, 2025. - 592 стр. ;
24 см

Фусноти кон текстот
. - Превод на делото:
لحياة النبوية، حياة الرسول صلى الله عليه وآله وسلم كأنك تعيش معه

ISBN 978-608-216-277-5

COBISS.MK-ID 67149317

JETA PROFETIKE

Sikur të jetoje me të

ABDULVEHAB TUREJRI

Shkup, 2025

Autor:
Abdulvehab TUREJRI

Titulli në arabisht:
لحياة النبوية، حياة الرسول صلى الله عليه وآله وسلم كأنك تعيش معه

Titulli:
JETA PROFETIKE
Sikur të jetoje me të

Për botuesin:
Muhamed MURTEZI

Kryeredaktor:
Rufat SHERIFI

Përktheu nga arabishtja:
Agim ELEZI

Redaktor:
Hasan BAFTIJARI

Redaktor gjuhësor:
Namir LAPARDHAJA

Korrektor:
Agim ABAZI

Radhitja kompjuterike dhe kopertina:
Jusuf SALIU

Botues:
SHB "Furkan ISM"
Adem Demaçi lok 22, 1000 Shkup
Tel: (02) 26 22 360
http://www.furkan.com.mk
E-mail: furkan@furkan.com.mk

Shtypi:
Furkan Print - Shkup
Copyright©Furkan ISM, 2025

Tirazhi:
1000

Përmbajtja:

Kushtim 13
Falënderim dhe lutje 14
Parathënie 15

Kapitulli i Parë: Pararendësit e librit 19
Rrugëtimi me Sira-n 21
Veçoritë e Sira-s Profetike 26
Së pari: Qartësia 26
Së dyti: Gjithëpërfshirja 28
Së treti: Kompletimi 31
Së katërti: Lehtësia 32
Së pesti: Madhështia 33
Frytet e leximit të Sira-s 37
Së pari: Fryti i besimit 37
Së dyti: Fryti shpirtëror 39
Së treti: Fryti shkencor 41
Së katërti: Fryti edukativ 42
Fytyra profetike 44

Kapitulli i Dytë: Marrëdhëniet e të Dërguarit 51
I Dërguari dhe nëna e tij 53
Së pari: Amine dhe Abdullahu 53
Së dyti: Udhëtimi në Medinë dhe vdekja e Amines 54
Së treti: I Dërguari viziton varrin e nënës së tij 55
Së katërti: Nëna kujdestare pas nënës së tij 57
Së pesti: Përfundim 58
I Dërguari si bashkëshort 59
Bisedat e tij me familjen 78
I Dërguari si baba 85
I Dërguari dhe vëllezërit e tij, pejgamberë (paqja e Allahut qoftë mbi ta) ... 96
Së pari: Përmendja e virtyteve dhe cilësive të tyre të lavdërueshme 98
Së dyti: Përmendja e tregimeve dhe lajmeve të tyre 99

Së treti: Takimi me pejgamberët gjatë natës së Israsë dhe Miraxhit 101
Së katërti: Përmendja e cilësive dhe pamjes së tyre sikur po i shihte para syve 103
Së pesti: Ndjekja e shembullit të tyre 104
Së gjashti: Respektimi i tyre dhe ruajtja e pozitës e vendit të tyre 105
Së shtati: Vëllazëria dhe dashuria për ta 106
I Dërguari si shok 107
I Dërguari dhe gruaja 114
Së pari: Kundërshtimi i zakonit të popullit të tij, kurejshëve, në marrëdhëniet me gratë 115
Së dyti: Ndjesia e gruas për përgjegjësinë e saj dhe përfshirja në punën për fenë 115
Së treti: Hapja e mundësive për gratë që të shprehnin mendimet e tyre... 118
Së katërti: Pranimi i iniciativave të grave, mirëpritja dhe bashkëveprimi me to 120
Së pesti: Përcaktimi i takimeve të posaçme me gratë 120
Së gjashti: Përmbushja e nevojave të grave dhe angazhimi për çështjet e tyre 121
Së shtati: Përcaktimi i një komunikimi të posaçëm për gratë, që lidhet drejtpërdrejt me nevojat dhe çështjet e tyre specifike 122
Së teti: Nxitja e grave për kërkimin e dijes 123
Së nënti: Pjesëmarrja e tyre në Xhihad 124
Së dhjeti: Mbrojtja e të drejtave të gruas 125
Së njëmbëdhjeti: Madhërimi i vlerës së gruas dhe rolit të saj si nënë, grua, bijë dhe motër - dhe këshilla ruajtjen e kësaj porosie 128
I Dërguari dhe shërbyesit 130
I Dërguari dhe fëmijët 136
I Dërguari dhe të rinjtë 145
I Dërguari dhe njerëzit e Strehimores Suffa 153
I Dërguari dhe mikpritja 161
I Dërguari si mysafir 166
I Dërguari dhe sahabët 173
I Dërguari dhe gabimtarët 185
I Dërguari dhe kundërshtarët 191
I Dërguari dhe armiqtë 206
I Dërguari dhe hipokritët 212
I Dërguari dhe bota e xhindëve 219

Kapitulli i Tretë: Adhurimi i të Dërguarit 225
I Dërguari dhe lutja - duaja 227
I Dërguari dhe kërkimi i faljes - Istigfari 233
I Dërguari dhe namazi i natës - Kijamu el-lejl 237
I Dërguari dhe Kurani 243
I Dërguari dhe Dita e Xhuma 248
I Dërguari dhe Ramazani 255
1. Muaji i studimit të Kuranit 256
2. Përgatitja e Pejgamberit për Ramazanin 258
3. Pejgamberi dhe dhjetë netët e fundit të Ramazanit 259
4. Itikafi 259
5. Agjërimi pa ndërprerje i Pejgamberit gjatë dhjetëditëshit të fundit .. 260
6. Pejgamberi: Adhurim i plotë pa u shkëputur nga familja 261
7. Pavarësisht përpjekjes së tij të madhe në adhurim, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i kujdesshëm që Umeti të mos e ngarkonte veten me atë që nuk mund ta përballonte .. 262
8. Gjatë Ramazanit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i zgjonte edhe familjarët për t'u falur natën 262
I Dërguari dhe festa e Bajramit 263
I Dërguari dhe Haxhi 269

Kapitulli i Katërt: Bota e ndjenjave dhe i Dërguari 277
I Dërguari dhe mirëqenia e tij shpirtërore 279
I Dërguari dhe humori 282
1. Humori i tij me sahabët 282
2. Humori i të Dërguarit me fëmijët dhe në bisedat e përditshme 283
3. Si e priste i Dërguari humorin nga të tjerët? 284
4. Më shumë për shakatë e të Dërguarit me familjen e tij 285
I Dërguari dhe argëtimi 286
Buzëqeshjet e të Dërguarit 291
I Dërguari dhe guximi - trimëria 295
I Dërguari dhe lotët 302
1. Të qarët është i dukshëm dhe i natyrshëm te ai 303
2. Qetësia në të qarë 303
3. Të qarët nga madhërimi i Allahut 303
4. Të qarët nga dhembshuria për Umetin 304
5. Të qarët nga mëshira në familje dhe miqësi 304

6. Pikëllimi me përulësi, jo me zemërim 306
I Dërguari dhe hidhërimi 307
1. Hidhërimi kurrë nuk e mbizotëroi zemrën e tij 307
2. Hidhërimet që vizituan jetën e tij 307
3. Qasja profetike ndaj hidhërimit 308
4. Nuk jetoi në hidhërim, por e tejkaloi atë 308
5. Mbështetja dhe dhembshuria për të pikëlluarit 308
I Dërguari dhe dashuria 310
I Dërguari dhe zemërimi 315
I Dërguari dhe bukuria 319
I Dërguari dhe ndjeshmëria në sjellje 322
I Dërguari dhe dhuratat 327
1. Pranimi i dhuratës, edhe nëse ishte pak ose diçka e thjeshtë 328
2. Siç i pranonte dhuratat, edhe i shpërblente ato 328
3. Siç pranonte dhurata nga jomuslimanët, edhe u dhuronte atyre 329
4. Nga edukata e tij në lidhje me dhuratën ishte edhe vlerësimi i saj dhe shfaqja e gëzimit për të 329
5. Nëse ndodhte ta kthente një dhuratë për ndonjë arsye, ai e shpjegonte shkakun dhe qetësonte dhuruesin 329
6. Dhuratat e tij ishin të bollshme, fisnike dhe të ndara me zemërgjerësi .. 330
7. Ashtu siç pranonte dhurata të vogla, edhe ai vetë i dhuronte ato. 330
I Dërguari dhe kujdesi për ndjenjat 332
I Dërguari dhe çelësat e zemrave 336
Së pari: Buzëqeshja 336
Së dyti: Vlerësimi 337
Së treti: Interesimi 339
Së katërti: Ndjeshmëria emocionale 340
Së pesti: Kujdesit për fëmijët 342
Së gjashti: Dhuratat 342
Së shtati: Lavdërimi për meritat 343

Kapitulli i Pestë: I Dërguari dhe gjendjet e jetës së tij 345
I Dërguari dhe begatitë 347
1. Para gjumit 348
2. Pas zgjimit 348
3. Me shokët e tij 349
4. Pritja e bukur e begative 349

5. Prej begative më të mëdha: Udhëzimi 350
6. Shkallët e falënderimit..... 350
I Dërguari dhe vështirësitë 351
I Dërguari dhe pasuria 356
I Dërguari dhe aktiviteti fizik 362
I Dërguari dhe sëmundja 367
I Dërguari dhe mjekësia..... 372
I Dërguari dhe udhëheqja..... 383
Së pari: Qartësia e idesë dhe qëllimit..... 385
Së dyti: Nxitja për marrje e detyrave përsipër 386
Së treti: Urtësia në marrjen e vendimeve 388
Së katërti: Planifikimi i mirë..... 389
Së pesti: Menaxhimi i krizave 390
Së gjashti: Vëmendja dhe parapërgatitja..... 390
Së shtati: Zgjedhja e personave të aftë 391
Së teti: Konsultimi (Shura) 392
Së nënti: Guximi 395
Së dhjeti: Ndershmëria dhe besueshmëria 395
Së njëmbëdhjeti: Falja dhe përfshirja..... 395
Së dymbëdhjeti: Ruajtja e pozitës së udhëheqësve dhe fisnikëve 396
Së trembëdhjeti: Fitimi i zemrave të njerëzve dhe përmbushja e nevojave të tyre..... 397
Së katërmbëdhjeti: Vendosja e drejtësisë 398
Së pesëmbëdhjeti: Shembulli i mirë..... 398
I Dërguari dhe njohja e realitetit 399
I Dërguari dhe udhëtimi 404
I Dërguari dhe lufta..... 411
I Dërguari dhe fitorja 418
I Dërguari dhe paqja shoqërore 421
Së pari: Ruajtja e paqes shoqërore..... 423
Së dyti: Shmangia e asaj që mund të prishë paqen shoqërore 425
Së treti: Trajtimi i situatave që mund të shkaktojnë përçarje 427
Së katërti: Parandalimi i shkaqeve të përçarjes shoqërore 428
Së pesti: Përgatitja e shoqërisë me shkaqet e afërsisë dhe harmonisë shoqërore 429
Së gjashti: Paralajmërimi kundër përçarjes së bashkësisë së përbashkët ... 429
I Dërguari dhe politika e jashtme 430

I Dërguari dhe e ardhmja 434

Kapitulli i Gjashtë: I Dërguari dhe thirrja e tij - daveti 443
Edukimi profetik 445
1. Ngritja e pyetjes dhe kërkesa për përgjigje, pastaj sqarimi i përgjigjes së synuar 448
2. Përdorimi i mjetit ilustruese 448
3. Dhënia e shembullit krahasues 449
4. Përafrimi i kuptimit me anë të skenës imagjinare 449
5. Kujdesi i veçantë për ata me mendje të shëndoshë dhe dijeni 450
6. Edukimi profetik iu jepej me dashuri, mëshirë dhe kujdes prindëror 451
I Dërguari dhe leximi 453
I Dërguari dhe thirrja - daveti 456
I Dërguari ligjërues - *hatib* 461
I Dërguari dhe Umeti i tij 470
Kjo pozitë dhe dashuri për Umetin shfaqet qartë në shumë aspekte: ... 471
Së pari: Interesimi dhe kujdesi i madh për Umetin 471
Së dyti: Kujdesi për brezat e ardhshëm 471
Së treti: Paralajmërimet për sprovat 472
Së katërti: Dashuria për shumimin e Umetit 473
Së pesti: Lehtësimi për Umetin 474
Së gjashti: Lutjet e tij për Umetin 474
Së shtati: Lutja e pranuar, ndërmjetësimi i madh 476
Së teti: Largimi i ndëshkimit nga Umeti 476
Të folurit e të Dërguarit 478
1. Mënyra e të folurit 478
2. Shkurtësia dhe përmbledhja 478
3. Dialogu dhe shembujt 479
4. Përsëritja për theksim 480
5. Pastërtia e fjalës 480
6. Betimi për theksim 481
7. Fuqia e ndikimit 481

Kapitulli i Shtatë: I Dërguari në mjedisin e tij 485
I Dërguari dhe mjedisi i Mekës 487
I Dërguari dhe mjedisi i Medinës 494
Shtëpitë e të Dërguarit 498

Xhamia e Pejgamberit 504
Dita e të Dërguarit 510
Nata e të Dërguarit 515
I Dërguari dhe ushqimi 518
Veshja e të Dërguarit 525
Mexhlisi profetik 531
1. Mexhlisi pas namazit të sabahut 531
2. Mexhlisi i paradites - *Duha* 531
I Dërguari në rrugë 537
1. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në rrugët e Medinës 537
2. Ecja e tij në rrugë 538
3. Aroma dhe shkopi i tij në rrugë 538
4. Thjeshtësia e tij në rrugë 539
5. Buzëqeshja e tij 539
6. Mirësjellja me fëmijët 540
7. Mirësjellja në përshëndetje 540
8. Thjeshtësia dhe afërsia e tij 540
9. Afërsia dhe dashamirësia në rrugë 541
10-Udhëtimi në rrugë si mundësi për mësim dhe thirrje 541
I Dërguari dhe tregu 543
I Dërguari dhe trajtimi i kafshëve 548
Së pari: Ndalimi i torturimit të kafshëve 549
Së dyti: Urdhri për butësi me kafshët gjatë therjes 550
Së treti: Urdhri për butësi ndaj kafshës gjatë përdorimit 551
Së katërti: Ndalimi i mallkimit dhe fyerjes së kafshëve 553
Së pesti: Urdhri për mirësjellje ndaj kafshëve 553

Kapitulli i Tetë: Përmbyllja e librit 555
I Dërguari dhe vdekja 557
I Dërguari drejt Zotit të Lartë 562
Bota e gjerë e të Dërguarit 568
1. Dija për Allahun 570
2. Zbulimi i dijeve që nuk iu zbuluan askujt tjetër 572
3. Skenat e botës tjetër dhe hollësitë e gjendjeve të saj 573
4. Dimensionet e kohës dhe të hapësirës 574
5. Bota e kafshëve 574

6. Bota e sendeve të pajeta 575
7. Shikimi i vendlindjeve dhe vendperëndimeve të tokës 576
Shenjat e pejgamberisë nga Sira e tij 577
Vështrim i përgjithshëm mbi jetën profetike 585

Kushtim

Motrës time, shoqes dhe nënës, krahas nënës time. Asaj që ndau me mua lojën e fëmijërisë, ëndrrat e rinisë, më shoqëroi në fazat e jetës dhe duroi me mua brengat e saj. Asaj që ishte për mua një shoqëri, mbështetje, ndihmë dhe bekim. Asaj që gjithmonë është me ne, dhe është referencë për ne... Motrës sime: Umu Naif Munira al-Nassir el Turejri!

Bashkëshortit të saj: Vëllait tim, shokut tim dhe dhëndrit tim: Ebu Naif Saud bin Abdurrahman el Asimi!

Djemve: Naifit dhe Umerit!

Vajzave: Hissa, Nouf, el Anod, Hifa dhe Dima Saud al Asimi!

"Mëshira e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi ju - familjen e të Dërguarit. Me të vërtetë, Ai është i Falënderuar dhe i Lavdëruar!" (Hud: 73)

Falënderim dhe lutje

Për vëllain tim, Ebu Abdurrahman Abdullah bin Nasir el Bedrani. Ky libër nuk do të kishte arritur në këtë formë pa mendimet dhe mbikëqyrjen e tij. Ai ishte një motivues për vendosmërinë time, një ndihmues me këshilla, një mbështetje dhe forcë. Në përkushtimin e tij ka energji dhe vendosmëri, në këshillat e tij ka drejtësi dhe urtësi. Sa shpesh fjalët e tij kanë mbjellë mendime në shpirtin tim që janë rritur, kanë lulëzuar dhe kanë dhënë frytet e tyre. Kam ndjerë gjithmonë që njeriu është i vogël me veten e tij, por bëhet i madh me vëllain e tij. Ai është mbështetës në punë dhe bashkëpunëtor në realizim.

Për këtë, i lutem Allahut që t'i dhurojë shpërblimin e kësaj vepre, t'i dhurojë shpërblimin, begatinë dhe mirësinë e saj, dhe t'i japë atij më të mirën që i është dhënë ndonjëherë vëllait për vëllain e tij. Lutem që Allahu t'ia vazhdojë begatitë e Tij, ta mbrojë shëndetin e tij dhe ta shpërblejë për mundin dhe përpjekjen e tij!

"Vërtet, Zoti im është i Butë me kë të dojë; Ai është i Gjithëdijshmi dhe i Urti!" (Jusuf: 100)

Gjithashtu, një falënderim shkon për mikun tim, Shejh dr. Feisal bin Ali el Beadani, i cili rishikoi draftin e librit ndërkohë që ishte ende në fazën e krijimit dhe formimit. Ai e lexoi atë me vëmendje dhe përfitim, duke e mbështetur dhe plotësuar me sugjerime të hollësishme dhe shtesa të vlefshme, duke marrë shumë kohë dhe mund nga ai. Ai e risolli librin në një formë më të plotë dhe më të përkryer. Për këtë, unë i jam mirënjohës, e falënderoj dhe për të kam një lutje të sinqertë që Allahu ta shpërblejë për mundin e tij. Vërtet, ai është miku i dijes, me përulësi dhe mirësi, i sjellshëm dhe bujar. Lutem që Allahu të shpërblejë shumëfish mundin e tij dhe t'i japë shpërblimin më të madh dhe më të plotë.

Po ashtu, falënderoj miqtë e mi, dr. Enes el Sermini dhe Shejh Ahmed bin Muhamed el Devseri, të cilët rishikuan librin dhe më dhanë disa komente të vlefshme që më ndihmuan shumë. U shpreh falënderimet dhe lutjet e mia më të sinqerta.

Parathënie

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

Një përshëndetje e bekuar dhe e pastër nga Allahu!

Një nga dhuntitë më të mëdha që na ka dhënë Allahu është dërgimi i Pejgamberit të Tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në mesin tonë:

"Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) ***e urtësinë*** (diturinë e thellë fetare)**."** (Ali Imran: 164)

Nga plotësimi i kësaj dhuntie për këtë Umet është ruajtja e jetëshkrimit të tij - *Sira* dhe Sunetit të tij, duke i mbajtur të gjalla rrëfimet dhe gjendjet e tij. Jeta e tij ka mbetur e pranishme ndër brezat e Umetit të tij, brez pas brezi, në një mënyrë të tillë që çdo brez e njeh atë ashtu siç e njohën ata që jetuan me të dhe e shoqëruan përgjatë jetës së tij.

Nëse shokët e tij, *sahabët,* patën nderin e madh ta shoqërojnë dhe ta takojnë atë (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), atëherë brezat pas tyre kanë nderin të jenë trashëgimtarë të tij, duke përcjellë diturinë e tij dhe duke ruajtur jetëshkrimin e tij - *Sira*.

Pejgamberi fisnik (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është i pranishëm përmes jetës dhe mësimeve të tij në çdo brez të Umetit të tij, pa marrë parasysh sa shumë vite kanë kaluar.

Edhe pse ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u largua nga kjo jetë për te Zoti i Lartë, ai mbetet i gjallë në ndërgjegjen e Umetit të tij, *me një jetëshkrim - Sira të dokumentuar qartë dhe të ndritshëm*, sikur e shohim me sytë tanë. Ne njohim detajet e jetës së tij, hollësitë e gjendjes së tij. Dimë tiparet e fytyrës së tij, ecjen e tij, fjalët e tij kur fliste, leximin e tij kur recitonte, faljen e tij kur falej. Dimë rrobat që vishte, ushqimin që hante, shtëpinë ku banonte. Dimë marrëdhëniet e tij me shokët, afërsinë e tij me gratë e tij dhe gjendjen e tij në çdo aspekt të jetës së tij - aq sa duket sikur ai është ende i gjallë dhe jeton mes nesh.

Ndërsa të krishterët nuk e kanë këtë qartësi dhe prani për jetën e pejgamberit të Allahut, Isait (*paqja e Allahut qoftë mbi të*), ata e kanë zëvendësuar këtë mungesë me imagjinatë, duke e paraqitur në piktura dhe statuja të sajuara, të vendosura në manastire dhe kisha, për t'i dhënë atij një prani të ndjeshme në jetën e tyre.

Ndërsa për muslimanët, ajo që ata dinë nga jetëshkrimi - *Sira* e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është e mjaftueshme për ta konceptuar atë pa pasur nevojë për portretizim me ilustrime apo statuja. Për ata, i Dërguari është një imazh, kurse për ne, ai është një jetë - *Sira* e gjallë.[1]

Më herët kam bërë një përmbledhje në një libër të vogël për programin ditor të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), duke përshkruar çfarë bënte ai gjatë ditës, nga mëngjesi deri në mëngjesin tjetër, me titull "Dita Profetike". Më pas mendova ta plotësoj këtë duke përmbledhur një libër që paraqet "Jetën Profetike" në gjithë gjerësinë, shtrirjen dhe larminë e saj, duke e shqyrtuar nga këndvështrime të ndryshme dhe duke treguar për gjendjet dhe udhëzimet e tij, në ato aspekte që janë të përbashkëta për njerëzit në jetën e tyre. Kjo pasi librat e *Sira*-s janë përqendruar kryesisht te betejat dhe Xhihadi, ndaj edhe fillimisht janë quajtur "Librat e Betejave". Kurse librat "Karakteristikat" - *Shemail* janë fokusuar te morali dhe disa aspekte të jetës së tij. Për këtë arsye, unë pashë të nevojshme të riafroj këtë temë në një mënyrë më gjithëpërfshirëse, duke përmbledhur momente të ndryshme të jetës së tij, për të krijuar një imazh të plotë të udhëzimit profetik dhe jetës së tij në aspekte të ndryshme të adhurimit, moralit, bashkëveprimit, marrëdhënieve, zakoneve etj.. Sipas pozicioneve:

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* si bashkëshort, si baba, si mik;

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe Kurani, namazi dhe agjërimi;

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në xhami, në treg, në rrugë;

[1] Përfitim nga një diskutim me mikun tim dr. Ömer Faruk Korkmaz

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me shokët, me fëmijët, me shërbyesit;
I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në mexhlisin e tij, në shtratin e tij, në sofrën e tij;
I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe edukata, bukuria, argëtimi dhe këndimi etj.

Ky është një riformulim për "Karakteristikat profetike" – *Shemail,* një paraqitje e jetës së tij, e cila përbën një përbashkësi të jetës njerëzore sipas zbatimit të tyre në praktikën profetike. Kam kërkuar që të përfshij ato aspekte që lidhen me jetën e përgjithshme të njerëzve dhe me çështjet që kanë rëndësi në përditshmërinë e tyre.

Ky projekt ende nuk ka përfunduar plotësisht. Ka ende tema të rëndësishme që janë në përgatitje dhe ndoshta do t'i përfshij në një pjesë të dytë, me lejen e Allahut të Lartësuar.

Edhe pse libri është ende në fazën e përgatitjes, kam vendosur ta publikoj atë pjesërisht, me shpresën se kjo do të shërbejë si një shtysë për ta përfunduar, si dhe për të lehtësuar korrigjimet dhe sugjerimet. Do të më gëzonte shumë të pranoja komente, korrigjime dhe shtesa nga ata që do ta lexojnë.

Lus Allahun të na bëjë prej atyre që bashkëpunojnë në mirësi dhe devotshmëri, që këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën dhe durimin! Lus Allahun të na bashkojë në shoqërinë e Pejgamberit tonë (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), të jemi pranë tij te burimi *Havd*, të na dhurojë ndërmjetësimin e tij dhe të na nderojë me shoqërinë e tij: ***"Në kopshtet e Xhenetit, ku rrjedhin lumenj, në kuvendin e së vërtetës*** (në Xhenet)***, tek një Sundues i Plotfuqishëm."*** (El-Kamer: 54-55)[2]

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju!

Abdulvehab el Turejri Eba el Hajl
Başakşehir, Stamboll
12 Rabi' el Evvel, 1443 H

[2] **Shënim i përkthyesit**: Përkthimi i ajeteve të Kuranit është marrë nga përkthimi i Hasan Nahit.

Kapitulli i Parë:

Pararendësit e librit

Rrugëtimi me Sira-n

Marrëdhënia ime me *Sira*-n Profetike filloi që në shkollën fillore, kur babai im më dha një libër mbi *Sira*-n, të cilin ende e kujtoj për ilustrimet e faqeve të tij, ndonëse nuk mbaj mend titullin apo autorin - gjë që nuk kishte rëndësi për dikë të moshës sime atëherë.

Ajo që më tërhoqi vëmendjen në atë libër ishte rrëfimi përshkrues i *Sira*-s, dhe veçanërisht përshkrimi i Betejës së Bedrit, që më bëri ta imagjinoj skenën dhe të ndërveproj me të. Ndjeva një kthesë në leximin e *Sira*-s. Ishte një përvojë krejt ndryshe nga mënyra se si *Sira* na prezantohej në shkollë, ku shndërrohej në një listë të fakteve të thata, thjeshtë emra dhe numra, si: "Si quhej nëna e Profetit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)? Kush e ushqeu atë me gji? Sa ishte numri i ushtrisë muslimane në Bedër? Sa dëshmorë pati në Uhud? Kur ndodhi Beteja e Hendekut?" - sikur të ishte një pyetësor dhe jo një histori që duhej përjetuar.

Më pas lexova librin "*Fikhu el Sira*" të Shejh Muhamed el Gazalit, i cili më magjepsi me stilin e tij letrar të mrekullueshëm dhe emocionin që përcillte. Kisha dëgjuar se lotët e tij përziheshin me bojën ndërsa e shkruante këtë libër. Një vepër e nënvlerësuar, e cila nuk ka marrë famën e librave të tjerë që dolën më pas, edhe pse nuk arritën ta kapin madhështinë e tij e as t'i afrohen.

Më pas, u thellova në "*Zadu el Mead*" të Ibn Kajimit (Allahu e mëshiroftë), një vepër e një kalibri krejt tjetër në qasjen ndaj *Sira*-s, duke nxjerrë nga ajo udhëzimin profetik. Ky është një lexim që më ka dhënë begati dhe fryte deri në ditët e sotme.

Ndikimi i këtij leximi u thellua më shumë kur kisha mundësinë të dëgjoja hadithet e *Sira-s,* duke u lexuar para Shejh Abdulaziz bin Baz (Allahu e mëshiroftë). Reagimet dhe ndërveprimi i tij me ngjarjet e rrëfyera në hadithe ishin të mrekullueshme. Sikur i shihte me sytë e tij ato që dëgjonte. Ai i përjetonte ngjarjet me emocionet dhe ndjenjat e tij. E kujtoj sesi gjatë leximit të hadithit për shpifjen ndaj Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të), fytyra e tij u skuq, buzët iu drodhën dhe emocionet e kapluan aq shumë sa nuk mundi të

komentonte më shumë sesa disa fraza të copëzuara, që i ndërpreu nga emocionet e thella.

Një tjetër moment i paharrueshëm ishte kur ai e përshkruante Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) gjatë Haxhit të Lamtumirës, kur tha: "*O Allah, dëshmo! O Allah, dëshmo!*" - duke imituar lëvizjen e gishtit të tij dhe duke përsëritur: "*Ne dëshmojmë! Ne dëshmojmë!*" - derisa lotët ia ndërprenë fjalët. E të tjera skena të ngjashme që e bënë jetën me *Sira*-n një përvojë plot shije dhe ndjenjë.

Ndikim të madh në përjetimin e *Sira*-s pati edhe Shejh Muhamed el Rravi (Allahu e mëshiroftë), i cili gjatë hytbeve të tij i rrëfente ndodhitë e saj me një zë të fuqishëm, një gjuhë të pasur dhe një stil elokuent. E mbaj mend se një ditë, kur ai po largohej nga departamenti i Kuranit, e ndala dhe e pyeta për metodën më të mirë për të lexuar dhe përcjellë *Sira*-n. Ai u ndal dhe më dha një përgjigje të gjatë, të cilën e përmbylli me një fjali të thellë dhe të përmbledhur: "Sira Profetike nuk është thjesht një histori e së kaluarës, por një Sunet që do të mbetet i përjetshëm."

Më pas, u grumbullua një sasi e madhe materiali pasi fillova të jap leksione për miqtë e mi mbi *Sira*-n, duke e studiuar atë nga libri "*Siretu Ibn Hisham*" të komentuar nga El Suhejliju në "*El Ravdu el Unuf*".

Por kuptimin më të plotë të *Sira*-s e fitova duke lexuar librat e hadithit: "*Dy Sahihët*", "*Sunenet*", "*El Musned*" dhe veprat që përmblidhnin hadithet, si "*El Xhamiu Bejne el Sahihajn*", "*Xhamiu el Usul*" dhe "*Xhamiu el Usul el Tis'atu*" e të tjera.

Këto burime të sjellin një tablo të plotë të jetës së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) - jo vetëm në betejat dhe karakteristikat e tij, por në çdo ditë të tij, në çdo detaj të *Sira*-s. Ai del nga sfera e ngjarjeve historike dhe hyn në realitetin e jetuar të jetës së përditshme.

Lexuesi i këtyre burimeve, *librave të hadithit*, vazhdon të thellohet në to, duke mediuar mbi hadithet e *Sira*-s dhe ngjarjet e saj, duke i analizuar me kujdes dhe duke lidhur mes tyre episodet, derisa tabloja e plotë të formohet në mendjen e tij dhe skena të bëhet e qartë, duke u zhdukur pengesat e kohës dhe të hapësirës. Atëherë ai sikur e përjeton vetë ngjarjen dhe realitetin e saj; sikur

hyn në xhaminë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ashtu siç është përshkruar, e sheh Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) duke dalë nga shtëpia e tij për t'u drejtuar drejt mihrabit të tij, ndjek hapat e tij, dëgjon leximin e tij, njeh tiparet e tij, sodit shkëlqimin e fytyrës së tij dhe nurin e saj. Ai e dallon ecjen e tij kur lëviz, vështrimin e tij kur shikon, tonin e zërit të tij kur flet dhe mënyrën se si ulej në mexhlisin e tij.

Kur e lexon *Sira*-n në këtë mënyrë, fillon të përfytyrosh gjithçka sikur je aty. Të duket sikur je duke u ulur vetë në atë mexhlis me *sahabët* - shokët e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), i njeh të gjithë me tiparet dhe pamjet e tyre. Dëgjon bisedat e tyre dhe e ndjek çdo fjalë që ata thonë. E sheh Ebu Bekrin, të urtin dhe të butin; Umerin, të fuqishmin dhe të drejtin; Uthmanin, fisnikun dhe të turpshmin; Aliun, të riun e fuqishëm; Ibn Mesudin, të voglin trupvogël, por thesar në dije; dhe Enesin, shërbëtorin e dashur të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë.

Kjo përvojë të zhvillon një nuhatje dhe shije të veçantë, që e kupton përfundimin e hadithit përpara se ai të përfundojë, dhe fundin e historisë para se të mbyllet. Mund të parashikosh atë që mund të ndodhë, dhe e jeton ngjarjen sikur je pjesë e saj, dhe e rrëfen sikur të kishe qenë aty.

Kështu ndodhi me Ibn Umerin (Allahu qoftë i kënaqur me ta), kur e dëgjoi dijetarin El Sheabi duke treguar ngjarjet e betejave. Ibn Umeri tha: "*Ai po i tregon sikur të kishte qenë aty! Ai i kujton ato më mirë se unë, edhe pse unë isha prezent në ato ngjarje me Pejgamberin (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).*"[3]

Një aftësi e tillë e plotë ishte e pranishme te imamët e hadithit, si Maliku, Ahmedi, Buhariu, Ali bin el Medini, Tirmidhiu dhe të tjerë. Pra, njohuria e tyre për transmetimin e haditheve dhe korrektësia e tyre nuk ishte thjesht një zanat, shkencë teknike, por krahas saj vinte me një intuitë të thellë që ishte formuar nga praktika dhe koha e gjatë e shoqërimit. Dhe çdo kush që ndjek rrugën e tyre merr

[3] Tarihu Ibn Ebi Hajtheme (1798). Muaxhemul Tabarani el Kebiru (13/181). Tarihu Bagdad (14/143). Tarihul Islam i Dhehebiut (3/70).

një pjesë nga ajo që ata kanë dhe secili merr nga deti i gjerë i njohurisë, sipas kapacitetit të tij dhe hapësirës që Zoti ia ka dhënë.

Sa më shumë e njeh Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), aq më shumë e do, ndjen mall, e admiron dhe kupton urtësinë e përzgjedhjes hyjnore: ***"Allahu zgjedh të dërguar nga engjëjt dhe njerëzit."*** (El-Haxh: 75); ***"Allahu e di më mirë se kujt ia jep mesazhin e Vet."*** (El-En'am: 124) Kështu zbulova hapësirat e modelit për t'u ndjekur në jetën profetike, pasi ky është fryti më i madh i njohjes së *Sira*-s. Kjo është esenca e ndjekjes së *Sira*-s: të njohësh shembullin më të madh të jetës.

Fakti që unë u rrita në një mjedis tradicional arab në qytetin e Zulfit dhe njohja ime me kulturën e jetës së vjetër Nexhdiane, për shkak të afërsisë së kohës me të, më ndihmuan të përfytyroj më mirë jetën e Profetit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), pasi shumë prej zakoneve dhe objekteve ishin të njëjta me ato të kohës së tij: enët e ushqimit, mënyrat e jetesës, ritmet e ditës. Të kuptoj mjedisin profetik në Medinë dhe të kuptoj mënyrën e jetesës atje. Kjo ndodhi për shkak të ngjashmërisë së realitetit, ambientit dhe kushteve me ato që ishin dikur të gjalla në Nexhd. Mjetet ishin të njëjtat, me emrat dhe realitetin e tyre: tasa, pjatanca, kova e ujit, shala e devesë, shkopinjtë e lakuar, lëkurët e ujit, enët e drurit, thërrimet e bukës me lëng, mishi i thatë, qumështi i tharë dhe përzierjet e ëmbëlsirave, të cilave mund t'u kenë ndryshuar disa emra, por jo thelbi i tyre.

Po ashtu, edhe mënyra e jetesës ishte e ngjashme: zgjimi herët në agim, pushimi para mesditës, ngrënia e drekës paradite dhe darkës pas ikindisë ose në perëndim të diellit.

Të gjitha këto pamje u bënë për mua mjete shpjeguese që më afruan me përfytyrimin e ngjarjeve dhe kushteve të asaj kohe. Nuk pata nevojë të pyesja se çfarë ishte **"el-akit"** (qumështi i tharë), **"el-garb"** (kova e ujit), **"ed-dab"** (lloj hardhuce) apo **"es-sa'dan"** (lloj bime shkretëtire), sepse të gjitha këto ishin të zakonshme në mjedisin tim.

Kjo më dha aftësinë të përfytyroj jetën profetike ashtu siç ishte dhe të rrëfej *Sira*-n me një ndjeshmëri të thellë, duke e bërë atë më shumë se një histori - një përvojë të gjallë për lexuesin, pasi munda

të kap diçka që akoma kishte mbetur prej saj dhe të shoh gjurmët e saj, gjë që më bëri të formoj një tablo të plotë në imagjinatën time. Rrallëherë kam folur për një skenë pa e përfytyruar më parë para syve të mi dhe, kur flisja, e përshkruaja atë që shihja, jo thjesht atë që kisha lexuar.

Kur shkrova librin "*Përshkrimi i Haxhit të Pejgamberit* (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)", disa më thanë: "Dukej sikur po shikonim një film ose një skenë para syve tanë."

Librat e njohur të *Sira*-s, të cilët janë përmbledhje e *Siretu Ibn Hishami*-t - ata që kanë ndjekur të njëjtën qasje, janë përqendruar kryesisht te betejat dhe mrekullitë. Nuk ka asgjë për t'u kritikuar në këtë, pasi qëllimi i tyre ka qenë ky, që në fillimet e hartimit të tyre dhe, për këtë arsye, në fillim janë quajtur *Magazi* (betejat).

Lexuesi i këtyre librave gjen një paraqitje të ngjarjeve madhore në jetën e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), por aspektet e ndjekjes së shembullit të tij nuk trajtohen plotësisht në to. Ngjarjet e *Hixhretit* dhe të betejave nuk janë pjesë e përditshmërisë së shumicës së muslimanëve, ndërsa aspektet e ndjekjes së udhëzimit profetik janë shumë më të gjera dhe më gjithëpërfshirëse. Çdo musliman është i etur të dijë për gjendjen e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në përditshmërinë e tij dhe në të gjitha çështjet e jetës së tij. Kjo është pikërisht ajo që kanë trajtuar librat "Karakteristikat profetike" - *Shemail* dhe që është shpërndarë nëpër *librat e hadithit*.

E gjithë kjo më nxiti të përpiqem të ofroj një përshkrim më të afërt të *Sira*-s profetike, duke kaluar përtej rrëfimeve të betejave drejt ngjarjeve të jetës së përditshme dhe duke bashkuar pjesët e shpërndara të skenës në një tablo sa më të plotë.

Kjo është qasja që kam ndjekur në rrëfimin dhe shkrimin e ngjarjeve të *Sira*-s, duke gjurmuar transmetimet e shpërndara të çdo ngjarjeje dhe duke u përpjekur t'i bashkoj si copëzat e mozaikut, në mënyrë që të formohet një tablo e plotë. Kështu, shpirti gjen kënaqësi dhe ngopje nga skenat e *Sira*-s dhe bëhen më të qarta vendet e frymëzimit dhe shembullit për t'u ndjekur.

Kjo është fuqia e *Sira*-s kur tregohet në mënyrë të gjallë ajo bëhet realitet. Për këtë arsye, përpjekja ime është të jap një pasqyrë

më të plotë të *Sira*-s, duke kaluar nga rrëfimi i betejave te jeta e përditshme e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), ashtu siç u përpoqa ta bëj në librat e mi "*Një ditë me Profetin*", "*Histori Profetike*", "*Si të ishe me të*", "*Fjalimi i Gadirit*", "*Varri i Shenjtë*", "*Gjurmët Profetike*", "*Vendet Profetike*" dhe "*Pikat kryesore të Sira*-s".

Veçoritë e Sira-s Profetike

Sa e sa biografi dhe autobiografi janë shkruar! Megjithatë, ka disa veçori që e dallojnë biografinë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nga të gjitha biografitë e shkruara dhe që do të shkruhen. Këto janë veçori unike, të cilat nuk i gëzon askush tjetër përveç tij. Ndër këto veçori janë:

Së pari: Qartësia
Së dyti: Gjithëpërfshirja
Së treti: Kompletimi
Së katërti: Lehtësia
Së pesti: Madhështia

Më poshtë, është një përshkrim i shkurtër për secilën prej tyre.

Së pari: Qartësia

Sira e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është e qartë dhe e ndritshme, pa episode të humbura, pa zona të errëta dhe pa pika të paqarta. Përkundrazi, ajo na shfaq Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), i cili jetoi para katërmbëdhjetë shekujsh, sikur të ishte mes nesh sot.

Ne njohim çdo detaj të jetës së tij. Një orientalist, duke përshkruar jetën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), thotë: "Ai është një profet që ecën nën diell", duke nënvizuar qartësinë dhe ndriçimin e jetës së tij.

Ai që lexon biografinë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ndien sikur ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka jetuar në një shtëpi prej xhami; jeta e tij ka qenë e hapur dhe transparente, pa ndarje mes jetës publike dhe asaj private.

Për këtë arsye, them me plot siguri: Unë di më shumë për Pejgamberin tim (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) sesa për babanë tim.

Ne e njohim çdo hyrje dhe dalje të tij, jetën e tij brenda shtëpisë, mënyrën se si ulej në sofër, si kalonte kohën me familjen, kur zgjohej e kur flinte, madje edhe tingullin e frymëmarrjes së tij gjatë gjumit. E gjitha kjo është kaq e qartë, sikur ta dëgjojmë me veshët tanë dhe ta shohim me sytë tanë. Ndërsa çdo njeri ka një sferë të jetës së tij që mbetet private dhe sekrete, e pazbuluar për të tjerët, te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk kishte asgjë të fshehtë apo të errët. Madje, edhe me gratë e tij, ai nuk i ndalonte ato të tregonin për çështjet e tij personale, dhe ato nuk fshihnin asgjë nga jeta e tij.

Nuk ka asnjë njeri të madh, pa pasur aspekte të jetës së tij, që përpiqet t'i fshehë dhe t'i mbajë të pazbuluara, duke u frikësuar se mos njerëzit marrin vesh për to. Aspekte që lidhen me epshin e tij, me familjen e tij, ose që tregojnë dobësinë dhe devijimin e tij. Ndërsa Muhamedi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është i vetmi që e ka zbuluar të gjithë jetën e tij për njerëzit, duke e bërë atë një libër të hapur, pa asnjë faqe të mbyllur dhe asnjë rresht të fshirë, ku kushdo mund të lexojë çfarë të dojë.

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte i vetmi që u dha leje shokëve të tij ta përcillnin çdo gjë që ndodhte prej tij dhe ta transmetonin atë. Prandaj, ata treguan gjithçka që panë nga gjendjet e tij, si në momentet e qetësisë, ashtu edhe në momentet e dobësisë njerëzore - në çastet e zemërimit, dëshirës dhe emocioneve. Po ashtu, edhe gratë e tij përcollën gjithçka që ndodhte mes tij dhe tyre.

Më tregoni një tjetër njeri të madh që ka guxuar të marrë një rrezik të tillë dhe t'u thotë njerëzve: "Ja ku është e gjithë biografia - *Sira* ime, të gjitha veprat e mia, njihuni me to dhe përcillini si tek

miku ashtu edhe tek armiku, dhe le të gjejë kush të dojë ndonjë mangësi në to."

Më tregoni një tjetër njeri të madh, biografia - *Sira*-ja e të cilit është dokumentuar me kaq detaje, ku ngjarjet dhe të fshehtat e saj janë njohur pas një mijë e treqind vjetësh, ashtu siç njohim *Sira*-n e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)[4].

Për këtë arsye, pasuesit *Tabiinët* vinin me besim të plotë dhe i thoshin Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të): "Na trego se çfarë bënte Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në shtëpinë e tij"*[5], dhe ajo nuk u tha asnjëherë: "Kjo është një çështje private mes nesh", por përgjigjej gjithmonë me qartësi, dhe kjo është diçka që nuk mund ta gjesh në asnjë biografi tjetër përveç *Sira*-s së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)[6].

Kjo qartësi në jetën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bëri që brezat e muslimanëve të jetojnë me *Sira*-n e tij dhe të njohin karakteristikat e tij, sikur t'i kishin parë me sy.

Së dyti: Gjithëpërfshirja

Jeta e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ishte e ngushtë, monotone dhe pa zhvillime, por ishte një jetë e gjerë dhe me plot zhvillime, e mbushur me situata të larmishme dhe forma të ndryshme në aspektet e saj. Mund të takosh një person që ka jetuar më shumë se njëqind vjet, por, kur flet me të, do të gjesh se jeta e tij është një vit i përsëritur njëqind herë. Ndërkaq, jeta e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, edhe pse relativisht e shkurtër, ishte një jetë e gjerë, e pasur dhe e mbushur me ndryshime situatash dhe rrethana e kushte të reja herë pas here, dhe ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjithmonë kishte një qëndrim të ri në çdo situate të re.

Gjatë *Sira*-s shohim se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në jetën e tij ka kaluar nëpër periudha me numër të

[4] Shkurtuar nga: "*Prezantim i përgjithshëm i fesë islame"* nga Ali Tantavi (f. 169-170).
[5] Buhariu, 676.
[6] Shihni detajet e këtij kuptimi në "*Muhadaratun fi el Sireti el Nebevijeti*" nga Shejh Sulejman el Nedevi.

vogël pasuesish dhe periudha me numër të madh. Ai është ai që e pyeti Umer bin Abese në Meke: "Sa njerëz janë me ty në këtë rrugë?" dhe ai u përgjigj: "*Një i lirë dhe një skllav!*"[7] Pastaj e shohim Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kur hyn në çlirimin e Mekes të rrethuar nga dhjetë mijë shpatë *shoqërues.* Ndërsa kur bëri Haxhin e Lamtumirës me të ishin më shumë se njëqind mijë njerëz.

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kaloi periudha varfërie dhe mungese të pasurisë, derisa mund të *kalonin dy-tre muaj dhe në shtëpinë e tij nuk ndizej zjarr për të gatuar*[8]. Ndonjëherë ai *lidhte një gur mbi bark nga uria*[9]. Por ai kaloi edhe periudha pasurie dhe bollëku, kur pasuria iu soll dhe u vendos para tij në xhami, ndërsa ai e ndau atë mes njerëzve duke ua mbushur rrobat me pasuri[10].

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përjetoi periudha shëndeti dhe sëmundje, ai jetoi një jetë të shëndetshme dhe pa sëmundje, por pati raste që u sëmur prandaj thoshte: "*Unë përjetoj dhimbje sa dy burra prej jush!*"[11]

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përjetoi gëzime dhe hidhërime. Ai shijoi gëzimin e atësisë, u gëzua për fëmijët dhe bijat e tij dhe, po ashtu, përjetoi dhimbjen e humbjes, dhe vuajti dhimbjen e prindërve që humbin fëmijët. Ai qëndroi pranë varrit të vajzës së tij, Zejnebit, dhe sytë e tij ishin plot lot që rridhnin mbi fytyrën e tij të bekuar.[12]

Ai ndjeu shijen e fitores, por nuk u mburr dhe nuk përçmoi. Përkundrazi, ai u përul me mirënjohje ndaj Allahut. Hyri në Meke triumfues, rreth tij kishte dhjetë mijë shpatë, por kokën e mbante ulur përpara Zotit, dhe këndonte: ***"Ne të dhamë fitoren tënde të qartë."*** (El-Fet'h: 1)[13]

---

[7] Muslimi, 832.
[8] Buhariu, 2567. Muslimi, 2972.
[9] Buhariu, 4101. Muslimi, 2040.
[10] Buhariu, 2296. Muslimi, 2314
[11] Buhariu, 5648. Muslimi, 2571.
[12] Buhariu, 1342.
[13] Buhariu 7540. Muslimi 794.

Shokët e tij - *sahabët* u mposhtën në Uhud, ndërsa Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u godit në ballin e tij, iu thye njëri nga dhëmbët prerës anësorë - *rebaije*[14] të tij. Gjaku rrodhi në fytyrën e tij[15], dhe shokët e tij - *sahabët* (Allahu qoftë i kënaqur me ta) ranë dëshmorë përreth tij. Por ai qëndroi i palëkundur, nuk iku, qëndroi si shkëmb i fortë dhe i pathyeshëm.

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kaloi situata të ndryshme në marrëdhëniet e tij me të tjerët: në marrëdhënie me muslimanët, politeistët, hebrenjtë, shokët, armiqtë, banorët e qytetit dhe beduinët, si dhe me të rinjtë dhe të moshuarit. Dhe për secilën marrëdhënie ai mbajti qëndrim të veçantë dhe pati udhëzime specifike.

Në bashkëveprimet e tij me jetën, gjejmë një larmi të gjerë situatash në të cilat ai u gjend i pranishëm. Ai ishte i pranishëm në shtëpinë e tij me familjen, në kuvendet me shokët, në xhami, në rrugë, në treg... shohim një përfshirje dhe larmi të roleve të tij në jetë. Për çdo situatë ai kishte qasjen e tij të veçantë, si: thirrës, mësues, bashkëshort, baba, shok, kur bënte *dhikër*, kur këndonte Kuran, kur falej, kur udhëtonte, kur ishte në qytetin e tij, kur luftonte, kur lidhte marrëveshjeve... dhe shumë e shumë situata të tjera të ndryshme në jetën e tij.

Shumëllojshmëria e këtyre situatave në jetën e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është e tillë, saqë rrallë kalon ndonjë situatë në jetën e një besimtari pa gjetur udhëzim në jetën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), dhe situatë të ngjashme ose të afërt me të. Besimtarët do të gjejnë në situatat e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) udhëzime dhe dritë për jetën e tyre. Madje, edhe ata që gabojnë do të gjejnë udhëzime në trajtimin që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i bëri gabimeve të njerëzve në kohën e tij, sepse çdo situatë në jetën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) rrezaton dritë dhe udhëzim për njerëzit.

---

[14] *Rebaije* janë dhëmbët prerës anësorë dy sipër dhe dy poshtë, që vijnë pas dhëmbëve prerës qendrorë. Shiko: *Sherh el Nevevi ala Muslim,* 12/481.

[15] Buhariu, 5722, dhe Muslimi, 1790.

Së treti: Kompletimi

Rrallë mund të lexojmë biografinë ndonjë njeriu të madh, pa zbuluar se aspekti i madhështisë në jetën e tij është përqendruar në një fushë të vetme, mund të jetë madhështi udhëheqëse, ushtarake, shkencore, tregtare dhe kështu me radhë. Në përgjithësi do të shohim që ky aspekt i madhështisë ka dominuar mbi anët e tjera të jetës së atyre. Mund ta shohim një udhëheqës të madh, por që është i dobët në jetën e tij shoqërore; mund të gjejmë një tregtar të pasur, por që është i dështuar në marrëdhëniet e tij; mund të gjejmë një shkencëtar të madh dhe të specializuar në fushën e tij, por që është injorant për çështje të tjera të jetës, dhe kështu me radhë.

Kurse për Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), cilindo aspekt të jetës së tij, të analizojmë, do të mendojmë se ai ka qenë i përkushtuar vetëm në atë aspekt, pasi ai ka qenë shembull në çdo aspekt.

Kur e shqyrtojmë jetën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) si një thirrës, do të shohim se ai e ka jetuar jetën e tij tërësisht i angazhuar me thirrje. Ai ishte thirrës duke ngrënë, në rrugë, mbi *minber*, mes shokëve të tij, në jetën e përditshme dhe gjatë udhëtimeve. Dhe kur e mendon jetën e tij si bashkëshort, do të mendosh se ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kalonte gjithë ditën e tij duke u zhvendosur mes nëntë shtëpive dhe nëntë bashkëshorteve të tij.

Po ashtu, kur e mendon jetën e tij si baba, do të shohësh se ajo është e pasur dhe e mbushur me dashuri, deri në atë masë sa duket se vajzat dhe nipërit e tij ishin i gjithë shqetësimi i tij.

Dhe nëse e shikon jetën e tij me shokët e tij, do të habitesh nga fuqia e pranisë së tij në jetën e tyre. Kështu ishte jeta e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), e kompletuar dhe e ekuilibruar në çdo aspekt, në mënyrë që mund të marrim prej saj një pamje të qartë të balancës në jetë dhe të plotësimit të të gjitha të drejtave të saj. Ai është që tha: *"Ti ke detyrime ndaj trupit tënd, ke detyrime ndaj syve të tu, ke detyrime ndaj gruas tënde dhe ke detyrime ndaj mikut*

tënd."[16] Dhe kjo balancë e mrekullueshme është tregues i profetësisë dhe tregues i jetës së tij të ekuilibruar.

Së katërti: Lehtësia

Një nga tiparet e biografisë - *Sira*-s së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është lehtësia dhe realizmi, si dhe thjeshtësia në ndjekjen e tij.

Ashtu siç e bëri Allahu të lehtë Kuranin për kujtesë: ***"Vërtet, Ne e kemi bërë Kuranin të lehtë për t'u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!"*** (El-Kamer: 22), ashtu e ka lehtësuar edhe *Sira*-n dhe udhëzimet e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për t'u ndjekur: ***"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun."*** (El Ahzab: 21)

Një nga mrekullitë e këtij shembulli është lehtësia e tij, pasi Zoti nuk e bën të vështirë dhe të mundimshëm shembullin që duhet të ndiqet nga i gjithë Umeti.

Për këtë arsye, ai që lexon *Sira*-n e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ndjen afërsinë e saj dhe lehtësinë e pasimit të saj, madje ndoshta mendon se mund të bëjë më shumë se kaq, siç menduan disa të rinj prej *sahabëve*: Tre vetë erdhën te shtëpitë e grave të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe pyetën për adhurimin e tij. Kur u informuan për të, sikur iu duk pak dhe thanë: "Ku jemi ne në krahasim me Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)? Ai është falur për atë që ka kaluar dhe atë që ka mbetur." Prandaj mbajtën qëndrim. Njëri tha: "Unë do të falem çdo natë për të gjithë jetën." I dyti tha: "Unë do të agjëroj çdo ditë të gjithë jetën." Ndërsa i treti tha: "Unë do të shmang gratë dhe nuk do të martohem kurrë." Pastaj erdhi Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tek ata dhe tha: "*Ju jeni ata që thoni kështu e ashtu? Jo, betohem në Allahun se unë jam më i përulur dhe më i devotshëm se ju ndaj Allahut, por unë edhe*

[16] Buhariu, 1975. Muslimi, 1159.

agjëroj edhe ha, edhe falem edhe fle, dhe martohem. Kush largohet nga Suneti im, ai nuk është prej meje."[17]

Ata e menduan si të pakët adhurimin e Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pasi pyetën për disa adhurime të caktuara, si namazi natën dhe agjërimi, ndërkohë që jeta e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është e gjitha adhurim i përhershëm, sepse ishte në përputhje me natyrën e njeriut, dëshirat dhe fuqitë e tij.

Mund të lexosh rreth jetës së shumë njerëzve të mëdhenj dhe të mahnitesh shumë me ta, por jo çdo njeri që admiron është e lehtë ta ndjekësh dhe ta kesh për model. Madje, ndoshta, që në momentin e parë, mund të ndiesh respekt për atë personalitet, por shikon se stili i jetës së tij i përshtatet vetëm atij dhe nuk është i përshtatshëm për të tjerët.

Ndërkaq, jeta e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është modeli që përfshin të gjitha stilet e jetës së njerëzve dhe kushdo që e ka njohur *Sira*-n e tij është mahnitur dhe e ka dashur atë, duke gjetur në të një hapësirë të gjerë shembulli për t'u ndjekur.

A mund të mendohet se Zoti do të na japë një model dhe shembull tjetër për udhëheqje dhe ndjekje përveç këtij modeli të thjeshtë dhe të lehtë? A nuk është vetë Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ai që erdhi me lehtësinë dhe e shpalli atë me fjalët e tij: "*Kjo fe është e lehtë*"?[18]

Së pesti: Madhështia

Madhështia e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është përsosja e madhështisë njerëzore.

Madhështia ose mund të jetë në natyrshmërinë e njeriut, në etikën e tij, në meritat e tij dhe në cilësitë e tij personale.

Ose mund të jetë në veprat e mëdha që ka bërë njeriu i madh.

Ose mund të jetë në gjurmët që ai ka lënë në historinë e popullit të tij dhe në historinë e botës.

---

[17] Buhariu, 5063. Muslimi, 1401.

[18] Buhariu, 39. Shih: "*Adhametu Muhammed Hatem el Nebijjine*" nga shejhu Mustafa el Zurka.

Çdo i madh ka një pjesë të këtyre kritereve me të cilat matet madhështia e tij, ndërsa madhështia e Muhamedit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) matet me të gjitha këto.

Një njeri mund të jetë i madh sepse ka qenë i madh për popullin e tij, për dobinë që i ka sjellë popullit të tij, por në të njëjtën masë ka dëmtuar të tjerët, siç është madhështia e heronjve luftëtarë dhe komandantëve pushtues.

Ose mund të jetë i madh me madhështi botërore, por në një fushë të caktuar.

Kurse Muhamedi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është i madh me madhështi botërore në gjerësinë e saj dhe gjithëpërfshirës i të gjitha fushave dhe aspektet të jetës[19].

Disa nga aspektet e madhështisë së tij

1. **Madhështia e pozitës së tij:**

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka gradën e lartë dhe të ngritur - *Derexhe Refia*. Ka pozitën e lavdëruar - *Mekam Mahmud*. Ka flamurin e shpalosur - *Liva Meakud*, nën të cilin qëndrojnë Ademi dhe ata që vijnë pas tij. Ai është zotëria i bijve të Ademit. Ai është miku i zgjedhur i Allahut: "*Me të vërtetë, shoku juaj është miku i zgjedhur i Allahut.*"[20] A ka madhështi më të madhe se sa që Allahu dhe engjëjt e tij të dërgojnë *salavate* për të në tubimet qiellore dhe pastaj të urdhërohen besimtarët që edhe ata të dërgojnë *salavate* për të: "***Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me 'selam'!***" (El-Ahzab: 56) Allahu paralajmëron për dënim të dhembshëm këdo që e mundon atë: ***"Kurse ata që e lëndojnë të Dërguarin e Allahut, i pret një ndëshkim i dhembshëm."*** (Et-Teube: 61)

2. **Madhështia e përgjegjësisë së tij**:

Pejgamberët e mëparshëm, paqja qoftë mbi ta, janë dërguar te popujt e tyre dhe në kohën e tyre, ndërsa ai (*paqja dhe mëshira e*

[19] Përmbledhur nga "*Prezantim i përgjithshëm i fesë islame*" (faqe 170).
[20] Muslimi, 2383.

Allahut qofshin mbi të) është dërguar te mbarë njerëzit dhe xhinët, me mesazh përfundimtar që do të mbetet deri në Ditën e Kijametit. Ai është Pejgamberi i fundit dhe nuk ka Pejgamber pas tij. Prandaj, ai është Pejgamberi me më shumë pasues në Ditën e Kijametit.

3. **Madhështia e personalitetit të tij**:

Te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u mblodhën të gjitha kompletimet në paraqitje ashtu edhe në karakterin e tij. Aty u bashkuan të gjitha cilësitë e mira dhe virtytet e larta morale, me natyrën e tij të balancuar, pastërtinë e zemrës dhe forcën e personalitetit të tij. Ai ishte i madh në thjeshtësinë e tij, i thjeshtë në madhështinë e tij, i afërt në lartësinë e tij, dhe i lehtë dhe i mundësuar. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Sa herë që i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është vënë përballë dy opsioneve, gjithmonë ka zgjedhur më të lehtin prej tyre, për sa kohë që nuk ishte mëkat. Nëse ishte mëkat, ai ishte më larg se kushdo tjetër prej tij. I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) kurrë nuk është hakmarrë për veten e tij, por vetëm për Allahun dhe ajo vetëm kur është prekur shenjtëria e porosive të Allahut ."[21]

4. **Madhështia e moralit të tij**:

A ka madhështi më të madhe se sa që Allahu të lavdërojë Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për moralin e tij, ndërkohë që Allahu është Krijuesi i tij!: ***"Ti je me virtyte madhore..."*** (El-Kalem: 4) Fjala *"me virtyte"* tregon madhështi që do të thotë zotërim, ashtu siç thotë: ***"Vërtet, ti je në të drejtën e qartë!"*** (En-Neml: 79) Moral i madh është morali më fisnik, që arrin përsosmërinë e plotë dhe është më i lavdëruar se sa thjeshtë morali i mirë.

Kuptimin e vërtetë të kësaj madhështie morale tek Allahu mbase nuk arrin ta kuptojë kush prej njerëzve.[22] Kjo madhështi morale është natyra në të cilën Allahu e krijoi dhe e përgatiti atë (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*): ***"Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta*** (o Muhamed)***."*** (Ali Imran: 159) Ai

[21] Buhariu, 3560. Muslimi, 2327.
[22] Shiko: "*El-Tahrir ve el Tenvir*" dhe "*Fi Dhilal el Kur'an*".

(*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është i madh në moralin e tij me një madhështi të lindur, që nuk është e sajuar apo shtirje.

5. **Madhështia e arritjes së tij**:

Kjo u shfaq kur ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i nxori njerëzit nga paganizmi në besimin e pastër, nga besimi ateist në besimin në ringjallje, llogari, shpërblimin, ndëshkim, amshim. Kur ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i nxori nga kaosi moral në sjellje të drejtë, nga ndarjet racore dhe fanatizmi i injorancës dhe mburrja për prejardhjen, në parimin: "*Njerëzit janë prej Ademit, dhe Ademi është prej dheut. Nuk ka përparësi arabi ndaj jo arabëve, përveç në devotshmëri.*"[23] Kur ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i nxori nga errësira e injorancës në horizontet e dijes dhe dritën e saj, nga verbëria e besëtytnive në dritën e së vërtetës.

E gjithë kjo u realizua në një kohë rekord. Brenda dhjetë vitesh, Gadishulli Arab iu dorëzua Zotit të tij dhe ndoqi të Dërguarin e Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk u largua nga kjo jetë derisa e përmbushi mesazhin, e përcolli shpalljen në tërësi, feja u plotësua, mirësia u përmbush, argumenti u ngrit dhe ai e la Umetin në rrugën e pastër dhe të ndritshme.

6. **Madhështia e tij në përjetësinë e mesazhit të tij**:

Që nga dita kur e shpalli thirrjen e tij në Mekë e deri në ditët tona, ndjekësit e fesë së tij vetëm shtohen dhe nuk pakësohen, mesazhi i tij vazhdon të zgjerohet dhe të thellohet, dhe premtimi i vërtetë i Allahut po realizohet: ***"Për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë"***. (El-Fet'h: 28) Pas të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, rrjedha e historisë dhe ngjarjet e saj ndryshuan, si dhe kultura dhe mendimi i njerëzimit. Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje në tokë që të ketë pasur ndikim më të madh dhe më të thellë në histori sesa thirrja e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Feja e tij do të mbetet feja e përjetshme derisa Allahu ta trashëgojë tokën dhe gjithçka mbi të. Dhe gjithmonë do të mbetet një

[23] Ahmedi, "El Musned", 23489.

grup nga Umeti i tij i qëndrueshëm në urdhrin e Allahut, të cilëve nuk do t'u bëjë dëm as ai që i braktis e as ai që i kundërshton, derisa t'u vijë urdhri i Allahut.[24]

Frytet e leximit të Sira-s

Ne e lexojmë *Sira-n* për të vjelë frytet e shumta dhe të pjekura. Për këtë arsye, do t'i përmbledh frytet kryesore të leximit të saj në katër pika kryesore:

Së pari: Fryti i besimit
Së dyti: Fryti shpirtëror
Së treti: Fryti shkencor
Së katërti: Fryti edukativ

Më poshtë do të shpjegojmë secilin prej këtyre fryteve.

Së pari: Fryti i besimit

Kur e lexon *Sira-n* e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, vëren se Allahu i Lartësuar i ka përgatitur ngjarjet për misionin e këtij të Dërguari madhështor që herët, në botën e *Gajbit*.

Më parë, Ibrahimi kishte ardhur me Ismailin dhe nënën e tij (*paqja qoftë mbi ta*) në Mekë dhe i kishte lënë në një luginë të shkretë, ku më vonë nisi të lulëzojë jeta, u formua një shoqëri dhe u zhvillua një qytet - si një përgatitje për dërgimin e Muhamedit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* aty.

Pastaj erdhi udhëtimi i Hashimit drejt Gazës dhe kalimi i tij në Medinë, ku u martua dhe pati djalin e tij, Abdu el Mutalibin. Më pas, në të njëjtin vend, në Medinë, vdiq edhe Abdullahu, babai i Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Kështu, në Medinë u lind gjyshi i tij dhe u nda nga jeta babai i tij - sikur

[24] Buhariu, 3641. Muslimi, 1037.

gjithçka të ishte një përgatitje për migrimin e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) drejt këtij qyteti në të ardhmen.

Viti i Elefantit ndodhi pikërisht në vitin e lindjes së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, në mënyrë që nëpërmjet kësaj ngjarje të jashtëzakonshme, të tërhiqte vëmendjen e botës drejt këtij qyteti nga i cili do të dërgohej ai. E gjithë kjo ishte një përgatitje hyjnore për ngjarjen e shpalljes.

Ngjarje të tilla, që i përkasin së fshehtës - *Gajb*, nuk mund të ndodhin rastësisht dhe pa qëllim; përkundrazi, ato janë caktimi i Allahut, të Urtit dhe të Gjithëdijshmit, i Cili i ka renditur dhe harmonizuar në mënyrë të përsosur, si përgatitje për dërgimin e këtij Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Kjo ngjall tek vëzhguesi një bindje të fortë se Allahu i Lartësuar ka përcaktuar që në lashtësi rrjedhën e ngjarjeve historike, derisa ato, pavarësisht largësisë së tyre në kohë dhe vend, u bashkuan në kohë dhe në hapësirë sipas caktimit të Allahut për ta bërë të mundur dërgimin e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në kohën dhe vendin më të përshtatshëm për këtë ngjarje madhështore. "***Zoti yt krijon ç'të dojë dhe zgjedh lirisht.***" (El-Kasas: 68)

Kjo është urtësia e Allahut në rregullimin e gjërave dhe butësia e Tij në caktimin e tyre: ***"Vërtet, Zoti im është i Butë me kë të dojë; Ai është i Gjithëdijshmi dhe i Urti!"*** (Jusuf: 100)

Kur e studion jetën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), gjen në të shenja të qarta të profetësisë së tij. Nuk është e mundur që këto cilësi të përsosura të bashkohen në një njeri, përveç nëse ai është i mbështetur me ndihmë hyjnore. Prandaj, reflektimi mbi *Sira-n* e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është një faktor i fuqishëm në forcimin e besimit në Allahun dhe në vërtetësinë e mesazhit të tij.

Kur Herakliu e pyeti Ebu Sufjanin për Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), ai i bëri njëmbëdhjetë pyetje, por asnjëra nuk ishte rreth ndonjë mrekullie të jashtëzakonshme. Përkundrazi, të gjitha pyetjet e tij kishin të bënin me *Sira-n* e tij, gjë që tregon se Herakliu e njohu profetësinë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përmes biografisë *Sira*-s së tij, sepse

detajet e jetës së tij nuk mund të bashkoheshin në jetën e një njeriu tjetër përveç një të Dërguari të shpallur nga qielli.

Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) arriti në Medinë, njerëzit u dyndën drejt tij për ta parë. Abdullah bin Selam tha: "Unë isha ndër ata që u dyndën drejt tij dhe, kur e pashë fytyrën e tij dhe e vështrova me kujdes, e kuptova se ajo fytyrë nuk ishte fytyra e një njeriu gënjeshtar."[25]

Habitem pse autorët e mëvonshëm të *Sira*-s janë përpjekur të theksojnë sa më shumë mrekulli dhe çfarë nevoje ka për këtë? Çdo ngjarje nga jeta e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe çdo aspekt i personalitetit të tij është një mrekulli nga më të mëdhatë.

Çfarë është mrekullia? A nuk është mrekullia pikërisht ajo gjë që nuk mund ta bëjë askush tjetër prej njerëzve? Besueshmëria dhe ndershmëria e tij janë mrekulli. Jeta e tij e tërë ishte një mrekulli, që as heronjtë më të mëdhenj të botës nuk mundën të linin një biografi të ngjashme me të. Në çdo aspekt të saj është e virtytshme dhe madhështore: qëndresa e tij në betejat më të ashpra, ku edhe heronjtë e shokëve të tij mbronin veten pas tij; guximi i tij, para të cilit dobësoheshin liderët më të fuqishëm të njerëzve; përulësia e tij ndaj të varfërve dhe nevojtarëve; ndihma për të vejat dhe të moshuarit; pranimi dhe pohimi të vërtetës; besnikëria e tij në transmetimin e mesazhit të Allahut, deri në përmendjen e ajeteve që e kritikuan dhe e qortuan atë dhe, gjithashtu, respekti i tij për marrëveshjet dhe mbajtja e fjalës së dhënë, pa marrë parasysh sakrificat dhe mundimet që kjo kërkonte, qofshin ato në bashkëpunimet e tij personale apo në çështjet e shtetit.

Së dyti: Fryti shpirtëror

Muslimani vazhdon të njihet me të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përmes *Sira-s* së tij derisa ta dojë atë, sepse një nga cilësitë e tij është se kush e shihte për herë të parë ndiente respekt e madhështi për të dhe kush njihej me të, e donte

[25] "*Sunen*", Ibn Maxheh, 1334.

atë. Kështu që sa më shumë ta njohësh, aq më shumë do ta duash, dhe rritja e dashurisë për të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të bën të denjë që të jesh me të në Xhenet.

Nga Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet se një burrë e pyeti të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për Ditën e Kijametit, duke thënë: "Kur do të ndodhë ora (e fundit)?" I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu përgjigj me një pyetje: *"Çfarë ke përgatitur për të?"* Burri u përgjigj: "Asgjë, përveçse unë e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)." I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Ti do të jesh me atë që e do."*

Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Nuk jemi gëzuar kurrë për diçka më shumë sesa për fjalën e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: *"Ti do të jesh me atë që e do."*

Enesi shtoi: "Unë e dua të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, Ebu Bekrin dhe Umerin, dhe shpresoj të jem me ta për shkak të dashurisë sime për ta, edhe nëse nuk kam vepruar siç kanë vepruar ata."[26]

Dhe, për këtë arsye, *sahabët* (Allahu qoftë i kënaqur me ta) përjetuan lumturinë e kësaj dashurie profetike, saqë ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte më i dashur për ta se vetvetja, fëmijët dhe prindërit e tyre.

Amr ibn el As (Allahu qoftë i kënaqur me të) tregon historinë e pranimit të Islamit dhe thotë: "Nuk kishte askënd më të dashur për mua se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe as më madhështor në sytë e mi se ai. Nuk mund ta shikoja drejtpërdrejt nga respekti i madh që ndjeja për të. Dhe nëse do të më kërkohej ta përshkruaja, nuk do të isha në gjendje, sepse nuk e mbushja dot shikimin tim me të."[27]

Kur Zejd ibn el Dethine (Allahu qoftë i kënaqur me të) u soll për t'u ekzekutuar, Ebu Sufjani i tha: "Të betohem në Allahun, o Zejd! A do të dëshiroje që Muhamedi të ishte tani këtu në vendin tënd dhe ne t'ia prisnim qafën, ndërsa ti të ishe i sigurt mes familjes

[26] Buhariu, 3688. Muslim, 2639.
[27] Muslimi, 121.

tënde?" Zejdi u përgjigj: "Për Allahun, nuk do të dëshiroja që Muhamedi të ishte tani në vendin ku ndodhet dhe t'i hynte qoftë edhe një gjemb që ta lëndonte, ndërsa unë të isha i ulur i qetë mes familjes sime!" Atëherë, Ebu Sufjani tha: "Nuk kam parë kurrë dikë që të dojë dikë, ashtu siç e duan shokët e Muhamedit, Muhamedin!" [28]

Kjo dashuri është fryti i besimit, i shoqërimit me të dhe i njohjes së tij në mënyrë të përsosur.

Kështu, kushdo që lexon *Sira-n* e njeh gjithnjë e më shumë Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), e do edhe më shumë dhe ky lexim mbjell në zemrën e tij një fryt të madh, me të cilin Allahu e ngre në Xhenet në vendbanimet e atyre që ai ka dashur.

Së treti: Fryti shkencor

Fryti shkencor arrihet duke nxjerrë dispozitat juridike që përmban *Sira* e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe që tregohen nga ngjarjet e saj. Në të vërtetë, ka shumë dispozita që mund të nxirren nga *Sira*, për ata që kanë aftësinë juridike dhe dhuntinë e *istinbatit* (deduktimit), ashtu siç ndodh me *Sunetin* e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Kjo e vërteton qartë se *Sira* nuk lexohet për argëtim, por për dije; pasi ajo nuk është një histori e së kaluarës, por një *Sunet* i përhershëm. Kur e lexojmë *Sira-n* dhe e shikojmë nga ky këndvështrim, do të nxjerrim prej saj shumë përfitime, mësime, këshilla dhe dispozita.

Kur e lexojmë *Sira-n* dhe nxjerrim prej saj dispozitat për jetën tonë. Në udhëzimin e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) si bashkëshort do të gjejmë dispozitat për martesën; në udhëzimin e tij për udhëtimin - do të gjejmë dispozitat e udhëtimit; në udhëzimin e tij për Xhihadin - do të gjejmë dispozitat e luftës, dhe në marrëdhëniet e tij me jomuslimanët paqësorë - udhëzimin e tij për bashkëpunimin me të tjerët. Po kështu, edhe në të gjitha aspektet e tjera të jetës së tij.

Ajo që i dallon *dispozitat* e nxjerra nga *Sira* është marrja e dispozitave nga zbatimet dhe situatat e ndryshme të Pejgamberit

[28] "Siretu", Ibn Hisham, 2/172.

(*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), gjë që e plotëson këndvështrimin për çështjet dhe e lehtëson përcaktimin e saktë të tyre.

Për shembull, kur shqyrtojmë çështje, si: trajtimi i atyre që kanë pikëpamje ndryshe, trajtimi i grave, dispozitat e Xhihadit dhe të ngjashme, mbledhja dhe krahasimi i rasteve të ndryshme na çon drejt vendimit të duhur për secilën situatë dhe na ndihmon të dallojmë veçoritë që ndikojnë në dispozitat e këtyre çështjeve.

Së katërti: Fryti edukativ

Fryti edukativ është sjellja që e marrim si model nga *Sira* e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për të mishëruar moralin e mirë, mënyrën e zbatimit të tij dhe të jetuarit me njerëzit sipas tij. Në *Sira* shohim sesi Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) jeton me moral të lartë mes njerëzve, si e vendos çdo cilësi morale në vendin e saj të duhur - si e shfaq vendosmërinë kur kërkohet dhe butësinë kur është e përshtatshme.

Shohim, gjithashtu, sesi ai i përfshin njerëzit me sjelljen e tij të bukur, si i kontrollon emocionet dhe reagimet e tij, dhe sesi e zotëron veten në çastet e zemërimit.

Ndër shembujt e kësaj është historia e beduinit që iu afrua Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe e kapi këmishën e tij nga pas, aq fort saqë këmisha u shqye dhe i la shenjë në qafë. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u tërhoq aq shumë saqë gati ra prapa.

Këto tre ngacmime *(kapja dhe tërheqja, shqyerja e këmishës dhe shenjat në qafë)* ishin mjaftueshëm për të shkaktuar një zemërim. Pastaj i tha Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "Më jep nga pasuria e Allahut që ke në dorën tënde." Por si reagoi Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)? Ai u kthye, nuk e injoroi, buzëqeshi dhe nuk e shikoi me zemërim, pastaj urdhëroi që t'i jepej diçka.[29]

Ky ishte një reagim i menjëhershëm dhe i natyrshëm nga Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), edhe pse

[29] Buhariu, 3149. Muslimi, 1057.

veprimi i beduinit ishte jashtëzakonisht provokues. Megjithatë, përgjigjja e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte e mbushur me vetëkontroll dhe madhështinë e karakterit.

Edhe pse ishte një reagim spontan dhe i menjëhershëm, nëse e shqyrton me kujdes, me durim dhe reflektim të thellë, nuk do të gjesh një sjellje më të bukur dhe më të mrekullueshme se ky veprim profetik i natyrshëm. Kjo është shkolla e moralit të lartë të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), prej së cilës mësojmë durimin, vetëkontrollin dhe menaxhimin e emocioneve në situata provokuese.

Kur vëren aftësinë e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për të hapur zemrat dhe për t'i fituar njerëzit me butësi, si dhe për të lënë një gjurmë të bukur në shpirtin e çdo njeriu që e takonte, kupton se kushdo që ka pasur rastin të bashkëveprojë me të (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e kujton gjithnjë me dashuri dhe e rikujton me mall atë takim.

E gjithë kjo është pjesë e udhëzimit të tij që ne ndjekim, pjesë e Sunetit të tij që e ndjekim dhe përmes të cilit i afrohemi Allahut.

Ka një dallim të madh midis të folurit për butësinë, moralin e mirë apo bamirësinë si vlera të përgjithshme dhe të shprehura në mënyrë abstrakte, dhe mes përjetimit të tyre përmes zbatimeve të mrekullueshme të këtyre moraleve në jetën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Këto virtyte shfaqen jo thjesht si fjalë, por si sjellje konkrete, si një mënyrë jetese në ndërveprimin me njerëzit.

Prandaj, kujtimi i tij mbeti në zemrat e shokëve të tij si kujtimi më i bukur dhe pamja e tij më e dashura, saqë ata e shihnin vetëm me sy të mbushur me dashuri dhe kënaqësi.

Këtë e sqaron dhe e bën më të dukshëm hadithi i Enesit (*Allahu qoftë i kënaqur me të*), ku thotë: "Nuk kam prekur kurrë mëndafsh apo stof më të butë se dora e Pejgamberit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), dhe nuk kam nuhatur kurrë një aromë më të këndshme se era e Pejgamberit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."[30] "I kam shërbyer të Dërguarit të Allahut (paqja

[30] Buhariu, 3561. Muslimi, 2330

dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) për dhjetë vjet dhe, për Allahun, asnjëherë nuk më tha: 'Uf!' dhe asnjëherë nuk më qortoi për diçka që kisha bërë duke thënë: 'Pse e bëre këtë?' apo për diçka që nuk e bëra duke thënë: 'Pse nuk e bëre këtë kështu?'."[31]

Prandaj, leximi i *Sira*-s dhe përthithja e skenave të saj është një edukim për ndjeshmërinë shpirtërore dhe një përgatitje për një sjellje fisnike me njerëzit. Kjo ndodh, sepse është një ndjekje e lidhur me dashurinë dhe madhështinë për Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, si dhe një shpresë për shpërblimin dhe mirësinë e ndjekjes së shembullit të tij.

Dhe tani, në këto faqe, do të endemi së bashku në disa prej momenteve nga jeta tij, do të hedhim vështrime në këndet e jetës së tij, për të marrë prej saj dritë për jetën tonë dhe udhëzim për rrugën tonë. Le të marrim nga jeta profetike një nur që na ndriçon dhe një udhëzim që na drejton!

Fytyra profetike

Drita e fytyrës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përshkoi fytyrat e shokëve të tij *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Ata e përshkruan atë si në mënyrë të përgjithshme, ashtu edhe në hollësi. Prandaj, ejani së bashku të përjetojmë përshkrimin e përgjithshëm të fytyrës fisnike të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

1. **Shkëlqimi i fytyrës së Pejgamberit** (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Gjithçka që shokët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përshkruan për të, e para që bie në sy është bukuria dhe madhështia e tij. El-Bera (*Allahu qoftë i kënaqur me të*) thotë: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu

[31] Buhariu, 6038. Muslimi, 2309.

me fytyrën më të bukur. Ai kishte një fytyrë të këndshme dhe të hijshme."[32]

Ndërsa, kur Xhabir bin Semura *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* u pyet: "A ishte fytyra e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* si shpata?", ai u përgjigj: "Jo, por ishte si dielli dhe hëna, dhe ajo ishte e rrumbullakët."[33]

Përshkrimi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* si diell është për të theksuar shkëlqimin dhe ndriçimin e tij. Rubejia bint Muavidh *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Nëse do ta kishit parë, do të thoshit se dielli ka lindur."[34] Ndërsa Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Nuk kam parë asgjë më të bukur se Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ishte sikur dielli që po ecte në fytyrën e tij."[35]

Kurse, përshkrimi i tij si hënë është përdorur për të theksuar bukurinë dhe hijeshinë e tij. Xhabir bin Semura *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "E pashë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në një natë të plotë hëne, kishte veshur një xhup të kuq, dhe fillova të shikoja hënën dhe fytyrën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe, për syrin tim, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte më i bukur se hëna."[36]

Ky përshkrim i *sahabëve* për bukurinë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk është vetëm për bukurinë fizike, por edhe për dashurinë dhe admirimin e thellë që shokët e tij ndjenin për të. Kur një i dashuruar shikon bukurinë e atij që do, ajo shkëlqen në sytë e tij, dhe ai ndihet i magjepsur prej saj.

Por nëse ndodh që të ndjehet një ndjesi vetmie në vetvete, ajo do ta pengojë shikimin e bukurisë, edhe sikur ajo të jetë drita e diellit dhe ndriçimi i hënës.

Mëshira e Allahut qoftë mbi të, ai bashkoi bukurinë e para-qitjes dhe të moralit, bukurinë e jashtme dhe të brendshme, dhe

[32] Buhariu, 3549. Muslimi, 2337.
[33] Buhariu, 3552. Muslimi, 2344.
[34] Darimiu, 61.
[35] Tirmidhiu, 3648.
[36] Tirmidhiu, 2811.

bukuria e tij u shfaq për sytë e shokëve të tij që e shihnin atë me dashuri dhe nderim.

2. **Ngjyra e fytyrës së Pejgamberit** *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).*

Fytyra e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kishte ngjyrë të ndritshme, të bardhë me një nuancë të kuqe, jo të bardhë[37] tërësisht si mjegull, dhe jo të errët[38]. Shkëlqimi i fytyrës së tij shtohej kur rreth saj janë flokë të zinj. Ebu Tufejli thotë: "Pashë Pejgamberin (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ditën e hapjes së Mekës, dhe nuk do ta harroj kurrë fytyrën e tij të bardhë, me flokët e tij të zinj."[39]

3. **Fytyra e njomë e Pejgamberit** (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Fytyra e Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte e njomë saqë kushdo që e shihte mendonte se ai ishte më i ri se sa ishte në të vërtetë. Madje, kur e shihnin me të rinjtë, ai dukej sikur të ishte një i ri. Për këtë arsye, kur erdhi në Medinë i shoqëruar nga Ebu Bekri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, njerëzit përshkruan takimin e parë duke thënë: "Menduam se Ebu Bekri ishte Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.", pasi Ebu Bekri ishte një plak tashmë i thinjur, ndërsa Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dukej si një i ri, edhe pse Ebu Bekri ishte më i ri se Pejgamberi në moshë.[40]

4. **Hijeshia dhe dinjiteti i Pejgamberit** (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Ky përshkrim i fytyrës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregon një kombinim unik mes bukurisë dhe madhështisë. Ai kishte një nur të freskët dhe të ndritshëm, por njëkohësisht impononte respekt dhe solemnitet. Ata që e shihnin

[37] Që ka një bardhësi të shëmtuar, si ngjyra e gëlqeres.
[38] Buhariu, 3547. Muslimi, 2347.
[39] Ibn Sead, "*El Tabakatu el Kubra*", 1/321
[40] Buhariu, 3906.

për herë të parë ndjenin respekt dhe madhështi për të, ndërsa ata që njiheshin me të, e donin pa masë.

Dëshmia e Amr ibn el Asit *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon praninë e madhështisë në fytyrën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Edhe pse ai kishte qëndruar pranë tij për tre vjet, ai thotë: "Për Allahun nëse do të më kërkonit ta përshkruaj fytyrën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, nuk do të mundja t'ua përshkruaj dot, sepse nuk e ngopja dot shikimin tim me të nga respekti i madh që ndjeja për të."[41] Kjo tregon se bukuria e tij nuk ishte vetëm fizike, por rrezatonte një dritë hyjnore që imponohej në zemrat e njerëzve.

5. **Fytyra e bekuar dhe fisnike e Pejgamberit** (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Një nga veçoritë e fytyrës së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është se fytyra e tij ishte e pastër dhe e shndritshme, ajo reflektonte karakterin e tij të mrekullueshëm. Ata që e shihnin fytyrën e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) mund të njihnin menjëherë natyrën e tij të pastër, karakterin e lartë dhe virtytet fisnike që Allahu i kishte dhuruar. Kur Pejgamberi bëri Haxhin e Lamtumirës dhe qëndroi në Arafat, beduinët dhe banorët e rajoneve të largëta që kishin ardhur për të kryer Haxhin ishin grumbulluar të ngjeshur përreth për të parë Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Kur ata e shihni fytyrën e tij të ndritur, thoshin: "*Kjo është fytyra e bekuar.*"[42] Bekimi lexohej qartë në fytyrën e të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe ndjehej në mënyrën e tij të shprehjes.

Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) gëzohej dhe lumturohej, fytyra e tij shndrinte dhe ndriçonte, sa dukej si gjysmëhënë. Xherir ibn Abdullah el Bexheli e përshkruan kështu gëzimin e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kur ai shprehu ngushëllim për një grup udhëtarësh të lodhur që kishin ardhur tek ai, dhe ai kishte grumbulluar para tyre dy grumbuj me ushqim dhe rroba: "*Pashë fytyrën e Pejgamberit (paqja*

[41] Muslimi, 121.
[42] Ebu Davudi, "*Sunen*", 1742.

dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) duke ndriçuar si e artë"[43], duke u shkëlqyer sikur të ishte një pjatë prej argjendi e mbuluar me ar."

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) thotë: "Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hyri tek unë i gëzuar dhe fytyra e tij shndriste nga gëzimi. Ai më tha: "*A nuk e patë se si Muxheziz i hodhi një shikim Zaid bin Harithës dhe Usamës bin Zaid dhe tha: "Këto këmbë janë nga i njëjtit lloj?"*"[44] Dhe fytyra e tij shndriti si drita e borës nga gëzimi, për shkak të faktit që *Muxheziz* e vërtetoi se Zejdi dhe Usama ishin babë e bir, edhe pse ngjyrat e trupave të tyre ishin të ndryshme."

Por kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) zemërohej, fytyra e tij kuqej. Ibn Mes'udi, duke përshkruar momentin e zemërimit të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), thotë: "*Fytyra e tij ndryshoi, derisa u bë si ngjyra e kuqe.*"[45] (përkatësisht, ngjante me bojën kuqe). Fytyra e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) shprehte emocionet e tij, shprehte fisnikërinë e moralit të tij dhe shprehte bukurinë dhe shkëlqimin e tij.

6. **Fytyra unike e Pejgamberit** (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Fytyra e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kishte një shkëlqim të veçantë që nuk mund ta kishte askush tjetër. Prandaj, kushdo që e pa Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: "*Nuk kam parë as përpara as pas tij dikë si ai*." Një grua nga Hemdani e pa atë gjatë Haxhit dhe kur iu tha të bënte krahasim, ajo tha: "*I ngjante hënës së plotë. Nuk kam parë as përpara as pas tij dikë si ai.*"[46]

7. **Përshkrimi më i bukur për të** *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).*

Një nga frazat më të bukura në përshkrimin e fytyrës së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është përshkrimi i

[43] Buhariu, 1017.
[44] Buhariu, 6770. Muslimi, 1459.
[45] Muslimi, 1062.
[46] El Feseviu, "*El Mearifetu ve el Tarihu*", 3/28.

Enesit *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Për shikimin e tij të fundit në fytyrën e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ditën e vdekjes, ai thotë: "*Pejgamberi* (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) largoi perden e dhomës dhe na shikoi ndërsa ai qëndronte në këmbë, dhe fytyra e tij ishte si një fletë e Kuranit, pastaj buzëqeshi dhe qeshi."[47] Përshkrimi "*si një fletë e Kuranit*" është një shprehje për bukurinë e jashtëzakonshme, fytyrën e pastër dhe të ndritshme. Megjithatë, krahasimi i Enesit me *fletën e Kuranit* bart kuptime të mrekullueshme, që nënkuptojnë vlera të larta që inspirojnë lavdinë bashkë me bukurinë, madhështinë bashkë me dashurinë. Ky është përshkrimi më i bukur që kam dëgjuar për fytyrën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe nuk e harroj ndikimin që la në zemrën time kur e dëgjova për herë të parë, aq sa ndjeva një dridhje në zemër për shkak të madhështisë së tij, dhe ende e kujtoj këtë moment, kohën dhe vendin e tij, si dhe tonin e lexuesit që e lexonte hadithin, dhe dëshirën e zjarrtë në shpirtin tim për të parë fytyrën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Për të qoftë jeta jonë!

[47] Buhariu, 680. Muslimi, 419.

Kapitulli i Dytë:

Marrëdhëniet e të Dërguarit

I Dërguari dhe nëna e tij

Nëna e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është Amine bint Vehb el Zuhrije, një grua e nderuar, fisnike dhe e mençur, të cilën Allahu e zgjodhi nga të gjitha gratë e njerëzimit për të qenë vendi i sigurt për zhvillimin e parë të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) para se të lindte dhe prehri i parë që do ta mbante. Qumështi i saj qe ushqimi i tij i parë që mori, dashuria dhe dhembshuria e saj ishin dhembshuria dhe dashuria e parë që ai shijoi, ndërsa trupi i saj ishte i pari që preku trupin e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Ajo e mori lajmin e gëzueshëm me shndritjen e dritës së shpalljes së tij para lindjes së tij. Siç transmetohet nga Irbad bin Sarije, i cili thotë: "Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) duke thënë: "*Tek Allahu në Umu el Kitab, unë jam vula e pejgamberëve, ndërkohë që Ademi ishte ende në formën e baltës, për të cilën do t'ju tregoj më vonë; jam lutja e babait tim, Ibrahimit, dhe lajmi i mirë i Isait që i dha popullit të tij, dhe ëndrra e nënës sime, që pa se prej saj doli një dritë që ndriçoi sarajet e Shamit.*"[48]

Prandaj, kur flasim për zonjën e nderuar, nënën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), flasim me dashuri dhe respekt të thellë për të, pasi ajo ishte zgjedhja e Allahut nga të gjitha gratë e Tokës për të qenë nëna e të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Ne nuk mund të flasim për të, përveçse duke imagjinuar sikur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) po na dëgjon duke folur për nënën e tij; si do të ishte biseda jonë për të përpara tij?!

Së pari: Amine dhe Abdullahu

Nga tërësia e tregimeve të transmetuara, mund të kuptohet dashuria e madhe që Amine kishte për bashkëshortin e saj, Abdullah bin Abdulmutalibin. Kjo dashuri shfaqet qartë në faktin

[48] Ahmedi, "*Musned*", 17163.

se ajo nuk u martua pas vdekjes së tij. Ky nuk ishte zakon i grave arabe, pasi ishte e zakonshme që një grua e ve pas vdekjes së burrit të martohej menjëherë. Megjithatë, zonja fisnike Amina nuk u martua më, por e kaloi jetën duke jetuar me kujtimin e tij.

Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) mbushi gjashtë vjeç, nëna e tij e çoi atë në Medinë. Thuhet se shkaku i këtij udhëtimi ishte vizita te dajallarët e tij[49], por këtu me "dajallarë" nënkuptohen të afërmit e gjyshit të tij, Abdulmutalibit. Megjithatë, mendoj se arsyeja kryesore që e shtyu Aminen të ndërmerrte një udhëtim kaq të gjatë me një fëmijë gjashtëvjeçar nuk ishte thjesht vizita te të afërmit, por më tepër dëshira e saj për të vizituar varrin e bashkëshortit të saj, Abdullahut, pasi dashuria për të ishte ende e fortë në zemrën e saj dhe kujtimi i tij nuk ishte shuar nga mendja e saj edhe pas vdekjes së tij.

Së dyti: Udhëtimi në Medinë dhe vdekja e Amines

Ishte prej caktimit të Allahut që Amina të shkonte në Medinë me Um Ejmenin - e cila ishte shërbëtore e Abdullahut - dhe me djalin e saj, Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), kur ai ishte ende fëmijë. Sikur ky udhëtim të ishte një përgatitje për *Hixhretin* e mëvonshëm të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) drejt Medinës.

Amina u vendos në Medinë te Benu Adij bin el Nexhar, të cilët ishin dajat e Abdul-Mutalibit, në një shtëpi të quajtur "*Daru el Nabiga*", ku kishte qëndruar dhe Abdullahu kur kishte ardhur në Medinë, dhe ku kishte vdekur e ishte varrosur.[50]

Amina qëndroi në Medinë për një muaj, ndërsa qyteti ishte i prekur nga ethet e malaries[51]. Kur u kthye nga Medina me të birin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), u sëmur nga ethet. Kur

[49] Ahmedi, "*Musned*", 17163. Shih: "Sira e Ibn Is'hakut" (f. 65).
[50] Ibn Sa'd, "El Tabakat el Kubra", 1/79.
[51] "*Tabibun abre el Zemen*" (f. 52).

arritën në vendin e quajtur Ebva[52], sëmundja e saj u rëndua dhe atje ajo ndërroi jetë.[53]

E imagjinova atë në këtë shkretëtirë, me të birin e saj (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe me kujdestaren e tij, Um Ejmen, teksa përjetonte agoni dhe jepte frymën e fundit. Para saj qëndronte biri i saj, ndërsa ajo po ndahej nga jeta dhe po i thoshte lamtumirë.

Dhe pyes: *O Allah! Çfarë trishtimi ka ndjerë ajo, duke e përjetuar dhimbjen e thellë dhe duke mos ditur se çfarë do të ndodhte me të birin e saj në këtë shkretëtirë pasi ajo të mbyllte sytë? Si do të ishte fati i tij? A do të humbiste bashkë me këtë grua? A do të arrinte ai në Mekë?*

Por Zoti yt i Madhëruar dhe i Lavdishëm po përkujdesej për të Dërguarin e Tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) , ashtu siç thotë: "***A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë?"*** (Ed-Duha: 6)

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte i vetëdijshëm për këtë situatë, dhe sytë e tij e ruanin këtë skenë me detaje të sakta. Kur e ëma u varros, ai e mbajti mend mirë vendin e saj dhe nuk e harroi kurrë. Më pas, Um Ejmen e mori dhe e ktheu në Mekë.

Së treti: I Dërguari viziton varrin e nënës së tij

Vitet kaluan… Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i erdhi shpallja, pastaj emigroi në Medinë. Pesëdhjetë vjet pas vdekjes së Amina bint Vehbi-t, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) po kalonte në Ebva së bashku me një mijë e katërqind sahabë, duke udhëtuar drejt Mekës për Umren që më vonë mori emrin Umra e Hudejbijes.[54]

Kur arriti në Ebva, kujtimet vërshuan… Pamjet e së kaluarës u rikthyen para syve të tij. Para gjysmë shekulli, ai kishte kaluar këtu si një fëmijë i vogël me nënën e tij, duke shijuar butësinë e saj, ngrohtësinë e pranisë së saj dhe ëmbëlsinë e mëmësisë së saj - derisa arritën në këtë vend…

---

[52] *Ebva'*: Një vend midis Medinës dhe Mekës, që i përket rrethit të Zabigu-t. Ndodhet 201 km nga Meka dhe 161 km nga Medina. Shih: "*Muhafadhatu Zabig*", nga profesor Shejh Ahmed el Nu'mani.

[53] "*Tabibun abre el Zemen"* (f. 52).

[54] "Sira e Ibn Hishamit" (1/204).

Këtu ajo u nda nga jeta dhe nga ai. Këtu vdiq dhe këtu u varros.

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u ul që nga mëngjesi e deri afër pasdites - *Ikindisë*… ushtria e tij po priste - çfarë e mbante Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) aty kaq gjatë? Pse nuk po vazhdonte rrugën?

Kur u afrua koha e *ikindisë*, u ngrit dhe filloi të ecte duke kaluar mes varreve, sikur kërkonte një varr të caktuar. Kur arriti te varri që kërkonte, u ul pranë tij,[55] ndërsa shokët e tij e shikonin nga larg. Ata e panë të ulur pranë varrit, sikur po fliste me dikë përballë tij. Pasi qëndrimi zgjati, ata iu afruan dhe e gjetën të Dërguarin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pranë varrit të nënës së tij, duke qarë. Pastaj tha: *"I kërkova leje Zotit tim ..."* sikur kishte pritur nga mëngjesi deri në *ikindi* që Allahu t'i jepte leje.

"I kërkova leje Zotit tim që të kërkoj falje për nënën time, por Ai nuk ma lejoi. Dhe kërkova leje që ta vizitoj varrin e saj, e më dha leje. Prandaj, vizitoni varret, sepse ato ju përkujtojnë Ahiretin."[56]

Më pas, e rregulloi varrin e saj, i cili, pothuajse, ishte zhdukur për shkak të kohës së gjatë që kishte kaluar.

Sa herë që e kujtoj këtë skenë, them: O Allah! Kjo është dhimbja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për nënën e tij, edhe pse nga jeta e saj ai pati veçse një hije kalimtare, sepse, zakonisht, ai të cilit i ka vdekur nëna në një moshë të hershme fëmijërie, nuk kujton asgjë nga ngjarjet me të, nuk thotë: "Tha dhe bëri, shkoi dhe erdhi", por e kujton si një ëndërr të largët. Megjithatë, ky ishte mallëngjimi dhe dhembja[57] e tij për të. Po sikur ta kishte njohur më gjatë? Po sikur ajo të kishte jetuar kohën e pejgamberisë dhe të shtetit të tij? Po sikur të kishte jetuar me të në shtëpitë e tij? Si do të ishte mirësia e këtij Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ndaj saj dhe sjellja e tij me të? Çfarë shembulli do të merrte njerëzimi nga marrëdhënia e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me nënën e tij? Por Allahu vepron me urtësinë absolute; Ai krijon çfarë të dojë dhe zgjedh si të dojë!

[55] Hakimi, "*El-Mustedrek*", 3292.

[56] Muslimi, 976.

[57] Dhembja *Elitijai*: Djegia nga brenga. Shih: *Taxh el Arus*, 22/177.

Së katërti: Nëna kujdestare pas nënës së tij

Nëse nuk patëm mundësinë të shohim jetën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me nënën që e lindi, patëm fatin të njohim jetën e tij me nënën që e rriti, Umu Ejmen Bereke el-Habeshije *(Allahu qoftë i kënaqur me të).* Jeta e saj përfshiu të gjithë jetën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), ai lindi në praninë e saj dhe ndërroi jetë ndërsa ajo ishte ende gjallë. Ajo ishte dadoja e tij që e mori në fillimet e jetës së tij dhe u bë nëna e tij pas nënës së tij.

Kur ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u rrit dhe kur Allahu i dha atij profetësinë dhe shpalljen, ai vazhdoi ta trajtonte atë si nënë. Në një kohë kur kultura arabe e trajtonte robëreshën si një plaçkë nga plaçkat dhe një mall nga mallrat, i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e trajtoi atë si një djalë i devotshëm ndaj nënës së tij. Është transmetuar se ai e thërriste: "*Oj nënë!*" në formë dashamirësie dhe thoshte: "*Ajo është nëna ime pas nënës sime.*"[58]

Ai e vizitonte atë në shtëpinë e saj, e vizitonte ashtu siç e viziton djali nënën e tij, dhe për ta nderuar në mënyrë të veçantë shkonte për ta vizituar bashkë me Ebu Bekrin dhe Umerin.

Ai i linte asaj hapësirë të gjerë për të ushtruar autoritetin e mëmësisë, prandaj ajo guxonte ndaj tij në një mënyrë që të tjerët nuk e bënin dot. Enesi ka thënë: "Njerëzit i ndanin disa palma që hurmat e tyre t'i dhuroheshin të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) derisa ai mori pronat e Benu Kurejdha-s dhe Benu Nadiri-t. Pastaj ai filloi t'ua kthejë atë që i kishin dhënë. "Familja ime më urdhëroi që të shkoj te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe t'i kërkojë atë që i kishim dhënë ose një pjesë të saj dhe Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ia kishte dhënë ato Umu Ejmenit. Kur shkova te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai mi dha ato. Ndërkohë erdhi Umu Ejmeni dhe i vuri ato në qafën time dhe tha: 'Pasha Allahun, ai nuk do t'i japë ty ato pasi m'i ka dhënë

[58] Ibn Asakiri, "*Tarihu Dimashk*", 8/51.

mua!' Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*O Umu Ejmen, lëre dhe do të marrësh kaq dhe kaq!"* Ajo tha: "Jo pasha Atë që s'ka tjetër Zot përveç Tij!" - derisa ai i dha dhjetë herë më shumë apo diçka të ngjashme me dhjetë.[59]

Enesi thotë: "Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) shkoi te Umu Ejmeni dhe unë shkova me të. Ajo i dha një enë me pije. Thotë: "Nuk e di nëse ishte në agjërim apo deshi ta pinte, por ajo filloi ta qortonte dhe të ankohej ndaj tij."

Kjo do të thotë se ajo e qortonte dhe e kritikonte, siç vepron nëna me fëmijën e vet kur nuk e ha ushqimin. Ajo nuk do të guxonte ta bënte këtë me Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nëse ai nuk do ta kishte lejuar dhe nuk do t'i kishte shprehur gatishmërinë për ta pranuar këtë. Kjo është një mjeshtëri në trajtimin e nënës, që i jep asaj vendin dhe pozitat e saj, të cilat nuk mund t'i ketë askush tjetër përveç nënës.

Ajo që kemi mësuar nga historia e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me nënën e tij dhe pas saj me kujdestaren e tij, Umu Ejmenin, është një shembull i kujdesit dhe respektit për vendin e nënës dhe dashurisë së madhe që ndodhet në zemrën e tij. Po ashtu, është një inkurajim për të shijuar kënaqësinë e respektimit të nënës dhe për t'u përpjekur të bëjmë gjithçka për ta lumturuar atë dhe për t'i dhënë asaj vendin që meriton.

Për ata që ende e kanë nënën e tyre në jetë, uroj që të shijojnë gëzimin e fëmijërisë pavarësisht moshës, dhe për çdo bir apo bijë që ende e ka mundësinë të shijojë kënaqësinë e lumturimit të nënës dhe nderimit të saj!

Së pesti: Përfundim

a) Pikë së pari, ndalimi i Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për të kërkuar falje për nënën e tij nuk nënkupton se ajo është një nga të dënuarit. Ajo dhe ata që jetuan në atë periudhë, përkatësisht në kohën e periudhës së mungesës së dërgimit të shpalljeve *fetre*, janë të përfshirë në premtimin e Allahut: ***"Ne***

[59] Buhariu, 4120. Muslimi, 1771.

nuk dënojmë asnjë popull, para se të çojmë të dërguar!" (El-Isra: 15) Allahu ka shpjeguar se ata ende nuk ishin paralajmëruar: ***"Që të paralajmërosh një popull, paraardhësit e të cilit nuk ishin të paralajmëruar, prandaj këta janë të pakujdesshëm..."*** (Ja Sin: 6); ***"Për të paralajmëruar njerëzit, të cilëve nuk u kishte ardhur kurrfarë paralajmëruesi para teje."*** (El-Kasas: 46)[60]

b) Nuk ka prova se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e takoi nënën e tij të qumështit, Halime bint Abdullah el Seadije, pas shpalljes së pejgamberisë. Ka pasur lajme që thonë se e takoi pas betejës së Hunejnit[61], por këto lajme janë të paqëndrueshme në lidhje me burimin dhe janë të çuditshme në përmbajtje. Nëse do të kishte ndodhur një takim i tillë, do të ishte një ngjarje e njohur dhe e përmendur, Allahu e di më mirë.

I Dërguari si bashkëshort[62]

Jeta bashkëshortore e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është një jetë e gjerë dhe të folurit për të është një temë e ëmbël dhe e këndshme. Kur shikojmë në mënyrë të përgjithshme gjendjen e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me gratë e tij, na bien në sy disa aspekte:

Së pari: Gratë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishin jashtëzakonisht të larmishme. Ato vinin nga fise të ndryshme; disa prej tyre ishin nga fisi Kurejsh, por nga degë të ndryshme të tij: kishte prej tyre nga fisi Tejm, Adij, Mahzum, Esed, Umeje, dhe të tjera që nuk ishin nga kurejshët, si Xhuvejrija bint

[60] Shihni për këtë në librin "*Maxhalis me Shejh Muhammed el Emin el Shinkiti*" nga Ahmed el Shinkiti (f. 40), ku janë shpjeguar argumentet për këtë dhe janë dhënë përgjigje për çështjet që ngrihen lidhur me to.
[61] Ebu Daudi, "*Sunen*", 5144.
[62] Shih: "*Sira e Pejgamberit në shtëpinë e tij*", nga Shejh Salih bin Ahmed el Shami, prej së cilës kam përfituar në këtë hulumtim.

Harith, e cila ishte nga fisi Mustalik Huza, Meimuna bint Harith, që ishte nga fisi Hilal, ndërsa Safija bint Hujej bin Ahtab ishte çifute.

Kjo larmi fisnore shoqërohet edhe me një larmi tjetër në moshë: disa prej tyre ishin gra të pjekura dhe të mëdha në moshë, si Hatixhja, Sevda dhe Umu Seleme, ndërsa disa ishin të reja në moshë, si Aishja, Xhuvejrija dhe Safija, e disa të tjera ishin ndërmjet tyre.

Një larmi tjetër duket edhe në natyrat dhe temperamentet e tyre: ndër to kishte me natyrë të ashpër, si nëna jonë Zejneb bint Xhahsh *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, e cila kishte një karakter të fortë; ndër to kishte edhe gazmore dhe që pëlqente të bënte humor, si Sevda bint Zum'a (*Allahu qoftë i kënaqur me të*); dhe ndër to kishte edhe të reja që donin të luanin, si Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*.

Po ashtu, kishte një larmi në lidhje me etërit e tyre: disa prej tyre ishin bija të njerëzve që ishin ndër shokët më të afërt të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), si Aishja dhe Hafsa, etërit e të cilave ishin Ebu Bekri dhe Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)*. Ndërsa disa të tjera ishin bija të njerëzve që dikur ishin armiqtë më të mëdhenj të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), si Umu Habiba, babai i së cilës, Ebu Sufjani, ishte një nga kundërshtarët dhe luftëtarët më të ashpër kundër Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) para se të pranonte Islamin; dhe Safija bint Hujej, babai i së cilës, Hujej bin Ahtab, ishte një nga njerëzit më armiqësorë ndaj Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nga hebrenjtë.

Por gjëja e mrekullueshme është se gjithë kjo larmi u përfshi nga Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), i cili ruajti për secilën identitetin e saj personal, veçantinë, natyrën dhe prejardhjen e saj. Megjithatë, të gjitha ato u bashkuan në shtëpitë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), u lidhën me dashurinë për të, u kapën pas tij dhe u përkushtuan ndaj jetës me të (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Së dyti: Ato jetuan me Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) një jetë bashkëshortore ideale dhe të ndritshme, e cila, në të njëjtën kohë, ishte një jetë reale dhe e natyrshme, ku

ndonjëherë ndodhnin disa probleme që i jepnin jetës gjallëri dhe ripërtëritje.

Nëse dikush të thotë se mund të ketë jetë bashkëshortore pa asnjë problem, kjo do të thotë se njëri nga bashkëshortët ka shkelur personalitetin e tjetrit.

Jeta ideale dhe natyrore është ajo në të cilën ndodhin mosmarrëveshje dhe probleme kalimtare, të cilat e rifreskojnë jetën pa e futur atë në krizë. Kjo ishte natyra e jetës së bashkëshorteve të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Problemet mund të ndodhnin, mund edhe të shkaktonin njëfarë tensioni në marrëdhënie, por nuk shkaktonin krizë apo bllokim.

Ndodhte që midis tyre të kishte xhelozi, që ndonjëra prej tyre ta linte Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për një ditë, apo që ai të zemërohej me ndonjërën dhe të mbante qëndrim përkohësisht, madje ndonjëherë edhe mund të mbante qëndrim nga të gjitha bashkëshortet e tij për një kohë. Por këto ishin situata të përkohshme që kalonin dhe jeta riniste sërish, më e ndritshme dhe më e bukur.

Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Ndërsa isha duke u marrë me një çështje, gruaja ime më tha: "Sikur ta bëje kështu e ashtu!" I thashë: "Ç'të duhet ty me këtë çështje? Pse po ndërhyn në një punë që dua ta vendos vetë?" Ajo më tha: "Çudi për ty, o bir i Hatabit! A nuk dëshiron të të kundërshtojë dikush? Pasha Allahun, gratë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e kundërshtojnë atë, madje ndonjëra prej tyre e lë pa folur deri në mbrëmje. Madje, edhe vajza jote e kundërshton të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) derisa ai të mbetet i zemëruar për tërë ditën."

Atëherë Umeri u trondit, mori rrobën e tij dhe shkoi te gratë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Shkoi dhe i këshilloi me radhë njëra pas tjetrës, shkoi te vajza e tij, Hafsa, shkoi edhe te Aishja, dhe nisi t'i këshillonte e t'u fliste ashpër: "Si mund ta lini Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pa folur? A nuk keni frikë se Allahu do të zemërohet për shkak të zemërimit të Dërguarit të Tij?"

Pastaj kaloi te Umu Seleme, por ajo e kritikoi ashpër dhe e kundërshtoi fuqishëm, saqë ai tha: "Do të doja të mos kisha folur fare me të"' Ajo i tha: "O Umer, a nuk ka i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) aftësi t'i këshillojë gratë e tij që të vish ti e t'i këshillosh ato?! O Umer, po të na kishte ndaluar i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), ne do të kishim ndaluar menjëherë, sepse ne jemi më të bindura ndaj tij se sa je ti! Por i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) na ka lejuar këtë."[63]

Domethënë, ne veprojmë brenda hapësirës që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) na ka lejuar, sepse ai ua dha grave të tij këtë hapësirë, pasi ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u lejoi atyre të shprehnin emocionet e tyre, edhe nëse ato e zemëronin dhe e injoronin atë, sepse ai dëshironte që ato të jetonin me të një jetë martesore të natyrshme dhe të shëndetshme, ku ndodhin ndjenja dhe reagime, dhe ka një ndërveprim të vërtetë midis bashkëshortëve, edhe nëse këto ndjenja e zemërojnë Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), ose bëjnë që ai të mbajë qëndrim nga ndonjëra. Një shembull i kësaj është përpjekja e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për të kuptuar ndjenjat e xhelozisë që ndodhnin midis grave të tij. Kjo nuk e acaroi apo e stresoi atë, por ai e vendosi në një kontekst të zakonshëm dhe natyror për ndjenjat e tyre.

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte tek Aisha, kur njëra nga gratë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i dërgoi një pjatë me ushqim. Aishja e goditi në dorë shërbyesin dhe pjata u përmbys dhe ra. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) mblodhi copat e pjatës dhe filloi të mbledhë ushqimin që kishte qenë në pjatë, duke thënë: *"Nëna juaj u zemërua, nëna juaj u zemërua, hani!"* Ata hëngrën dhe pastaj mbajti shërbyesin derisa ata mbaruan. Pastaj u soll një pjatë nga shtëpia e Aishes dhe ai ia dha pjatën e pa dëmtuar në këmbim të pjatës së thyer dhe e mbajti të thyerën në shtëpinë e saj[64]. Ai tha: "*Pjatë me pjatë dhe ushqim*

[63] Buhariu, 4913. Muslimi, 1479.
[64] Buhariu, 5225.

me ushqim."[65] Aisha tha: "Nuk e pashë asnjë zemërim në fytyrën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)."

Shiko këtë përqafim të reagimit të gruas dhe xhelozisë së saj, ku ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kërkoi falje për të para atyre që ishin me të, duke thënë: *"Nëna juaj xhelozoi!"* Ata nuk vunë re ndonjë reagim të fortë prej tij dhe Aisha *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* nuk vuri re asnjë ndryshim në fytyrën e tij.

Po ashtu, Ebu Bekri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* kërkoi leje për të hyrë te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe dëgjoi zërin e Aishes që ishte lartë. Kur ai hyri, tentoi për ta goditur, duke thënë: "A po e ngre zërin ndaj të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)?" Mirëpo, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e ndaloi dhe Ebu Bekri doli i zemëruar. Pastaj kur doli Ebu Bekri, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i tha: *"A e pe si të shpëtova nga njeriu?"* Pas disa ditësh, Ebu Bekri kërkoi leje të hynte përsëri te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe gjeti se ata ishin pajtuar. Ai u tha atyre: "Më futni edhe mua në paqen tuaj ashtu siç më futët në luftën tuaj." Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: *"Patjetër, patjetër!"*[66]

Së treti: Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) jetonte me to (gratë e tij) si një bashkëshort dhe jo si imam, udhëheqës ose pushtetar totalitar. Ai hynte në shtëpitë e tyre si bashkëshort dhe, për këtë arsye, kur Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* u pyet se si ishte Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kur ai ishte vetëm në shtëpinë e tij, ajo tha*:* "Ishte më i butë i njerëzve dhe më fisniku i njerëzve, ai ishte një njeri si njerëzit tuaj, përveçse ishte një njeri që qeshte dhe buzëqeshte shpesh. Ai ishte vetëm një njeri, një njeri si çdo njeri tjetër. Ai merrej me punët e familjes së tij - domethënë shërbente për familjen e tij - ai riparonte këpucët e tij, qepte rrobat e tij, mundte delet, i shërbente vetes së tij dhe punonte në shtëpinë e tij ashtu si punoni ju në shtëpitë tuaja. Kur vinte koha e namazit, ai dilte për të falur namazin, dhe nuk e

[65] Tirmidhiu, 1359.
[66] Ebu Davudi, 4999.

kam parë kurrë që të ketë goditur me dorën e tij grua apo shërbëtorë."[67]

Ajo është një buqetë aromatike e cilësive profetike, që na e ka paraqitur në mënyrë të shkëlqyer në këto fraza të shkurtra dhe me këtë shpjegim elokuent.

Mbetet që ne të hapim sytë për kuptime të mëdha: Ai nuk ishte gjë tjetër veçse njeri si të gjithë njerëzit. Nëna jonë, Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, thekson njerëzoren e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në marrëdhëniet familjare, në mënyrë që ai hynte në shtëpinë e tij jo si udhëheqës, komandant apo imam, por si bashkëshort, për të jetuar një jetë martesore të qetë me familjen e tij. Kështu, shkrirja e madhështisë së tij profetike bashkohet me madhështinë e sjelljes martesore dhe ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk sillej në shtëpi me familjen e tij ashtu siç sillej me njerëzit kur takohej me ta; ai jetonte me thjeshtësinë dhe natyrshmërinë e jetës familjare, pa parë në të përveçse burrin e dashur dhe të butë, ndërkohë që ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është zotëria i bijve të Ademit dhe udhëheqësi i njerëzimit, dhe më i madh që sytë nuk kanë të ngopur nga shikimi i tij, plot nder dhe respekt.

Së katërti: Këshillimi dhe disiplinimi, pasi ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kujdesej për to me këshilla dhe i nxiste për të mirën, duke mos i ngarkuar ato. Aishja, *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ka thënë: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lutej natën, dhe kur donte të falte namazin e vitrit, më zgjonte që të falem me të."[68]

Këtu shohim një moment të butësisë në thirrjen për në fe, pasi Aishja ishte e re dhe nuk mund ta përballonte namazin e gjatë dhe të ngadaltë të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), këmbët e të cilit ënjteshin nga qëndrimi i gjatë në këmbë duke u falur. Për këtë arsye, ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e

[67] Shih: Is'hak bin Rahavejhi, "*Musned*", 1550. Ahmedi, "*Musned*", 23093, Buhariu (676, 6039). Ibn Hibbani 5676. Ibn Ebi Dunja, "*Mekarim el Ahlak*", 397. El Devlabi, "*Al-Kuna*", 360. Tarihu Ebi Zurate el Dimashkij, 1/659-660. Ebu el Hasen bin el Mudhaffer, "*Garaibu Shuabe*", 81. Ibn Rexheb, "*Fet'hu el bari*", 6/108-109. "*Fet'hu el Bari*", *2/163, 10/461.*

[68] Buhariu, 512. Muslimi, 512.

zgjonte atë kur i afrohej fundit të lutjes së tij për vitër, për ta lehtësuar dhe për t'ia bërë më të lehtë.

Po ashtu, Umi Seleme *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ka thënë: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u zgjua dhe tha: "*Subhanallah! Çfarë është zbritur nga thesaret dhe çfarë është zbritur nga sprovat? Kush do t'i zgjojë gratë e dhomave - që i referohet grave të tij - që të falen? Sepse ndoshta disa që janë të veshura në këtë botë, do të jenë të zhveshura në botën tjetër.*"[69]

Kjo këshillë që vjen në mesnatë nga Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për gratë e tij në dhomat e tyre, është që të falin pjesën e tyre të natës. Në fjalën e tij: "*Çfarë është zbritur nga thesaret dhe çfarë është zbritur nga sprovat?*", ai tregon se namazi i natës është përgatitje për të pranuar shpërblimet e Allahut nga thesaret e Tij dhe është një shkak për t'u mbrojtur nga sprovat, duke i mbrojtur robërit e Allahut prej tyre. Po ashtu, kur hynte dhjetëditëshi i fundit i Ramazanit, ai e zgjonte familjen e tij dhe i inkurajonte ata për të qëndruar natën në adhurim. Aishja thotë: "Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hynte në dhjetëditëshin e fundit, ai shtrëngonte Izarin rrobën për bel, kalonte natën duke u lutur dhe zgjonte familjen e tij."[70]

Po ashtu, ai i këshillonte ato kur ndodhte që të vepronin diçka që kërkonte këshillim dhe udhëzim. Aishja i tha të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) se Safija është kështu dhe ashtu - duke nënkuptuar se ajo është e shkurtë - ndërsa ai ia ktheu: "*Ke thënë një fjalë që sikur të përzihej me ujin e detit, do ta ndote atë.*" Aishja tha: "Unë imitova[71] dikë para Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe ai tha: "*Nuk dëshiroj të imitoj ndonjë person edhe po të kisha fituar kaq e aq.*'"[72]

Këtu shohim një mësim të thellë profetik për të shmangur përshkrimet në formë negative rreth dikujt, ose për të imituar gjendjen e tij për qëllime talljeje. Shiko fjalët e tij: "*Sikur të përzihej me ujin e detit, do ta ndote atë.*" Kjo do të thotë që kjo fjalë, që duket

[69] Buhariu, 6218.
[70] Buhariu, 2024. Muslimi, 1174.
[71] Fjala *hakejtu* do të thotë: Bëra si ai për ta përçmuar atë. Shiko: "*Aun el Mea'bud*", 4/420.
[72] Ebu Davudi, "*Sunen*", 4875. Tirmidhiu, 2674.

e parëndësishme, mund të dëmtojë aq shumë sa të ndotë gjithë ujin e detit, për shkak të peshës së mëkatit që përmban. Ky është një paralajmërim i fortë për të mos e nënvlerësuar këtë sjellje.

Një herë Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hyri tek Safija dhe e gjeti duke qarë. E pyeti: "*Çfarë të bëri të qash?*" Ajo tha: "Hafsa më tha se unë jam vajza e një çifuti." Atëherë Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i tha: "*Ti je vajza e një Pejgamberi, xhaxhai yt është Pejgamber dhe burri yt është Pejgamber, e me çfarë krenohet ajo para teje?*" Pastaj tha: "*Frikësoju Allahut, oj Hafsa!*"[73]

Këtu, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), nga njëra anë ngushëllon Safijen, duke i kujtuar se ajo ka një origjinë të lartë, pasi ajo është pasardhëse e pejgamberit Harun, që është babai i saj, kurse pejgamberi Musai është xhaxhai i saj dhe burri i saj është i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), prandaj kush mund të krenohet para saj, ndërsa, nga ana tjetër, ai e këshillon Hafsan, duke i tërhequr vëmendjen për veprimin e saj të gabuar: "*Frikësoju Allahut, oj Hafsa!*"

Gjatë Haxhit të Lamtumirës, deveja e Safijas u shkëput nga karvani dhe humbi rrugën. I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u kthye tek ajo dhe e gjeti duke qarë dhe filloi t'i fshinte lotët me duart e tij dhe ta qetësonte. Pastaj tha: "*Oj Zejneb, huazoji motrës tënde, Safijes, një deve.*" Ajo, edhe pse kishte deve më shumë se të tjerat, tha: "Unë t'i huazoj çifutes tënde një deve?" Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u zemërua kur e dëgjoi këtë fjalë prej saj, aq sa nuk i foli më gjatë gjithë rrugës derisa mbërritën në Mekë, madje as ditët kur qëndroi në Mina derisa u kthye në Medine. Kaloi muaji Muharrem dhe muaji Safer pa shkuar te ajo dhe pa i dhënë as pjesën e ndihmave, derisa ajo i humbi shpresat nga ai dhe kur erdhi muaji i Rebiu el Evvel, ai hyri tek ajo. Ajo e pa hijen e tij dhe tha: "Kjo është hija e një burri, por Pejgamberi nuk vjen te unë! Dhe pyeti kush është? Atëherë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri brenda."[74]

---

[73] Tirmidhiu, 3894.

[74] Ahmedi, "*Musned*", 26866. Për fjalën 'huazoj – *efkare*' shiko "*El Nihaje*", 3/462.

Për këtë fjalë që Zejnebja tha, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) mbajti qëndrim afërsisht tre muaj, derisa ajo humbi çdo shpresë, madje ajo hoqi edhe shtratin e saj. Të gjitha këto ishin një mësim për të për atë fjalë. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u tregua më i ashpër me Zejneben për shkak të pozitës që ajo kishte tek ai, sesa me Hafsan, për shkak të përsëritjes së këtij ofendimi ndaj Safijes. Duke qenë se ofendimi, tashmë, u përsërit pavarësisht se nga Zejnebja e jo nga Hafsa, qëndrimi i Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte më i ashpër, sepse ato të gjitha së bashku konsiderohen një shtëpi e vetme.

Së pesti: Gratë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) jetuan me të një jetë të thjeshtë dhe mjete jetese të kufizuara, edhe pse ai ishte udhëheqësi i të gjithë Gadishullit Arabik. Kur ato i kërkuan atij që t'i favorizonte me një jetë më të begatë dhe të rehatshme, ai i la për një muaj dhe më pas i vuri përpara zgjedhjes: "***O i Dërguar! Thuaju grave tuaja: "Nëse dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani, unë do t'ju lë të kënaqeni për ca kohë dhe do t'ju lëshoj si është më mirë. Por, nëse dëshironi Allahun, të Dërguarin e Tij dhe botën tjetër, dijeni se Allahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë vepra të mira.***" (El-Ahzab: 28-29)

Të gjitha pa përjashtim zgjodhën Allahun, të Dërguarin e Tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe botën tjetër,[75] dhe jetuan me të në të njëjtën gjendje modeste që ai jetonte. Pas kësaj zgjedhje të tyre, Allahu ia ndaloi Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) martesën me gra të tjera:

"Këtej e tutje nuk të lejohen më gra të tjera, as të marrësh tjetër grua në vend të tyre, edhe sikur të të magjepsë bukuria e tyre..." (El-Ahzab: 52)

Ato janë gratë e tij në këtë botë dhe do të jenë gratë e tij edhe në botën tjetër. Ato janë nënat tona - *Nënat e Besimtarëve* - Allahu qoftë i kënaqur me to të gjitha!

[75] Buhariu, 2468. Muslimi, 1479.

Së gjashti: Jeta bashkëshortore në shtëpinë e profetësisë ishte e mbushur me dashuri, ku dashuria ishte pjesë e çdo frymëmarrjeje dhe një ndjenjë e shpallur hapur, pa u fshehur apo mbuluar.

Amr bin Asi, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon se e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) se kush është njeriu më i dashur për ty, ndërsa ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i është përgjigjur: "*Aishja.*"[76] Kështu erdhi përgjigjja e shpejtë dhe e qartë, sepse dashuria e pastër është virtyt që duhet të shpallet e jo të fshihet.

Kur fliste për gruan e tij Hatixhen *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) thoshte: "*Ka qenë kështu e ka qenë kështu, dhe mua ma bëri Allahu rizk dashurinë për të.*"[77]

Shiko këtë shprehje shumë domethënëse! Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e konsideroi dashurinë e saj si një dhuratë dhe një bekim që Allahu ia kishte dhënë dhe një begati me të cilën e kishte bekuar.

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) jo vetëm që e shpall dhe e bën të njohur këtë dashuri, por ai u dhuronte dashuri grave të tij. Gjatë komunikimit me gratë e tij ai përdorte një art të veçantë të shprehjes së dashurisë si dhe shfaqte një kënaqësi të veçantë gjatë përshkrimit të saj.

Aishja (*Allahu qoftë i kënaqur me të*) tregon: "I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ma jepte enën me ujë dhe unë pija prej saj. Pastaj e merrte nga unë, e rrotullonte në duart e tij dhe e vendoste gojën aty ku e kisha vendosur unë, pastaj pinte. Po ashtu, kur haja mish dhe lija kockat, ai i merrte dhe i vendoste në gojën e tij aty ku i kisha vënë unë në gojë."[78]

Çfarë mesazhe dashurie përçon ky veprim i mrekullueshëm? Si mund të mos ndiejë një grua kënaqësinë e një dashurie të tillë, e shprehur përmes këtyre gjesteve kaq domethënëse?

Madje, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kur përmendi llojet e ndryshme të *sadakasë* e përfshiu edhe dashurinë në mesin e tyre, duke thënë:

---

[76] Buhariu, 3662.
[77] Buhariu, 3818. Muslimi, 2435.
[78] Nesaiu, "*El Sunen el Kubra*", 279.

"Çfarëdo që të shpenzosh për familjen tënde, ajo është sadaka, madje edhe kafshata që ia vendos në gojë gruas tënde."[79]

Do të ishte e mjaftueshme që ai të thoshte: "Shpenzimi yt për familjen tënde", por ai e ndan ushqimin kafshatë-kafshatë, pastaj e bënte mënyrën e dhënies së asaj kafshate pjesë të *sadakasë*. Burri e merr një kafshatë nga ushqimi dhe me dorën e tij ia jep gruas së tij për ta ngrënë, sikur të ishte duke i dhënë një mësim për sjelljen dhe shprehjen e dashurisë.

Së shtati: Shfaqja e kujdesit për interesimin dhe rëndësinë midis bashkëshortëve. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka treguar mjeshtëri, delikatesë dhe butësi në këtë drejtim. Kur u pyet Aishja për mënyrën e jetës së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në shtëpinë e tij, ajo tha: "Ai merrej me punët e familjes së tij."

Këtu në mendje më shfaqet një pyetje e thellë: A ishte Aishja e shqetësuar nga puna dhe mundimi, që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) të punonte me të në shtëpinë e tij, ta ndihmonte dhe të shërbente? A nuk ishte dhoma e saj shumë e ngushtë, me mure të afërta, saqë nuk tejkalonte dhjetë krahë në gjatësi dhe shtatë krahë në gjerësi, që do të thotë rreth 5 metra x 3.5 metra?

Dhe puna aty ishte e tillë që mund të kalonin dy muaj të plotë pa ndezur një zjarr për të përgatitur ushqim. Vallë, a kishte pastaj ndonjë punë që kërkonte shumë mund dhe, për më tepër, të kërkonte ndihmën që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) të ishte i angazhuar në punët e familjes së tij?

Përgjigjja për këtë pyetje është se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk i ndihmonte gruas së tij në punët e shtëpisë për shkak të punës së shumtë dhe mundimit të saj, por kishte një kuptim më të thellë, që ishte ngushëllimi dhe ndjenja e pjesëmarrjes së plotë në jetën bashkëshortore, si dhe për të realizuar një nga kuptimet e fjalës *seken* (që do të thotë "qetësi dhe prehje") tek ajo: *"Për t'u qetësuar pranë saj"*, ashtu sikurse Kurani thotë: ***"Që të qetësoheni pranë tyre"*** (Er-Rum: 21) dhe nuk thotë *për*

[79] Buhariu, 2742. Muslimi, 1628.

t'u qetësuar me ato, që tregon për angazhimin e plotë dhe përkushtimin ndaj saj në çdo aspekt të jetës së përbashkët.

Këto veprime të vogla në shtëpi arrijnë në zemrën e gruas, të shoqëruara me një shpjegim që mbushet me kuptime dashurie, dashamirësie dhe mëshire, duke e bërë gruan të ndiejë afërsi të madhe me burrin dhe një mishërim shpirtëror dhe emocional me të.

Fakti që burri angazhohet me punët e shtëpisë, në çdo formë dhe në çdo lloj pune, është një mesazh jete që thotë se kjo është shtëpia jonë e të gjithëve, ashtu siç është jeta jonë e përbashkët. Këto gjeste të ndjeshme krijojnë kuptimin e mishërimit bashkëshortor dhe burrin e bëjnë të madh në sytë e gruas për shkak të përulësisë së tij, e gjithashtu të rëndësishëm për shkak të thjeshtësisë së tij.

Nga këto veprime, është edhe vëmendja ndaj ndjenjave të gruas dhe të kuptuarit e tyre. Pasi Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i tha Aishes: "*Unë e di kur je e kënaqur me mua dhe kur je e zemëruar ndaj meje...*", ajo e pyeti: "Si e di ti këtë?" Ai u përgjigj: "*Kur je e kënaqur, ti thua: Pasha Zotin e Muhamedit, dhe kur je e zemëruar, thua: Pasha Zotin e Ibrahimit!*" Ajo tha: "Po, për Zotin, vetëm emrin shmang!"[80] (dhe jo ty).[81]

Së teti: Jeta martesore e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte plot me momente të gëzuara dhe të natyrshme, të cilat rigjeneronin gëzimin dhe lumturinë. Nga këto momente mund të përmendim:

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ka thënë: "Një ditë na vizitoi Sevda dhe Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u ul midis meje dhe saj, njëra këmbë e tij ishte në prehrin tim dhe tjetra në prehrin e saj. Unë i përgatita asaj një harire (ose tha: një hazire[82]). I thashë: 'Haje!', por ajo refuzoi. I thashë: 'Do ta hash ose do ta hedh në fytyrë!' Ajo refuzoi. Atëherë unë mora diçka nga tepsia[83] dhe ia

[80] Buhariu, 5228. Muslimi, 2439.

[81] **Shënim i përkthyesit**: Aishja dëshiron të tregojë se është thjesht e zemëruar, por dashuria është e plotë, prandaj ajo thjesht heq emrin e tij gjatë betimit dhe vendos emrin e Ibrahimit, alejhi selam.

[82] Hazire: Mish i grirë në copa të vogla, mbi të cilin hidhet shumë ujë. Kur zihet mirë, i shtohet miell. Nëse nuk ka mish, atëherë quhet "Asida". Shih: "*Nihaje*", 2/28.

[83] Kasatu: Enë e madhe për të vendosur ushqimin që mjafton për dhjetë vetë. "*Taxhu el Arus*", 5/24.

fshiva në fytyrë. Në atë moment i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e ngriti këmbën nga prehri i saj që të mund të merrte pjesë dhe ajo mori diçka nga tepsia dhe e fshiu në fytyrën time. I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) vetëm qeshte. Ndërkohë, jashtë u dëgjua një zë që thërriste: 'O Abdullah ibn Umer, O Abdullah ibn Umer!' I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: "*Ngrihuni shpejt dhe lajini fytyrat tuaja, sepse më duket se Umeri do të hyjë brenda.*"[84]

Ky është një fragment i ngrohtësisë së hareshme, lumturisë dhe qeshjes me zë, që ndodhte në mënyrë krejt të natyrshme në shtëpinë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) mes tij dhe grave të tij, me pjesëmarrjen aktive dhe qeshjen e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Së nënti: Butësia në familje, lehtësimi dhe jo vështirësimi. Nga Xhabiri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet se pas përfundimit të Haxhit dhe përgatitjes për Tavafin e lamtumirës, Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* i tha Profetit: "*O i Dërguari i Allahut, njerëzit do të kthehen me Umre dhe Haxh, ndërsa unë do të kthehem vetëm me Haxh!*" Ajo po i referohej faktit se nuk kishte kryer Umre të veçantë para Haxhit, siç bënë gratë e tjera të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), për shkak të menstruacioneve. I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i tha: "*Tavafi yt rreth Qabes është i mjaftueshëm për Haxhin tënd dhe Umren tënde!*" Ajo refuzoi dhe tha: "Njerëzit do të kthehen me Haxh dhe me Umre, njerëzit do të kthehen me dy shpërblime, ndërsa unë do të kthehem me një shpërblim!" Ai tha: "*Ty të takon po aq sa atyre.*" Ajo tha: "Unë ndiej se nuk kam bërë Tavaf rreth Qabes derisa të bëj Haxhin." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte një njeri i lehtë dhe nëse dikush dëshironte diçka, ai e mbështeste atë. Ai thirri vëllain e saj, Abdurrahmanin, dhe i tha: "Shko me motrën tënde në Ten'îm, dhe kur të arrini atje, le të bëjë telbijen për Umre, sepse ajo është Umre e pranuar. Pasi të përfundoni Tavafin tuaj, do t'ju pres këtu."

[84] Nesaiu, "*El Sunen el Kubra*", 8868.

Gjatë udhëtimit, sidomos në fund të tij, shpenzohet shumë energji shpirtërore dhe zakonisht udhëtari nuk e duron kundërshtimin kur është gati për t'u nisur. Megjithatë, I Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tregoi një nivel të lartë mirëkuptimi dhe lehtësimi, duke kuptuar dëshirat e shpirtit. Shiko përshkrimin e Xhabirit: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte një njeri mirëkuptues dhe, nëse dikush dëshironte diçka, ai e mbështeste atë!" Ky është një përshkrim i butësisë dhe lehtësimit, i shoqërimit të mirë, i mirësjelljes ndaj familjes dhe i përmbushjes së dëshirave të tyre.

Së dhjeti: Dhënia e pozitës së duhur gruas, duke i shprehur asaj ndjesitë që ndodhen në zemër dhe duke pranuar këshillat e saj të mençura. Nga shembujt e kësaj janë:

Momenti kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u kthye i tronditur nga shpella Hira pas takimit të tij të parë me engjëllin Xhibril, Hatixhja e qetësoi dhe e siguroi, pastaj i sugjeroi të shkonin te kushëriri i saj, Vereka bin Neufeli. Ai shkoi me të, bisedoi me të dhe dëgjoi fjalët e tij.[85]

Momenti në Hudejbije, kur i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i urdhëroi shokët e tij të therin kurbanët dhe të rruanin flokët, mirëpo ata hezituan për shkak të dëshirës së madhe për të shkuar në Mekë për Umre. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u zemërua dhe hyri te Umu Seleme i shqetësuar. Ajo i tha: "*Dil jashtë, mos u thuaj asgjë dhe ther kurbanin tënd, pastaj rruaj flokët. Kur të veprosh kështu, njerëzit do të ndjekin.*" Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) doli jashtë, nuk foli me askënd, theri kurbanin e tij dhe thirri berberin që t'i rruante flokët. Këtu *sahabët* menjëherë nxituan të therin kurbanët e tyre dhe të rruajnë kokat, aq shpejt sa nga frika se mos e kanë zemëruar të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) disa prej tyre pothuajse e prenë njëri-tjetrin me brisk nga ngutja.[86]

Ky udhëzim profetik ishte ndryshe nga zakonet e kurejshëve, ashtu siç tregon Umeri, *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* për kohën para

[85] Buhariu, 3. Muslimi, 160.
[86] Buhariu, 2731.

ardhjes së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*): "Ne nuk u jepnim grave të drejtë mendimi."[87]

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* veproi ndryshe nga tradita e popullit të tij, duke zgjedhur të këshillohej me gratë dhe t'i përfshinte ato në vendimmarrje. Dhënia e kësaj të drejte për gratë është një nga dëshmitë e profetësisë së tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), pasi ai nuk e merrte udhëzimin e tij nga mjedisi shoqëror, por e pranonte atë nga shpallja hyjnore.

Së njëmbëdhjeti: Gratë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), të cilat ishin pranë tij dhe kishin qasje të plotë dhe të drejtpërdrejtë në jetën e tij private si askush tjetër, luajtën një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe përcjelljen e traditës së tij për Umetin. Kështu, jeta e tij u përfshi e tëra, si ajo publike ashtu edhe ajo private, si çështjet e përgjithshme ashtu edhe ato personale, duke i mundësuar Umetit mundësinë e njohjes së plotë të gjendjeve të tij dhe ndjekjen e shembullit të tij në çdo aspekt të jetës.

Gratë e tij, *Nënat e Besimtarëve*, ishin si një sy vigjilent për Umetin, të cilat përcollën ato aspekte të jetës së tij që të tjerët nuk mund t'i shihnin.

Një shembull i kësaj është kur disa nga Tabiinët e pyetën Aishen *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*: "Çfarë bënte i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në shtëpi kur ishte me ty?"

Ajo e priti këtë pyetje me ngrohtësi dhe hapi një dritare drejt *Shtëpisë Profetike*, duke na lejuar të shohim sesi ishte ai në jetën e tij private dhe me familjen e tij. Ajo u përgjigj: "I Dërguari, kur ishte vetëm në shtëpinë e tij dhe me familjen e tij, ishte njeriu më i butë dhe më fisnik nga të gjithë..."[88]

Ndër këto çështje është edhe përcjellja e normave të veçanta të marrëdhënieve të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me bashkëshortet e tij. Siç janë aspektet e marrëdhënieve, përshkrimi i pastrimit dhe i mënyrës së pastrimit pas marrëdhënieve etj.

Këto janë transmetuar nga disa prej *Nënave të Besimtarëve*.

---

[87] Buhariu, 2468. Muslimi, 1479.

[88] Buhariu, 676, 6039. Is'hak bin Rahovejhi, "*Musned*", 1550. Ahmedi, "*Musned*", 23093. Ibn Hibbani 5676. "*Fet'hu el Bari*", 2/163, 10/461.

Përshkrimi i pastrimit të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*):

Mejmunja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "I solla ujë të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që të lahej dhe ai e hodhi ujin mbi duart e tij dhe i lau ato dy ose tri herë. Pastaj me dorën e djathtë hodhi ujë dhe me të majtën lau organin e tij intim, pastaj e fërkoi dorën me dhe, më pas shpëlau gojën dhe hundën, e lau fytyrën dhe duart, e lau kokën tri herë, pastaj e hodhi ujin mbi gjithë trupin e tij. Më pas u largua pak nga vendi i larjes dhe lau këmbët."[89]

Përshkrimi i qëndrimit gjatë ditës së agjërimit:

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) puthte dhe përqafonte ndërsa ishte agjërueshëm, por ai ishte më i përmbajturi ndër ju në kontrollimin e epshit të tij."[90]

Po ashtu, Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Kur ndonjëra prej nesh ishte me menstruacione dhe i Dërguari i Allahut dëshironte t'i afrohej, ai e urdhëronte që të vishte izarin (një rrobë që lidhet për beli dhe mbulon pjesën e poshtme të trupit) dhe pastaj i afrohej..."[91]

Në këtë mënyrë, *Nënat e Besimtarëve* përcollën disa aspekte të natyrës njerëzore të të Dërguarit të Allahut, sidomos aspektet që i përkasin hapësirës së marrjes shembull për t'u ndjekur. Prandaj, ato u bënë referencë për sahabët dhe Tabiinët për njohjen e shumë normave që ndodhnin në shtëpitë e tyre. Kthimi te to ndihmonte në sqarimin e këtyre normave dhe largimin e paqartësive rreth tyre.

Ja disa shembuj:

Ebu Musa *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se një grup nga muhaxhirët dhe ensarët patën një mospajtim. Ensarët thanë: "Gusli është i detyrueshëm vetëm nëse ndodh derdhja." Ndërsa muhaxhirët thanë: "Nëse ndodh kontakti, atëherë gusli është i

[89] Buhariu, 265. Muslimi, 317.
[90] Buhariu, 1927. Muslimi, 1106.
[91] Buhariu, 302. Muslimi, 293.

detyrueshëm." Ebu Musa thotë se u tha: "Unë do t'ju jap zgjidhjen për këtë çështje." - dhe shkova tek Aishja, i kërkova leje për të hyrë dhe më dha leje. Pastaj i thashë: "Oj nëna ime! Oj Nëna e Besimtarëve! Dua të pyes për diçka, por më vjen turp nga ti." Ajo tha: "Mos ki turp të më pyesësh për diçka që do ta pyesje nënën tënde që të ka lindur. Unë jam nëna jote." Ebu Musa tha: "Çfarë e bën guslin të detyrueshëm?" Ajo tha: "Ke pyetur personin e duhur. I Dërguari i Allahut ka thënë: "Kur burri ulet midis katër gjymtyrëve të saj dhe organet e tyre intime preken, atëherë gusli bëhet i detyrueshëm."[92]

Sead bin Hisham bin Amir tregon se shkoi tek Ibn Abasi dhe e pyeti për namazin e *vitrit* të të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Ibn Abasi iu përgjigj: "A të tregoj për personin më të ditur për namazin e vitrit të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)*?*" I thashë: "Kush është ai?" Ibn Abasi më tha: "Aishja, shko dhe pyete, pastaj kthehu e më trego përgjigjen e saj." Seadi tregon se shkoi tek Aishja së bashku me Hakim bin Eflah dhe kërkoi leje për të hyrë. Kur hynë, Aishja e njohu Hakimin dhe e pyeti për mua. Ai i tha: "Sead bin Hisham." Ajo tha: "I biri i Hishamit bin Amirit?" Pastaj u lut për mëshirë për të dhe e përmendi me fjalë të mira, sepse ai kishte rënë dëshmor në Uhud. Unë i thashë: "Oj Nëna e Besimtarëve! Më trego për moralin e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)." Ajo më tha: "A nuk e lexon Kuranin?" Unë i thashë: "Po!" Ajo më tha: "Morali i të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte Kurani."

Seadi thotë se mendoi të ngrihet dhe të mos pyes më askënd derisa të vdesë, por pastaj i thashë: "Oj Nëna e Besimtarëve! Më trego për namazin e natës të të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)." Ajo më tha: "A nuk e lexon fjalën e Allahut: ***"O ti i mbuluar*** (o Muhamed)***!"*** (El-Muzemil: 1) Unë i thashë: "Po." Ajo më tha: "Allahu e bëri namazin e natës obligim në fillim të kësaj sureje, kështu që i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) *dhe shokët e tij e falën atë për një vit. Allahu e mbajti fundin e kësaj sureje në qiell për dymbëdhjetë muaj, pastaj e zbriti*

[92] Muslimi, 349.

atë dhe aty erdhi lehtësimi në fund të sures, dhe kështu namazi i natës u bë një adhurim vullnetar pasi ishte obligim." Unë i thashë: "O Nëna e Besimtarëve! Më trego për namazin e vitrit të të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)." Ajo më tha: "Ne i përgatisnim atij misvakun dhe ujin për abdes. Allahu e zgjonte nga gjumi kur të donte gjatë natës dhe ai merrte misvakun, merrte abdes dhe falte nëntë rekate, duke mos u ulur deri në rekatin e tetë, ku bënte teshehudin, e falënderonte Allahun dhe bënte dua, pastaj çohej pa dhënë selam dhe falte rekatin e nëntë. Pastaj ulej, e falënderonte Allahun, bënte dua dhe jepte selam, të cilin ne e dëgjonim. Pastaj, pasi jepte selam, falte edhe dy rekate ulur, dhe kështu bëheshin njëmbëdhjetë rekate, o biri im! Kur Pejgamberi i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u plak dhe u dobësua, e falte vitrin me shtatë rekate dhe bënte në to si më parë, kështu që gjithsej ishin nëntë rekate. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nëse falej një herë, e pëlqente ta vazhdonte atë. Kur e zinte gjumi ose ishte i sëmurë dhe nuk mund të ngrihej natën, ai e falte namazin e natës gjatë ditës me dymbëdhjetë rekate.

Nuk e di që i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ta ketë lexuar të gjithë Kuranin brenda një nate, as që e ka falur gjithë natën derisa të zbardhte mëngjesi, as që e ka agjëruar ndonjë muaj të plotë përveç Ramazanit."[93]

Ubejd bin Umejr tregon se Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* dëgjoi se Abdullah bin Umejri i urdhëronte gratë që kur të lahen për *gusl* të zgjidhin flokët e tyre. Ajo tha: "Sa çudi me këtë Ibn Umejrin! Ai u thotë grave që kur të lahen për gusl të zgjidhin flokët e tyre! Pse nuk u thotë që t'i rruajnë krejtësisht?! Unë dhe i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* laheshim nga një enë e përbashkët dhe nuk bëja më shumë sesa të hidhja ujë mbi kokën time tri herë."[94]

Aishja, Umu Seleme, Hafsa dhe Mejmunja *(Allahu qoftë i kënaqur me to)* ishin thesari i dijes për shkak të pranisë së tyre për të parë dhe dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut*

[93] Muslimi, 746.
[94] Muslimi, 331.

qofshin mbi të) ato e ruajtën atë që panë dhe dëgjuan dhe më pas e përcollën tek Umeti pas vdekjes së tij.

Së dymbëdhjeti: Besnikëria ndaj tyre, ruajtja dhe përmendja e kujtimit të tyre me mirënjohje dhe ruajtja e miqësisë pas tyre.

I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) vazhdimisht i shprehte me mirësinë më të madhe kujtimet me Hatixhen *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* dhe i qëndronte besnik asaj, ruante lidhjet me të miqtë e saj, përmendte virtytet e saj dhe kujtonte me dashamirësi të kaluarën e saj.

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se një grua e moshuar erdhi te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ndërsa ai ishte tek unë.

Ai e pyeti:

- *"Kush je ti?"*

Ajo u përgjigj:

- "Unë jam Xheththame[95] el Muzenije."

Atëherë i Dërguari i Allahut i tha:

- *"Jo, por ti je Hasane el Muzenije! Si jeni? Si është gjendja juaj? Si keni qenë pas nesh?"*

Ajo iu përgjigj:

- "Mirë, o i Dërguari i Allahut! Qoftë jeta ime për ty! "

Pasi ajo u largua, unë e pyeta:

- "O i Dërguari i Allahut, si ka mundësi që tregove kaq shumë përzemërsi ndaj kësaj gruaje të moshuar?"

Ai u përgjigj:

- *"Ajo na vinte në kohën e Hatixhes dhe ruajtja e miqësisë është pjesë e besimit."*[96]

O Zot! Si ka mundësi që ta quajë të gjithë atë kohë *koha e Hatixhes*? Pastaj, t'i japë aq shumë rëndësi asaj që vinte te ata në atë kohë, si një nderim për atë besë dhe atë jetë të përbashkët, aq sa Aishja vuri re përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm ndaj saj, një vëmendje dhe mall që e bënë të pyeste për sekretin pas kësaj.

---

[95] **Shënim i përkthyesit**: Emri Xheththame nuk ka kuptim pozitiv pasi ai nënkupton njeriun dembel dhe makthin, për këtë Pejgamberi i tha: "Jo, por ti je Hassane - Më e mira!"

[96] "*El Mustedrek*", 40.

Dhe përgjigjja profetike ishte: "*Ajo vinte tek ne në kohën e Hatixhes.*"

O Zot, po sikur të vinte vetë Hatixhja?!

Aishja, po ashtu, tregon se Hala bint Huvejlid, motra e Hatixhes, kërkoi leje për të hyrë te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).* Kur ai e dëgjoi mënyrën e saj të kërkimit të lejes, e njohu atë si e ngjashme me atë të Hatixhes dhe u emocionua, pastaj tha: "O Allah, (erdhi) Hala!" Aishja vazhdon se ndjeu *xhelozi* dhe i tha: "Për çfarë e përmend një plakë nga plakat e kurejshëve, me faqe të kuqe të fishkura, që ka vdekur prej kohësh? Allahu të ka dhënë një më të mirë se ajo!" I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) mu përgjigj: *"Allahu nuk më ka dhënë më të mirë se ajo. Ajo më besoi kur njerëzit më mohuan, më besoi kur njerëzit më përgënjeshtruan, më ndihmoi me pasurinë e saj kur njerëzit më privuan, dhe Allahu më dha fëmijë prej saj, ndërsa më privoi nga fëmijët e grave të tjera."*[97]

Njeriu nuk mund të mos habitet: nëse ai ndjeu një gëzim të tillë për motrën e Hatixhes, si do të ishte gjendja e tij po të vinte vetë Hatixhja?!

Ajo u largua nga kjo botë, por mbeti gjallë në zemrën e tij. Ai vazhdoi t'i qëndronte besnik kujtimit të saj, të mbante marrëdhënie të mira me të afërmit dhe miqtë e saj. Dhe ky kujtim i zjarrtë nuk u shua as nga prania e nëntë grave të tjera që e rrethonin dhe i përkushtoheshin atij.

Bisedat e tij me familjen

Së pari: Biseda e burrit me gruan e tij është një element thelbësor që thellon marrëdhënien dhe mbush jetën me dashuri, duke i dhënë secilit prej bashkëshortëve një prani të fortë në jetën e tjetrit. Këtë e shohim të pasqyruar qartë në jetën e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, nëpërmjet disa fragmenteve të bukura të bisedës së tij me familjen.

[97] Buhariu, 3821. Muslimi, 2437.

Kështu, Ibn Abasi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* përshkruan natën që kaloi me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në shtëpinë e gruas së tij, Mejmunes - e cila ishte tezja e Ibn Abasit. Ai thotë: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* fjeti me familjen e tij në gjatësi të jastëkut, ndërsa unë fjeta në gjerësinë e tij. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bisedoi me familjen e tij për një kohë, pastaj ra në gjumë..."[98]

Shiko se si Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, para se të flinte, zhvillonte një bisedë dashamirësie dhe afërsie me gruan e tij. Ai nuk hynte në shtëpi duke mbajtur me vete shqetësimet dhe lodhjet e ditës, por, përkundrazi, sillte gëzim dhe shoqërim për familjen e tij. Gjëja e fundit që gruaja e tij kujtonte para se të flinte ishte pikërisht kjo bisedë plot dashuri.

Dhe ka diçka edhe më të mrekullueshme se kjo! Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, kur thërriste ezani i sabahut, ngrihej dhe falte dy rekate të lehta. Nëse isha zgjuar, ai bisedonte me mua, e nëse isha në gjumë, ai shtrihej derisa të vinte Bilali për ta lajmëruar për namazin."[99]

Kjo do të thotë se Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* e fillonte ditën e saj para namazit të sabahut duke biseduar me të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai e merrte parasysh gjendjen e saj: nëse ishte zgjuar, bisedonte me të, e nëse flinte, nuk e zgjonte, sepse e dinte që ajo kishte më shumë nevojë për gjumë.

Shihe pozitën e gruas në jetën e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: ajo flinte dhe zgjohej me bisedën e tij!

Së dyti: I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shihte bisedën me gruan si një nevojë shpirtërore, për të cilën gruaja ka nevojë për të ndjerë afërsinë dhe ngrohtësinë e bashkëshortit të saj. Për këtë arsye, gratë e tij shkonin tek ai edhe gjatë Ramazanit, kur ai ishte në *itikaf*, edhe pse në *itikaf* ndalohen të gjitha kënaqësitë trupore bashkëshortore. Safija *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* shkonte tek i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në mes të natës, sepse kishte një lloj tjetër kënaqësie shpirtërore që nuk mund

[98] Buhariu, 4569. Muslimi, 256.
[99] Buhariu, 1161. Muslimi, 743.

të lihej pas dore: biseda me bashkëshortin. Ajo tregon: "Shkova tek i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndërsa ai ishte në itikaf dhe bisedova me të për një kohë. Kur desha të kthehem, ai u ngrit për të më shoqëruar deri në shtëpi."[100]

Shtëpia e saj ishte jashtë xhamisë dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e shoqëroi nga frika se mos i ndodhte diçka, sepse Medina ishte një vend i sigurt dhe i qetë. Por, ai doli me të vetëm për ta shoqëruar dhe për t'i dhuruar ngrohtësinë e prezencës gjatë rrugës.

Së treti: Një aspekt tjetër i bisedave mes të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe bashkëshorteve të tij ishte biseda mësimdhënëse, duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre dhe duke sqaruar çështjet e paqarta.

Kjo tregon hapësirën e madhe që ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i jepte dialogut shkencor, reflektimit dhe arsyetimit. Gratë e tij i shtronin pyetje dhe kërkonin sqarime, ndërsa ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i mirëpriste dhe u përgjigjej me qartësi dhe butësi.

Ibn Ebi Mulejka tregon se Aishja, bashkëshortja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, sa herë që dëgjonte diçka që nuk e kuptonte e pyeste për të, derisa ta kuptonte. Një ditë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Kush merret në llogari në Ditën e Gjykimit, do të dënohet."* Aishja tregon se tha: *"A nuk thotë Allahu i Lartësuar:* ***"Do ta ketë të lehtë llogarinë"****,* por Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha*: "Kjo është vetëm në momentin e paraqitjes, kurse kush merret në llogari, ai do të shkatërrohet."*[101]

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kishte biseda të shumta me gratë e tij, *Nënat e Besimtarëve*, të cilat tregonin zellin e tyre për të marrë dije dhe pyetjet e tyre për të kuptuar çështjet e paqarta, ndërsa ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigjej me shpjegime dhe me sqarime.

[100] Buhariu, 2038. Muslimi, 1275.
[101] Buhariu, 103. Muslimi, 2876.

Disa shembuj të këtyre bisedave:

1. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Dy gra të moshuara nga çifutët e Medinës hynë tek unë dhe më thanë: "Të vdekurit dënohen në varret e tyre." Unë e mohova dhe nuk isha e qetë[102] ta pranoja atë që thanë. Kur ato dolën, hyri i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe i tregova për këtë. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha*: "Ato kanë thënë të vërtetën. Ata dënohen me një dënim që e dëgjojnë të gjitha kafshët."* Pas kësaj, sa herë që kam parë duke u falur, e kam dëgjuar që kërkonte mbrojtje nga dënimi i varrit*."*[103]

2. Umu Seleme *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha*: "Një burrë do të kërkojë mbrojtje në Qabe dhe një ushtri do të dërgohet kundër tij. Kur të mbërrijnë në një vend të quajtur Bejda, toka do t'i përpijë të gjithë."* Umu Seleme tregon se e pyeti të Dërguarin e Allahut: *"Po ata që janë me ta pa dëshirën e tyre, si tregtarët apo ata që s'kanë lidhje me këtë?"* Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha*: "Ata do të përfshihen në fundosje me ta, por do të ringjallen në Ditën e Gjykimit sipas qëllimit të tyre."*[104]

3. Hafsa *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Unë shpresoj që, me lejen e Allahut, askush prej atyre që morën pjesë në Bedër dhe Hudejbije të mos hyjë në zjarr."* Hafsa thotë se pyeti të Dërguarin e Allahut se a nuk ka thënë Allahu i Lartësuar: *"**Nuk ka asnjë prej jush që të mos kalojë mbi të** (Xhehenemin)**; ky është një urdhër i caktuar nga Zoti yt**."* (Merjem: 71) Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) iu përgjigj: *"A nuk ke dëgjuar fjalën e Allahut: "**Pastaj do t'i shpëtojmë ata që i janë frikësuar Allahut dhe do t'i lëmë mizorët aty** (në zjarr)**, të gjunjëzuar.**"?* (Merjem: 72)

4. Umu Seleme *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se *lutja* që i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e bënte më së shumti ishte: *"O Ti që i kthen zemrat* (nga një gjendje në tjetrën)*, forcoje zemrën time në fenë Tënde."* Umu Seleme tregon se e pyeti të

---

[102] Shiko "*Sherh el Sujuti ala Muslim"*, 2/248.

[103] Buhariu, 6366. Muslimi, 586.

[104] Muslimi, 2882.

Dërguarin e Allahut se pse e thotë kaq shpesh këtë lutje, ndërsa ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) iu përgjigj: *"O Umu Seleme! Nuk ka njeri, që zemra e tij të mos jetë midis dy gishtave të Allahut; Ai drejton kë të dojë dhe devijon kë të dojë."*[105]

Së katërti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregoi nivel të lartë ndjeshmërie dhe komunikimi me gratë e tij. Ai jo vetëm që ishte një folës i shkëlqyer, por ishte edhe një dëgjues i vëmendshëm.

Një ditë **Aishja** (Allahu qoftë i kënaqur me të) i tregoi Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) bisedën e Umu Zera, një bisedë e gjatë ku njëmbëdhjetë gra u bashkuan dhe vendosën që secila të përshkruante burrin e vet. Kështu secila filloi të përshkruante burrin e saj. Njëra fliste me mirënjohje, tjetra fliste duke u ankuar, derisa erdhi radha te e njëmbëdhjeta, e cila tregoi:

Burri im është Ebu Zera e kush është Ebu Zera! Më zbukuroi me stoli veshët dhe më shëndoshi krahët me ushqim, më gëzoi[106] aq sa unë u ndjeva e lumtur. Më gjeti ndër njerëz që jetonin me vështirësi[107], në një vend të varfër, e më bëri pjesë të njerëzve ku hingëllinin kuajt dhe kërcisnin samarët e kafshëve nga ngarkesat e mëdha, në një vend ku mblidheshin të korrurat dhe zhvisheshin prodhimet e shumta[108]. Pranë tij flisja pa u qortuar, shtrihesha dhe flija[109] në qetësi dhe zgjohesha kur të doja, pija derisa ngopesha.[110]

Pastaj tha se Ebu Zera doli një ditë ndërsa po tundeshin dybekët e qumështit.[111] Në rrugë takoi një grua me dy fëmijë si dy gepardë, të cilët po luanin përreth saj me dy shegë. Ai më ndau dhe u martua me të.

---

[105] Tirmidhiu, 3522.
[106] "*El Nihajetu*", 1/96.
[107] "*El Nihajetu*", 2/491.
[108] "*El Nihajetu*", 2/140 dhe 5/111.
[109] "*El Nihajetu*", 3/7.
[110] "*El Nihajetu*", 4/106.
[111] "*Fet'h el Bari*", 1/186.

Pas tij u martova me një burrë fisnik, i cili kishte kalë[112] të shpejtë, mbante shtizë të gjatë[113]. Ai më mbuloi me begati të shumta dhe nga çdo lloj pasurie më sillte një pjesë[114]. Ai më thoshte: "Ha, o Umu Zera, vizitoje familjen tënde dhe dërgoju edhe atyre!"[115]

Por, ajo shtoi: Nëse do t'i mblidhja të gjitha ato që më dha ai (burri i dytë), nuk do të arrinin as madhësinë e enës më të vogël të Ebu Zeras!

Kur Aisheja përfundoi tregimin, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha:

"Unë jam për ty si Ebu Zera për Umu Zeran - por me ndryshim se unë nuk të ndaj!"[116]

Shikoje këtë shtesë të bukur që ai i dha Aishes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*! I dha sigurinë që nuk do ta ndante siç ndodhi me Umu Zeran, edhe pse Ebu Zera ishte një burrë bujar dhe i mrekullueshëm, ai e la. Ndërsa i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është më i mirë se ai dhe nuk do ta ndajë.

Shikoje, gjithashtu, përgjigjen e Aishes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*: *"Përkundrazi, - kurban t'u bëfsha me babë dhe nënë! Ti je më i mirë se Ebu Zera!"*

Ky dialog reflekton një marrëdhënie të ndërtuar mbi dashuri, vlerësim dhe siguri emocionale. Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) jo vetëm që dëgjoi me durim një histori të gjatë, por edhe e përdori atë për t'i shprehur Aishes sigurinë e dashurisë së tij të përhershme.

Ndërkohë është e mrekullueshme gatishmëria emocionale e Aishes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, e cila nxitoi t'i shprehë Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) se Ai është më i mirë se Ebu Zera. Ajo tregoi të vërtetën pasi pranë tij fitoi nderin e kësaj bote dhe të botës tjetër. *Qoftë jeta jonë për të (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

---

[112] "*El Nihajetu*", 2/469.
[113] "*El Nihajetu*", 2/48.
[114] "*El Nihajetu*", 2/273.
[115] "*Fet'h el Bari*", 9/275.
[116] Buhariu, 5189.

Së pesti: Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), kur fliste me gratë e tij, zgjidhte atë që i interesonte atyre dhe u përkiste atyre, dhe që prekte ndjenjat e tyre. Prandaj e shohim se, kur ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u kthye nga beteja e Hajberit dhe hyri në shtëpinë e Aishes pas një mungese prej afro një muaji, Aishja kishte vendosur lodrat e saj në një çarje të murit, mbi të cilën kishte vendosur një mbulesë dhe e kishte përgatitur si një shtëpi për lodrat. Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hapi derën, me të hyri një rrymë ajri që lëvizi mbulesën dhe zbuluan lodrat. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) filloi të shikonte lodrat dhe tha: *"Aish.., çfarë janë këto?"*

Ai e dinte se ato ishin lodrat e saj, por pyeti për të hapur bisedën me të dhe për të treguar kujdes për gjërat që i interesonin. Ajo u përgjigj: "Këto janë vajzat e mia, O i Dërguar i Allahut!" Ai tha: *"Po çfarë është ai që është mes tyre?"* - Ajo kishte vendosur mes tyre një kalë me krahë prej lëkure. Ajo tha: "O i Dërguar i Allahut, ky është një kalë!" Dhe erdhi pyetja e tretë për ta gjallëruar më tej bisedën. Ai tha: *"Subhanallah! Kalë me krahë?!"*

Ajo u përgjigj: "O i Dërguar i Allahut, a nuk ke dëgjuar se pejgamberi i Allahut, Sulejmani, kishte një kalë me krahë?!"[117]

Këtu mbetemi të mahnitur…, pasi Aishja nuk e kishte njohur Sulejmanin veçse nga Muhamedi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), por ajo u shpreh ashtu për të vazhduar bisedën, sepse Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kishte tërhequr vëmendjen e saj dhe kishte folur me të për gjëra që asaj i pëlqenin.

Biseda e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me gratë e tij ishte një bisedë që sillte dashuri, thellonte marrëdhënien dhe i jepte jetës një shije dhe hare të veçantë. Ndërsa një nga gjërat që më së shumti e shuajnë ngrohtësinë e një marrëdhënieje bashkëshortore është mungesa e reagimit, heshtja e gjatë dhe fytyrat e ngrysura.

[117] Ebu Davudi, 4932.

I Dërguari si baba

Atësia - kjo ndjenjë e mrekullueshme dhe e bukur që e shijon babai me një kënaqësi të thellë kur i drejtohet të birit: "O biri im!" ose kur dëgjon thirrjen e djalit të tij: "O babai im!"

Pejgamberët e Allahut, paqja qoftë mbi ta, i paraqitën njerëzimit shembullin më të plotë të atësisë. E shohim këtë në thirrjen plot dashuri të Nuhut (*paqja qoftë mbi të)* ndaj të birit: ***"O biri im, hip me ne ...!"*** (Hud: 42); në thirrjen e Jakubit (*paqja qoftë mbi të)* drejtuar djalit të tij, Jusufit (*paqja qoftë mbi të)*: ***"O biri im! Mos ua trego ëndrrën tënde vëllezërve të tu..."*** (Jusuf: 5); në këshillën e Lukmanit për të birin: ***"O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë."*** (Lukman: 13) Allahu i dërgoi të Dërguarit e Tij etër të bijve të tyre, siç thotë Allahu: ***"Vërtet, edhe para teje Ne kemi sjellë të dërguar, të cilëve u kemi dhënë gra dhe pasardhës."*** (Er-Ra'd: 38) Derisa erdhi i fundit prej tyre, Pejgamberi ynë (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), për t'ia kthyer kësaj ndjenje natyrshmërinë e saj të pastër, thellësinë emocionale dhe rolin edukativ.

Pejgamberi ynë (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u dërgua në një kohë kur atësia në mjedisin arab ishte shformuar deri në egërsi të skajshme, aq sa disa njerëz i vrisnin fëmijët e tyre - djemtë nga frika e varfërisë dhe vajzat nga frika e turpit.

Ndjenja e atësisë ishte deformuar deri aty saqë shfaqja e dashurisë dhe mëshirës ndaj fëmijëve konsiderohej si një shenjë dobësie dhe pafuqie, të cilën ata përpiqeshin ta shmangnin. E fshihnin ndjenjën e dashurisë prindërore dhe i qëndronin krenarisht larg saj!

Njëherë, El Esh'ath bin Kajsi erdhi te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e pyeti: *"A ke fëmijë?"*, ai u përgjigj: "Më erdhi lajmi, ndërsa isha rrugës për tek ti, se më ka lindur një fëmijë. Por, për mua, më e dashur është t'u jap një darkë shokëve të mi sesa ai fëmijë." Atëherë Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi*

të) i tha: "*Mos thuaj asnjëherë kështu, sepse ata* (fëmijët) *janë gëzim për prindërit dhe shpërblim kur ndahen prej teje* (nëse vdesin)."[118]

Esh'athi nuk kishte shumë kohë që e kishte braktisur injorancën (xhahilijetit) dhe mendonte se shfaqja e gëzimit për lindjen e fëmijës nuk ishte e denjë për pozitën e tij. Ndaj, përgjigjja e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte një rikthim i ekuilibrit natyror dhe një shpallje e hapur për të: "*Mos thuaj asnjëherë kështu, sepse ata janë gëzim për prindërit …*"

Një beduin e pa Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) duke e puthur Hasanin dhe tha i habitur: "A i puthni ju fëmijët tuaj?! Unë kam dhjetë fëmijë dhe nuk kam puthur asnjërin prej tyre!" Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e pa dhe i tha: "*Çfarë mund të bëj unë nëse Allahu i Lartësuar ta ka hequr mëshirën nga zemra jote? Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet!*"[119]

Kështu, erdhi i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) plot butësi dhe mëshirë për të shpallur dashurinë, për të shfaqur mëshirën dhe për të mësuar Umetin se ndjenjat prindërore janë pjesë e adhurimit, përmes të cilave kërkohet mëshira e të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Disa nga veçoritë e atësisë së tij fisnike (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishin:

Së pari: Shfaqja e gëzimit për fëmijët dhe ndarja e lajmit të mirë me të tjerët. Ja, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u drejtohet shokëve të tij duke i përgëzuar dhe duke i bërë pjesë të gëzimit të tij: "*Më lindi sonte një djalë dhe i vura emrin e babait tim, Ibrahimit.*"[120]

Krahasoje këtë qëndrim me qëndrimin e El Esh'ath bin Kajsit kur mori lajmin për lindjen e djalit të tij, që të kuptosh se sa e madhe ishte kthesa emocionale që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i bëri të përjetonin. Ai e udhëhoqi Umetin nga një

[118] Ahmedi, "*Musned*", 21840.
[119] Buhariu, 5997. Muslimi, 2317, 2318.
[120] Muslimi, 2315.

gjendje ftohtësie dhe ashpërsie emocionale drejt një natyrshmërie të ekuilibruar dhe mëshirëplotë.

Së dyti: Ai e shfaqte hapur mëshirën dhe dashurinë për fëmijët e tij - si një akt të dukshëm e të shpallur. Një ditë, ndërsa mbante hytben në *minber*, erdhën Hasani dhe Husejni - të veshur me këmisha të kuqe - duke ecur e duke u penguar.

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ndërpreu fjalimin e tij, zbriti nga *minberi*, i mori në krahë dhe u kthye përsëri në *minber*, duke i vendosur përpara vetes. Pastaj tha: *"Allahu e ka thënë të vërtetën!"* Pastaj lexoj ajetin kuranor**: *"Pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë për ju..."*** (Et-Tegabun: 15) - pastaj shtoi: *"Pashë këta dy fëmijë duke ecur dhe duke u penguar dhe nuk pata durim pa e ndërprerë fjalën time dhe pa i marrë në krahë."*[121]

Vëre sa shumë kuptim përmban fjala e tij: *"Dhe nuk pata durim"* - sa mëshirë dhe butësi për pengesat e fëmijërisë dhe sa gëzim për hapat e tyre të vegjël! Prandaj Enesi ka thënë: "Nuk kam parë askënd më të mëshirshëm me fëmijët sesa i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."*[122]

Së treti: Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e jepte këtë dashuri në mënyrë të bollshme, të dendur e të pandërprerë, duke i mbuluar fëmijët e tij me të, derisa shpirtrat e tyre të ngopeshin me dashuri dhe afeksion.

Ebu Hurejra përshkruan një skenë të mrekullueshme të kësaj dashurie prindërore, të cilën kur e lexojmë, duket sikur po e shohim me sytë tanë, dhe kur e dëgjojmë, duket sikur jemi aty vetë, në atë çast të ngrohtë dhe të gjallë.

Ai tregon: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) doli në mesditë, eci derisa u ndal te shtëpia e Fatimes, dhe thirri: "A është aty vocërraku? A është aty vocërraku?"* - ishte një thirrje përkëdhelëse dhe e dashur, që tregon zvogëlim e dashamirësi, me kuptimin: "Ku është i vogli? Ku është i vogli?"

[121] Ebu Davudi, "*Sunen*", 1109. Tirmidhiu, 3774.
[122] Muslimi, 2316.

Fatimja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* e dëgjoi thirrjen e babait të saj, po ashtu edhe djali i saj e dëgjoi thirrjen e gjyshit. I vogli nxitoi të dalë, por nëna e tij e ndali dhe e mbajti pak, që ta përgatiste për takimin me gjyshin që kishte ardhur për ta parë. E lau, i vuri një varëse prej karafili që zakonisht i vinin fëmijëve dhe pastaj e la të dilte.

Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e pa, hapi krahët për ta pritur. Edhe djali i vogël i hapi krahët dhe nxitoi drejt tij me gjithë forcën e tij të fëmijës, derisa u hodh në prehrin e të Dërguarit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Ai e përqafoi fort, e mbajti afër gjoksit të tij të mëshirshëm, filloi ta nuhasë, ta puthte, ta përkëdhelte dhe, duke hapur buzët, i vendoste ato mbi fytyrën e tij të pastër, ndërsa lutej: "*O Allah! Unë e dua atë, andaj duaje edhe Ti! Dhe duaje çdo kë e do atë!*"[123]

Kjo shpalosje dashurie me puthje prindërore, me prekje të butë dhe me fjalë të ngrohta dashurie, është një thirrje që kumbon në veshin e fëmijës dhe mbush zemrën e tij, duke treguar vendin që ai ka në zemrën e prindit të tij. Kjo është një paketë ndjenjash që e merr fëmija nga prindi i tij, për ta mbushur shpirtin me siguri emocionale dhe për ta drejtuar shpirtërisht drejt një ekuilibri të shëndetshëm.

Së katërti: Për shkak të gjallërisë dhe ngrohtësisë në marrëdhënien mes tij dhe fëmijëve të tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), ai shqetësohej për shqetësimet e tyre, i përshtatej nivelit të mendjes së tyre, luante me ta me atë që atyre u pëlqente, i përkëdhelte me atë që i gëzonte dhe përjetonte gëzimin e tij në gëzimin e tyre.

Një ditë, i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) doli për në namaz me nipin e tij, Hasanin, dhe e vendosi pranë vetes, pastaj u fal me njerëzit. Gjatë namazit, në një nga sexhdet, ai e zgjati qëndrimin më shumë se zakonisht. Shaddad bin el Hadi tregon se e ngrita kokën dhe pashë djalin e vogël mbi shpinën e të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), ndërsa ai ishte në sexhde. Kur përfundoi namazin, njerëzit i thanë: "O i Dërguar i Allahut, ti bëre një sexhde që e zgjate shumë, saqë menduam se ka ndodhur diçka ose se po të vjen shpallja!" Ai tha:

[123] Buhariu, 2122. Muslimi, 2421.

"Asgjë nga këto nuk ndodhi, por djali im më ishte ngjitur mbi shpinë dhe nuk desha ta ndërprisja, derisa të plotësonte dëshirën e tij."[124]

Ngjitja e djalit mbi shpinën e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) gjatë namazit na tregon se kjo ishte një gjë që ai e njihte dhe e donte; ishte një mënyrë loje që e kishte përjetuar më parë me të Dërguarin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Për këtë arsye, kur e pa gjyshin në sexhde, iu ngjit si zakonisht.

Në këtë skenë të bukur, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i bashkoi disa akte adhurimi: sexhden për Allahun, ngrohtësinë dhe gëzimin për fëmijën, edukimin e Umetit për dashurinë ndaj fëmijëve dhe vetë adhurimin përmes gëzimit që i jepte atij - duke e bërë buzëqeshjen e një fëmije një akt afërsie me Zotin.

Së pesti: Dashuria profetike rritej bashkë me fëmijët. Ashtu siç Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i dhuronte dashuri të bollshme bijave të tij kur ishin të vogla, ai ua vazhdonte këtë dashuri edhe kur u rritën. Ai e vizitonte Fatimen *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* në shtëpinë e saj dhe ajo e vizitonte në shtëpinë e tij. Ndërmjet tyre shkëmbeheshin ndjenja dashurie dhe sjellje të dashurisë së sinqertë. Kjo dukej qartë në veprimet e tyre.

Kur ajo e vizitonte, ai ngrihej në këmbë për ta pritur, e përshëndeste me fjalët: *"Mirë se erdhe, bija ime!"*,[125] e merrte për dore, e puthte dhe e ulte në vendin ku kishte qenë ulur vetë - një shprehje e skajshme dashurie, nderimi dhe kujdesi. E njëjta ndodhte edhe kur ai e vizitonte atë: ajo ngrihej për ta pritur, e përshëndeste me ngrohtësi, e puthte dhe e ulte në vendin e saj. Në një skenë të lartë respektimi dhe nderimi.

Një ditë, vajza e tij, Zejnebja *(Allahu qoftë i kënaqur me të),* për lirimin e burrit të saj, Ebu'l-As ibn Er-Rebia, dërgoi si shpërblim një varëse - atë që i kishte dhuruar në natën e martesës së saj nëna e saj, Hatixhja *(Allahu qoftë i kënaqur me të).* Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e pa atë varëse, u përlot dhe u prek thellë. Pastaj u drejtua nga shokët dhe u tha: *"Nëse e shihni të arsyeshme ta lironi të burgosurin e saj dhe t'i ktheni pasurinë, atëherë bëjeni."*[126]

---

[124] Nesaiu, *"El Sunen el Kubra"*, 1141.
[125] Buhariu, 3623. Muslimi, 2450.
[126] Ebu Davudi, 2692.

Kjo ndjeshmëri e jashtëzakonshme që ai ndjeu vetëm duke parë varësen e vajzës, na bën të pyesim: Si do të ishte ndjeshmëria dhe butësia e tij po të shihte vetë vajzën e tij në atë çast? Sa dashuri do ta kishte përfshirë kur ta përqafonte?!

Së gjashti: Pejgamberi si baba (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) bashkonte dashurinë e butë me një edukim të lartë dhe mësim të ndërtuar mbi bindjen dhe butësinë.

Në një rast, ai po ndante hurma që kishin ardhur si sadaka dhe pranë tij ishte nipi i tij, Hasani, ende fëmijë i vogël. Kur mbaroi ndarjen, e mori për ta përqafuar dhe vuri re se ai kishte futur një hurmë në gojë. Ia nxori hurmën me butësi, edhe pse ajo tashmë ishte me pështymë, dhe e hodhi mes hurmave, duke i thënë: "*Keh! Keh! Nxirre! A nuk e di ti se ne nuk hamë nga sadakaja?!*"

Shprehja "*Keh! Keh!*" ishte një fjalë e përdorur për t'u folur fëmijëve të vegjël si formë ndalese e butë, por ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk u mjaftua vetëm me ndalesën - ai ia sqaroi arsyen: "*Ne nuk hamë nga sadakaja*", që do të thotë: *as unë, as ti*, duke përfshirë fëmijën në këtë ndalesë profetike, për ta bërë ta kuptojë rregullin dhe për të mbjellë bindjen në zemrën e tij që në vegjëli. Ai nuk ia mori hurmën nga goja për koprraci, por sepse ajo ishte e ndaluar për të. Ajo është pasuri që vjen nga sadakaja që jepet për të varfrit dhe nevojtarët. Pastaj vëreje fjalinë e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) "*A nuk e di ti se ne nuk hamë nga sadakaja?*"[127] - domethënë unë dhe ti nuk hamë prej saj; që ta kuptojë ky fëmijë i vogël se ky është një rregull që vlen edhe për të, bashkë me gjyshin e tij, të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) - dhe ky është një mësim për fëmijën dhe një mbjellje e bindjes në shpirtin e tij.

Në një rast tjetër, kur i erdhi lajmi se vajza e tij, Fatimja, kishte ardhur te shtëpia e tij për të kërkuar një shërbyes nga robërit që i kishin sjellë, ai nuk i dërgoi përgjigje të thatë, por shkoi vetë tek ajo dhe Aliu në mbrëmje. Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* rrëfen:

"Erdhi Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ndërsa ne ishim shtrirë për të fjetur. U ul mes nesh, derisa ndjeva

[127] Buhariu, 1491. Muslimi, 1069.

freskinë e këmbëve të tij mbi gjoksin tim. Pastaj tha: *"A t'ju mësoj diçka që është më e mirë për ju se sa një shërbyes? Kur të shtriheni për të fjetur, thoni: Allahu Ekber 34 herë, SubhanaAllah 33 herë, Elhamdulilah 33 herë. Kjo është më mirë për ju se një shërbyes."*[128] Pastaj shtoi: *"Për Zotin, unë nuk do t'ju jap një shërbyes dhe të lë njerëzit e strehimores - që u janë mbledhur barqet nga uria - pa ndihmë. Unë do t'i shes ata dhe me çmimin e tyre do t'u blej ushqim njerëzve të strehimores."*[129]

I Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) prind u mëson, i sqaron dhe i bind. Kjo pasuri është pasuri publike për nevojat e muslimanëve. Të varfrit muslimanë që jetojnë në strehimore kanë më tepër nevojë. Këtë edhe ua bën të ditur edhe i bind me qëllim që informacioni bashkë me bindjen të kalojnë te fëmijët, duke ju dhënë kështu edhe mësimin edhe edukimin.

Së shtati: Nga përkujdesja dhe dashuria e plotë profetike për bijat e tij ishte edhe përkujtimi i vazhdueshëm me këshillë të mençur dhe thirrje të bukur për vepra të mira. Ndër këto qëndron thirrja e tij e qartë, para të gjithëve, drejtuar vajzës së tij, Fatimes: *"Oj Fatime, bija e Muhamedit! Shpëtoje vetveten prej zjarrit! Oj Fatime, bija e Muhamedit! Kërko prej pasurisë sime ç'të duash, por unë nuk të vlej asgjë para Allahut!"*[130]

E sa shumë përmban kjo thirrje nga dhimbja e dashurisë, nga shqetësimi i dhembshurisë dhe nga zjarrmia e këshillës!

Ndër shembujt e kësaj përkujdesjeje është edhe interesimi i tij për faljen e natës për vajzat e tij dhe nxitja e tyre për të. Transmeton Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* se Profeti (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) erdhi tek ai dhe Fatimja natën dhe thirri: *"A nuk faleni ju të dy?"*

I thashë: "O i Dërguar i Allahut, shpirtrat tanë janë në dorën e Allahut, kur të dojë Ai, na zgjon."

Atëherë i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u largua kur i thashë këtë dhe nuk më ktheu përgjigje. Pastaj dëgjova atë teksa largohej duke rënë lehtë me dorë në kofshën e tij

[128] Buhariu, 3705. Muslimi, 2727.
[129] Ahmedi, "*Musned*", 838.
[130] Muslimi, 206.

dhe duke recituar: ***"Por njeriu kundërshton më tepër se çdo krijesë tjetër."*** (El-Kehf: 54)

Këtu vërejmë butësinë në këshillë: ajo erdhi si ftesë e dashur dhe nxitje, jo si urdhër i drejtpërdrejtë: *"A nuk faleni ju të dy?"* Pastaj vërejmë edhe mos përsëritjen këmbëngulëse, ngaqë merret parasysh gjendja e të rinjve - siç ishin Aliu dhe Fatimja - dhe kjo është nga mençuria në thirrje dhe bukuria në këshillim.

Së teti: Vetëdija e bijve dhe bijave të tij u formësua në duart e babait më fisnik dhe mësuesit më të madh, ndaj ata mësuan prej tij dhe kuptuan thellësisht mësimet e tij. Sot, i gjithë Umeti e bën Duanë e Kunutit gjatë faljes me fjalët që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ia mësoi nipit të tij, Hasanit, kur ishte ende fëmijë:

"O Allah, më udhëzo me ata që Ti i ke udhëzuar, më jep shëndet me ata që Ti i ke dhënë shëndet, me merr nën kujdesin Tënd me ata që Ti i ke marrë nën kujdesin Tënd, më beko në atë që më ke dhënë, dhe më ruaj nga e keqja e asaj që ke caktuar. Vërtet, Ti je Ai që cakton dhe askush nuk mund të caktojë përveç Teje. Nuk poshtërohet ai që Ti e mbron, i madhëruar je Ti, o Zoti ynë, dhe i Lartësuar."[131]

Gjithashtu, Umeti ruan një hadith që është prej fjalëve më përmbledhëse dhe bazë e sjelljes së mirë - një mësim që Profeti (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ia mësoi Hasanit kur ishte fëmijë. Hasan ibn Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* ka thënë:

"E kam mësuar nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)**:** *"Lëre atë që të ngjall dyshim, dhe vepro atë që nuk të ngjall dyshim."*[132]

Vëre fjalët e Hasanit: "E kam mësuar nga i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)"* - nga kjo kuptojmë përkushtimin e të Dërguarit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për ta mësuar atë dhe për të siguruar që ai ta mbante mend këtë fjalë të përmbledhur.

Po ashtu, i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i bënte *dua* mbrojtëse Hasanit dhe Husejnit *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* me fjalët: *"Ju mbroj me fjalët e plota të Allahut nga çdo shejtan*

[131] Ebu Daudi, 1425.
[132] Tirmidhiu, 2518.

dhe çdo pickues helmues dhe nga çdo sy i keq që dëmton." Pastaj shton: *"Babai juaj* (Ibrahimi) *i mbrojti me këto fjalë Ismailin dhe Is'hakun."*[133]

Këto fjalë madhështore që Pejgamberi ia thoshte bijve të tij nuk ishin vetëm mbrojtje dhe përmendje, por edhe edukim dhe mësim - që e lidhin fëmijën me madhërimin e Allahut, me kërkimin e strehimit tek Ai dhe me mbështetjen në fuqinë dhe mbrojtjen e Tij. Ai u mësonte atyre që të vegjël ato që do t'i përdorin për t'u mbrojtur kur të rriten.

Pastaj shiko edhe mënyrën si u flet atyre: Ai u tregon se babai i tyre Ibrahimi (*paqja qoftë mbi të)* e bënte këtë mbrojtje *dua* për babanë e tyre, Ismailin, dhe për xhaxhain e tyre, Is'hakun - paqja qoftë mbi ta.

Kjo është një lidhje shpirtërore e thellë që u ngjall ndjenjat dhe i lidh zemrat e tyre të vogla me pejgamberinë dhe me mesazhet e profetëve të mëhershëm, aq sa e kupton mendja e tyre dhe e madhëron shpirti i tyre.

Hasani e Husejni *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* mësuan këto dhe të tjera nga i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur ishin vetëm shtatë dhe gjashtë vjeç në maksimum, që ishte mosha e tyre në momentin kur ndërroi jetë i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Atëherë, çfarë kanë mësuar Fatimja, Zejnebi, Rukaja dhe Umu Kulthumi *(Allahu qoftë i kënaqur me to)* gjatë gjithë atyre viteve të gjata që kaluan me babanë e tyre të dashur (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)?

Së nënti: Nga shfaqjet e atësisë profetike është edhe kujdesi i veçantë për vajzat, nderimi i tyre dhe dhurimi i dashurisë në mënyrë të pakursyer, si dhe shembja e perceptimit injorant të kohës së mëparshme, që anonte tërësisht kah djemtë, ndërsa për vajzat ndienin fatkeqësi dhe përçmim, saqë fati i tyre luhatej mes varrosjes fizike dhe asaj shpirtërore: ***"A ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit apo ta varrosë në dhé."*** (En-Nahl: 59)

E me të tillë realitet, Pejgamberi fisnik (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) shpalos dashurinë për vajzat dhe kujdesin ndaj tyre, saqë njëherë mbajti hytbe në *minber* dhe tha: *"Me të vërtetë*

[133] Buhariu, 3371.

Fatimja është një pjesë e imja; mua më lëndon çfarë e lëndon atë, dhe më zemëron çfarë e zemëron atë!" **-** Është kjo një shpallje e ndjenjës atësore, shfaqje dhe publikim i saj.

Madje, një herë habiti shokët e vet me një pamje të çuditshme: doli për të falur namazin e ikindisë dhe në supe mbante mbesën e tij, Umamen, vajzën e Zejnebes. Pastaj u fal me njerëzit dhe atë e kishte në krahët e tij, ndërkohë sa herë që bënte ruku e zbriste dhe sa herë që ngrihej në këmbë, e merrte përsëri mbi supe.[134]

Vlerësimi i femrës në këtë skenë është i dyfishtë: ajo është bija e bijës së tij. Dhe ja ku del ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me mbesën mbi supe para njerëzve, për të dhënë një mësim praktik mbi kujdesin e veçantë ndaj vajzave dhe për të zhdukur mbetjet e injorancës së mëparshme nga zemrat, ku vajza shihej si një turp:

*"**Dhe kur ndonjëri prej tyre merr lajmin se i lindi një vajzë, fytyra i nxihet dhe i mbushet me mjerim. Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq që mori dhe s'di: a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit apo ta varrosë në dhé. Ah! Sa mbrapsht që gjykojnë ata!**"* (En-Nahl: 58-59)

Sa e madhe është distanca ndërmjet atij që fshihet nga njerëzit, sepse i kanë dhënë lajmin e lindjes së një vajze - dhe atij që del para njerëzve me vajzën në supet e tij!

Së dhjeti: Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) iu dhurua një varëse me një lloj guri të zi me vija të bardha, ai tha: *"Do t'ia jap njeriut më të dashur për mua nga familja ime..."*[135] dhe thirri Umamen, vajzën e vajzës së tij, Zejnebes, dhe ia vari atë në qafë.

Ky trajtim i veçantë për djemtë dhe vajzat e bijave të tij është një shenjë e dashurisë dhe mirësisë së dyfishtë ndaj bijave dhe një lumturim për zemrat e tyre. Sa e madhe duhet të ketë qenë ndjenja e bijës së tij, Zejnebes *(Allahu qoftë i kënaqur me të),* duke parë vajzën e saj mbi supet e babait të saj duke dalë për të shkuar me të në xhami! Cila duhet të ketë qenë ndjenja e saj duke parë vajzën e saj në duart e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe të dëgjojë

[134] Buhariu, 516. Muslimi, 543.
[135] Ahmedi, "*Musned*", 24704.

fjalët e tij duke thënë: *"Njeriut më të dashur për mua nga familja ime"* dhe ai vetë ia vendoste varësen në qafë?!

Ishte mjeshtëria e Pejgamberi të nderuar në shpërthimin e burimeve të lumturisë në zemrat e njerëzve.

Së njëmbëdhjeti: Ashtu siç e jetoi Pejgamberi ynë (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) begatinë e atësisë dhe madhështinë e dashurisë, gjithashtu, ai e përjetoi dhimbjen e humbjes dhe pikëllimin e ndarjes. Fëmijët e tij, djem dhe vajza, ndërruan jetë para tij, dhe ky pikëllim u përsërit disa herë përgjatë viteve të jetës së tij. Ai u pikëllua në vitet e para të shpalljes nga vdekja e të birit të tij të parë, Kasimit, dhe u pikëllua në vitin e fundit të jetës nga vdekja e djalit të tij të vogël të fundit, Ibrahimit. Ndërmjet këtyre dy ngjarjeve, pikëllimet për djemtë dhe vajzat e tij u shpërndanë në vite të ndryshme të jetës së tij.

Kur Zejnebja ndërroi jetë, i tha grave që po e lanin: *"Kur të mbaroni, më njoftoni."* Kur mbaruan, ai ju dha rrobën e tij dhe tha: *"Mbështilleni me të."*[136]

Ndërsa kur u varros vajza e tij, Rukija *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, ai ishte ulur buzë varrit dhe lotët i rridhnin nga sytë.[137]

Djali i tij, Ibrahimi, ishte në moshën e dashurisë dhe afeksionit - një vjeç e gjysmë - kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hyri tek ai dhe pa se po jepte frymën e fundit, dhe tha: *"O Ibrahim! Ne nuk kemi në dorë asgjë për ty para Allahut. Sikur të mos ishte kjo një çështje e caktuar dhe një premtim i vërtetë, do të pikëlloheshim për ty edhe më shumë se kaq. Por syri loton, zemra pikëllohet dhe nuk themi veçse atë që kënaq Zotin tonë. Dhe me të vërtetë, për ndarjen tënde, o Ibrahim, jemi të pikëlluar."*[138]

Madje, edhe për vajzën e fundit që mbeti gjallë pas tij nga fëmijët e tij - Fatimja, *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* - Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u njoftua para vdekjes së tij se ajo do të ishte e para nga të afërmit e tij që do t'i bashkohej.[139]

---

[136] Buhariu, 1253. Muslimi, 939.
[137] Buhariu, 1285.
[138] Buhariu, 1303. Muslimi, 2315.
[139] Buhariu, 3623. Muslimi, 2450.

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte durimtar në të gjitha pikëllimet e tij, i përulur para caktimit të Allahut dhe i bindur për shpërblimin e durimit në pikëllim, prandaj thoshte: *"Por syri loton, zemra pikëllohet, dhe nuk themi veçse atë që kënaq Zotin tonë. Dhe me të vërtetë, për ndarjen tënde, o Ibrahim, jemi të pikëlluar."*[140]

Ashtu siç i dha Umetit të tij, bukurinë e atësisë përmes dashurisë, mëshirës dhe butësisë në sjelljen me fëmijët e tij, po ashtu, i ofroi atyre edhe shembullin e durimit, përuljes dhe shembullin më të mirë në përballimin e humbjes dhe pikëllimit. Fakti që fëmijët e tij ndërruan jetë në kohën kur ai ishte ende gjallë dhe se pas tij nuk mbeti trashëgimi e drejtpërdrejtë prej tyre, ishte një urtësi hyjnore për të mbrojtur Umetin nga shenjtërimi ndaj Shtëpisë së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe pasardhësve të tij. Sepse, nëse teprimi ndodhi ndaj djalit të vajzës së tij dhe djalit të xhaxhait, çfarë do të ndodhte po të kishin jetuar djali i tij me pasardhësit e tij në mesin e Umetit?

I Dërguari dhe vëllezërit e tij, pejgamberë (paqja e Allahut qoftë mbi ta)

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u rrit në një popull analfabet, të mbushur me idhujtari, të shkëputur plotësisht nga pejgamberët që erdhën te pasardhësit e Jakubit, alejhi selam. Lidhja e tyre me shpalljen ishte shumë e hershme në historinë e largët të profetësisë së Ibrahimit dhe Ismailit (*paqja qoftë mbi ta*) e cila, tashmë, kishte humbur gjurmët e saj, duke u shndërruar prej një Islami të drejtë në një paganizëm injorant.

Dhe ja, ky pejgamber analfabet tani flet atë që i është shpallur nga Kurani dhe atë që i është shpallur nga Urtësia, flet për karvanin e bekuar të pejgamberëve të Allahut dhe të dërguarve të Tij. Ai i kujton popullit të tij thirrjen e tyre, tregimet e tyre me popujt, përshkrimet e tyre, pamjen e tyre dhe çfarë ndodhi me ta.

[140] Buhariu, 1303. Muslimi, 2315.

Po si i njohu ai këto gjëra, ndërkohë që ai ishte analfabet në një shoqëri të zhytur në injorancë!? Ai i mësoi përmes shpalljes që i shpalli Zoti i tij, i Cili i kishte dërguar edhe ata, e pastaj e dërgoi edhe Atë si vulën e tyre?

Sepse, përmendja e detajuar që ai bëri për pejgamberët dhe historitë e tyre është një nga provat e pejgamberisë së tij, sepse nuk ka burim tjetër për këtë dije përveç shpalljes hyjnore.

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i përmendi pejgamberët para tij me dashuri, nderim dhe vlerësim për thirrjen dhe misionin e tyre dhe i përshkroi ata me cilësitë më të mira dhe pamjen më të hijshme. Sa dallim të madh ka mes përshkrimit të Kuranit dhe haditheve të Sunetit për pejgamberët e ndershëm dhe përshkrimit të tyre në librat e shtrembëruar të ithtarëve të librit, të cilat i përshkruajnë ata me gjëra të shëmtuara dhe i shpifin për mëkate të rënda.

Ndërsa Pejgamberi ynë (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), marrëdhënia e tij me vëllezërit e tij prej pejgamberëve dhe të dërguarve të Allahut që e kanë paraprirë, pavarësisht largësisë së kohërave dhe ndarjes së vendeve të tyre, ishte marrëdhënie vëllazërie, pasimi dhe ndjekjeje shembulli, siç ka thënë ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*): "*Pejgamberët janë vëllezër, nënat e tyre janë të ndryshme, por feja e tyre është një.*"[141]

Prandaj ai i përmendte ata me fjalën "vëllezër" dhe thoshte: "*Allahu e mëshiroftë vëllain tim, Musanë!*"[142]

Edhe ata e pritën atë me fjalën e vëllazërisë gjatë udhëtimit të *Isra*'së dhe *Miraxhit*, kur i uronin mirëseardhjen: "*Mirë se erdhe, o Pejgamber i ndershëm! Mirë se erdhe, o vëlla i ndershëm!*"[143]

Sepse ata janë vëllezër në Islam dhe vëllezër në pejgamberësi.

Vëllazëria e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me pejgamberët dhe të dërguarit para tij shfaqet në disa aspekte:

[141] Buhariu, 3443.
[142] Buhariu, 3425. Muslimi, 1062.
[143] Buhariu, 3430.

Së pari: Përmendja e virtyteve dhe cilësive të tyre të lavdërueshme

1. Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka përmendur në hadithet e tij virtytet e tyre, moralin e tyre të lartë, adhurimin dhe madhërimin që kishin për Zotin e tyre. Ai e përmendi virtytin e Jusufit (*paqja qoftë mbi të*) përmes vazhdimësisë së profecisë në etërit e tij njëri pas tjetrit, kur u pyet: "O i Dërguar i Allahut, kush janë njerëzit më fisnikë?" Ai u përgjigj: *"Më të devotshmit."* I thanë: "Nuk po të pyesim për këtë." Ai Tha: *"Atëherë* (është) *Jusufi, Pejgamberi i Allahut, biri i Pejgamberit të Allahut, biri i Pejgamberit të Allahut, biri i të dashurit të Allahut* (Ibrahimit)." I thanë: "Nuk po të pyesim për këtë." Ai tha: *"A po më pyesni për fisnikërinë ndër arabë? Më të mirët prej tyre në kohën e injorancës, janë më të mirët prej tyre në Islam, nëse janë të mençur."*[144]

2. Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përmendi turpin dhe ndrojtjen e Musait *(paqja qoftë mbi të)* dhe mbulimin e tij, duke e përshkruar: *"Musai ishte njeri shumë i turpshëm dhe i mbuluar; nuk i dukej asgjë nga trupi për shkak të turpit të tij. Disa nga Beni Israilët e ofenduan dhe thanë: "Ai mbulohet kështu vetëm sepse ka ndonjë të metë në trup: Ose është me lebrozë, ose ka ënjtje në testikuj, ose ndonjë sëmundje tjetër." Atëherë Allahu deshi ta pastrojë Musain nga ajo që ata thanë për të. Një ditë, u largua vetëm, hoqi rrobat dhe i vendosi mbi një gur, pastaj u la. Kur e mbaroi larjen dhe u kthye të merrte rrobat, guri ia kishte marrë rrobat dhe po largohej me to. Musai mori shkopin dhe ndoqi gurin duke thënë: "Rrobat e mia, o gur! Rrobat e mia, o gur!" Derisa arriti te një grup nga Beni Israilët dhe ata e panë të zhveshur dhe panë se ishte krijuar në mënyrën më të mirë që Allahu ka krijuar, dhe kështu Allahu e pastroi nga çfarë ata kishin thënë. Guri u ndal, Musai i mori rrobat, u vesh dhe filloi të godiste gurin me shkopin e tij. Betohem në Allah, se në gur mbetën gjurmë nga goditjet - tri, katër apo pesë. Dhe ky është kuptimi i fjalës së Allahut:* ***"O besimtarë, mos u bëni si ata, që e shqetësuan Musain. Allahu e çliroi atë nga përgojimet e tyre; ai është i nderuar në sytë e Allahut."*** (El-Ahzab: 69)

[144] Buhariu, 3353. Muslimi, 2378.

Së dyti: Përmendja e tregimeve dhe lajmeve të tyre

I Dërguari i Allahut tregoi për ta rrëfime të detajuara që të japin ndjesinë e afërsisë me ta dhe njohjes së hollësishme të gjendjeve të tyre - sikur të jetonin me të në të njëjtin vend - ndonëse kohët e tyre ishin shumë të largëta, vendet e tyre të shpërndara dhe popujt e tyre të ndryshëm. Ndër këto janë:

1. I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përmendi tregimin e shkuarjes së Ibrahimit *(paqja qoftë mbi të)* me Haxheren në Egjipt, dhe tha:

"Një herë Ibrahimi bashkë me Sarën, shkuan te një tiran nga tiranët. Njerëzit i thanë tiranit: "Këtu ndodhet një burrë me një grua nga më të bukurat e grave." Ai dërgoi dikë ta thërrasë dhe e pyeti për të: "Kush është kjo?" Ibrahimi tha: "Motra ime." Pastaj u kthye te Sara dhe i tha: "Oj Sara! Nuk ka mbi faqen e dheut tjetër besimtar përveç meje dhe teje. Ky më pyeti për ty dhe i tregova se je motra ime, prandaj mos më përgënjeshtro." Tirani thirri Sarën dhe, kur ajo hyri te ai, ai zgjati dorën ta kapte me dorë, por dora iu ngri. Ai tha: "Lutu Allahut për mua dhe unë nuk do të të bëj keq." Ajo iu lut Allahut për të dhe dora iu lirua. Pastaj ai zgjati dorën përsëri ta kapte me dorë, por dora iu ngri për herë të dytë, si herën e parë, madje edhe më rëndë. Pastaj ai tha: "Lutu Allahut për mua dhe nuk do të të bëj keq." Ajo iu lut Allahut për të dhe dora iu lirua. Pastaj ai thirri disa nga rojet e tij dhe u tha: "Ju nuk më keni sjellë një njeri, por një djall!" - dhe i dhuroi Haxheren t'i shërbejë.

Sara u kthye tek Ibrahimi ndërkohë që ai ishte në këmbë duke u falur dhe ai i bëri me dorë: "Ç'ndodhi?" Ajo tha: "Allahu e ktheu dredhinë e femohuesit - ose njeriut të prishur - kundër tij dhe më dhuroi Haxheren." Ebu Hurejra *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: *"Kjo është nëna juaj, o bij të ujit të qiellit."* [145]

Gjithashtu, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tregoi rrëfimin e ardhjes së Ibrahimit me Ismailin dhe nënën e tij *(paqja qoftë mbi ta)* në Mekë dhe se si i la atje me urdhër të Allahut, pastaj i vizitonte herë pas here, si dhe tregimin e ndërtimit të Qabesë - në një përshkrim të gjatë dhe të detajuar, aq sa të duket sikur po e sheh ngjarjen me sytë tu.

[145] Buhariu, 3357. Muslimi, 2371.

2. I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përmendi, gjithashtu, rrëfime dhe lajme për Musain *(paqja qoftë mbi të)*. Transmetohet se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), kur kaloi në Luginën *El Ezrek*, pyeti: *"Cila luginë është kjo?"* Njerëzit i thanë: "Kjo është Lugina El Ezrek." Ai Tha: *"Sikur po e shoh Musain (paqja qoftë mbi të) duke zbritur nga shpati, me gishtat e tij në veshë, duke iu drejtuar Allahut me Telbije!"*[146]

Ebu Hurejre tregon se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka thënë: *"Ademi dhe Musai diskutuan me njëritjetrin. Musai i tha atij: "Ti je Ademi, që mëkati yt të nxori nga Xheneti." Ademi iu përgjigj: "Ti je Musai, të cilin Allahu e zgjodhi me shpalljet e Tij dhe me fjalën e Tij, e megjithatë më qorton mua për diçka që ishte caktuar për mua para se unë të krijohesha?!"* Pastaj i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: *"Dhe kështu Ademi e mundi Musain. Ademi e mundi Musain."*[147]

3. I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përmendi mençurinë e Sulejmanit *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* për gjykimin e tij.

Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka thënë: *"Dy gra kishin me vete djemtë e tyre. Erdhi ujku dhe mori djalin e njërës prej tyre. Ajo i tha shoqes së saj: "Ujku mori djalin tënd!" Ndërsa tjetra tha: "Jo, ujku mori djalin tënd!" Pastaj ato iu drejtuan për gjykim Davudit (paqja qoftë mbi të), dhe ai gjykoi në favor të më të madhes prej tyre. Pastaj dolën te Sulejmani, biri i Davudit (paqja qoftë mbi ta), dhe ia treguan ngjarjen. Ai tha: "Më sillni një thikë, që ta ndaj djalin përgjysmë mes tyre!" Atëherë gruaja më e vogël tha: "Mos e bëj, Allahu të mëshiroftë! Ai është djali i saj." Atëherë Sulejmani gjykoi se djali i takonte asaj më të voglës."*[148]

4. I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përmendi ngjarjen e Pejgamberit të Allahut, Ejubit *(paqja qoftë mbi të)*, kur mbi të ra një tufë karkalecash prej ari:

"Ndërsa Ejubi po lahej lakuriq, mbi të ra një tufë karkalecash prej ari. Ai filloi t'i mblidhte ata në rrobën e tij. Atëherë Zoti i tij e thirri: "O

[146] Muslimi, 166.
[147] Buhariu, 3409. Muslimi, 2652
[148] Buhariu, 6797. Muslimi, 1720.

Ejub, a nuk të kam pasuruar nga ajo që po sheh?' Ai u përgjigj: "Po, pasha Madhërinë Tënde! Por unë nuk kam të ngopur nga begatia Jote."

5. I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përmendi, gjithashtu, lajmet për Zekerijan, Jahjan dhe Isain *(paqja qoftë mbi ta)*: "*Zekerija ishte marangoz*" - një tregues se ai ushqehej nga puna e duarve të veta.

Kurse për Isain *(paqja qoftë mbi të)* tha: "*Isai, biri i Merjemes, pa një burrë duke vjedhur, dhe i tha: 'A vodhe?' Ai u përgjigj: 'Jo, pasha Allahun, që nuk ka zot tjetër përveç Tij!' Atëherë Isai tha: "E besova Allahun dhe përgënjeshtrova syrin tim."*

Ky është një shembull i madhërimit për betimin në Allahun dhe një bindje ndaj atij që betohet në Allahun.

Këto lajme të detajuara nga i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për vëllezërit e tij pejgamberë, krahas asaj që iu shpall në Kuran për historitë e tyre, tregojnë se sa të pranishme ishin pejgamberia dhe pejgamberët në jetën e tij dhe përmendja e historive të tyre. Ai i përmendte ngjarjet e tyre për të nxjerrë mësime dhe për të ndjekur shembullin e tyre. Kjo, gjithashtu, tregon për pozitën e tyre të lartë, sepse çdo përmendje që ua bënte (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte në kontekstin e nderimit dhe respektit.

Së treti: Takimi me pejgamberët gjatë natës së Israsë dhe Miraxhit

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përmendi takimin e tij me pejgamberët gjatë udhëtimit të Israsë në xhaminë Aksa dhe në qiejt e lartë. Ja, pra, i Dërguari fisnik (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), të cilit i është shpallur nga Allahu rrëfimi për ta dhe lajmet e tyre, i takon ata me trup dhe me shpirt në një mënyrë të padukshme për ne të cilën ne besojmë, por nuk e dimë realitetin e saj.

1. Enes ibn Maliku tregon se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka thënë: "*Kalova pranë Musait natën e Israsë, pranë kodrës së kuqe, dhe ai ishte duke u falur në varrin e tij.*"[149]

[149] Muslimi, 2375.

2. Ibn Abasi thotë: "Kur Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) hyri në xhaminë Aksa, filloi të falet. Kur u kthye, pa të gjithë pejgamberët duke u falur bashkë pas tij."[150]

3. Enes ibn Maliku transmeton nga Malik ibn Sea'sea se Pejgamberi i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u kishte treguar për natën e Israsë: *"Xhibrili më mori mua derisa arriti në qiellin e parë. Aty gjetëm Ademin! Xhibrili më tha: "Ky është babai yt, Ademi. Jepi selam!" Unë i dhashë selam, ai ma ktheu selamin dhe më uroi: "Mirë se vjen biri i mirë dhe Pejgamberi i mirë." Pastaj Xhibrili më mori derisa arritëm në qiellin e dytë. Aty gjetëm Jahjanë dhe Isain - të dy djem teze - Xhibrili më tha: "Këta janë Jahja dhe Isai, jepu selam!" Unë ju dhashë selam, ata ma kthyen selamin dhe më uruan: "Mirë se vjen vëllai i mirë dhe Pejgamberi i mirë." Pastaj Xhibrili më mori derisa arritëm në qiellin e tretë. Aty gjetëm Jusufin. Xhibrili më tha: "Ky është Jusufi, jepi selam!" Unë i dhashë selam, ai ma ktheu selamin dhe më uroi: "Mirë se vjen vëllai i mirë dhe Pejgamberi i mirë." Pastaj Xhibrili më mori derisa arritëm në qiellin e katërt. Aty gjetëm Idrisin. Xhibrili më tha: "Ky është Idrisi, jepi selam!" Unë i dhashë selam, ai ma ktheu selamin dhe më uroi: "Mirë se vjen vëllai i mirë dhe Pejgamberi i mirë." Pastaj Xhibrili më mori derisa arritëm në qiellin e pestë. Aty gjetëm Harunin. Xhibrili më tha: "Ky është Haruni, jepi selam!" Unë i dhashë selam, ai ma ktheu selamin dhe më uroi: "Mirë se vjen vëllai i mirë dhe Pejgamberi i mirë." Pastaj Xhibrili më mori derisa arritëm në qiellin e gjashtë. Aty gjetëm Musain. Xhibrili më tha: "Ky është Musai, jepi selam!" Unë i dhashë selam, ai ma ktheu selamin dhe më uroi: "Mirë se vjen vëllai i mirë dhe Pejgamberi i mirë." Kur kalova, ai filloi të qajë. Dikush e pyeti: "Pse po qan?" Ai u përgjigj: "Po qaj, sepse një djalosh u dërgua pas meje dhe do të hyjnë në Xhenet nga Umeti i tij më shumë sesa nga Umeti im." Pastaj Xhibrili më mori derisa arritëm në qiellin e shtatë. Aty gjetëm Ibrahimin. Xhibrili më tha: "Ky është babai yt, jepi selam." Unë i dhashë selam, ai ma ktheu selamin dhe më uroi: "Mirë se vjen biri i mirë dhe Pejgamberi i mirë."*[151]

Ky takim tregon lidhjen e fortë mes tyre, pajtueshmërinë e mesazhit të tyre dhe dëshminë e njërit për tjetrin. Prandaj, besimi në të gjithë pejgamberët është nga shtyllat e besimit: ***"Besimtarët:***

[150] Ahmedi, "*Musned*", 2324.
[151] Buhariu, 3887. Muslimi, 162.

të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij *(duke thënë):* ***"Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij."*** (El-Bekare: 285)

Së katërti: Përmendja e cilësive dhe pamjes së tyre sikur po i shihte para syve

I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i përshkroi pamjen dhe tiparet fizike të pejgamberëve sikur t'i kishte parë dhe jetuar me ta. Përshkrimi i pamjes së bukur dhe në hollësi është ndër shenjat e dashurisë dhe afërsisë, andaj përshkrimi i tij për ta ishte në formën më të përkryer të cilësive të tyre. Pejgamberët dhe të dërguarit e Allahut kishin pamje të bukur dhe asnjëri prej tyre nuk kishte mangësi fizike apo ndonjë të metë fizike. Ibn Haxheri thotë: "Pejgamberët, në paraqitje dhe në moral, ishin në shkallën më të lartë të përsosmërisë dhe kushdo që ia mvesh ndonjë pejgamberi një mangësi fizike, e ka fyer atë dhe rrezikon të bëj kufr."[152]

Përshkrimi që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) bëri për përsosmërinë fizike të tyre - e cila është ena e përsosmërive të tyre morale dhe shkencore - ishte i tillë sikur t'i kishim përpara syve tanë, siç përshkroi Ibrahimin, Musain dhe Isain *(paqja qoftë mbi ta)* sikur t'i kishim përpara syve tanë.

Nga Xhabiri transmetohet se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka thënë: "*Mu paraqitën pejgamberët dhe pashë Musain: ishte burrë shtatlartë, sikur të ishte një nga burrat e Shenua-s*[153]*. E pashë Isain, birin e Merjemes (paqja qoftë mbi të) dhe njeriu që më së shumti i ngjante atij ishte Urve ibn Mes'udi. E pashë Ibrahimin (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe njeriu që më së shumti i ngjante atij është shoku juaj* (pra, po i referohej vetes së tij). *E pashë Xhibrilin (paqja qoftë mbi të) dhe më së shumti i ngjante Dehja ibn Halifes.*"[154]

---

[152] "*Fet'h el Bari*", 6/438.

[153] Shenua është lagje në Jemen, ky është emri i Abdullahbin Keab bin Malik bin Nasr bin el Ezed. El Davudi thotë se burrat e këtij fisi janë të njohur për gjatësinë e tyre. "*Fet'h el Bari*", 6/429.

[154] Muslimi, 167.

Së pesti: Ndjekja e shembullit të tyre

I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ndiqte shembullin e pejgamberëve dhe të dërguarve të Allahut në mënyrën e transmetimit të shpalljes hyjnore, në durimin dhe udhëzimin e tyre. Kjo ishte porosi e drejtpërdrejtë prej Allahut: ***"Këta janë ata, të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, andaj edhe ti*** (o Muhamed) ***ndiq rrugën e tyre."*** (El-En'am: 90)

Ja disa shembuj:

1. Abdullah ibn Mes'udi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë se një herë Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) po u ndante pasurinë njerëzve, një burrë tha: "Kjo është një ndarje që nuk është bërë për hir të Allahut!" Unë ia tregova Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe ai u zemërua aq shumë saqë ia pashë zemërimin në fytyrë. Ai tha: "*Allahu e mëshiroftë vëllain tim, Musanë! Ai është lënduar edhe më shumë se kaq, dhe ka duruar!*"[155]

Kjo për shkak se Musai *(paqja qoftë mbi të)* i trajtoi bijtë e Israilit me përpjekje shumë të mëdha; ai duroi kokëfortësinë dhe lëndimet e tyre, dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ngushëllohej me shembullin e tij dhe e merrte atë si model në durim.

2. Abdullah ibn Amri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: Një herë i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) më tha: "*Agjërimi më i dashur për Allahun është agjërimi i Davudit, ai agjëronte një ditë po dhe një ditë jo. Dhe namazi më i dashur për Allahun është namazi i Davudit, ai flinte gjysmën e natës, falej një të tretën, pastaj flinte një të gjashtën.*"[156]

Kjo ishte zakonisht mënyra e faljes së natës për të Dërguarin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), ashtu siç e përshkruan Aishja. Ajo tregon se ai ngrihej dhe falej pas gjysmës së natës, pastaj flinte para sabahut dhe agimi e zinte gjithmonë duke qenë në gjumë. Pra, ishte shumë afër mënyrës së faljes së natës të Davudit *(paqja qoftë mbi të)*.

---

[155] Buhariu, 6336. Muslimi, 1062.
[156] Buhariu, 3420. Muslimi, 1062.

Së gjashti: Respektimi i tyre dhe ruajtja e pozitës e vendit të tyre

1. Nga Ebu Hurejra transmetohet se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka thënë: *"Ne jemi më të denjë për të dyshuar sesa Ibrahimi* ***"Kur Ibrahimi tha: "O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!" - Zoti i tha: "A nuk beson?" - "Besoj" - iu përgjigj Ibrahimi, "por dëshiroj të më qetësohet zemra."*** - (El-Bekare: 260) *Allahu e mëshiroftë Lutin! Ai me të vërtetë kishte një mbështetje të fortë. - E, sikur të qëndroja në burg sa qëndroi Jusufi, do t'i përgjigjesha thirrësit."*[157]

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e tha këtë nga përulësia dhe përulësia nuk e ul pozitën e të madhit, përkundrazi, ia shton madhështinë dhe lavdinë.[158]

2. Ebu Hurejra *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se një çifut po shiste mallin e tij, dikush i ofroi një çmim, por ai nuk i pëlqeu, dhe tha: *"Jo, pasha Atë që e zgjodhi Musain mbi njerëzit!"* Një burrë nga ensarët e dëgjoi dhe u ngrit, e goditi në fytyrë dhe i tha: *"Ti thua: 'Pasha Atë që e zgjodhi Musain mbi njerëzit', ndërkohë që i Dërguari (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është mes nesh?!"* Çifuti shkoi te i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe i tha: *"O Baba i Kasimit! Unë jam në besën dhe në mbrojtjen tuaj. Si është puna që filani më goditi në fytyrë?"* Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: *"Pse e godite në fytyrë?"* Ai ia tregoi ngjarjen. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u zemërua aq shumë sa u pa qartë në fytyrën e tij, pastaj tha: *"Mos bëni dallime midis Pejgamberëve të Allahut. Pasi kur të fryhet në Sur, do të vdesë kush është në qiej dhe në tokë, përveç atyre që do Allahu. Pastaj do të fryhet përsëri, dhe unë do të jem i pari që do të ringjallet. Dhe kur të ringjallem, do ta gjej Musain të kapur për Arshin e Allahut, dhe nuk e di nëse ai është goditur në momentin e parë në malin Tur* (në këtë botë)*, apo është ringjallur para meje."*[159]

3. Nga Abdullah bin Mes'udit *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi*

[157] Buhariu, 3372. Muslimi, 151.
[158] *"Fet'hu el Bari"*, 6/413.
[159] Buhariu, 3414. Muslimi, 2373

të) ka thënë: *"Askush prej jush të mos thotë për mua: se unë jam më i mirë se Junusi, biri i Metës!"*

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e tha këtë nga përulësia e tij, sepse dallimi i shprehur në mënyrë të caktuar mund të nënkuptojë uljen e tjetrit. Megjithatë, Allahu ka thënë: ***"Nga këta të dërguar, disa syresh i ngritëm mbi të tjerët. Disave Allahu u foli drejtpërdrejt, kurse të tjerë i ngriti në shkallë të larta."*** (El-Bekare: 253)

Gjithashtu, i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka treguar se ai është ***"Zotëria i bijve të Ademit"***, por ai e ka përmendur këtë pozitë në mënyrë të përgjithshme, pa përmendur ndonjë pejgamber tjetër me emër për krahasim - nga nderimi për ta dhe për ruajtjen e pozitës së tyre.[160]

Së shtati: Vëllazëria dhe dashuria për ta

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e ka bërë pejgemberinë një lidhje të përbashkët vëllazërore mes të gjithë pejgamberëve, edhe pse kombet e tyre kanë qenë të ndryshme dhe kohët e tyre të largëta.

1. Nga Ebu Hurejra transmetohet se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka thënë: *"Unë jam njeriu më pranë Isait, birit të Merjemes, në këtë botë dhe në botën tjetër. Pejgamberët janë vëllezër; nënat e tyre janë të ndryshme, por feja e tyre është një."*[161]

2. Po ashtu, Ebu Hurejra tregon se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka thënë: *"Unë shpresoj që, nëse më zgjatet jeta, të takoj Isain, birin e Merjemes. Por nëse më arrin vdekja para se ta takoj, atëherë kushdo prej jush që e takon, le t'i përcjellë prej meje selam."*[162]

[160] Buhariu, 3412.
[161] Buhariu, 3443.
[162] Ahmedi, "*Musned*", 7970.

I Dërguari si shok

Jeta e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte e rrethuar nga shokë të nderuar, si para shpalljes së pejgamberisë ashtu edhe pas saj. Pas *Hixhretit*, atë e rrethonte shoqëria e shokëve të tij nga radhët e Muhaxhirëve dhe ensarëve. Edhe pse shoqëria e tij ishte e gjerë dhe e pasur, ne do të ndalemi te modeli më i ndritshëm dhe te grada më e lartë e saj, për të parë shoqërinë në formën më të bukur dhe më të plotë, më të sinqertën, më të ndershmen, më besniken dhe më të përsosurën - ajo është shoqëria ndërmjet Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe shokut të tij, Ebu Bekr Es-Sidikut *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*.

Ebu Bekri ishte shok i vërtetë, shok i ngushtë dhe, gjithashtu, mik *(babai i gruas së tij)*. Kjo shoqëri kishte tiparet e saj të qarta në jetën e tyre.

Disa nga këto tipare janë:

1. Afërsia në moshë ndërmjet tyre. Ebu Bekri ishte nga bashkëmoshatarët e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Ai ishte më i ri se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për rreth dy vjet e disa muaj. Afërsia në moshë zgjeron fushat e përbashkëta të preokupimeve, njohurive dhe rrethanave të jetës.

Ashtu siç kishte afërsi në moshë mes tyre, gjithashtu, kishte afërsi në virtyte dhe sjellje. Këtë e tregon edhe fakti që Ebu Bekri përshkruhej me të njëjtat cilësi me të cilat përshkruhej Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) para pejgamberisë. Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i tha Hatixhes, pas zbritjes së shpalljes në shpellën Hira: "*U frikësova për veten time*", ajo i tha: "Kurrsesi! Përgëzohu, se, për Allahun, Allahu kurrë nuk do të të poshtërojë. Pasha Allahun, ti i mban lidhjet me të afërmit, e flet të vërtetën, e ndihmon të dobëtin, i jep atij që nuk ka, e mikpret mikun dhe i ndihmon nevojtarët."[163]

[163] Buhariu, 3. Muslim, 160.

Po të njëjtën gjë tha edhe Ibnu el Dagine kur takoi Ebu Bekrin, kur u nis të emigronte për në Abisini. E takoi atë në vendin e quajtur Berku el Gamad dhe i tha: "Ku po shkon, o Ebu Bekr?" Ai i tha: "Më kanë përzënë njerëzit e mi dhe dua të endem në tokë duke adhuruar Zotin tim."

Ibnu el Degineh i tha: "Njerëz si ti, o Ebu Bekr, as nuk dalin vetë, as nuk duhen përzënë. Ti i jep atyre që nuk kanë, i ruan lidhjet me të afërmit, e ndihmon të dobëtin, e mikpret mikun dhe i ndihmon nevojtarët. Ti je në mbrojtjen time: kthehu dhe adhuroje Zotin tënd në vendin tënd!"[164]

Prandaj, shikoje përputhshmërinë e përshkrimit të moralit të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me atë të moralit të Ebu Bekrit *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*; këto ishin cilësitë e tyre të natyrshme që ata kishin që para Islamit.

2. Kjo shoqëri midis tyre ishte e hershme, para pejgamberisë dhe zbritjes së shpalljes, pastaj pas pejgamberisë kjo shoqëri u forcua dhe u thellua më tepër me përqafimin e hershëm të Islamit nga Ebu Bekri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Ai është i pari nga burrat që pranoi Islamin, pasi ai ishte njeriu që e njihte më mirë se askush tjetër Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), ai njihte jetën dhe sjelljen e tij gjatë fazave të ndryshme të jetës. Prandaj, ai nxitoi dhe i besoi menjëherë atij dhe mesazhit të tij. Ndaj, një nga dëshmitë e pejgamberisë së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është se i pari që i besoi është njeriu që e njihte më mirë se çdokush tjetër dhe ai është më i binduri ndaj tij dhe më i afërmi i tij.

3. Për shkak të kësaj lidhjeje të fortë dhe të afërt midis tyre, Ebu Bekri e njihte qëllimin e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe e kuptonte çfarë do të thoshte ai para se ta shprehte, si dhe e kuptonte çfarë nënkuptonte fjala e tij edhe nëse nuk e shpjegonte hapur. Këtë mund ta shohim në shumë raste. Për shembull, ditën e Hudejbijes, kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pranoi kushtet që vendosën kurejshët për paqen. Këto kushte në sytë e shumë sahabëve dukeshin të padrejta, saqë Umeri shkoi te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe i

[164] Buhariu, 2297.

tha: "O i Dërguari i Allahut, a nuk jemi ne në të drejtën?" Ai tha: *"Po!"* Umeri tha: "A nuk janë ata gabim?" Ai tha: *"Po!"* Umeri tha: "Atëherë, pse të pranojmë poshtërim në fenë tonë?" Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i tha: *"O Umer! Unë jam robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij dhe nuk bëj gjë tjetër veçse atë që më urdhëron Ai."* Umeri tha: "A nuk na the se do të hyjmë në Qaben e Shenjtë me flokë të rruar dhe të shkurtuar?!" Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i tha: *"O Umer! A të thashë se do të hysh këtë vit?"* Tha: "Jo!" Tha: *"Atëherë, ti do të hysh* (por jo këtë vit)*."*[165]

Umeri nuk duroi dhe shkoi te Ebu Bekri dhe e pyeti atë njësoj siç e kishte pyetur Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Përgjigjja e Ebu Bekrit ishte e njëjtë me atë të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), edhe pse ai nuk ishte i pranishëm kur Umeri e pyeti Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe nuk e kishte dëgjuar përgjigjen e tij.

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u ul në *minber* gjatë sëmundjes së vdekjes së tij dhe tha: *"Një rob u vu në zgjedhje nga Zoti i tij, midis jetës së kësaj bote - sa të donte prej saj - dhe asaj që është te Ai, dhe ai zgjodhi atë që është tek Ai."* Ebu Bekri ishte i vetmi që e kuptoi menjëherë aludimin e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe e mori mesazhin e tij se vetë Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte robi që ishte vënë në zgjedhje dhe se ai kishte zgjedhur takimin me Allahun dhe se momenti i ndarjes së tij nga jeta ishte afër. Ebu Bekri shpërtheu në lot dhe filloi të thotë: "Qoftë jeta jonë për ty, o i Dërguari i Allahut!"

Ndërsa sahabët e tjerë nuk e kuptuan atë çka kuptoi Ebu Bekri dhe u habitën nga të qarët e tij, duke thënë: "Çfarë ka ky plak që qan, ndërkohë që Allahu i ka dhënë një robi zgjedhje mes jetës së kësaj bote dhe asaj që është te Ai?!"[166]

Por më vonë e kuptuan të gjithë se Ebu Bekri kishte qenë më i dijshmi prej tyre mbi qëllimin e fjalës së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe se vetë Pejgamberi ishte robi i vënë në zgjedhje.

---

[165] Buhari, 2731. Muslimi, 1784.
[166] Buhariu, 3924. Muslimi, 2382.

Oh, sa i madh është pozicioni i Ebu Bekrit! Ai qau kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) vetëm sa dha një shenjë për afërsinë e ndarjes së tij nga kjo botë. Qau ndërkohë që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte akoma gjallë para syve të tij. Vallë, si do të ketë qenë tronditja dhe dhimbja e tij kur ndarja ndodhi në të vërtetë dhe Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ndërroi jetë?!

Por jo, Ebu Bekri atë ditë nuk u ligështua: ai qëndroi i vendosur, i qetë dhe i urtë në fjalë[167] dhe qëndrimi i tij atë ditë ishte mburojë për Umetin e Muhamedit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në ditën më të vështirë, ditën e ndarjes së të Dërguarit të Allahut nga jeta. Ai ishte që i dha siguri e forcë të gjithë muslimanëve.

4. Lidhja emocionale midis Ebu Bekrit dhe Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte nga më të fortat dhe më të lartat që mund të ekzistojnë midis dy njerëzve. Mjafton për të kuptuar butësinë dhe ndjeshmërinë e thellë të kësaj marrëdhënieje, fakti që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e përzgjodhi për të qenë shoqëruesi i tij gjatë emigrimit - *Hixhretit*. Ndërkohë që sahabët po largoheshin një e nga një drejt Medinës, sa herë që Ebu Bekri kërkonte leje për të emigruar, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e ndalonte, duke pritur kur t'i jepej leje nga Allahu për të emigruar bashkë me të.

Butësia e ndjenjave të Ebu Bekrit dhe forca e dashurisë së tij u shfaqën qartë në momentin kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e vizitoi në shtëpinë e tij për t'i dhënë lajmin e lejes së dhënë nga Allahu për t'u nisur për *Hixhret*.

Aishja - që ishte e pranishme në atë moment - tregon se kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ia dha lajmin Ebu Bekrit, ai tha me përmallim: "Do të jem shoqëruesi i juaj, o i Dërguar i Allahut?!", dhe Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ia ktheu: "*Shoqërues!*" Aishja rrëfen: "Pasha Allahun! Nuk kisha parë ndonjëherë më parë dikë të qante nga gëzimi, derisa e pashë Ebu

[167] Buhariu, 3667.

Bekrin atë ditë duke qarë nga gëzimi për shoqërinë me të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."[168]

5. Jeta e Ebu Bekrit u shtri përgjatë gjithë jetës së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) duke kaluar me të në çdo fazë dhe në çdo situatë që përjetoi. Ndërsa situatat e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ndryshonin - herë në mirësi, herë në vështirësi, herë në varfëri, herë në pasuri - Ebu Bekri ishte gjithmonë pranë tij, më afër se kushdo tjetër, pavarësisht rrethanave.

Ai përjetoi me të gëzimin e fitoreve, por edhe dhimbjen e fatkeqësive.

E jetoi me të lodhjen e varfërisë dhe përjetoi me të begatinë e pasurisë.

Në të gjitha këto rrethana, ishte ai që qëndroi i palëkundur pranë tij, më besniku dhe më i afërmi, edhe në ditët kur njerëzit u shpërndanë prej tij - siç ndodhi në Uhud dhe në Hunejn.

Ndryshonin rrethanat rreth të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), por prezenca e Ebu Bekrit pranë tij nuk ndryshonte kurrë: qëndronte gjithmonë me afërsi, dashuri, qëndrueshmëri dhe sinqeritet.

Gjatë *Hixhretit* të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nga Meka në Medinë, Ebu Bekri ishte me të në shpellë. Edhe në rrugën e rrezikshme drejt Medinës, Ebu Bekri ishte me të. Dhe dhjetë vjet më vonë, kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u nis nga Medina drejt Mekës për Haxhin e Lamtumirës, ai ishte në gjendjen më të sigurt dhe më të dukshme të fuqisë, duke qenë i shoqëruar nga më shumë se njëqind mijë vetë, por shoqëruesi i tij në udhëtim, ndër të gjithë ata njerëz, ishte pikërisht Ebu Bekri. Madje, deveja[169] e tij dhe e Ebu Bekrit ishte një e vetme.[170]

6. Prandaj, Ebu Bekri fitoi një pozitë të veçantë tek Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe një shoqërim të pandarë me të; ai ishte shoku më i afërt i tij. Ebu Bekri kishte raste që qëndronte natën te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe kishte raste ku Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut*

[168] Ibn Hisham, "*El Siretu el Nebevijjetu*", 2/93.
[169] "*Fet'hu el Bari*", 1/128.
[170] Buhariu, 4093.

qofshin mbi të) qëndronte natën te Ebu Bekri, për të trajtuar hallet e njerëzve dhe nevojat e tyre dhe për të ndjekur çështjet e tyre. Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Pejgamberi i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndronte natën me Ebu Bekrin për të diskutuar çështjet e muslimanëve dhe unë isha me ta."[171]

Diçka të tillë e transmeton edhe Abdullahu ibn Mes'udi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, i cili thotë: "Ebu Bekri dhe Umeri ndenjën një natë tek Pejgamberi, pastaj dolën së bashku me të. Ndërsa kaluan pranë Abdullah ibn Mes'udit, i cili po lexonte Kuran, Pejgamberi tha: '*Kush dëshiron ta lexojë Kuranin siç është shpallur, le ta lexojë sipas leximit të Ibn Umi Abd-it* (Abdullah ibn Mes'udit)."[172]

7. Pastaj vërejmë besnikërinë profetike ndaj kësaj miqësie dhe kujdesin e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për gjendjen e Ebu Bekrit në këtë marrëdhënie, kur shohim vendin e lartë që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i jep Ebu Bekrit - një vend që askush nga shokët e tjerë nuk e arrin e as i afrohet. Kjo shfaqet në zemërimin e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ndaj shokut të tij, Umerit, kur ndodhi një keqkuptim mes tij dhe Ebu Bekrit. Ebu Bekri shkoi dhe i kërkoi falje Umerit, por Umeri nuk e fali atë, atëherë Ebu Bekri shkoi te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, ndodhi diçka mes meje dhe Umerit; unë i kërkova falje, por ai nuk më fali." Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: "*Allahu të faltë, o Ebu Bekr! Allahu të faltë, o Ebu Bekr!*" Pastaj, kur Umeri erdhi te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i ndryshoi fytyra nga zemërimi dhe tha: "*A do ta lini të qetë shokun tim?! A do ta lini të qetë shokun tim?! Kur unë ju thashë: 'O njerëz! Unë jam i Dërguari i Allahut për ju të gjithë', ju më thatë: 'Gënjeve!' Ndërsa Ebu Bekri tha: 'Të vërtetën the' dhe më përkrahu me veten e tij dhe me pasurinë e tij. A do ta lini të qetë shokun tim?!*" Derisa Ebu Bekri u përpoq të qetësonte gjendjen dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, unë e pata fajin, unë e pata fajin."[173]

---

[171] Tirmidhiu, 169.
[172] "*Musned*", *Ebi Hanife,* 19.
[173] Buhariu, 4604.

Përparësia që Ebu Bekri i besoi qysh herët në ditët e para të shpalljes dhe afërsia e hershme e tij pranë të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) janë ruajtur, përmendur dhe e lavdëruar prej Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). A ka nder më të madh sesa që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e përmendi dhe e falënderoi atë në prag të ndarjes së tij nga kjo botë? Kur, tri ditë para vdekjes së tij, doli para shokëve të tij, u ul në *minber* - dhe ajo ishte hera e fundit që ata e panë në *minber* - dhe tha: *"Njeriu më fisnik me mua me shoqërinë e tij dhe pasurinë e tij, është Ebu Bekri. Po të kisha marrë dikë si mik të ngushtë, do ta kisha marrë Ebu Bekrin si mik të ngushtë, por shoku juaj është miku i të Gjithëmëshirshmit. Çdo njëri që na e ka dhënë dorën, ne ia kemi shpërblyer atij, përveç Ebu Bekrit, të cilit Allahu do t'ia shpërblejë."*[174]

8. Me gjithë këtë miqësi, dashuri dhe afërsi pranë Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), i Dërguari ynë (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk i dha Ebu Bekrit diçka të veçantë apo ndonjë copë toke (privilegj) dhe Ebu Bekri nuk përfitoi nga afërsia me Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) asnjë përfitim të kësaj bote, as pasuri dhe as të mira materiale. Aspiratat, dëshirat dhe ambiciet e tij ishin të gjitha të drejtuara atje, tek Allahu, në botën tjetër. Kjo ambicie e lartë shfaqet qartë në një pyetje që Ebu Bekri i bëri Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kur ai përmendi se Xheneti ka tetë dyer dhe se çdo vepër e mirë ka derën e vet: *"Kush ka qenë prej atyre që falen, thirret nga dera e namazit; kush ka qenë prej atyre që luftojnë në rrugë të Allahut, thirret nga dera e Xhihadit; kush ka qenë prej atyre që japin lëmoshë, thirret nga dera e sadakasë; dhe kush ka qenë prej atyre që agjërojnë, thirret nga dera e agjërimit, që është dera e Rejanit."* Atëherë Ebu Bekri e pyeti: "O i Dërguari i Allahut, ai që thirret nga njëra prej këtyre dyerve, nuk ka nevojë, por a ka ndonjë që do të thirret nga të gjitha dyert?" Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u përgjigj: *"Po, dhe shpresoj që ti të jesh prej tyre, o Ebu Bekr!"*[175]

Ebu Bekri e deshi shumë Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) si shok të ngushtë dhe kur lexojmë rreth kësaj

[174] Buhariu, 466. Muslimi, 2382.
[175] Buhariu, 1897. Muslimi, 1027.

miqësie madhështore, bindesh se Ebu Bekri ishte njeriu që i solli më shumë gëzim, kënaqësi dhe lumturi Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nga të gjithë shokët e tij. Allahu qoftë i kënaqur me Ebu Bekrin, mikun dhe mbështetësin e sinqertë të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), si dhe mbi të gjithë shokët e tij!

I Dërguari dhe gruaja

Gruaja pati një prani të fortë dhe ndikim të madh në jetën pejgamberike: si bashkëshorte, si bijë dhe si sahabije e ndershme, bartëse e mesazhit dhe aktiviste e fortë në veprimtari. Qëndrimi pejgamberik ndaj gruas solli një ndryshim të madh në trajtimin që tashmë shoqëria do të bënte në raport me gruan. Shpallja hyjnore dhe udhëzimi profetik hapën një rrugë të re: i dhanë gruas vendin e saj të merituar, e aktivizuan rolin e saj, i ruajtën të drejtat dhe i ngritën pozitën. Kështu, Kurani shpalli barazinë e gruas me burrin në punë dhe në shpërblim, duke thënë: ***"Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: "Unë nuk do t'ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëlloj*** (në shpërblim)**."** (Ali Imran: 195)

Po ashtu, udhëzimi pejgamberik e thekson këtë kuptim, kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) thotë: "*Vërtet, gratë janë njëlloj me burrat.*"[176]

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), në udhëzimin dhe sjelljen e tij me gratë, e aktivizonte këtë rol, e theksonte këtë pozitë dhe e çlironte gruan nga shumë pengesa të trashëgimisë shoqërore të periudhës së injorancës - *xhahilijetit*. Kjo shfaqet qartë në disa aspekte, ndër të cilat janë:

[176] Ebu Davudi, 236.

Së pari: Kundërshtimi i zakonit të popullit të tij, kurejshëve, në marrëdhëniet me gratë

Kurejshët, në veçanti, dhe arabët, në përgjithësi, nuk ia njihnin gruas mendimin dhe as këshillën; ajo ishte thjesht ndjekëse e burrit në atë që ai shihte të përshtatshme. Ata përbuznin rolin dhe pozitën e saj dhe thoshin: "Fitorja e saj është vajë dhe mirësia e saj është vjedhje!"

Ndërsa sjellja fisnike profetike erdhi ndryshe nga ky zakon shoqëror, për ta ngritur pozitën e saj, për t'i dhënë asaj të drejtën e mendimit dhe për ta marrë në konsideratë këshillën e saj. Kjo është shenjë e profetësisë së tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), sepse ai nuk e ndoqi sistemin shoqëror të popullit të tij; udhëzimi i tij buronte nga shpallja hyjnore, e jo nga trashëgimia shoqërore. Prandaj ai i kundërshtoi ata në mënyrën e trajtimit të gruas dhe e trajtoi atë sipas natyrës dhe njerëzisë së saj.

Nga shembujt praktik për këtë është pranimi i mendimit të Hatixhes në fillimin e zbritjes së shpalljes në shpellën Hira, kur ajo e çoi tek kushëriri i saj, Veraka ibn Nevfeli, i cili e dëgjoi rrëfimin e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), e qetësoi dhe e ngushëlloi atë.

Një shembull tjetër është pranimi i këshillës së Umu Selemes ditën e Hudejbijes.

Këtu vërejmë se Profeti (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ia paraqiti Umu Selemes gjendjen e tij me njerëzit dhe ia hapi asaj brengën e tij; si ankesë dhe si kërkim këshille. Për këtë arsye, Umu Selemeja nxitoi të japë mendimin e saj. Pastaj shohim sa bukur e pranoi Profeti (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) këtë këshillë dhe sa shumë ndikoi ajo tek njerëzit.

Së dyti: Ndjesia e gruas për përgjegjësinë e saj dhe përfshirja në punën për fenë

Këtë rol të gruas e shohim nga fakti se e para që e besoi dhe e përkrahu të Dërguarin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nga të gjitha krijesat - njerëzit dhe xhindët, burrat dhe gratë - ishte nëna jonë, Hatixhja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Ajo ishte e para që e priti

me nderim shpalljen nga i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), e para që i besoi dhe e përkrahu atë dhe mesazhin e tij. Po ashtu, edhe gratë të para besimtare: ato i besuan fesë me bindje të thellë dhe jo thjesht duke ndjekur ose imituar, prandaj morën përsipër përgjegjësi, kontribuuan, sakrifikuan, emigruan, luftuan, duruan të bindura për shpërblimin.

Prej tyre veçojmë:

1. Ebu Musa *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Erdhi Esmaja, bija e Umejsit - gruaja e Xhaferit - për të vizituar Hafsën, gruan e Profetit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).* Ajo kishte emigruar në Abisini bashkë me ata që kishin emigruar. Erdhi Umeri dhe e pa Esmanë tek Hafsa, dhe pyeti: 'Kush është kjo?' Ajo i tha: 'Kjo është Esmaja, bija e Umejsit.' Umeri tha: 'Kjo është abisinasja... kjo është nga detarja?' Tha Esmaja: 'Po.' Umeri tha: 'Ne kemi emigruar para jush, prandaj ne jemi më pranë të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* se ju!' Esmaja u zemërua dhe tha: 'Jo, pasha Allahun! Ju ishit me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).* Ai i ushqente të uriturit tuaj dhe i udhëzonte të paditurit tuaj, ndërsa ne ishim në një tokë të largët, në dhe të huaj, të përbuzur dhe të urryer në Abisini, për hir të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).* Pasha Allahun! Nuk do të ha as ushqim, as nuk do të pi ujë derisa t'i tregoj çfarë the ti të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të),* sepse ne përjetuam mundime dhe frikë, dhe këtë do t'ia paraqes Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).* Do ta pyes atë, vallahi nuk do ta gënjej, nuk do të pakësoj as nuk do të shtoj asgjë përtej asaj që the.' Kur erdhi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ajo iu drejtua Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i tha: 'O i Dërguar i Allahut! Umeri tha kështu e kështu.' Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pyeti: *"E ti çfarë i the?"* Ajo iu përgjigj: "Unë i thashë kështu, e kështu e kështu" Ai tha: *"Ai nuk është më pranë meje se ju. Ata kanë një emigrim, kurse ju, o banorët e anijes, keni dy emigrime."*[177]

[177] Buhariu, 4230.

Të mahnit qëndrimi i Esmasë në këtë ngjarje, sepse kjo tregon se ajo e kryente rolin e saj me vetëdije të plotë për përgjegjësinë që kishte; ajo mund t'i ishte përgjigjur Umerit duke thënë: "Unë shkova me burrin tim kur ai shkoi dhe u ktheva me të kur ai u kthye", dhe kjo do të kishte mjaftuar nëse roli i saj do të ishte vetëm një ndjekje pasive. Mirëpo, i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kur dëgjoi fjalët e Umerit drejtuar Esmasë, nuk nxitoi të përgjigjej vetë, por e pyeti atë duke i thënë: *"Çfarë i the?"* Dhe kur ajo i tregoi çfarë i kishte thënë, ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e miratoi dhe e përforcoi fjalën e saj. Ky është një shembull i edukimit profetik për të ndërtuar vetëbesimin dhe për të treguar respektimin e mendimit të gruas.

2. Gjithashtu, ngjarja e emigrimit të Umu Selemes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*:

Ajo tregon: "Kur burri im, Ebu Seleme, vendosi të nisej për në Medinë, njerëzit e fisit tim, Benu Mugire, më ndaluan dhe më penguan të shkoja me të. Ndërsa njerëzit e fisit të Ebu Selemes, Benu Esed, morën djalin tim, Selemen. Kështu burri im u nis për në Medinë, dhe unë mbeta e ndarë nga burri im dhe djali im. Çdo mëngjes dilja dhe ulesha në vendin e quajtur El Ebtuh dhe qaja derisa më zinte mbrëmja, për një vit ose pak më pak. Një ditë kaloi aty një burrë nga fisi im, njëri prej Benu Mugires, dhe kur pa gjendjen time, iu dhimbsa. Ai tha njerëzve të Benu Mugires: 'A nuk e lironi këtë të mjeruarën? E keni ndarë nga burri dhe djali i saj!' Më pas, ata më lejuan të shkoja te burri im nëse doja. Në atë kohë, edhe njerëzit e Benu Esedit ma kthyen djalin tim. Ngjesha devenë time, mora djalin në prehrin tim dhe u nisa për të shkuar tek burri im në Medinë. Nuk kishte asnjë krijesë të Allahut me mua. I thashë vetes: 'Do të udhëtoj dhe do të kërkoj ndihmë nga kushdo që të takoj gjatë rrugës, derisa të arrij tek burri im.'"

Ky durim dhe kjo qëndrueshmëri buronin nga bindja e saj në fe, nga durimi ndaj vështirësive për hir të fesë dhe nga ndjenja e thellë e përkatësisë ndaj Islamit. Prandaj u ndikua aq shumë kur iu ndalua emigrimi dhe për këtë guxoi të ndërmarrë një udhëtim të gjatë e të rrezikshëm e vetme, vetëm që të bashkohej me burrin e saj dhe të arrinte nderin e madh të emigrimit. Ajo nuk do ta kishte

ndërmarrë dhe duruar këtë, po të mos ishte për shkak të besimit të saj të palëkundur dhe ndjenjës së përgjegjësisë për fenë e saj.

Së treti: Hapja e mundësive për gratë që të shprehnin mendimet e tyre

I Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hapi horizonte të gjera për to në biseda dhe në shprehjen e mendimeve për ato që ai u transmetonte. Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) përballej me pyetjet dhe opinionet e tyre para të gjithëve, me mirëpritje dhe respekt të madh, saqë gratë dhe vajzat fituan guximin të qëndronin përpara tij, ta pyesnin dhe të shprehnin mendimet e tyre me qartësi dhe hapur për ato që ai u thoshte.

Ja disa shembuj për këtë:

1. Xhabir ibn Abdullahu transmeton: "Kam qenë i pranishëm me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në faljen e Bajramit. Ai e fali namazin para hytbes, pa ezan dhe pa ikamet. Pastaj u ngrit duke u mbështetur te Bilali, këshilloi për devotshmëri ndaj Allahut, nxiti për bindje ndaj Tij, i këshilloi dhe i përkujtoi njerëzit. Pastaj shkoi te gratë, i këshilloi dhe i përkujtoi ato, dhe u tha: "*Jepni sadaka, sepse shumica prej jush janë dru për Xhehenemin.*" Atëherë u ngrit një grua e thjeshtë[178], me fytyrë ngjyrë të mbyllur[179] dhe pyeti: "Përse, o i Dërguar i Allahut?" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigj: "*Sepse ju e teproni me ankesa dhe jeni mosmirënjohëse.*" Pastaj ato filluan të jepnin sadaka nga stolitë e tyre, duke i hedhur në rrobën e Bilalit vathët dhe unazat e tyre."[180]

Kjo grua, të cilën Xhabiri e përshkroi si të thjeshtë nga mesi i grave, nuk ishte e njohur ose e famshme; megjithatë, ajo pati guximin të bëjë një pyetje të tillë Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) para njerëzve, pa ndrojtje dhe pa hezitim. Nga ana tjetër, edhe Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e priti pyetjen e saj me përzemërsi, ia sqaroi me hollësi përgjigjen për

[178] Një grua as shumë e shquar, as e panjohur. Shiko: "*Ikmal el Mual-lim*", 3/294.
[179] Mollëzat e faqes pak në të zezë, ose ngjyrë e zezë e përzier me një ngjyrë tjetër. Shiko: "*El Nihaje*", 2/374.
[180] Muslimi, 885.

atë që ajo pyeti dhe ia shpjegoi arsyen, duke i paralajmëruar për cilësitë që shkaktojnë hyrjen në zjarr. Si rezultat i kësaj, gratë reaguan me gjallëri dhe nxituan të japin sadaka nga stolitë që mbanin.

2. Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) fali namazin, pastaj tha: *"Qëndroni në vendet tuaja, qëndroni në vendet tuaja këtu."* Pastaj e lavdëroi Allahun e Madhëruar dhe e falënderoi Atë, pastaj tha: *"E më pas..."* Pastaj u kthye nga burrat dhe tha: *"A ka ndonjë burrë prej jush që kur veçohet me gruan e tij, e mbyll derën, e mbulon veten me mbulesën e tij dhe mbulohet me mbulesën e Allahut?"* Ata thanë: "Po!" Ai tha: *"Pastaj ulet më pas dhe tregon: Kam bërë këtë e këtë?"* Ata heshtën. Pastaj ai u kthye nga gratë dhe tha: *"A ka ndonjë prej jush që e bën këtë?"* Ato heshtën. Atëherë një vajzë e re, u mbështet në njërin gju, u ngrit për t'u dukur para Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe që ai ta dëgjonte fjalën e saj. Ajo tha: "O i Dërguari i Allahut, me të vërtetë ata tregojnë, por edhe ato tregojnë!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"A e dini si është shembulli i një veprimi të tillë?"* Ai tha: *"Shembulli i tij është si shembulli i një shejtaneje që takon një shejtan në rrugë, plotëson nevojën e tij prej saj, ndërsa njerëzit i shikojnë."*[181]

Kjo vajzë pati guximin të bënte atë që nuk patën guxim ta bënin as burrat dhe as gratë. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e priti pjesëmarrjen e saj dhe e ndërtoi pjesën tjetër të bisedës mbi atë që ajo tha. Ajo nuk pati frikë se do të qortohej apo do të përballej me ndonjë fyerje. Vajza nuk u tregua kaq e guximshme para të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe para tubimit të muslimanëve, përveçse sepse kishte parë raste të mëparshme ku gratë i drejtoheshin Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe kishte parë mënyrën e mirë se si ai e priste fjalën e tyre. Prandaj, ajo mori guximin - megjithëse ishte një vajzë e re në moshë - për të thënë atë që as burrat dhe as gratë nuk patën guxim ta thoshin.

[181] Ebu Davudi, 2174.

Së katërti: Pranimi i iniciativave të grave, mirëpritja dhe bashkëveprimi me to

Xhabir ibn Abdullahu *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* tregon se një grua nga ensarët i tha të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*): "O i Dërguar i Allahut, a të bëj një minber që të qëndrosh mbi të? Sepse unë kam një djalosh marangoz." Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha*: "Po, nëse dëshiron."* - dhe ajo i përgatiti atij një *minber* me dy shkallë."[182]

Në fakt, kjo grua që doli me këtë propozim nuk u pengua nga prania e Ebu Bekrit, Umerit dhe të mëdhenjve të sahabëve përreth të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) që të paraqiste propozimin dhe nismën e saj. Ajo pati përparësinë dhe *minberi* që ajo punoi për Profetin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) mbeti një gjurmë, e cila u ruajt për rreth shtatëqind vjet. Gjithashtu, të gjithë *minberët* në xhamitë e muslimanëve më pas janë fryt i kësaj nisme të begatë; kështu që kjo sahabije e ka për nder që të ketë qenë e para në këtë traditë të mirë.

Së pesti: Përcaktimi i takimeve të posaçme me gratë

Ebu Said el Hudri tregon se gratë i thanë Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*): "Burrat të kanë marrë gjithë kohën, prandaj na cakto një ditë të rrimë me ty." Ai u premtoi atyre një ditë në të cilën u takua me to, i këshilloi dhe i porositi. Ndër të tjera u tha: *"Një gruaje që i vdesin tre fëmijë, ata do të jenë mburoja e saj nga zjarri."* Një grua pyeti: *"Po dy fëmijë?"* Ai tha: *"Edhe dy."*

Kur kjo grua tha: *"Burrat të kanë marrë gjithë kohën..."* ajo nuk kishte për qëllim që burrat po e përvetësonin krejtësisht Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), pasi gratë gjithashtu merrnin pjesë në xhami dhe dëgjonin hytbet dhe këshillat e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*); por prania e burrave i pengonte të pyesnin për shqetësimet e tyre në lidhje me çështjet që i përkisnin vetëm grave dhe të kërkonin sqarime për ato që dëshironin. Prandaj,

[182] Buhariu, 2095. Ebu Davudi, 1081. Shiko dhe Avnu el Meabud, 1/421.

kërkuan një takim të veçantë për to. Kur Profeti (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) erdhi për t'u folur, ai trajtoi çështje që i përkisnin drejtpërdrejt nevojave të tyre, duke folur për shpërblimin e nënave që humbnin fëmijët e tyre - pasi nënat në Medinë shpesh humbnin fëmijët për shkak të epidemive të shumta - dhe kështu fjalët e tij ishin ngushëllim dhe lehtësim për to.

Së gjashti: Përmbushja e nevojave të grave dhe angazhimi për çështjet e tyre

Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Një grua, e cila kishte diçka në mendjen e saj, i tha Profetit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*): "O i Dërguar i Allahut, kam një nevojë për ty." Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i tha: "*Oj nëna e filanit! Shiko në cilën rrugë dëshiron, që ta plotësoj nevojën tënde."* Pastaj u tërhoq mënjanë me të në njërën prej rrugëve, derisa ajo e shprehu shqetësimin e saj."[183]

Nëse një grua, e cila kishte një shqetësim në mendjen e saj, kërkon nga Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) një kërkesë të tillë dhe ai ia plotëson, kjo tregon se ky ishte një rregull i njohur mes të gjitha grave, aq sa edhe kjo grua kërkon haptazi për të shprehur shqetësimin e saj në mënyrë private para të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Adij bin Hatimi thotë se erdha te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe ai më mori me vete për në shtëpinë e tij. Adij tregon: "Pasha Allahun, ndërsa po shkonim për në shtëpinë e tij, në rrugë takoi një grua të dobët dhe të moshuar, e cila e ndali dhe ai u ndal për të biseduar me të, mirëpo ajo e ndali gjatë, duke folur për hallet e saj, derisa unë ndjeva keqardhje për të nga qëndrimi i gjatë në këmbë. Por thashë me vete: "Pasha Allahun, ky nuk është mbret!"[184]

Gjithashtu, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kujdesej për gratë e varfra, vizitonte të sëmurat prej tyre, interesohej për to dhe kujdesej për faljen e namazit të xhenazes kur ndonjëra vdiste.

---

[183] Muslimi, 2326.
[184] Ibn Hisham, "*El Siretu el Nebevijetu"*, 2/580.

Ebu Umame bin Sehl bin Hunejf el Ensari tregon se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i vizitonte të sëmurët nga të varfrit dhe të dobëtit e muslimanëve, i përcillte xhenazet e tyre dhe askush tjetër nuk ua falte namazin e xhenazes përveç tij.

Ebu Hurejre tregon: "Ishte një grua me ngjyrë që pastronte xhaminë. Kur ajo mungoi, i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pyeti për të. Ata i thanë: "*Ka vdekur.*" Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: "*Pse nuk më njoftuat?*" Ata sikur e panë si diçka të vogël çështjen e saj. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: "*Më çoni te varri i saj.*" Ata e çuan dhe ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i fali namazin e xhenazes, pastaj tha: "*Këto varre janë të mbushura me errësirë për banorët e tyre, por Allahu i Lartësuar i ndriçon varret e tyre përmes namazit tim për ta.*"[185]

Shikoje me sa kujdes të madh u soll ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me këto gra të dobëta: interesimi i tij për to, pyetja për to, kujdesi për gjendjen e tyre, pastaj qortimi i tij ndaj shokëve që nuk e kishin njoftuar për vdekjen e tyre. Ai vetë shkon te varri i tyre dhe fal namazin për to.

Kur shokët e tij e panë si të vogël çështjen e shërbëtores me ngjyrë, ajo nuk ishte e vogël për të (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Ajo ishte një shërbëtore, e huaj në Medinë, pa të afërm e pa mbështetje fisnore. Por ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte strehë për të huajt, baba për të dobëtit, nuk e përçmoi askënd, sepse të gjithë ishin Umeti i tij, ishin njerëzit për të cilët ai ishte përgjegjës dhe ishin pasuesit që i besuan.

Së shtati: Përcaktimi i një komunikimi të posaçëm për gratë, që lidhet drejtpërdrejt me nevojat dhe çështjet e tyre specifike

Janë shumë hadithe që trajtojnë posaçërisht çështje që u përkasin grave, duke iu drejtuar atyre me kujdes dhe ndjeshmëri të veçantë:

Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) iu drejtua grave: "*O ju gra*

[185] Muslimi, 956.

muslimane, mos e nënvlerësoni kurrë ndonjëra nga ju t'i japë diçka fqinjës së saj, qoftë edhe thundrat e një deleje."[186]

Umu Atije tregon: "Jemi porositur që ditën e Bajramit të gjitha të dalim për në xhami, edhe gratë me menstruacione, po ashtu edhe vajzat që qëndrojnë në shtëpi, që të dëshmojnë mbledhjen e muslimanëve dhe thirrjen e tyre, ndërsa gratë me menstruacione të rrinë pak më larg vendit të faljes. Një grua tha: 'O i Dërguari i Allahut, ndonjëra prej nesh nuk gjen mbulesë?' Ai tha: *"Le t'ia huazojë shoqja e saj nga mbulesa e saj."*[187]

Këto hadithe, si edhe shumë të tjera, kanë lidhje me pastërtinë e grave, adhurimin e tyre, shpenzimet për to, zbukurimin e tyre dhe çështje të tjera që kanë lidhje me to.

Së teti: Nxitja e grave për kërkimin e dijes

I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i nxiste njerëzit në mënyrë të përgjithshme për të kërkuar dijen, dhe gratë - ndër to edhe Nënat e Besimtarëve - kuptuan nga kjo se edhe ato ishin të përfshira në këtë thirrje. Prandaj, ato u angazhuan në mësim dhe në përçimin e dijes, duke qenë të bindura se kjo nuk ishte një detyrë vetëm për burrat.

1. Abdullah ibn Rafiu thotë se Umu Seleme tregon se kishte dëgjuar të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) duke folur nga *minberi* i xhamisë ndërkohë që ajo ishte në dhomën e saj dhe një grua po i krihte flokët. Ai tha: *"O ju njerëz!"* Ajo i tha gruas që po e krihte: *"M'i lidh shpejt flokët!"* - ajo i tha: "Qoftë jeta ime për të! Ai vetëm po thotë: *'O ju njerëz!'"* - Ajo u përgjigj: "Mjerë për ty! A nuk jemi edhe ne prej njerëzve?!" - Pastaj ia lidhi flokët dhe Umu Seleme qëndroi në dhomën e saj duke dëgjuar të Dërguarin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) duke thënë: *"O ju njerëz! Teksa jam pranë Burimit të Havdit, ju do të silleni në grupe, por ju shpërndaheni rrugës sime. Unë ju thërras: 'Ejani në kësaj rruge!' Por një zë më vjen pas dhe më thotë: 'Ata kanë ndryshuar pas teje.' Atëherë them: 'Larguar qofshi! Larguar qofshi!'"*[188]

---

[186] Buhariu, 2566. Muslimi, 1030.

[187] Buhariu, 351. Muslimi, 883.

[188] Ahmedi, "*Musned*", 26546. Muslimi, 249.

Ky vetëdijesim i Umu Selemes, që ajo kuptoi se ishte e përfshirë në thirrjen e përgjithshme dhe më pas nxitoi për të dëgjuar, ishte rezultat i edukimit profetik që nxitë dijen, si për burrat ashtu edhe për gratë.

2. Umu Seleme, Nëna e Besimtarëve, gjithashtu, tregon se erdhi Umu Sulejm, gruaja e Ebu Talhas, te i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, Allahu nuk turpërohet nga e vërteta. A është e detyruar gruaja të lahet gusl (larje të plotë) nëse sheh ëndërr marrëdhënie (derdhje)?" I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: "*Po, nëse kur zgjohet gjen lagështirë* (ujë)."[189]

Ky është një shembull i guximit në kërkimin e dijes. Umu Sulejm pati kurajën të pyesë për një çështje që zakonisht ngurron të pyetet dhe i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e priti pyetjen e saj me seriozitet e vëmendje. Nuk është transmetuar se ai ka qeshur apo u habit, por, përkundrazi, e mbrojti atë kur Umu Seleme i tha: "O Umu Sulejm, i turpërove gratë, çfarë flet kështu?"[190] Atëherë i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: "*Jo, por ti çfarë po flet! Po, le të lahet, o Umu Sulejm, nëse e sheh atë* (lagështinë)."[191]

Së nënti: Pjesëmarrja e tyre në Xhihad

Kjo pjesëmarrje ndodhte në kohën dhe mënyrën më të përshtatshme për to, prandaj zakonisht pjesëmarrja e tyre ndodhi në luftërat afër Medinës, si Uhudi dhe Hendeku.

1. Sehli *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se u pyet për plagosjen e të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ditën e Uhudit dhe ai tha: "U plagos fytyra e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), iu thye dhëmbi i përparmë[192] dhe helmeta mbi kokën e tij u copëtua[193]. Fatimja (paqja qoftë mbi të) ia lante gjakun, ndërsa Aliu e

[189] Buhariu, 282. Muslimi, 313.
[190] "*Fet'h eb Bari*", 1/274.
[191] Muslimi, 313.
[192] "*Sherh el Nevevej ala muslim*", 12/481.
[193] "*El Nihajetu*", 5/246.

mbante. Kur pa se gjaku vetëm sa shtohej, mori një hasër, e dogji derisa u bë hi dhe më pas ia ngjiti plagës dhe gjaku pushoi."[194]

2. Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton: "Ditën e Uhudit, njerëzit rreth të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u mundën. Unë pashë që Aishja, vajza e Ebu Bekrit, dhe Umu Sulejmi, vraponin me enët e ujit në duar, ju dukeshin kërcinjtë[195] e këmbëve ngaqë ju ngriheshin fundet duke vrapuar." Në një transmetim tjetër thuhet: "I bartnin enët mbi supe, u sillnin ujë luftëtarëve për të pirë, pastaj ktheheshin t'i mbushnin sërish, e përsëri u jepnin ujë në gojë luftëtarëve."[196]

3. Rubejjia bint Muavvidhi transmeton: "Ne dilnim në luftë bashkë me të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), u jepnim ujë burrave, u shërbenim atyre dhe i kthenim të plagosurit dhe të vrarët në Medinë."[197]

Këtu vërejmë se pjesëmarrja e grave ishte në ato gjëra që ato i dinin dhe i bënin mirë: Fatimja mjekonte plagët e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), Aishja dhe Umu Sulejmi u jepnin ujë luftëtarëve me ujët që sillnin në enët e tyre, ndërsa gratë e ensarë*ve* mjekonin të plagosurit. Këto ishin vepra që përputheshin me natyrën e tyre dhe ishin të denja për to, pa u futur në përballje luftarake që nuk përputheshin me fuqinë dhe rolin e tyre.

Së dhjeti: Mbrojtja e të drejtave të gruas

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e theksoi fuqimisht shenjtërinë e të drejtave të grave dhe ndaloi shkeljen dhe cenimin e tyre. Ebu Hurejra transmeton se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka thënë: "*O Allah, unë ia bëj të rëndë* (ndëshkimin) *atij që cenon të drejtën e dy të dobëtëve: jetimit dhe gruas.*"[198]

Nga mbrojtja e tij për të drejtat e gruas:

---

[194] Buhariu, 2911. Muslimi, 1790.
[195] Pjesa mbi nyje të këmbës ku varen edhe stolitë. "*Fet'h el Bari*", 6/92.
[196] Buhariu, 2880. Muslimi, 1811.
[197] Buhariu, 2883.
[198] Ibn Maxhe, 3674.

1. Mbrojtja e të drejtës së gruas për trashëgimi. Gruaja ishte privuar nga trashëgimia, ndërsa meshkujt e përvetësonin të gjithën. Kur u martirizua Sead ibn Rabia në betejën e Uhudit, gruaja e tij erdhi te i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, këto janë dy vajzat e Sead ibn Rabias, babai i tyre u vra dëshmor me ty ditën e Uhudit dhe xhaxhai i tyre ua mori pasurinë, duke mos u lënë asgjë. Ato nuk mund të martohen pa pasuri." Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: *"Allahu do të japë gjykim për këtë."* Pastaj zbriti ajeti i trashëgimisë dhe i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dërgoi lajm te xhaxhai i tyre dhe i tha: *"Jepu dy vajzave të Seadit, dy të tretat, jepi nënës së tyre një të tetën dhe çfarë mbetet të takon ty."*[199]

Për shkak të rëndësisë dhe përparësisë së këtij rasti, i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) mori pjesë vetë në ndarjen e trashëgimisë dhe e realizoi këtë ndarje në shtëpinë e Sead ibn Rabias.

Xhabir ibn Abdullahu transmeton: "Dola për të kërkuar të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në xhaminë e tij, por nuk e gjeta. Pyeta për të dhe më thanë: 'Ai është në Esvaf tek vajzat e Sead ibn Rabias', vëllait të Benu Belarith ibn el Harith ibn el Hazrexh, duke u ndarë atyre trashëgiminë e babait të tyre.' Ato ishin gratë e para që gëzuan të drejtën e trashëgimisë siç e përcakton Islami nga pasuria e babait të tyre. U nisa derisa arrita në Esvaf, tek pasuria e Sead ibn Rabias. E gjeta të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në një vend me kopsht palmash, që sapo ishte vaditur, ai ishte aty brenda. Atij iu soll për ushqim bukë dhe mish që ishte përgatitur për të, ai hëngri prej saj e, po ashtu, hëngrën edhe njerëzit me të. Pastaj u pastrua dhe mori abdes për namazin e drekës, morën abdes edhe njerëzit me të. Pastaj së bashku me ta fali namazin e drekës. Më pas, i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) qëndroi aty për të përfunduar ndarjen e trashëgimisë për vajzat, derisa erdhi koha e namazit të ikindisë dhe derisa përfundoi çështjen e

[199] Tirmidhiu, 2092.

ndarjes së pasurisë. Pastaj ia sollën edhe njëherë të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pjesën e mbetur të ushqimit nga buka dhe mishi dhe ai hëngri prej saj, e hëngrën edhe të tjerët me të. Pastaj u ngrit dhe e fali namazin me ne."[200]

Shiko si u angazhua Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) që nga namazi i drekës deri pas ikindisë për t'u marrë me ndarjen e pasurisë së Sead ibn Rabi'as në mënyrë që të ruajë të drejtën e vajzave të tij dhe të gruas së tij. Pjesëmarrja e tij personalisht dhe ndarja e trashëgimisë në praninë e tij është një theksim i fortë i kësaj të drejte dhe një kujdes i posaçëm për të - veçanërisht duke marrë parasysh se ato ishin gratë e para që trashëguan sipas përcaktimit Islam nga pasuria e babait.

2. Ndalesa për ta penguar gruan nga martesa me burrin që ajo dëshiron - dhe ndalesa që kujdestari të bëhet pengesë mes saj dhe atij që ajo pëlqen pa ndonjë arsye të vlefshme.

Hasen el-Basri transmeton se Meakil ibn Jesari kishte motrën e tij të martuar me një burrë, i cili e kishte divorcuar dhe e kishte lënë të lirë, derisa i mbaroi koha e pritjes - *iddah*. Pastaj ai erdhi sërish për ta kërkuar për martesë. Meakili u zemërua për këtë dhe tha: *"Ai e la atë, kur kishte mundësi ta mbante, e tani po vjen e po e kërkon përsëri?!"* Dhe e pengoi që të martohej me të. Atëherë Allahu shpalli:

*"**Kur t'i lini gratë të lira dhe ato të kenë plotësuar kohën e pritjes, mos i pengoni ato që të martohen përsëri me burrat e tyre, nëse merren vesh me të mirë. Kështu këshillohet çdokush prej jush që beson Allahun dhe Ditën e Kijametit. Kjo është më e ndershme dhe më e virtytshme. Allahu di, kurse ju nuk dini.**"* (El-Bekare: 232)
I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e thirri Meakilin dhe ia lexoi këtë ajet. Meakili e la mënjanë mllefin dhe iu nënshtrua urdhrit të Allahut.

Në këtë rast ka një mbrojtje të qartë për gruan nga të qenët viktimë e mosmarrëveshjeve midis kujdestarit të saj dhe burrit të saj. Kujdestari duhet të kërkojë të mirën e saj, jo dëshirat e veta personale.

[200] Ahmedi, 15020.

Gjithashtu, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e theksoi qartë të drejtën e saj për të zgjedhur bashkëshortin dhe shokun e jetës, duke thënë:

"Nuk martohet vajza pa u marrë pëlqimi i saj dhe nuk martohet gruaja e ve apo e ndarë pa u kërkuar mendimi i saj."[201]

Së njëmbëdhjeti: Madhërimi i vlerës së gruas dhe rolit të saj si nënë, grua, bijë dhe motër - dhe këshilla ruajtjen e kësaj porosie

1. E para ndër të drejtat dhe më e merituara është amësia: Islami i dha nënës pozitën më të lartë dhe më të theksuar ndër të drejtat njerëzore. Ajo ka të drejtën shkallës së parë, të dytë dhe të tretë të mirësjelljes, para se të vijë radha e babait në shkallën e katërt. Ky është kulmi i vlerësimit të pozitës dhe të drejtave të saj.

Ebu Hurejre transmeton se një burrë erdhi te i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe e pyeti: "O i Dërguari i Allahut, kush është më meritori për mirësjelljen time?"

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u përgjigj: *"Nëna jote."*

Ai pyeti përsëri: *"Pastaj kush?"*

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u përgjigj: *"Pastaj nëna jote."*

Ai pyeti përsëri: *"Pastaj kush?"*

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u përgjigj: *"Pastaj nëna jote."*

Ai pyeti përsëri: *"Pastaj kush?"*

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u përgjigj: *"Pastaj babai yt."*[202]

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se një grua e varfër me dy vajza të vogla erdhi te unë dhe më kërkoi ushqim. I dhashë tri hurma. Ajo i dha nga një hurmë secilës prej vajzave, ndërsa të tretën e ngriti për ta ngrënë vetë. Por vajzat e kërkuan edhe atë.

[201] Buhariu, 6968. Muslimi, 1419.
[202] Buhariu, 5971. Muslimi, 2548.

Atëherë ajo e ndau hurmën në mes për t'ua dhënë atyre, pa ngrënë vetë asgjë. Më la mbresa ky veprim dhe ia tregova të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Ai tha: *"Allahu e ka bërë të detyrueshëm hyrjen e saj në Xhenet me veprimin e saj, ose e ka shpëtuar nga zjarri me këtë veprim."*[203]

2. Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) porosit për rëndësinë e përkujdesjes dhe edukimit të femrës si bijë në periudhën e vajzërisë:

Ai e madhëroi kujdesin për vajzën, sidomos në fazën kur ajo është e dobët dhe ka nevojë për përkujdesje dhe butësi.

Enesi ibn Maliku transmeton se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ka thënë: *"Kush ka dy vajza dhe përkujdeset për to derisa të rriten, në Ditën e Kijametit do të jetë bashkë me mua - dhe i bashkoi gishtat e tij."* [204]

3. Po ashtu, porosit për përkujdesjen për femrën si grua dhe shoqe jete:

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e porositi Umetin e tij për mirësi dhe butësi ndaj grave.

Ebu Hurejra transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Porositeni njëri-tjetrin të silleni mirë me gratë! Sepse gruaja është krijuar nga brinja, dhe pjesa më e lakuar e brinjës është koka e saj. Nëse kërkon ta drejtosh atë, do ta thyesh; por nëse e lë, ajo do të qëndrojë e lakuar. Prandaj, porositeni njëri-tjetrin të silleni mirë me gratë!"*[205]

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tregoi se gruaja është pjesëmarrëse në shpërblim kur shpenzon nga ushqimi i shtëpisë së saj: *"Nëse gruaja jep nga ushqimi i shtëpisë së saj pa shpërdoruar, ajo ka shpërblimin e saj për atë që ka dhënë, edhe burri i saj ka shpërblimin e tij për atë që ka fituar, dhe magazinuesi po ashtu ka shpërblimin e tij - dhe shpërblimi i ndonjërit nuk e pakëson aspak shpërblimin e tjetrit."*[206]

Këtu Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tregon se marrja e saj përsipër përgjegjësinë e kujdesit, si pjesëmarrja e saj në shpërblimin e bamirësisë nga shtëpia e burrit të saj, ka një

[203] Muslimi, 2630.
[204] Muslimi, 2631.
[205] Buhariu, 3331. Muslimi, 1468.
[206] Buhariu, 1437. Muslimi, 1024.

pohim për rolin e saj, ngritjen e pozitës së saj, dhe përfshirjen e saj në jetën shoqërore me **efikasitet dhe aftësi**, në mënyrë që roli i saj të bëhet **plotësues me rolin e burrit**.

Këtu shfaqet ndikimi i faktorizimit të rolit të gruas dhe ngritjes së pozitës së saj në pjesëmarrjen e gjallë të grave në ngjarjet e *Sira-s* dhe në transmetimet e *Sunetit*, në ndërveprimin e tyre me ngjarjet dhe pjesëmarrjen e tyre në to.

Transmetimet e haditheve nga gratë dhe pozicionimi i tyre referencë për Umetin, siç ishin: **Nënat e besimtarëve**, **Um Atija**, **Um Sulejm**, **Um Haram bint Milhan** dhe të tjera, nuk do të ishte e mundur **po të mos ishte ky horizont i gjerë** që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i mundësoi gruas, për të pasur atë rol dhe atë pjesëmarrje.

I Dërguari dhe shërbyesit

Shërbyesit kishin një prani të dukshme në jetën e Pejgamberit me shërbimin e tyre ndaj tij dhe kujdesin për çështjet e tij. Por edhe ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pati një prani të veçantë në jetën e tyre, duke u kujdesur për ta, duke i bekuar, trajtuar me mirësi dhe duke treguar fisnikëri në sjellje.

Kur shikojmë marrëdhënien e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me shërbyesit, do të vërejmë disa pika kryesore:

Së pari: Vërejmë një llojshmëri të shërbyesve që ndodheshin rreth Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*): kishte prej tyre të vegjël në moshë, si Enesi, dhe të rritur, si Rebia bin Keab el Eslemiu dhe Abdullah bin Mes'udi *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)*.[207]

Po ashtu, kishte burra siç e kemi përmendur dhe gra, si Umu Ejmeni dhe Berireja.

---

[207] Për të mësuar rreth atyre që i kanë shërbyer Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) shiko librin: *"El Fahru el mutevalij fi men hademe el Nebijje min el hademi ve el mevali"*, të hafëz El Sahavi. Në këtë libër, Sahavi përmend afërsisht 215 vetë që patën nderin t'i shërbejnë Pejgamberit. Këta nuk ishin të gjithë në të njëjtën kohë, por disa prej tyre i kanë shërbyer për një periudhë të gjatë, si Enesi dhe Ibn Mes'udi, e disa të tjerë i shërbyen kalimthi ose përkohësisht.

Ata që i shërbyen Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) disa qenë muslimanë - si shumica e tyre - por pati edhe jomuslimanë si djaloshi çifut që i shërbente Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në shtëpinë e tij dhe vajza hebre që i shërbente Aishes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*.

Pavarësisht kësaj larmie - në moshë, gjini dhe fe - i bashkonte një element i përbashkët: dashuria për Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe përkushtimi në shërbimin e tij. Ata, megjithëse të ndryshëm, ndiheshin të nderuar që i shërbenin atij.

Shumica e atyre që i shërbyen nuk ishin "shërbëtorë" në kuptimin klasik të fjalës, por shokë të tij - *sahabët* që dëshironin të kishin nderin t'i shërbenin nga dashuria dhe respekti i thellë që kishin për të. Prandaj, në mesin e atyre që përmenden si shërbyes të tij, gjejmë emra të mëdhenj dhe prijës të sahabëve *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)*.

Së dyti: Natyrshëm lind pyetja - nëse të gjithë këta njerëz i shërbenin Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), cilat ishin detyrat e tyre? Sidomos kur marrim parasysh se dhomat e tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishin të vogla, me mure ndarëse, çati të ulët dhe mobilie të thjeshta, pasi ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk banonte në pallat që të kishte nevojë për gjithë këta shërbyes!

Ndoshta përgjigjja është se detyrat e tyre ishin më të ngjashme me detyrat e një korrieri apo ndihmësi të përgjithshëm në kohët moderne. Për shkak të thjeshtësisë dhe madhësisë së vogël të shtëpisë, nuk mund të bëhej ruajtje apo magazinim i shumë gjërave, ndaj çdo nevojë ishte ditore e përditshme kërkonte që të merrej e të sillet në mënyrë të vazhdueshme.

Kështu që:

- Një shërbëtor sillte dru për zjarrin çdo ditë,
- tjetri sillte ujë,
- një tjetër merrej me ushqimin - dhe të gjitha këto kryheshin rregullisht dhe në vazhdimësi.

Pra, ishte një shërbim modest, i përditshëm, por i përkushtuar, dhe kjo i jep më shumë vlerë përkushtimit të tyre ndaj Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Po ashtu, shërbëtorët kishin edhe një detyrë tjetër shumë të rëndësishme: ata ndihmonin në komunikimin dhe thirrjen e personave që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dëshironte t'i ftonte. Për shembull, ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i thoshte Enesit:

"*Shko thirre Ebu Bekrin.*"

"*Shko thirre Umerin.*"

"*Shko thirre filanin.*"

"*Shko dhe sill këtë gjë.*" [208]

Kështu, roli i tij ishte shumë i ngjashëm me rolin e një korrieri personal në shtëpinë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Së treti: E shohim se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) sillej me shërbyesit e tij me një butësi dhe dashamirësi që i pushtonte zemrat e tyre, i tërhiqte drejt vetes dhe i mbulonte me kujdesin e tij. Kjo bënte që ata ta donin me gjithë shpirt dhe t'i shërbenin me përkushtim të jashtëzakonshëm.

Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, i cili i shërbeu Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për dhjetë vite, thotë: "I Dërguari i Allahut ishte njeriu me sjelljen më të mirë. I kam shërbyer për dhjetë vjet, në udhëtime dhe në vendbanim, ndërkohë që isha i vogël dhe shërbimi im nuk ishte gjithmonë siç duhet. Por, Pasha Allahun, kurrë nuk më tha: 'Uf!', kurrë nuk më tha për diçka që e bëra: 'Pse e bëre kështu?', dhe as për diçka që nuk e bëra: 'Pse nuk e bëre kështu?'"[209]

Ky qëndrim i mrekullueshëm i Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), pa qortim, pa ngritje zëri, me mirëkuptim dhe edukatë hyjnore, i bënte ata të ndiheshin të nderuar dhe të gatshëm të shërbenin me dashuri, me ndjenjë dhe me një vetëdije të lartë të qëllimit të këtij shërbimi.

Abdullahu ibn Mes'udi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ishte njeriu që kujdesej për sandalet e të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i hiqte sandalet, Ibn Mes'udi i merrte me duart e tij dhe

[208] Muslimi, 1428.

[209] Buhariu, 6038. Muslimi, 2309.

i mbante me përkushtim - si shenjë dashurie dhe madhërimi të thellë për Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).[210]

Sefine, një shërbyes i të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), u bë i njohur me këtë emër për një ngjarje domethënëse: ai ishte në një udhëtim me disa *sahabë* dhe mbajti mbi shpinë pjesën më të madhe të plaçkave të tyre. Atëherë, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i tha: "*Mbaj, sepse ti je* [si] *Sefine* (anije)*!*"

Që prej asaj dite, ai njihej me emrin *Sefine* dhe kur dikush e pyeste për emrin, ai përgjigjej: "Nuk po jua tregoj emrin tim të vërtetë. Mua më ka quajtur i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të): Sefîne, dhe nuk dua asnjë emër tjetër!"[211]

Shikoje sa fort ishte i lidhur me këtë emër, megjithëse i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ia kishte thënë në formë loje dhe për ta gëzuar. E, megjithatë, ai zgjodhi ta mbante atë emër gjithë jetën, sepse ai e konsideroi atë emrin më të dashur në botë, nga dashuria që kishte për të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Po ashtu, shiko përkushtimin e Rabia ibn Keab el Eslemiut. Ai thotë: "I shërbeja Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjithë ditën. E kur ai hynte në shtëpinë e tij pas namazit të jacisë, e ndiqja dhe ulesha pranë pragut të derës së tij, ndoshta do t'i duhej diçka gjatë natës, e unë të isha aty afër. Derisa më zinte gjumi."[212]

Çfarë tjetër, përveç dashurisë së madhe për Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe kënaqësisë që ndjente në shërbimin ndaj tij, mund ta shtynte Rabian që pas shërbimit gjatë ditës, të vazhdonte t'i shërbente edhe natën, duke luftuar gjumin nga sytë e tij, në pritje të ndonjë nevoje të mundshme të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)?

Së katërti: Nga tiparet e sjelljes së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me shërbyesit ishte përkujdesja e tij për ta, në një mënyrë që të kujton përkujdesjen e prindit për fëmijën e tij.

---

[210] Buhariu, 3742. Muslimi, 824.
[211] "*El Istijab*", 2/685.
[212] Ahmedi, 16579.

Nga përkujdesja e tij ishte vizita e tij në shtëpitë e tyre. Sa herë e ka vizituar Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) Enesin dhe nënën e tij dhe është falur në shtëpinë e tyre!

Nga kujdesi i tij është edhe lutja e tij për ta. Enesi thotë se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) u lut për mua duke thënë: *"O Allah! Shtoja pasurinë, shtoja fëmijët dhe zgjate jetën e tij."* - dhe sot unë jam ndër ensarët më të pasur dhe me më shumë fëmijë, saqë numri i fëmijëve të mi kalon njëqind." [213] Allahu ia zgjati jetën Enesit, saqë ai jetoi më shumë se nëntëdhjetë vjet.

Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pa dashurinë dhe përkushtimin e madh të Rabia bin Keab el Eslemit në shërbim të tij, i tha: *"Oj Rabia, kërko prej meje çfarë të duash!"* Rebia i thotë: "Më jep pak kohë, o i Dërguar i Allahut, që të mendohem për çështjen time." Rabia tregon: "U mendova dhe e pashë se gjëja më e mirë që mund të kërkoj është që ai të lutet për mua për Xhenetin." Pastaj i shkova dhe i thashë: "O i Dërguar i Allahut, kërkoj të jem në shoqërinë tënde në Xhenet." Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: *"A nuk kërkon ndonjë gjë tjetër, oj Rabia?"* Thashë: "Vetëm këtë, o i Dërguar i Allahut." Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: *"Atëherë më ndihmo për veten tënde me shumë sexhde."* [214]

Së pesti: Kujdesi i Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për shërbyesit nuk ndalej as kur ata vdisnin. Kur njëherë mungoi shërbyesja zezake që pastronte xhaminë, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pyeti për të. I thanë: *"Ka vdekur."* Ai tha: *"Sikur të më njoftonit! Më tregoni ku është varri i saj."* Shkoi te varri i saj, ia fali namazin e xhenazes dhe u lut për të.

Kjo shërbëtore zezake ishte në peshoren e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) një njeri me dinjitet të plotë, një muslimane me të gjitha të drejtat e muslimanëve, edhe pse në sytë e të tjerëve mund të shihej vetëm si një shërbëtore apo send pa vlerë.

Së gjashti: Me gjithë dashurinë e madhe dhe madhështinë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), shërbyesit

[213] Buhariu, 6334. Muslimi, 2481.
[214] Muslimi, 489.

nuk ndienin frikë apo druajtje në marrëdhëniet me të. Ata sillen me natyrshmëri dhe vullnet të lirë. Enesi tregon: "Një ditë më dërgoi Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) për një punë dhe thashë me vete: "Pasha Allahun, nuk do të shkoj", megjithëse në zemër doja që të shkoja, për të kryer porosinë e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Dola dhe kalova pranë disa fëmijëve që po luanin në treg, e fillova të luaj me ta. Papritur, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më kapi nga mbrapa për në zverk. U ktheva dhe e pashë, po qeshte. Më tha: *"O Unejs* (përkëdhelje e emrit të Enesit)*! A shkove atje ku të urdhërova?" I thashë: "Po shkoj, o i Dërguar i Allahut."* [215]

Berira, e cila, kur e fitoi lirinë nga skllavëria, nuk pranoi të qëndronte me burrin e saj Mugithin. Ky i fundit erdhi tek i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe i kërkoi ndërmjetësimin e tij. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) foli me Beriren për këtë çështje. Ajo i tha: "O i Dërguar i Allahut, a po më urdhëron?" Ai tha: *"Jo, unë jam vetëm ndërmjetësues."* Ajo tha: "Nuk kam nevojë për të."[216] Kështu, ajo mori vendimin e saj e bindur se nuk do të merrte asnjë lloj qortimi nga Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), e lëre më të kishte frikë ndonjë ndëshkim. Shërbyesit në shoqërinë e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) jetonin njerëzinë e tyre të plotë dhe i gëzonin të drejtat e tyre të plota.

Së shtati: Nga afërsia dhe qëndrimi i vazhdueshëm i atyre që i shërbenin dhe e shoqëronin Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ata kishin mundësinë të shihnin aspekte të jetës së tij që nuk mund t'i dinte dikush tjetër përveç atyre që ishin vazhdimisht pranë tij dhe i shërbenin. Për këtë arsye, ata mësuan dhe transmetuan nga Seneti i tij atë që të tjerët nuk e transmetuan. Kjo duket qartë në sasinë e madhe të transmetimeve të Enesit dhe Ibn Mes'udit, si dhe në njohuritë e tyre për çështje që të tjerët nuk i kishin njohuri. Siç është transmetimi i Enesit për rastin kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) shkoi me të te

[215] Muslimi, 2310.
[216] Buhariu, 5283.

rrobaqepësi që e kishte ftuar; nuk ishte askush tjetër përveç Enesit, i cili dëshmoi atë situatë, e mbajti mend dhe e transmetoi.[217]

Ibn Mes'udi tregon për faljen e tij së bashku me të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) në namazin e natës: "U fala me të Dërguarin e Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe Ai qëndroi gjatë në këmbë, derisa mendova për një gjë të pakëndshme." I thanë: "Çfarë ishte ajo?" Tha: "Mendova të ulem dhe ta lë atë."[218]

Së teti: Mbetet të dish se ky Pejgamber (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), të cilit të gjithë ata që ishin përreth tij dëshironin me gjithë shpirt t'i shërbenin, ishte vetë ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) që i shërbente vetes së tij. Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) rregullonte - *qepte* me dorën e vet sandalet e tij, milte delen e tij, qepte rrobën e tij dhe merrej vetë me punët që në mënyrë të zakonshme mund t'i kryente një shërbëtor për të. Por kjo ishte përulësia e madhe profetike. Prandaj paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi këtë Pejgamber fisnik dhe të Dërguar madhështor!

I Dërguari dhe fëmijët

1. Pejgamberi i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e priste fëmijën që në fillimin e jetës së tyre; banorët e Medinës ia sillnin fëmijët e tyre foshnja, duke ditur përkujdesjen dhe dashurinë e tij ndaj tyre dhe duke kërkuar bekimin e lutjeve të tij. Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i priste me dashuri dhe i merrte në prehrin e tij.

Enesi përshkruan këtë skenë kur kishte sjellë vëllain e tij, Abdullahun, foshnjë të porsalindur. Nëna e tij e kishte dërguar me disa hurma dhe ai tregon: "Më tha nëna ime: O Enes, të mos i japë kush gji derisa ta çosh te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e*

[217] Buhariu, 2092. Muslimi, 2041.
[218] Buhariu, 1135. Muslimi, 773.

Allahut qofshin mbi të). Kur u gdhi, e mora me vete dhe shkova me të te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).* E gjeta ndërkohë që në dorë mbante një hekur [219] rrobash dhe kur më pa tha: 'Mos vallë ka lindur Umu Sulejm?' Thashë: 'Po!' Atëherë e la hekurin mënjanë. E solla fëmijën dhe e vendosa në prehrin e tij. Ai më tha: 'A ka dërguar diçka?' Thashë: 'Po, disa hurma!' I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i mori ato hurma dhe i përtypi në gojën e tij derisa u zbutën mirë, pastaj ato i vendosi në gojën e foshnjës. Foshnja filloi ta lëpinte ëmbëlsinë e tyre. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Shikoni sa shumë e duan ensarët hurmën!"* Pastaj ia fshiu fytyrën dhe ia la emri: Abdullah."[220]

Kur e vëzhgojmë këtë skenë, vërejmë se Enesi mbërriti te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në një moment kur ai ishte i zënë, por ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk i tha: "Hajde më vonë" apo "Prit sa të mbaroj punën time", por e la punën menjëherë dhe iu drejtua Enesit, e mori foshnjën dhe e vendosi në prehrin e tij.

Kjo butësi dhe gatishmëri tregon gëzimin e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe bashkëveprimin e tij të sinqertë në këtë situatë me dashuri. Ai e përjetonte me kënaqësi këtë çast, pa u treguar i ngutshëm, edhe pse sapo kishte lënë një punë të tijën, por ishte sikur kishte mbaruar çdo gjë tjetër dhe e kishte përqendruar gjithë vëmendjen për ta pritur këtë foshnjë në orët e para të jetës së saj.

Nëse Enesi na e ka përcjellë këtë skenë me gjithë hollësitë e saj, padyshim që ai do t'ia ketë treguar edhe nënës së tij me më shumë detaje dhe ndjeshmëri.

Një ditë erdhi te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* Ebu Usejdi me djalin e tij, El Mundhirin. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e vendosi foshnjën në prehrin e tij, ndërsa babai i tij qëndronte ulur. Pastaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ashtu siç ishte i ulur u mor me një

[219] "*Lisanu el Arab"*, 12/636.
[220] Buhariu, 5470. Muslimi, 2144.

punë që kishte në dorë. Ebu Usejdi urdhëroi dikë që ta merrte foshnjën nga prehri i Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e përfundoi atë që kishte në dorë, tha: *"Ku është foshnja?"* Ebu Usejdi i tha: "E morëm, o i Dërguar i Allahut." Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e pyeti: *"Si e keni quajtur?"* Ai i tha: "Filan." Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: *"Jo! Quajeni El-Mundhir!"* - dhe atë ditë ia vuri emrin El-Mundhir.[221]

Shiko, pra, si pyeti Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) menjëherë për fëmijën sapo mbaroi punën që kishte në dorë? Dhe si ndikoi ky interesim tek babai i fëmijës - duke i dhënë ndjesinë se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kujdesej për të dhe ende kishte një punë me të.

Madje, ndodhte që fëmija të vendosej në prehrin e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe të urinonte mbi rrobat e tij, por ai nuk mërzitej dhe nuk tregonte pakënaqësi, për të mos ua shtuar ndjenjën e sikletit prindërve të fëmijës.

Transmetohet nga Umu Kajs bint Mihsan se ajo i kishte sjellë të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) një djalë të vogël që nuk kishte filluar ende të hante ushqim. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e uli fëmijën në prehrin e tij dhe ai urinoi mbi rrobat e tij. Atëherë, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kërkoi ujë dhe e spërkati vendin me urinë dhe nuk e lau atë.[222]

Umu Kajs e përmendi atë që bëri Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*), pa ndier aspak siklet apo se ai ishte shqetësuar apo i befasuar nga ajo që ndodhi; sepse ai e përballoi situatën me qetësi, me delikatesë dhe me madhështi të karakterit.

2. E kur fëmijët rriteshin pak dhe fillonin të kuptonin dhe të reagonin ndaj afërsisë së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) me ta, ai zbriste në nivelin e të kuptuarit të tyre me butësi dhe shoqërim. Enesi tregon: "I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ishte njeriu me sjelljen më të

[221] Buhariu, 6191. Muslimi, 2148.
[222] Buhariu, 223. Muslimi, 287.

mirë. Ai vinte tek ne dhe qeshte me vëllain tim të vogël që kishte ndërprerë gjirin (rreth moshës tre vjeç). Një ditë hyri dhe e pa djalin të mërzitur[223] dhe të heshtur dhe e pyeti nënën e tij: *"Oj Umu Sulejm! Përse e shoh Ebu Umejrin të mërzitur?"*

Ajo i tha: "I ka ngordhur Nugajri i tij - një zog me të cilin ai luante." Atëherë, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) iu afrua fëmijës, filloi të qeshte me të duke i thënë: *"O Ebu Umejr! Çfarë ndodhi me Nugajrin?"* - d.m.th.: më trego si ngordhi zogu yt. Me këtë ai kërkonte ta qetësonte fëmijën, të ndante me të hidhërimin e tij duke biseduar me të dhe ta lehtësonte pikëllimin e tij. Fëmija reagonte, tregonte historinë, qante, dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i hapte zemrën e tij atij fëmije, e i kushtonte vëmendje të plotë.

Mahmudi ibn el Rebia tregon: "E mbaj mend mirë një lagie[224] me ujë që më bëri i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në fytyrë, kur isha pesë vjeç, nga një kovë në shtëpinë tonë."[225]

Kjo pamje që e ka transmetuar Mahmudi nga kujtesa e hershme e fëmijërisë së tij, është e rrethuar me një pamje tjetër që nuk është transmetuar, sepse i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk mund ta kishte befasuar një fëmijë të pavëmendshëm me një lagie uji në fytyrë që do ta trembte, mirëpo e gjithë pamja tregon se ata po luanin bashkë dhe kjo lojë përparoi derisa ai e lagu në fytyrë me ujë pusi - gjë që ia shtoi afërsinë dhe gëzimin fëmijës dhe e bëri këtë skenë të paharrueshme në kujtesën e tij.

3. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndante jetën e tij me jetën e fëmijëve, kështu që kalimi i tij pranë tyre nuk ishte thjesht kalim i rastësishëm, por i gjallë e i pranishëm. Semura ibn Xhundub tregon: "Fala me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* namazin e drekës[226], pastaj ai shkoi te familja e tij dhe dola edhe unë me të. Përballë i dolën disa fëmijë dhe ai filloi të përkëdhelte faqet e secilit prej tyre, një nga një.

---

[223] "*El Nihajetu*", 2/11.

[224] Kjo lloj lagie me ujë ishte me mbush gojën me ujë pastaj ta lagësh njëri-tjetrin. Shiko "*Sherh el Nevevij ala Muslim*", 5/162.

[225] Buhariu, 77. Muslimi, 33.

[226] "*Sherh el Nevevij ala Muslim*", 15/85.

Ndërsa mua më preku faqen dhe ndjeva nga dora e tij një aromë, si të ishte nxjerrë nga një kuti parfumi."[227]

Vëre përshkrimin e Semura-s: *"Dhe përballë i dolën disa fëmijë"*; kjo është një shenjë e gëzimit të fëmijëve kur shihnin Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, sepse e takonin në rrugë dhe ndiheshin të ngrohtë nga afërsia e tij dhe merrnin prej tij dashuri e butësi, të cilën ua jepte me të dyja duart, kur u përkëdhelte faqet një nga një - pastaj ata ktheheshin në shtëpitë e tyre me tregimin më të bukur: takimin me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe përkëdheljen e tij ndaj tyre.

4. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mësonte atyre sjelljet e mira dhe përmbledhjet thelbësore të fesë, sipas kapacitetit të perceptimit dhe vetëdijes së moshës. Transmeton Umer ibn Ebi Seleme: "Isha një djalosh që rrija në prehrin e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe dora ime shëtiste nëpër enën e ushqimit. Atëherë i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më tha: *'O djalosh! Thuaj Bismil-lah, ha me dorën e djathtë dhe ha përpara vetes!'* Që prej asaj kohe, kjo është mënyra ime e të ngrënit."[228]

Vëre se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi me butësi të skajshme dhe e shoqëroi këshillën me një grup udhëzimesh, në mënyrë që të mos shfaqej qortim ndaj veprimit të Umerit. Dhe vërejtjen për veprimin e tij e vendosi në fund të udhëzimeve: *"... dhe ha përpara vetes!"*

Nga ndikimi i kësaj butësie në mësimdhënie është se shpirti i fëmijës përthithi këto mësime dhe i ruajti gjatë gjithë jetës së tij. Ai shprehet: "Që prej asaj kohe, kjo është mënyra ime e të ngrënit."

Ibn Abasi transmeton se një ditë po shoqëroja Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ai më tha: *"O bir! A dëshiron të mësoj disa fjalë që Allahu do të bëjë dobi me to?"* Thashë: "Po!" Atëherë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Ruaje Allahun, të të ruajë ty. Ruaje Allahun, ta gjesh përballë teje. Kujtoje Allahun në ditë të mira, të të kujtojë ty në ditë të vështira. Kur të*

[227] Muslimi, 2329. Shiko *"El Nihajetu"*, 1/318.
[228] Buhariu, 5376. Muslimi, 2022.

kërkosh (diçka), kërkoje vetëm nga Allahu. Kur të kërkosh ndihmë, kërkoje vetëm prej Allahut. Dije se, edhe sikur të mblidhet i gjithë populli për të sjellë ndonjë dobi, nuk do të sjellin asgjë tjetër përveç asaj që Allahu e ka caktuar për ty. Dhe nëse mblidhen për të dëmtuar me diçka, nuk do të dëmtojnë me gjë tjetër përveç asaj që Allahu e ka shkruar për ty. Janë ngritur penat dhe është tharë boja mbi faqe. Dije se fitorja vjen me durimin, çlirimi vjen me brenga dhe me vështirësinë vjen lehtësimi."[229]

Këtu shohim se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shfrytëzoi momentin e afërsisë - që ishte fakti se fëmija ishte pas tij në kafshë - dhe kjo është prej gjërave që japin ndjesinë e veçantësisë dhe përgatitin për të pranuar mësimin. Pastaj vjen thirrja atërore: *"O bir!"* Më pas vjen pyetja nxitëse: *"A dëshiron të mësoj disa fjalë që Allahu do të bëjë dobi me to?"* Më pas ai ia përmendi disa fjalë të përmbledhura që janë nga parimet thelbësore të fesë. E gjithë kjo është një formë nderimi për fëmijët dhe ngritjeje të nivelit të tyre.

Për këtë arsye, Ibn Abasi e ruajti këtë porosi, e kuptoi mirë dhe e transmetoi të mbështjellë me këtë skenë të fuqishme dhe prekëse.

5. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* sillej me ta duke e respektuar individualitetin dhe personalitetin e tyre, kështu që, kur kalonte pranë tyre në rrugë, i përshëndeste i pari.

Enesi kaloi pranë disa fëmijëve dhe i përshëndeti, pastaj tha: "Pejgamberi kaloi pranë disa djemve dhe i përshëndeti ata."[230]

Shikoje ndikimin e këtij veprimi të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në shpirtrat e këtyre djemve dhe ndoshta edhe Enesi ishte në mesin e tyre, sepse kjo skenë mbeti e gjallë në mendjet e tyre dhe ndikoi në formën e imitimit të tij, prandaj Enesi pason shembullin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe zbaton udhëzimin e tij.

6. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kujdesej për pastërtinë e tyre morale dhe për ruajtjen e besueshmërisë në marrëdhëniet me ta. Amër ibn Rebia tregon se një ditë nëna ime më thirri, ndërsa i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ulur në shtëpinë tonë. Ajo tha: "Eja, do të jap diçka!" i

[229] Tirmidhiu, 2516.
[230] Muslimi, 2168.

Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: *"Çfarë deshe t'i japësh atij?"* Ajo u përgjigj: "Desha t'i jap hurma." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Nëse nuk do t'i jepje gjë, do të shkruhej një gënjeshtër."*[231]

Me këtë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kujdesej për drejtësinë e tyre morale që në fëmijëri dhe korrigjonte sjelljet që prindërit zakonisht e marrin lehtë, si mashtrimi ndaj fëmijëve, i cili ia humb vlerën dhe rëndësinë besueshmërisë në sytë e tyre.

7. Ashtu siç gëzuan djemtë përkujdesjen dhe dashurinë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, po ashtu, edhe vajzat gëzuan praninë, dashamirësinë dhe mëshirën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Enesi ibn Maliku tregon se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kaloi një ditë diku nëpër Medine dhe aty ishin disa vajza të vogla që po i binin defeve të tyre dhe po këndonin. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu afrua atyre dhe tha: *"Allahu është dëshmitar se unë ju dua."*[232]

Le të shohim një fragment prindëror pejgamberik që nuk mbaron mrekullia e tij: është fragmenti i një qëndrimi të veçantë të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj një vajze të vogël rreth katërvjeçare, që thirrej Umu Halid, ndërsa emrin e kishte Ema, bija e Halid ibn Said ibn el As. Ngjarja ishte kështu: I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po ndante disa rroba për sahabët e tij dhe përpara tij mbeti një mantel i vogël me vija ngjyrë të verdhë, jeshile dhe të kuqe. Ishte një mantel i bukur që shkëlqente dhe të gjithë po i mbanin sytë aty. Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Kujt mendoni t'ia japim këtë mantel?"*

Të gjithë sahabët heshtën nga respekti për mendimin e tij. Ndërsa në mendjet e tyre lindën pyetjet: Kujt do t'ia dhurojë i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* këtë mantel? Cila është ajo që do ta përzgjedhë?

[231] Ebu Davudi, 4991.
[232] Ibn Maxhe, 1899.

Pastaj Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Ma thirrni Umu Halid-in.*" Lajmëtari shkoi te babai i saj për t'i thënë që i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po e kërkonte vajzën e tij të vogël. Babai e mori vajzën e tij në krahë dhe e solli para të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu drejtua asaj, hapi mantelin e vogël dhe filloi t'ia vishte me duart e tij të bekuara.

Kur manteli përqafoi trupin e vogël të vajzës dhe sytë e saj shkëlqyen nga gëzimi i fëmijërisë për rrobën e re, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u bë pjesë e gëzimit të saj dhe u përfshi me harenë e saj. Ai prekte me dorën e tij të nderuar vijat shumëngjyrëshe të mantelit dhe përulej me ndjeshmërinë e tij ndaj ndjeshmërisë së saj dhe me fjalët e tij ndaj fjalëve të saj, duke folur si ajo, me atë të folur të këndshëm që bëjnë fëmijët, duke thënë: "*O Umu Halid, sena*!",[233] që do të thotë: "*Kjo është e bukur dhe e hijshme.*"

Më pas i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia uroj rrobën e re dhe u lut për të, duke e përsëriti tri herë: "*E gëzofsh dhe e mbarofsh! E gëzofsh dhe e mbarofsh! E gëzofsh dhe e mbarofsh!*"

Vajza e deshi shumë të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe u miqësua shumë me të. Filloi të luante me dorën e saj të vogël ato që i tërhiqnin vëmendjen te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe nga gjërat që i zunë syrin ishte vula e profetësisë mes shpatullave të tij. Ajo nisi të luante me të dhe ta prekë me gishtat e saj të vegjël. Atëherë, babai i saj e qortoi për këtë lojë - nga respekti për të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Por butësia profetike e tejkaloi butësinë atërore dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu drejtua atij duke thënë: "*Lëre!*" Le të lozë vajza sa të dojë dhe le të luajë sa të dëshirojë. Umu Halid *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* rritet dhe e mban mend me përkushtim këtë ngjarje. Ajo ruan rrobën *(mantelin),*

[233] Buhariu, 3071.

sepse ai i ruan asaj bekimin e duarve të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe madhështinë e atij takimi.[234]

Me të vërtetë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mund të ishte mjaftuar duke ia dërguar rrobën *Um Halid-it* përmes dikujt tjetër; por ai vetë e mori përsipër këtë veprim dhe e përmbushi me të gjitha detajet e tij - që ky gjest, gëzimi i një vajze të vogël dhe futja e haresë në zemrën e saj, të bëhet një sunet profetik që ndiqet, një shembull i bukur për këdo që shpreson takimin me Allahun dhe Ditën e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.

Për këtë arsye, këtë gjest të ndjeshëm dhe të bukur do ta gjesh të përsëritur në *Sira-n* profetike në shumë episode të ngjashme, të cilat theksojnë vazhdimisht këtë mësim dhe ringjallin kuptimet e thella të kësaj skene.

Pastaj shiko mjeshtërinë profetike në kthimin e një veprimi të bukur në një *buqetë aktesh të hijshme dhe domethënëse:*

- E nisi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me *pyetjen* se kujt t'i jepej rroba, gjë që sugjeron *vlerësim dhe përzgjedhje*, duke e shndërruar rrobën në një *medalje nderi*.
- Më pas e *kërkoi vetë vajzën* që ajo të kishte *nderin ta merrte prej tij*, e jo që t'ia dërgonte dikush tjetër.
- Pastaj *vetë ia veshi rrobën* me duart e tij të bekuara.
- E pasoi me *shoqërim të ngrohtë, dashuri dhe pjesëmarrje në hare*, duke u bashkuar me gëzimin e saj fëmijëror.
- Më pas *urimi* dhe *lutja për të*, madje e *përsëriti lutjen* disa herë.
- Dhe e *afroi aq shumë* saqë ajo *prek dhe luan me trupin e tij të bekuar*, duke shfaqur ndjesinë e afërsisë e sigurisë.
- Kur babai i saj deshi ta ndalojë, Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Lëre!*", duke e miratuar dhe përforcuar ndjesinë e lirshmërisë dhe dashurisë.

Ky është një *mësim profetik* që tregon se *veprat e mira*, përveçse janë *bujari dhe dashamirësi*, gjithashtu, janë një *art dhe mjeshtëri në realizim*.

---

[234] Ahmedi, 20811. Buhariu, 3071, 5823. Ebu Davudi, 4024. "*Sijer Ealamu el Nubela*", 3/470. "*El Isabetu*", 7/506. "*Fet'hu el Bari*", 6/184, 10/279.

I Dërguari dhe të rinjtë

Kur shohim sjelljen e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me të rinjtë, vërejmë disa veçori të marrëdhënies së tij me ta, ndër të cilat:

1. **Bashkëveprimi dhe afërsia me të rinjtë**, saqë ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i theu barrierat mes brezave dhe krijoi lidhje mes të rinjve dhe brezit para tyre, në mënyrë që të rinjtë të jetonin e të bashkëvepronin me më të mëdhenjtë në një harmoni të plotë.

Këtë e vërejmë në rastin kur Ibn Abasi, në moshën dymbëdhjetëvjeçare, ishte ulur në të djathtë të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndërsa në të majtën e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin pleqtë e Kurejshit. Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu soll një enë me pije, piu prej saj dhe pastaj i tha Ibn Abasit: *"A më lejon t'ia jap atë* (pijen) *xhaxhallarëve të tu?"* **-** duke iu referuar pleqve që ndodheshin në të majtë të tij. Ibn Abasi, me mençuri, zgjuarsi dhe vetëbesim, u përgjigj: "Jo, nuk do t'i jap askujt përparësi të pijë atë që mbetet nga pija e të Dërguart të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."* Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia dha atij enën.[235]

Vëre se si është edukuar Ibn Abasi nën kujdesin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në mbledhjet e tij, ndërsa rreth tij qëndronin pleqtë dhe shih se si, ndonëse në një moshë të re, ai kishte zhvilluar një pavarësi të mendimit, vetëbesim në vendimmarrje dhe një vetëdije të thellë për rëndësinë e mbetjes së pijes së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - duke e kuptuar se ajo ishte një gjë e ndershme, të cilën nuk ia jepte përparësi askujt tjetër.

Po të shohësh edhe pjesën tjetër të shokëve të rinj të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, do të vëresh se jeta e tyre ishte e ndërthurur me jetën e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Njëri kishte hipur me të në udhëtim, tjetri ishte pas

[235] Buhariu, 5620. Muslimi, 2030.

tij në kafshë, e një tjetër ishte gjithmonë me të. Ja, për shembull, Muadhi thotë: "Isha pas Pejgamberit mbi një gomar; nuk ishte mes meje dhe atij veçse pjesa e pasme e jastëkut të shalës." Mjafton ta përfytyrosh Muadhin - një djalosh rreth të njëzetave - duke qenë kaq afër të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kraharori i tij i ngjitur pas shpinës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe duart e tij të mbështetura anash trupit të tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Çfarë afërsie më të madhe mund të ketë?

E megjithatë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e thërret me emrin e tij të plotë, duke e respektuar dhe nderuar: "*O Muadh ibn Xhebel!"* Ai përgjigjet: "Urdhëro, o i Dërguar i Allahut!" Pastaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* heshti pak dhe sërish i tha: "*O Muadh ibn Xhebel!"* Ai përsëriti: "Urdhëro, o i Dërguar i Allahut!" Pastaj heshti përsëri dhe përsëri i tha: "*O Muadh ibn Xhebel!"* Ai u përgjigj për herë të tretë: "Urdhëro, o i Dërguar i Allahut!"

Atëherë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*A e di ti se cila është e drejta e Allahut ndaj robërve dhe cila është e drejta e robërve ndaj Allahut?"* … dhe vazhdoi hadithin.[236]

Kjo afërsi, ky dialog i ngrohtë, ky dhurim i dijes, si dhe kjo ndjeshmëri për pjekurinë e të riut - që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mësonte atij një dije të veçantë, të cilën nuk e shpërndante publikisht që të mos keqkuptohej - të gjitha këto tregojnë se çfarë vendi të veçantë kishin të rinjtë te ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: dashuri, afërsi dhe besim.

Në Haxhin e Lamtumirës, kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në Arafat dhe dielli po afrohej drejt perëndimit, ai ndodhej mbi devenë e tij dhe njerëzit ishin rreth e rrotull. Atëherë u tha shokëve të tij: *"Thirrmani Usame ibn Zejdin!"*[237] Arafati u përfshi nga thirrjet: "O Usame ibn Zejd! O Usame ibn Zejd! Eja te i Dërguari i Allahut!" Udhëheqësit e fiseve beduine shikonin përreth të habitur: Kush është ky Usame ibn Zejd që

[236] Buhariu, 2856. Muslimi, 30.
[237] Buhariu, 1669. Muslimi, 1280.

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) po e thërret në këtë çast kaq të ngushtë para largimit nga Arafati? Pse po e veçon me këtë thirrje dhe po pret për të?! Sikur e kishin përfytyruar një plak të moshuar me mjekër të bardhë…

Por, ndërsa ata mendonin kështu, u shfaq një djalosh me ngjyrë të zezë, rreth të tetëmbëdhjetave. Ai iu afrua Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, u ngjit mbi devenë e tij dhe u ul pas tij, duke u mbështetur mbi të. Atëherë, beduinët të habitur thanë: "Ky është ai që na mbajti pezull? A po prisnim këtë djalosh të vogël?!"

Prandaj, vërejmë se shumica e atyre që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i merrte pas vetes në udhëtimet e tij ishin të rinj.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndërtonte marrëdhënie të forta me të rinjtë dhe bashkëvepronte në harmoni të përkryer me brezat e rinj.

2. Ai i edukonte të rinjtë me vlerat e besimit dhe me vlerat morale, para se t'ua mësonte ato si dije teorike

I edukonte që ta madhëronin Allahun, ta donin dhe ta nderonin Atë, të mos e zemëronin Atë, si dhe i mësonte mbi vlerat e mirësisë dhe moralit. Kështu, kur mësonin Kuranin, ai gjente në zemrat e tyre një tokë pjellore të gatshme për shiun, ndërvepronte me të dhe rritej përmes tij.

Xhundebi ibn Abdullahu tregon: "Ishim me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* djem të rinj në prag të burrërisë[238], prandaj mësuam besimin para se të mësonim Kuranin. Pastaj, mësuam Kuranin, i cili na e shtoi besimin."

Ibn Umeri thotë: "Kemi qëndruar një periudhë të gjatë në kohën tonë, ku më të riut prej nesh, së pari, i mësohej besimi pastaj Kurani."[239]

Ata mësonin nga i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* Kuranin, mësonin ajetet e tij dhe vlerat e tyre. Po ashtu, ata e mësonin vlerat e ajeteve të shprehura me fjalë të tjera që i mësonin prej tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përpara se të mësonin

[238] "*El Nihajetu*", 1/380.
[239] Ibn Maxhe, 61.

ajetet. Kështu ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u mësonte atyre besimin - që është vlera më e madhe që ka sjellë Kurani nëpërmjet porosive të tij për besim, nëpërmjet rrëfimeve të tij rreth besimit dhe vlera të tjera të cilat priten me bindje dhe besim të plotë - e më pas ata i mësonin përmendësh ato nga vetë teksti i Kuranit.[240]

Abdullah ibn Umeri: "E pashë një ëndërr kur isha ende djalosh i ri dhe ia tregova motrës sime, Hafsës. Ajo ia tregoi atë të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Abdullahu është njeri i mirë. Sa njeri i mirë është Abdullahu, sikur të falte namaz nate!"*

Pas kësaj, Abdullahu filloi të falej gjatë natës, saqë flinte vetëm një pjesë të saj.

Shiko, pra, këtë nxitje profetike për të rinjtë drejt adhurimit dhe pastaj shiko ndikimin që pati kjo fjalë te i riu Abdullah ibn Umeri, i cili e përjetoi gjithë jetën e tij i përkushtuar ndaj namazit të natës.

3. Gjithashtu, vërejmë se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i dhuronte të rinjve një sasi të madhe ndjenjash dhe emocionesh, sepse të rinjtë janë më të ndjeshëm ndaj emocioneve dhe reagojnë më fort ndaj tyre. E shohim Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* teksa e merr për dore të riun Muadh ibn Xhebel, ia vendos dorën në dorën e vet dhe i thotë: *"O Muadh ibn Xhebel!"* Muadhi i thotë: "Urdhëro, o i Dërguar i Allahut!" Pastaj ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i thotë: *"Vallahi, unë të dua ty!..."* (vijon hadithi).[241]

Mjafton ta imagjinosh emocionin e Muadhit në atë moment dhe rrahjet e zemrës së tij me dorën e tij në dorën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndërsa fytyra e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* rrezaton drejt tij dhe nga buzët e bekuara të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dalin fjalë dashurie të ëmbla dhe të bukura. Nuk është çudi që zemra e Muadhit u mbush me gëzim e dashuri, duke dëgjuar këto fjalë.

[240] "*Xhevabu el Iatiradati el Misrijeti*", Ibn Tejmije, 12.
[241] Ebu Davudi, 1522.

Prandaj ai tha: "Vallahi, o i Dërguar i Allahut! Betohem në Allahun në dorën e të Cilit është shpirti im, se edhe unë të dua ty!"

Abdullahu ibn Mesudi thotë: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më mësoi Et-tehijatin (teshehudin), ndërsa dora ime ishte në duart e tij."[242]

Prandaj, Abdullahu ibn Mesudi e ruajti përmendësh *Et-tehijatin* (teshehudin) dhe ua mësoi atë gjithë umetit të Muhamedit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, të cilët e këndojnë në namazet e tyre - atë që e ka mësuar Ibn Mesudi, ndërsa dora e tij ishte me duart e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Dhe ja ky i ri - **Abdullah ibn Umeri**… Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vjen tek ai dhe i vendos duart mbi shpatullat e tij! Mjafton të imagjinosh: Abdullah ibn Umeri, një i ri nën moshën njëzetvjeçare dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbështetet me butësi e dashuri, me duart e tij mbi shpatulla. Është një çast afërsie dhe një prekje dashurie dhe më pas Pejgamberi i thotë: *"O Abdullah! Jeto në këtë botë si një i huaj ose kalimtar i përkohshëm."*[243] Një këshillë e shkurtër, por që i ngulitet në shpirt të riut përjetësisht, si një busull që e udhëheq në jetë.

4. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i kuptonte dëshirat dhe ndjenjat e të rinjve

Në Haxhin e Lamtumirës, ai kishte ulur pas vetes në devenë e tij Fadl ibn Abasin, një djalosh i pashëm dhe me flokë të bukur. Erdhi një vajzë e hijshme për të bërë një pyetje dhe filloi të shikonte Fadlin dhe ai e shikonte atë. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia ktheu kokën Fadlit që të mos shikonte, por Fadli e nxori kokën nga ana tjetër. Megjithatë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e qortoi, nuk e fyeu dhe nuk u zemërua me të. Madje, më e çuditshmja është se as vajzën nuk e qortoi, por u mjaftua duke i mënjanuar kokën Fadlit me butësi.[244]

Nga mirëkuptimi i tij për nevojat dhe ndjeshmëritë e të rinjve, është edhe rasti i treguar nga Malik ibn Huvejrith, i cili thotë:

[242] Buhariu, 6265. Muslimi, 402.
[243] Buhariu, 6416.
[244] Buhariu, 1513. 1334.

"Shkuam tek i Dërguari i Allahut ndërsa ishim djem të rinj, afërsisht moshatarë. Qëndruam tek ai për njëzet net. Ai ishte i mëshirshëm me ne. Kur vërejti se na kishte marrë malli për familjet tona, na pyeti për to dhe ne i treguam. Atëherë, ai tha: "*Kthehuni te familjet tuaja!...*"[245]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vërejti mallin e të rinjve për gratë e tyre dhe e kuptoi dëshirën e tyre për t'u kthyer. Prandaj, ai urdhëroi që të ktheheshin tek familjet e tyre. Vëre se si ata e kuptuan se ky urdhër ishte nga mëshira e tij për ta dhe nga njohja e tij për mallin që ndienin.

Dhe për të dëshmuar kuptimin e thellë që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte për dëshirat rinore, mjafton të përmendim se të rinjtë i hapeshin atij për dëshirat e tyre... Një djalë i ri i afrohet dhe i thotë: "*O i Dërguar i Allahut, më lejo të bëj zina.*"

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e qortoi dhe as nuk e ofendoi, por i tha: "*Afrohu.*" Dhe i riu u afrua derisa qëndroi përballë tij. Pastaj ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*A do ta doje atë* (zinanë) *për nënën tënde?*" Ai u përgjigj: "Jo, për Atë që të ka dërguar me të vërtetën!" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*A do ta doje për motrën tënde? Për hallën tënde? Për tezen tënde?*" I riu tha: "Jo, për Zotin që të ka dërguar me të vërtetën!" Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*As njerëzit nuk e duan këtë për nënat e tyre, as për bijat e tyre, as për motrat e tyre.*"

Pastaj Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vuri dorën në kraharorin e këtij të riu, derisa i riu e ndjeu ftohtësinë e dorës së tij mbi kraharor, dhe tha: "*O Allah, fale mëkatin e tij dhe ruaje nderin e tij!*"[246]

5. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte besim te të rinjtë dhe i bënte ata të ndiheshin të besuar

Ai nuk i nënvlerësonte aftësitë e tyre, nuk i linte mënjanë talentet e tyre, por, përkundrazi, u besonte atyre punë madhore kur i shihte të denjë për to, mosha e tyre e re nuk ua ulte aspak vlerën e tyre.

[245] Buhariu, 631. Muslimi, 674.
[246] Ahmedi, 22211.

El Erkam ibn Ebi el Erkam el Mahzumiu ishte djalosh rreth të tetëmbëdhjetave kur i kishte vdekur i ati. Shtëpia e tij, që ndodhej mbi Safa, ishte vendi më i përshtatshëm për tubimet profetike, prandaj Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mblidhej aty me shokët e tij.

Shtëpia e tij u bë shkolla e parë e muslimanëve në Mekë dhe vendi i sigurt ku takoheshin me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ajo mbeti qendra e takimeve dhe dijes për muslimanët gjatë gjithë periudhës para thirrjes publike në Mekë.

Gjithashtu, një shembull tjetër i aktivizimit të aftësive rinore është Zejd ibn Thabiti, të cilin Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e takoi kur ishte vetëm njëmbëdhjetë vjeç. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përkrahu, i dha besim dhe e drejtoi të mësonte leximin, shkrimin dhe gjuhën hebraike dhe ai u bë shkruesi i shpalljes ndërsa ajo zbriste.

Zejdi u bë më i dituri i Umetit për çështjet e trashëgimisë, saqë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Më i dituri për trashëgiminë në Umetin tim është Zejdi."*[247] Kur vdiq Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, Zejdi ishte vetëm njëzet e një vjeç.

Pas çlirimit të Mekës, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli prej Mekës dhe caktoi mbi të guvernator Atab ibn Esjed, i cili ishte rreth njëzet vjeç.[248]

Mjafton ta imagjinosh se Atab ibn Esjedi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* u bë udhëheqës i Mekës, ndërkohë që në të gjendeshin personalitete të mëdha si Ebu Sufjani ibn Harbi, Suhejli ibn Amri dhe Ikrime ibn Ebu Xhehli! Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zgjidhte kuadrot e aftë për detyrat e ndryshme, ju caktonte detyrat dhe ju besonte përgjegjësinë. Me këtë veprim, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po përgatiste brezin e dytë që herët për të marrë përgjegjësi, për të qenë të aftë të përballonin krizat dhe sfidat.

Dhe pikërisht këta të rinj ishin ata që pas vdekjes së tij e bartën mesazhin e tij përpara dhe ia përcollën atë mbarë njerëzimit.

---

[247] Ahmedi, 13102. Tirmidhiu, 3790. Hakimi në "*El Mustedrek*", 8057.
[248] "*El Tabakatu el Kubra*", Ibn Sead, 6/34.

6. **Pejgamberi** *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* **i kushtonte të rinjve një kujdes të veçantë në arsimim**, sepse ata janë më të kuptueshëm dhe më të aftë për të përthithur dijen, ata do të jenë të dërguarit e tij drejt brezave që do të vijnë.

Kjo përkujdesje arsimore shfaqet qartë në mënyrën si i përfshinte ata, si bisedonte me ta, si iu përgjigjej pyetjeve të tyre.

Ndër shembujt e kësaj përkujdesjeje është rasti që rrëfen Ebu Mahdhura: "Dola bashkë me dhjetë të rinj nga Meka, në kohën kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po kthehej nga lufta e Hunejnit. E takuam në një udhë dhe ai ishte njeriu më i urryer për ne në atë kohë. Ata filluan të thërrasin ezanin, e ne filluam të bërtasim duke i imituar dhe tallur. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"M'i sillni këta të rinj, se dëgjova thirrjen e një njeriu që ka zë të bukur."* Kur na sollën, Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Thirreni ezanin"* - dhe e thirrëm. Unë isha i fundit. Kur thirra ezanin, tha: *"Eja!"* - dhe më uli përpara vetes. Më përkëdheli në ballë dhe më bekoi tri herë. Pastaj më dha një qese me pak argjend. I thashë: "O i Dërguar i Allahut, më urdhëro të thërras ezanin në Mekë." Ai tha: *"Të kam urdhëruar. Shko dhe thirr ezanin në Qaben e shenjtë."* I thashë: "Si, o i Dërguar i Allahut?" - dhe më mësoi ezanin me gojën e tij vetë." Pastaj shkova tek Atab ibn Esjed, guvernatori i Pejgamberit në Mekë, dhe thirra ezanin, me urdhrin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*."[249]

Këtu shohim përfshirjen dhe afërsinë që u jepte të rinjve, me një prekje të butë, një lutje të mirë, një dhuratë bujare dhe mësim të bukur. Dhe shohim se si ndikoi kjo tek i riu: nga një njeri që e urrente, u bë dashamirës; nga tallës, u bë i bindur. Ai u bë thirrësi i Ezanit në Mekë deri në vdekjen e tij.[250]

Muadhi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton: "Isha pas Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hipur mbi kafshë e ai më tha: *"Me të vërtetë, e drejta e Allahut mbi robërit është ta adhurojnë Atë dhe të mos i shoqërojnë Atij asgjë. Dhe e drejta e robërve mbi Allahun është që Ai të mos e ndëshkojë atë që nuk i shoqëron Atij*

[249] Ahmedi, 15376. Nesaiu, 1608. Ibn Maxhe, 708.
[250] *"Sijeru Ealamu el Nubelai"*, 3/118.

asgjë." I thashë: "O i Dërguar i Allahut! A t'i jap lajmin e mirë njerëzve për këtë?" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Mos u jep lajmin, se do të mbështeten në të* (pa vepra)." [251]

Këtu vëmë re se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i besoi Muadhit një dije të veçantë, por e ndaloi ta shpërndante menjëherë, sepse disa njerëz mund ta keqkuptonin dhe të mbështeteshin në shpresë pa përpjekje.

7. **Ai i nxiste të rinjtë për seriozitet, adhurim dhe ruajtjen e veprave vullnetare - *Sunet***

Por përveç nxitjes për adhurim, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ruante ekuilibrin në punë dhe nuk lejonte teprimin rraskapitës që mund ta shtyjë rininë për shkak të vrullit të saj.

Kur mori vesh se tre të rinj kishin ardhur në shtëpitë e tij për të pyetur për adhurimin e tij në shtëpinë e tij dhe kur u informuan, adhurimi i tij iu duk pak, atëherë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkoi te ta dhe tha: *"Ju jeni ata që thoni kështu e ashtu? Ju, betohem në Allahun se unë jam më i përulur dhe më i devotshëm se ju ndaj Allahut! Por unë edhe agjëroj edhe ha, edhe falem edhe fle, dhe martohem. Kush largohet nga Suneti im, ai nuk është prej meje!"*[252]

I Dërguari dhe njerëzit e Strehimores Suffa[253]

1. Të varfrit, të dobëtit dhe të huajt ishin në qendër të kujdesit dhe përkujdesjes së të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai i nderonte dhe i përkrahte ata, porosiste për ta, i priste vetë dhe i afronte pranë vetes, duke thënë:

"M'i sillni[254] *të dobëtit! A nuk ndihmoheni dhe furnizoheni vetëm për hatër të dobëtëve në mesin tuaj?!"*[255]

---

[251] Buhariu, 128. Muslimi, 22.
[252] Buhariu, 5063.
[253] *"Ehlu el Suffa baidenan el vehem ve el hajal"* të Sheh Salih bin Ahmed el Shami prej ku edhe e kam përfituar për këtë pjesë.
[254] Thirrni. Shiko *"El Nihajetu"*, 1/43.
[255] Buhariu, 2896.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u jepte kujdes dhe ngushëllim të varfërve në një mënyrë që e ruante dinjitetin e tyre dhe i përfshinte ata në shoqëri, asnjëherë nuk lejonte që dikush të ndiente se varfëria e përjashtonte apo ia ulte vlerën. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, gjithashtu, i përgatiste ata me kualifikim dhe motivim.

Ndër të varfrit më të njohur nga muslimanët ishin banorët e strehimores *Suffa*-s. Të folurit për ta paraqet një shembull se si i Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* sillej me të varfrit në përgjithësi - duke u përkujdesur, duke i mësuar dhe duke i përgatitur.

2. *Suffa* ishte një vend i mbuluar që ndodhej në fund të xhamisë së të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i cili shërbente si strehë për muhaxhirët e varfër që kishin emigruar tek i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Sa për banorët e *Suffa*-s, ishin ata që kishin emigruar te i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pasi ai dhe shokët e tij të parë ishin vendosur tashmë në Medinë. Ata erdhën në këtë qytet pa pasur as familje e as pasuri ku të strehoheshin. Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i vendosi në atë pjesë të mbuluar në fund të xhamisë. Numri i tyre ndryshonte në varësi të atyre që vinin dhe qëndrimi i tyre zgjaste më shumë ose më pak, sipas gjendjes së secilit. Ata nuk ishin gjithmonë të pranishëm të gjithë njëkohësisht - ndonjëri krijonte familje, të tjerë shpërnguleshin diku tjetër kur u hapej mundësia, ose ktheheshin te populli i tyre, ndërkohë që vinin të tjerë pas tyre. Ndonjëherë ishin dhjetë veta, herë të tjera shtatëdhjetë a tetëdhjetë,[256] apo edhe më shumë ose më pak.

Vërejmë se ata vinin nga fise të ndryshme, pa ndonjë lidhje gjaku që t'i bashkonte, e as ndonjë lidhje tjetër që t'i afronte mes tyre. Mirëpo, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* krijoi mes tyre një lidhje madhore - jo lidhjen e fisit, as atë të vendit - por lidhjen e besimit dhe të vëllazërisë për hir të Allahut. Ata, me gjithë larminë e tyre, u bënë një me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut*

[256] "*Mexhmuu el Fetava*", Ibn Tejmije, 11/41.

qofshin mbi të) dhe u shkrinë në një marrëdhënie të fuqishme e të lartë, që ishte dashuria për Allahun dhe vëllazëria për hir të Tij.

3. Këta njerëz u strehuan në *Suffa* dhe aty jetonin bashkë me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* një jetë të thjeshtë dhe me mungesa materiale. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i ngushëllonte dhe i ndihmonte me çfarë kishte në dispozicion dhe ndonjëherë i shpërndante ata për darkë tek muslimanët e tjerë, që ata të hanin dhe njëkohësisht të përfshiheshin në jetën e shoqërisë.

Abdurrahman ibn Ebu Bekri ka tregon: "Banorët e Suffa-s ishin njerëz të varfër dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Kush ka ushqim për dy veta, le të marrë edhe një të tretë; kush ka për katër veta, le të marrë edhe një të pestë apo të gjashtë.*" Ebu Bekri solli tre veta, ndërsa i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori dhjetë."[257]

Beshir ibn Hasasije tregon se erdha te i Dërguari i Allahut dhe ai më thirri në Islam. Pastaj më tha: "*Si quhesh?*" Thashë: "Nedhir (Paralajmërues)." Tha: "*Jo, ti je Beshir* (Përgëzues)*!*" Pastaj më strehoi te *Suffa*. Kur i sillnin dhuratë, e ndante me ne; e kur i sillnin sadaka, e shpërndante të gjithën për ne."[258]

Varfëria që përjetuan banorët e *Suffa-s* ishte e detyruar, jo e zgjedhur me dëshirë. Ata nuk e zgjodhën varfërinë në vend të pasurisë, as nuk e zgjodhën këtë gjendje si formë të asketizmit apo tërheqjeje nga jeta, por emigrimi për te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nga vendlindjet e tyre - ku kishin familjet dhe pasuritë - i detyroi të sakrifikonin gjithçka. Ata erdhën në Medinë pa pasur as familje e as pasuri ku të strehoheshin dhe e përballuan këtë gjendje me mungesa, kufizime dhe vështirësi për hatër të dashurisë dhe shoqërisë me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Seleme ibn Ekva tregon: "Isha në shërbim[259] të Talha ibn Ubejdilah, kujdesesha për të, për kalin e tij i jepja ujë dhe e krehja[260],

[257] Buhariu, 602. Muslimi, 2057.
[258] "*Hiljetu el Evlijai*", 2/26.
[259] "*El Nihajetu*", 1/179.
[260] "*Sherh el Nevevij ala Muslim*", 12/50.

ai më mbante me ushqim, pastaj e lashë pasurinë dhe familjen time për të emigruar te Allahu dhe i Dërguari i Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*."[261]

Prandaj, gjendja e tyre nuk është thirrje për varfëri e as nënvlerësim për pasurisë[262]. Sepse, nga ana tjetër, do të gjejmë se prej dhjetë të përgëzuarve me Xhenet pati prej atyre që ishin të pasur. Madje, i Dërguari ka thënë: *"Sa e mirë është pasuria e pastër në dorën e njeriut të pastër!"*[263]

Por ata hoqën dorë nga ajo pasuri për hir të emigrimit drejt të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe pranuan këtë varfëri. Aq sa Ebu Hurejra - që ishte një nga ta - tregon: "E kam parë ndonjërin prej tyre të rrëzohej për shkak të urisë së gjatë..."

4. Sa për sjelljen e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj tyre, ai themeloi në *Suffa* shoqatën e parë bamirëse në histori, e cila bazohej në strehimin dhe edukimin e të varfërve. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndronte me ta në *Suffa*, u mësonte Kuranin dhe i mësonte fenë islame. Ai vuante urinë me ta, siç vuanin edhe ata dhe kur kishte diçka, e ndante me ta; kurrë nuk i mbante gjërat vetëm për vete.

Për këtë arsye, kur i sollën disa skllevër dhe vajza e tij Fatimja e kërkoi një prej tyre për t'i lehtësuar lodhjen në punët e shtëpisë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu përgjigj: *"Për Zotin, unë nuk do t'ju jap një shërbyes dhe të lë njerëzit e Strehimores - që u janë mbledhur barqet nga uria - pa ndihmë. Unë do t'i shes ata dhe me çmimin e tyre do t'u blej ushqim njerëzve të Strehimores."*[264]

Një ditë Ebu Talha kaloi aty pranë dhe e pa Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* teksa u mësonte banorëve të *Suffa-s* Kuran - dhe zëri i tij tregonte qartë lodhjen nga uria. Nuk mundi të durojë pamjen e tij në atë gjendje, ndaj shkoi me nxitim te gruaja e tij, Umu Sulejm, me shpresën se mund të gjente ndonjë gjë për t'ia ofruar të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të ngrënë. Kur ia tregoi këtë, ajo i tha: "Kam diçka" - dhe e tregoi me

[261] Muslimi, 1807.
[262] "*Mexhmuu el Fetava*", 11/38.
[263] Ahmedi, 17763. "*El Edeb el Mufred*", *299.*
[264] Ahmedi, "*Musned*", 838.

dorë duke bërë me shenjë se ishte shumë pak - "kemi rreth një mud (njësi matëse) miell elbi. Nëse vjen i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vetëm, do të mjaftojë për të, por nëse vjen me të tjerë, nuk do të mjaftojë për ta." Ai i tha: "Përzieje miellin dhe përgatite bukën. Ndoshta do ta ftojmë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të vijë të hajë te ne."

Pastaj Ebu Talha i tha djalit të gruas së tij, Enesit *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*: "O biri im, shko te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe qëndro pranë tij. Kur ai të ngrihet, prit që të shpërndahen shokët e tij, pastaj ndiqe dhe, kur të arrijë te dera e shtëpisë së tij, thuaji: "Babai im të fton." Kujdes mos i fto të tjerët dhe mos më turpëro!"

Enesi shkoi te i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe e gjeti të ulur në një rrethim me rreth tetëdhjetë sahabë. Qëndroi në këmbë duke pritur që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të ngrihej që ta ftonte, por i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu kthye dhe i tha: *"A të ka dërguar babai yt, o djalosh?"* Tha: "Po!" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Për ushqim?"* Tha: "Po!"

Atëherë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u kthye nga shokët e tij dhe u tha: *"Çohuni, Bismilah, ejani t'i përgjigjemi ftesës së Ebu Talhas!"* Enesi thotë: "U nisa përpara tyre derisa arrita te Ebu Talha dhe e njoftova. Ebu Talha i tha Umu Sulejmës: "I Dërguari po vjen me njerëz, ndërsa ne nuk kemi çfarë t'u japim për të ngrënë!" Ajo i tha: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri."

Pastaj, Ebu Talha doli për ta pritur Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi me të derisa hynë në shtëpi. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Na jep çfarë ke, o Umu Sulejm."* Ajo solli bukën dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi që ajo të përsheshej në copa. Umu Sulejm shtrydhi një lëng nga një enë e saj dhe e hodhi mbi bukën e thërrmuar. Pastaj i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu lut Allahut dhe tha: *"Le të hyjnë dhjetë vetë!"* Ata hynë dhe hëngrën derisa u ngopën, pastaj dolën. Pastaj ai *(paqja dhe mëshira e*

Allahut qofshin mbi të) tha: *"Le të hyjnë dhjetë të tjerë!"* Ata hynë, hëngrën derisa u ngopën, pastaj dolën. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vazhdoi të thoshte: *"Le të hyjnë dhjetë të tjerë!"* derisa të gjithë njerëzit hëngrën dhe u ngopën - dhe ata ishin shtatëdhjetë ose tetëdhjetë vetë.[265]

Kjo skenë prekëse e përmbyll bukur tregimin:

Pastaj ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"O Umu Sulejm, ku është ky ushqim prej ushqimit tënd që më tregove?"* Ajo u përgjigj: "Qoftë jeta ime për ty, o i Dërguari i Allahut! Po të mos i kisha parë me sytë e mi duke ngrënë, do të thosha se nuk është pakësuar fare nga ushqimi ynë!" - Pastaj Umu Sulejmi mblodhi atë që kishte mbetur dhe ua dhuroi fqinjëve të saj."[266]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* megjithëse i lodhur nga uria, ulej me ta për t'i mësuar. Dhe kur iu ofrua ushqimi - nuk e mbajti për vete, por i thirri edhe ata që kishin ndarë me të urinë, që të ndanin me të edhe ushqimin.

5. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, për shkak të afërsisë dhe përzierjes së tij me njerëzit, vërente nga gjendja e tyre atë që të tjerët nuk mund ta dallonin dhe ua kuptonte fjalët që kishin në zemër para se t'i shprehnin. Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Pasha Atë që nuk ka të adhuruar tjetër të vërtetë përveç Tij, unë shtrihesha përtokë nga uria dhe e lidhja një gur mbi bark për shkak të urisë. Një ditë u ula në rrugën nga dilnin (shokët e Pejgamberit), kur kaloi Ebu Bekri dhe e pyeta për një ajet nga Libri i Allahut - nuk e pyeta për tjetër veçse që të më ushqente - por ai kaloi dhe nuk bëri gjë. Pastaj kaloi Umeri dhe e pyeta për një ajet nga Libri i Allahut - nuk e pyeta për tjetër veçse që të më ushqente - por ai kaloi dhe nuk bëri gjë. Pastaj kaloi pranë meje Ebu el Kasimi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Kur më pa, buzëqeshi dhe e kuptoi çfarë kisha në shpirtin tim dhe në fytyrën time. Më tha: *"O Ebu Hirr!"* I thashë: "Urdhëro, o i Dërguari i Allahut!" Tha: *"Eja me mua!"* Dhe ai vazhdoi, e unë e ndoqa. Hyri (në shtëpi) dh e kërkoi leje (për

[265] Hadithin e mora nga Muslimi, sepse është më i përmbledhur dhe na jep panoramë të qartë.
[266] Buhariu, 3578. Muslimi, 2040.

mua) dhe më lejoi të hyj. Në shtëpi gjeti një enë me qumësht dhe pyeti: *"Nga ka ardhur ky qumësht?"* I thanë: *"Ta ka dhuruar filani apo filanja."* Tha: *"O Ebu Hirr!"* I thashë: "Urdhëro, o i Dërguari i Allahut!" Tha: *"Shko dhe mi thirr njerëzit e Suffa-s!*

Ebu Hurejra tregon se njerëzit e *Suffa*-s ishin mysafirët e Islamit. Ata nuk kishin as familje, as pasuri, as përkrahje nga dikush. Kur vinte ndonjë lëmoshë (sadaka), ua dërgonte atyre dhe nuk merrte gjë nga ajo për vete. Por kur i vinte ndonjë dhuratë, ua çonte atyre dhe merrte prej saj edhe vetë, duke i përfshirë edhe ata. Prandaj, kjo gjë më mërziti. Mendova me vete: "Çfarë mund të bëjë ky qumësht për tërë njerëzit e Suffas? Unë kisha më shumë të drejtë të pija sadopak prej tij që të merrja fuqi. Por, kur të vijnë ata, do të më urdhërojë mua, dhe unë do t'ua shpërndaj. E çfarë do të më mbetet mua nga ky qumësht?" Por nuk kisha rrugë tjetër veç bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Shkova tek ata dhe i thirra. Erdhën, kërkuan leje, dhe u lejua të hynin. U ulën në vendet e tyre brenda. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"O Ebu Hirr!"* I thashë: *"Urdhëro, o i Dërguari i Allahut!"* Tha: *"Merre dhe jepua atyre!"* Mora enën dhe fillova t'ia jepja një nga një, secili e merrte enën, pinte derisa ngopej, pastaj ma kthente enën, e unë ia jepja tjetrit dhe kështu me radhë, secili pinte deri sa ngopej, pastaj ma kthente enën - dhe ena qëndronte ende plot dhe lëkundej në dorën time - derisa arrita te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe të gjithë ishin ngopur.

Ai mori enën, e vuri në dorën e tij, më shikoi dhe buzëqeshi - sikur e lexoi atë që mendoja në zemrën time dhe çfarë më kishte thënë vetja ime. Më tha: *"O Ebu Hirr!"* I thashë: "Urdhëro, o i Dërguari i Allahut!" Tha: *"Kemi mbetur unë dhe ti."* I thashë: "Ke të drejtë, o i Dërguari i Allahut." Tha: *"Ulu dhe pi!"* U ula dhe piva. Tha: *"Pi!"* dhe unë piva, derisa barku im u mbush dhe u bë si El Kid'hu[267]. Dhe ai vazhdonte të thoshte: *"Pi!"* derisa i thashë: "Jo,

[267] El Kid'hu është shkopi i shigjetës, përdoret si shembull për drejtësinë e tij. Ebu Hurejre po nënkupton se barku i tij u bë i drejtë me kraharorin dhe kjo në kohën e tyre ishte shenja më e madhe e ngopjes dhe mbushjes, sepse barqet e tyre zakonisht ishin të sheshta dhe të zbrazëta. Kur ngopeshin, barku barazohej me gjoksin. Por kjo gjendje nuk është si ajo

pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën, nuk gjej më vend!" Tha: *"Ma jep atëherë!"* Ia dhashë enën. "Ai falënderoi Allahun, tha 'Bismilah' dhe piu atë që kishte mbetur."[268]

Pejgamberi ynë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* piu atë që kishte mbetur nga qumështi pas banorëve të *Suffa*-s. A ka ndonjë formë të përparësisë, dhembshurisë dhe harmonisë me këta të varfër më madhështore e më të bukur sesa kjo dhembshuri profetike?

6. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mësonte dhe i nxiste ata për të mësuar

Njëri prej tyre rrëfen se na doli i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndërsa ne ishim në *Suffa*, dhe tha: *"Kush prej jush do të donte të nisej çdo ditë në But'han ose në Akik dhe të kthehej prej andej me dy deve të mëdha, pa bërë mëkat dhe pa shkëputur lidhjet farefisnore?"* Ne thamë: "O i Dërguari i Allahut, të gjithë do ta donim këtë!" Tha: *"A nuk do të ishte më mirë që ndonjëri prej jush të shkonte në xhami e të mësonte ose të lexonte dy ajete nga Libri i Allahut të Lartësuar? Kjo është më e mirë për të se sa dy deve; tri ajete janë më të mira se tri deve; katër janë më të mira se katër deve; dhe kështu me radhë, sa më shumë, aq më mirë sesa çdo numër deveje."*[269]

Kjo është një lloj i veçantë i përpjekjes dhe nxitjes, për ta kthyer *Suffa-n* nga një strehë banimi në një rreth diturie dhe shkollë mësimore.

7. Mbetet të dish se ata që ishin në strehimoren *Suffa*, të cilët Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mbështeti dhe i mësoi, koha i kishte harruar dhe askush nuk i njihte, por, më pas, njëri pas tjetrit u bënë prijës në qytete, imamë në vende të ndryshme dhe thirrës në fise të shumta. Të huajt dhe të varfrit u bënë sundimtarë, prijës dhe mësues. Ata ishin fryti i edukimit profetik, i cili i tejkaloi kufijtë e ndihmës dhe strehimit për të arritur në edukim dhe zhvillim. Me këtë, aftësitë u përgatitën dhe energjitë u aktivizuan.

---

e jona sot, ku barqet janë të rrumbullakëta dhe njeriu ndien uri ndërkohë që mban në bark një thes të mbushur me dhjamë të ndenjur.

[268] Buhariu, 6452.

[269] Buhariu, 362. Muslimi, 803.

I varfri nga strehimorja *Suffa*, Ebu Hurejra, u bë udhëheqës i Medinës. Ndërsa Utbe ibn Gazvani, u bë udhëheqës i Basrës dhe në një hutbe tha: "Unë kam qenë i shtati nga shtatë persona me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Nuk kishim tjetër ushqim përveç gjetheve të pemëve, derisa na u gjakosën nofullat tona[270]. E gjeta një rrobë dhe e ndava me Sead ibn Malikun, gjysmën e mbajta unë dhe gjysmën Sead-i. E sot, secili prej nesh është udhëheqës në një vend. Kërkoj mbrojtje tek Allahu që të mos jem i madh në sytë e vetes dhe i vogël në sytë e Allahut."[271] Kështu ishte sjellja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me banorët e *Suffa*-s, një model i marrëdhënies së tij me të varfrit dhe të huajt.

I Dërguari dhe mikpritja

1. Bujaria në mikpritje ishte një zakon i rrënjosur thellë në shoqërinë kurejshite dhe ndër ata që u bënë të njohur për këtë bujari ishin edhe të parët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Gjyshi i tij i largët, Kusaj, vendoste tryeza ushqimi për Haxhinjtë dhe u bë i njohur për këtë. Gjyshi tjetër, Hashimi (*thërrmuesi*), u quajt kështu sepse thërrmonte *therid*-in (ushqim tradicional) për haxhinjtë dhe kjo nofkë dominoi mbi emrin e tij të vërtetë, Menaf. Ndërsa gjyshi i tij, Abdulmutalibi, ishte një nga paria e Mekës si për udhëheqje ashtu edhe për bujari. Ai kishte në përgjegjësi furnizimin me ujë të haxhinjve dhe kjo përgjegjësi mbeti në dorën e bijve të tij pas tij. Pra, familja dhe shtëpia e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* trashëguan mikpritjen bujare dhe u bënë të njohur për të.

Para kësaj, edhe babai i tij, Ibrahimi (*paqja e Allahut qoftë mbi të)* ishte nga njerëzit më fisnik të Allahut për nga bujaria. Allahu ka treguar ngjarjen e mikpritjes së tij ndaj engjëjve që i erdhën në

[270] Na u bënë plagë anët e gojës nga puçrrat dhe ato u çanë. "*Sherhu el Sindi ala Ibn Maxhe*", 2/539.
[271] Muslimi, 2967.

formë njerëzore, kur tha: "***A e ke dëgjuar historinë e mysafirëve të nderuar të Ibrahimit? Ata hynë tek ai e i thanë: "Paqe!" - dhe ai u tha: "Paqe, o njerëz të panjohur!" E pa u vënë re, ai shkoi te njerëzit e shtëpisë dhe solli një viç të majmë. Pastaj ua afroi atyre e u tha: "A nuk po hani?""*** (Edh-Dharijat: 24-27)

Bujarinë e Ibrahimit *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* e shohim te përshkrimi për mysafirët si "*të nderuar*", pastaj përshëndetja e bukur dhe pritja e mirë, më pas largimi i tij në fshehtësi për të sjellë ushqimin e mikpritjes, pastaj afrimi i ushqimit para tyre dhe ftesa për të ngrënë.

Nga ky Pejgamber fisnik erdhi Pejgamberi ynë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i cili ishte pasardhësi më i ngjashëm me të si në pamje ashtu edhe në moral dhe në sjellje.

2. Pastaj, bujaria në mikpritje ishte një cilësi e njohur për të *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* edhe para shpalljes profetike. Prandaj, kur ai u kthye i tronditur nga shpella Hira, Hatixhja i tha atij: "Kurrsesi! Përgëzohu se, për Allahun, Allahu kurrë nuk do të të poshtërojë. Pasha Allahun, ti i mban lidhjet me të afërmit, e flet të vërtetën, e ndihmon të dobëtin, i jep atij që nuk ka, e mikpret mikun dhe i ndihmon nevojtarët."[272]

3. Pastaj, pas shpalljes profetike, bujaria e mikpritjes së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u shtua edhe më shumë, saqë Ibn Abasi e përshkroi kështu: "Ishte më bujar sesa era e që fryn lirshëm gjithandej."

Për këtë arsye, shtëpia e tij ishte vendstrehim për nevojtarët dhe ushqimi i tij ishte sofër për mysafirët - qoftë i pakët apo i shumtë. Ai jepte bujarisht me shumicë kur kishte me shumicë dhe ndante me të tjerët nga pak kur kishte vetëm pak.

Disa nga momentet e bujarisë së mikpritjes së tij:

a) Abdullah ibn Buseri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se i sollën të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* një dele dhuratë, dhe atë ditë ushqimi ishte i paktë. Ai i tha familjes së tij: *"Gatuajeni këtë dele dhe merreni këtë bukë - përshesheni dhe hidhni sipër lëngun."*

[272] Buhariu 3.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte një enë të madhe[273] që quhej *el-Garra'*, të cilën duhej ta mbanin katër burra. Kur erdhi mëngjesi dhe ata kishin falur namazin e duhasë, u soll ajo enë ku ishte përgatitur *theridi (bukë e përsheshur me lëng mishi)* dhe njerëzit u mblodhën rreth saj. Kur u shtua numri i tyre, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u ngushtua pak dhe u ul mbi gjunjë duke ngrënë.

Një beduin e pyeti: "*Ç'është kjo mënyrë uljeje?*" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Allahu më ka bërë një rob fisnik dhe nuk më ka bërë një tiran arrogant.*"

Pastaj tha: "*Hani anash përreth saj dhe lëreni pjesën e mesit që të bekohet.*" Dhe shtoi: "*Merrni dhe hani! Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, do t'ju hapen dyert e Persisë dhe Romës, ushqimi do të shtohet shumë, por emri i Allahut nuk të përmendet në të.*"[274]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u ngushtua dhe u ul mbi gjunjë për të hapur më shumë vend rreth enës së ushqimit, pasi ishin shtuar mysafirët. E bëri këtë nga përulësia ndaj atyre që ishin ulur me të, ndërkohë që një sjellje e tillë nuk ndodh me tiranët dhe arrogantët.

b) Ndonjëherë, ajo që kishte Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte shumë e pakët, por ai ndante edhe nga ajo pakicë, pa u kursyer.

Xhabiri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton: "Isha ulur në shtëpinë time kur nga unë kaloi i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe më bëri shenjë. U ngrita dhe shkova tek ai. Ai më mori për dore dhe ecëm derisa arriti tek një prej dhomave të grave të tij. Hyri brenda, pastaj më lejoi të hyja. Kur hyra, pyeti familjen: "A ka ndonjë gjë për drekë?" Ata thanë: "Po!" Aty i sollën tri copa buke. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori një copë dhe e vuri përpara vetes, mori një tjetër dhe e vuri para meje, pastaj mori të tretën, e ndau në dy pjesë: gjysmën e vuri para vetes, gjysmën para meje. Pastaj pyeti: "*A ka ndonjë gjellë?*" Ata thanë: "Jo, vetëm pak uthull." Ai tha: "*Silleni atë! Uthulla është gjellë e mirë!*

[273] Një enë e madhe që mjaftonte për dhjetë burra. *Taxhu el Arus* 24/5.
[274] Ebu Davudi 3773.

Një shtëpi ku ka uthull, nuk është pa gjellë." Xhabiri thotë: "Që nga ajo ditë, e dua uthullën - që kur e dëgjova këtë nga Pejgamberi i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."*[275]

Këtu shohim se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ftoi i pari Xhabirin dhe e mori me vete nga shtëpia e tij, megjithëse kishte shumë pak ushqim - vetëm tri copa buke. Pastaj, ai e ndau këtë ushqim të pakët në mënyrë që Xhabiri të mos ndjehej në siklet apo në pozitë të vështirë.

c) Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte gjithmonë i kujdesshëm që të nderonte mysafirin dhe të mos e linte pa mikpritje. Kur i vinte dikush, pyeste në shtëpinë e tij për ndonjë ushqim; nëse gjente diçka, e ushqente vetë, e nëse jo, u kërkonte shokëve të tij ta strehojnë mysafirin.

Ndër shembujt e kësaj sjelljeje është rrëfimi i transmetuar nga Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, i cili thotë se një burrë erdhi tek i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe tha: "Jam i lodhur nga uria." Atëherë, i Dërguari i Allahut dërgoi dikë te njëra nga gratë e tij për të pyetur për ushqim. Ajo tha: "Pasha Atë që të ka dërguar me të drejtën, nuk kam tjetër veç ujit." Pastaj dërgoi tek një tjetër, por edhe ajo tha të njëjtën gjë. Të gjitha gratë e tij i thanë njësoj: "Jo, pasha Atë që të ka dërguar me të drejtën, nuk kemi tjetër veç ujit." Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Kush do ta presë këtë mysafir sonte? Allahu e mëshiroftë!"* Një burrë nga ensarët, i quajtur Ebu Talha, u ngrit dhe tha: "Unë, o i Dërguari i Allahut." Pastaj e mori mysafirin dhe shkoi me të në shtëpinë e vet.[276]

Këtu shohim se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dërgoi të pyetej në të gjitha shtëpitë e grave të tij dhe të gjitha kërkuan ndjesë për shkak se nuk kishin asgjë tjetër përveç ujit. Kjo ishte pritshmëria, sepse nëse njëra prej tyre nuk kishte gjë, nuk pritej që të tjerat të kishin, pasi shtëpitë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin si një shtëpi e vetme në thjeshtësi dhe ndarje të mundësive.

[275] Muslimi, 2052.
[276] Muslimi, 2054.

Mirëpo, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e bëri këtë për të theksuar sa shumë përpiqej për nderimin e mysafirit dhe ushqimin e tij. Ai nuk ua kërkoi shokëve të tij mundësinë për të strehuar të ftuarin, derisa të ishte i sigurt që nuk kishte mundësi ta ushqente vetë. Kjo është një formë e lartë e dhembshurisë dhe bashkëndjenjës - është pjesë e atij ushqimi që jepet ***"ose të ushqesh në një ditë zie".*** (El-Beled: 14)

4. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ngushëllonte dhe e çlironte nga sikleti e ndjesia e barrës çdo mysafir që e priste në shtëpi. Ebu Rezin Lakit ibn Sabira el Ukajli *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton: "Isha në mesin e delegacionit të fisit Benu el Muntefik që shkuam te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Kur arritëm, nuk e gjetëm në shtëpi, por gjetëm Aishen, nënën e besimtarëve, e cila urdhëroi që të na përgatitej ushqim *hazira*[277], dhe ajo u përgatit për ne, pastaj na e sollën edhe një pjatë. Kur erdhi i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pyeti: "*A ju është dhënë diçka për të ngrënë? Apo ju është porositur diçka?*" Ne thamë: "Po, o i Dërguari i Allahut!" Ndërkohë që ishim ulur me të, erdhi bariu duke kthyer kopenë e tij në vathë[278] dhe në dorë kishte një qengj që blegëronte[279]. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: "*A ka pjellë ndonjë nga delet sot, o filan?*" Ai tha: Po. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Ther për ne në vend të saj një dele.*" Pastaj u kthye nga ne dhe tha: "*Mos mendoni se e kemi therur delen për ju. Ne kemi njëqind dele dhe nuk duam që të shtohen. Sa herë që lind ndonjë, e zëvendësojmë me një tjetër duke therur një prej tyre.*"[280]

Fjala e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "*Mos mendoni se e kemi therur delen për ju*" është një mënyrë për t'i larguar çdo ndjenjë sikleti që mund të ndjente mysafiri nëse do të mendonte se mikpritësi i tij është munduar dhe është rënduar për të. Kështu, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi*

---

[277] *Hazira* është një lloj ushqimi që përgatitet me mish të grirë që zihet me ujë të bollshëm, pastaj i hidhet miell, nëse nuk ka mish ky lloj ushqimi quhet *Aside* qull. "*El Nihaje*", 2/28.
[278] Vathë-streha e bagëtive në mbrëmje. Shiko: "*El Nihajetu*", 2/273.
[279] "*Mealim el Sunen*", 1/53.
[280] Ebu Davudi, 142.

të) ia hoqi këtë dyshim mysafirit për ta qetësuar shpirtërisht dhe për ta bërë të ndihet rehat, duke sqaruar se therja e deles ishte një gjë e zakonshme për ta, e cila përkoi me ardhjen e tij.

I Dërguari si mysafir

Ndalesa e parë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në Medinë ishte në shtëpinë e Kulthum bin el-Hidmit në Kuba, ku qëndroi katërmbëdhjetë ditë.[281] Aty flinte, ndërsa ditën e kalon në shtëpinë e Sead bin Hajtheme, ku priti ata që erdhën për ta takuar, sepse ai ishte beqar dhe shtëpia ishte më e përshtatshme.

Pastaj, ndalesa tjetër fisnike ishte te Ebu Ejub Halid bin Zejd, ku qëndroi si mysafir për gjashtë muaj, duke ndarë me të shtëpinë dhe ushqimin, derisa u ndërtua xhamia dhe shtëpia e tij.

Vizita e njerëzve në shtëpitë e tyre, pranimi i ftesave të tyre, mikpritja dhe pjesëmarrja në ushqimin që ata ofrojnë janë prej çelësave të zemrave që hapin edhe ato që janë të mbyllura. E si ishte gjendja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur e ftonin shokët e tij? Ai i vizitonte në shtëpitë e tyre, i ngushëllonte zemrat e tyre dhe merrte pjesë në ushqimin e thjeshtë që ata i ofronin?

Nga prezenca e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* si mysafir, në shtëpitë e besimtarëve mësojmë disa gjëra të rëndësishme:

1. Gjerësia e pranimit të ftesave nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në Medinë: Nuk kishte lagje nga lagjet e ensarëve që të mos ishin gëzuar me vizitën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe nderimin e tij në shtëpitë e tyre.

Ndër lagjet periferike të Medinës prej të cilave Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pranoi ftesën e tyre ishte lagjja Benu Seleme, që ndodhej rreth 4 kilometra larg xhamisë së

[281] Ka mendime të ndryshme në numrin e ditëve që qëndroi në Kuba, por ky është një nga mendimet dhe ndoshta më i sakti.

Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ata e ftuan Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i thanë: *"O i Dërguar i Allahut, kemi një deve që duam ta therim dhe dëshirojmë që ti të jesh i pranishëm."* Therja e një deveje ishte një ngjarje festive dhe një rast i madh gëzimi, për shkak të mungesës së mishit në mesin e tyre. Prandaj, ata e ftuan Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që të marrë pjesë me ta dhe të ndajë gëzimin e tyre. Ai tha: *"Po!"* Kur fali namazin e ikindisë, shkoi tek ata dhe gjeti devenë ende të gjallë, pasi ata po prisnin ardhjen e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për ta therur. Pasi e therën, i thanë: *"O i Dërguar i Allahut, ulu që të shijosh nga mishi i saj."* Ata prenë mishin e saj, e gatuan dhe ia shtruan Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i cili hëngri prej tij. Më pas u kthye në Medinë dhe e fali atje namazin e akshamit.[282]

Le të pyesim veten: Çfarë ndjenje përjetuan Benu Seleme kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori pjesë me ta në atë festë, hëngri nga ushqimi i tyre dhe ndau me ta gëzimin e therjes së devesë?

Pa dyshim, ishte një ndjenjë nderimi dhe lumturie e madhe! Ai është Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, të cilit Allahu i kishte dhënë këtë mjeshtëri dhe këtë aftësi për të lumturuar shpirtrat dhe për të hapur drynat e zemrave.

2. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pranonte ftesën nga kushdo që e ftonte, qofshin të vegjël apo të mëdhenj, dhe nuk e përçmonte askënd e as nuk ngrihej mbi askënd kur e ftonin. Në të njëjtën kohë kur ai pranonte ftesat e sahabëve të mëdhenj, gjejmë edhe një grua të moshuar - Mulejka, gjyshja e Enes bin Malikut - e cila e ftoi Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ai shkoi tek ajo, i gëzoi zemrën dhe hëngri nga ushqimi i saj.[283]

Ne mund të pyesim për masën e lumturisë që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* sillte në ato zemra dhe për gëzimin që ajo i jepte atyre shpirtrave.

---

[282] Muslimi, 624.
[283] Buhariu, 380. Muslimi, 658.

3. Shokët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur e ftonin, nuk sforcoheshin me gjëra të vështira për ta apo të lodhshme. Ata thjesht i ofronin çfarë kishin të gatshme. Sepse vetë ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thoshte: "*Edhe sikur të ftohesha në një drekë vetëm me thundrat e bagëtisë, do ta pranoja.*"[284]

Një rrobaqepës e ftoi Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ai shkoi te ai së bashku me Enes bin Malikun. Enesi rrëfen: "*Na shtruan kulaçë elbi dhe një lëng* (supë) *me kungull dhe mish të thatë.*"[285] Kjo ishte mikpritja. Ajo që të habit është se rrobaqepësi, pasi u shërbeu ushqimin[286], u ul dhe vazhdoi të qepte, ngaqë ishte i zënë me punën e vet. Kjo tregon se ai nuk ishte as i frikësuar, as i shqetësuar, e as që ndjente ndonjë drojë prej Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Përkundrazi, ai ndiente gëzim dhe afërsi. Prandaj i mirëpriti dhe u shërbeu, pastaj vazhdoi punën e tij. Mos pyet pastaj se sa shumë ia gëzoi zemrën Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me këtë vizitë!

Njerëz si ky rrobaqepës, rob, ishin të përçmuar ndër arabë - ata nuk pranonin as të uleshin me të. Kurse Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pranoi ftesën e tij, hyri në shtëpinë e tij dhe hëngri nga ushqimi i tij. Kjo është madhështia morale e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

4. Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i vizitonte njerëzit dhe i lumturonte me pjesëmarrjen në ushqimin e tyre, ai i gëzonte edhe më shumë duke u lutur për ta.

Abdullah bin Bisr tregon: "Na vizitoi Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe i ofruam ushqim, nga i cili hëngri. Pastaj i dhamë një pije dhe ai piu prej saj. Kur u ngrit për të dalë, babai im i tha: 'O i Dërguar i Allahut, lutu për ne!' Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lut: "*O Allah, bekoje furnizimin që u ke dhënë, fali ata dhe mëshiroji!*"[287]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkoi edhe te Sead bin Ubade, i cili i shërbeu disa kulaçë elbi. Atëherë,

[284] Buhariu, 2568.
[285] "*El Nihajetu*", 2/96, 4/22.
[286] Buhariu, 2092. Muslimi, 2041.
[287] Muslimi, 2042.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lut me fjalët: *"Agjëruesit çelshin iftar tek ju, njerëzit e mirë ngrënçin ushqimin tuaj dhe engjëjt u lutshin për ju."*[288]

5. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pranoi ftesa si nga muslimanët ashtu edhe nga jomuslimanët. Ai nuk ngurronte të pranonte ftesat e jomuslimanëve kur e ftonin.

Një hebre e ftoi atë për të ngrënë disa kulaçë elbi dhe pak gjalpë ose dhjam i shkrirë që kishte marrë erë nga vjetërsia dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pranoi ftesën.[289]

Kur u çlirua Hajberi, një grua hebreje e ftoi Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për ushqim dhe i ofroi një dele të pjekur, e cila ishte e helmuar. Ai e pranoi ftesën[290] dhe nuk e dinte që ishte e helmuar, derisa hëngri prej saj.

6. Nga etika dhe finesa pejgamberike gjatë vizitave ishte se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kërkonte leje te dera tri herë. Nëse i jepej leje, hynte; përndryshe, kthehej.

7. Nga edukata e lartë e vizitës ishte, gjithashtu, se, kur qëndronte para derës së dikujt, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk qëndronte përballë saj, por largohej disi në të djathtë apo të majtë, në mënyrë që të mos shihte brenda shtëpisë diçka që nuk do të ishte e hijshme të shihej dhe që mund t'i vinte në siklet njerëzit e shtëpisë.[291]

8. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i lumturonte ata që i vizitonte dhe i bënte të ndiheshin se ajo që kishin ofruar e kishte gëzuar atë vërtet.

Një herë ai vizitoi Ebu Hejthem bin el Tijhan bashkë me Ebu Bekrin dhe Umerin. Ky u shërbeu ujë të freskët dhe një degë hurmash që kishte hurma të pjekura, të papjekura dhe të thata. Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u tha shokëve të tij: *"Do të pyeteni për këtë begati në Ditën e Kijametit: hije e freskët, ujë i ftohtë dhe hurma të mira!"*[292]

---

[288] Ebu Davudi, 3854.
[289] Buhariu, 2617. Muslimi, 2190.
[290] Buhariu, 2617. Muslimi, 2190.
[291] Ebu Davudi, 5186.
[292] Tirmidhiu, 2369.

Ai e përshkroi këtë mikpritje të thjeshtë si *"begati"*. E si mund të mos ndjejë gëzim dhe nderim Ebu Hejthem kur dëgjon këtë lavdërim nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për mikpritjen e tij.

Ky është Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - njeriu që i është dhuruar mjeshtëria më e lartë për të lumturuar njerëzit, për t'i bërë zemrat e tyre të ndriçojnë me gëzim dhe për të ndarë me ta momentet e jetës së tyre.

9. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* merrte leje për dikë që i bashkohej në një ftesë pa qenë i ftuar, në mënyrë që të mos vinte në siklet mikpritësin, i cili mund të mos kishte përgatitur ushqim për më shumë njerëz.

Një herë, një burrë nga ensarët, i quajtur Ebu Shuajb, i tha shërbëtorit të tij që punonte kasap: "Na përgatit ushqim, do të ftoj të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vetë i pestë." Ai e ftoi Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bashkë me katër shokë të tjerë. Ndërsa po shkonin, një burrë tjetër u bashkua me ta pa qenë i ftuar. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha mikpritësit: *"Ti na ftove pesë vetë, dhe ky njeri na është bashkuar. Nëse dëshiron, lejoje të hyjë, e nëse dëshiron, lëre jashtë."* Ai tha: "Jo, e lejoj të hyjë."[293]

Ky kujdes ishte i rëndësishëm për kohën kur jetonin ata, kur ushqimi ishte i pakët dhe mikpritësi përgatitej fiks për aq persona sa kishte ftuar. Nëse vinte dikush pa ftesë, kjo mund ta vinte mikpritësin në pozitë të vështirë dhe të mos mjaftonte ushqimi.

Ndërsa nëse rrethanat ndryshojnë dhe njerëzit jetojnë në bollëk dhe janë të lumtur kur dikush u shkon edhe pa ftesë, atëherë gjykimi ndryshon sipas gjendjes dhe zakonit të njerëzve. Në raste të tilla, ai që shkon pa ftesë, nëse pritet me gëzim, shihet, madje, si njeri i nderuar që ka treguar gatishmëri dhe afërsi. Sidoqoftë këtë e përcakton zakoni dhe mundësia e njerëzve.

10. Ishte dashuria e sahabëve për të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që i shtynte ata ta ftonin në shtëpitë

[293] Buhariu, 5434. Muslimi, 2036.

e tyre, të kërkonin bekimin e pranisë së tij dhe të nderoheshin me vizitën e tij. Ndonjëherë, ajo që i nxiste për ta ftuar ishte edhe ndikimi shpirtëror që u linte gjendja fizike e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, siç ndodhi me Ebu Talhën kur e pa bashkë me *banorët e Suffa-s*, apo siç ndodhi me Ebu Shuajb el Ensariji-n.

Një rast prekës është rrëfimi i Xhabirit *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, i cili tregon: "Në ditën e Hendekut punuam për tre ditë duke hapur hendekun pa ngrënë asgjë. Papritur hodha sytë dhe pashë të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që kishte lidhur një gur në bark nga uria. I thashë: "O i Dërguari i Allahut, më lejo të shkoj në shtëpi." Shkova dhe i thashë gruas: "E pashë të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në një uri[294] të thellë. A ke gjë për të ngrënë?" Ajo tha: "Kam pak elb dhe një kec të vogël." E thera kecin dhe ajo bloi elbin. Pasi mishi u fut në kazan dhe brumi u përgatit, shkova te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i thashë në vesh: "O i Dërguari i Allahut, kam një ushqim të thjeshtë. Ejani ti me një ose dy veta." Ai më pyeti: "Sa është?" I tregova. Ai tha: "Shumë mirë, mjaftueshëm e mirë." Pastaj më tha: "Thuaji gruas të mos e heqë kazanin nga zjarri, e as bukën nga magjja, derisa të vij." Më pas Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thirri: *"O njerëz të hendekut! Xhabiri ka përgatitur një ushqim[295], ejani të gjithë!"* Dhe u ngritën muhaxhirët dhe ensarët bashkë me të. I thashë gruas: "Mjerë unë! Erdhi i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me të gjithë Muhaxhirët, ensarët dhe ata që janë me ta!" Ajo më tha: *"Ti vetë e bëre këtë!"* Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri i pari dhe u tha shokëve: *"Hyni dhe mos u ngjishni mes vete."*

Unë ia solla brumin dhe ai fryu mbi të dhe u lut për bereqet. Pastaj shkoi te kazani, i fryu dhe u lut. Pastaj tha: *"Thirr furrtarë që të më ndihmojë."* Pastaj filloi të thyente bukën, i vinte sipër mishin dhe u jepte shokëve. Sa herë që merrte bukën dhe mishin, e mbulonte enën. Ai vazhdonte vetë të thyente bukën, të merrte mishin

[294] *"Fet'h el Bari"*, 1/114.
[295] *"Fet'h el Bari"*, 6/213.

dhe t'ua ndante njerëzve. Ata ishin një mijë vetë - dhe, pasha Allahun, të gjithë hëngrën e u ngopën dhe kur u larguan, kazani vazhdonte të vlojë si më parë dhe buka vazhdonte të piqej. Pastaj i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Hani dhe shpërndani të tjerëve, sepse njerëzit janë prekur nga uria."*[296]

Në tregimet e Ebu Talhas dhe Xhabirit *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* shohim se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ftoi një numër të madh njerëzish, edhe pse nuk ishin ftuar nga mikpritësi. Kjo nuk ishte për të vënë në siklet mikpritësin, por sepse ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e dinte mirë gjendjen e vështirë të njerëzve dhe ishte i sigurt për bekimin hyjnor që Allahu do të zbriste mbi atë ushqim, saqë një sasi e vogël do të mjaftonte për një numër të madh njerëzish. Kjo ishte një nga mrekullitë e Allahut për Pejgamberin e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, e cila ndodhi përpara sahabëve, nën dëgjimin dhe shikimin e tyre, që besimtarët të forcoheshin më shumë në besim, të shtohej bindja e tyre dhe të kishte qëndrueshmëri në sprova e vështirësi.

Allahu thotë: ***"Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër, kurse keqbërësit i shpie në humbje; Allahu bën ç'të dojë."*** (Ibrahim: 27)

Po ashtu, shohim të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që merrte pjesë vetë, personalisht, në ndihmën e atyre që e kishin ftuar, bashkohej me ta në përgatitjen e ushqimit dhe në shërbimin ndaj të ftuarve, si një prej njerëzve të shtëpisë. Sa gëzim dhe sa lumturi do t'i kishte kapluar ata të bekuar njerëz, kur e shihnin të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që lëvizte mes tyre me dorën e tij të bekuar, duke përzier, përgatitur dhe shërbyer, bashkë me ta - ndihmë dhe bereqet!

[296] Buhariu, 4121. Muslimi, 2039.

I Dërguari dhe sahabët

Së pari: ***Sahabë***, sa shumë më ka ndalur ky titull fisnik si dhe domethënia që ai përmban dhe inspirimi që jep: sahabët e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Ky emërtim i nderuar ka një kuptim që përcjell: pavarësi dhe një personalitet i qëndrueshëm pranë Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ata nuk janë përshkruar si ndjekës, as si kërkues *muridë*, e as si nxënës, por si *sahabë* shoqërues që janë me të: ***"Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të..."*** (El-Fet'h: 29)

Emrin e tyre ua zgjodhi vetë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, si një medalje nderi dhe titull nderi. Ai qëndroi pranë varreve të shokëve të tij në Bekia, i përshëndeti ata dhe u lut për ta, pastaj tha: *"Do të doja t'i kishim parë vëllezërit tanë."* Shokët e tij që ishin me të i thanë: "A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguar i Allahut?" Ai tha: *"Ju jeni As'habët - shokët e mi, ndërsa vëllezërit tanë janë ata që nuk kanë ardhur ende."*[297]

Ashtu siç i quajti ata: s*ahabë* - shokë të tij, edhe veten e quajti shoku i tyre, kur tregoi se kujt i ngjante Ibrahimi *(paqja e Allahut qoftë mbi të)*, duke thënë: *"Kurse Ibrahimi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) shikoni shoku tuaj* (pra, po i referohej vetes së tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)."[298]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* sillej me shokët e tij ashtu siç kishte edhe kuptimin vetë fjala *sahabë* shoqëri dhe miqësi, të cilën Allahu e përshkruan me përmasat e saj në fjalën e Tij: "***Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta*** (o Muhamed)**. *Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai."*** (Ali Imran: 159)

[297] Muslimi, 249.
[298] Buhariu, 3355. Muslimi, 166.

Ky ajet, ashtu siç është lavdërim për moralin e lartë profetik në marrëdhëniet me shokët, gjithashtu, është lavdërim për personalitetet e shokëve (të tij), sepse, po të ishin trajtuar me ashpërsi, do të ndiheshin të fyer dhe do të largoheshin - kjo për shkak të plotësisë së personaliteteve të tyre dhe faktit se ata e ndoqën Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me besim dhe bindje, e jo nga dhuna apo detyrimi. Prandaj ata ishin rreth tij me personalitetin e tyre të plotë.

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u hapi atyre horizontet e aftësisë dhe fuqisë vepruese. Secili prej tyre ishte i pranishëm me qëndrueshmëri. Asnjëri nuk qe i nënvlerësuar në personalitet apo i shtypur në dhuntitë e tij. Edhe pse ishin përreth Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, rrezatimi i diellit të tij nuk e shoi dritën e yjeve të tyre.

Kjo është ndryshe nga ajo që e sheh te shumë udhëheqës, të cilët e shuajnë aftësinë e atyre përreth tyre, i thithin fuqitë e tyre dhe i shkrijnë në personalitetin e udhëheqësit.

Ndërsa shokët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, vetë praninë e tyre rreth tij e kishin si një mundësi për të nxitur dhuntitë dhe veçantitë e tyre, për të vepruar me tërë kapacitetin e tyre dhe me pjesëmarrje të gjallë e të dalluar në jetën e tij.

Secili kishte rrugën dhe dhuntitë e tij, aq sa e shohim Selman el Farisiun - ende i freskët në përjetimin e lirisë - duke marrë pjesë në dhomën e komandës përpara betejës së Hendekut, e duke dhënë një ide ushtarake, e cila u miratua dhe u zbatua. Dhe kjo nuk e zbehu as personalitetin e tij e as mendimin e tij.

Njëherë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kaloi nëpër rrugë pranë një grupi prej shokëve të tij që ishin ulur në një oborr anës rrugës. Ai u tha: *"Ruajuni nga të ndenjurit në rrugë!"* Ata i thanë: "O i Dërguar i Allahut, nuk mundemi pa këto ndeje, aty bisedojmë!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Nëse këmbëngulni të rrini* (në rrugë)*, atëherë jepjani rrugës të drejtën e saj."* Ata pyetën: "Cila është e drejta e saj?"

Ai tha: "*Ulja e shikimit, përmbajtja nga shqetësimi i të tjerëve, kthimi i selamit, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.*"[299]

Ky dialog tregon se si shokët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin në një komunikim të gjallë dhe të hapur me të, si reagonin dhe bashkëvepronin me udhëzimet që merrnin prej tij. Ata shprehën mendimin e tyre dhe kuptuan se ky ndalim *i qëndrimit në rrugë* nuk ishte qëllim në vetvete, por kishte një arsye pas tij. Prandaj ata dhanë mendimin e tyre dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pranoi dhe u përgjigj me përcaktimin e disa rregullave për këtë situatë.

E njëjta gjë ndodhi me Hubab ibn el Mundhirin, ditën e Bedrit, kur i tha Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* se vendi ku ishin pozicionuar nuk ishte më i përshtatshmi dhe i propozoi që të pozicionohen pranë ujit që ishte më afër armikut, për ta penguar atë të merrte ujë. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pranoi dhe e miratoi mendimin e tij.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e nxiste pavarësinë e personalitetit te shokët e tij përmes këshillimit të shpeshtë me ta. Ebu Hurejre thotë: "Askush nuk i këshillohej më shumë me shokët e tij sesa i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).*"[300]

Së dyti: Ne shohim se shokët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, që prej fillimit të thirrjes islame[301], ishin nga etni, fise dhe vende të ndryshme. Ndër ta kishte banorë qytetesh dhe beduinë. Kështu, shokët përbënin një përfshirje ndërkombëtare që nga fillimet e hershme të thirrjes dhe rrezatimit të saj. Kjo larmi u shtua më shumë pas *Hixhretit*, ku "*Suffa*" grumbullonte njerëz të ardhur nga fise të ndryshme. Më pas, pas çlirimit (të Mekës), Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* filloi të priste delegacione nga çdo cep i Gadishullit Arabik.

---

[299] Muslimi, 2121.

[300] Tirmidhiu, 1714.

[301] Dr. Mehmet Efendioğlu ka një studim rreth Sahabëve jo arab me titull *"Arap Olmayan Sahabiler"*, ku përmend se 45 ishin nga Etiopia, 17 nga Persia, 8 nga koptët e Egjiptit, 7 nga romakët dhe 43 nga hebrenjtë.

Me gjithë këtë shumëllojshmëri, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përfshiu të gjithë në mënyrë të plotë dhe i përqafoi me dhembshuri e kujdes, pa e ndier askush veten të huaj apo të larguar në praninë e tij.

Së treti: Prania e gjallë dhe e vazhdueshme e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në jetën e tyre. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* merrte pjesë me ta në gëzimet, dhimbjet dhe trishtimet e tyre. Kush e sodit gjendjen e tij në komunikimin me shokët dhe në përfshirjen e tij në jetën e tyre, ndien sikur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte tërësisht i përkushtuar ndaj tyre, me gjithë kohën dhe shpirtin e tij. Ai i vizitonte vetë, pranonte ftesat e tyre, merrte pjesë në gëzimet e tyre.

Nga këto pjesëmarrje në gëzime është ajo që tregon Ebu Usejd el Saidi, i cili kishte ftuar Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në dasmën e tij: "Ishte gruaja ime që u shërbeu atyre atë ditë dhe ajo ishte nusja. A e dini çfarë përgatiti për të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*? Ajo i kishte njomur disa hurma qysh nga mbrëmja në një enë me ujë!"[302]

Shiko sa e thjeshtë ishte jeta me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - një dasmë ku shërbyese është vetë nusja dhe gostia është hurma të njomura në ujë!

Po ashtu, Rabije bint Muavidh ka treguar: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri tek unë në mëngjesin kur u martova[303] me burrin tim. U ul në shilte dhe disa vajza të vogla po i binin daulleve dhe këndonin për të lavdëruar familjarët e mi që kishin rënë dëshmorë në Betejën e Bedrit."

Ashtu siç i gëzonte me pjesëmarrjen e tij në gëzimet e tyre, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i shoqëronte edhe në dhimbje dhe i vizitonte në sëmundjet e tyre. Xhabir ibn Abdullah *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* ka treguar: "U sëmura rëndë dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi të më vizitonte bashkë me Ebu Bekrin dhe të dy po ecnin në këmbë. Më gjetën pa ndjenja. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori

[302] Buhariu, 5183. Shiko dhe *"El Nihajetu"*, 1/199.
[303] Mëngjesin pas dasmës

abdes dhe e derdhi ujin e abdesit mbi mua, e unë u zgjova. Kur hapa sytë, pashë të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*." [304]

Imagjino pak ndjenjat e Xhabirit dhe emocionet e tij kur ai zgjohet nga të fikët, e gjen Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pranë vetes dhe rrezet e fytyrës së tij e përshkojnë.

Transmetohet nga Abdullah ibn Umeri (*Allahu qoftë i kënaqur me ta)* se ka thënë: "Sead ibn Ubade ishte sëmurë rëndë. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkoi ta vizitonte bashkë me Abdurrahman ibn Aufin, Sead ibn Ebi Vekasin dhe Abdullah ibn Mesudin *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)*. Kur hyri tek ai, e gjeti të shtrirë mes njerëzve të familjes së tij. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pyeti: "*A ka vdekur?*" Ata thanë: "*Jo, o i Dërguari i Allahut!*" Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shpërtheu në lot. Kur njerëzit panë të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke qarë, gjithashtu, edhe ata shpërthyen në lot."[305]

Imagjino ndjenjat e Sead ibn Ubades kur ai zgjohet nga paqëndrueshmëria e sëmundjes dhe mëson se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kishte vizituar vetë dhe se lotët e tij ishin derdhur nga mëshira për të. Po çfarë ndikimi do të kishte ky moment për fëmijët dhe të afërmit e Seadit? Janë pamje që rrëmbejnë zemrat...

Ndjenjat e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin, gjithashtu, në harmoni me gëzimet dhe festat e tyre - ai gëzohej për ta dhe lumturia reflektohej në fytyrën e tij. Kur Allahu pranoi pendimin e Ka'b ibn Malikut pas vonesës së tij për të marrë pjesë në ekspeditën e Tebukut, Ka'bi u drejtua menjëherë drejt xhamisë së të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për t'i dhënë selam.

Ai (Ka'bi) tregon: "Kur i dhashë selam, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më tha: "*Përgëzohu me ditën më të mirë që ke*

[304] Buhariu, 5651. Muslimi, 1616.
[305] Buhariu, 1304. Muslimi, 924.

kaluar që kur të lindi nëna jote!" Unë e pyeta: "A është kjo nga ti, o i Dërguari i Allahut, apo nga Allahu?" Ai tha: *"Jo, është nga Allahu!"*

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, kur gëzohej, i ndriçohej fytyra, saqë dukej sikur fytyra e tij ishte një copë hëne. Dhe ne e njihnim këtë gjendje në të."[306] Ky gëzim i shndritshëm në fytyrën e tij ishte shprehje e një gëzimi të thellë për ta.

Kjo ndërthurje emocionale mes tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe shokëve të tij bëri që gëzimet dhe hidhërimet e tij të ishin me ta dhe për ta.

Përshkrimi më gjithëpërfshirës i pranisë së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në jetën e shokëve të tij, shkrirjes së tij mes tyre dhe kujdesit ndaj çështjeve të tyre, është ajo që na tregon Uthmani *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*: "Ne, pasha Allahun, e kemi shoqëruar të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në udhëtim dhe në qëndrim. Ai na vizitonte kur sëmureshim, merrte pjesë në varrimet tona, dilte në beteja me ne dhe na ndihmonte si me pak ashtu edhe me shumë."[307]

Së katërti: Prania e tyre në jetën e tij nëpërmjet interesimit dhe kujdesit të tij për ta.

Ti vërtetë do të habitesh nga numri i madh i angazhimeve të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, madhësia e përgjegjësive të tij dhe numri i madh i shokëve që e rrethonin, e megjithatë ai pyeste për ata që mungonin dhe kujdesej për ata që nuk i shihte.

Kështu, kur doli për në Tebuk bashkë me tridhjetë mijë vetë dhe arriti atje, pyeti: *"Çfarë bëri Ka'b ibn Maliku?"*[308]

Ndërsa, gjatë Haxhit të Lamtumirës, ku e shoqëronin mbi njëqind mijë vetë, vuri re mungesën e Sead ibn Ebi Vekasit. Ai e vizitoi atë ndërsa ishte i sëmurë, u lut për të dhe e përgëzoi me lajme të mira.[309]

---

[306] Buhariu, 4418. Muslimi, 2769.
[307] Ahmedi, 504.
[308] Buhariu, 4418. Muslimi, 2769.
[309] Buhariu, 1628. Muslimi, 1616.

Muavije ibn Kurra tregon se babai i tij, ka thënë: "Pejgamberi i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, kur ulej, mblidheshin rreth tij disa prej shokëve të tij. Midis tyre ishte një burrë që kishte një djalë të vogël, i cili vinte nga pas shpinës së tij dhe ai e ulte në prehër, përballë vetes." Pastaj (ky djalë) ndërroi jetë dhe burri u ndal së ardhuri në rrethin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ngaqë i sillte ndër mend të birin dhe i shtohej mërzia për të.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e vërejti mungesën e tij dhe tha: *"Ç'ka që nuk po e shoh filanin?"* Ata thanë: "O i Dërguar i Allahut, djali i tij i vogël që ti e shihje, ka vdekur."

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e takoi atë burrë, e pyeti për djalin e tij dhe ai e informoi se kishte ndërruar jetë. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ngushëlloi për të dhe pastaj i tha: *"O filan, cili prej këtyre dy gjërave do të ishte më i dashur për ty: që ta kishe pranë vetes të gjithë jetën tënde dhe të kënaqesh me të, apo që kur të vish nesër te secila derë prej dyerve të Xhenetit, ta gjesh atë që ka arritur para teje dhe po ta hap derën?"* Tha ai: "O Pejgamber i Allahut! Më e dashur për mua është që ai të më paraprijë drejt derës së Xhenetit dhe ta hapë atë për mua." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Atëherë, ajo do të jetë për ty!"*[310]

Shih si e vërejti mungesën e tij kur nuk erdhi dhe pyeti për të. Pastaj, kur e takoi, e pyeti vetë, e ngushëlloi për djalin e tij, e përkrahu dhe e përgëzoi me shpërblim dhe kompensim të madh.

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u kthye nga Haxhi i Lamtumirës, i erdhi në takim nëna e Meakilit, pasi i dha selam, ai i tha: *"O nëna e Meakilit! Çfarë të pengoi që të dalësh me ne?"* Ajo tha: "O i Dërguar i Allahut, u përgatitëm për të dalë, por babai i Meakilit vdiq dhe ne kishim vetëm një deve me të cilën bënim Haxhin. Ai e la me amanet që ajo të përdoret në rrugë të Allahut." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Po pse nuk dole me atë, sepse Haxhi është në rrugë të Allahut! Tani*

[310] Nesaiu, *"El Sunen el Kubra"*, 2088.

që ti e humbe këtë Haxh me ne, atëherë bëj një Umre në Ramazan, sepse ajo është sa një Haxh."[311]

Tani, imagjino ndikimin e pyetjes së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për Um Ma'kil: *"Pse nuk bëre Haxh me ne?"* Si mund ta ketë ndier veten ajo, kur ai e kishte vërejtur mungesën e saj, edhe pse ishte i rrethuar nga mijëra njerëz që e shoqëronin? Si e ndjeu ai mungesën e saj, edhe pse ishte i ngarkuar me çështjet e të gjithë njerëzve? E tani, ja ku është, duke e pyetur personalisht.

Unë nuk mund ta përfytyroj gëzimin dhe krenarinë e saj për këtë pyetje dhe çfarë ndjenje kujdesi e ndershmërie ndjeu ajo nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Kjo është mjeshtëria profetike në dhënien e rëndësisë për çdo person - aq sa edhe një grua nga masa e gjerë e muslimanëve ndien se ajo ka vend në kujdesin, interesimin dhe vëmendjen e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Askush në jetën e tij nuk ishte i shpërfillur apo i lënë pas dore!

Së pesti: Përfshirja e të gjithëve në jetën e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe gjerësia e jetës së tij, saqë përfshinte të vegjlit e të mëdhenjtë, i mbështeste të dobëtit dhe të varfrit, i përkrahte të mjerët dhe i përfshinte të gjithë me mirësinë dhe bamirësinë e tij. Asnjëri prej tyre nuk ndiente ndonjë përjashtim, margjinalizim apo ndjenjë nënvlerësimi, pavarësisht statusit të tij.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thoshte: *"A nuk po ndihmoheni dhe po furnizoheni veçse për shkak të të dobëtëve tuaj?"*[312]

Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton: "Shërbëtorja më e thjeshtë nga shërbëtoret e Medinës, e kapte për dore të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe e shoqëronte me vete ku të donte ajo."[313]

Së gjashti: Kujdesi i madh i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për ruajtjen e marrëdhënieve të sahabëve dhe mbrojtjen e tyre nga ndasitë dhe konfliktet.

---

311 Ebu Davudi, 1989.
312 Buhariu, 2896.
313 Buhariu, 6072.

Prandaj, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* angazhohej personalisht në pajtimin mes tyre. Një njeri erdhi te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i tha: *"Fisi i Benu Amr ibn Auf është përplasur dhe kanë hedhur gurë ndaj njëri-tjetrit."* Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli menjëherë tek ata për të bërë pajtimin mes tyre.

Kjo tregon nxitimin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të ndërmjetësuar në paqe, edhe pse ata ishin në një vend të largët. Vendbanimi i fisit Benu Amr ibn Auf ishte në Kuba, në jug të Medinës, mjaft larg nga xhamia e tij.

Dhe kjo ndodhi ishte iniciativë e vetë Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të parandaluar përshkallëzimin e mosmarrëveshjes dhe përkeqësimin e armiqësisë.

Ka'b ibn Maliku i kërkoi borxhin që i kishte dhënë Ibn Ebu Hadredit, ndërkohë që ishin në xhami, dhe zëri i tyre u ngrit aq shumë saqë e dëgjoi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndërsa ishte në shtëpinë e tij. Ai doli dhe hapi perden[314] e dhomës së tij dhe thirri: *"O Ka'b!"* Ai u përgjigj: "Urdhëro, o i Dërguar i Allahut!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Lë diçka nga borxhi yt për këtë."* Dhe i bëri me shenjë që të falte gjysmën. Ai tha: "E bëra, o i Dërguar i Allahut!" Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Çohu dhe paguaje."*[315]

Së shtati: Ngritja e vlerës së shokëve të tij, ruajtja e pozitës së atyre që patën përparësi dhe pjesëmarrje të hershme dhe mbrojtja e tyre që të mos dëmtohen apo nënvlerësohen nga askush.

Aidh ibn Amr transmeton se Ebu Sufjani kaloi pranë Selmanit, Suhejbit dhe Bilalit, të cilët ishin së bashku me një grup tjetër njerëzish. Ata thanë: "Pasha Allahun, nuk kanë goditur shpatat e Allahut në qafën e armikut të Allahut siç duhej." (Ebu Sufjani akoma nuk kishte hyrë në Islam.)

Ebu Bekri u tha atyre: "A thoni kështu për plakun e Kurejshit dhe zotërinë e tyre?" Pastaj shkoi te Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i tregoi për këtë. Ai *(paqja dhe mëshira e*

[314] "*El Nihajetu*", 2/343.
[315] Buhariu, 457. Muslimi, 2504.

Allahut qofshin mbi të) i tha: *"O Ebu Bekr! Ndoshta i ke zemëruar ata. Nëse i ke zemëruar ata, atëherë me të vërtetë ke zemëruar Zotin tënd."* Atëherë, Ebu Bekri shkoi te ata dhe u tha: "O vëllezërit e mi! A ju kam zemëruar?" Ata i thanë: "Jo! Allahu të fal ty, o vëllai ynë!"[316]

Së teti: Nga rezultatet e kësaj përkujdesje dhe këtij përkushtimi të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj shokëve të tij, ishte prania e tij e fortë në jetën e tyre dhe thellësia e lidhjes së tij në zemrat e tyre.

Ajo që e preokuponte atë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i shqetësonte edhe ata. Ajo që e brengoste atë, i brengoste edhe ata.

Ndër dëshmitë e kësaj është rrëfimi i Umerit me fqinjin e tij Ensarij. Ai thotë: "Unë dhe një fqinj imi nga ensarët i ndërronim ditët për të zbritur te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e për të mësuar prej tij. Një ditë shkoja unë dhe një ditë ai. Kur shkoja unë, i tregoja çfarë kishte ndodhur atë ditë nga shpallja dhe ngjarjet, dhe kur shkonte ai, më tregonte mua."

"Një ditë kishim folur se fisi Gasanë po ju mbathte potkonjtë kuajve në përgatitje për të na sulmuar, shoku im zbriti ditën që kishte radhën dhe u kthye në mbrëmje dhe trokiti fort në derën time. Tha: "A je duke fjetur?" U tremba dhe dola. Tha: "Ka ndodhur një çështje e madhe!" I thashë: "A kanë sulmuar Gasanët?" Tha: "Jo, por diçka më e rëndë dhe më e madhe - i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i ka ndarë gratë e tij.'"

Unë thashë: "Humbi Hafsa dhe dështoi!"

Ky ishte preokupimi i tyre për qëndrueshmërinë e shtëpisë së Profetit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Prandaj, kur menduan se ai i kishte ndarë gratë e tij, kjo iu duk më e rëndë se sa një sulm nga Roma apo nga Gasani. Ishte një pikëllim i përgjithshëm për të gjithë.

Prandaj, biseda e tyre pas ndarjes së tij nga kjo botë ishte rreth tij:

"Isha me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)..."*

[316] Muslimi, 2504.

"Na tha i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)..."*

"Doli para nesh i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)..."*

"E pashë të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)..."*

Ndjenjat e tyre mbetën të lidhura me të. Malli i tyre ishte i drejtuar nga ai. Gjuhët e tyre vazhdonin ta përmendnin atë.

Kur Ebu Bekri mbajti një hytbe në *minberin* e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, tha: "Qëndroi ndër ne i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* një vit më parë..." - dhe tre herë e ndërpreu fjalën nga të qarit.

Ndërsa Amr ibn Mejmuni tregon: "Rrallë ndodhte që të më kalonte një pasdite e së enjtes pa e vizituar Ibn Mesudin. Nuk e kisha dëgjuar asnjëherë të thoshte: "Ka thënë i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*...", por një mbrëmje, kur ishte në këmbë, me këmishën e zbërthyer, me sytë e mbushur me lot dhe me damarët e fryrë në qafë, tha: "Pak a shumë kështu, apo përafërsisht kështu, apo ngjashme me këtë."[317]

Shiko gjendjen e Ibn Mesudit - si prekej nga përmendja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, frikën dhe respektin që kishte për fjalët e tij dhe sa thellë ndikohej.

E nënta: Ata flisnin për kujtimet e tyre me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* sikur ende t'i jetonin dhe e ndjenin ëmbëlsinë e asaj kohe.

Nga Rafi ibn Amr el Muzeni transmetohet: "Erdha me babanë tim, ndërsa isha ende djalosh në Haxhin e Lamtumirës. E pamë të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke mbajtur Hytben mbi një mushkë me ngjyrë gri, ndërsa Ali ibn Ebi Talibi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* e përkthente për njerëzit (nga arabishtja në dialektin e fiseve të tjera). Njerëzit disa ishin ulur dhe disa në këmbë. Babai im u ul dhe unë depërtova mes kafshëve derisa arrita te mushka. E kapa frerin e saj dhe vendosa dorën time mbi gjurin e tij, pastaj e zbrita dorën ngadalë mbi kërcirin e tij deri

[317] Ibn Maxhe, 23.

te këmba dhe futa dorën time midis sandales dhe shputës së tij. Dhe sot, më duket sikur ende e ndiej freskinë e këmbëve të tij në pëllëmbën time."[318]

Nga Safija bint Bahra transmetohet: "E kam parë Ebu Mahdhuren *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, kur ulej, i lëshonte flokët e mbi-ballit[319] për tokë." Dikush e pyeti për këtë, dhe ai tha: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më fërkoi kokën me dorën e tij dhe unë nuk e qeth kurrë vendin ku ka vendosur dorën e tij i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*."[320]

E dhjeta: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i ngarkoi ata me përgjegjësinë e misionit për të cilin ishte dërguar, derisa jeta e tyre u bë si vazhdim i jetës së tij.

Ata u përkushtuan në përçimin e fesë së tij, përhapjen e mesazhit të tij dhe ruajtjen e trashëgimisë së tij. Pastaj e transmetuan këtë trashëgimi ashtu siç e kishin kuptuar dhe përjetuar: jeta e tyre u bë vëzhgim i jetës së tij, kujdes për Sunetin e tij dhe madhërimin e ligjeve të tij, kështu që ata e transmetuan Sunetin e tij ashtu siç e kishin dëgjuar, së bashku me madhërimin ndaj tij dhe bashkë me fenë bartën edhe nderimin për të. Ata ishin përfaqësuesit më të mirë të të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe lajmëtarët më të denjë për të.

Nga Ibn Umeri transmetohet: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Mos i pengoni shërbëtoret e Allahut që të falen në xhami.*" Njëri nga djemtë e tij tha: "Ne do t'i pengojmë ato." Atëherë, ai u zemërua shumë dhe tha: "Po të tregoj fjalën e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ti më thua: "Ne do t'i pengojmë ato?!"[321]

Ky nderim i thellë ndaj pozitës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndaj fjalës dhe Sunetit të tij, tregon madhështinë e pozitës që zinte ai në zemrat e shokëve të tij. Kjo

[318] Taberani, "*El Muaxhemu el Kebiru*", 4458.
[319] "*Fet'hu el Bahri*", 6/596.
[320] "*Ahbaru Mekete* el Fakihiju", 1312.
[321] Muslimi, 442.

ishte një dashuri e shkrirë me respekt, një guxim për fenë e tij dhe një xhelozi për Sunetin e tij.

Allahu i Madhërishëm thotë: "***Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit!***" (El-A'raf: 157)

I Dërguari dhe gabimtarët

Abdullahu e donte të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me dashurinë më të fortë që mund të ketë njeriu. Për shkak të kësaj dashurie, ai dëshironte që çdo ushqim që shihte të hynte në Medinë, t'ia ofronte të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ndonjëherë, kur ndonjë beduin sillte një enë[322] me gjalpë ose mjaltë, ai e merrte prej tij dhe ia dhuronte Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Pastaj, kur vinte pronari për t'i kërkuar pagesën, ai e çonte te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i thoshte: "*Jepi këtij njeriut çmimin e mallit.*"

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i thoshte: "*A nuk ma dhurove mua atë?*" Ai përgjigjej: "Po, o i Dërguar i Allahut, por nuk kam para ta paguaj."[323] Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vetëm qeshte me të dhe urdhëronte që të paguhej çmimi për të.

Kjo shaka e lehtë dhe plot butësi pasqyron afërsinë shpirtërore dhe shoqërimin e bukur mes tij dhe të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Ky Abdullahu ishte i sprovuar me pirjen e verës; ai pinte shpesh dhe shumë herë e sillnin te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të dehur dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëronte që të dënohej me rrahje. Një ditë,

[322] Enë prej lëkure. "*El Nihajetu*", 3/284.
[323] Ebu Jeala, "*Musned*", 127.

pasi e sollën sërish në atë gjendje dhe ai u ndëshkua, një nga sahabët tha: "O Allah, mallkoje, sa shpesh që sillet këtu!"

Por i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kundërshtoi këtë fjalë dhe tha: *"Mos e mallkoni atë! Pasha Allahun, unë e di se ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Mos u bëni ndihmës të shejtanit kundër vëllait tuaj."*[324]

Ky qëndrim profetik na ofron orientime profetike për mënyrën e trajtimit të gabimit dhe atyre që gabojnë.

Prej tyre janë:

Së pari: Të habit dhe të prek ky afrim, madje përzierje shpirtërore, mes këtij sahabiu - megjithëse ai kishte rënë në një gabim - dhe të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Është një afërsi, dashuri, shaka dhe butësi. Kjo na zbulon se në shoqërinë profetike nuk kishte ndarje klasore apo izolim të ndokujt për shkak të ndonjë faji që kishte bërë. Përkundrazi, ishte një përfshirje dhe përzierje e natyrshme midis tyre, ndonëse me nivele të ndryshme në mirësi: kishte prej atyre që konkurronin në mirësi, kishte prej atyre që ishin mesatar dhe kishte edhe nga ata që i bënin padrejtësi vetes së tyre.

Megjithatë, askush nuk përjetonte përçmim, fyerje apo përjashtim. Në vend të kësaj, mbizotëronte afërsia dhe përfshirja. Kështu, gabimet që ndodhnin tek ndonjëri prej tyre mbeteshin me ndikim dhe pasoja të kufizuara.

Së dyti: Vështrimi i hapësirës pozitive në shpirtin e Abdullahut - dashuria e tij për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Kjo nuk është një virtyt i veçantë vetëm për Abdullahun, por është cilësi e përbashkët e çdo besimtari, sepse nuk ka besim të vlefshëm pa dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

Megjithatë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e nxori në pah këtë cilësi dhe e lavdëroi atë për të. Imagjino tani ndjesinë e Abdullahut kur i arrin fjala e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të - çfarë gëzimi dhe ngritjeje do të ndiente në zemrën e tij nga një fjalë e tillë!

[324] Buhariu, 6780.

Ashtu siç ndodhi edhe me Hatib ibn Ebi Beltean, kur ai deshi të nxirrte një sekret ushtarak tek mekasit para çlirimit të Mekës dhe Umeri tha: "Më lejo t'ia pres kokën këtij hipokriti!" Por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia ktheu: *"Ai mori pjesë në Bedër! E ku e di ti? Ndoshta Allahu i Lartësuar ka hedhur vështrimin e Tij mbi pjesëmarrësit e Bedrit dhe ka thënë: "Veproni ç'të doni, unë ju kam falur."*[325]

Kështu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përmendi veprën e tij të madhe, pjesëmarrjen dhe luftën e tij në rrugën e Allahut dhe nxori në pah vlerën e madhe të mirësisë në shpirtin e tij - e cila as nuk mbulohet dot dhe as nuk mund të harrohet për asnjë gabim.

Së treti: Ky mëkat - pirja e verës - është një gabim i qartë dhe, madje, një nga mëkatet e mëdha (kebair), ku nuk ka vend për interpretim apo lehtësim. Bëhet fjalë për verën, e cila u mallkua nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* së bashku me dhjetë persona[326] të tjerë.

Megjithatë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që urdhëroi të ndëshkohet për pirjen e verës, ruajti të drejtën që ndaj tij të mos tejkalohej dënimi ligjor dhe e konsideroi këtë si ndihmë të shejtanit ndaj tij.

Së katërti: Ndoshta në trajtimin e disa gabimeve, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përdorte një dozë të ashpërsisë dhe tregonte ndjeshmëri të fortë që tregonte rëndësinë e gabimit. Por kjo nuk bëhej për çdo gabim e për çdo gabimtar, por vetëm për gabime të mëdha dhe me ata që kjo do të ndikonte pozitivisht dhe nuk do t'i largonte.

Nga këto është edhe rasti i tij me Usama bin Zejdin, kur ai vrau një njeri nga politeistët, pasi ai kishte deklaruar fjalën: *"Nuk ka zot tjetër përveç Allahut."* Kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori vesh këtë, e thirri dhe i tha: *"O Usama! E vrave atë pasi tha: "Nuk ka zot tjetër përveç Allahut?"* Usama u përgjigj: "O i Dërguar i Allahut, ai e tha këtë nga frika e armëve

[325] Buhariu, 4890. Muslimi, 2494.
[326] Ebu Davudi, 3674.

dhe vdekjes." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*Vallë, ia ke hapur zemrën e tij që ta dish nëse e tha për këtë arsye apo jo? Si do të veprosh me fjalën 'nuk ka zot tjetër përveç Allahut', kur të vijë Ditën e Kijametit?"*

Usama i foli Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me gjuhën e njeriut që po e pranon gabimin dhe po kërkon ndjesë: "O i Dërguar i Allahut, kërko falje për mua." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përsëriti pyetjen: "*Si do të veprosh me fjalën 'nuk ka zot tjetër përveç Allahut' kur të vijë Ditën e Kijametit?"*[327]

Usama përsëriti kërkesën për falje, por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk tha më shumë se kjo pyetje, e cila e shqetësoi shumë Usamën, saqë dëshironte që të ishte bërë musliman vetëm atë orë, që t'i fshihej çdo mëkat i mëparshëm dhe të shpëtonte nga pasoja e veprës së tij.

Ky disiplinim profetik ndikoi thellë te Usama, aq sa u bë njeriu më i kujdesshëm dhe i vëmendshëm në çdo trazirë ku mund të frikoheshin se mund të ketë të vrarë që dëshmojnë fjalën "*Nuk ka zot tjetër përveç Allahut.*" Deri në atë pikë sa Sead bin Ebi Vekasi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, thoshte: "Unë nuk luftoj kundër një muslimani derisa të luftojë Usama, për shkak të kujdesit dhe vëmendjes së tij të madhe në çështjet e derdhjes së gjakut në rrethana të paqarta."[328]

Po ashtu, qëndrimi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj Ebu Dherrit kur ai fyeu një shërbyes duke e quajtur biri i zezakes, ishte shumë i prerë. Ai e thirri dhe i tha: "*A e fyeve atë për nënën e tij? Ti je njeri tek i cili ka injorancë.*"

Prandaj, kjo ndikoi thellë te Ebu Dherri, i cili e mbajti këtë mësim gjatë gjithë jetës së tij. Ai kishte me vete një shërbëtor, të cilit i kishte veshur një mantel të ngjashëm me atë që kishte vetë. Disa njerëz që e panë këtë gjë u habitën dhe e pyetën për arsyen dhe ai u tregoi atyre këtë hadith.

---

[327] Buhariu, 4269. Muslimi, 96.

[328] "*Sherhu Mushkili el Athari"* të Tahaviut, 8/265. "*El Mufhimu"* të Kurtubiut, 1/293-298. "*Sherhu el Neveviji ala Musim"*, 2/99. "*Fet'hu el Bari"*, 7/518, 12/195. "*Umdetu el Kari"*, 24/260.

Së pesti: Kur shkaku i gabimit është padija, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e korrigjon gabimin duke e mësuar me butësi dhe mirësjellje. Siç thuhet në transmetimin e Muavije bin Hakemit, i cili tregon: "Po falja namazin me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, kur një njeri teshtiu. Unë i thashë: "Allahu të mëshiroftë!" Njerëzit më shikuan me shikim të mprehtë, unë u thashë: "Ju qafshin nënat, përse po më shikoni?" Ata filluan të godisnin me duar në kofshët e tyre dhe kur pashë që po më heshtnin, heshta. Pasi i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përfundoi faljen, tha: "*Ky është namaz dhe në të nuk vlen asnjë fjalë e njerëzve; ajo është vetëm për Tesbih, Tekbir dhe Këndim Kurani.*"[329]

Gjithashtu, në rastin e beduinit që urinoi në xhami dhe njerëzit iu vërsulën ta godasin, ndërsa Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u tha: "*Lëreni dhe derdhni mbi urinë e tij një kovë ujë; ju jeni dërguar lehtësues, jo vështirësues.*"[330]

Pra, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* luftonte padijen me mësim, butësi, edukatë dhe mirësjellje. Kjo la një ndikim të madh edhe te Muavia bin Hakem, i cili tha: "Qoftë jeta ime për të! Nuk kam parë mësues më të mirë se ai, as para tij dhe as pas tij. Pasha Allahun, kurrë nuk më ka zemëruar, nuk më ka rrahur dhe nuk më ka fyer."

Kjo ndikoi edhe te beduini kur i tha: "*Në xhami nuk urinohet! Ajo është ndërtuar për të përmendur Allahun dhe për të falur namaz.*"[331]

Së gjashti: Mbyllja e gabimit pa ndjekje, pa fajësim dhe pa sharje. Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po mbante Hytben e xhumasë dhe erdhi karvani, njerëzit u shpërndanë menjëherë pas karvanit, duke e lënë atë në këmbë duke ligjëruar. Pastaj u shpall ajeti: ***"Mirëpo, sa herë që ata shohin ndonjë tregti ose lojë, shkojnë tek ajo e të lënë ty në këmbë."*** (El-Xhumua: 11)

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u mjaftua me kritikën që erdhi nga Kurani dhe nuk e diskutoi më tej me

[329] Muslimi, 537.
[330] Buhariu, 220.
[331] Ibn Maxhe, 529.

ndonjë fajësim shtesë. Ai nuk e bëri njollë të përhershme mbi ata që u larguan, prandaj ne na janë transmetuar emrat e disa prej atyre që qëndruan, por jo emrat e atyre që u larguan.[332]

Së shtati: Ndihmesa për t'i kaluar gabimet dhe mos mbajtja në burg edhe pas vërtetimit të fajësisë. Kjo shihet në rastin e gruas nga fisi i Mehzumije që vodhi dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi dhe iu pre dora. Pas kësaj ajo ndryshoi dhe përmirëso sjellje, u martua. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Ajo vinte dhe unë e ngrija shqetësimin e saj tek Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*."[333]

Kështu ajo ishte e mirëpritur pas pendimit të saj për gabimin që bëri saqë shtëpia e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u bë strehë e zgjidhjes së halleve të saj.

Së teti: Mos përballja direkt me njeriun që bën gabimin dhe të mjaftuarit me një këshillë të përgjithshme pa përcaktuar fajtorin, kur ishte e mundur të korrigjohet gabimi, kjo për arsye, që të mos dëmtohet ose turpërohet personi. Kështu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shpesh korrigjonte shumë gabime pa përmendur direkt fajtorin, por thjesht duke thënë: *"Ç'është puna me disa njerëz...."*

Një shembull është kur një person nga muhaxhirët e goditi[334] nga pas një person nga ensarët. Ensariu i thirri ensarëve: "O ensarë!" dhe Muhaxhiri i thirri Muhaxhirëve: "O Muhaxhirë!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i dëgjoi dhe tha: *"Ç'është kjo thirrje injorance?"* Kur ata i thanë se një Muhaxhir e goditi një Ensar, ai tha: *"Lëreni, atë thirrje sepse është e ndyrë."*[335]

Pra, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e transferoi bisedën rreth thirrjes duke përçmuar atë dhe shmangu bisedën nga njeriu që bëri atë thirrje.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i trajtonte gabimet me shumë delikatesë, butësi dhe ndjeshmëri.

---

[332] Buhariu, 4899. Muslimi, 863.
[333] Buhariu, 4304.
[334] "*El Nihajetu*", 4/163.
[335] Buhariu, 4905. Muslimi, 2584.

I Dërguari dhe kundërshtarët

Nga urtësia e Allahut në dërgimin e pejgamberëve është që ata të ishin njerëz nga mesi i njerëzve, që të jetojnë me njerëzit dhe të ndërveprojnë me ta. Në familjet e disa prej pejgamberëve të Allahut pati edhe kundërshtarë të tyre: në familjen e Nuhut ishte gruaja dhe djali i tij, në familjen e Ibrahimit ishte babai i tij, në familjen e Lutit ishte gruaja e tij dhe në familjen e Pejgamberit tonë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin xhaxhai i tij, Ebu Talibi, dhe xhaxhai i tij, Ebu Lehebi.

Prandaj, udhëzimi profetik në këtë drejtim përfaqëson natyrshmërinë e ekuilibruar dhe përmbushjen e përsosmërisë njerëzore.

Allahu e përshkroi moralin e Pejgamberit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me fjalët: ***"Se ti je me virtyte madhore."*** (El-Kalem: 4)

Ky është përshkrim i madhështisë së moralit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me të gjithë ata që ndërveproi, qoftë nga ndjekësit apo kundërshtarët. Allahu i Lartësuar urdhëroi të flitet me mirësi me të gjithë njerëzit: ***"Do t'u thoni fjalë të mira njerëzve."*** (El-Bekare: 83)

Fjala "njerëzve" është e përgjithshme dhe përfshin muslimanë e jo muslimanë. Allahu i Lartësuar, gjithashtu, thotë: ***"Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me keqbërësit e tjerë."*** (El-Ankebut: 46)

Prandaj, debatet dhe dialogu me njerëzit e Librit duhet të jenë me fjalët më të mira.

Prandaj, sjellja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me kundërshtarët pati tiparet dhe veçoritë e saj të veçanta.

Së pari: Jeta shoqërore

Përfshirja në jetën publike ishte tipar i përgjithshëm i shoqërisë së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe kjo vërehet:

Në dokumentin e Medinës, ku rregullohej marrëdhënia midis qytetarëve të Shtetit të Medinës, muslimanëve dhe të tjerëve.

Në përzierjen sociale dhe bashkëpunimin midis muslimanëve dhe të tjerëve; Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kaloi pranë një tubimi ku ishin ulur bashkë muslimanë, mushrikë dhe hebrenj, u ul dhe bisedoi me ta[336]. Ai nuk ia ndaloi muslimanëve të qëndronin në këtë tubim të përzier, përkundrazi iu bashkua atyre.

Diçka të tillë tregojnë edhe fjalët e Allahut të Lartësuar: ***"Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata*** (njerëz që veprojnë kështu)***, derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata."*** (En-Nisa: 140)

Kjo është porosia që Allahu i Lartësuar i kërkon muslimanëve kur të rrinë me mushrikët.

Kur mushrikët mohojnë ajetet e Allahut dhe tallen me to, besimtarëve u kërkohet të ngihen nga ai tubim, por nëse bëhet ndonjë bisedë tjetër, atëherë mund të qëndrojnë, përndryshe ata do të jenë njëlloj.

Së dyti: Vizita e njëri-tjetrit

Hebrenjtë hynin në shtëpinë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai ishte mikpritës i tyre dhe ulej me ta.

1. Djaloshi hebre që shërbente në shtëpinë e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton: "Një djalosh hebre i shërbente Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)..."*[337] dhe ky djalosh hynte në shtëpinë e tij dhe kujdesej për çështjet e tij private.

2. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se një grua hebreje i shërbente asaj; dhe sa herë që Aishja i bënte ndonjë mirësi asaj, ajo i thoshte: "Allahu të ruajttë nga dënimi i varrit!"

3. Gjithashtu, Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Erdhën tek unë dy gra të moshuara nga hebrenjtë e Medinës, ato më thanë se: "Banorët e varreve përjetojnë dënim në varret e tyre." Unë e mohova këtë dhe nuk pranova t'i besoja. Ato u larguan, kur erdhi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i thashë: "O i Dërguar i Allahut, dy gra të moshuara më thanë kështu kështu..." dhe i tregova

[336] Buhariu, 6254. Muslimi, 1798.
[337] Buhariu, 1356.

ç'më thanë. Ai tha: "*Të vërtetën e kanë thënë; ata përjetojnë dënim që e dëgjojnë të gjitha kafshët.*" Që prej asaj kohe, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në çdo namaz e kam parë duke u lutur, duke kërkuar mbrojtje nga dënimi i varrit."[338]

4. Gjithashtu, Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Një grup hebrenjsh hynë te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe nuk e përshëndetën me fjalët: "*Es selamu alejkum*", por "*es Samu*[339] *alejkum*". Që do të thotë: *Ju marrtë vdekja!* Aishja tha: "E kuptova mirë çfarë thanë, prandaj u thashë: "Juve, ju marrtë vdekja dhe mallkimi!" Ajo tregon: "Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më tha: "*Ngadalë, o Aishe, se Allahu e do butësinë në çdo çështje.*" I thashë: "O i Dërguar i Allahut, a nuk dëgjove çfarë thanë?" I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më tha: "*Unë u thashë: "Edhe mbi ju!"*[340]

Këta hebrenj, edhe pse ishin me sjellje të ulët dhe urrejtjen të fshehtë, megjithatë shtëpitë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin të hapura për ta dhe morali i tij fisnik i përfshinte me mirësi. Ai i trajtonte me butësi dhe urdhëronte që sjellja ndaj tyre të jetë me butësi.

Dhe ashtu siç i priste në shtëpinë e tij, po ashtu, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i vizitonte në shtëpitë e tyre.

Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se një hebre e ftoi Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për bukë elbi dhe gjalpë[341] të vjetruar dhe ai ia pranoi ftesën.

Së treti: Kërkimi i ndihmës nga njerëz me ndikim, edhe pse nuk ishin muslimanë

1. Emigrimi në drejtim të Nexhashiut në Abisini dhe qëndrimi nën mbrojtjen e tij, ndërkohë që ai ishte i krishterë.

2. Ndihma dhe mbrojtja që i dha Ebu Talibi të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, megjithëse ai qëndroi në fenë e popullit të vet.

---

[338] Buhariu, 6366. Muslimi, 586.
[339] Fjala *es samu* do të thotë vdekje e shpejtë. "*Fet'hu el Bari*", 11/42.
[340] Buhariu, 6024. Muslimi, 2165.
[341] Ahmedi, 13201. "*Fet'hu el Bari*", 1/82.

3. Ndihma nga fisi Benu Hashim dhe Benu Mutalib - si muslimanët ashtu edhe jomuslimanët prej tyre - ndaj tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjatë bojkotit që iu bë lagjes së tyre.

4. Hyrja e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në Mekë nën mbrojtjen e Mut'im ibn Adij. Pasi kur u kthye nga Taifi, nuk hynte dot në Mekë pa mbrojtjen e dikujt, ai i dërgoi lajm Mut'im ibn Adijit duke kërkuar mbrojtjen e tij për të hyrë në Mekë i sigurt nga sulmi dhe dëmtimi i kurejshëve. Mut'im ibn Adiju pranoi dhe e mori nën mbrojtjen e tij dhe kurejshët e pranuan mbrojtjen dhe besën që ai i dha.[342]

5. Ibn el Degina mori nën mbrojtje Ebu Bekrin dhe iu drejtua krerëve të kurejshëve dhe u tha atyre: "*Nuk duhet të dalë dikush si Ebu Bekri, e as të dëbohet.*" Atëherë, kurejshët pranuan mbrojtjen e Ibn el Deginas për Ebu Bekrin dhe e lanë të qetë.[343]

Së katërti: Kërkimi i ndihmës për çështje të rëndësishme nga njerëzit e ndershëm dhe të matur, edhe pse nuk ishin muslimanë

Zgjedhja e Abdullah bin Ureikit si udhërrëfyes në rrugën e *Hixhretit*, megjithëse ai ishte mushrik. Megjithatë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i besoi një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme dhe të rrezikshme.

Kjo zgjedhje përputhej me burrërinë, fisnikërinë dhe krenarinë e vetë Abdullah bin Ureikitit. Edhe pse kurejshët jepnin shpërblime të mëdha për këdo që do t'u tregonte vendndodhjen e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe shokut të tij, Ebu Bekrit, ai kurrë nuk e çoi ndër mend t'i tradhtonte për të përfituar dhe për të shpëtuar veten nga lodhja e udhëtimit. Përkundrazi, ai i qëndroi besnik marrëveshjes dhe tregoi burrëri dhe ndershmëri.

Së pesti: Pohimi i marrëdhënieve njerëzore

Marrëdhëniet njerëzore janë një sjellje e natyrshme, ashtu si veprimet e jetës së përditshme, të cilat përfshihen në hapësirën e gjerë që feja e ka lënë të lirë dhe të lejueshme. Prandaj, shokët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e pyesnin

[342] "*El Tabakatu el Kubra*", Ibn Sead, 1/180-181.
[343] Buhariu, 2297.

për shumë detaje të sjelljes me jobesimtarët, sepse i konsideronin ato si çështje të përditshme, që hyjnë në sferën e hapësirës së lejuar.

1. **Rasti i Sead bin Muadhit**, i cili ishte mik i ngushtë me Umeje bin Halefin. Kur Umeja kalonte nëpër Medinë, qëndronte te Seadi; dhe kur Seadi kalonte nëpër Mekë, qëndronte te Umeja. Kur i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi në Medinë, Seadi shkoi për Umre dhe qëndroi te Umeja në Mekë...[344]

Këtu vërejmë se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e ndaloi Seadin kur shkoi, e as nuk e pyeti kur u kthye.

2. **Rasti i Amr bin Abeses**, i cili, kur ai erdhi në Mekë në fillim të shpalljes, takoi të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, e dëgjoi dhe e pranoi Islamin. Pastaj, i tha: "Unë dua të vij me ty." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Ti nuk mund ta bësh këtë sot. A nuk e sheh gjendjen time dhe gjendjen e njerëzve? Por kthehu te familja jote, e kur të dëgjosh se unë kam triumfuar, atëherë eja tek unë..."*[345]

Po ashtu, besimtarët e parë që pranuan Islamin qoftë nga muhaxhirët qoftë nga ensarët, u sollën në mënyrë njerëzore dhe të natyrshme me prindërit dhe të afërmit e tyre që qëndruan idhujtarë.

Së gjashti: Shkëmbimi i dhuratave me ta

1. Dhurata e Ukajdir Dumës për Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se Ukajdir Duma i dërgoi të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* një rrobë mëndafshi dhe ai e veshi atë - kjo ndodhi para se të ndalohej mëndafshi për burrat. Njerëzit u mahnitën nga bukuria e saj, kurse Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Shamitë e Sead bin Muadhit në Xhenet janë më të mira dhe më të buta se kjo."*[346]

2. Abdullahu ibni Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* transmeton: "*I erdhën të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut*

[344] Buhariu, 3950.
[345] Buhariu, 2615. Muslimi, 832.
[346] Muslimi, 2469.

qofshin mbi të) disa rroba dhe ai i dha Umerit një prej tyre. Umeri ia dha këtë rrobë vëllait të tij në Mekë, i cili ishte idhujtar."[347]

3. Abdullahu ibn Amri transmeton se e pyeti shërbyesin e tij pasi e theri delen: "A i dhe mish fqinjit tonë hebre? A i dhe mish fqinjit tonë hebre?" Pastaj shtoi: "Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke thënë: "*Xhibrili më porositi aq shumë për fqinjët, saqë mendova se do t'i bënte trashëgimtarë."*[348]

Së shtati: Bamirësia dhe sjellja e mirë ndaj tyre

1. Allahu i Lartësuar thotë: "***Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.***" (El-Mumtehine: 8);"***Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë.***" (El-Insan: 8) - Ndërkohë që i burgosuri (robi i luftës) është kundërshtar dhe armik - ka ardhur si luftëtar - por, pasi është zënë rob, ai bëhet objekt i bamirësisë dhe mëshirës. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Silluni mirë me robërit!"*[349]

2. Esmaja, vajza e Ebu Bekrit *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)*, tregon: "Më erdhi në shtëpi nëna ime, ndërsa ishte mushrike, në kohën e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. E pyeta të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i thashë: "Nëna ime më ka ardhur e dëshiron diçka nga unë, a ta ruaj lidhjen me të?" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Po, ruaje lidhjen me nënën tënde!"*[350]

3. Ikrima tregon se nëna e besimtarëve Safija, bija e Hujejit *(Allahu qoftë i kënaqur me të),* ia shiti njëqind mijë (monedha) odën e saj Muavies. Ajo kishte një vëlla hebre. Ajo i propozoi atij të pranonte Islamin që ta trashëgonte, por ai nuk pranoi. Atëherë, ajo bëri testament që t'i linte atij një të tretën e shumës.[351]

---

[347] Buhariu, 886. Muslimi, 2068.
[348] Buhariu, 6015. Muslimi, 2625.
[349] Taberaniu, "*El Muaxhemu el Kebiru"*, 977.
[350] Buhariu, 2620. Muslimi, 1003.
[351] Abdurrazzak, "*Musannef", 19327.*

Së teti: Vizitimi i të sëmurëve të tyre dhe pjesëmarrja në varrimet e tyre

1. Një djalosh hebre që i shërbente Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u sëmur. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkoi ta vizitonte. U ul pranë kokës së tij dhe i tha: "Pranoje Islamin!" Djaloshi shikoi babanë e tij, i cili ishte ulur, po ashtu, pranë kokës dhe ai i tha: "Përgjigju Ebu Kasimit!" Dhe ai (djaloshi) e pranoi Islamin. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli prej aty duke thënë: "*Falënderimi i qoftë Allahut që e shpëtoi nga zjarri!*"[352]

2. Sehl ibn Hunejfi dhe Kajs ibn Seadi ishin ulur në vendin e quajtur Kadisije. Përpara tyre kaloi një funeral dhe ata u ngritën në këmbë. Dikush u tha: "Është funeral i ndonjërit prej banorëve të vendit - nga ithtarët e librit (jomusliman)." Ata thanë: "Para të Dërguari të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kaloi një funeral dhe u ngrit në këmbë. Dikush i tha: "Është funeral i një hebreu." Ai tha: "*A nuk është një shpirt?!*"[353]

Së nënti: Hyrja e tyre në xhami dhe hyrja e muslimanëve në faltoret e tyre

1. Kur erdhi delegacioni nga Thekifi tek i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, atyre iu ngrit një çadër në fund të xhamisë, prej ku të shikonin faljen e muslimanëve, rukunë dhe sexhden e tyre. Dikush pyeti: "O i Dërguari i Allahut, a do t'i fusësh në xhami këta që janë idhujtarë?" Ai u përgjigj: "*Toka nuk bëhet e papastër. I papastër bëhet vetëm njeriu.*"[354]

2. Kur erdhi delegacioni nga Nexhranit, ata hynë te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në xhami, pas namazit të ikindisë. Në atë kohë hyri koha e faljes së tyre, prandaj u ngritën dhe u falën në xhami. Disa njerëz deshën t'i ndalonin, por i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Lërini!*" Ata u kthyen nga lindja dhe u falën."[355]

---

[352] Buhariu, 1356.
[353] Buhariu, 1312. Muslimi, 961.
[354] "*Elmerasijlu*", Ebu Davudi, f. 80.
[355] *Ibnu Hisham*, 2/159-160

Kështu vepronin të gjitha delegacionet arabe. Të gjithë hynin në xhami dhe qëndronin pranë të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, muslimanët dhe jo muslimanët.

Po ashtu, edhe muslimanët kanë hyrë në kishat dhe faltoret e tyre.

Disa nga gratë e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përmendën një kishë në tokën e Abisinisë, të quajtur Marije. Ishin Umu Seleme dhe Umu Habibe, që kishin qëndruar në Abisini. E përmendën bukurinë e kishës dhe pikturat në të. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ngriti kokën dhe tha: *"Ata kur u vdiste ndonjë njeri i mirë, ndërtonin mbi varrin e tij një xhami dhe pastaj në të bënin piktura. Ata janë njerëzit më të këqij te Allahu."*[356]

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kritikoi veprimin që bënin në faltore, por nuk e qortoi hyrjen e grave të tij në kishë, as shikimin e tyre ato që ndodheshin në të.

Umer ibn Hatabi, kur hyri në Jerusalem, shkoi në Kishën e Ringjalljes dhe u ul në oborrin e saj. Kur erdhi koha e faljes, i tha patriarkut: "Dua të falem." Ai i tha: "Falu këtu ku je." Por Umeri refuzoi dhe u fal vetëm në shkallët jashtë kishës. Kur e përfundoi namazin, i tha patriarkut: "Nëse do të isha falur brenda në kishë, muslimanët pas meje do ta merrnin kishën dhe do të thoshin: "Këtu është falur Umeri!" Pastaj u shkroi një dokument të krishterëve që: "Të mos falet namaz në atë shkallë dhe të mos thirret ezani mbi të."[357]

Së dhjeti: Pjesëmarrja me ta në marrëveshje dhe pakte

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë për Marrëveshjen e të Ndershmëve *Hilfu el Fudul*: *"Kam qenë i pranishëm në shtëpinë e Abdullah bin Xhud'an në një marrëveshje, nëse do të ftohesha për të edhe në Islam, do t'i përgjigjesha."*

Gjithashtu, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte nisur drejt Mekës në vitin e Hudejbijes, kur tha: *"Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im! Ata, mekasit, nuk do të më kërkojnë*

[356] Buhariu, 427. Muslimi, 528
[357] *"Tarihu Ibn Haldun"*, 2/225.

ndonjë marrëveshje me të cilën madhërohen kufijtë shenjtëritë e Allahut, vetëm se do t'ua jap atë që kërkojnë."[358]

Së njëmbëdhjeti: Pohimi i virtyteve për njerëzit me virtyte

Umu Seleme *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se kur jeta në Mekë u ngushtua dhe shokët e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u keqtrajtuan, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u tha: "*Në tokën e Habeshes* (Etiopisë) *ndodhet një mbret tek i cili nuk i bëhet padrejtësi askujt. Shkoni në vendin e tij derisa Allahu t'ju hapë rrugëdalje dhe shpëtim nga kjo gjendje në të cilën ndodheni."*[359]

Gjithashtu, Umu Seleme e përshkruan me mirënjohje dhe nderim sjelljen e Uthman bin Talhas, i cili në atë kohë ishte ende idhujtar, por e shoqëroi dhe u kujdes për të gjatë udhëtimit të saj për t'u bashkuar me burrin e saj, Ebu Selemen, në Medinë. Ajo thotë: "E takova Uthman bin Talhan dhe ai më pyeti: "Ku po shkon, oj bijë e Ebi Umejës?" I thashë: "Po shkoj te burri im në Medinë." Tha: "A nuk është me ty askush?" I thashë: "Pasha Allahun, vetëm me këtë djalin tim dhe me Allahun." Tha: "Pasha Allahun, ti nuk mund të lihesh vetëm!" - dhe e mori litarin e devesë dhe më shoqëroi."

Pastaj Umu Seleme e përshkroi me këto fjalë prekëse: "Pasha Allahun, nuk kam pasur ndonjëherë shoqëri më fisnike se ajo e tij. Kur ndaleshim për të pushuar, ai e ulte devenë dhe largohej që unë të zbrisja. Pastaj e merrte devenë, ia ulte barrën, pastaj e lidhte te ndonjë pemë, kurse vetë shkonte të pushonte larg meje. Kur afrohej koha për të vazhduar rrugën, ai vinte e merrte devenë, e përgatiste, largohej pak dhe më thoshte: "Hip." Kur hipja, kthehej, e merrte litarin e devesë për dorë dhe më shoqëroi derisa më çoi në Medinë." Kur arritëm në vendbanimin e Benu Amr bin Avf në Kuba, më tha: "Burri yt është në këtë fshat." Dhe më uroi: "Hyr me bekimin e Allahut!" Pastaj u kthye për në Mekë."

Kjo ishte një burrëri dhe sjellje fisnike nga një njeri që në atë kohë nuk ishte ende musliman, por Umu Seleme, me besnikëri dhe

[358] Buhariu, 2731.
[359] Bejhakiu, "*El Sunen el Kubra"*, 17734.

mirënjohje, ia përmend si shembull të lartë të karakterit dhe ndershmërisë.

Së dymbëdhjeti: Dashuria e natyrshme ndaj jobesimtarëve

Kjo dashuri është një ndjenjë e brendshme, spontane dhe e natyrshme, që lind si përgjigje ndaj shkaktarëve të dashurisë, si: afërsia familjare, miqësia, mirësia apo bashkëshortësia. Siç është:

- Dashuria e njeriut për prindërit e tij,
- Dashuria e burrit për gruan e tij,
- Dashuria e mikut për mikun e tij,
- Dashuria për atë që të ka bërë mirë.

Kjo është një ndjenjë e lindur me njeriun dhe ekzistenca e saj ndërmjet muslimanëve dhe jomuslimanëve paqësorë është e konfirmuar në fjalën e Allahut drejtuar të Dërguarit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: ***"Vërtet, ti*** (Muhamed) ***nuk mund të udhëzosh kë të duash."*** (El-Kasas: 56) (Kjo tregon se ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte ndjenja dashurie të natyrshme ndaj tij, edhe pse nuk ishte musliman dhe dëshironte për të që ai të pranonte Islamin.)

Allahu ka lejuar martesën me bijat e Ithtarëve të Librit (hebrenjve dhe të krishterëve), ndërkohë që dihet se martesa nuk ka kuptim pa ndjenja të qetësisë, dashurisë dhe mëshirës mes burrit dhe gruas, siç tregon Allahu i Lartësuar: ***"Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë."*** (Er-Rum: 21)

Po ashtu, nëse prindërit janë jobesimtarë, mosbesimi i tyre nuk i shuan ndjenjat natyrore të dashurisë ndaj tyre. Për këtë, Allahu thotë: *"****Nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua*** (në adhurim) ***diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë."*** (Lukman: 15)

Nuk mund të mendojmë se sahabët *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* ishin të ashpër ndaj të afërmve të tyre që nuk ishin muslimanë apo që i urrenin në zemrat e tyre.

Po ashtu, kur dikush prej jomuslimanëve na bën ndonjë të mirë, zemra jonë do të anojë drejt dashurisë për të, sepse natyra njerëzore është e krijuar e dashur ndaj bamirësve.

A do të ishte e pranueshme të themi se sahabët, që qëndronin nën mbrojtjen dhe mirësinë e Nexhashiut, mbretit të Habeshes, fshihnin urrejtje për të në zemrat e tyre! Jo! Kurrsesi, zemra e shëndoshë nuk e pranon një gjë të tillë.

A pranohet të thuhet se muslimanët në dukje sillen mirë në bashkëpunim me të tjerët, por brenda tyre fshehin urrejtje? Kjo është në kundërshtim me sinqeritetin dhe natyrën e pastër.

Ashtu siç është e natyrshme dashuria për jomuslimanët, po ashtu, edhe urrejtja është e natyrshme nëse ndodh ndonjë keqbërje, ofendim ose hasmëri, qoftë edhe mes vetë muslimanëve.

Për këtë, Allahu i Lartësuar thotë: "***Vërtet, punëmirët do të jenë në kopshtet e Xhenetit pranë burimeve. Atyre do t'u thuhet: "Hyni atje me paqe dhe siguri!" Ne do ta heqim urrejtjen nga zemrat e tyre; ata do të rrinë ulur si vëllezër përballë njëri-tjetrit në divane. Aty nuk do t'i mundojë lodhja e prej aty kurrë nuk do të dëbohen.***" (El-Hixhr: 45-48)

Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ka thënë: "Shpresoj të jem unë, Talha dhe Zubejri prej atyre për të cilët Allahu ka thënë: "***Ne do ta heqim urrejtjen nga zemrat e tyre...***"[360]

Së trembëdhjeti: Ruajtja e të drejtave të tyre

Kundërshtarët e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, qofshin nga hebrenjtë apo idhujtarët, gëzonin të drejta të garantuara, me mbrojtje të plotë për gjakun, pasurinë dhe të drejtat e tyre.

Këtë e vërteton edhe fakti se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndërroi jetë, ndërsa parzmorja e tij ishte peng te një hebre, në këmbim të tridhjetë babune *Saë* elbi dhe nuk pati ç'të jepte për ta shlyer borxhin derisa ndërroi jetë.[361]

[360] "Musannef", Ibn Ebi Shejbe, 37795.
[361] Buhariu, 2916. Muslimi, 1603.

Ky fakt është vërtet për t'u habitur: I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* merr hua nga një hebre në kohën kur ai ishte në kulmin e fuqisë dhe shtetit të tij!

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* emigroi nga Meka, la pas vetes Aliun për të kthyer amanetet që njerëzit i kishin besuar. Duhet theksuar fakti se kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në Mekë, kushdo që kishte diçka të shtrenjtë dhe kishte frikë se mos e humbiste atë, e dërgonte te ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për t'ia ruajtur.

Prej ruajtjes së të drejtave të tyre është edhe ndalimi i rreptë i derdhjes së gjakut të tyre, si dhe paralajmërimi i ashpër për atë që i sulmon ata:

I Dërguar *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thotë: "*Kush vret një të huaj të mbrojtur me marrëveshje* (muahed)*, nuk do ta nuhasë aromën e Xhenetit, edhe pse aroma e tij nuhatet nga largësia e një udhëtimi 40-vjeçar.*"[362]

Muahed është ai që ka hyrë në vendin e muslimanëve me një marrëveshje sigurie, ose që është nga banorët vendas nën kujdesin e shtetit islam, të cilët quhen 'ehlu el dhime'.

Së katërmbëdhjeti: Kujdesi që ata të udhëzohen

Kur vështrojmë kujdesin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për udhëzimin e kundërshtarëve, shohim se ai ishte i mbushur me një ndjenjë të zjarrtë, si kujdesi i babait për të birin, madje edhe më shumë.

Shembuj të këtij kujdesi:

1. Kur u kthye nga Taifi, i pikëlluar për qëndrimin e tyre, u ndal në "Karn el Thealib". Ai vetë rrëfen: "*E ngrita kokën dhe pashë një re që më kishte bërë hije. Aty ishte Xhibrili, i cili më thirri dhe më tha: 'Allahu i ka dëgjuar fjalët e popullit tënd dhe përgjigjen që të dhanë. Të ka dërguar engjëllin e maleve që ta urdhërosh për çfarë të duash kundër tyre.' Më foli engjëlli i maleve dhe më dha selam pastaj më tha: 'O Muhamed, çfarë të duash ti, nëse do ua shemb dy malet* (që rrethojnë Mekën) *mbi ta.' Por Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Jo!*

[362] Buhariu, 3166.

Shpresoj që Allahu të nxjerrë nga pasardhësit e tyre ata që do ta adhurojnë vetëm Atë, pa i shoqëruar shok."

2. Në betejën e Uhudit, kur iu thye dhëmbi[363], u plagos në kokë dhe gjaku i rridhte nga fytyra, ai vetëm fshinte gjakun dhe thoshte: "*O Allah, fale popullin tim, sepse ata nuk dinë."*[364]

Imam Kurtubiu komenton këtë moment duke thënë: "Kush e mendon me kujdes këtë lutje në një situatë kaq të rëndë, kupton kuptimin e fjalës së Allahut: "***Ti je me virtyte madhore.***" (El Kalem: 4) Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk u lut kundër tyre për hakmarrje, as nuk u mjaftua me falje, por u lut për ta. Jo vetëm kaq, por i quajti 'populli im' nga mëshira dhe e përdori injorancën e tyre si njëfarë justifikimi, edhe nëse nuk ishte justifikim real. Ky është kulmi i virtytit dhe bujarisë që askush tjetër nuk e arrin."[365]

Kjo tregon se paqja dhe bashkëjetesa janë klima e thirrjes në fe, prandaj paqja që pasoi marrëveshjen e Hudejbijes ishte shkak për përhapjen e Islamit, jo vetëm në mesin e fiseve arabe, por edhe jashtë Gadishullit Arabik.

Imam Zuhriu thotë: "Nuk ka pasur fitore më të madhe se marrëveshja e Hudejbijes, sepse jobesimtarët filluan të përziheshin me muslimanët, të dëgjonin fjalët e tyre, dhe kështu Islami depërtoi në zemrat e tyre. Brenda tre vitesh shumë njerëz e pranuan Islamin."[366]

Sjellja e muslimanëve çlirimtarë me pasuesit e feve të tjera ishte shkak që ata të pranonin Islamin dhe t'i bashkëngjiten shtetit islam.

Ky ishte udhëzimi dhe qëndrimi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe madhështia e tij morale në marrëdhënie me ata që e kundërshtonin fenë e tij.

Prandaj, kur sot shohim disa muslimanë që e teprojnë me armiqësi ndaj njëri-tjetrit për shkak të këndvështrimit ndryshe ndaj disa çështjeve dytësore rreth besimit apo dispozitave, çështje të

[363] "*Sherh el Nevevij ala Muslim*", 12/481.
[364] Ibn Hibbani, 973.
[365] "*El Mufhim li el Kurtubiji*", 3/650.
[366] El Vahidiu, "*El Tefsiru el Vesijtu*", 4/133.

cilat kanë ekzistuar që në shekujt e parë, themi: Ah, sikur muslimanët të silleshin me njëri-tjetrin, ashtu siç është sjellë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me jomuslimanët…!

Ah, sikur edhe disa prej vëllezërve tanë muslimanë të na trajtonin neve, siç ka trajtuar i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ata që ende nuk e kishin pranuar Islamin…![367]

Sqarim:

Pasi përmendëm këto sjellje të larta të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe e argumentuam secilën me dëshmi të qarta, dikush mund të shtrojë një pyetje:

Si mund të pajtohen këto sjellje me hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejre, në të cilin Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thotë: "*Mos jepni selam të parët as hebrenjve dhe as të krishterëve, madje nëse e takoni ndonjërin prej tyre në rrugë, ngushtojuani kalimin në të*" dhe transmetime të ngjashme?[368]

Përgjigjja - Allahu e di më së miri - është si vijon**:**

Qëllimi i hadithit dhe kuptimi i tij kuptohet drejt vetëm kur mblidhen të gjitha transmetimet dhe rastet kur është zbatuar, si dhe kur shihet në dritën e ajeteve që flasin në këtë drejtim.

Kur i bashkojmë transmetimet në këtë temë, kuptojmë se hadithi është i përmendur në një rast të veçantë dhe ai është rast lufte dhe përgatitje për luftë.

Dëshmi për këtë është hadithi i transmetuar nga Ebu Basra el Gifari, në të cilin Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thotë: "*Unë nesër do të shkoj te hebrenjtë, prandaj mos jepni selam të parët. Por nëse ata ju përshëndesin të parët, atëherë thoni: "Edhe mbi ju!"*[369]

Kuptimi i fjalëve "*Unë nesër do të shkoj te hebrenjtë*" tregon qartë se bëhet fjalë për një rast të përgatitjes për një sulm ushtarak ndaj tyre dhe jo për kohën e bashkëjetesës së zakonshme në Medinë.

Sepse hebrenjtë ishin të pranishëm në Medinë dhe në lagjet e saj.

---

[367] Një shprehje që e thoshte vëllai im Shejh Aid el Karni.

[368] Muslimi, 2167.

[369] "*El Edebu el Mufredu*", 1102.

Kështu që hadithi është një udhëzim specifik, për këtë rast kur hebrenjtë shkelën marrëveshjen e paqes dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po shkonte për të luftuar, prandaj i kërkoi sahabëve[370] të mos japin selam të parët pasi dhënia e selamit bie ndesh me vullnetin e luftës, sepse dhënia e selamit është besë dhe marrëveshje për paqe që nuk mund të shkelet.

Çështja qartësohet edhe më shumë, po të shohim zbatimin praktik të këtij hadithi.

Asnjëherë nuk është transmetuar nga jeta e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* apo e sahabëve të tij që ata të kenë takuar një *dhimi* - jomusliman dhe t'ia kenë ngushtuar kalimin në rrugë.[371]

E dimë se sahabët kishin kontakt të shpeshtë me hebrenjtë në Medinë dhe në vendet e çliruara më vonë, por asnjëherë nuk është vepruar në atë mënyrë.

Pastaj çështja kush jep selam i pari. Nëse shohim praktikën e sahabëve do të shohim se ata nuk e kishin zakon të kontrollonin nëse duhej apo jo t'i përshëndesin me selam njerëzit që takonin, qoftë edhe nëse ishin të afërmit e tyre jobesimtarë.

A mund të mendojmë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe Ebu Bekrin *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* në udhëtim e tyre gjatë emigrimit me udhërrëfyesin e tyre pagan, Abdullah bin Urejkitin, ai t'i përshëndeste me selam kur vinte, ndërsa ata të mos e përshëndesin kur ta takojnë?

A është e logjikshme të mendojmë se Sead bin Muadhi, kur zbriti si mysafir në shtëpinë e mikut të tij jomusliman, Umeje bin Halef, në Mekë - që të mos e përshëndeste me selam, ndërkohë që po qëndronte në shtëpinë e tij dhe po hante ushqimin e tij?

Edhe shumë prej të rinjve që pranonin Islamin para prindërve të tyre. A i trajtonin ata me ftohtësi dhe pa përshëndetje? Sigurisht që jo!

Udhëzimi i drejtë që përcakton normën e sjelljes në këtë situatë është fjala e Allahut të Lartësuar: ***"Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër***

[370] "*Zadu el Mead*", 2/388.
[371] Ibn Uthejmin, "*El Sahvetu el Islamijetu Davabitun ve tevexhxhuhatun*", 189.

jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët." (El-Mumtehine: 8)

Nëse paraprakisht na lejohet së sillemi me mirësjellje, me drejtësi dhe me bujari, si mund të mos na lejohet t'i përshëndesim me *selam* përshëndetjen e paqes?

Po ashtu, Allahu i Madhërishëm thotë: ***"Dhe, kur dëgjojnë ndonjë marrëzi, i shmangen asaj, duke thënë: "Ne kemi veprat tona, ndërsa ju keni veprat tuaja! Paqja qoftë me ju! Ne nuk duam shoqëri me të paditurit."*** (El-Kasas: 55)

Përfundim:

Duke i bashkuar të gjitha këto ajete, hadithe dhe praktika, kuptojmë se hadithi i lartpërmendur që ndalon përshëndetjen e hebrenjve dhe të krishterëve ishte porosi specifike vetëm për rastin e parapërgatitjes për luftë.

Ndërsa në kohë paqeje dhe marrëveshjeje, sjellja jonë kthehet te udhëzimi i qartë i Kuranit Fisnik: ***"Dhe, kur dëgjojnë ndonjë marrëzi, i shmangen asaj, duke thënë: "Ne kemi veprat tona, ndërsa ju keni veprat tuaja! Paqja qoftë me ju! Ne nuk duam shoqëri me të paditurit."*** (El-Kasas: 55)

Allahu e di më së miri![372]

I Dërguari dhe armiqtë

Nuk është e mundur për një bartës të një mesazhi apo thirrjeje të kryejë detyrën dhe thirrjen e tij pa u përballur me kundërshtime dhe armiqësi. Këto mund të zvogëlohen dhe të menaxhohen, por nuk mund të kapërcehen apo të anulohen tërësisht.

Allahu i Lartmadhëruar: ***"Dhe, kështu Ne, çdo profeti i kemi kundërvënë një armik nga keqbërësit. Por ty të mjafton Zoti yt si udhërrëfyes dhe ndihmës!"*** (El-Furkan: 31)

[372] Shejh Selman el Aude, "*Hazanetu el Muraselati*".

Kur qëndrojmë përballë qëndrimeve të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me armiqtë e tij dhe armiqësitë rreth tij, vërejmë disa gjëra:

Së pari: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përball që në fillim të thirrjes së tij me armiqësi nga armiq të mëdhenj. Nuk është e përshtatshme që t'i nënvlerësojmë armiqtë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke i paraqitur në mënyrë përqeshëse apo të dobët. Ata ishin njerëz të mëdhenj në aftësitë, kapacitetet dhe pozitën e tyre.

– Ebu Xhehli ishte gjeni në udhëheqje; arriti të udhëhiqte krerët e kurejshëve, ndonëse mes tyre kishte më të mëdhenj dhe më të nderuar se ai.

– Hujej bin Ahtab ishte mjeshtër në diplomaci dhe i aftë në krijimin e aleancave; arriti të grumbullojë dhjetë mijë luftëtarë rreth Medinës nga fise të ndryshme dhe, me zgjuarsinë e tij diplomatike, arriti të joshë fisin Benu Kurejdha që të thyenin marrëveshjen me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

– Abdullah bin Ubej bin Seluli ishte një udhëheqës i madh në pozicionin e tij. Ishte njeriu që arriti t'i bashkonte fiset Evs dhe Hazrexh para ardhjes së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ata kishin rënë dakord që ai të bëhej mbreti i tyre - dhe ishte e vështirë të binin dakord për ndonjë tjetër, për shkak të armiqësive të thella mes tyre.

Pra, nënvlerësimi i armiqve të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është nënvlerësim i fitores dhe epërsisë së tij ndaj tyre. Ata kishin talente dhe aftësi, por ishin në rrugë të gabuar kundër së vërtetës. Allahu është Mbizotërues i urdhrit të Tij. Për këtë arsye, dredhitë e tyre përfunduan, armiqësia e tyre dështoi dhe fundi i çështjes së tyre ishte humbje.

Së dyti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përball me armiqësitë më të ashpra, më të hidhura dhe më të dhimbshme, armiqësitë nga të afërmit.

Armiqtë e tij në Mekë ishin njerëzit e fisit të tij dhe të afërmit e tij. Ebu Lehebi ishte xhaxhai i tij.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i ftoi ata të ruajnë lidhjet familjare. Ibn Abasi transmeton: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte lidhje farefisnore me të gjitha degët e kurejshëve. Kur ata e përgënjeshtruan dhe refuzuan t'i jepnin besën, ai tha: "*O populli im! Nëse refuzoni të më pasoni, atëherë ruajeni lidhjen familjare që kemi midis nesh dhe mos lejoni që arabë të tjerët të më mbrojnë mua dhe të më mbështesin para jush!*"[373]

Së treti: Pavarësisht kësaj armiqësie dhe dëmtimit të madh, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte shumë i kujdesur për udhëzimin e tyre, e jo për hakmarrje ndaj tyre. Për këtë arsye, ai iu lut Allahut: "*O Allah, fuqizoje Islamin me njeriun që Ti e do më shumë nga këta të dy: Ebu Xhehli ose Umer ibn El-Hatab.*"[374] Dhe më i dashuri për Allahun nga të dy qëlloi të ishte Umeri ibn El-Hatabi.

Tufejl ibn Amri e njoftoi Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* se fisi Devs kishte kundërshtuar dhe refuzuar thirrjen e tij, prandaj i tha që të lutej kundër tyre, po ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lut për ta, jo kundër tyre.

Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se Tufejl ibn Amr el Devsi dhe shokët e tij erdhën te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i thanë: "O i Dërguar i Allahut! Fisi Devs e kundërshtoi dhe e refuzoi (thirrjen), andaj lutu kundër tyre." Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ngriti duart - dhe në atë moment njerëzit menduan se ai do të lutej kundër tyre dhe thanë: "*Mbaroi Devsi.*" Por ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*O Allah! Udhëzoje fisin Devs dhe silli këtu!*"[375]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gëzohej kur ata e pranonin Islamin, prandaj tha: "*Kush hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit do të jetë i sigurt.*"

Kur e çliroi Mekën dhe kurejshët erdhën për të dhënë besën për Islamin, ai i priti duke u dhënë dorën dhe gëzimi i tij ishte i dukshëm. Gëzimi i tij shpërthente nga fytyra, derisa ensarët u frikësuan se ai mund të vendoste të qëndronte në Mekë dhe të mos

[373] "*Tefsir el Tabarij*", 21/525. "*El Muaxhemu el Kebiru li el Tabaranij*", 13026.
[374] Tirmidhiu, 3681.
[375] Buhariu, 2937. Muslimi, 2524.

kthehej me ta. Ata thanë: "Këtë njeri e ka zënë dëshira për vendlindjen e tij dhe ndjen mëshirë për fisin e tij."

Ebu Hurejre tregon se në këtë kohë zbriti shpallja - dhe kur vinte shpallja, nuk kalonte pa u vërejtur. Asnjëri nuk ngrinte sytë drejt të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* derisa shpallja të përfundonte. - Dhe i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*O ju ensarë!*" Ata u përgjigjën: "Urdhëro, o i Dërguar i Allahut!" Ai tha: "*Ju thatë: "Këtë njeri e ka zënë dëshira për vendlindjen e tij."* Ata thanë: "Është e vërtetë." Ai tha: "*Po cili është emri im, atëherë? Jo! Unë jam robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij. Unë u shpërngula për Allahun dhe për tek ju. Jeta është me ju dhe vdekja është me ju.*"

Atëherë, ata iu drejtuan atij duke qarë dhe duke thënë: "Pasha Allahun, nuk thamë atë që thamë veçse nga frika që mos ta humbasim dashurinë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u tha: "*Allahu dhe i Dërguari i Tij ju besojnë dhe ju arsyetojnë.*"[376]

Së katërti: Vërejmë suksesin e jashtëzakonshëm të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në kthimin e armiqësive të ashpra në dashuri të thellë. Prandaj, gjatë shfletimit rreth jetës së sahabëve do të hasësh shprehje të tilla që i kanë deklaruar para Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "Nuk kishte fytyrë më të urryer për mua sesa fytyra jote, por sot fytyra jote është fytyra më e dashur për mua. Nuk kishte fe më të urryer për mua sesa feja jote, por sot feja jote është feja më e dashur për mua." Këtë e tha Thumame ibn Uthali, që erdhi nga Nexhdi[377]. Të njëjtën e tha Amr ibn el As që erdhi nga Meka[378]. Po ashtu, e tha Safvan ibn Umeje ibn Halefi, e thotë Hind bint Utbe ibn Rebia.[379]

Së pesti: Vërejmë se armiqësitë rreth Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ngushtoheshin dhe nuk zgjeroheshin, tkurreshin dhe nuk përhapeshin. Ai *(paqja dhe mëshira e*

[376] Muslimi, 1780.
[377] Buhariu, 4372. Muslimi, 1764.
[378] Muslimi, 121.
[379] Buhariu, 3825. Muslimi, 1742.

Allahut qofshin mbi të) nuk i linte armiqësitë të përhapen dhe të shtrihen, por ua ngushtonte rrezen dhe i mbyllte në rrethin më të ngushtë të mundshëm. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk lejonte që armiqësia të trashëgohej nga baballarët te bijtë.

Kur Ikrime ibn Ebu Xhehli erdhi (për të hyrë në Islam), Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u ngrit për ta pritur dhe i doli përpara duke thënë: "*Mirë se vjen Muhaxhiri kalorës!*"[380]

Askund nuk është përmendur që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* t'ia ketë kujtuar ndonjëherë atij armiqësinë e babait të tij apo që t'ia ketë përmendur këtë në ndonjë formë. Për këtë arsye, e pranuan Islamin dhe e shoqëruan Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bijtë e atyre që kishin qenë armiqtë më të ashpër të tij. Dhe ata gjetën në praninë e tij kujdes, dashuri dhe përfshirje të plotë.

Së gjashti: Këto armiqësi asnjëherë nuk ndikuan te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në përcaktimin e qëllimeve apo drejtimin e orientimit. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e linte veten të udhëhiqej nga reagimet ndaj armiqësive, por ajo që e drejtonte dhe i caktonte rrugën ishin shpallja dhe përgjegjësia e tij.

Prandaj, Allahu e gëzoi zemrën e tij, ia qetësoi shikimin dhe ia përmbushi shpresën: ai pa se nga brezi i atyre që e kishin armiqësuar po dilnin njerëz që adhuronin Allahun pa i shoqëruar Atij askënd. Ai pa se bijtë e atyre që kishin luftuar kundër tij, tashmë, po dëshmonin profetësinë e tij: "Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut."

Së shtati: Pavarësisht numrit të madh të armiqësive dhe ashpërsisë së tyre, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk hoqi dorë në asnjë moment nga sjellja e lartë ndaj armiqve, ashtu siç i ka hije pozitës së tij të lartë si Pejgamber i Allahut.

Nuk është transmetuar prej tij asnjë fjalë e pahijshme, as ndonjë sjellje e ulët. Po ashtu, nuk gjejmë që, përkundër armiqësive të shumta që i përjetoi, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*

[380] Tirmidhiu, 2735.

të ketë fyer dinjitetin e ndonjë njeriu, apo të sillej në mënyrë të pahijshme me të, sado armik të ishte.

Madje, edhe ata që meritonin të vriteshin, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk lejoi të gjymtohen apo të torturohen për hakmarrje.

Së teti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia doli me sukses të përfshijë shumicën dërrmuese të armiqësive dhe t'i shndërrojë ato në dashuri e miqësi.

Ndërsa ato armiqësi që nuk mundën të përfshiheshin, ishin ato që buronin nga smira.

Ata që e kundërshtuan Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i shpallën armiqësi për shkak të smirës të tyre, ngulën këmbë në armiqësinë e tyre deri në fund të jetës.

Ebu Xhehli u tregua mendjemadh që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të ishte nga fisi Benu Abd Menaf, ndërkohë që ai vetë ishte nga fisi Benu Mahzum.

Hujej ibn Ahtab, hebreu, priste që pejgamberia të ishte në bijtë e Israilit, andaj e kishte zili dhe këmbënguli në armiqësinë e tij.

Abdullah ibn Ubej ibn Seluli e kishte problemin e tij me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për shkak se i "rrëmbeu" udhëheqjen që ishte përgatitur ta merrte.

Dhe kështu ata e morën zilinë e tyre me vete në varret e tyre. Ndërkaq Allahu bëri që feja e të Dërguarit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, të triumfojë mbi të gjitha besimet.

Së nënti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk i trajtoi armiqtë të gjithë njëlloj, ndaj edhe mënyra e tij e të vepruarit me ta ndryshonte sipas rastit.

Kjo shfaqet qartë në mënyrën si u soll me robërit e luftës në Bedër:

- disa prej tyre i liroi pa kërkuar shpërblim, si, për shembull, Ebu Iz el Xhumahi;

- nga disa të tjerë mori shpërblim në këmbim të lirimit të tyre;

- ndërsa ata që ishin kriminelë lufte i dënoi me vdekje.

Po ashtu, veproi edhe me fisin Hevazin pas betejës së Hunejnit.

Kjo është një mjeshtëri profetike në trajtimin e armiqve, në mënyrë që koalicioni i tyre të copëtohet dhe ata që kanë ndonjë mundësi për përmirësim të përfshihen gradualisht.

Së dhjeti: Allahu e gëzoi zemrën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i qetësoi shpirtin e tij ndaj armiqve.

Allahu e gëzoi me pranimin e Islamit nga shumë prej tyre pas një armiqësie të gjatë, siç ishin:

Amr ibn el Asi, Halid ibn el Velidi dhe Ebu Sufjan ibn Harbi; ose me pranimin e Islamit nga bijtë e tyre, si: Ikrima djali e Ebu Xhehlit, Safvani djali i Umejes dhe Um Kulthumi bija e Ukbe ibn Ebi Muajt.

Ndërsa ata që ngulën këmbë në armiqësinë e tyre ndaj të Dërguarit të Allahut, Allahu i qetësoi zemrën dhe i largoi mllefin, kur pa vdekjen dhe përfundimin e tyre.

I Dërguari dhe hipokritët

Pas *Hixhretit* të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në Medinë, disa nga krerët e saj mbetën në idhujtari dhe e përtypën me vështirësi ardhjen e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe të mesazhit, ndaj as nuk besuan dhe as nuk e ndoqën. Megjithatë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk iu drejtua atyre me gjë tjetër veçse me thirrje për në Islam, përmes urtësisë dhe këshillës së mirë.

Kur numri i muslimanëve në Medine u shtua dhe pozita e tyre u forcua, veçanërisht pas betejës së Bedrit, e cila tregoi qartë fitoren dhe përhapjen e kësaj feje, filloi të shfaqet hipokrizia. Kjo ndodhi pasi Abdullah bin Ubej bin Seluli pa se Islami, tashmë, triumfoi. Ai tha: "*Kjo çështje, tashmë, e mori drejtimin*" dhe këtu ai bashkë me ndjekësit e tij vendosën dhe shfaqën hyrjen e tyre në Islam, ndërsa brenda vetes fshihnin mosbesimin, urrejtjen ndaj Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe sajuan kurthe dhe intriga të shumta ndaj tij sa herë të kishin mundësi. Këtë

e treguan, ajetet e Kuranit që herë pas here zbrisnin duke paralajmëruar kurthet e tyre, duke përmendur cilësitë e tyre dhe duke zbuluar mashtrimet e tyre. Ata vërtet ishin pakicë në shoqëri, por një pakicë e rrezikshme dhe shkatërruese nëse nuk trajtohen me vigjilencë dhe kujdes.

Sidoqoftë, ekzistenca e hipokrizisë, në fakt, ishte një tregues i fuqisë së muslimanëve, pasi triumfi i tyre i detyroi këta njerëz ta fshehin mosbesimin dhe të shfaqin një besim të rremë - ndryshe nga ajo që ndodhi dikur në Mekë, kur disa muslimanë të pafuqishëm u detyruan të mbanin të fshehtë besimin dhe fenë e tyre.

Nga tërësia e lajmeve që kemi për hipokritët, kuptojmë se shumica e tyre ishin pleq nga shtresa e Abdullah bin Ubejit dhe pasuesve të tyre, të cilët nuk e kapërdinë dot thirrjen e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur ai mbërriti në Medinë. Ata panë sesi njerëzit po mblidheshin rreth tij dhe menduan se ardhja e tij do t'ua rrëmbente autoritetin dhe pozitën, ndaj nuk pranuan ta pasojnë. Por pas betejës së Bedrit, kur muslimanët u shtuan dhe u bënë më të fuqishëm, ata u detyruan të shfaqnin kinse e pranuan Islamin.

Duhet theksuar se këta ishin vetëm një pjesë e elitës dhe jo shumica, pasi shumë nga të moshuarit ensarë e pranuan Islamin dhe dhanë shembull të shkëlqyer në të, si: Abdullah bin Haram, Sead bin Ubadah, Amr bin Xhemuh, Jeman bin Hisli dhe të tjerë *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)*.

Një dëshmi për këtë është fjala e Hudhejfes kur u pyet për hipokritët dhe ai tha: "Nuk ka mbetur prej tyre - prej atyre që njiheshin për hipokritë - veçse katër vetë. Njëri prej tyre është një plak i moshuar që edhe po të pinte ujë të ftohtë, nuk do ta ndiente freskinë e tij."[381]

Kjo tregon se hipokritët vdiqën gjatë jetës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ose menjëherë pas tij.

Në jetën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, hipokrizia u tkurr dhe u tret dhe nuk qëndroi si një bllok i bashkuar. Përkundrazi, ata u shpërndanë dhe shumë prej tyre u

[381] Buhariu, 4658.

penduan nën ndikimin e shoqërimit me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, sjelljes së tij të mirë me ta dhe shenjave të qarta të pejgamberisë së tij. Disa ajete tregojnë për këtë pjesë të tyre që u penduan dhe gjendja e tyre u përmirësua.

Gjithashtu, hipokrizia nuk ishte diçka që trashëgohej. Bijtë e hipokritëve nuk ishin hipokritë - ndryshe nga çifutët - pra nuk kaloi te brezi i dytë, as te të rinjtë, por ishte një fenomen i kufizuar te disa pleq, dhe u shua me përmirësimin apo vdekjen e tyre.

Prandaj, nëse shikojmë praninë e tyre në mesin e shokëve të Pejgamberit, ajo ishte një shtrirje shumë e kufizuar. Edhe pse në një periudhë të caktuar të historisë së profetësisë ishin burim trazirash dhe frike, kjo gjendje nuk vazhdoi gjatë dhe nuk u përhap.

Për ta bërë më të qartë këtë theksojmë se:

- Asnjë nga muhaxhirët nuk ishte hipokrit, qoftë ata nga Meka apo nga vende e fise të tjera.
- Asnjë nga të rinjtë e ensarëve nuk ishte hipokrit.
- Asnjë nga fiset arabe përveç Evsit dhe Hazrexhit nuk kishte hipokritë, përveç disa beduinëve rreth Medinës, siç thotë Allahu i Lartësuar: **"*Ka beduinë në mjedisin tuaj, që janë hipokritë, por ka edhe ndër banorët e Medinës të atillë që janë këmbëngulës në hipokrizi…*"** (Et-Teube: 101)

Ndërsa beduinët që ishin larg Medinës, disa prej tyre mbetën në shirk deri në çlirimin e Mekës dhe disa të tjerë e pranuan Islamin me sinqeritet.

Numri i pakët i tyre bëhet i qartë edhe në hadithin e Ka'b bin Malikut për rastin e mbetjes së tij pas në ekspeditën e Tebukut, ku ai tregon se kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u kthye nga Tebuku: "Erdhën ata që kishin mbetur pas dhe filluan të kërkonin ndjesë dhe të betoheshin para tij. Ishin rreth tetëdhjetë e disa burra."[382]

Nëse në vitin e nëntë ata ishin rreth tetëdhjetë burra, atëherë krahasuar me ushtrinë që kishte dalë me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, e cila numëronte tridhjetë mijë veta, ata ishin thjesht një pakicë fare e vogël.

[382] Buhariu, 4418.

Sa i përket sjelljes së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* **me hipokritët, ajo kishte disa veçori të dallueshme, ndër të cilat:**

Së pari: Sjellja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me hipokritët ishte përfshirja me butësi, gjykimi sipas veprimeve dhe jo paragjykimi, pa hetuar të padukshmen, shfaqjen, sikur e vërteta rreth tyre është e panjohur. Nuk ka dëshmi më të qartë për këtë sesa fakti që ai nuk u përball me asnjërin prej tyre me akuzën për hipokrizi. Kështu që rruga e kthimit para tyre mbetej gjithmonë e hapur, ashtu sikurse kjo garantonte shmangien e formimit të ndonjë grupi që mund t'i bashkonte ndjenja e fanatizmit, krenarisë ose lidhjes fisnore, siç ndodhi kur Abdullah bin Ubej bin Seluli u tërhoq haptazi gjatë rrugës për në betejën e Uhudit, duke marrë me vete treqind vetë nga ushtria.

Megjithatë, nuk transmetohet që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ta ketë qortuar Abdullah bin Ubejin për këtë veprim, as që ta ketë përmendur ndonjërin prej atyre që u kthyen me të. Përkundrazi, ai e përfshiu situatën me urtësi dhe e kaloi pa u ndalur gjatë në të.

Së dyti: Nuk dihet që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ta ketë lënë pa ia falur namazin ndonjërit prej njerëzve me pretekstin e hipokrizisë, edhe pse Allahu i kishte shpallur: *"**Askujt prej hipokritëve, kur të vdesin, mos ia fal xhenazen, as mos rri afër varrit të hipokritit.**"* (Et-Teube: 84)

As Ebu Bekri, as Umeri, as Uthmani, as Aliu, e as ndonjë nga sahabët nuk vepruan ndryshe, përveç asaj që është transmetuar nga Umeri lidhur me pyetjen e tij drejtuar Hudhejfes.

Kjo, sepse hipokrizia nuk është çështje e dukshme, por një gjendje e fshehtë e zemrës. Dhe sepse ata që dëmtohen nga mos falja e namazit të xhenazes nuk është i vdekuri vetë, por të afërmit dhe fisi i tij.

Ndërkaq, vetë ajeti mbetet një paralajmërim dhe qortim për ta, se nuk janë të denjë për namazin e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbi ta dhe se namazi e lutja e tij për falje nuk do t'u sjellin dobi.

Së treti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e trajtonte me kujdes të veçantë çdo situatë që mund të shkaktonte trazira ose përplasje me hipokritët, sepse terreni i përshtatshëm për lëvizjet e tyre ishte atmosfera e tensionuar, të cilën ata e shfrytëzonin për të shtuar përçarjen dhe për të krijuar ndarje dhe rreshtime.

Prandaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e lajmëroi ushtrinë për nisje të menjëhershme, në një orë kur zakonisht nuk nisej, vetëm që të angazhonte ushtrinë me udhëtim dhe ecje.

Si rezultat i kësaj, njerëzit e fisit të tij shkuan dhe e qortuan për fjalët që kishte thënë.

Madje, djali i tij, Abdullah bin Abdullah bin Ubej - një burrë i mirë - erdhi te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i tha: "O i Dërguar i Allahut! Nëse dëshiron ta vrasësh babanë tim, më urdhëro mua dhe unë do të ta sjell kokën e tij." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bëri dua për të dhe i tha: *"Jo, por do sillemi me butësi me të dhe do t'i tregojmë shoqëri të mirë sa të jetë mes nesh."*[383]

Së katërti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mbyllte dyert e akuzës për hipokrizi dhe për dyshime para njerëzve për këtë çështje, në mënyrë që të mos hidhej akuza e rëndë e hipokrizisë mbi dikë që mund të ishte i pafajshëm. Kjo, sepse hipokrizia është një gjendje e fshehur që vetë njeriu e mohon dhe përballja me të në këtë çështje mund ta bëjë edhe më kokëfortë dhe më të ngulitur në të, duke ia mbyllur kështu rrugën e kthimit dhe pendimit.

Për këtë arsye, nuk transmetohet që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të ketë akuzuar dikë në mënyrë të drejtpërdrejtë për hipokrizi. Ai vetëm paralajmëronte për cilësitë e hipokrizisë, pa përmendur emrin e askujt.

Një herë një burrë tha: "Ç'u bë me Malik bin Duhshumin? Nuk po e shoh!" Një tjetër nga ata tha: "Ai është hipokrit, nuk e do as Allahun dhe as të Dërguarin e Tij!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Mos thuaj ashtu! A nuk e sheh se ai ka thënë: La ilahe il-lAllah* (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut)*, me të cilën kërkon fytyrën* (kënaqësinë) *e Allahut?"* Atëherë, ai tha: "Allahu dhe

[383] "*Siretu Ibn Hisham*", 2/292.

i Dërguari i Tij e dinë më mirë, por, për Zotin, ne nuk e shohim dashurinë dhe bisedat e tij përveçse me hipokritët!" Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Allahu ia ka ndaluar Zjarrit atë që thotë La ilahe il-lAllah, duke kërkuar me të fytyrën e Allahut.*"[384]

Këtu vërejmë se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e mbylli mundësinë që dikush të etiketohej si hipokrit për sa kohë që ai thotë *La ilahe il-lAllah*, sepse kjo është shenja e jashtme e Islamit që i bashkon të gjithë muslimanët dhe që i mbron ata nga akuzat. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e qortoi Malik bin Duhshumin për këtë çështje, sepse ata që ishin të akuzuar për hipokrizi, ndoshta, ishin të pafajshëm, siç ishte rasti i Malikut. Për më tepër, marrëdhënia njerëzore me hipokritët përmes dashamirësisë dhe bashkëbisedimit ishte një ndër mënyrat e trajtimit dhe shërimit të tyre. Me këtë përzierje dhe përfshirje, ata u përthithën nga shoqëria, u shkrinë brenda saj dhe nuk u kthyen në një grup të veçuar apo të rrezikshëm.

Duhet ditur se Malik bin Duhshumi, i cili u akuzua për hipokrizi, ishte një nga ata që kishte marrë pjesë në Betejën e Bedrit dhe se ishte pikërisht ai që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e dërgoi për të djegur 'Xhaminë e Sherrit' (Mesxhidu el Dirar). Ai mori një tufë të ndezur palmash nga shtëpia e tij, shkoi drejt xhamisë dhe e dogji atë.[385] Pra, ai ishte plotësisht i pafajshëm dhe larg çdo akuze për hipokrizi - *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*.

Së pesti: Me gjithë besimin e mirë dhe trajtimin e mirë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në vigjilencë të plotë ndaj intrigave dhe manovrave të hipokritëve. Ai paralajmëronte për cilësitë e tyre pa përmendur emra të veçantë dhe kështu lëvizjet e tyre mbeteshin të kufizuara. Siç tha ai: "*Namazi më i rëndë për hipokritët është namazi i jacisë dhe i sabahut dhe sikur ta dinin çfarë ka në jaci dhe në sabah, do të vinin për t'i kryer ato, edhe duke*

[384] Buhariu, 1186. Muslimi, 33.
[385] "*Siretu Ibn Hisham*", 2/530.

zvarritur."[386] Po ashtu, tha: "*Shenjat e hipokritit janë tri: kur flet gënjen, kur i besohet tradhton dhe kur premton shkel premtimin."*[387]

Po ashtu, Kurani tregon për cilësitë e tyre, madje zbret një sure e plotë me emrin e tyre, Surja *El-Munafikun*: "***Kur vijnë tek ti hipokritët, thonë: "Ne dëshmojmë se ti je vërtet i dërguari i Allahut!" Allahu e di se ti je i dërguari i Tij, por Ai dëshmon se hipokritët janë gënjeshtarë!***" (El-Munafikun: 1)

Dhe Surja *Et-Teube* ndryshe quhet "*Surja e zbulimit*", sepse ajo përmend qartë cilësitë e hipokritëve.

Nga kujdesi dhe vigjilenca e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj tyre është edhe kur po kthehej nga Tebuku natën dhe kur kaloi rrugën e Akabes, që ishte një rrugë e ngushtë dhe e vështirë, urdhëroi që askush të mos e ndiqte atë në këtë rrugë. Por kur arritëm në Akabe, pashë dymbëdhjetë kalorës që kishin dalë përpara. Unë e njoftova Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për ta, ai bërtiti ndaj tyre dhe ata kthyen shpinën dhe ikën me vrap. Pastaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* na pyeti: "*A i njohët ata?*" I thamë: "Jo, o i Dërguar i Allahut, ishin të maskuar, por ne njohëm kafshët e tyre." Ai tha: "*Ata janë hipokritët deri në Ditën e Kijametit. A dini çfarë donin?*" I thamë: "Jo!" Ai tha: "*Donin të pengonin Pejgamberin (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në Akabe dhe ta rrëzonin prej aty!*" I thamë: "O i Dërguar i Allahut, a nuk do të dërgosh tek fiset e tyre derisa çdo popull t'ju dërgojë kryet e mikut të vet?" Ai tha: "*Jo, nuk dua që arabët të flasin se Muhamedi ka luftuar kundër popujve, derisa Allahu i dha triumf, pastaj ai filloi t'i vrasë ata.*"[388]

Kjo vigjilencë dhe kujdes u bën shkak për të dështuar intrigat e tyre dhe për të shuar fitnet e tyre. Ndërsa trajtimi përfshirës i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për ta, shkaktoi shpërbërjen e grupit të tyre dhe dobësimin e tyre, duke bërë që të mos mbetej asnjë gjurmë e tyre. Hudhejfe tha: "Hipokrizia ishte

[386] Buhariu, 644, 657. Muslimi, 651.
[387] Buhariu, 2682. Muslimi, 59.
[388] "*Delailu el Nubuvveti*", Bejhakiu, 5/261.

vetëm në kohën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndërsa sot ajo është vetëm femohimi pas besimit."[389]

I Dërguari dhe bota e xhindëve

1. Xhindët janë një botë tjetër që Allahu i ka krijuar, ashtu siç ka krijuar botën e njerëzve dhe botën e engjëjve. Ata janë krijesa të ngarkuara me detyrën për të adhuruar Allahun, ashtu siç ka thënë i Lartësuari: ***"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë."*** (Edh-Dharijat: 56)

Pejgamberi ynë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është i dërguar për xhindët dhe njerëzit në përgjithësi. Ai është i Dërguari i Allahut për ne dhe për ta, gjë që nuk vlen për asnjë pejgamber tjetër, pasi çdo pejgamber është dërguar vetëm te populli i vet, ndërsa xhindët nuk ishin nga populli i tij. Ibn Hazmi ka thënë: "Nuk është dërguar te xhindët asnjë pejgamber nga njerëzit para Muhamedit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, sepse ai është i fundit i të dërguarve me pajtimin unanim të dijetarëve."

Me siguri të plotë e dimë se ata janë paralajmëruar, prandaj është e saktë se u kanë ardhur të dërguar nga mesi i tyre, ashtu siç thotë Allahu: ***"O tog i xhindeve dhe i njerëzve, a nuk ju patën ardhur të dërguar nga mesi juaj, për t'ju treguar shpalljet Tona dhe për t'ju paralajmëruar takimin me këtë ditë?"*** [390] (El-En'am: 130)

Ibn Abdu el Berri ka thënë: "Nuk ka kundërshtim se Muhamedi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është i Dërguari i Allahut për njerëzit dhe xhindët, si përgëzues ashtu edhe si paralajmërues. Kjo është një prej veçorive me të cilat ai është dalluar nga Pejgamberët e tjerë."[391]

---

[389] Buhariu, 7114.
[390] "*El Fasl fi el Milel ve el Ehvai ve el Nihal*", 3/147.
[391] "*El Temhijdu*", 11/117.

2. Dëgjimi i Kuranit prej xhindëve dhe takimi i tyre me të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Xhindët e dëgjuan të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe u takuan me të kur ai po kthehej nga Taifi, ndërsa po lexonte Kuranin në luginën e Nakhlas. Kur e dëgjuan, i thanë njëri-tjetrit: "*Dëgjoni me vëmendje!"* Për këtë ngjarje, Allahu shpalli: ***"O tog i xhindeve dhe i njerëzve, a nuk ju patën ardhur të dërguar nga mesi juaj, për t'ju treguar shpalljet Tona dhe për t'ju paralajmëruar takimin me këtë ditë?"*** (El-En'am: 130)

Kjo ndodhi në muajin Rebiu el Evvel, në vitin e njëmbëdhjetë të shpalljes.[392]

Kjo ishte një ndihmë dhe përforcim nga Allahu për të Dërguarin e Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, sepse pas vdekjes së Ebu Talibit, në vitin e dhjetë të shpalljes, kurejshët u bënë më të guximshëm në armiqësi dhe i shtuan ngacmimet ndaj tij. Ndërkohë që kishte shkuar edhe në Taif për t'i thirrur njerëzit në Islam, por ata e refuzuan dhe e përçmuan, ndaj ai u kthye i pikëlluar dhe i rënduar. Pikërisht në këtë gjendje, lajmi për besimin e xhindëve ishte për të një ndihmë dhe përforcim.

Më pas, pati disa raste të tjera kur xhindët e vizituan të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Ibn Abasi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u nis me një grup shokësh të tij për në panairin e Ukadhit. Ndërkohë, djajve u ishte ndaluar dëgjimi i lajmeve nga qielli, andaj ata u shpërndanë në lindje e perëndim të tokës për të zbuluar shkakun e këtij ndalimi. Grupi prej tyre që ishin nisur për në Tihama u drejtuan nga i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i cili ndodhej në luginën Nakhla, rrugës për në panairin e Ukadhit. Ai ishte duke falur namazin e sabahut me shokët e tij. Kur dëgjuan Kuranin, u ndalën dhe e dëgjuan me vëmendje, pastaj thanë: "Për Allahun, kjo është ajo që ju ka penguar nga lajmet e qiellit!" Më pas u kthyen te populli i tyre dhe thanë: ***"Me të vërtetë, kemi dëgjuar një Kuran të mrekullueshëm, i cili udhëzon në rrugën e drejtë dhe kemi besuar në***

[392] Ebu Naim el Asfehani, "*Delailu el Nubuvveti"*, 260.

të, prandaj kurrsesi më nuk do t'i shoqërojmë askënd Zotit tonë (në adhurim)***!"*** (El-Xhin: 1-2)

Atëherë, Allahu i shpalli të Dërguarit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: ***"Thuaj*** (o Muhamed)***: "Mua më është shpallur se disa prej xhindeve kanë dëgjuar*** (Kuranin) ***dhe kanë thënë: 'Me të vërtetë, kemi dëgjuar një Kuran të mrekullueshëm, i cili udhëzon në rrugën e drejtë dhe kemi besuar në të, prandaj kurrsesi më nuk do t'i shoqërojmë askënd Zotit tonë*** (në adhurim)***!"*** (El-Xhin: 1-2)

3. **Përgjigjja e xhindëve besimtarë** ndaj thirrjes së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte një përgjigje me besim dhe bindjeje, e cila u kthye në një thirrje të sinqertë drejtuar popullit të tyre, duke thënë: "***Posa dëgjuam udhëzimin*** (Kuranin)***, Ne besuam në të; e kush beson në Zotin e vet, nuk ka përse të frikësohet se mos dëmtohet, as se mos i bëhet padrejtësi.***" (El-Xhin: 13)

Ata shpjeguan se kishin marrë pjesë në namazin dhe lutjet e tij: ***"Kur robi i Allahut*** (Muhamedi)***, u ngrit t'i lutej Atij, ata*** (xhindet) ***u tubuan rreth tij si shtëllungë."*** (El-Xhin: 19)

Ata u bënë paralajmërues për popullin e tyre dhe i njoftuan: ***"O populli ynë! Ne dëgjuam një Libër të shpallur pas Musait, i cili vërteton shpalljet para tij, udhëzon nga e vërteta dhe tregon rrugën e drejtë." (***El-Ahkaf: 30)

Kjo përgjigje dhe ky pasim ndodhi ndërkohë që i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ende në Mekë, në një kohë kur ai u përball me sprova dhe vuajtje të mëdha.

Megjithatë, nuk ka asnjë dëshmi se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka kërkuar ndihmë nga xhindët besimtarë në ndonjë nga këto sprova, e as që ata kanë ndërmarrë ndonjë iniciativë për ta ndihmuar atë, ndonëse nevoja ishte e madhe.

Prandaj, kushdo që pretendon se i ka nënshtruar xhindët apo pretendon se i përdor ata për të përmbushur nevojat e veta apo për të zbuluar gjëra të fshehta, ai po pretendon diçka që nuk e ka pretenduar as krijesa më e mirë dhe më e dashur për çdo besimtar - qofshin njerëz apo xhindë - pejgamberi Muhamad *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Kjo tregon se nënshtrimi i xhindëve ishte një veçanti që Allahu ia dha vetëm Pejgamberit të Tij, Sulejmanit, alejhi selam,

dhe nuk i takon askujt pas tij. Për këtë arsye, Pejgamberi ynë, Muhamedi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, nuk e kërkoi një gjë të tillë.

4. Bota e xhindëve është e mbuluar për ne - si në pamje ashtu edhe në përfytyrim.

Allahu thotë: "***Ai dhe shpura e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata.***" (El-A'raf: 27)

Në librat që flasin për rregullat lidhur me xhindët ka mospajtime në lidhje me përshkrimet e tyre, por shumica e tyre janë spekulime dhe teprime. E drejta është që xhindët janë pjesë e botës së fshehtë, në të cilën besojmë pa u lodhur për ta përshkruar. Ashtu siç besojmë në jetën e ahiretit dhe në botën e engjëjve, ne besojmë në lajmet që Allahu dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* na kanë dhënë për ta dhe nuk shtojmë më tepër.

5. Gjatë gjithë jetës profetike nuk ka dëshmi se ndonjë musliman apo idhujtar ka qenë i prekur nga ndonjë pushtim prej xhindëve, e as që është përcjellë nga ndonjë sahabi që të ketë bërë rukje për ndonjë njeri të prekur nga xhindët, apo se xhindët kanë pushtuar dikë prej njerëzve.

Përkundrazi, është transmetuar prej tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ajo që tregon se ajo që ndodh me të sëmurin që bie në kriza nuk është një pushtim djallëzor, por është një sëmundje për të cilën njeriu shpërblehet nëse bën durim, ashtu siç shpërblehet për çdo sëmundje tjetër.

Atau ibn Ebi Rabah transmeton se i ka thënë Ibn Abasi: "A dëshiron të tregoj një grua nga banorët e Xhenetit?" Thashë: "Po!" Tha: "Kjo grua me ngjyrë të errët erdhi te i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i tha: "Unë bie në kriza dhe gjatë tyre zhvishem. Lutju Allahut për mua." Ai i tha: "*Nëse dëshiron, bëj durim dhe do të shpërblehesh me Xhenet, por nëse dëshiron, do t'i lutem Allahut që të shërojë.*" Ajo tha: "Do bëj durim, por lutju Allahut që të mos zhvishem." - Dhe ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lut për të."[393]

[393] Buhariu, 5652. Muslimi, 2576.

Nëse do të ishte shejtani ai që e kishte pushtuar, e të ishte ai që fliste në gjuhën e saj gjatë krizave, që të merrte nën kontroll trupin dhe mendjen e saj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk do ta linte që ta pushtonte e ta përplaste, por padyshim do të kishte bërë dua për të. Por ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mësoi asaj se durimi është më i mirë për të dhe se nuk ka nevojë të lutet që ajo të shërohet.

Kjo, sepse shpëtimi nga shejtani dhe kërkimi i mbrojtjes tek Allahu nga vesveset e tij është gjë e detyrueshme dhe e rekomanduar.

Fahreddin Razi thotë: "Shejtani nuk ka aspak fuqi të shkaktojë sëmundje apo dhimbje tek njerëzit dhe për këtë ka disa argumente:

Argumenti i parë: Nëse do ta pranonim se jeta, vdekja, shëndeti dhe sëmundja vijnë nga djalli, atëherë ndoshta jeta që kemi është nga veprimi i tij, e gjithçka e mirë që kemi ndoshta është nga djalli - dhe kështu nuk do të kishim më rrugë për të ditur se jeta, vdekja, shëndeti dhe sëmundja janë dhunti nga Allahu.

Argumenti i dytë: Po të kishte djalli këtë fuqi, pse nuk përpiqet t'i vrasë pejgamberët dhe të afërmit e Allahut? Pse nuk ua shkatërron shtëpitë? Pse nuk ua vret fëmijët?

Argumenti i tretë: Allahu i Lartësuar shpjegon në Kuran se shejtani nuk posedon as fuqi as pushtet mbi njeriun as mbi besimtarët e as mbi jobesimtarët, prandaj në fjalimin e tij drejtuar banorëve të zjarrit shejtani u thotë: "***Unë nuk kam pasur kurrfarë pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra e ju m'u përgjigjët.***" (Ibrahim: 22) Pra, shejtani vetë deklaron se fuqia e tij ndaj njerëzve është vetëm të bëjë vesvese, jo përmes pushtimit të trupit apo mendjes."[394]

Prandaj, ajo që bëjnë disa priftërinj të krishterë duke pretenduar se nxjerrin "shpirtrat e këqij" dhe disa muslimanë që bëjnë *rukje* në dhe "ceremoni" për nxjerrjen e xhindëve, shumica prej tyre janë mashtrime dhe hile për të mashtruar njerëzit e thjeshtë.

6. Ndër gjërat që na ka treguar Allahu dhe i Dërguari i Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për shejtanët, është se ata janë të dobët. Allahu i Lartësuar thotë: **"*Vërtet, dinakëria e djallit është e dobët.*"** (En-Nisa: 76)

[394] "*Tefsir el Razi*", 26/397.

Gjithashtu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka treguar se mjafton mbyllja e derës për t'i penguar ata. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Mbuloni enën e ushqimit, mbylleni enën e ujit, mbyllni derën dhe fikni kandilin, sepse shejtani nuk hapë enë, nuk hap derë, nuk ngre kapak dhe nuk zbulon enë. E nëse ndonjëri prej jush nuk gjen veçse një shkop për ta vendosur mbi enë dhe përmend emrin e Allahut, le ta bëjë.*"[395]

Po ashtu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka treguar se shejtani fryhet nga krenaria kur njeriu e mallkon drejtpërdrejt, prandaj na porosit: "*Mos thuaj: 'Qoftë i shkatërruar shejtani', sepse kur e thua këtë, ai fryhet dhe bëhet sikur është një shtëpi, dhe thotë: 'Me fuqinë time* (e munda)*.' Por thuaj: 'Bismil-lah - Me emrin e Allahut', sepse kur e thua këtë, ai zvogëlohet dhe dobësohet.*"[396]

Prandaj, frikësimi nga fuqitë e xhindëve dhe nga pushteti i ndikimit të tyre në tokë e mbi njerëz, ashtu siç dëgjojmë në tregime e rrëfenja të përhapura nëpër libra të pavërtetuara, është pjesë e trashëgimisë së kulturës popullore dhe jo të dijes së saktë dhe të lajmit të besueshëm.

[395] Muslimi, 2012.
[396] Ebu Davudi, 4982.

Kapitulli i Tretë:

Adhurimi i të Dërguarit

I Dërguari dhe lutja - duaja[397]

Vallë, si mund të jetë lutja e atij që është më i dituri prej krijesave për Allahun, më i druajturi drejt Tij dhe më i devotshmi ndaj Tij? Vallë, si e paraqet ai kërkesën e tij, përulësinë e tij, frikën e tij dhe ngashërimin e tij në lutje?

Një: Nga lutjet e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - dhe gjendja e tij gjatë lutjes kuptojmë se lutja e tij ishte një shijim i ëmbël i kërkesës drejtuar Allahut, një ndjesi e nderit të robërisë para Tij në momentin e përuljes përpara Tij. Lutja dhe përulësia janë një gjendje afërsie me Allahun, ku robi ndien zotërimin dhe madhështinë e Allahut, mëshirën dhe bujarinë e Tij, pasurinë e Tij dhe madhështinë e fuqisë së Tij, si dhe plotësimin e vullnetit të Tij. E gjithë kjo na shfaqet qartë në gjendjen e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjatë lutjes së tij:

Ai e fillonte lutjen me shprehje gjithëpërfshirëse lavdërimi dhe madhërimi për Allahun, derisa të ndieje se shpirti i tij ngjitej në botën e lartë në një lëvizje të shenjtë, të mbushur me ndjenja madhërimi dhe nderimi për Allahun, përmes lavdërimeve të bukura për Të.

Dy: Këto hyrje të lutjeve të tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* na tregojnë gjendjen e shijimit të lutjes dhe bukurinë e lavdërimit me fjalë të gjithanshme madhërimi për Zotin e tij, të cilit i drejtohet dhe i lutet.

Nga lavdërimet e tij në lutje është:

"O Allah!
Zoti i qiejve!
Zoti i tokës!
Zoti i Arshit të madh!
Zoti ynë dhe
Zoti i çdo gjëje!
Shpërthyesi i farës dhe i bërthamës!
Zbritësi i Tevratit, i Ungjillit dhe i Furkanit!

[397] Për këtë pjesë kam përfituar shumë nga libri i Shejh Muhamed el Gazalit *(Allahu e mëshiroftë)* me titull: "*Fennu el dhikr ve el dua inde khatemi el enbijai*".

Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e çdo gjëje!
Ti që e ke në dorë Tënde ballin e saj.
O Allah!
Ti je i Pari dhe nuk ka asgjë para Teje!
Ti je i Fundit dhe nuk ka asgjë pas Teje
Ti je i Dukshmi dhe nuk ka asgjë mbi Ty!
Ti je i Padukshmi dhe nuk ka asgjë poshtë Teje.
Largoje prej nesh borxhin dhe
Na shpëto nga varfëria!"[398]

Gjithashtu, thoshte:

"O Allah!
Unë i mbështetem pushtetit Tënd!
Askush nuk meriton të adhurohet përveç Teje!
Mos më shmang nga udhëzimi!
Ti je i Gjalli që nuk vdes!
Kurse xhindët dhe njerëzit vdesin!"[399]

Ky lavdërim i madh në hyrje dhe mbyllje të lutjes tregon se lutja profetike është një gjendje përqendrimi e plotë në kuptimet e robërisë ndaj Allahut dhe madhërimit për Të.

Tre: Ndër shenjat që tregojnë se ai e shijon vërtet lutjen, është lavdërimi që i bën Allahut për mirësitë e Tij të mëdha. Në lutjen e njohur si "Mjeshtri i kërkim-faljes" (Sejjid el Istigfar), ai shprehet me përulësi dhe sinqeritet: *"Të shpreh mirënjohjen time për mirësinë Tënde ndaj meje, e pranoj mëkatin tim. Më fal mua!"*[400]

Katër: Ashtu siç lutej me përulje, po ashtu qëndronte me përulje para Zotit të vet gjatë lutjes.

Nga shenjat e këtij qëndrimi me përulje janë: ngritja e duarve dhe shtrirja e tyre; ndonjëherë i ngrinte aq shumë sa i dukej bardhësia e sqetullave. Kur qëndroi të lutej në Arafat, i ngriti duart deri në nivel të kraharorit si lypësi i varfër që kërkon, në një mënyrë të thellë-thellë për të shprehur nevojën dhe nënshtrimin ndaj Allahut të Lartësuar.

[398] Muslimi, 2713.
[399] Buhariu, 7383. Muslimi, 2717.
[400] Buhariu, 6306.

Ndër skenat që tregojnë përulësinë dhe ngulmimin e tij në lutje është edhe thirrja e tij drejtuar Zotit Ditën e Bedrit. Ai nisi të lutej me ngulm, duke thënë: *"O Allah, përmbushe premtimin që më ke dhënë! O Allah, më jep atë që më ke premtuar! O Allah, nëse zhduket ky grusht njerëzish prej muslimanëve, nuk do të adhurohesh më në Tokë!"*[401] Në atë çast Ebu Bekri i thotë: "O i Dërguar i Allahut, mjaft më me këtë ngulmim në lutje ndaj Zotit tënd, sepse Ai do ta përmbushë premtimin që të ka dhënë."[402]

Një tjetër skenë e përulësisë në lutjet e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është heqja dorë nga mbështetja në fuqinë dhe aftësinë e vet dhe mbështetja e plotë në fuqinë dhe ndihmën e Allahut. Kjo shfaqet qartë në lutjet e shumta për qëndrueshmëri në fe, aq sa nëna jonë, Umu Seleme, çuditej sa shpesh ai thoshte: "*O Ti që i rrotullon zemrat, bëje zemrën time të palëkundur në fenë Tënde!*" Ai i tha asaj: "*Zemrat janë mes dy gishtave nga gishtat e Allahut; Ai i rrotullon ato si të dojë.*"[403]

Ky i Dërguar fisnik, që erdhi me udhëzim për mbarë botën, që ia mësoi njerëzimit fenë e Zotit të tyre dhe i drejtoi në rrugën e drejtë - madje njerëzimi nuk e njeh të vërtetën dhe fenë e drejtë përveçse nëpërmjet mësimit dhe udhëzimit të tij - megjithatë, ai shpeshherë i lutej Zotit për qëndrueshmëri në fe.

Kjo është një skenë e largimit nga vetëbesimi i tepruar dhe e përqendrimit me nderim dhe madhërim në mirësinë, favorin dhe dhuntinë e Allahut. Çdo udhëzim që kemi arritur dhe çdo rrugë të drejtë që kemi ndjekur është thjesht një dhuratë prej Tij, një udhëzim dhe sukses nga Allahu.

Ashtu siç bënte Ibrahimi *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* që vetë me dorën e tij i thyente idhujt, por me përulje lutej: ***"... Më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!"*** (Ibrahim: 35)

Dhe siç lutej Jusufi *(paqja e Allahut qoftë mbi të)*, pas një jete të gjatë me thirrje dhe bamirësi: ***"... Bëj që të vdes si musliman dhe më shoqëro me punëmirët*** (në botën tjetër)***!"*** (Jusuf: 101)

[401] Nesaiu, 8574.
[402] Buhariu, 2915. Muslimi, 1763.
[403] Tirmidhiu, 3522.

Me të vërtetë, të Dërguarit e Allahut janë njerëzit që e njohin më mirë se askush Allahun, ashtu sikurse janë më mirënjohësit ndaj Tij dhe më të përulur se askush tjetër qoftë në lutje kur i luten dhe qoftë në kërkesat e tyre kur i kërkojnë Atij.

Pesë: Gjithashtu, vërejmë se lutja përfshinte çdo situatë të jetës së tij. Kur shtrihej për të fjetur, lutej; kur dilte nga shtëpia, lutej; kur hynte në xhami, lutej; gjatë namazit, lutej; kur dilte nga xhamia, lutej; kur nisej për udhëtim, kur hynte në ndonjë qytet apo vend dhe kur kthehej nga udhëtimi - çdo situatë e tij kishte adhurimin dhe lutjen që i përshtatej.

Në lutjet e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ai përfshinte nevojat e dynjasë dhe të ahiretit; i lutej Allahut për çështjet e jetës së kësaj bote, ashtu siç i lutej për botën tjetër. Vështro këtë lutje të mrekullueshme ku i kërkon mbrojtje Allahut dhe i drejtohet Atij që ta ruajë nga shqetësimet dhe hidhërimet e jetës: "*O Allah, kërkoj mbrojtjen Tënde nga brenga dhe pikëllimi, nga paaftësia dhe përtacia, nga frika dhe koprracia, nga barra*[404] *e borxhit dhe nënshtrimi ndaj njerëzve.*"[405]

Ai kërkonte shpesh mbrojtje nga mëkati dhe borxhi. Kur e pyetën për këtë, ai tha: "*Kur njeriun e rëndon borxhi, ai flet e gënjen, premton e nuk e mban.*"[406]

Madje, edhe momentet intime me bashkëshorten kishin lutjen e vet: "*Bismil-lah* (me emrin e Allahut). *O Allah, na largo neve prej shejtanit dhe largoje shejtanin prej furnizimit që na jep* (fëmijëve)**.**"[407] Kështu lutja ishte për të një adhurim që përfshinte të gjitha aspektet e jetës së tij.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lutej për fenë dhe për jetën: "*O Allah, ma përmirëso fenë time, e cila është mbrojtësi i çështjes sime; ma përmirëso dynjanë time në të cilën kam jetesën time; ma përmirëso ahiretin tim, në të cilin do të kthehem. Bëje jetën rritje për mua në çdo të mirë dhe bëje vdekjen një çlirim për mua nga çdo e keqe.*"[408]

---

[404] "*El Nihajetu*", 3/96.
[405] Buhariu, 2893.
[406] Buhariu, 832. Muslimi, 589.
[407] Buhariu, 141. Muslimi, 1434.
[408] Muslimi, 2720.

Kur ndonjë njeri pranonte Islamin, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mësonte namazin dhe pastaj e urdhëronte që të lutej me këto fjalë: "*O Allah, më fal, më mëshiro, më udhëzo, më shëro dhe më furnizo.*" Pastaj i thoshte: "*Këto fjalë përmbledhin për ty dynjanë dhe ahiretin.*"[409]

Kështu, lutja përfshinte gjithçka që e preokuponte në këtë botë dhe në botën tjetër.

Gjashtë: Në lutjet e tij, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bënte lutje të përgjithshme që përmblidhte të mirat e dynjasë dhe të ahiretit.

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pëlqente lutjen e përgjithshme dhe linte çdo gjë tjetër." Për këtë arsye, një nga lutjet më të shpeshta të tij ishte: "*Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit.*"[410]

Ai e mësoi Aishen *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* të lutej me këtë lutje: "*O Allah, unë të kërkoj çdo të mirë, të afërt apo të largët, atë që e di dhe atë që nuk e di. Dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga çdo e keqe, e afërt apo e largët, ajo që e di dhe ajo që nuk e di. O Allah, të kërkoj prej së mirës që ta ka kërkuar robi dhe i Dërguari Yt dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja nga e cila ka kërkuar mbrojtje robi dhe i Dërguari Yt. O Allah, të kërkoj Xhenetin dhe çdo fjalë apo vepër që afron drejt tij dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga Zjarri dhe çdo fjalë apo vepër që afron drejt tij. Dhe të kërkoj që çdo caktim që më ke caktuar, ta bësh të mirë për mua.*"[411]

Shikoje këtë lutje: A ka ndonjë të mirë që nuk është përfshirë në këtë kërkesë? A ka ndonjë të keqe nga e cila nuk është kërkuar mbrojtje në këtë lutje profetike gjithëpërfshirëse?

Shtatë: Sahabët e tij gëzoheshin për lutjet e tij të bekuara e të mbara. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lutej për ta, lutej edhe për të vdekurit. Auf ibn Malik tregon: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* fali një xhenaze dhe unë mbajta mend nga lutja e tij këto fjalë: "*O Allah, fale atë, mëshiroje atë,*

[409] Muslimi, 2697.
[410] Buhariu, 6389. Muslimi, 2680.
[411] Ibn Maxhe, 3846.

falja gabimet, nderoje ardhjen e tij, zgjeroja vendbanimin, pastroje me ujë, borë dhe breshër dhe pastroje nga mëkatet sikurse pastrohet rroba e bardhë nga ndotja. Jepi një shtëpi më të mirë se e tij..." - Derisa dëshirova që të isha unë ai i vdekuri."[412]

Po ashtu, Umeti i tij u bekua me lutjet e shumta që ai i bënte vazhdimisht me përulësi, me ngulm dhe me përkushtim të thellë ndaj Zotit të tij, për të shmangur dënimin nga pasuesit e tij.

Kjo tregon se sa shumë e donte Umetin e tij dhe sa mëshirë kishte për ta.

Në një rast, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lexoi fjalët e Allahut rreth Ibrahimit

"***O Zoti im, ata kanë shmangur shumë njerëz*** (nga rruga e drejtë)***. Ai që më pason mua, është i fesë sime; ndërsa për atë që më kundërshton mua, Ti, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirëplotë...***"** (Ibrahim: 36) dhe pastaj fjalët e Isait: "***Nëse Ti i dënon ata - robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.***" (El-Maide: 118) Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ngriti duart dhe tha: "*O Allah! Umeti im, Umeti im!*" - dhe qau. Allahu i Madhëruar i tha Xhibrilit: "*Shko te Muhamedi, - dhe Zoti yt e di më mirë, - dhe pyete çfarë e ka bërë të qajë.*" Kur Xhibrili e pyeti, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tregoi se ishte duke u lutur për Umetin e tij. Atëherë, Allahu i Lartësuar tha: "*O Xhibril, shko te Muhamedi dhe thuaji: Ne do të kënaqim për Umetin tënd dhe nuk do të mërzisim.*"[413]

Nëse këto lutje kanë qenë për Umetin në këtë jetë, atëherë ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lutjen më të çmueshme - lutjen e veçantë të çdo Pejgamberi - e ruajti për ta bërë ndërmjetësim në Ditën e Gjykimit. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Çdo Pejgamber ka një lutje të pranuar që e bën dhe unë dëshiroj ta ruaj lutjen time si ndërmjetësim për Umetin tim në botën tjetër.*"[414]

[412] Muslimi, 963.
[413] Muslimi, 202.
[414] Buhariu, 6304. Muslimi, 198.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lut gjatë gjithë jetës së tij për Umetin me ngulm, kurse lutjen e veçantë e ruajti për ditën më të vështirë

Çfarë begatie më të madhe mund të ketë një popull sesa të jetë Umeti i këtij Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*? Sa bekim dhe nder i madh është të jesh i përfshirë në lutjet e tij në këtë botë dhe në botën tjetër?

I Dërguari dhe kërkimi i faljes - Istigfari

Kur i mbledh hadithet që flasin për *Istigfarin* - kërkimin e faljes nga ana e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe gjendjen e tij gjatë këtij *Istigfari*, pastaj i shikon ato nga këndvështrime të ndryshme, do të vësh re disa çështje të habitshme, ndër to:

Një: Shpeshtësia e *Istigfarit* dhe shqiptimi me zë, saqë shokët e tij i numëronin në një mexhlis të vetëm më shumë se shtatëdhjetë herë fjalët e tij: "*Estagfirullah ve etubu ilejhi*" (Kërkoj falje nga Allahu dhe pendohem tek Ai).

Dhe ti mund të pyesësh: Sa herë kishte kërkuar falje, pra, para se të vinte në këtë mexhlis? Dhe sa herë kërkoi falje pas saj?!

Një ditë del te shokët e tij ndërsa ata ishin ulur dhe u thotë: "*Nuk kam kaluar kurrë një mëngjes pa kërkuar falje nga Allahu njëqind herë.*"[415] Dhe "*mëngjesi*" është periudha mes lindjes së agimit dhe lindjes së diellit. Pra, që në fillim të ditës së tij, ai kërkonte falje njëqind herë - sa mund të ketë qenë *Istigfari* i tij gjatë pjesës tjetër të ditës?!

Dy: Gjithashtu, vërejmë se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, kur i lutej Zotit të tij, përdorte lutje të përgjithshme dhe përmbledhëse që përfshijnë të mirat e kësaj bote dhe botës tjetër, pa hyrë në detaje. Përjashtim bën Istigfari, ku ai hynte në detaje që nuk i përmendte në asnjë lutje tjetër, duke thënë: "*Zoti im, më fal mëkatin tim, gabimin tim, teprimin tim në çështjen time dhe gjithçka që Ti di më mirë për mua sesa unë vetë. O Allah, më fal mëkatet*

[415] Nesaiu, "*El Sunen el Kubra*", 10202.

e mia, qoftë të bëra me qëllim apo pa qëllim, të bëra me ose pa vetëdije - dhe të gjitha janë prezent te unë. O Allah, më fal çfarë kam bërë më parë dhe çfarë do të bëj më vonë, çfarë kam fshehur dhe çfarë kam shpallur haptas - Ti je i Pari dhe i Fundit, dhe Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë."[416]

Dhe dihet mirë se, po të kishte thënë thjesht: "*Më fal për çdo gjë që kam bërë*", do të ishte më e shkurtër dhe më e përmbledhur. Por fjalët e hadithit në kontekstin e *Istigfarit* kanë qëllim thellimin, përuljen, shfaqjen e robërisë dhe varfërisë së plotë para Zotit, si dhe sjelljen në vëmendje të llojeve të ndryshme të mëkateve për të cilat robi pendohet në mënyrë të detajuar - dhe kjo është më e bukur dhe më e plotë sesa përmbledhja.

Sepse *Istigfari* është një adhurim ndaj Allahut, një shfaqje e nevojës për Të, një përulje para Tij. Prandaj, sa më shumë që robi e shton istigfarin, e zgjat atë, e përsërit dhe e thotë me forma të ndryshme, aq më e plotë është robëria e tij, aq më shumë shfaq varfërinë dhe nevojën e tij, dhe aq më afër është ai me Zotin e tij, dhe më i madh është shpërblimi që merr.[417]

Tre: Këtu lind pyetja: Për çfarë dhe nga çfarë kërkon falje Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me një *Istigfar* kaq të shpeshtë dhe kaq të detajuar? Cili është ai mëkat për të cilin Zoti i tij i kujton e i thotë: "***Kërko falje për gjynahun tënd***" (Gafir: 55; Muhamed: 19); "***Për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme***"? (El-Fet'h: 2)

Ndërkohë që ne e dimë nga *Sira* e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* se jeta e tij ishte e pastër si kristali - pa mëkate, pa gabime dhe pa faje. Atëherë, nga çfarë kërkon falje dikush që ka jetuar një jetë kaq të pastër dhe të mbushur me adhurim dhe afrim tek Allahu?!

Përgjigjja ndaj kësaj pikëpyetje është kjo: Ky Pejgamber *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është më i dijshmi nga të gjithë krijesat rreth Allahut dhe më i devotshmi e më i frikësuari nga Ai. Për shkak të plotësisë së njohjes së tij për Zotin e vet, ai e di se çdo gjë që robi bën, sado të punojë, sado të ruhet dhe të jetë i përkushtuar, gjithmonë do të mbetet i mangët dhe i pamjaftueshëm për të

[416] Buhariu, 1120.
[417] Ibn Kajjim, "*Xhelau el efhami*", 343.

përmbushur të drejtën e Zotit të Madhërishëm, i Cili i ka përfshirë njerëzit me mirësitë dhe dhuntitë e Tij pa ndërprerje.

Prandaj, e sheh atë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që kërkon falje çdo mëngjes njëqind herë. Dhe mund të pyesësh: Çfarë ka ndodhur para këtij Istigfari të mëngjesit tek Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*? Përpara tij ka ndodhur: namazi i natës, vitri, dy rekatet e Sunetit të sabahut, pastaj namazi i sabahut, pastaj leximi i Kuranit të mëngjesit dhe *dhikri* i mëngjesit.

Pas gjithë këtyre adhurimeve të njëpasnjëshme, ai e pason ditën me njëqind herë Istigfar.

Ky *Istigfar* nuk është kërkesë për falje për ndonjë mëkat të kaluar, por ndjenjë dhe vetëdije e thellë për madhështinë e së drejtës që ka Allahu mbi ne, për mirësitë dhe dhuntitë e Tij të mëdha dhe për mangësinë tonë në përmbushjen e saj.

E drejta e Allahut është më e madhe sesa mund ta përmbushë ndonjë krijesë dhe adhurimi i robërve të Tij është më i vogël sesa madhështia e Tij - prandaj ai ngulmon në *Istigfar*.

Gjithashtu, *Istigfari* i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vjen pas kryerjes së veprave të mira, siç është pas përfundimit të namazit, ku kërkon falje tri herë, megjithëse sapo ka përfunduar një prej adhurimeve më të mëdha dhe më të vlefshme.

Dhe kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgëzua me fitoren (çlirimin), bashkë me këtë përgëzim i erdhi edhe lajmi i faljes së mëkateve të mëhershme dhe atyre që do të vinin, siç thotë Allahu: ***"Ne të dhamë ty një fitore të qartë, për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe që Allahu të të japë ndihmë të madhe."*** (El-Fet'h: 1-3)

Por kur ndodhi fitorja, i erdhi urdhri për të shtuar edhe më shumë *Istigfarin*, siç thotë Allahu i Lartësuar: "***Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi*** (i Mekës) ***dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.***" (En-Nasr: 1-3)

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ka thënë: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ka falur ndonjë namaz pas

zbritjes së sures ***"Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi"*** pa thënë në rukunë dhe sexhden e tij: *'Subhaneke Allahume ve bihamdike, Allahume igfir li'* (Lavdëruar qofsh Ti, o Zoti ynë! Ty të takon falënderimi! O Allah, më fal mua!), duke e zbatuar urdhrin e Kuranit."[418]

Pas njëzet vitesh përpjekjeje, sakrifice, thirrje dhe kumtese, pas arritjes së udhëzimit dhe kur njerëzit filluan të hyjnë në fenë e Allahut me turma, ai jo vetëm që nuk e ndalon *Istigfarin*, por e shton më shumë se më parë, duket sikur gjendja e tij thotë: "*O Zoti im! Me gjithë çfarë kam bërë për Ty, unë kërkoj falje për mangësinë time në kryerjen e së drejtës Tënde dhe për mosmirënjohjen time ndaj mirësive dhe begative të Tua. Prandaj më fal për mangësinë time në atë që kam bërë, sepse veprat e mia janë të pakta, përpjekjet e mia janë të pamjaftueshme, ndërsa e drejta Jote ndaj meje është madhështore. Prandaj, më fal për mangësinë time të madhe në përmbushjen e së drejtës Tënde madhështore!*"

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Askush nuk do të hyjë në Xhenet për shkak të veprave të tij*", ata e pyetën: "As ti, o i Dërguar i Allahut?" Ai tha: "*As unë, veçse nëse Allahu më mbulon me mëshirën e Tij.*"[419]

Këtë e sqaron edhe përgjigjja e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për Ebu Bekrin *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* kur ai i tha: "Më mëso një dua që ta them në namazin tim." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*Thuaj: O Allah, unë i kam bërë vetes padrejtësi të madhe dhe askush nuk i fal mëkatet përveç Teje. Prandaj, më fal me një falje nga ana Jote dhe më mëshiro, se Ti je me të vërtetë Falësi dhe Mëshiruesi*!"[420]

Ky është Ebu Bekri - më i miri i këtij Umeti pas Pejgamberit të tij - ai që do të thirret nga të gjitha dyert e Xhenetit. E, megjithatë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mëson një lutje në të cilën ai pranon padrejtësinë ndaj vetes - jo çfarëdo padrejtësie, por një padrejtësi të madhe - dhe kërkon me përulësi falje dhe mëshirë nga Zoti i tij.

Ky kuptim, kur bëhet i qartë për ne, tërheq vëmendjen e zemrave tona për nevojën tonë për *Istigfar* të kërkojmë falje. Kur ne

[418] Buhariu, 817. Muslimi, 484. "*Umdetu el Karii",* 6/95.
[419] Buhariu, 6463. Muslimi, 2816.
[420] Buhariu, 6326. Muslimi, 2705.

kërkojmë falje, nuk është e nevojshme të kujtojmë një mëkat të caktuar që e kemi para syve, por të kujtojmë madhështinë e së drejtës që Allahu ka mbi ne, begatitë e Tij të shumta dhe pafundësinë e mirësive të Tij dhe, njëkohësisht, të kujtojmë mangësinë tonë të madhe në përmbushjen e kësaj të drejte.

Ashtu siç na mësoi i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në duanë - lutjen e njohur si "Mjeshtri i kërkim-faljes" (Sejjidu el Istigfar): *"Të shpreh mirënjohjen time për mirësinë Tënde ndaj meje, e pranoj mëkatin tim. Më fal mua! Sepse askush nuk i fal mëkatet përveç Teje."*[421]

Prandaj, robi nuk ndahet kurrë, as natën e as ditën, nga nevoja për *Istigfar*, sepse nuk ndahet asnjëherë nga vazhdimi i mirësive dhe begative të Allahut ndaj tij. Duke shpresuar të jemi prej atyre që Zoti ynë do ta pranojë *Istigfarin* tonë, siç ka deklaruar: *"Robi Im e kuptoi se ai e ka një Zot që i fal mëkatet dhe që ndëshkon për to. Ju dëshmoj se Unë ia kam falur atij."*[422]

I Dërguari dhe namazi i natës - Kijamu el-lejl

Vallë, si ishte namazi i natës i atij që iu shpall porosia: "***Çohu*** (të falesh) ***gjithë natën, përveç një pjese të saj..."***? (El-Muzemil: 2) Dhe si të jetë gjendja e atij që iu shpall: "***Kaloje një pjesë të natës, si falje shtesë për ty*** (Muhamed)***!"***? (El-Isra: 79)

Gjendja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me namazin e natës është një gjendje mahnitëse. Kur ndalemi pranë saj dhe e meditojmë, e ndiejmë se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* teksa falet natën, është sikur shpirti dhe malli i tij ngjiten drejt botës më të lartë.

Kjo kuptohet nga disa aspekte:

Një: Zgjedhja e kohës së zgjimit për namazin e natës.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zgjohej në gjysmën e dytë të natës, në kohën kur ndodh zbritja hyjnore.

[421] Buhariu, 6306.
[422] Ahmedi, 7948.

Nëse e shikojmë këtë kohë në raport me ditën e plotë të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, vërejmë se ajo përbën kulmin e energjisë së tij, sepse paraprihej nga periudha më e gjatë e gjumit që ai bënte - nga fillimi i natës deri në mesin e saj. Sa i përket periudhave të tjera të gjumit, ato ishin të shkurtra, qoftë në fund të natës apo gjatë dremitjes së mesditës - *kajlula*.

Dy: Përgatitja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për namazin e natës.

Kur e shikojmë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke u zgjuar në mesin e natës, e vërejmë se ai përgatitej për namaz me një sërë veprimesh që të japin ndjesinë sikur po hyn në një adhurim në të cilin do të zhytet plotësisht. Kur zgjohej nga gjumi, fshinte gjumin nga fytyra e tij e ndershme, pastronte gojën e tij të pastër me *misvak*, e më pas ngulte shikimin nga qielli, sikur po bisedonte me yjet e tij dhe po shihte madhështinë e krijimit të Allahut në të, teksa recitonte: "***Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët...***" (Ali Imran: 190) derisa t'i mbaronte dhjetë ajetet e fundit të sures Ali Imran. Pastaj ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* çohej drejt një enë[423] uji të varur dhe merrte abdes prej saj, pastaj vishte rrobat dhe përgatitej për falje[424]. Nga përgatitjet e tij për falje ishte edhe përmendja e Allahut para saj - nëna jonë, Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të),* ka treguar se ai, para se të falej natën, thoshte: *Subhanallah* (dhjetë herë), *Allahu Ekber* (dhjetë herë) dhe *La ilahe il-lAllah* (dhjetë herë).[425]

Më pas e fillonte natën me dy rekate të lehta, si përgatitje për qëndrimin e gjatë në namaz[426].

Tre: Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* falej me namazin e natës - *tehexhud,* falja e tij të linte të kuptoje se ai ishte plotësisht i zhytur në të - i përqendruar krejtësisht.

---

[423] Enë prej lëkure që përdorej për mbajtur ujin, e cila e ftohte atë, shiko: "*El Nihajetu*", 2/506.
[424] Buhariu, 4563. Muslimi, 763.
[425] Nesaiu, "*El Sunen el Kubra*", 1617.
[426] Muslimi, 767.

Prej këtij përqendrimi është se, sapo e hapte namazin me tekbir, ai fillonte me lutjet hyrëse dhe përmendje të detajuara, të gjitha me lavdërim të madh ndaj Allahut, madhërim, lartësim dhe ndërmjetësim drejt Tij.

Ai e hapte namazin e natës me një hyrje të gjatë, ndryshe nga hyrja më e shkurtër që përdorte në namazet farze. E ndjeje se kjo hyrje ishte si një bisedë e ngrohtë me Allahun e Lartësuar, e mbushur me adhurim dhe shije të ëmbël shpirtërore.

Nga lutjet me të cilat e fillonte namazin e natës ishte edhe kjo: *"O Allah, vetëm Ty të takon lavdia. Ti je Rregulluesi i qiejve dhe i tokës dhe gjithçkaje që ka në to. Vetëm Ty të takon lavdia. Ti je Zoti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje që ka në to. Vetëm Ty të takon lavdia. Pushteti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje që ka në to është i Yti. Vetëm Ty të takon lavdia. Ti je drita e qiejve dhe e tokës dhe e gjithçkaje që ka në to. Vetëm Ty të takon lavdia. Ti je Sunduesi i qiejve dhe i tokës. Vetëm Ty të takon lavdia. Ti je e Vërteta, premtimi Yt është i vërtetë, takimi me Ty është i vërtetë, fjala Jote është e vërtetë, Xheneti është i vërtetë, Zjarri është i vërtetë, pejgamberët janë të vërtetë, Muhamedi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është i vërtetë, Dita e Kijametit është e vërtetë. O Allah, vetëm Ty të jam dorëzuar, në Ty kam besuar, në Ty jam mbështetur, tek Ti jam kthyer, për Ty kam luftuar dhe me ndihmën Tënde kam gjykuar. Më fal për atë që kam bërë më parë dhe atë që do të vijë, për atë që e kam fshehur dhe atë që e kam shpallur, dhe për atë që Ti e di më mirë sesa unë. Ti je i Pari dhe i Fundit, nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje."*[427]

E gjitha kjo hyjnore bëhej para se ai të fillonte të lexonte *Fatihanë*. Kur e lexonte *Fatihanë*, ai e recitonte me qetësi, ndalej në çdo ajet, pastaj lexonte pjesë të gjata nga Kurani - aq sa të dukej sikur shpirti i tij po ngjitej në qiell.

Kur falej me njerëzit, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu më i lehtë në falje, e shkurtonte atë. Por kur falej natën, ai ishte njeriu më i gjatë në namaz.

Hudhejfe *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se është falur një natë me të dhe thotë: "*E hapi namazin me suren El-Bekare. Mendova se do të përkulej në ruku pas 100 ajeteve, por vazhdoi. Mendova se do të përkulej pas 200 ajeteve, por prapë vazhdoi. Mendova se do ta mbaronte*

[427] Buhariu, 1120.

suren El Bekare e pastaj do të bënte ruku, por ai vazhdoi me suren El Nisa, pastaj me suren Ali Imran. E lexonte me ngadalësi dhe bukur. Nuk kalonte pranë ndonjë ajeti mëshire, përveçse lutej, dhe nuk kalonte pranë ndonjë ajeti ndëshkimi, përveçse kërkonte mbrojtje, dhe kur kalonte pranë ajeteve të lavdërimit, e lavdëronte Allahun. Pastaj, shkoi në ruku dhe tha: "Subhane Rabbijel Adhim" (I Lavdëruar është Zoti im i Madhërishëm) - *dhe rukuja e tij zgjati sa qëndrimi në këmbë. Pastaj tha: "SemiAllahu limen hamideh"* (Allahu e dëgjon atë që e falënderon), *dhe qëndroi gjatë pas rikthimit nga rukuja - pothuajse aq gjatë sa rukuja. Pastaj ra në sexhde dhe tha: "Subhane Rabbijel Eala"* (I lavdëruar është Zoti im më i Larti), *dhe sexhdeja e tij zgjati afërsisht sa qëndrimi në këmbë."*[428]

Abdullah ibn Mesudi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "*U fala një natë me Pejgamberin (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ai nuk pushoi së qëndruari në këmbë (nga gjatësia), saqë mendova një gjë të keqe." E pyetën: "Çfarë mendove?" Tha: "Mendova ta lë dhe të ulem, duke e lënë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në këmbë duke u falur."[429]

Pastaj, ai i drejtohej Zotit të tij në ruku dhe sexhde me një lutje të përulur, me nënshtrim të plotë, me ngulm të përkushtuar dhe me ëmbëlsinë e një bisede të dashur.

Katër: E imagjinoj Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në atë gjendje…

E imagjinoj Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në atë çast të natës - në heshtjen e thellë të natës së Medinës, e cila është mbështjellë nga një qetësi madhështore. Dhe në atë qetësi, ai e thyen heshtjen e natës me një lexim të përulur të Kuranit, me një lutje në përulje dhe me përmendje të shenjtë të Allahut.

E imagjinoj sikur malet e Medinës po e dëgjojnë dhe po e ndjekin ritmin e tij me përulje; sikur yjet po shndrisin në qiell, si të ishin sy që vështrojnë drejt tij. E imagjinoj të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* si të ishte ngjitur në një ecje të shenjtë drejt botës së lartë - sikur po sodit Arshin e Zotit të tij, të dukshëm për para syve të shpirtit të tij.

[428] Muslimi, 772.
[429] Buhariu, 1135. Muslimi, 773.

E imagjinoj sikur dritat hyjnore po e përfshijnë dhe ai ndodhet në një gjendje tjetër, në një botë tjetër, në një zhytje të plotë - një zhytje në ëmbëlsinë e adhurimit të pastër për Allahun e Lartësuar.

Dhe nuk është aspak për t'u habitur që ai qëndronte kaq gjatë në namaz, derisa këmbët e tij ënjteshin nga lodhja.

E kur u pyet: "*Përse e bën këtë, o i Dërguar, kur Allahu ta ka falur të kaluarën dhe të ardhmen tënde?*" Ai u përgjigj: "*A nuk duhet të jem një rob falënderues?*"[430]

Pesë: Duhet të dish, gjithashtu, se ky Pejgamber *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i kryente këto namaze në një shtëpi ku ishin larguar sendet e dynjasë dhe lukset e saj. Nuk kishte gjë tjetër ku të falej përveç një hasër e vogël të quajtur *khumra*, i cili mjaftonte vetëm për vendin e sexhdes.

Ndonjëherë, nuk gjente as këtë dhe falej mbi shtrojën ku flinte bashkëshortja e tij. Kur donte të bënte sexhde, e prekte lehtë që ajo të tërhiqte këmbët dhe, kur ai ngrihej për të qëndruar, ajo i shtrinte përsëri. E ndonjëherë, për të mos e shqetësuar, dilte dhe falej në xhami.

Gjashtë: Namazi i tij i natës *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i caktuar.

Namazi i natës për të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte një pjesë e qëndrueshme e jetës së tij. Ai qëndronte për adhurim një të tretën e natës, ashtu siç vepronte edhe profeti i Allahut, Davudi *(paqja e Allahut qoftë mbi të)*. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Namazi më i dashur te Allahu është namazi i Davudit (paqja e Allahut qoftë mbi të): ai flinte gjysmën e natës, ngrihej për një të tretën dhe flinte edhe një të gjashtën.*"[431]

Ai ngrihej në mesnatë dhe falte njëmbëdhjetë rekate - siç ka tregon Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Ajo thotë: "Nuk e di që i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ta ketë lexuar tërë Kuranin në një natë, as që të jetë falur tërë natën deri në agim dhe as të ketë agjëruar një muaj të tërë përveç Ramazanit."[432] Kjo

[430] Buhariu, 4836. Muslimi, 2820.
[431] Buhariu, 1131. Muslimi, 1159.
[432] Muslimi, 746.

ishte për shkak të kujdesit të tij për të drejtat e trupit dhe për të ruajtur fuqinë nga rraskapitja.

Shtatë: Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i zgjonte të afërmit për faljen e natës me butësi…

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk mjaftohej vetëm me adhurimin personal gjatë natës, por i nxiste edhe të afërmit e tij në këtë mirësi. Ai i zgjonte me dashuri dhe kujdes, pa ashpërsi e imponim. Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Një natë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi te unë dhe Fatimja, vajza e tij, dhe tha: *"A nuk po faleni ju?"* I thashë: "O i Dërguari i Allahut, shpirtrat tanë janë në dorën e Allahut. Kur Ai dëshiron të na zgjojë, na zgjon." Ai u largua pa thënë asgjë, por dëgjova tek largohej duke i rënë butësisht kofshës së tij dhe duke lexuar ajetin: ***"... Por njeriu kundërshton më tepër se çdo krijesë tjetër."*** (El-Kehf: 54)

Tetë: Në fund të jetës, edhe pse u rëndua fizikisht, ai nuk e la namazin e natës…

Kur trupi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lodh nga vizitat e shumta të njerëzve që e vizitonin për kërkesat dhe pyetjet e tyre dhe gjendja e tij filloi të rëndohej, të humbte freskinë dhe të mos kishte më atë fuqi fizike që kishte më parë. Nuk mund të qëndronte gjatë në këmbë si më parë, ndaj falej ulur.

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ndërroi jetë pa qenë pjesa më e madhe e namazit të tij ulur."[433] Kjo ndodhi rreth një apo dy vjet para vdekjes së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Megjithatë, ai kurrë nuk e braktisi namazin e natës, as në udhëtim, as në sëmundje, as në lodhje. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* dëshmon: "I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e linte kurrë namazin e natës. Edhe kur sëmurej apo ndjente lodhje, falej ulur."[434]

[433] Muslimi, 732.
[434] Ebu Davudi, 1307.

I Dërguari dhe Kurani

Një: Kur shikojmë gjendjen e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me Kuranin, e gjejmë atë si një lidhje të gjerë e gjithëpërfshirëse. Dhe kur shikojmë përkushtimin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj Kuranit, e gjejmë si një përkushtim të thellë. Kjo shfaqet qartë në leximin që ai i bënte Kuranit. Çfarë mendon për atë që i është shpallur ajeti: ***"Dhe lexo atë që të është shpallur ty nga Libri i Zotit tënd!"*** (El-Kehf: 27) Si mendon se ishte leximi i tij ndaj Kuranit? Ishte një lexim i vazhdueshëm i Kuranit që i përfshinte të gjitha kohët dhe mbushte tërë jetën e tij. Ai e lexonte Kuranin në këmbë, ulur, i shtrirë, me abdes dhe pa abdes. Madje, edhe në çaste afërsie dhe intimiteti me bashkëshortet, e shohim duke lexuar Kuran. Nëna jonë, Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, thotë: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbështetej në prehrin tim, ndërsa unë isha me menstruacione, dhe ai lexonte Kuranin."[435]

Madje, edhe në çaste frike e shqetësimi, qetësia e tij ishte Kurani. Në hadithin e Suraka ibn Malikut, kur ai ndoqi Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe Ebu Bekrin gjatë *Hixhretit* të tyre për në Medinë, pasi ishte shpallur ndjekja për t'i kapur, Suraka tha: "Hipa mbi kalin tim dhe u afrova me të gjithnjë e më shumë, derisa dëgjova leximin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i cili nuk kthehej aspak nga prapa, ndërsa Ebu Bekri kthehej shpeshherë."[436]

Pra, as orët e gëzimit nuk e largonin nga leximi i Kuranit, e as çastet e frikës nuk e hutonin prej tij.

Kur shtrihej në shtrat, e mbyllte ditën dhe e niste gjumin me lexim të Kuranit, aq sa ndonjëherë lexonte: ***"Elif, Lām, Mīm. Shpallja e këtij Libri, pa asnjë dyshim, është nga Zoti i botëve..."*** (Es-Sexhde: 1-2); ***"Qoftë i lartësuar Ai, në dorën e të Cilit është pushteti***

[435] Buhariu, 297. Muslimi, 301.
[436] Buhariu, 3906.

suprem dhe që është i Fuqishëm të bëjë çdo gjë!...” (El-Mulk: 1) e ndonjëherë edhe suret *Ez-Zumer*[437] dhe *El-Isra*.[438]

Dy: Kur donte të lexonte, kërkonte mbrojtje tek Allahu nga shejtani i mallkuar. Leximi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i Kuranit ishte lexim i qartë, me ngadalësi dhe me ritëm të bukur. Ai ishte që u urdhërua të lexonte në mënyrë të rregullt dhe të ngadalshme: ***“Lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë.”*** (El-Muzemil: 4)

Zëri i tij në leximin e Kuranit ishte më i ëmbli nga të gjithë dhe leximi i tij më i bukuri ndër të gjitha leximet. El Berra ibn Azib tregon: “E kam dëgjuar Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të lexonte në namazin e jacisë suren vet-Tini vez-Zejtun dhe nuk kam dëgjuar ndonjë njeri me zë më të bukur se ai.”[439]

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lexonte Kuranin, e lexonte me qetësi dhe me recitim të bukur, saqë Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thoshte: “I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e lexonte suren aq ngadalë dhe me përkushtim, saqë dukej sikur ajo ishte më e gjatë se suret më të gjata.”[440]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e këndonte Kuranin me melodi dhe bukuri. Ai thoshte: “*Allahu nuk e dëgjon askënd me më shumë kënaqësi sesa e dëgjon një Pejgamber me zë të bukur që e këndon Kuranin me zë të lartë*.”[441]

E gjithë kjo na tregon se kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lexonte Kuranin, ai e bënte këtë me shije, përqendrim të thellë dhe përjetim të plotë. Ishte një lexim i gjallë, bashkëveprues me kuptimet, me madhështinë e ajeteve dhe me vetëdijen se po lexonte fjalën e Allahut ashtu siç Ai ia kishte shpallur Xhebrailit dhe ashtu siç e kishte dëgjuar prej tij.

---

[437] Tirmidhiu, 3404.
[438] Tirmidhiu, 3405.
[439] Muslimi, 464.
[440] Muslimi, 733.
[441] Buhariu, 5023. Muslimi, 792.

Tre: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mësonte shokët e tij këndimin e Kuranit recitim *tertil*, një lexim që e përthith shpirtin me kuptimet e tij dhe që i jep zemrës kënaqësi e qetësi.

Për këtë arsye, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i ndalonte të rinjtë e zellshëm dhe të fuqishëm që ta lexonin tërë Kuranin brenda një nate, sepse thelbi nuk ishte thjesht të përfundosh, por të kuptosh e të shijosh. Siç transmetohet në hadithin e Abdullah ibn Amr ibn el As, i cili tregon: "Më tha Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të): "Lexoje Kuranin një herë çdo muaj."* I thashë: "Unë kam fuqi më shumë." Tha: *"Atëherë lexoje për çdo pesëmbëdhjetë ditë."* I thashë: "Kam fuqi më shumë." Tha: *"Lexoje për çdo shtatë ditë dhe mos e tejkalo këtë."*[442]

Katër: Ndërsa leximin e gjatë dhe përqendrimin e thellë me Kuranin, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ruante për namazin e natës - *tehexhud*.

Kur ngrihej për namazin e natës, ai lexonte me ngadalë, me përkushtim dhe përulësi. Abdullah ibn Mesudi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "U fala një natë me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai qëndroi në këmbë aq gjatë, saqë mendova një gjë të keqe." E pyetën: "Çfarë mendove?" Tha: "Mendova të ulem dhe ta lë të vazhdojë vetëm."[443]

Kjo sepse gjendja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me Kuranin ishte e veçantë, e pakrahasueshme me të tjerët. Kur ai lexonte Kuranin, përpara tij shfaqeshin kuptimet madhështore të fjalës së Allahut, prandaj qëndronte gjatë në këmbë dhe lexonte me recitim, me ngadalë, me thellim dhe me shije.

Pesë: Ramazani kishte një veçanti të posaçme në lidhje me Kuranin, sepse në të ishte zbritur: ***"Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani..."*** (El-Bekare: 185)

Takimi i parë i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me shpirtin e shenjtë - *Xhibrilin* dhe marrja e parë e shpalljes ndodhi në muajin Ramazan, në shpellën Hira. Ky muaj u bë sezon

[442] Buhariu, 1976. Muslimi, 1159.
[443] Buhariu, 1135. Muslimi, 773.

i përvitshëm për rizgjimin dhe përforcimin e lidhjes me Kuranin nëpërmjet studimit të tij me *Xhibrilin (paqja e Allahut qoftë mbi të)*. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndjente një gëzim të thellë dhe një gjendje shpirtërore të ngrohtë në këtë studim të përbashkët, e cila reflektohej edhe tek shokët e tij.

Ibn Abasi transmeton: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu më bujar. Dhe bujaria më e madhe e tij ndodhte në Ramazan, kur e takonte Xhibrili dhe ai e takonte çdo natë të Ramazanit për të studiuar me të Kuranin. Vërtet, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte më bujar me të mirat se era e lirë që fryn."[444] Pra, kjo gjendje e bujarisë së shtuar ishte fryt i bashkëveprimit me Kuranin nëpërmjet studimit me *Xhibrilin*.

Gjashtë: Ashtu siç adhuronte me leximin e Kuranit, adhuronte edhe me dëgjimin dhe përqendrimin në të.

Një natë, ndërsa kalonte pranë një shtëpie në një rrugicë të Medinës, dëgjoi një grua që lexonte Kuranin dhe po recitonte: ***"A ke dëgjuar për Ngjarjen Gjithëpërfshirëse*** (Kijametin)***?"*** (El-Gashije: 1) Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaloi, u përqendrua dhe filloi të reagonte emocionalisht, duke thënë: *"Po, po, kam dëgjuar!"*[445] Sikur thirrja e ajetit i drejtohej atij në atë moment dhe zemra e tij u trondit, ndjeshmëria e tij shpirtërore u ndez.

Një herë ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha Ibn Mesudit: *"Lexo të dëgjoj Kuranin prej teje."* Ai i tha: "O i Dërguar i Allahut, a ta lexoj ty ndërkohë që ai është zbritur mbi ty?" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Unë kam dëshirë që ta dëgjoj nga dikush tjetër."* Ibn Mesudi filloi të lexonte nga Surja *En-Nisa* dhe kur arriti tek ajeti: ***"Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellin dëshmitarë dhe të të sjellin ty*** (o Muhamed!) ***për dëshmitar mbi të gjithë ata?!"*** (En-Nisa: 41) Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Mjafton tani."* Ibn Mesudi tregon: "U ktheva nga ai dhe pashë që sytë e tij po rridhnin lot."[446]

---

[444] Buhariu, 6. Muslimi, 2308.
[445] *"Tefsir"* i Ibn Ebi Hatem, 10/ 3420.
[446] Buhariu, 5050.

Dhe ndër qëndrimet më madhështore të tij ndaj Kuranit ishte përkushtimi për mësimin e tij dhe përcjelljen te Umeti. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ai që hapi gojët e njerëzve për leximin e Kuranit. Të gjitha transmetimet e Kuranit, pavarësisht largësisë në kohë dhe vend, i referohen atij.

Ibn Mesudi ka thënë: "Kam marrë shtatëdhjetë sure nga goja e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të),* nga goja e tij në gojën time."[447] Ashtu siç Kurani fillimisht lexohej nga vetë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, po ashtu, edhe shkruhej në praninë e tij. Kur i zbriste një ajet, ai thërriste Zejd ibn Thabitin ose një tjetër nga shkruesit e shpalljes dhe i urdhëronte ta shkruante, duke i treguar vendin e tij në suren përkatëse.

Shtatë: Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ngrihej për të falur namaz natën, dëgjohej nga kraharori i tij një zë[448] i ngjashëm me zhurmën e kazanit që zien, nga të qarat e tij.

Abdullah ibn Shekhir transmeton: "E kam parë të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke u falur dhe nga kraharori i tij dëgjohej një zë si zhurma e mullirit për shkak të të qarit."[449]

Ky ishte një i qarë i brendshëm, i përmbajtur. Nuk kishte vajtime, zë të lartë apo ngashërim publik; ishte një zhurmë e lehtë, e mbuluar, që vinte nga thellësia e kraharorit të tij. Një lotim i thellë që shoqëronte recitimin e Kuranit gjatë faljes së natës, kur ai qëndronte vetëm me Zotin e tij, i zhytur në përmbajtjen dhe madhështinë e shpalljes.

Tetë: Pamja më madhështore e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me Kuranin ishte të jetuarit me të.

S'ad ibn Hisham ibn Amir erdhi në Medinë dhe shkoi tek Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* për të pyetur për disa çështje. I tha: "Oj Nëna e Besimtarëve! Më trego për moralin e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."* Ajo i tha: "A nuk e lexon Kuranin?" Tha: "Po!" Ajo tha: "Moral i të Dërguarit të

[447] Ahmedi, 4330.
[448] "*El Nihajetu*", 1/45.
[449] Ebu Davudi, 904.

Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte Kurani." Pastaj ajo recitoi fjalën e Allahut: ***"Ti je me virtyte madhore."*** (El-Kalem: 4) Sead tregon: "Aty e ndjeva se nuk më duhet të pyes askënd më për asgjë derisa të vdesë."[450] Kjo ishte një përgjigje e plotë dhe gjithëpërfshirëse.

I Dërguari dhe Dita e Xhuma

Një: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i kushtonte një përkujdesje të veçantë ditës së xhuma dhe e madhëronte atë. Ai e përmendte mirësinë e Allahut ndaj Umetit të tij përmes kësaj dite, udhëzimin e Tij drejt saj dhe dallimin e tyre ndaj popujve të tjerë. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: *"Allahu i largoi nga dita e xhuma ata që ishin para nesh. E shtuna ishte për çifutët dhe e diela për të krishterët. Pastaj Allahu na solli ne dhe na udhëzoi drejt ditës së xhuma. Kështu Ai e bëri xhumanë, pastaj të shtunën dhe më pas të dielën* (në radhitjen e vlerës)**.** *Po ashtu, ata do të na pasojnë në Ditën e Kijametit. Ne jemi të fundit në dynja, por të parët në Ditën e Kijametit - të parët për të cilët do të jepet gjykimi."*[451]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përmendte, gjithashtu, të mirat që përmban kjo ditë dhe ngjarjet madhore kozmike që Allahu i ka përcaktuar në të, duke thënë: *"Dita më e mirë në të cilën lind dielli është dita e xhuma. Atë ditë u krijua Ademi, atë ditë u fut në xhenet dhe atë ditë u nxor prej tij."*[452]

Dita e xhuma është festa javore e muslimanëve. Ajo ka shkëlqimin dhe hijeshinë e saj, ka rregullin dhe bashkimin e njerëzve. Për këtë arsye, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaloi agjërimin vetëm të kësaj dite, duke thënë: *"Dita e xhuma është ditë feste, prandaj mos e bëni ditën e festës suaj ditë agjërimi."*[453]

[450] Muslimi, 746.
[451] Muslimi, 856.
[452] Muslimi, 854.
[453] Ahmedi, 8140.

Gjithashtu, ai tha: *"Mos të agjërojë askush prej jush ditën e xhuma, përveç nëse e agjëron një ditë para saj ose një ditë pas saj."*[454]

Kjo e bën ditën e xhuma të ngjashme me ditët e Bajramit, për të cilat është e ndaluar agjërimi. Kjo për shkak se veçimi i saj me agjërim dobëson njeriun për t'u angazhuar në adhurimet e saj dhe nuk përputhet me atmosferën e bukurisë dhe bashkimit që e karakterizon këtë ditë.

Dy: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e madhëronte këtë ditë dhe e veçonte me adhurime që nuk i bënte në ditët e tjera. Ndër këto veçori është leximi në namazin e sabahut të ditës së xhuma i sureve *Es-Sexhde* dhe *El-Insan,* për shkak të përmbajtjes së tyre që lidhet me ngjarjet madhore të kësaj dite. Në to përmendet krijimi i Ademit, rikthimi në jetën tjetër dhe tubimi i njerëzve për llogari - ngjarje që lidhen me ditën e xhuma. Këto sure përmbajnë përkujtim të gjendjes së botës tjetër: gjendjen e banorëve të Xhenetit dhe kënaqësitë e tyre dhe gjendjen e banorëve të Zjarrit dhe ndëshkimin e tyre. Në to ka këshillë dhe përkujtim.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* porosit për përgatitje për faljen e xhumasë, përmes pastrimit, veshjes së rrobave të bukura, përdorimit të aromës së mirë dhe qëndrimit me edukatë në xhami.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* porositi *guslin* (larjen) për këtë ditë, duke thënë: *"Gusli i ditës së xhuma është obligim për çdo person që ka arritur moshën e përgjegjësisë."*[455]

Abdullah ibn Selami tregon se e dëgjoi të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të thoshte nga *minberi* ditën e xhuma: *"A nuk do të ishte mirë sikur ndokush prej jush, po të kishte mundësi, të blinte dy rroba të reja që t'i vishte për ditën e xhuma përveç rrobave të punës së përditshme?"*[456]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vishte rrobat më të bukura për ditën e xhuma. Kjo ishte një shenjë nderimi ndaj kësaj ngjarjeje të madhe fetare dhe të bashkimit të njerëzve në

[454] Buhariu, 1985. Muslimi, 1144.
[455] Buhariu, 858. Muslimi, 846.
[456] Ebu Davudi, 1078.

të. Këtë e tregon edhe fjala e Umerit *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* kur pa një njeri me emrin 'Utarid duke shitur një rrobë të bukur. Umeri i tha: "Sikur ta blije dhe ta vishje për ardhjen e delegacioneve, për festë dhe për ditën e xhuma!"

Këtë Umeri e tha duke e ditur se ishte praktikë e zakonshme e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që të vishej bukur për festa dhe për xhuma.

Tre: Nga shenjat e nderimit të plotë të ditës së xhuma është përdorimi i erërave të mira, aq sa njeriu të ketë mundësi, në mënyrë që bashkimi i njerëzve në xhami të jetë i shoqëruar me aromë të këndshme dhe atmosferë të pastër. Prandaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka nxitur përdorimin e parfumit për pjesëmarrësit në xhuma, duke thënë: "*Nuk ka njeri që lahet ditën e xhuma, pastrohet sa të mundet, lyhet me vaj* (vajra aromatike) *nga shtëpia e vet, apo përdor ndonjë parfum, pastaj del për në xhami dhe nuk kalon mes njerëzve* (në xhami), *pastaj fal atë që është caktuar për të falur dhe dëgjon në heshtje kur imami flet, përveçse do t'i falen mëkatet nga kjo xhuma deri në xhumanë tjetër.*" [457]

Për këtë arsye, sahabët - pasi Allahu i begatoi me të mira - e parfumonin xhaminë me erëra të këndshme përpara faljes së xhumasë. Tregohet se Nuajm ibn Abdullahu *el Muxhmiri* thotë se Umer ibn Hatabi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* urdhëroi që xhamia e Medinës të parfumohej me *temjan* çdo të ditë të xhuma në mesditë. Ishte pikërisht Nuajm ibn Abdullahu që kujdesej për këtë çështje: ai përgatiste qymyrin për *temjanin* dhe parfumonte me të xhaminë, ndaj mori nofkën "*El-Muxhmir*"[458] - ai që parfumon me *temjan*.

Katër: Nga etika e ditës së xhuma që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i ka theksuar, është edhe kjo fjalë e tij: "*Kushdo që lahet ditën e xhuma, përdor parfum nga ai që ka në shtëpi, vesh rrobat më të mira, pastaj del* (për në xhami) *me qetësi, fal çfarë i jepet mundësi të falë, nuk shqetëson askënd dhe dëgjon në heshtje kur del*

[457] Buhariu, 883.
[458] El Dhehebiu, "*Sijer Ealam el Nubela*", 5/227. El Muzzi, "*Tehdhijbu el Kemali*", 3/1421.

imami deri në përfundimin e namazit, do t'i falen mëkatet nga kjo xhuma deri në xhumanë tjetër."[459]

Këto sjellje - pastërtia, paraqitja e hijshme, aroma e mirë dhe sjellja e mirë - janë shprehje e madhërimit të kësaj ngjarjeje dhe të kësaj dite të bekuar. Ato janë, gjithashtu, një formë edukimi për njerëzit në drejtim të sjelljes së hijshme në ambiente publike.

Është me rëndësi të theksohet se këto udhëzime profetike janë dhënë në një shoqëri të varfër, në një ambient shkretinor ku këto norma nuk ishin të zakonshme dhe nuk u jepej rëndësi e veçantë. Prandaj, kjo etikë profetike ishte në të vërtetë një përgatitje dhe edukim për Umetin që të kultivojë ndjeshmërinë ndaj shijes së përbashkët, pastërtisë dhe mënyrës së sjelljes në publik.

Pesë: Banorët e Medinës kishin zakon të mblidheshin në Xhaminë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të falur xhumanë me të. Ata vinin nga lagjet dhe anët e ndryshme të qytetit, nga zonat e larta dhe të ulëta, dhe dita e xhuma ishte dita e përbashkët e takimit të njerëzve të Medinës nga pjesë të largëta, ku takoheshin me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, e dëgjonin fjalën e tij dhe njiheshin me njëri-tjetrin - prandaj ajo quhej xhumaja bashkuese.

Kur njerëzit mblidheshin dhe dielli kalonte zenitin, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dilte menjëherë pas zeniti, hynte në xhami dhe u jepte selam, pastaj ngjitej në *minber*, drejtohej me fytyrë nga njerëzit dhe u jepte selam, pastaj ulej.

Bilali fillonte ezanin dhe, pasi e përfundonte, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ngrihej dhe mbante dy hytbe, ndërmjet të cilave kishte një ulje të shkurtër.

Para se të përdorte *minberin*, ai mbante hytben duke u mbështetur në një trung druri që ndodhej në krye të xhamisë. Kur u vendos *minberi* dhe ai u ngjit për herë të parë në të, trungu rënkoi me një zë të ngjashëm me zërin e "*isharit*"[460], aq sa e dëgjuan të gjithë njerëzit në xhami. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut*

[459] Ahmedi, 24055.

[460] Ishari është deveja barrse në muajin e dhjetë derisa të pjellë, është përmendur si përngjasim kur ndahet nga të vegjlit e vet. Shiko "*Umdetu el Karii*", 6/217.

qofshin mbi të) zbriti dhe e përqafoi dhe trungu u qetësua menjëherë, duke bërë një zë si fëmija kur qetësohet. Pastaj ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, sikur ta lija atë* (të fliste)*, do të vazhdonte të rënkonte deri në Ditën e Kijametit.*"[461]

Gjithashtu, kur mbante hytben, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i drejtohej shokëve të tij me fytyrë dhe ata i përgjigjeshin me fytyrat e tyre, ndërsa ai i porosiste të qetësoheshin dhe të dëgjonin me vëmendje. Ai u tregonte se: "*Kur njeriu i thotë shokut të tij 'Dëgjo!', ai e ka kaluar kufirin* (ka folur pa vend)*. Kur prek gurin* (d.m.th. ndërpret namazin)*, edhe ai e ka kaluar kufirin. Ai që e kalon kufirin nuk ka xhuma.*"[462]

Gjashtë: Kur mbante hytben, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e fillonte duke lavdëruar Allahun dhe duke e falënderuar ashtu si e meriton Ai, pastaj recitonte dëshminë e besimit. Ai thoshte: "*Fjalimi që niset pa dëshminë e Shehadetit, është si dora e gjymtuar.*"[463]

Shpesh përdorte ajete nga Kurani dhe sure që përmbajnë mësime dhe këshilla. Um Hisham bint el Harith bint el Nuaman tha se ajo e mësoi suren "Kaf" nga goja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pasi ai i lexonte ato çdo të xhuma në hytbe.[464]

Hytbeja e tij e xhumasë ishte një predikim që theksonte çështjet më të rëndësishme të fesë, themelet e besimit, Xhenetin dhe Zjarrin, çfarë ka përgatitur Allahu për besimtarët që i përmbahen bindjes së Tij, çfarë i pret armiqtë e Tij dhe njerëzit mëkatarë.

Me fjalët e tij mbushte zemrat me besim ndaj Allahut, nderim dhe frikë për takimin me Të dhe për jetën e përtejme, duke i bërë xhematit të ndiejnë sikur po shohin Xhenetin dhe Zjarrin me sytë e tyre, kështu që zemrat dridheshin dhe lotët rridhnin dhe shokët e tij tundnin kokat e tyre duke qarë.[465]

---

[461] Buhariu, 3584.
[462] Ahmedi, 730. Buhariu, 934. Muslimi, 851.
[463] Ahmedi, 8018.
[464] Muslimi, 873.
[465] Shiko pjesën: I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* Ligjërues - *Hatib.*

Shtatë: Pasi përfundonte hytben e tij të dytë, Bilali thërriste *ikametin* për namaz dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* falej me njerëzit.

Në rekatin e parë të namazit të xhumanë ai lexonte suret: "*Sabbiḥ isme rabbike el eala"* dhe "*Hel etake ḥadithu el gashije"*, nganjëherë suren *El-Xhuma* që përmban porosinë për kryerjen e këtij namazi dhe nxitimin për të, si dhe largimin nga gjërat që e pengojnë kryerjen e tij.

Në rekatin e dytë lexonte suren: "*Idha xhaeke el munafikun"*, si paralajmërim për Umetin nga hipokrizia e rrezikshme dhe për t'u kujtuar që preokupimi për pasurinë dhe fëmijët nuk duhet t'i pengojnë nga namazi i xhumanë dhe përmendja e Allahut.[466]

Kur Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përfundonte namazin e xhumasë, kthehej në shtëpi dhe falte dy rekate sunet pas tij, siç transmetohet nga Ibni Umer që thotë se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjithmonë falte dy rekate në shtëpi pas namazit të xhumasë.[467]

Ai urdhëroi, gjithashtu, që pas namazit të xhumanë të falen edhe katër rekate shtesë, duke thënë: "*Kur dikush falë xhumanë, le të falë pas saj katër rekate."*[468] Disa dijetarë kanë thënë se ata që i falin këto rekate në xhami falin katër rekate, kurse ata që i falin në shtëpi, i falin dy rekate.[469]

Tetë: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkonte herët për në xhuma sapo hynte koha. Pas xhumasë njerëzit largoheshin duke ndjekur hijen. Seleme bin el Ekva thotë: "Ne mblidheshim për xhuma me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur dielli kalonte zenitin, pastaj pas xhumasë ktheheshim duke ndjekur hijen."[470] - Duke u përpjekur për të gjetur sado pak hije ngaqë dielli ishte pingul dhe hija nuk ishte zgjatur ende.

---

[466] "*Zadu el Mead"*, 1/529-530.
[467] Buhariu, 937. Muslimi, 882.
[468] Muslimi, 881.
[469] "*Zadu el Mead"*, 1/552.
[470] Muslimi, 860.

Nëntë: Ditën e xhuma, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe besimtarët angazhoheshin me përgatitjet për pjesëmarrjen në xhami për faljen e namazit dhe dëgjimin e hytbes dhe, për këtë arsye, rendi i ditës ndryshonte nga ditët e tjera. Nga këto ndryshime ishte shtyrja e ngrënies së drekës, që zakonisht e hanin para drekës, dhe e shtynin atë pas xhumasë, për shkak të angazhimit për përgatitjen dhe përpjekjen për të arritur në xhuma. Po ashtu, shtynin edhe dremitjen, pushimin e drekës, duke e lënë atë pas xhumasë, për shkak të përgatitjes dhe angazhimit për xhumanë. Sehl bin Sead tha: "Ne nuk e hanim drekën as nuk pushonim në drekë në kohën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përveç pas xhumasë."[471] Kjo do të thotë se ishin të zënë me përgatitjen për xhumanë dhe e shtynin ushqimin, gjumin dhe pushimin për më vonë.

Dhjetë: Një nga virtytet që përmendi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për ditën e xhuma është se në këtë ditë është një orë, në të cilën cilido besimtar që është duke iu lutur Allahut për ndonjë të mirë nga dynjaja apo ahireti, atij do t'i jepet.

Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përmendi ditën e xhuma dhe tha: *"Në të është një orë që çdo njeri musliman që gjendet duke falur, duke e lutur Allahun për diçka, do ta marrë atë."* - Dhe bëri me dorë duke treguar se është një kohë e shkurtër.[472]

Në lidhje me kohën e kësaj ore, ka dy mendime kryesore:

Mendimi i parë thotë se kjo orë është gjatë faljes së xhumasë në momentet e lutjes, si në sexhde ose në lutjet pas namazit, bazuar në hadithin: *"Çdo njeri musliman që gjendet duke falur, duke e lutur Allahun për diçka, do ta marrë atë."* Falja më e mirë në ditën e xhumasë është falja e xhumasë. Ebu Musa *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tha për orën e xhumasë se dëgjoi Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke thënë: *"Ajo orë është midis momentit kur imami fillon hytben deri kur falja të përfundojë."*[473]

---

[471] Buhariu, 939. Muslimi, 859

[472] Buhariu, 935. Muslimi, 852.

[473] Muslimi, 853.

Mendimi i dytë thotë se kjo orë është në orën e fundit të ditës së xhuma, sipas hadithit: *"Në ditën e xhuma është një orë që çdo njeri musliman që gjendet duke e lutur Allahun për një të mirë, do t'ia japë atë, ajo është pas ikindisë."*[474]

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve të parë, prandaj ata ia kushtonin pasditen e xhuma lutjeve, përmendjes dhe pritjes së faljes.

Në hadithe nuk kam gjetur ndonjë tregues se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i kushtonte mbrëmjes së xhuma *(domethënë natës që i paraprin ditës së xhuma)* një veprim të veçantë apo se rutina e tij ndryshonte në këtë ditë krahasuar me ditët e tjera, as në transmetimet e shokëve, Allahu qoftë i kënaqur me ta, dhe Allahu e di më së miri.

I Dërguari dhe Ramazani

Muaji i Ramazanit është koha e takimit të parë me zbritjen e Kuranit dhe takimi i parë me Shpirtin e Shenjtë, ditën kur zbritën ajetet e para të Kuranit mbi të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, teksa ai ndodhej në shpellën Hira.

Rreth e rrotull tij çdo gjë ishte errësirë dhe qetësi; asnjë lëvizje, asnjë zë. E përfytyroj Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në këtë shpellë, duke dëgjuar vetëm frymëmarrjen e vet, tingullin e nxjerrjes dhe thithjes së frymës, pa dëgjuar asgjë tjetër.

Në këtë heshtje madhështore, ndërsa Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndronte në atë shpellë të lartë ku nuk pritej të kalonte kush apo të vinte ndokush, veç qetësisë absolute dhe heshtjes së thellë - Pejgamberi yt *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në një përqendrim të thellë meditimi, i zhytur në mendime, si të ishte duke dëgjuar heshtjen dhe duke vështruar qetësinë - kur papritur e befasoi e vërteta: i erdhi Xhibrili (*paqja qoftë mbi të*).

[474] Ahmedi, 7803.

"***Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi*** (gjithçka), ***e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.***" (El-Alek: 1-5)[475]

Ishte kjo nata në të cilën zbriti shpallja e parë dhe ajetet e para të Kuranit në zemrën e Muhamedit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, duke i dhënë njerëzimit lajmin e mirë për dritën dhe ndriçimin, për një mesazh që është mëshirë dhe lumturi për të gjithë njerëzit.

Kjo ndodhi në muajin e Ramazanit dhe për këtë Allahu i Lartësuar e përshkroi Ramazanin me këto fjalë: **"*Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues*** (i së mirës nga e keqja)**."** (El-Bekare: 185)

Muaji Ramazan dhe Kurani

Ky muaj i bekuar, Ramazani, është si një enë që mbart një mirësi shumë të madhe - zbritjen e Kuranit. Njerëzimi, që nga koha kur Ademi zbriti në Tokë e deri në Ditën e Gjykimit, nuk ka përjetuar ndonjë ngjarje më të rëndësishme dhe më të bukur se sa zbritja e Kuranit në Ramazan.

1. Muaji i studimit të Kuranit

Prandaj, Allahu e bëri Ramazanin muaj për takimin e Xhibrilit *(paqja qoftë mbi të)* me Muhamedin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, takim të përvitshëm, çdo vit takoheshin për të mësuar dhe përsëritur së bashku Kuranin. Sa herë vinte Ramazani, ata shqyrtonin gjithnjë e më shumë pjesë nga Kurani, derisa erdhi Ramazani i vitit të dhjetë pas shpërnguljes në Medinë. Në atë vit, Xhibrili e shqyrtoi Kuranin me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dy herë.[476] Kjo ndodhi pas 23 vitesh zbritjeje të Kuranit.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kuptoi nga kjo që shpallja ishte drejt përfundimit - sepse pas kësaj nuk

[475] Buhariu, 3. Muslimi, 160.
[476] Buhariu, 4998.

zbritën veçse pak ajete. Dhe përderisa zbritja kishte mbaruar, kjo ishte shenjë se misioni i tij në Tokë ishte drejt fundit dhe se ai duhej të përgatitej për të kaluar në botën tjetër, tek Allahu i Lartësuar.

Na tregon Ibn Abasi *(Allahu qoftë i kënaqur me të dhe me babain e tij)* për këtë takim të veçantë gjatë Ramazanit, ndërmjet Xhibrilit dhe Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai thotë: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu më bujar. Dhe më bujar bëhej në Ramazan, kur e takonte Xhibrili. Ai e takonte çdo natë dhe së bashku lexonin Kuranin. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte më bujar në të mirat se era që fryn dhe sjell begati - nuk i kërkohej diçka, veçse ai e jepte."[477]

Ky hadith na tregon gëzimin shpirtëror që ndjente Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në Ramazan. Çdo herë që takohej me Xhibrilin dhe lexonin Kuranin, atij i kujtohej takimi i parë - kur mori shpalljen. Ky gëzim i brendshëm i shfaqej në sjelljen e tij të butë dhe në zemërgjerësinë e tij.

Ibn Abasi na përshkruan se një nga shenjat e kësaj gjendjeje ishte bujaria e jashtëzakonshme e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai ishte gjithmonë bujar, por në Ramazan bujaria e tij shumëfishohej, sepse në këtë muaj ai kishte lidhje të drejtpërdrejtë me botën e lartë, përmes leximit të fjalës së Allahut me Xhibrilin, i cili ia zbriti atë.

Pra, kjo ishte një dhuratë dhe mirësi që prekte të gjithë njerëzit - ndaj Ibn Abasi e krahason bujarinë e tij me shiun që bie për të mirën e të gjithëve në fshatra dhe në qytete dhe ky është një nga krahasimet më të bukura për Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Nëse kjo është bujaria e të Dërguarit, si është atëherë bujaria e Allahut që e dërgoi atë? Nëse kaq e madhe është bujaria e krijesës, atëherë sa e pafundme është bujaria e Krijuesit?!

[477] Buhariu, 6. Muslimi, 2308.

2. Përgatitja e Pejgamberit për Ramazanin

Një nga mënyrat se si Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përgatitej për Ramazanin ishte agjërimi gjatë muajit Shaban (muaji para Ramazanit). Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Ai agjëronte aq shumë sa thoshim se ai agjëron gjithmonë dhe hante (nuk agjëronte) aq shumë sa thoshim se ha gjithmonë, por nuk e kam parë asnjë muaj tjetër që ai të agjëronte më shumë se sa Shabanin. Ai e agjëronte të gjithë muajin Shaban - ose, thuajse, të gjithin."[478]

Ky agjërim i Shabanit ishte një përgatitje shpirtërore dhe fizike për Ramazanin, prandaj dijetarët e kanë krahasuar me sunetet para namazit farz - si një hyrje për të hyrë më lehtë dhe më bukur në adhurimin e madh që vjen pas.

Gjithashtu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përgëzonte shokët e tij me ardhjen e Ramazanit, duke u kujtuar vlerën dhe begatinë e tij. Ja disa prej fjalëve të tij: *"Kur hyn Ramazani, hapen portat e Xhenetit, mbyllen portat e Xhehenemit dhe prangosen shejtanët."*[479]

"Kush agjëron Ramazanin me besim dhe duke shpresuar shpërblimin nga Allahu, do t'i falen mëkatet e mëparshme."[480]

"Kush e kalon Ramazanin duke falur namaz nate me besim dhe shpresë në shpërblim, do t'i falen mëkatet e mëparshme."[481]

"Kush e kalon natën e Kadrit duke falur namaz nate me besim dhe shpresë në shpërblim, do t'i falen mëkatet e mëparshme."[482]

Prandaj, Ramazani është muaj i pastrimit nga mëkatet, sepse përmban shumë mundësi për të fituar falje dhe mëshirë nga Allahu Lartësuar.

[478] Muslimi, 1156.
[479] Buhariu, 3277. Muslimi, 1079.
[480] Buhariu, 38. Muslimi, 759.
[481] Buhariu, 37.
[482] Buhariu, 1901. Muslimi, 760.

3. Pejgamberi dhe dhjetë netët e fundit të Ramazanit

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kërkonte Natën e Kadrit posaçërisht gjatë dhjetë netëve të fundit të Ramazanit, sepse në to ajo pritet të ndodhë.

Kur shikojmë jetën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në këto net, e shohim se ai i përkushtohej me gjithë qenien e tij adhurimit dhe i kushtonte ato net vetëm për t'u afruar tek Allahu i Lartësuar. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndante pjesën e parë të Ramazanit mes namazit të natës dhe pushimit, por kur hynin dhjetë netët e fundit, ai i gdhinte netët e tij krejtësisht me adhurim - duke u marrë me lexim të Kuranit bashkë me Xhibrilin, me namaz nate, lutje dhe me adhurim të thellë deri në agim.

Një përshkrim shumë të bukur dhe të plotë të sjelljes së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në këto net e jep nëna jonë, Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Ajo thotë: "Kur hynin dhjetë netët e fundit të Ramazanit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e gdhinte gjithë natën, zgjaste në adhurim, i shtrëngonte rrobat (shenja përkushtimi të plotë) dhe i zgjonte familjarët e tij."[483]

Zakonisht, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* falej një të tretën e natës dhe pastaj pushonte, por në këto dhjetë net ai falej gjithë natën, lexonte Kuran, lutej dhe e përmendte Allahun deri në agim. Nëse planifikonte të hante syfyr, e bënte atë, por shpeshherë e vazhdonte adhurimin e tij deri në agim pa pushim, sikur nuk donte të humbiste asnjë çast pa qenë me Zotin e tij.

4. Itikafi

Një adhurim i veçantë që e praktikonte vetëm në dhjetë netët e fundit ishte *itikafi* - një qëndrim i tërhequr në xhami për t'u përqendruar plotësisht në adhurim, duke lënë pas angazhimet dhe kontaktet e përditshme. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut*

[483] Buhariu, 2024. Muslimi, 1174.

qofshin mbi të) e bënte *itikafin* në një cep të xhamisë, në pjesën juglindore që kishte dalje drejt shtëpisë së tij, ku kishte lëshuar një hasër në vend të derës, në mënyrë që të kishte vetmi dhe përqendrim. Në një rast, madje, kishte ngritur një tendë të vogël turke për të qëndruar brenda saj.

Itikafi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në xhami do të thotë shkëputje nga përzërja me njerëzit. Kështu, siç agjëruesi lë ushqimin, pijet dhe marrëdhëniet bashkëshortore për hir të Allahut, po ashtu, edhe në itikaf njeriu tërhiqet nga bisedat e tepërta me njerëzit, për t'u përqendruar plotësisht në shoqërinë dhe afërsinë me Zotin e tij.

Itikafi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në xhami dhe jo në shpellë në mal apo në shkretëtirë, sepse mesazhi i tij ishte të ndërveprojë me jetën de jo të shkëputej prej saj. ***"O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!"*** (El-Enfal: 24)

5. Agjërimi pa ndërprerje i Pejgamberit gjatë dhjetëditëshit të fundit

Nga adhurimet që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i bënte gjatë dhjetëditëshit (dhjetë netëve të fundit të Ramazanit) ishte agjërimi pa ndërprerje. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* agjëronte dy apo tri ditë radhazi pa ngrënë as iftar, as syfyr. Shokët e tij u habitën nga kjo ndërprerje e ushqimit dhe fakti që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përkushtohej kaq shumë në adhurim, duke mos ngrënë fare. Ata i thanë: "O i Dërguar i Allahut, ne duam të agjërojmë sikurse ti pa ndërprerje." Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigj: *"Jo, nuk jeni si unë; gjatë natës më ushqen Zoti im me ushqim dhe me pije."*[484]

Kjo është një veçori e veçantë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, sepse ai ishte në një gjendje të veçantë besimi të plotë (*jekin*) që askush tjetër nuk e përjetonte ashtu.

[484] Buhariu, 1961. Muslimi, 1103.

E si mund të ishte dikush tjetër si ai kur atij i ishin hapur shtatë palë qiej, ishte ngritur në shkallën ku dëgjonte zhurmën e penave teksa shkruanin pranë *Sidretul-muntahá*, kishte folur me Zotin e tij në Kuvendin e Lartë, kishte parë para syve Xhenetin dhe kishte parë Ferrin. Prandaj, dëshirat dhe kënaqësia e tij në adhurim nuk janë si kënaqësia e të tjerëve, ndaj ai mund të heqë dorë nga ushqimi dhe uji për t'u zhytur në adhurim.

6. Pejgamberi: Adhurim i plotë pa u shkëputur nga familja

Edhe pse Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përkushtohej plotësisht adhurimit gjatë dhjetë netëve të fundit të Ramazanit, ai nuk e ndërpriste lidhjen me familjen. Ai nuk largohej nga njerëzit që i donte; përkundrazi, u kushtonte vëmendje me butësi dhe dashuri. Aishja, nëna jonë e dashur, tregon: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e afronte te unë kokën e tij që t'ia krihja, ndërkohë që unë isha me menstruacione dhe ai ishte në itikaf. Ai nuk hynte në shtëpi, veçse për nevojat personale."[485]

Ky veprim i thjeshtë - që t'i ofronte kokën Aishes për t'ia krehur - nuk ishte vetëm nevojë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, por edhe një mënyrë për t'i dhënë gëzim bashkëshortes së tij. Sepse një grua ndjen lumturi kur kujdeset për burrin e saj me dashuri dhe përkushtim. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në adhurim, por edhe në dashuri. I jepte zemrës së Aishes atë çfarë kishte nevojë: afërsi, vëmendje, komunikim.

Mund të imagjinosh ndjesinë e Aishes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, duke ia krehur flokët dhe duke biseduar me të, edhe pse ishte në *itikaf*, i shkëputur për një adhurim total. Me këtë veprim Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bashkon midis dy adhurimeve, njëkohësisht edhe *itikafin* edhe mirësjelljen me familjen

Edhe gjatë *itikafit*, gratë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bashkoheshin tek ai në mbrëmje. Ato bisedonin, e shoqëronin për pak çaste dhe pastaj ktheheshin njëra pas

[485] Buhariu, 2029. Muslimi, 297.

tjetrës. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e bëri *itikafin* një përqendrim me Allahun, pa u shkëputur nga jeta, dashuria dhe njerëzillëku. Ai e dinte që bashkëshortja nuk ka nevojë vetëm për afrim fizik, por edhe për ndjesi shpirtërore bashkëshortore, fjalë, prani.

7. Pavarësisht përpjekjes së tij të madhe në adhurim, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i kujdesshëm që Umeti të mos e ngarkonte veten me atë që nuk mund ta përballonte

Njëherë, ai e vazhdoi agjërimin për dy-tri ditë pa iftar e pa syfyr. Sahabët u mahnitën, kërkuan të vepronin si ai, por ai ua ndaloi.

Po ashtu, ai u fal një natë me xhemat në itikaf dhe njerëzit u bashkuan pas tij. Të nesërmen ishin më shumë. Në natën e tretë, u shtuan edhe më shumë saqë xhamia u mbush. Por ai nuk doli nga çadra e tij dhe nuk e udhëhoqi faljen. Pastaj u tha: "*Unë e dija që ishit mbledhur, por pata frikë se mos kjo falje e natës do t'ju bëhet obligim, e pastaj nuk do të mund ta përballoni.*"[486]

8. Gjatë Ramazanit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i zgjonte edhe familjarët për t'u falur natën

Gjatë vitit, ai i zgjonte në mënyrë të butë, që të faleshin sa të mundeshin, por në dhjetë netët e fundit, ai i nxiste me më shumë këmbëngulje që të përfitonin nga këto net të çmuara. Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i zgjonte të gjithë të shtëpisë në dhjetë netët e fundit të Ramazanit - të vegjël e të mëdhenj - që kishin mundësi të falen."[487]

Me këtë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dëshironte përmbushjen e porosisë së Allahut të Lartësuar: ***"Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për***

[486] Muslimi, 761.
[487] Taberani, "*El Muaxhemu el Evsatu*", 7425.

këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim: jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj Allahut." (Ta Ha: 132)

Pikërisht për këtë arsye, gratë e tij *(Allahu qoftë i kënaqur me to)* janë ato që na kanë transmetuar pjesën më të madhe nga jeta e tij në Ramazan, sepse ato ishin pranë tij dhe pjesë aktive e adhurimit bashkë me të *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

I Dërguari dhe festa e Bajramit

Kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi në Medinë, banorët e saj kishin dy ditë feste në të cilat argëtoheshin. Ato ishin festa idhujtarie. Atëherë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i zëvendësoi me dy ditë të ndershme e madhështore, të lidhura me dy adhurime të mëdha që janë nga shtyllat e Islamit. Festa e Fitër Bajramit është gëzim për përmbushjen e agjërimit të Ramazanit dhe plotësimin e numrit të ditëve, kurse festa e Kurban Bajramit është gëzim për prezencën e haxhinjve për adhurimin e Haxhit dhe për veprat e dhjetë ditëve për ata që nuk janë në Haxh. Muslimanët nuk kanë festa të tjera fetare përveç këtyre dy ditëve.

Prandaj, festa me të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte veçori dhe veprime që shprehnin gëzim për mirësinë e Allahut, madhërim për Të dhe mirënjohje ndaj Tij - qoftë kjo përmes tubimit të madh, pamjes së hijshme apo gëzimit të shpallur.

Nga këto ishin:

Së pari: Për festën e Bajramit, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vishte rrobat e tij më të bukura. Ai kishte një rrobë të bukur dhe të hijshme, të cilën e vishte për dy Bajramet dhe për ditën e xhuma. Një herë vishte dy mantela të gjelbër[488], e një herë tjetër një mantel të kuq.[489]

[488] Ebu Davudi, 3021.
[489] Ibn Sead, "*ElTabekatu el Kubra*", 1/388.

Para se të dilte për Fitër Bajramin, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hante disa hurma dhe i hante në numër tek,[490] ndërsa për Kurban Bajramin nuk hante gjë derisa të kthehej nga falja dhe të hante nga kurbani i tij.[491]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lahej për festat e Bajrameve dhe kjo është vërtetuar nga shokët e tij – sahabët,[492] sepse festa është një tubim i përgjithshëm, ashtu siç është edhe dita e xhuma.

Ai parfumohej para se të dilte për festë dhe kjo tregon madhërimin e këtij adhurimi, si dhe përputhjen me prirjen e natyrshme të shëndoshë për zbukurim, bukuri dhe paraqitje të hijshme në tubimet publike.

Së dyti: Vendndodhja e vendfaljes së Bajramit dhe namazit të *istiska*-së (lutjes për shi) në kohën e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte aty ku sot ndodhet xhamia e Gamames. Ajo është rreth pesëqind metra në jugperëndim të xhamisë së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Vendi ku Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e fali Bajramin nuk ishte xhami, por një hapësirë e lirë jashtë qytetit, pa asnjë ndërtim. Xhamia që gjendet sot aty përfshin vetëm një pjesë të saj.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dilte me njerëzit dhe e falte namazin e Bajramit në këtë vend të hapur, sepse xhamia e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk mjaftonte për të gjithë banorët e Medinës kur mblidheshin për namazin e Bajramit. Në këtë falje vinin edhe banorët e rrethinave dhe lagjeve të largëta, bashkë me gratë, për të cilat i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kishte theksuar rëndësinë e daljes së tyre për në namazin e Bajramit.

Umu Atije *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Jemi porositur që ditën e Bajramit të gjitha të dalim për në xhami, edhe gratë me menstruacione; po ashtu, edhe vajzat që qëndrojnë në shtëpi, që të dëshmojnë mbledhjen e muslimanëve dhe thirrjen e tyre, ndërsa

[490] Buhariu, 953.
[491] Ahmedi, 22984.
[492] Ibn el Mulekkin, "*El Bedru el Munijru*", 5/41.

gratë me menstruacione të rrinë pak më larg vendit të faljes. Një grua tha: 'O i Dërguari i Allahut, ndonjëra prej nesh nuk gjen mbulesë?' Ai tha: *"Le t'ia huazojë shoqja e saj nga mbulesa e saj."*[493]

Ky tubim i gjerë, ku mblidhen banorët e zonave të largëta në një vend të hapur që i përfshin të gjithë - burra e gra - është një mënyrë për të thelluar ndjenjën e përkatësisë ndaj bashkësisë dhe për të forcuar lidhjet ndërmjet tyre. Prandaj i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i urdhëroi gratë të dilnin për namazin e Bajramit dhe tha: *"Të dëshmojnë mbledhjen e muslimanëve."*

Ky është tubimi i madh i bashkësisë së muslimanëve që i mbledh të gjithë së bashku në një vend.

Së treti: Nga veprimi i sahabëve shihet se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ngrinte zërin dhe i shtonte *tekbiret* gjatë rrugës për në namazin e Bajramit, duke iu përgjigjur kështu fjalës së Allahut të Lartësuar: ***"Që ta madhëroni Allahun*** (në fund të agjërimit)***, për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë."*** (El-Bekare: 185)

Kur arrinte në vendfalje, e fillonte me faljen e namazit përpara hytbes, pa ezan dhe pa *ikamet*.[494] Ai falte dy rekate, ku në rekatin e parë bënte shtatë tekbire radhazi, duke përfshirë edhe tekbirin e hapjes[495] dhe mes çdo dy tekbireve ndalonte pak.

Pasi përfundonte tekbiret, fillonte leximin e Kuranit: lexonte Fatihanë, pastaj në njërën nga rekatet lexonte suren: ***"Kâf. Betohem në Kuranin e lavdishëm!"*** (Kaf: 1) dhe në tjetrën: ***"U afrua Ora dhe u ça Hëna!"*** (El-Kamer: 1)[496]

Ndoshta ndonjëherë lexonte: ***"Lavdëro emrin e Zotit tënd, më të Lartit"*** (El-A'la: 1); ***"A ke dëgjuar për Ngjarjen Gjithëpërfshirëse*** (Kijametin)***?"*** (El-Gashije: 1)[497]

Pasi përfundonte leximin, bënte tekbir dhe shkonte në ruku. Kur përfundonte rekatin dhe ngrihej nga sexhdeja për rekatin e dytë, bënte pesë tekbire radhazi dhe pastaj vazhdonte leximin.

---

[493] Buhariu, 351. Muslimi, 883.
[494] Ebu Davud, 1146.
[495] Ebu Davud, 1149.
[496] Muslimi, 891.
[497] Muslimi, 878.

Së katërti: Pasi e përfundonte namazin, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* drejtohej nga njerëzit, ndërsa ata rrinin ulur në rreshta. Nuk kishte një *minber* ku ngjitej, por e mbante hytben duke qëndruar në këmbë. Hytben e niste me lavdërim për Allahun, gjatë saj këndonte tekbire. I këshillonte dhe i përkujtonte njerëzit.

Xhabir ibn Abdullahu *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* ka thënë: "Kam qenë i pranishëm me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në faljen e Bajramit. Ai e fali namazi para hytbes, pa ezan dhe pa ikamet. Pastaj u ngrit duke u mbështetur te Bilali, këshilloi për devotshmëri ndaj Allahut, nxiti për bindje ndaj Tij, i këshilloi dhe i përkujtoi njerëzit. Pastaj shkoi te gratë, i këshilloi dhe i përkujtoi ato dhe u tha: "*Jepni sadaka, sepse shumica prej jush janë dru për Xhehenemin.*" Atëherë, u ngrit një grua e thjeshtë[498], me fytyrë ngjyrë të mbyllur[499] dhe pyeti: "Përse, o i Dërguar i Allahut?" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigj: "*Sepse ju e teproni me ankesa dhe jeni mosmirënjohëse.*" Pastaj ato filluan të jepnin sadaka nga stolitë e tyre, duke i hedhur në rrobën e Bilalit vathët dhe unazat e tyre."[500]

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lejoi atyre që kishin marrë pjesë në faljen e namazit të Bajramit të qëndronin për hytbe, pastaj të largoheshin dhe u lejoi që kur Bajrami të binte në ditë të xhuma, falja e Bajramit t'u mjaftonte pa qenë nevoja të merrnin pjesë edhe në faljen e xhumasë.[501]

Ky është nga lehtësimi i adhurimeve për njerëzit, sepse ata vijnë nga zona të largëta për t'u bashkuar në falje dhe më pas merren me angazhimet e ditës së Bajramit, prandaj qëndrimi i gjatë apo kthimi përsëri për xhuma mund të jetë i vështirë për ta. Ky është një shembull i qartë i lehtësisë që sjell Legjislacioni Islam dhe i mëshirës në adhurimet fetare.

---

[498] Një grua as shumë e shquar, as e panjohur. Shiko: "*Ikmal el Mual-lim*", 3/294.
[499] Mollëzat e faqes pak në të zezë, ose ngjyrë e zezë e përzier me një ngjyrë tjetër. Shiko: "*El Nihaje*", 2/374.
[500] Buhariu, 304. Muslimi, 885.
[501] Ebu Davudi, 1070.

Po ashtu, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndryshonte rrugën në Bajram: shkonte në një rrugë dhe kthehej nga një tjetër.[502] Është thënë se e bënte këtë që të përfitonin nga bekimi i tij njerëzit e të dy rrugëve dhe që të krijonte afri dhe ngrohtësi me banorët e lagjeve që ndodheshin përgjatë të dy rrugëve - në vajtje dhe në kthim.[503]

Sot ato rrugë nuk ekzistojnë më, ndërsa vendfalje e atëhershme ka mbetur një vend i hapur, me një shesh të gjerë ndërmjet saj dhe xhamisë së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Së pesti: Bajrami është një sezon i begatisë dhe mëshirës hyjnore dhe këto dy të mira janë burim i gëzimit dhe i manifestimit të haresë. Udhëzimi dhe praktika e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka qenë nxitja për ta shfaqur hapur këtë gëzim dhe hare në ditët e Bajramit.

Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Kur i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi në Medinë, ata kishin dy ditë në të cilat luanin. Ai tha: "*Allahu ua ka zëvendësuar ato me dy ditë më të mira: Ditën e Kurbanit* (Kurban Bajramit) *dhe Ditën e Fitrit* (Fitër Bajramit)."[504]

Ky hadith dëshmon se shfaqja e haresë në Bajram është e pëlqyer dhe se ajo është porosi e ligjit të Allahut për robërit e Tij. Vetë zëvendësimi i festave të injorancës me dy Bajramet islame tregon se është e lejueshme të bëhen në to veprime gëzimi e loje që nuk janë të ndaluara, sikurse vepronin njerëzit në festat e tyre para Islamit - por me ndryshim në kohë dhe kuptim, pasi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* caktoi kohën e festës dhe arsyen e saj.

Këtë e thekson edhe ndalimi i agjërimit në ditët e Bajramit. Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ka thënë në një hytbe në ditën e Kurban Bajramit: "O njerëz! I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ju ka ndaluar nga agjërimi në këto dy festa: njëra është dita e Fitër Bajramit, në të cilën çelni agjërimin, dhe tjetra është dita në të cilën hani nga kurbani juaj."[505]

---

[502] Buhariu, 986.
[503] "*Fet'hu el Bari*". 2/472.
[504] Nesaiu, 1556.
[505] Buhariu, 5571. Muslimi, 1137.

Gjithashtu, Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri tek unë, ndërsa tek unë ishin dy vajza që po këndonin me def këngën e Buathit. Ai u shtri në shtrat dhe mbuloi fytyrën me rrobën dhe e ktheu nga muri. Erdhi Ebu Bekri dhe i qortoi ato duke ju thënë: "A instrumente e shejtanit në shtëpinë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)?!"* Atëherë, Pejgamberi e zbuloi fytyrën dhe iu kthye Ebu Bekrit me fjalët: *"Lëri ato, o Ebu Bekr, sepse çdo popull ka festën e vet dhe kjo është festa jonë."*[506]

Një skenë tjetër e gëzimit të Bajramit në prani të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndodhi kur një grup nga Etiopia u mblodhën në xhami dhe filluan të kërcejnë me mburoja dhe heshta,[507] ndërsa fëmijët u bashkuan dhe u dëgjuan zërat e tyre. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e dëgjoi këtë dhe i tha Aishes: *"Oj faqekuqe! A dëshiron t'i shikosh?"* Ajo u përgjigj: *"Po!"* Ai e vuri pas vetes, faqen e saj mbi faqen e tij dhe e mbuloi, ndërsa ajo shikonte. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i nxiste ata dhe u thoshte: *"Vazhdoni, o bijtë e Arfidës, le të dinë çifutët se në fenë tonë ka lehtësim. Unë jam dërguar me fenë e drejtë dhe të lehtë."*[508]

Këto skena të gëzimit e festimit të Bajramit ndodhnin në praninë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ai jo vetëm që i pranonte, por edhe i miratonte me buzëqeshje e pjesëmarrje. Prandaj dijetarët kanë thënë: "Shfaqja e haresë në Bajram është nga motot e fesë."

Duket qartë se kjo shprehje e gëzimit dhe reagimi ndaj atmosferës së festës ishte një sjellje spontane që e shfaq çdo popull sipas traditës dhe kulturës së tij. Etiopasët festuan duke kërcyer me mburoja e heshta, ashtu si në vendin e tyre. Vajzat tek Aishja kënduan me def këngët e ditëve të lashta të popullit të tyre, siç këndohej dikur në Buath.[509]

---

[506] Buhariu, 2906. Muslimi, 892.
[507] *"Umdetu el Karii"*, 6/276.
[508] Buhariu, 986. Muslimi, 892. Nesaiu, 8902.
[509] Buhariu, 2906. Muslimi, 892.

Çdo popull dhe çdo kohë ka mënyrat dhe mjetet e veta të lojës dhe zbavitjes, të cilat i përfshin hapësira e gjerë dhe e pafund e fesë tonë. Vërtet, në fenë tonë ka hapësirë, pasi Pejgamberi ynë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është dërguar me fenë e drejtë dhe të hapësirës.

I Dërguari dhe Haxhi[510]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pas emigrimit në Medinë, kreu vetëm një Haxh - i njohur si **Haxhi i Lamtumirës**, në vitin e dhjetë pas *Hixhret*it. Ndërkohë që Haxhi ishte bërë obligim në vitin e nëntë, ai nuk e kreu atë vit për disa arsye, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte ardhja e shumtë e delegacioneve tek ai në Medinë. Për t'iu përkushtuar atyre, ai e shtyu Haxhin për vitin tjetër dhe dërgoi Ebu Bekrin për të udhëhequr Haxhin në atë vit.

Në vitin e dhjetë, kur ai njoftoi se do të shkonte për Haxh, shumë njerëz erdhën në Medinë për të udhëtuar me të, të tjerë iu bashkuan rrugës dhe një numër tjetër e takoi në Mekë. Kështu u mblodhën rreth tij grupe të shumta si asnjëherë më parë dhe, sipas dëshmive, një grumbullim i tillë nuk kishte ndodhur më parë dhe nuk u përsërit më deri kur u lehtësuan udhëtimet dhe mjetet e transportit në shekullin e kaluar.

Sahabët e nderuar ruajtën me përpikëri çdo detaj nga Haxhi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, e përçuan me saktësi dhe ia transmetuan Umetit. Ne do të qëndrojmë me shpirt e mendje në disa prej këtyre pamjeve madhështore të Haxhit, për të nxjerrë kuptimet e tyre të thella dhe për të ndjerë madhështinë e këtyre çasteve:

E para: Madhështia e adhurimit të tij për Allahun e Lartësuar dhe përulësia para Tij

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu që e njihte më shumë Allahun dhe që i përulej më shumë se

[510] Përmbledhje nga libri "*Sifetu Haxhxheti el Nebijji Ke Enneke mealhu"* (Forma e Haxhit të Pejgamberit sikur të ishe me të), Abdul Vehhab el Turejri.

askush tjetër. Ai veshi ihramin dhe nisi udhëtimin e Haxhit, duke hipur në devenë e tij, mbi një shalë të thjeshtë dhe një rrobë të vjetër që nuk vlente më shumë se katër dërhemë, ndërsa me përulësi këndonte: *"Lebbejke... - Të përgjigjem Ty, o Allah, me një Haxh të sinqertë jo për t'u dukur as për t'u dëgjuar."*[511]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me përkushtim të thellë e këndonte telbijen dhe i porosit sahabët ta këndojnë me zë të lartë: *"Lebbejke Allahume lebbejke, lebbejke laa sherike leke lebbejke, innel-hamde ven-niamete leke vel-mulku, laa sherike leke."*

"Erdha Zoti im erdha! Erdha, vetëm për Ty, erdha! I gjithë lavdërimi është vetëm për Ty, Po ashtu, edhe mirësia dhe pushteti! vetëm për Ty!"[512]

Në **Arafat**, pasi fali drekën dhe ikindinë në fillim të kohës së drekës, qëndroi në deve rrëzë malit[513] me përulje dhe përkushtim ndaj Allahut. Gjatë lutjes ai ngriti duart në nivel të kraharorit, sa iu dukën të bardhat e sqetullave. I shtriu duart si nevojtarë përpara Zotit të tij, i zhytur në lutje, sikur nuk donte të humbiste asnjë çast të kësaj dite pa e përmendur Allahun apo pa iu lutur Atij. Ashtu qëndroi deri në perëndimin e diellit - në përkujtim, lutje dhe përulësi.

Në **Muzdelife**, sapo agoi mëngjesi dhe dolën rrezet e para të agimit, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u ngrit me nxitim dhe fali sabahun në fillimin e kohës së tij, që më pas të kishte kohë të mjaftueshme për përkujtim dhe përgatitje për pjesën tjetër të adhurimeve. Më pas hipi në devenë e tij, u ngjit në kodrën **Kuzah** - një kodër që mbikëqyr xhaminë e Muzdelifes - dhe ngriti duart duke lavdëruar, madhëruar, lartësuar dhe njësuar Allahun dhe vazhdoi me telbije, në përgjigje të fjalës së Allahut të Lartësuar: ***"E, kur të ktheheni nga Arafati, përmendni Allahun në vendet e shenjta! Përmendni Atë që ju ka udhëzuar në rrugën e drejtë, sepse ju më parë ishit të humbur!"*** (El-Bekare: 198) - derisa, pothuajse, ra dielli.

Në **Mina**, pas hedhjes së gurëve në Akabe, ai nisi të madhërojë Allahun me tekbire dhe njerëzit bënë të njëjtën gjë, derisa Mina

511 Ibn Maxhe, 2890.
512 Buhariu, 1549. Muslimi, 1184.
513 Qëndroi rrëzë malit dhe nuk u ngjit mbi të.

oshtinte nga zërat që madhëronin Allahun.[514] Pastaj, në mesditën e ditës së njëmbëdhjetë, pasi kaloi koha e drekës, duke ecur në këmbë, u drejtua për tek gjuajtja e gurëve. Filloi me **xhemren e vogël**, ku gjuajti shtatë gurë me fytyrë nga kibla dhe duke kënduar tekbir për çdo gjuajtje, pastaj shkoi përtej turmës, u kthye nga kibleja, ngriti duart dhe u lut gjatë. Pastaj shkoi tek **xhemra e mesme** dhe bëri njësoj si më parë. Më pas shkoi tek **xhemra e Akabes**, u drejtua nga kibla gjuajti shtatë gurë pastaj nuk qëndroi aty.

Kështu, nëse vëzhgojmë skenat e Haxhit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i gjejmë të gjitha të mbushura me adhurim të sinqertë ndaj Allahut, përulje, thirrje me përkushtim dhe nënshtrim të plotë ndaj Madhështisë së Tij.

Së dyti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kalonte nëpër këto hapësira të gjera shkretinore, male, lugina e kodra - dhe sikur këto vende t'i rrëfenin atij historinë e tyre, t'i tregonin se kush kishte kaluar më parë. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i shihte me sytë e shpirtit hijet e pejgamberëve të mëhershëm, të cilët kishin udhëtuar drejt kësaj Shtëpie të lashtë për ta vizituar. Ishte sikur i shihte përpara vetes, sikur ecte bashkë me ta në këtë rrugëtim.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thoshte: *"Junusi biri i Metit (paqja e Allahut qoftë mbi të) Musai, Hudi dhe Salihu, të gjithë kanë bërë telbije, të gjithë e kanë kryer Haxhin në Shtëpinë e Lashtë."*[515]

Ky është një adhurim i hershëm që në lashtësi, të cilin e kryen pejgamberët e Allahut dhe të Dërguarit e Tij *(paqja e Allahut qoftë mbi ta)* në gjurmët e të cilëve do të pasojnë në fund të kohës edhe Isa, biri i Merjemes *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Së treti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në këtë udhëtim një mësues dhe udhërrëfyes, i cili ua mësonte njerëzve hapat e haxhit, i udhëzonte në mënyrën e saktë të kryerjes së adhurimeve dhe i përgjigjej pyetjeve të tyre.

---

[514] Kjo është transmetuar nga Umeri dhe ne jemi të bindur se Umeri e ka vepruar këtë duke ndjekur shembullin e Pejgamberit dhe se njerëzit e kanë vepruar këtë me Umerin, sepse e kishin vepruar më parë me Pejgamberin. Gjurmët e Umerit. Buhariu, 2/20, "Mual-lak".
[515] Ahmedi, 2067.

Ai dëgjoi një njeri që po thoshte: "*Lebbejke an Shubrumeh!* - Erdha në emër të Shubrumes!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e thirri dhe e pyeti: "*Kush është Shubrumeh?*" Ai u përgjigj: "Vëllai im ose një i afërm." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: "*A ke bërë Haxh për veten tënde?*" - "Jo!" - u përgjigj ai. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*Këtë Haxh bëje për veten tënde, pastaj bëj një Haxh tjetër për Shubrumen!*"[516]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kalonte pranë burrave që ecnin në këmbë dhe u thoshte të hipnin mbi devetë që kishin sjellë për kurban. Me këtë ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* donte të thyente zakonet e gabuara të trashëguara nga injoranca, ku ata nuk i hipnin deveve të kurbanit si shenjë nderimi - siç ishte zakoni për *bahire*, *saibe*, *wasile* dhe *ham* - praktika pagane të ndaluara nga Islami.[517]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbajti fjalime para njerëzve në ditën e Arafatit, ditën e Kurbanit, ditën e qëndrimit në Mina, që është dita e 11-të e Dhul-Hixhes ku theksoi shenjtërinë e gjakut, pasurisë dhe nderit dhe u kërkoi të pranishmëve të dëshmojnë dhe të transmetojnë te të tjerët mesazhin që dëgjuan. Ai tha: "*Vërtet, gjaku juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj janë të shenjta midis jush, siç është e shenjtë kjo ditë, në këtë muaj në këtë qytet. Ai që është i pranishëm le t'ia përcjellë atij që nuk është i pranishëm, sepse ndoshta një i pranishëm e përcjell te dikush që e kupton më mirë se ai vetë.*"[518]

Së katërti: Përulësia e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).*

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ecte në mesin e njerëzve, i rrethuar nga zemra që e donin, nga sy që e ndiqnin dhe nga shpirtra që do të sakrifikoheshin për të. E, megjithatë, ai ishte si një prej tyre, nuk kishte ndonjë trajtim të veçantë, nuk i ishin shtruar tapete, nuk kishte eskortë që i paraprinte, nuk kishte nevojë t'i hapeshin rrugët, nuk kishte tenda të ngritura veçmas për të.

---

[516] Ebu Davudi, 1811.

[517] Kjo është prej zakoneve të kohës së injorancës, ku ata i caktonin disa deve sipas disa zakoneve pagane mbi të cilat as nuk hipnin as nuk ngarkonin.

[518] Buhariu, 67. Muslimi, 1679.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ecte mes njerëzve si njëri prej tyre, pa ndonjë shenjë dalluese, përveç dritës së pejgamberisë dhe madhështisë së shpalljes.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte afër njerëzve dhe njerëzit ishin të afërt me të. Të gjithë ndjenin respekt ndaj tij, por edhe afërsi dhe dashuri. Ai i mbulonte ata me sjelljen e tij të mirë, me moralin e lartë që i kishte dhënë Zoti i tij.

Një kujtim i paharruar...

Ebu Xhuhejfe *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon për një moment nga ditët e Haxhit, kur ai ishte vetëm një djalosh rreth dhjetë vjeç: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli në mesditë, kishte veshur një mantel të kuq dhe i kishte përvjelë mëngët. Sikur e shoh edhe tani shkëlqimin e këmbëve të tij. U fal me njerëzit dy rekate. Kur mbaroi namazin, njerëzit iu afruan dhe filluan t'i kapnin duart dhe t'i fërkonin me to fytyrat e tyre. Edhe unë i kapa dorën dhe e vendosa në fytyrën time: ajo ishte më e ftohtë se akulli dhe mbante një aromë më të mirë se myshku."[519]

Rruga nga Arafati në Muzdelife:

Kur u nis *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nga Arafati drejt Muzdelifes, ecte bashkë me turmën, pa ndonjë rrugë të veçantë, pa eskortë. Ai ishte udhëheqësi i njerëzve, por nuk lejonte që dikush të ndalohej të ecte para tij, apo të ndalohej dikush që vinte pas tij. Me dorën e djathtë të ngritur dhe me pëllëmbën e kthyer nga qielli, ai u thoshte: "*O njerëz, ecni me qetësi dhe me dinjitet! Sepse mirësia nuk qëndron në ngutjen e kuajve apo të deveve!*"[520]

Dhe kur dëgjonte britmat e njerëzve, shtyrjen e tyre mbrapa dhe goditjen e deveve djathtas e majtas, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kthehej dhe bënte shenjë me shkopin e tij duke thënë: "*Ngadalë o njerëz, ecni me qetësi, sepse mirësia nuk qëndron në ngutje.*"[521]

Një skenë madhështore në ditën e 11-të të Dhul-Hixhes në Mina:

Rafi ibn Amr el-Muzni *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton: "Erdha me babanë tim, ndërsa isha ende djalosh, në Haxhin

[519] Ahmedi, 18767.
[520] Ebu Davudi, 1920.
[521] Taberani, "*El Muaxhemu el Kebijru*", 4458.

e Lamtumirës. E pamë të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke mbajtur hytben mbi një mushkë me ngjyrë gri, ndërsa Ali ibn Ebi Talibi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* e përkthente për njerëzit (nga arabishtja në dialektin e fiseve të tjera). Njerëzit disa ishin ulur dhe disa në këmbë. Babai im u ul dhe unë depërtova mes kafshëve derisa arrita te mushka. E kapa frerin e saj dhe vendosa dorën time mbi gjurin e tij, pastaj e zbrita dorën ngadalë mbi kërcirin e tij deri te këmba dhe futa dorën time midis sandales dhe shputës së tij. Dhe sot, më duket sikur ende e ndiej freskinë e këmbëve të tij në pëllëmbën time."[522]

Nëse Rafiu u mahnit nga freskia e këmbës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ne mahnitemi nga freskia e shpirtit të tij, nga madhështia e moralit të tij.

Çfarë zemre e madhe dhe çfarë shpirtbutësie e pakrahasueshme - të vazhdojë hytben e tij pa e ndalur djaloshin që i fërkonte këmbën e i vendoste dorën brenda sandales! Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* edukonte me sjelljen e tij para se të edukonte me fjalë.

Së pesti: Lehtësimi i Pejgamberit në kryerjen e adhurimeve të Haxhit.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i dërguar me fenë e drejtë dhe të hapësirës, ishte i mëshirshëm dhe i kujdesshëm me njerëzit në kryerjen e adhurimeve. Ai e bëri Haxhin të lehtë, të qartë dhe pa vështirësi, me një qëllim të qartë: lehtësimin për njerëzit, jo ngarkesën.

Shembuj nga praktika e tij:

U lejoi barinjve që të gjuajnë gurët ditën e Kurbanit, pastaj të mos i gjuanin ditën tjetër dhe të vazhdonin gjuajtjen ditën pas saj.

I lejoi Abasit (xhaxhait të tij) të qëndronte natën në Mekë, për shkak të detyrës së tij për të furnizuar haxhinjtë me ujë.

Gjatë gjithë Haxhit të tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk u transmetua që t'i ketë kërkuar ndokujt kompensim me kurban, edhe pse shumë prej tyre ishin të rinj në Islam dhe po e kryenin për herë të parë Haxhin, këtë obligim madhor.

[522] Taberani, "*El Muaxhemu el Kebiru*", 4458.

Fjalët[523] **që përsëriste shpesh ishin:**

– "*Vepro, s'ka problem!*" Kjo ishte përgjigjja e tij e zakonshme për çdo pyetje që kishte të bënte me radhën apo mënyrën e riteve të Haxhit.

Rasti i Urve ibn Mudarrisit *(Allahu qoftë i kënaqur me të)***:** Ky sahabi erdhi me vonesë në Muzdelife, pasi kishte kaluar male të shumta ai tha: "O i Dërguari i Allahut! Erdha nga malet e Tajit.[524] Lodha veten dhe mundova devenë time. Pothuaj nuk lashë ndonjë kodër pa kaluar mbi të. A kam pjesë në Haxh?"

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*Kush fali me ne këtë namaz* (namazin e sabahut në Muzdelife) *dhe qëndroi me ne derisa të nisej nga ajo* (Muzdelife), *dhe ka qëndruar para kësaj në Arafat natën apo ditën, ai e ka përmbushur Haxhin e tij dhe ka hequr papastërtitë e tij.*"[525]

Pyetjet e beduinëve dhe përgjigjet profetike:

Beduinët vinin nga të gjitha anët dhe e pyesnin për çështje të ndryshme. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u tha: "*O njerëz! Allahu u ka hequr vështirësitë, përveç atij që ka cenuar nderin e muslimanit padrejtësisht - ai e ka të vështirë dhe është i shkatërruar.*"

Kur e pyetën për mjekimin, tha: "*Po, mjekohuni! Allahu nuk ka zbritur ndonjë sëmundje, veçse ka zbritur edhe shërimin për të - përveç një sëmundjeje.*" Kur e pyetën: "*Cila është ajo, o i Dërguar i Allahut?*", ai tha: "*Plakja.*"

Kur e pyetën: "*Cila është dhurata më e mirë që i është dhënë njerëzimit?*", ai u përgjigj: "*Morali i mirë.*"[526]

Së gjashti: Lamtumira e tij me njerëzit.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte filluar të përgatitej për takimin me Shoqëruesin e Lartë. Kishin ardhur shenjat e afërsisë së fundit të tij. Ai tha: "*O njerëz! Merrni*

---

[523] "*El Nihajetu*", 5/246.

[524] Malet e Tajit janë dy male në veri të Saudisë: Mali Axha dhe Salma në zonën Hail në veri të Saudisë, aty ndodhet fisi Taj. Shiko: "*Muaxhemu el Mealimi el xhugrafijeti fi el Sireti el Nebevjjeti*", f. 1307.

[525] Muslimi, 1307.

[526] Ibn Maxhe, 3436.

prej meje mënyrën e kryerjes së Haxhit, sepse ndoshta nuk do ta kryej më pas këtij viti."[527]

Nga Xhubejr ibn Mut'im transmetohet se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u ngrit për të folur në çadrën e Hajfit në Mina dhe tha: *"E ndriçoftë Allahu njeriun që e dëgjon fjalën time dhe e përcjell atë. Sepse ndodh që bartësi i dijes nuk e kupton atë që ka, ndërsa ai që ia përcjell e kupton më mirë se ai."*[528]

Njerëzit e kuptuan se kjo ishte një këshillë e lamtumirës. Një burrë nga turma e pyeti: "O i Dërguari i Allahut, çfarë na porosit?" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigj: *"Adhuroni Zotin tuaj, falni pesë kohët e namazit, agjëroni muajin tuaj, jepni zekatin e pasurisë suaj dhe bindjuni atij që është udhëheqësi juaj - dhe do të hyni në Xhenetin e Zotit tuaj."*[529]

Ibn Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* thotë: "Flisnim për Haxhin e Lamtumirës, ndërsa Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte mes nesh dhe nuk e dinim se çfarë do të thoshte Haxhi i Lamtumirës."[530] Ai e falënderoi dhe lavdëroi Allahun, pastaj tha: *"Me të vërtetë Allahu ua ka ndaluar gjakun dhe pasurinë tuaj, ashtu siç është e ndaluar kjo ditë, në këtë vend, në këtë muajin. A e përcolla mesazhin?"* Ata thanë: "Po!" Ai tha: *"O Allah, dëshmo!" - tre herë.* Pastaj tha: *"Shikoni mirë! Mos u ktheni pas meje në jobesimtarë që godisni qafat e njëri-tjetrit."*[531]

Gjatë rrugës së kthimit për në Medinë, ndaloi në Gadir Hum, fali drekën dhe pastaj u ngrit dhe mbajti hytbe. E lavdëroi dhe e falënderoi Allahun dhe tha: *"E më pas: O njerëz! Unë jam vetëm një njeri. Së shpejti do të më vijë i dërguari i Zotit tim dhe do t'i përgjigjem* (thirrjes së Tij)."[532]

E gjithë kjo ishte përgatitje për ndarjen e tij nga kjo botë - një lajm që ndodhi vetëm tre muaj më vonë - në mënyrë që Umeti të përgatitej për ngjarjen e madhe dhe të merrte përgjegjësinë e bartjes së porosisë nga ai që e përmbushi misionin dhe e përcolli mesazhin.

---

[527] Nesaiu, *"El Sunen el Kubra"*, 3062.
[528] Ebu Davudi, 3660. Tirmidhiu, 2847. Ibn Maxhe, 230.
[529] Tirmidhiu, 616.
[530] Buhariu, 4402. Muslimi, 66.
[531] Buhariu, 4403.
[532] Muslimi, 2408.

Kapitulli i Katërt:

Bota e ndjenjave dhe i Dërguari

I Dërguari dhe mirëqenia e tij shpirtërore

Kur njeh personalitetin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të),* do të kuptosh se ai gëzonte shëndet trupor dhe mirëqenie shpirtërore dhe se jetonte në një ekuilibër të plotë psikologjik, gjë që dallohej në fjalët, veprat dhe marrëdhënien e tij me njerëzit dhe ngjarjet.

Disa nga shenjat e mirëqenies së tij shpirtërore janë:

1. Gëzimi i përhershëm që pasqyrohej në fytyrën e tij të bekuar, e cila ishte gjëja e parë që e vërente kushdo që e takonte. Ai ishte njeriu më i buzëqeshur. Gëzimi dhe përgëzimi lexohej qartë në fytyrën e tij dhe kushdo që e shihte ndiente se po shihte një njeri të lumtur, një lumturi që përhapej nga ai tek të tjerët. Takimi me të ishte një lajm i mirë dhe një burim gëzimi për shokët e tij. Sikur secili që qëndronte me të, të merrte diçka nga lumturia dhe përgëzimi i tij.

2. Një tjetër shenjë e mirëqenies së tij shpirtërore ishte optimizmi i vazhdueshëm. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pëlqente shumë të ishte ndjellamirë dhe ndalonte nga besëtytnitë dhe ndjellja e keqe[533]. Edhe pse përjetoi sprova dhe vështirësi të mëdha, asnjëherë nuk e humbi shpresën dhe nuk u zhyt në dëshpërim. Edhe në momentet më të vështira, ai ngrinte shikimin drejt një shprese që e priste, drejt një ndjellje të mirë që i jepte gëzim.

Ngjarja më e dhimbshme për të ishte kur u kthye nga Taifi, pas një refuzimi të ashpër dhe fyes nga banorët e saj ndaj thirrjes së tij. U kthye drejt Mekës ku pritej që edhe populli i tij do ta fyente dhe lëndonte. Në atë çast, iu shfaq engjëlli i maleve dhe kërkoi leje nga ai për t'i bashkuar dy malet e Mekës dhe për të shtypur popullin nën to. Por përgjigjja e tij ishte e menjëhershme dhe e vendosur:

"Jo! Do të duroj! Shpresoj që Allahu të nxjerrë nga pasardhësit e tyre dikë që do ta adhurojë Atë pa i shoqëruar askënd."[534]

[533] Buhariu, 5756. Muslimi, 2224.
[534] Buhariu, 3231. Muslimi, 1795

Shpresat e tij ishin të lidhura me brezat që do të vinin, që Allahu do t'i shpëtonte përmes tij nga idhujtaria, edhe pse baballarët e tyre ishin të zhytur në mohim dhe fanatizëm.

3. Nga shenjat e mirëqenies së tij shpirtërore ishte edhe largësia nga dyshimet dhe mendimi i keq për njerëzit. Nuk e gjeje kurrë të sillej me njerëzit me frikë, dyshim apo mosbesim. Ai i shihte njerëzit me sy të mirë, i kuptonte dhe i trajtonte me mendim të mirë, pa qenë naiv apo i mashtruar.

Të kesh mendim të mirë për njerëzit dhe të jesh larg dyshimeve e pasigurisë në raport me ta, është dëshmi e shëndetit shpirtëror dhe e një sjelljeje të drejtë.

Ndërsa të menduarit keq për njerëzit, dyshimi i shpeshtë ndaj tyre dhe nxitimi për t'i akuzuar pa prova, janë simptoma të sëmundjeve të brendshme shpirtërore dhe të një sjelljeje të shtrembër.

4. Një tjetër shenjë e shëndetit të tij shpirtëror ishte aftësia për të kaluar përtej lëndimeve dhe për të falur me zemër të pastër. Ai sillej me armiqtë e djeshëm, pas faljes së tyre, me një pastërti dhe sinqeritet të tillë, saqë të dukej sikur kishte përballë një njeri krejtësisht tjetër, e jo atë që më parë e kishte luftuar.

I tillë ishte rasti i Halid ibn Velidit - pas pranimit të Islamit - që dukej si një person tjetër, krejt i ndryshëm nga ai Halidi që në betejën e Uhudit ishte komandanti i kalorësisë së idhujtarëve dhe që me manovrën e tij i shkaktoi muslimanëve atë humbje të rëndë, me shumë të vrarë dhe të plagosur.

Po kështu, Ebu Sufjani - pas çlirimit të Mekës - dukej sikur ishte një tjetër njeri, ndryshe nga ai që dikur udhëhoqi koalicionin e fiseve që rrethuan Medinën dhe e futën në një gjendje aq të rëndë, saqë sytë rrotulloheshin dhe zemrat arrinin në fyt nga frika.

Madje, nuk gjejmë në historinë e jetës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që ai t'ua ketë përmendur ndonjëherë ndonjërit prej armiqve të mëparshëm që u penduan e u bënë muslimanë për atë që kishin bërë më herët ndaj tij. As nuk i qortoi dhe as nuk ua përmendi të kaluarën.

Kjo aftësi për të kaluar mbi lëndimet dhe për të falur me një zemër të pastër mund të vijë vetëm nga një gjendjeje e lartë e mirëqenies shpirtërore dhe baraspeshës psikologjike.

5. Një tjetër dëshmi e mirëqenies shpirtërore të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte mënyra e natyrshme dhe e ekuilibruar me të cilën ai e trajtonte botën emocionale dhe reagimet e brendshme. Ai nuk i shtypte ndjenjat, por as nuk i linte të shfrenoheshin pa kontroll. Kur kishte arsye për të qenë i pikëlluar, ai ndiente hidhërim dhe kjo reflektohej qartë në fytyrën e tij të bekuar. Nuk e mohon këtë ndjenjë, as nuk e fshihte. Pikëllimi nuk e pushtonte shpirtin e tij për një kohë të gjatë; ai përjetonte ndjenjën në mënyrë të natyrshme, reagonte ndaj saj dhe më pas kalonte përtej saj, duke iu kthyer jetës së përditshme dhe ritmeve të saj.

E njëjta gjë ndodhte me gëzimin - ai gëzohej sinqerisht dhe gëzimi shihej qartë në fytyrën e tij, por nuk lejonte që ky entuziazëm të kthehej në sipërfaqësi apo papërgjegjshmëri.

Edhe kur zemërohej, kjo dallohej në fytyrën e tij, ndoshta fytyra i skuqej[535] nga zemërimi, por kjo ndjenjë kurrë nuk e shtynte në padrejtësi. Ai nuk shfrynte zemërimin e tij në mënyrë të nxituar apo të dhunshme, por gjithmonë mbante kontrollin dhe maturinë.

6. Nga shenjat më madhështore të ekuilibrit të tij shpirtëror ishte qetësia që e shoqëronte, përkundër peshës së madhe të përgjegjësive dhe përballjes me sfida të jashtëzakonshme. Ai ishte i ngarkuar me misionin më të madh që i është besuar ndonjë njeriu, ballafaqohej me sprova të rënda, me kundërshti të ashpra dhe me barrën e udhëheqjes së një populli, por kurrë nuk shfaqte shenja të ankthit apo të tensionit. Në jetën e tij shihej gjithmonë qetësi, paqe dhe butësi në çdo veprim.

Kjo përkryerje njerëzore dhe ekuilibër shpirtëror është vetë një prej begative të jetës dhe ëmbëlsive të ekzistencës. Ai përfaqëson një model të lartë për t'u marrë shembull dhe një fushë e gjerë për të ndjekur gjurmët e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).*

[535] Muslimi, 1062.

I Dërguari dhe humori

Humori është ai që e zbut ashpërsinë e jetës, e zbukuron seriozitetin dhe e kthen në një përjetim të ngrohtë e të gëzueshëm. Ai është, gjithashtu, një prej shkaqeve të dashurisë, afrimit dhe shoqërimit të sinqertë, sepse sjell një reagim të lumtur dhe fut gëzim në zemrat e njerëzve.

Do të shohim se jeta e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte e gjallëruar me humor, por ishte ai humor fisnik, i bukur, që nuk lëndon, nuk turpëron, nuk ofendon e as nuk hidhëron. Ishte humor që gëzonte dhe afronte.

Humori i tij ishte i lartë dhe i butë, pa vulgaritet, pa gënjeshtër dhe pa fyerje. Transmeton Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: *"Unë nuk them tjetër veçse të vërtetën."*

Ata i thanë: "O i Dërguar i Allahut, por ti bën shaka me ne!"

Ai u përgjigj: *"Unë nuk them tjetër veçse të vërtetën."*[536]

Humori në jetën e të Dërguarit

Në jetën e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* humori ishte i larmishëm: ndonjëherë ai bënte shaka me shokët e tij, ndonjëherë ata bënin shaka me të dhe herë të tjera ndodhte që të tjerët bënin humor pranë tij dhe ai qeshte me ta.

1. Humori i tij me sahabët

Ndër ata ishte edhe Zahiri - një beduin që sillte mallra fshati për t'i shitur në Medinë, si gjalpë dhe djathë i thatë. Një herë, kur ishte në treg duke shitur mallin e tij, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu afrua nga pas, pa e parë ai, dhe e përqafoi. Zahiri filloi të thoshte:

– "Kush është? Kush është? Më lësho!"

[536] Ahmedi, 8481.

Derisa e njohu dorën e të Dërguarit dhe e vështroi, atëherë filloi ta mbështeste shpinën fort në gjoksin e tij të bekuar, që të përfitonte nga prekja e trupit të tij të ndershëm.

Ndërkohë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* filloi të thërriste me humor: *"Kush e blen këtë rob? Kush e blen këtë rob?"*

Zahiri, që ishte i shëmtuar në pamje, i tha me ndjeshmëri:

– *"O i Dërguar i Allahut, do të më gjesh pa vlerë në treg!"*

Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përkëdheli me fjalë dhe zemër, duke i thënë: *"Por ti, tek Allahu, nuk je pa vlerë. Ti je i çmuar tek Allahu!"*[537]

O Allah! Sa lajm të gëzueshëm mori Zahiri, kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Ti je i çmuar tek Allahu!"*

2. Humori i të Dërguarit me fëmijët dhe në bisedat e përditshme

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dinte të sillte gëzim dhe qetësi me fjalët e tij të buta, sidomos me fëmijët dhe njerëzit e zakonshëm.

– Me Enesin, shërbëtorin e tij të dashur, që e kishte shërbyer që nga mosha e vogël, ai bënte shaka me dashuri dhe butësi, duke i thënë: *"O Enes, o ti me dy veshë!"*[538]

Një shaka e thjeshtë, por plot ngrohtësi, që i përshtatej moshës së tij dhe e gëzonte shpirtërisht.

– Një herë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti një grua: *"Kush është burri yt?"* Ajo ia përmendi emrin. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: *"Ai që ka të bardhë në sy?"* Gruaja u kthye në shtëpi dhe nisi ta shikonte burrin e saj me habi. Ai e pyeti se ç'kishte dhe gruaja i tregoi çfarë e kishte pyetur dhe çfarë i kishte thënë i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndërkohë burri i saj qeshi dhe i tha: "Po a nuk është e bardha më shumë se e zeza në sytë e mi?"[539] Një shaka e hollë dhe plot mençuri, që e bënte bashkëbisedimin të hareshëm dhe të çliruar.

---

[537] Ahmedi, 12648.

[538] Tirmidhiu, 3828.

[539] El Irakijju, *"Tekhrixhu Ehadijthi el lhjai"*, 2/796.

– Edhe fëmijët kishin një vend të veçantë në zemrën e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Një herë hyri në shtëpinë e Umu Sulejm dhe pa një djalë të vogël, rreth tre vjeç, që ishte i mërzitur. E pyeti nënën e tij*: "Oj Umu Sulejm! Përse e shoh Ebu Umejrin të mërzitur?"*

Ajo i tha: "I ka ngordhur Nugajri i tij" - një zog me të cilin ai luante. Atëherë, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) iu afrua fëmijës, filloi të qeshte me të, duke i thënë: *"O Ebu Umejr! Çfarë ndodhi me Nugajrin?"* - domethënë, më trego si ngordhi zogu yt. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e afroi, e pyeti dhe e gëzoi me fjalë e përqafime të dashura.

– Me nipin e tij Hasanin, kur ai ishte fëmijë i vogël, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nxirrte gjuhën për të dhe Hasani qeshte kur shihte ngjyrën e kuqe të gjuhës së tij.[540] Kështu krijonte lidhje dashurie, duke e bërë edukimin dhe përkujdesjen të mbushur me gëzim dhe afrimitet.

– Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bënte shaka me vajzën e gruas së tij, Zejnebin, bijën e Umu Selemes, ndërsa ajo ishte ende fëmijë në prehrin e tij dhe i thoshte*:* *"O Zuvejneb, o Zuvejneb..."* - zvogëlim i emrit Zejneb – me përkëdhelje dhe dashamirësi.

3. Si e priste i Dërguari humorin nga të tjerët?

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* jo vetëm që bënte shaka me të tjerët në mënyrë të butë e të dashur, por edhe e pranonte me gëzim dhe zemërgjerësi humorin që të tjerët bënin me të.

– Një nga sahabët, i njohur me emrin Abdullah dhe me nofkën "Himar", ishte njeri i këndshëm dhe shpesh qeshte me Pejgamberin[541]. Abdullahu e donte të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Për shkak të kësaj dashurie, ai dëshironte që çdo ushqim që shihte të hynte në Medinë, t'ia ofronte të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ndonjëherë,

[540] Ahmedi, 16848.
[541] Buhariu, 6780.

kur ndonjë beduin sillte një enë[542] me gjalpë ose mjaltë, ai e merrte prej tij dhe ia dhuronte Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Pastaj, kur vinte pronari për t'i kërkuar pagesën, ai e çonte tek i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i thoshte: "Jepi këtij njeriut çmimin e mallit." I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i thoshte: *"A nuk ma dhurove mua atë?"* Ai përgjigjej: "Po, o i Dërguar i Allahut, por nuk kam para ta paguaj."[543] Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vetëm qeshte me të dhe urdhëronte që të paguhej çmimi për të.

Kjo shaka e lehtë dhe plot butësi pasqyron afërsinë shpirtërore dhe shoqërimin e bukur mes tij dhe të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

– Edhe në bisedat që zhvilloheshin në prani të tij, humori dilte natyrshëm dhe ai e pranonte me buzëqeshje. Njëherë po tregonte për Xhenetin dhe begatitë e tij: *"Një burrë nga banorët e Xhenetit, kërkoi leje nga Zoti për të mbjellë, dhe Zoti i tha: "A nuk ke në të çfarë dëshiron?" Ai u përgjigj: "Po, por unë dua të mbjell." Dhe menjëherë fara u mboll, mbiu, u rrit dhe dha të korra sa malet*[544]*. Pastaj Zoti i tha: "Merr, o biri i Ademit, se asgjë nuk të ngop."*

Një beduin, duke dëgjuar këtë tregim, tha me humor: "Pasha Allahun, ky do të jetë ose nga kurejshët ose nga ensarët, se ata janë të zotët e bujqësisë! Ne nuk jemi njerëz të mbjelljes."

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe shokët e tij qeshën me këtë ndërhyrje.[545]

4. Më shumë për shakatë e të Dërguarit me familjen e tij

Njëherë, gjatë namazit të natës, gruaja e tij Sevda ishte duke u falur pas Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i cili e zgjati shumë namazin. Të nesërmen ajo i tha me humor: "Jam falur pas teje natën e kaluar dhe e zgjate rukunë aq shumë sa e

[542] Enë prej lëkure. "*El Nihajetu*", 3/284.
[543] Ebu Jeala, "*Musned*", 127.
[544] "*Fet'hu el Bari*", 5/27
[545] Buhariu, 2348.

mbajta hundën me dorë nga frika se mos më derdhet gjaku!" I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qeshi me të dhe shpesh diçka e tillë e bënte të qeshte.[546]

Në shtëpinë e tij shpesh ndodhnin shaka të ngrohta dhe të gëzueshme, ndonjëherë ndodhte që mes grave të tij të kishte shaka edhe në praninë e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Mund të imagjinosh skenën, ku *hazire*[547] rrjedh në fytyrën e Sevdës dhe rrjedh në fytyrën e Aishes, të gjithë qeshin, dhe i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qesh bashkë me to. Kjo është shakaja në shtëpinë profetike, aty ku ndriçojnë buzëqeshjet dhe kumbon e qeshura.

Me të vërtetë, humori e gëzon jetën dhe e zbut atë. Ajo bëhet me dëshirë dhe pranohet nga njerëzit e sjellshëm dhe modestë, ndërsa shmanget nga mendjemëdhenjtë, të cilët mendojnë se ajo u zbeh hijen dhe krenarinë. Ndërsa i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shfaqte butësi dhe afërsi, e largonte ndrojtjen dhe i gëzonte ata që e rrethonin me një humor të lehtë, që nuk kishte as fjalë të pahijshme, as lëndim, as siklet - por, përkundrazi, miqësi, përkëdheli dhe gëzim.

Sahabët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e morën këtë mësim prej tij dhe ia dhanë vetes një pjesë nga ky argëtim i bukur që ngushëllon shpirtin dhe i rikthen gjallërinë dhe energjinë.

I Dërguari dhe argëtimi

Kur vështron madhësinë e përgjegjësive të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, lidhjen e tij me botën e të padukshmes dhe faktin që ai ka parë pamje të botës tjetër me sytë e tij, mund të mendosh se një jetë e tillë s'është veçse një jetë serioze, e rreptë, ku çdo çast ruhet me vigjilencë që të mos humbasë në diçka

[546] Ibn Sead, "*El-Tabekatu el Kubra*", 8/44.

[547] Hazire: Mish i grirë në copa të vogla, mbi të cilin hidhet shumë ujë. Kur zihet mirë, i shtohet miell. Nëse nuk ka mish, atëherë quhet "Asida". Shih: "*Nihaje*", 2/28.

që s'është përpjekje apo përkushtim. Por nëse vështron jetën e tij, do të shohësh një mirëkuptim të plotë për dëshirat e shpirtit njerëzor, një hapësirë të bollshme për kënaqësi dhe shoqërim përmes një argëtimi të bukur, i cili qetëson zemrat, u rikthen atyre energjinë dhe gjallërinë dhe u afrohet zemrave të të rinjve me të gjithë atë çka ata dëshirojnë. Ai i bashkohet kënaqësisë së tyre, u hap horizonte të jetës dhe u jep hapësirën që feja e tij i solli njerëzimit.

Ja ku është me bashkëshorten e tij në një ditë feste, kur dëgjon zëra në xhami. Ai hedh një sy nga dera e dhomës që të çon në xhami dhe sheh një grup që po luajnë e argëtohen. Mund ta imagjinosh sa të lumtur ndiheshin ata ngaqë i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i shihte duke luajtur dhe i inkurajonte. Sa i madh duhet të ketë qenë gëzimi i tyre dhe sa lart ka arritur entuziazmi i tyre!

Teksa ata ishin të zhytur në festën dhe entuziazmin e tyre, papritur hyri Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* i zemëruar dhe nisi të marrë gurishte nga toka e xhamisë dhe t'i gjuajë duke u thënë: "Mjaft, a këtu në xhaminë e të Dërguarit të Allahut?!" Atëherë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Ngadalë, o biri i Hatabit!"* Pastaj u drejtua nga grupi dhe tha: *"Mos u trembni, o bijtë e Arfidës! Luani, o bijtë e Arfidës, që hebrenjtë të kuptojnë se në fenë tonë ka lehtësim. Jam dërguar me fenë e drejtë dhe të lehtë."*[548]

Feja e drejtë dhe e lehtë me të cilën ai u dërgua është plotësisht në harmoni me natyrën njerëzore, me prirjet e saj dhe atë për të cilën është krijuar shpirti njerëzor. Ajo erdhi me gjerësi e jo me ngushtësi, prandaj zemrat pranë tij lëviznin me natyrshmërinë e tyre, gëzonin me të gjithë finesën e tyre dhe Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përkrahte me mbështetjen e tij: *"Mos u trembni, o bijtë e Arfidës! Luani!"*

Ai e ndante këtë gëzim edhe me familjen e tij. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ulur, kur dëgjuam një zhurmë dhe zëra fëmijësh. Ai u ngrit dhe pa një grua nga Abisinia që po kërcente dhe fëmijët përreth saj. Tha: *"Oj Aishe, eja dhe shikoje."* Unë vajta dhe vendosa gushën mbi supin e tij dhe vazhdova të shikoja nga

[548] Nesaiu, 8951.

supi deri te koka e saj. Ai më tha: *'A nuk u ngope?! A nuk u ngope?!'* Unë i thoja 'Jo!', vetëm që të shihja se sa do të më lejonte, derisa erdhi Umeri. Njerëzit u larguan menjëherë prej saj.[549] I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *'Unë po shoh djajtë e njerëzve dhe xhindëve që u larguan nga Umeri.'* Atëherë, u ktheva."[550]

Shikoje këtë grua shërbëtore që luan me fëmijët pranë shtëpisë së të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ku zëri i saj mund të dëgjohej brenda dhe nuk ndjeu aspak se kjo gjë mund të kundërshtohej apo të qortohej për të. E si do të ishte nëse ajo do ta dinte se Ai kishte dalë me bashkëshorten e tij për t'i dhënë kënaqësi me një skenë të tillë gëzimi dhe hareje?

Një herë, kur po kthehej nga një ekspeditë, erdhi një robëreshë me ngjyrë dhe i tha: *"O i Dërguari i Allahut! Kam bërë një betim që nëse Allahu të kthen ty shëndoshë e mirë, do t'i bie defit dhe do të këndoj para teje."* Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Nëse ke bërë betim, atëherë bjeri, përndryshe mos i bjer."* Ajo filloi t'i bjerë defit. Ajo e kishte marrë me vete, duke ditur se ai do ta pranonte këtë gëzim dhe do t'i jepte liri ndjenjave të saj për të shprehur lumturinë me kthimin e tij. Filloi t'i bjerë defit mbi kokën e tij, ndërkohë që ai i bashkëngjitej gëzimit të saj dhe ia lejoi të festonte siç dëshironte. Mund ta imagjinosh këtë skenë: një robëreshë që i bie defit mbi kokën e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, rrethuar nga shokët e tij! Sa e madhërishme është kjo zemër që i përgjigjet dëshirave të njerëzve dhe u jep njerëzve liri të tillë, saqë një grua të guxojë të festojë ashtu para tij!

Ky udhëzim profetik na çon drejt lehtësimit me të cilën ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u dërgua: *"Jam dërguar me fe të drejtë dhe të lehtë."*

Njëherë Aishja martoi një të afërmen e saj nga ensarët. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"A ia dhatë dhuratën vajzës?"* Thanë: "Po!" Tha: *"A dërguat me të dikë që të këndojë?"* Thanë: "Jo!" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Ensarët janë njerëz që u pëlqen poezia. Do të kishte qenë mirë të kishit*

[549] *"El Nihajetu"*, 2/243.
[550] Tirmidhiu, 3691.

dërguar me të dikë që të këndonte këngën: "Erdhëm te ju, erdhëm te ju. Na pritët mirë, dhe ne ju presim me mirësi."

Rubeja bint Muadh thotë: "Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri te ne ditën që u bë dasma ime, u ul në shtrojën time dhe disa prej vajzave tona nisën t'i bien defit dhe të këndojnë për baballarët tanë që ranë në ditën e Bedrit. Njëra prej tyre tha: 'Ndër ne është Pejgamberi që di ç'do të ndodhë nesër.' Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Lëre këtë dhe thuaj atë që po thuaje më parë."*[551]

Orët e gëzimit janë për të shpallur hare dhe një formë e shpalljes së kësaj hareje është edhe argëtimi kolektiv.

Ditën e Bajramit, Aishja thirri shoqet e saj për të ndarë me to gëzimin dhe argëtimin e festës. Ato erdhën me defet e tyre dhe filluan të këndojnë në shtëpinë e saj, me këngë nga këngët e vjetra paraislame të Evsit dhe Hazrexhit për ditën e Buathit. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri në këtë atmosferë festive. Shërbëtoret e ndjenë afërsinë e tij dhe nuk ndaluan, por e vazhduan këngën. Ai u shtri në shtrat, e ktheu fytyrën nga muri, që të mos i vinte në siklet me shikimin e tij, si për të thënë: "Argëtohuni me këngët tuaja, vazhdoni siç jeni." Këngët dhe defet vazhduan derisa e dëgjoi Ebu Bekri nga xhamia. Ai hyri i zemëruar dhe i tha Aishes: "A janë këto fyejt e djallit në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut?!" Atëherë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Lëri, o Ebu Bekr, sepse këto janë ditë feste."*[552]

Është ditë gëzimi dhe kjo festë muzikore është një mënyrë për ta shprehur atë. Gëzimi ka entuziazmin dhe gjallërinë e vet.

Këtu vëmë re se këngët që këndoheshin ishin nga koha e injorancës, nga betejat e Evsit dhe Hazrexhit, dhe mjetet e argëtimit ishin, gjithashtu, nga trashëgimia paraislame. Kjo tregon se argëtimi, loja dhe arti nuk kanë fe e as kombësi. Dhe, me sa di unë, nuk ka diçka nga ajo që ne e quajmë *art islam*, por është *art njerëzor*: në të ka gjëra të lejuara - dhe parimisht të gjitha janë të lejuara - por ka edhe të ndaluara, ku futet çdo gjë që përmban gjëra të ndaluara, si fjalë të pahijshme, bixhoz apo simbole fetare të ndaluara. Kur një

[551] Buhariu, 4001.
[552] Buhariu, 2906. Muslimi, 892

argëtim ndalohet, është për shkak të ndalesave që përmban. Kur ato ndalesa hiqen, argëtimi kthehet në gjendjen e tij të natyrshme - të lejueshme.

Çdo kohë ka mënyrat dhe mjetet e saj të argëtimit. Mjetet që u përdorën në prezencën e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin nga koha e injorancës, por mbetën në zonën e së lejuarës.

Kështu edhe mjetet moderne të zbavitjes, si lojërat me drita, shfaqjet e cirkut dhe forma të tjera argëtimi, marrin gjykimin e tyre sipas përmbajtjes. Nëse nuk përmbajnë ndalesa, janë të lejuara. Por nëse përmbajnë ndonjë të ndaluar si bixhoz, fjalë të pahijshme, etj., atëherë ndalohen për atë ndalesë.

Ashtu siç ishin këngët për momentet e gëzimit, po ashtu, ato ishin edhe për momentet e punës e mundimit, për të ngritur shpirtin dhe për të larguar lodhjen.

Gjatë ndërtimit të xhamisë këndohej:

"Nuk barazohet ai që ndërton xhamitë,
Aty qëndron në ruku dhe sexhde,
Me atë që shmanget nëpër pluhur..."

Gjatë hapjes së hendekut këndohej:

"O Allah, po të mos ishe Ti, nuk do të udhëzoheshim,
As nuk do të jepnim lëmoshë e as do të falnim namaz...
Zbrit pra qetësi mbi ne,
Dhe forco këmbët tona kur të përballemi!
Ata të parët na kanë bërë padrejtësi,
Por nëse duan sprova, nuk do t'i pranojmë!"

Kurse në udhëtime, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte një udhërrëfyes[553] me zë të bukur që këndonte. Kur ai këndonte, devetë nxitonin nga emocionet që ua ngjallte zëri. Atëherë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha:

[553] I printe deveve dhe ju këndonte atyre. "*Lisanu el Arabi*", 14/168.

"O Enxhe'she, ngadalë! Ji i butë me qelqet!" - sepse kënga e tij i shtynte devetë të lëviznin shpejt dhe kjo mund të lëkundte gratë që udhëtonin mbi deve.

Buzëqeshjet e të Dërguarit

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte gjithmonë fytyrë të çelur, pamje të ndritur, ishte buzëqeshës e i gëzuar. Në buzëqeshjet e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dallohen disa tipare:

1. Pejgamberi ishte njeriu që buzëqeshte më shumë nga të gjithë. Gjendja e tij e zakonshme ishte një fytyrë e qeshur dhe e ndritur. Abdullah ibn Harithi ka thënë: *"Nuk kam parë askënd që të buzëqeshë më shumë sesa i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."*[554] Kjo ishte gjendja e zakonshme e fytyrës së tij përballë çdokujt që takonte.

2. Buzëqeshja e tij ishte e gjallë dhe rrezatuese, jo e ftohtë apo e zbehur. Ai buzëqeshte me një sinqeritet të tillë që personi ndjente sikur ajo buzëqeshje ishte ruajtur posaçërisht për të. Xherir ibn Abdullah el Bexheli *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ka thënë: "Që kur u bëra musliman, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk më privoi kurrë nga takimi me të dhe nuk ndodhi kurrë që të më takonte pa më buzëqeshur."[555] Xheriri mendonte se kjo ishte diçka e veçantë për të, por, në fakt, ishte sjellja e përgjithshme e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me të gjithë.

3. Ai i ftonte edhe të tjerët të buzëqeshin. Ai thoshte: *"Mos e nënvlerëso asnjë të mirë, edhe nëse është vetëm të takosh vëllain tënd me fytyrë të buzëqeshur."*[556] Gjithashtu: *"Buzëqeshja jote në fytyrën e vëllait tënd është një lëmoshë."*[557]

---

[554] Tirmidhiu, 3641.
[555] Buhariu, 3035. Muslimi, 2475.
[556] Muslimi, 2626.
[557] Tirmidhiu, 1956.

4. Buzëqeshja e tij ishte mirëpritëse dhe ngushëlluese për këdo. Kur Halid ibn Velidi erdhi për të përqafuar Islamin, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e priti me fytyrë të buzëqeshur. Halidi tregon: "Kur iu afrova, ai vazhdonte të më buzëqeshte derisa qëndrova para tij, e përshëndeta me përshëndetjen e pejgamberisë dhe ai ma ktheu me një fytyrë të buzëqeshur." I thashë: "Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se ti je i Dërguar i Allahut" Pastaj ai më tha: "*Falënderimi i qoftë Allahut që të udhëzoi. Unë e shihja tek ti mençurinë dhe shpresoja se ajo do të të çonte vetëm drejt së mirës.*"[558]

5. Të qeshurat e tij ishin të ndritshme dhe të përmbajtura. Ai nuk qeshte me të madhe e me zë të lartë. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Nuk e kam parë kurrë të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të qeshë me gjithë gojën, e t'i duken shpatullzat e gojës së tij; ai vetëm buzëqeshte."[559] Kështu që qeshja dhe buzëqeshja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte e përmbajtur dhe e hijshme, maksimumi që përshkruhet për të qeshurën e tij është: "Qeshi sa iu dukën dhëmbët."[560]

6. Edhe kur qortonte, e bënte me buzëqeshje. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjithmonë e kishte prezent buzëqeshjen, madje edhe kur qortonte, qortonte me buzëqeshje. Rrugës për në Haxhin e Lamtumirës, e pa Ebu Bekrin duke goditur shërbëtorin e tij që kishte humbur devenë. Ebu Bekri kishte veshur Ihramin për në Haxh. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* filloi të qeshte dhe pa e drejtuar fjalën drejtpërdrejt ndaj tij, tha: "*Shikoni çfarë bën i ihramit!*"[561] - e tha këtë duke buzëqeshur. Ky ishte një qortim i butë dhe i ngrohtë që i shkonte për shtat natyrës së butë të Ebu Bekrit.

7. Edhe ashpërsinë dhe sjelljen e vrazhdë ai e priste me buzëqeshje. Një ditë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte gati duke hyrë në shtëpinë e tij, ishte mbështjellë me

[558] Bejhakiu, "*Delailu el Nubuveti*", 4/351.
[559] Buhariu, 6092. Muslimi, 899.
[560] Buhariu, 6087. "*Fet'h el Bari*", 11/374.
[561] Ebu Davudi, 1818.

një rrobë nga Nexhrani me anësore të ashpra dhe e kishte rrotulluar mbi supe pas qafe. Një beduin e tërhoqi fort nga rroba, saqë ajo i la shenja në qafën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i cili gati u ra mbrapa dhe i tha me zë të ashpër: *"Më jep nga ajo që të ka dhënë Allahu!"* I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk u zemërua nga kjo sjellje e ashpër dhe injorante; përkundrazi, u kthye nga ai duke qeshur dhe urdhëroi që t'i jepej çfarë kërkonte.[562]

8. Edhe kur ishte i zemëruar, ai buzëqeshte. Ka'b ibn Maliku, duke treguar takimin me të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, pasi nuk mori pjesë në betejën e Tebukut, thotë: "Kur u ula përballë tij, ai buzëqeshi buzëqeshjen e të zemëruarit dhe më tha: *"Çfarë të ndaloi të vish?'"*[563]

9. As sëmurja i tij nuk ia ndali buzëqeshjen. Aishja tregon: "Një ditë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u kthye nga një xhenaze në varrezat e Bekias dhe më gjeti me dhimbje koke, ndërsa unë po thosha: "Oj, koka ime!" Ai tha: *"Jo ti, por unë, oj Aishe, oj koka ime!"* Dhe me buzëqeshje shtoi: *"Për ty nuk do të ishte ndonjë dëm nëse do të vdisje para meje, që të të laja unë, të të mbështillja me qefin, të të falja namazin për ty dhe të të varrosja vetë."* Unë i thashë më duket sikur po të shoh pasi ta bësh këtë duke u kthyer në shtëpinë time dhe të martohesh me një tjetër. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* buzëqeshi." Pastaj, nisi sëmurja prej së cilës ndërroi jetë, por dhimbja e sëmurjes nuk ia ndali shkëlqimin e buzëqeshjes.

10. Në momente gëzimi, ai buzëqeshte dhe fytyra e tij shkëlqente si copë hëne. Ka'b ibn Maliku tregon se kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e priti pas shpalljes së Allahut për pranimin e pendimit të tij, tha: "U gëzua aq shumë sa fytyra e tij ndriçoi dhe tha: *"Gëzohu me ditën më të mirë që ke pasur që kur të ka lindur nëna!"*[564] Dhe kur gëzohej, fytyra e tij ndriçonte si të ishte copë hëne dhe ne e kuptonim gëzimin e tij prej atij ndriçimi.

[562] Buhariu, 3149. Muslimi, 1057.
[563] Buhariu, 4418. Muslimi, 2769.
[564] Buhariu, 4418. Muslimi, 2769.

11. Ai qeshte nga qëndrimet e bukura të shokëve të tij. Ebu Hurejre tregon se një herë, ndërsa ishim ulur me të, erdhi një burrë duke shkulur flokët dhe duke mjeruar veten. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: *"Çfarë ke?"* ai tha "Jam shkatërruar, o i Dërguar i Allahut!" I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: *"Ç'të shkatërroi?"* ai tha: "Pata marrëdhënie me gruan e time gjatë ditës së Ramazanit!" I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: *"A ke mundësi të lirosh një rob?"* Ai tha: "Jo!" Atëherë, e pyeti: *"A ke mundësi të agjërosh dy muaj rresht?"* Ai tha: "Jo!" Atëherë, e pyeti: *"A ke mundësi të ushqesh 60 të varfër?"* Ai tha: "Jo!" Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Ulu!"* - dhe ai u ul. Dikush solli një thes[565] me hurma dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thirri: *"Ku është ai që më pyeti?"* Burri tha: "Ja ku jam." I tha: *"Merre këtë dhe ushqe me të 60 të varfër."* Ai tha: "A ka ndonjë më të varfër se unë, o i Dërguar i Allahut? Vallahi, në gjithë Medinën nuk ka familje më të varfër se familja ime." Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qeshi aq sa iu panë dhëmbët dhe tha: *"Merre për vete dhe për familjen tënde dhe agjëro një ditë në vend të asaj. Dhe kërko falje nga Allahu!"*[566]

Qeshja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në këtë moment ishte qetësim dhe ngushëllim i madh për këtë njeri që erdhi shumë i shqetësuar duke mjeruar veten, por kur gjeti lehtësimin dhe begati tek i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dëshiroi që hurmat t'ia dërgonte familjes së vet për t'i ngrënë. Prandaj u kthye te populli i vet duke thënë: "Gjeta tek i Dërguari i Allahut lehtësim dhe begati."

12. Edhe ditën e fundit të jetës së tij, ai buzëqeshi. Mbetet të dimë se hera e fundit që sahabët e panë të Dërguarin e Allahut ishte momenti kur ata panë shkëlqimin e buzëqeshjes së tij ditën që ndërroi jetë. Enesi tregon: "Të hënën, ndërsa ishim duke falur sabahun, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ngriti perden te dera e dhomës dhe na shikoi duke qeshur. Gati sa nuk

[565] *"El Nihajetu"*, 3/219.
[566] Buhariu, 1834. Muslimi, 1111.

humbëm përqendrimin nga gëzimi që na përfshiu kur e pamë. Nuk kishim parë asgjë më të bukur sesa pamja e fytyrës së tij atë mëngjes, sikur të ishte një faqe Kurani."[567] Kjo ishte buzëqeshja e fundit e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Buzëqeshje e gëzimit, e dashurisë dhe kënaqësisë për gjendjen në të cilën e pa Umetin e tij. Pastaj, disa orë më pas, paraditen e asaj dite, ndërroi jetë i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndërsa sahabët ruajnë në kujtesën e tyre shikimin e fundit të Pejgamberit, e panë që ai po i shikonte duke buzëqeshur.

I Dërguari dhe guximi - trimëria

Guximi, siç e ka përshkruar Allahu, është fuqia e zemrës përballë fatkeqësive, qëndrueshmëria në kohë trazirash, vendosmëria në çastet e hezitimit, si dhe fuqia dhe përballimi shpirtëror në momente frike dhe ankthi. Guximi është një cilësi e përbashkët e të gjithë pejgamberëve *(paqja e Allahut qoftë mbi ta)* dhe një nga virtytet më të rëndësishme të udhëheqjes dhe përsosmërisë së karakterit. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në majat e përsosmërisë së guximit. E ç'të thuash për atë që forca e tij ishte nga Allahu, ndihma e tij nga Allahu dhe mbështetja e tij vetëm te Allahu? Si do të ishte zemra dhe qëndrueshmëria e tij, kur ai merrte shpalljen nga Zoti i tij dhe shihte botët nga madhështia dhe fuqia e Tij që askush tjetër nuk i kishte parë? Si do ta shihte ai forcën e dobët të njerëzve, kur kishte parë Xhibrilin *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* në pamjen e tij origjinale që e ka krijuar Allahu, që kishte mbuluar horizontin, dhe e dinte fundin e atyre që ishin kryeneçë ndaj Allahut dhe të dërguarve të Tij dhe që mohonin shpalljet e Tij?

"***Tani shiko se si ka qenë fundi i ngatërresave të tyre. Ne i shkatërruam ata të gjithë dhe popullin e tyre."*** (En-Neml: 51); ***"Atëherë, Ne hakmerreshim kundër atyre, prandaj shiko si ka qenë përfundimi i femohuesve."*** (Ez-Zuhruf: 25)

[567] Buhariu, 680. Muslimi, 419.

Prandaj, ai ishte njeriu më i guximshëm, më i vendosur dhe më i qëndrueshëm.

Ky është një guxim i veçantë, që bashkon fuqinë shpirtërore dhe sigurinë e besimit.

Disa pamje nga guximi i tij:

Së pari, marrja përsipër e thirrjes në fillim të misionit të tij.

Kur e nisi thirrjen, e gjithë bota ishte zhytur në idhujtari dhe në shirk. Ai u ngrit për Zotin, pa pasur askënd me vete. Ishte vetëm ai, përballë mbarë njerëzimit. Doli me qëndrueshmëri dhe forcë, thirri në luginat e Mekës, mbi Safa, derisa njerëzit u mblodhën dhe u foli hapur, me vendosmëri e qartësi, me një thirrje që as ata, as të parët[568] e tyre nuk e kishin dëgjuar më parë. Kjo përballje mund të bëhet vetëm nga një zemër e guximshme dhe e patundur.

Qëndrueshmëria në shpellë

Kur Kurejshit rrethuan shpellën në kërkim të tij, Ebu Bekri pa këmbët e tyre pranë hyrjes dhe tha: "O i Dërguar i Allahut, sikur ndonjëri të shikojë te këmbët e tij, do të na shohë." Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu përgjigj me qetësi dhe qëndrueshmëri: ***"Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!"*** (Et-Teube: 40) "*O Ebu Bekr, ç'mendim ke për dy veta ku i Treti i tyre është Allahu.*"

Ato ishin vërtetë çaste ku zemra rreh fort, sytë shikojnë në panik dhe rreziku është përballë, por qetësia dhe qëndrueshmëria e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbushi zemrën e Ebu Bekrit me paqe dhe largoi frikën dhe shqetësimin.

Së dyti, qëndrueshmëria në raste frike.

Gjatë emigrimit: Ai udhëtonte, ndërsa kërkuesit e ndiqnin nga para dhe pas. Fiset kishin shpallur shpërblim për kokën e tij. Megjithatë, ai nuk u frikësua dhe nuk u trondit. Këtë e tregon njëri prej atyre që i ishte vënë pas për ta kapur, Suraka ibn Maliku. Ai rrëfen: "I hipa kalit për t'i ndjekur dhe i arrita, aq afër sa dëgjoja leximin e Kuranit nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin*

[568] Buhariu, 4971. Muslimi, 208.

mbi të). Ai vazhdonte leximin i qetë, pa u shqetësuar e pa u kthyer prapa. E thirra dhe kërkova siguri, sepse nuk po arrija të afrohesha më shumë. Ata u ndalën. Hipur mbi kalë, iu afrova dhe atë çast e kuptova se ai dhe thirrja e tij do të triumfojnë. I thashë se populli i tij kishte vënë një shpërblim për kapjen e tij dhe i tregova se çfarë kishin planifikuar. U ofrova ndihmë dhe ushqim, por ai më tha vetëm: "Mbaj të fshehtë lajmin për ne!" Pastaj i kërkova një garanci sigurie. Ai urdhëroi Amir bin Fuhejren që ta shkruante në një copë lëkure. Më pas, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vazhdoi rrugën e tij."

Sa mbresëlënëse është kjo qëndrueshmëri! Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ecte përpara pa u kthyer pas, duke vazhduar leximin e pjesës së tij nga Kurani, ndërkohë që fiset ishin ngritur në ndjekje të tij dhe kurejshët kishin caktuar shpërblim për këdo që do ta kapte.

Në raste alarmi të papritur: Ai qëndronte i patundur dhe hynte vetë në vendet e rrezikut dhe të frikës. Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu më i mirë, më bujari dhe më trimi nga të gjithë njerëzit. "Një natë banorët e Medinës u tronditën nga një zhurmë. Të gjithë dolën në drejtim të saj, por i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i priti në rrugë: "*Mos u frikësoni! Mos u frikësoni!*" - Kishte dalë para tyre dhe po kthehej mbi një kalë pa shalë të Ebu Talhas, me shpatën varur në qafë dhe tha: "*E gjeta të shpejtë si detin ose ai është si deti.*" [569],[570]

Në përballje të drejtpërdrejtë me armikun: Në qëndrueshmërinë e tij, në forcën e zemrës dhe në shkëlqimin e syve të tij, kishte diçka që ia trembte zemrën edhe më trimave, kur përballeshin me të. Xhabiri ibn Abdullahu transmeton: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* luftoi kundër fisit Muharib Khusafe[571] në vendin e quajtur Nakhl. Ata e panë se

[569] El Esmai thotë: "Kalit i thuhet det kur është i shpejtë ose ngaqë nuk mbaron ashtu siç nuk mbaron deti." Shiko: "*Fet'h el Bari*", 5/285.
[570] Buhariu, 2908. Muslimi, 2307.
[571] Khasafe është i biri i Fihrit dhe Fihri është i biri i Malikut. Muharib i përket këtij fisi. "*Fet'h el Bari*", 7/417.

muslimanët ishin të pavëmendshëm në një moment dhe një burrë nga ata, i quajtur Gavreth ibn Harith, depërtoi deri te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe qëndroi mbi kokën e tij me shpatë në dorë. Ai tha: 'Kush do të të mbrojë prej meje?' Pejgamberi u përgjigj: *'Allahu!'* Shpata i ra nga dora. I Dërguari i Allahut e mori atë dhe i tha: *'Po tani, kush do të të mbrojë prej meje?'* Ai tha: 'Ji më i miri nga ata që mbajnë shpatën në dorë.' Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *'A dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Allahut?'* Ai tha: 'Jo, por të jap fjalën se nuk do të luftoj kundër teje dhe nuk do të jem me njerëzit që të luftojnë.' Pejgamberi e la të lirë."[572]

Ky njeri ishte me të vërtetë trim dhe i guximshëm, ndaj arriti me guximin e tij të depërtojë në mesin e ushtrisë muslimane derisa iu afrua vetë të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me shpatë të ngritur. Por trimëria e tij iu zhduk menjëherë; në vend që ta frikësonte Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ishte ai që u frikësua. Dhe në vend që të përdorte armën, u përkul përpara madhështisë, qëndrueshmërisë dhe virtytit të lartë të të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Në qëndrueshmëri në kohë tronditjeje dhe lajmesh të rënda: Një rast domethënës i qëndrueshmërisë së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndodhi gjatë betejës së Hendekut, kur erdhi lajmi se fisi Benu Kurejdha kishte thyer marrëveshjen dhe kishte tradhtuar. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dërgoi disa prej shokëve të tij për ta verifikuar lajmin. Ata shkuan dhe, pas kthimit, u afruan te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe pasi i dhanë selam i thanë me një kod të njohur: "Adal dhe Karra." (duke nënkuptuar se Benu Kurejdha kishin tradhtuar), mirëpo Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha me forcë: *"Allahu është më i Madhi! Gëzohuni, o muslimanë!"*[573]

[572] Ahmedi, 14929.
[573] "*Siretu Ibni Hishamin*", 2/221.

Dita e hendekut ishte një ditë shumë e vështirë dhe plot shqetësime. Aleatët që kishin rrethuar Medinën ishin dhjetë mijë vetë, ndërsa muslimanët ishin të lodhur, të rraskapitur dhe në një pozitë të vështirë. Në atë gjendje të rëndë, erdhi edhe lajmi i thyerjes së marrëveshjes nga Benu Kurejdha, gjë që e shtoi edhe më shumë rrezikun dhe e vështirësoi gjendjen, sepse, tashmë, armiku kërcënonte nga lart dhe nga poshtë.

Megjithatë, në këtë situatë të jashtëzakonshme, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndroi i palëkundur. Ai e priti lajmin me thirrjen: "*Allahu është më i Madhi!*", me besim të fortë dhe me përgëzim të qetë, duke dhënë shenjë sigurie e shprese për shokët e tij. Ai mbolli qetësi dhe qëndrueshmëri në zemrat e besimtarëve që ishin me të.

Së treti: Guximi në beteja.

Beteja e Bedrit: Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* dëshmon: "Me të vërtetë, në ditën e Bedrit, ne kërkonim strehim pas të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndërkohë që ai ishte më afër armikut se kushdo prej nesh dhe ishte më trim se të gjithë atë ditë."[574]

Beteja e Uhudit: Në betejën e Uhudit, kur ushtria e muslimanëve u thye dhe njerëzit u shpërndanë pas disfatës, disa thanë: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është vrarë." Por i pari që e njohu atë ishte Ka'b ibn Maliku, i cili tha: "E njoha me sytë e tij që shkëlqenin nën përkrenare." Ai thirri me zë të lartë: "O muslimanë, ky është i Dërguari i Allahut!"[575]

Fakti që Ka'bi e njohu Profetin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nga shkëlqimi i syve të tij në një moment kaq të vështirë është dëshmi e qëndrueshmërisë dhe forcës së tij. Sytë e një të frikësuari do të ishin të lëkundur dhe të fikur, por sytë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndriçonin në atë moment kritik, sikur të flisnin.

Në këtë betejë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u plagos rëndë: iu thyen dhëmbët e përparmë[576], përkrenarja iu

[574] Ahmedi, 654.
[575] Taberani, "*El Muaxhemu el Evsatu*", 1104.
[576] "*Sherh el Nevevij ala Muslim*", 12/481.

thye mbi kokë[577], dy unaza prej saj i hynë në faqe, balli iu ça dhe gjaku i rridhte në fytyrë. Të gjitha këto plagë janë dëshmi se ai ishte në vijën e parë të rrezikut, përballë armikut dhe përballej me trimat e tyre.

Beteja e Hunejinit: Në betejën e Hunejnit, kur muslimanët u zmbrapsën dhe mbetën shumë pak njerëz pranë tij, Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndroi i palëkundur. [578]

Një njeri e pyeti Bera ibn Azibin: "A u tërhoqët në ditën e Hunejnit, o Ebu Umare?" Ai u përgjigj: "Dëshmoj se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk u tërhoq."

Abas ibn Abdulmutalibi tha: "Kam qenë me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në ditën e Hunejnit. Unë dhe Ebu Sufjan bin Harith bin Abdulmutalibi, qëndruam ngjitur me të dhe nuk u ndamë. Ai ishte mbi mushkën e tij të bardhë. Kur muslimanët u përballën me femohuesit u zmbrapsën, kurse i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nisi të ngiste mushkën drejt armikut. Unë mbaja frerët e mushkës që të mos nxitohej, ndërsa Ebu Sufjani e mbante këmbëzën e saj."[579]

Ai ishte i vetmi që qëndroi kur të tjerët u larguan dhe doli përpara ndërsa të tjerët po iknin. Nisi të çante rrugën me mushkë dhe ata që ishin pranë tij përpiqeshin ta ndalonin që të mos largohej shumë. Kur mushka nuk e ndihmoi më, zbriti prej saj dhe duke ecur në këmbë thirri: "*Unë jam Pejgamberi, nuk është gënjeshtër! Unë jam biri i Abdulmutalibit!*"

Ky është kulmi i guximit dhe trimërisë - të qëndrojë ndërsa ushtria e tij është tërhequr dhe ai vetë përparon, duke thirrur edhe të tjerët derisa u kthyen.

Guxim pa hakmarrje - Ai nuk vrau përveç një njeriu (Ubej ibn Halef)

Me gjithë këtë guxim, ai nuk vrau me dorën e tij veçse një njeri të vetëm: Ubej ibn Halefin.

Ky njeri kishte thënë: "Pasha Allahun, unë do ta vras Muhamedin." Kur kjo arriti te Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi*

[577] "*El Nihajetu*", 5/246.
[578] Buhariu, 2864. Muslimi, 1776.
[579] Muslimi, 1775.

të), ai tha: "*Jo, por unë do ta vras atë, nëse do Allahu."* Një njeri prej atyre që e dëgjuan këtë nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u nis për tek Ubej bin Halefi dhe i tha: "Kur i thanë Muhamedit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* atë që ti ke thënë për të, ai tha: "*Jo, por unë do ta vras atë, nëse do Allahu.*"" Ubeji u tremb shumë nga kjo dhe e pyeti lajmëtarin: "Pash Allahun, a vërtetë e ke dëgjuar duke e thënë këtë?" Ai i tha: "Po!" Kjo e preku shumë Ubejin, sepse ata kurrë nuk kishin dëgjuar nga i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të thotë diçka që të mos jetë e vërtetë.

Kur erdhi dita e Uhudit, Ubej ibn Halefi doli me idhujtarët duke kërkuar një moment pavëmendjeje për ta sulmuar Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, por një nga muslimanët e pengonte vazhdimisht. Kur i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pa këtë, tha: "*Lëreni të vijë."* E mori heshtën dhe e goditi në anë të qafës. Nga plaga nuk i shkoi shumë gjak, gjaku u mblodh brenda dhe ai filloi të rënkonte si ka.

Shokët e tij e morën duke e mbajtur, ndërsa ai rënkonte dhe ata i thanë: "Çfarë është kjo? Pasha Allahun, nuk është veçse një gërvishtje!" Por ai tha: "Pasha Allahun, edhe po të më kishte pështyrë do të më kishte vrarë. A nuk ka thënë ai se do të më vrasë? Pasha Allahun, nëse ajo që më ndodhi mua do t'u ndodhte banorëve të Dhi-l-Mexhazit, do t'i kishte vrarë të gjithë." Nuk zgjati më shumë se një ditë derisa vdiq dhe përfundoi në zjarr."[580]

Një pyetje që shfaqet nganjëherë:

A është e çuditshme që me gjithë këtë guxim, ai vrau vetëm një njeri?

Jo, përkundrazi, kjo është një cilësi madhështore nga virtytet e tij. Sepse zakonisht njeriu trim është edhe hakmarrës e i dhunshëm, por guximi i Profetit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i pastër nga padrejtësia dhe hakmarrja.

Siç ka thënë Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të):* "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk është

[580] "*Musannef*", *Abdu el Rrezzak,* 10575.

hakmarrë kurrë për veten e tij, përveçse kur është shkelur një ndalesë e Allahut, atëherë është hakmarrë për hir të Allahut."[581]

Po ashtu, ka thënë: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ka goditur asnjëherë as shërbëtor, as grua."[582]

Guximi i një udhëheqësi nuk është si ai i një ushtari. Udhëheqësi dallohet për qëndrueshmëri, vendosmëri dhe aftësinë për t'u dhënë zemër të tjerëve. Guximi i ushtarit buron prej guximit të komandantit të tij.

Pas Uhudit, edhe pse ishin të plagosur dhe të tronditur, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli me ata që kishin marrë pjesë në betejë duke ndjekur kurejshët deri në Hamra el-Esed, në kërkim të një përballje tjetër. Kur kurejshët e morën vesh, u frikësuan dhe u kthyen shpejt në Mekë. Kjo ngriti moralin e muslimanëve dhe forcoi vendosmërinë e tyre - e gjithë kjo ndodh vetëm nga një shpirt trim, që nuk shuhet as nga plagët dhe as nga humbja.

I Dërguari dhe lotët

Të qarët si përgjigje ndaj ndjenjave të trishtimit, afërsisë dhe pikëllimit është një natyrshmëri njerëzore me të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit, siç thotë në Kuran: ***"Se Ai jep gazin dhe vajin"*** (En-Nexhm: 43) Të qarët sjell lehtësim për shpirtin, qetësim në fatkeqësi dhe çlirim për zemrën e pikëlluar.

Kur të qarët ndodh në situatat e duhura, është shenjë e përkryerjes njerëzore, e natyrës së shëndoshë dhe e ekuilibrit në ndjenja dhe reagime.

Edhe lotët e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në raste të tilla janë përgjigje dhe shprehje e natyrshmërisë dhe gjallërisë së ndjenjave, ndërsa mohimi i tyre është ashpërsi dhe ngurtësi.

[581] Buhariu, 3560. Muslimi, 2327.
[582] Muslimi, 2328.

1. Të qarët është i dukshëm dhe i natyrshëm te ai

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e fshehte të qarën dhe nuk përpiqej ta shtypte dhimbjen kur ajo bëhej e dukshme. Ai i përgjigjej natyrshëm dhimbjeve dhe pikëllimeve kur ato shkaktonin të qarë, ai nuk e fshihte pikëllimin as të qarët. Shokët e tij habiteshin nga kjo dhe e pyesnin: "Edhe ti, o i Dërguar i Allahut?" - sepse jetonin në një shoqëri që e konsideronte të qarën dhe butësinë e burrit si dobësi. Ata turpëroheshin nga ndjeshmëria dhe mëshira dhe i atribuonin të qarët vetëm grave. Edhe sot disa e trashëgojnë këtë cilësi të injorancës dhe thonë: "Lotët nuk janë për burrat!"

Subhanallah! A nuk qau Jakubi aq shumë sa iu verbuan sytë nga pikëllimi? A nuk qau zotëria i njerëzimit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur humbi fëmijët e tij? A nuk është Ai që krijoi dhe përsosi, Ai që jep të qeshurën dhe të qarën?

Kur shokët e pyetën për të qarën nga humbja e fëmijëve, ai tha: "*Ajo është mëshirë, dhe Allahu mëshiron nga robërit e Tij vetëm të mëshirshmit.*"[583]

2. Qetësia në të qarë

Kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qante, ai derdhte lot pa britma, pa vajtime e pa zhurmë, por me qetësi dhe përulësi. Kur Ibn Mesudi i lexoi suren El Nisa dhe arriti te ajeti: ***"Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellin dëshmitarë dhe të të sjellin ty*** (o Muhamed!) ***për dëshmitar mbi të gjithë ata?!"*** (En-Nisa: 41) - ai tha: "*Mjaft!*" - dhe i ishin mbushur sytë me lot.

Emocioni i tij ishte i moderuar, siç ishte e qeshura e tij buzëqeshje, ashtu edhe e qara ishte lot që rridhnin. Aq e qetë ishte e qara e tij saqë Ibn Mesudi nuk e vuri re derisa u kthye ta shikonte.

3. Të qarët nga madhërimi i Allahut

Ai qante nga frika dhe madhërimi ndaj Allahut kur e lexonte Kuranin me përkushtim në namaz dhe dëgjohej në kraharorin e tij një zë[584] i ngjashëm me zierjen e një tenxhereje. Ishte një e qarë që

[583] Buhariu, 1284. Muslimi, 923.
[584] Ebu Davudi, 904.

prekte zemrën, që ndjehej, por nuk dëgjohej me zë, i shoqëruar me qetësi e përulësi. Ai qante kur lexonte Kuranin dhe, gjithashtu, kur e dëgjonte atë, siç qau kur dëgjoi leximin e Ibn Mes'udit.

4. Të qarët nga dhembshuria për Umetin

Ai qante nga mëshira dhe kujdesi për Umetin. Kur ndodhi eklipsi i diellit, ai u frikësua se mos ishte një shenjë ndëshkimi për popullin e tij dhe në sexhde dëgjohej duke qarë dhe lutur Zotin: *"O Zoti im, a nuk më premtove se nuk do t'i ndëshkoje ata sa të jem unë mes tyre? A nuk më premtove se nuk do t'i ndëshkoje ata për sa kohë ata kërkojnë falje?"*[585]

Ai qante duke lutur Zotin të largonte ndëshkimin nga Umeti i tij. Ai e ndjente Umetin në zemrën e tij dhe prekej për ta me ndjenja të forta. Allahu e përshkruan: *"**Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.**"* (Et-Teube: 128)

5. Të qarët nga mëshira në familje dhe miqësi

Ai qau nga mëshira për birin e tij, Ibrahimin. Transmeton Enesi se hymë bashkë me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* te Ebu Sejfi, që ishte babai[586] i Ibrahimit nga qumështi. I Dërguari e mori Ibrahimin, e puthi dhe e nuhati. Pastaj hymë sërish dhe Ibrahimi ishte në frymën e fundit. Sytë e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) filluan të lotojnë. Abdurrahman ibn Auf e pyeti: "Edhe ti, o i Dërguar i Allahut?" Ai u përgjigj: *"O bir i Aufit, kjo është mëshirë."* Pastaj tha: *"Sytë lotojnë, zemra është e pikëlluar, por ne nuk themi veçse atë që e kënaq Zotin tonë. Ne jemi të pikëlluar për ndarjen me ty, o Ibrahim."*[587]

Po ashtu, ai qau te varri i nënës së tij dhe i preku të gjithë ata që ishin përreth. Ai tha: *"I kërkova leje Zotit tim për t'u lutur për falje*

[585] Ebu Davudi, 1194.
[586] *"El Nihajetu"*, 3/154.
[587] Buhariu, 1303. Muslimi, 2315.

për të, por nuk më lejoi. Pastaj i kërkova leje për të vizituar varrin e saj dhe më lejoi. Vizitoni varrezat, sepse ju kujtojnë vdekjen."[588]

E qara e tij u shfaqte në butësinë ndaj shokëve. Kur hyri të vizitonte Sead ibn Ubade që ishte rënduar në sëmundje dhe pa familjarët që e kishin rrethuar, pyeti: "*Ka ndërruar jetë?*" Ata thanë: "Jo, o i Dërguar i Allahut!" Ai qau dhe kur panë shokët se ai qau, qanë edhe ata. Ai tha: "*A nuk dëgjoni? Allahu nuk ndëshkon për lotët e syve, as për pikëllimin e zemrës, por ndëshkon ose mëshiron për këtë* **-** dhe bëri me shenjë nga gjuha e tij."[589]

Ai hyri te Uthman ibn Madh'un pas vdekjes së tij dhe pasi ishte larë dhe mbështjellë me qefin. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e zbuloi fytyrën e tij, u përkul mbi të dhe e puthi mes syve. Sahabët e panë të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të përkulur mbi fytyrën e Uthmanit dhe, kur ngriti kokën, panë lotët e tij që kishin rënë mbi fytyrën e Uthmanit.[590]

Këto ishin ndjenja të sinqerta dhe emocione të thella. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i ndante me shokët e tij ndjenjat e dashurisë në mënyrën më të sinqertë. Ai prekej nga ata dhe ata prekeshin prej tij. Ata nuk i fshihnin ndjenjat, as nuk turpëroheshin prej tyre. Të qarët e tij ishte përkryerje njerëzore dhe natyrshmëri e plotë.

Ndër to ishin edhe të qarët kur njoftoi për rënien dëshmorë të Zejdit, Xhaferit dhe Ibn Revahes - para se t'u vinte lajmi të tjerëve. Ai tha: "Zejdi mori flamurin dhe u vra. Pastaj e mori Xhaferi dhe u vra. Pastaj e mori Ibn Revaha dhe u vra - dhe sytë e tij po derdhnin lot - derisa e mori flamurin një shpatë nga shpatat e Allahut dhe Allahu i dha fitoren."[591]

Ai qante nga mëshira dhe butësia kur dëgjonte ngjarje që e tronditnin shpirtin. Një burrë i tregoi për veprimet e tij në kohën e injorancës: "O i Dërguar i Allahut, ne ishim njerëz të injorancës dhe adhuronim idhujt. Vrisnim fëmijët tanë. Kisha një vajzë që më përgjigjej e gëzuar kur e thërrisja. Një ditë e thirra dhe ajo më ndoqi.

[588] Muslimi, 976.
[589] Buhariu, 1304. Muslimi, 924.
[590] Ahmedi, 24165.
[591] Buhariu, 3757.

E çova te një pus dhe e hodha brenda. Fjalët e fundit që më tha ishin: "Babi..., babi!"

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qau aq shumë saqë lotët i mbushën sytë. Njëri nga të pranishmit i tha: "E hidhërove të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*!" Ai ia ktheu: "*Mjaft! Sepse ai po pyet për hallin e vet"* - dhe lotët vazhdonin t'i rridhnin. Pastaj iu drejtua dhe i tha: "*Ma përsërit edhe njëherë ngjarjen."* - ai ia përsëriti. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qau derisa lotët i rrodhën mbi mjekër, pastaj tha: "*Allahu ua ka falur mëkatet e kaluara në injorancë, prandaj rifillo veprat e tua."*[592]

6. Pikëllimi me përulësi, jo me zemërim

"I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qante me një të qarë të natyrshme, që buron nga mëshira e zemrave të mëshirshme. Kjo e qarë është një mënyrë për të larguar vrullin e ndjenjave dhe dhimbjen e pikëllimit. Por ai ndalonte nga tejkalimi i kësaj mase, siç është vajtimi me zë të lartë, bërtitja, pakënaqësia dhe të folurit pa kontroll.

Prandaj ai ka thënë: "*Vërtet, Allahu nuk ndëshkon për lotët e syve, as për pikëllimin e zemrës, por ndëshkon ose mëshiron për këtë* **-** dhe bëri me shenjë nga gjuha e tij."

Prandaj, ai paralajmëroi kundër zakoneve të periudhës së injorancës në rast pikëllimi, si rrahja e fytyrës, grisja e rrobave, vajtimi me zë të lartë dhe çdo gjë që shpreh pakënaqësi ndaj caktimit të Allahut, ankth ndaj fatkeqësisë dhe mos përulje ndaj asaj që Allahu ka përcaktuar dhe vendosur.

[592] "*Musned el Darimij* 2". Me transmetues të besueshëm. Hadithi është Mursel.

I Dërguari dhe hidhërimi

1. Hidhërimi kurrë nuk e mbizotëroi zemrën e tij

Allahu e mbrojti të Dërguarin e Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që hidhërimi të mos e pushtonte zemrën e tij. Ai ishte njeriu që i lutej Zotit të ruhej nga brenga dhe pikëllimi. Fytyra e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ishte kurrë e mbyllur nga trishtimi, por gjithnjë e ndriçuar, me buzëqeshje të shpeshta. A nuk ishte ai i Dërguar si përgëzues? E si mund të përgëzojë një fytyrë e vrerosur dhe e zymtë? Në jetën e tij mbizotëronin hareja dhe gëzimi, ndonëse hidhërimet nuk munguan, por ato kurrë nuk e mbizotëruan zemrën e tij.

2. Hidhërimet që vizituan jetën e tij

Hidhërimi e vizitoi që në fëmijëri: në Ebva i vdiq nëna para syve të tij, kur ishte vetëm gjashtë vjeç. Pak vite më vonë, i vdiq edhe gjyshi, Abdul Mutalibi, kur ishte tetë vjeç. Pas shpalljes, në moshën pesëdhjetëvjeçare, humbi xhaxhain e tij, Ebu Talibin, e pas tre ditësh edhe bashkëshorten e tij të dashur, Hadixhen *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Viti u quajt "*Viti i Hidhërimit*". Zemra e tij u prek edhe më fort kur ra dëshmor xhaxhai i tij, Hamza, në Uhud. Më pas, në Mu'te, u vra kushëriri i tij, Xhafer bin Ebi Talibi, miku i ngushtë Zejd bin Harithe dhe poeti i përkushtuar Abdullah bin Revaha. Aishja tregon: *"I Dërguari i Allahut u ul dhe në fytyrën e tij u pa qartë hidhërimi."*[593] Pikëllimi i tij thellohej sa herë humbiste një fëmijë apo bijë; u ul pranë varrit në të cilin do të varrosej bija e tij dhe sytë e tij derdhnin lot në heshtje.

Hidhërimi e vizitoi..., por si u soll ai me të?

[593] Buhariu, 4263.

3. Qasja profetike ndaj hidhërimit

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përjetonte hidhërimin në mënyrë të natyrshme dhe të ndjeshme. Nuk e mohonte natyrën njerëzore, as nuk e shtypte dhimbjen me forcë të sforcuar. Kur vinte sprova, ai ndiente dhimbje, pikëllohej dhe kjo pasqyrohej në fytyrën e tij. Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon për lajmin e vrasjes së shtatëdhjetë hafizëve në Bi'ru Maune: "Nuk e kam parë ndonjëherë më të pikëlluar se në atë moment."[594] Ai shprehej me lot që rridhnin në faqen e tij të ndritur, ose me rënkime që i shpërthenin nga thellësia e shpirtit.

Kur pa trupin e copëtuar të Hamzës, iu afrua, i pa ballin dhe qau. Pikëllimi ishte i thellë dhe i sinqertë - një dhimbje e pastër njerëzore që nuk fshihet e as nuk përbuzet.

4. Nuk jetoi në hidhërim, por e tejkaloi atë

Megjithatë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i kthehej jetës. Nuk lejonte që hidhërimi ta shoqëronte. Nuk caktoi as përkujtimore, as ditë të posaçme për të vdekurit. Jetonte për të përhapur shpresë dhe dritë. Ai e shihte jetën si një rrugëtim ku dhimbja duhej kaluar dhe jo ngritur si stacion i përhershëm.

5. Mbështetja dhe dhembshuria për të pikëlluarit

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e njihte thellësisht dhimbjen e të pikëlluarve dhe ua kuptonte gjendjen e brendshme. Kaloi pranë një gruaje që qante pranë një varri dhe i tha: *"Kij frikë Allahun dhe bëj durim."* Ajo u përgjigj: "Largohu nga unë, se ti nuk e di çfarë ndiej!" Ai nuk e qortoi. U largua pa thënë më asgjë, duke respektuar gjendjen e saj. Më vonë, kur ajo e njohu, u kthye e penduar dhe i tha: "Nuk të njoha." Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu përgjigj me butësi: *"Durimi është në çastin e parë të goditjes."*[595] Ai nuk foli për veten e tij, por për të, për qëndrimin që duhej të kishte në përballje me sprovën, pa e vënë nën presion për të kërkuar falje.

---

[594] Muslimi, 677.
[595] Buhariu, 1283.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndronte pranë të pikëlluarve, u largonte dhimbjet, u shëronte zemrën dhe u sillte përgëzime që tejkalonin çdo hidhërim.

E takoi Xhabirin ibn Abdullahun, një djalosh rreth njëzet vjeç, të pikëlluar për vrasjen e babait të tij në Uhud. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: "*O Xhabir, pse të shoh të thyer nga mërzia?"* Ai u përgjigj: "O i Dërguari i Allahut, im at vdiq, la pas fëmijë dhe borxhe." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*A do të të përgëzoj se si e ka pritur Allahu babanë tënd?"* - "Po, o i Dërguar i Allahut!" - tha ai. - "*Allahu nuk i ka folur askujt përveçse pas një perdeje, por për babanë tënd bëri përjashtim: e ringjalli dhe i foli drejtpërdrejt, duke i thënë: 'O rob Im, më kërko çfarë të duash!' Ai tha: 'O Zot, më kthe në jetë që të vritem sërish për Ty.' Allahu tha: "Është shkruar tashmë që ata që kanë vdekur nuk kthehen më në dynja."*[596]

Imagjinoje zemrën e Xhabirit pas kësaj fjale... si u mbush me dritë dhe shpresë, nga një fjalë e vetme e Profetit të mëshirës.

Kur Xhaferi ra dëshmor, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri te Esmaja, gruaja e tij, dhe kërkoi djemtë e Xhaferit: "*Mi sillni fëmijët e vëllait tim!"* Abdullah bin Xhaferi tregon: "*Na sollën sikur të ishim zogj të trembur. Ai urdhëroi që të na qethnin!"*, *pastaj tha*: "*Muhamedi i ngjan xhaxhait tim Ebu Talibit, ndërsa Abdullahu më ngjan mua në pamje dhe në sjellje." Pastaj më mori për dore dhe u lut:*

"*O Allah, kujdesu për familjen e Xhaferit dhe bekoje Abdullahun në tregtinë e tij!*

O Allah, kujdesu për familjen e Xhaferit dhe bekoje Abdullahun në tregtinë e tij!

O Allah, kujdesu për familjen e Xhaferit dhe bekoje Abdullahun në tregtinë e tij!"[597]

Çfarë ngushëllimi i madh, çfarë dashurie prindërore, çfarë prehjeje për një zemër të pikëlluar si ajo e Esmës!

6. Por hidhërimi më i madh që e preku Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ishte për humbjen e të afërmve, por për largimin e njerëzve nga udhëzimi. Ai ndiente dhimbje të

[596] Tirmidhiu, 3010.
[597] Ahmedi, 1750.

thellë për Umetin e tij, pasi ai i thërriste njerëzit në udhëzim, por ata nuk e pranonin. Zoti e qortoi në disa ajete: ***"A mos vallë do të vrasësh veten nga pikëllimi, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë*** (Kuran)***."*** (El-Kehf: 6); ***"Ti mos e shqetëso veten deri në shkatërrim për humbjen e tyre!"*** (Fatir: 8)

I Dërguari dhe dashuria

Dashuria - kjo fjalë e vogël, por me kuptim të gjerë - është vetëm një simbol për këtë ndjenjë të thellë; ajo nuk mund ta shprehë plotësisht, as ta përshkruajë siç duhet. Gjuha bëhet e varfër, fjalët pakësohen kur përpiqen të shprehin këtë ndjenjë të përhershme dhe të përjetshme, e cila është e pranishme gjithmonë sa herë që ka jetë, sepse jeta është dashuri dhe dashuria është jetë.

Si mund ta përshkruajnë fjalët zjarrin e dashurisë dhe mallin për të dashurin, dhimbjen e humbjes dhe pikëllimin, mallin e takimit dhe gëzimin? Kush mund t'i përshkruajë lotët që rrjedhin nga malli apo që derdhen nga gëzimi?

Kushdo që përpiqet të përshkruajë këtë ndjenjë e këtë emocion, është sikur përpiqet të fusë hënën në një çantë apo të hedhë detin në një gotë.[598]

Jeta me dashuri është jetë e hareshme, e dashur dhe e mbushur me energji e bukuri; ndërsa jeta pa dashuri është jetë e thatë, e vetmuar dhe e zymtë.

Dhe ja, erdhi ky i Dërguar *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për ta rikthyer dashurinë në jetë dhe jetën në dashuri. Ai e riktheu dashurinë për gruan duke e bërë adhurim; dashurinë për fëmijët, duke e bërë mëshirë; dashurinë për vëllazërinë, duke e bërë besim: *"Nuk do të hyni në Xhenet derisa të besoni dhe nuk do të besoni derisa të doni njëri-tjetrin."*[599] Ai përhapi dashuri në natyrë dhe

[598] Shkëputje nga një artikull i Shejh Ali Tantavit (*Allahu e mëshiroftë*) rreth dashurisë.
[599] Muslimi, 54.

këmbeu dashuri me dukuritë e saj. Tha për malin Uhud: "*Ky është Uhudi, një mal që na do dhe ne e duam atë.*"[600]

Kur vëzhgon jetën e sahabëve rreth Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, thuajse, duket sikur ata e thithnin dashurinë me ajrin që merrnin frymë dhe e pinin me ujin që pinin.

Dashuria ishte përhapur në të gjitha fushat e jetës së tyre, edhe pse jetonin në një kohë të afërt me errësirën e injorancës, ashpërsinë e shkretëtirës dhe rreptësinë e natyrës. E nëse kërkon arsyen e kësaj dashurie, do të kuptosh se drita e profetësisë kishte ndriçuar shpirtrat e tyre dhe ia kishte mbushur zemrat me këtë dritë nga ai personalitet i ndritshëm - sepse i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndizte kandila dashurie në çdo aspekt të jetës.

Kur hynte në shtëpinë e tij, shfaqte dashurinë bashkëshortore në formën më të bukur, duke i kthyer dhomat e tij të vogla në magazina të mëdha dashurie.

Ata e lexonin dashurinë profetike në ndjenjën e atësisë, që derdhej si dashuri në skena si ajo e përqafimit të Hasanit, nipit të tij, kur ai u hodh në gjoksin e tij dhe ai e përqafoi, e përkëdheli dhe shpalli dashurinë për të duke thënë: "*O Allah, unë e dua këtë djalë, andaj duaje edhe Ti dhe duaje këdo që e do atë!*"[601]

Dashuria rridhte në jetën e tyre dhe ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shprehte me ta, e derdhte në veshët e tyre dhe shpirtrat e tyre ndriçonin e ngazëllonin prej saj. Ja ku e merr dorën e Muadhit dhe i thotë: "*O Muadh, pasha Allahun, unë të dua!*" - dhe Muadhi i thotë: "Qoftë jeta ime për ty, o i Dërguar i Allahut, edhe unë, pasha Allahun, të dua!" - Atëherë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*O Muadh, mos e lër pa e thënë në fund të çdo namazi: "O Allah, më ndihmo të të kujtoj Ty, të të falënderoj Ty dhe të të adhuroj siç duhet!*"[602]

Ai përhapte dashurinë nëpër rrugët dhe rrugicat e Medinës - njëherë, kur pa disa fëmijë dhe gra që po ktheheshin nga një dasmë, u ngrit dhe tha:

"*Pasha Allahun! Ju jeni nga njerëzit më të dashur për mua!*

[600] Buhariu, 1481.
[601] Buhariu, 2122. Muslimi, 2421.
[602] Ebu Davudi, 1522.

Pasha Allahun! Ju jeni nga njerëzit më të dashur për mua!" - duke nënkuptuar ensarët.[603]

Dashuria e tij rridhte në jetë, si me të gjallët, ashtu edhe me të vdekurit. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* fliste për gruan e tij, Hadixhen *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, vite pas vdekjes së saj, duke thënë: *"Ajo ishte kjo e ajo... Mua më është dhuruar dashuria për të."*[604] Shiko sa bukur e përshkroi dashurinë si një dhuratë nga Allahu, një dhuratë e Tij e çmuar.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e largon perden që mbulon ndjenjën e bukur të dashurisë për ta zbuluar dhe për ta bërë publike hapur, në vend që ta mbante të fshehur. Kur Amr ibn el Asi e pyeti njëherë: "Kush është njeriu që do më shumë?", ai iu përgjigj menjëherë si rrufeja: *"Aishja!"*[605]

Me këtë ai shpalli se dashuria është një përsosmëri njerëzore dhe një prirje natyrore që duhet përjetuar dhe shpallur, sepse ajo e shton bukurinë dhe gëzimin në jetë.

Kur gruaja e tij, Safija, deshi të hipte në deve, ai u ul që ajo të shkelte mbi gjurin e tij dhe të hipte lehtësisht.[606] Imagjino ndjenjat e saj dhe emocionet që përjetonte teksa hipte në deve me dorën e saj në dorën e tij dhe këmbën mbi gjurin e tij, duke jetuar një skenë dashurie të hapur para syve të njerëzve.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shfaqte dashurinë dhe urdhëronte që ajo të shfaqet dhe të shpaloset. Një ditë, një burrë erdhi e përshëndeti, pastaj u largua. Një nga Sahabët tha: "O i Dërguar i Allahut, pasha Allahun, unë e dua këtë njeri." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: *"A i ke treguar atij?"* Ai tha: "Jo!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Shko dhe tregoji!"* - dhe ai shkoi e i tha: *"O ti, pasha Allahun, unë të dua për hir të Allahut!"* - dhe tjetri iu përgjigj: *"Të dashtë Allahu që për hir të Tij më do!"*[607]

---

[603] Buhariu, 3785. Muslimi, 2508.
[604] Buhariu, 3818. Muslimi, 2435.
[605] Buhariu, 3662.
[606] Buhariu, 2235.
[607] Ahmedi, 12430.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thoshte: *"Nëse njeriu e do vëllain e tij, le t'i tregojë se e do."*[608]

Kështu, dashuria u përhap në gjithë jetën e tyre. Ajo i bëri ata të kapërcenin inatet dhe armiqësitë e periudhës së injorancës, të çliroheshin nga urrejtjet e trashëguara, të përjetonin paqe shpirtërore dhe të gëzonin jetën, të kapërcenin ndjenjat negative dhe dhimbjet për të shkuar përpara. Në Medinë, ata përjetonin lloje të ndryshme dashurie dhe qyteti i tyre merrte frymë me dashuri dhe parfumohej me të.

Një nga skenat më të mëdha të dashurisë së shpallur ishte dashuria e Sahabëve për të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ebu Sufjani, para se të bëhej musliman, tha: "Nuk kam parë askënd që e do dikë, siç e duan shokët e Muhamedit, Muhamedin."[609]

Kjo dashuri e thellë dhe madhështore ishte dashuri besimi dhe dashuri zemre, që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e mbolli me butësinë e sjelljes dhe bukurinë e moralit: ***"Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta."*** (Ali Imran: 159)

Ai mbolli dashurinë në zemrat e tyre dhe ajo u bë shenjë dalluese e marrëdhënies së tyre, ura që lidhte zemrat e tyre me të. Për këtë, sahabët e përshkruanin marrëdhënien me të si dashuri: "Dikur, fytyra jote ishte më e urryer për mua se çdo fytyrë, ndërsa tani është më e dashura për mua. Edhe feja jote dikur ishte më e urryer për mua, por tani është më e dashura për mua." - siç është transmetuar nga Thumame bin Uthal,[610] Amr ibn el As[611] dhe Hind bint Utbe.[612]

Kjo tregon se bindja ndaj Pejgamberit nuk ishte thjesht mendore, por ishte një bindje e përzier me ndjenjë, ndjeshmëri dhe lidhje shpirtërore.

Ai ua drejtoi shikimin nga dashuria më e madhe dhe më e shenjtë: dashuria e Allahut për robërit e Tij dhe dashuria e tyre për Të: **"*Dijeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan*"** (El-

[608] Ebu Davudi, 5124.
[609] "*Siretu Ibni Hisham*", 2/272.
[610] Buhariu, 4372. Muslimi, 1764.
[611] Muslimi, 121.
[612] Buhariu, 3825. Muslimi, 1714.

Maide: 54) - dhe ua tregoi mënyrat për ta arritur këtë dashuri, siç thuhet në hadithin kudsij: "Allahu i Madhëruar ka thënë: **Kush e ngacmon një të dashur Tim, i kam shpallur luftë. Robi Im nuk më afrohet me asgjë më të dashur për Mua sesa me ato që ia kam bërë obligim. Pastaj robi Im vazhdon të afrohet te Unë me vepra vullnetare derisa ta dua. E kur e dua, bëhem dëgjimi me të cilin dëgjon, shikimi me të cilin sheh, dora me të cilën kap dhe këmba me të cilën ecën. Nëse më kërkon, Unë do t'ia jap. Nëse më kërkon mbrojtje, Unë do ta mbroj. Unë nuk ngurroj për asgjë që bëj, siç ngurroj për marrjen e shpirtit të besimtarit - ai e urren vdekjen dhe Unë nuk dua t'i shkaktoj dhimbje."**[613]

Kurani shpalli përshkrimin e të dashurve të Allahut me cilësitë, sjelljet dhe adhurimet e tyre:

"Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) ***dhe ata që pastrohen."*** (El-Bekare: 222)

"Allahu i do bamirësit." (El-Maide: 13)

"Allahu i do të duruarit." (Ali Imran: 146)

"Allahu i do ata që mbështeten tek Ai." (Ali Imran: 159)

"Vërtet, Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të radhitur si të ishin një ndërtesë solide." (Es-Saf: 4)

"Allahu, me të vërtetë, i do ata që janë të devotshëm." (Ali Imran: 76)

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përshkroi dashurinë e Allahut për besimtarët dhe ndikimin e kësaj dashurie në jetën e tyre: *"Kur Allahu e do një rob, e thërret Xhibrilin: 'Unë e dua filanin, andaj duaje edhe ti!' Xhibrili e do dhe u thotë banorëve të qiellit: 'Allahu e do filanin, andaj duajeni edhe ju!' - dhe ata e duan, pastaj kjo dashuri zbret në tokë dhe atë e duan banorët e tokës."*[614]

Ata e përjetuan këtë realitet dhe morën lajmin e mirë për dashurinë e Allahut ndaj tyre. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha për Aliun *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*: *"Nesër do t'ia jap flamurin një njeriu në dorën e të cilit do të vijë fitorja. Ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe Allahu dhe i Dërguari e duan atë."*[615]

[613] Buhariu, 6502.
[614] Buhariu, 3209. Muslimi, 2637.
[615] Buhariu, 3009. Muslimi, 1807.

Për ensarët tha: "*Ensarët nuk i do askush përveçse një besimtar dhe nuk i urren askush përveçse një hipokrit. Kush i do ata, atë e do Allahu, dhe kush i urren ata, atë e urren Allahu.*"[616]

Vallë, ç'është ky horizont i lartë i shenjtërisë mbi të cilin janë ngritur këta njerëz, ata ecin përmbi tokë, por zemrat i kanë në botën më të lartë! Allahu u jep dashurinë e Vet, i urdhëron engjëjt për këtë dashuri dhe këtë dashuri e mbjell në zemrat e njerëzve për besimtarët e Tij!

Ndaj edhe ata jetuan në lumturinë e dashurisë më të pastër - me zemra që fluturojnë drejt Allahut me dashuri dhe mall, e dëshirojnë takimin me Allahun dhe Allahu e dëshiron takimin me to.

I Dërguari dhe zemërimi

Hapësira më e madhe në jetën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ajo e kënaqësisë, butësisë, durimit ndaj lëndimeve dhe qëndrueshmërisë përballë paditurisë dhe ashpërsisë së njerëzve. Nëse ndonjëherë shfaqej zemërim prej tij në ndonjë situatë, ajo ishte një përjashtim i rrallë në oqeanin e qetësisë dhe kënaqësisë që karakterizonte jetën e tij. Ai vetë porosit duke thënë: "*Mos u zemëro!*"[617] dhe thotë: "*Nuk është i fortë ai që e mund*[618] *tjetrin* (në mundje)*, por i fortë është ai që e përmban veten në momente zemërimi.*"[619]

Për këtë arsye, e shohim Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të përballet me nxitës të fuqishëm të zemërimit dhe reagimit emocional, por ai i përballoi me butësinë e gjerë dhe durimin e bukur.

Një beduin e kapi nga pas dhe ia tërhoqi rrobën me forcë, aq sa Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gati sa nuk

[616] Buhariu, 3783. Muslimi, 75.
[617] Buhariu, 6116.
[618] Mundje, ai që është kampion. Shiko: "*El Nihajetu*", 3/23.
[619] Buhariu, 6114. Muslimi, 2609.

ra me shpinë për tokë. Rroba iu gris nga tërheqja, e beduini i tha me zë të ashpër: "Më jep nga pasuria e Allahut!"[620]

Mendo sa i pasjellshëm u tregua ky beduin në këtë rast - si në fjalë, ashtu edhe në vepër! Çdonjëra prej këtyre sjelljeve do të mjaftonte për të ndezur zemërimin, por Pejgamberi yt *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përmbajti veten, e mbajti nën kontroll reagimin dhe iu kthye beduinit duke i buzëqeshur dhe urdhëroi që t'i jepnin diçka.

Ky është interpretimi praktik i fjalës së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: *"I forti është ai që e përmban veten në momente zemërimi."* Nuk ka reagim më të mrekullueshëm dhe më të bukur sesa ky i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* – reagim i menjëhershëm dhe i natyrshëm. Ai nuk u tërhoq, por u kthye. Nuk u zemërua, por buzëqeshi. Nuk ndëshkoi, por dhuroi.

Dërgoi shërbëtorin e tij, Enesin, për një nevojë, por Enesi u ndal për të luajtur me fëmijët në rrugë. Papritur, dikush e kapi nga pas dhe kur ktheu kokën, pa Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që qeshi dhe i tha: *"O Enes, a shkove atje ku të dërgova?"* Ai tha: "Po, po shkoj, o i Dërguar i Allahut."

Ky veprim i Enesit - të harrojë një amanet për shkak të lojës - do ta zemëronte një baba nëse do ta bënte djali i tij, e lëre më një shërbyes. Por ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vetëm e pyeti me buzëqeshje: "Shkove ku të dërgova?" - dhe e la të lirë.

Prandaj, ky moment i bukur mbeti i gjallë në kujtimin e Enesit, i cili e tregonte me dashuri dhe gëzim.

Edhe kur zemërohej, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kishte nën kontroll veten. Kur ndau plaçkën e luftës së Hunejnit, një njeri tha: *"Për Allahun, kjo ndarje nuk është e drejtë!"* Kur i treguan Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai u zemërua aq sa i ndryshoi fytyra nga skuqja dhe tha: *"Nëse Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk bëjnë drejtësi, atëherë kush bën? Allahu e mëshiroftë Musain - u lëndua më shumë se kaq dhe duroi."*[621]

[620] Buhariu, 3149. Muslimi, 1057.
[621] Buhariu, 3150. Muslimi, 1062.

Megjithatë, edhe pse ishte në kulmin e fuqisë së tij - kishte çliruar Mekën, kishte fituar ndaj Havazinëve dhe kishte plaçkën e tyre - nuk e pyeti: *"Kush e tha këtë?"* Nuk kërkoi ndëshkim, por përmbajti inatin dhe mori shembull nga durimi i Pejgamberëve të mëdhenj para tij.

Madje, në një rast tjetër, dikush i tha drejtpërdrejt: "O Muhamed, bëj drejtësi!" Ai u përgjigj: "*Mjerë për ty! Po kush bën drejtësi atëherë, nëse unë nuk bëj unë?"*[622] Umeri tha: "Më lejo ta vras këtë hipokrit, o i Dërguar i Allahut." Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Zoti na ruajttë, që njerëzit të flasin se unë po vras shokët e mi!"*[623]

Ai njeri e kishte tejkaluar çdo kufi në ashpërsi dhe mungesë respekti, por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e shfrytëzoi zemërimin për hakmarrje apo ndëshkim.

Ai zemërohej kur kishte arsye për të - dhe zemërimi i tij lexohej në fytyrë - por kurrë nuk e kalonte kufirin. Nuk përdorte fjalë të pahijshme e as veprime të nxituara. Kur zemërohej, ishte për hir të Allahut - kur shkeleshin kufijtë e Tij apo i bëhej padrejtësi njerëzve.

U zemërua me Usamen kur vrau një njeri që kishte thënë "La ilahe il-lAllah", me Ebu Dherin kur ofendoi dikë për prejardhjen e tij nga nënë me ngjyrë, me Muadhin kur e zgjaste shumë namazin dhe rëndonte mbi njerëzit, dhe me njeriun që mbante unazë prej ari. Kur e pa, ia hoqi dhe e hodhi, duke thënë: *"A dëshiron të vësh në dorën tënde një copë zjarri nga zjarri i Xhehenemit?"* Kur dikush i tha atij pas largimit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "*Merre unazën e përfito prej saj!"*, ai tha: "Jo, për Zotin! Nuk do ta marr kurrë, pasi e ka hedhur i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)."

Sa për zemërimin për veten, është e mjaftueshme ajo që tregoi Aishja - Zoti qoftë i kënaqur me të: "I Dërguari i Allahut nuk ka goditur kurrë me dorën e tij asgjë, as grua, as shërbëtor - përveçse kur luftonte në rrugën e Allahut. Nuk i është hakmarrë kurrë dikujt për diçka personale, veçse nëse cenohej një prej ndalesave të Allahut - dhe atëherë hakmerrej për hir të Allahut."

---

[622] Buhariu, 3610. Muslimi, 1063

[623] Muslimi, 1063.

Nëse ndonjëherë në moment zemërimi i dilte ndonjë fjalë njerëzore, sapo e shihte se e drejta ishte në kthim nga ajo fjalë, ai kthehej menjëherë, pa u ndjerë i turpëruar ose krenar. Ka thënë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "*Për Zotin, nëse betohem për diçka dhe më del më e mirë se ajo që thashë, unë e bëj më të mirën dhe e shlyej betimin tim.*"[624]

Ai zemërohej si çdo njeri tjetër, por e mbante veten, e përmbyste inatin dhe falte me zemër të qetë. Madhështia e tij morale e bënte të sundonte emocionet në çdo gjendje.

Nga mëshira e tij për Umetin dhe dashuria për shokët e tij, i kishte kërkuar Allahut që nëse ndonjëherë në zemërim do të bënte ndonjë lutje kundër ndonjë anëtari të Umetit të tij, atëherë ajo të jetë një lutje për mëshirë dhe pastrim e jo lutje kundër tyre. I tha Umu Sulejmes: "*O Umu Sulejm! A nuk e di ti se unë u bëra një marrëveshjeje me Zotin tim: Unë jam njeri - zemërohem siç zemërohen njerëzit. Prandaj, kushdo që e shaj apo bëj lutje kundër tij, që nuk është me vend, le ta bëjë Allahu këtë lutje, pastrim, mëshirë dhe afrim drejt Tij Ditën e Gjykimit.*"[625]

Zemërimi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj shokëve ishte si ai që përdornin arabët në gojë pa pasur për qëllim zbatimin e tij. E, megjithatë, ai iu lut Zotit që çdo fjalë e thënë në zemërim të kthehej në pastrim dhe afrim për atë për të cilin u tha.

Çfarë mëshire delikate mbante zemra e këtij Pejgamberi të butë dhe mëshirues! Çfarë begatie të madhe për Umetin e tij!

Zemërimi i tij rrallë është dëshmi e forcës së shpirtit, ndërsa zemërimi i tij për Allahun ishte dëshmi e forcës së besimit. Kur ndodhte të zemërohej, kjo ishte vetëm për të na mësuar se si të sillemi në atë gjendje - që zemërimi të mos na çojë në padrejtësi, tejkalim të kufijve apo kokëfortësi. Ai gjithnjë kthehej shpejt në gjendjen e tij të mirë dhe nuk lejonte që një fjalë në zemërim ta bënte të humb kontrollin.

Zemërimi i tij në këto raste ishte pjesë e natyrës njerëzore. Ai zemërohej për të treguar se si duhen menaxhuar ndjenjat në të tilla raste, ashtu siç i ndodhte harresa për të na mësuar se çfarë të bëjmë kur harrojmë. Në këtë mënyrë, Umeti kupton mençurinë e madhe të Allahut që e bëri Pejgamberin një njeri prej njerëzve që të mund të marrim shembull prej tij.

[624] Buhariu, 3133. Muslimi, 1649.
[625] Muslimi, 2601.

Pa njëherë dy burra që po shanin njëri-tjetrin dhe njëri prej tyre ishte skuqur nga zemërimi. Tha: "Unë e di një fjalë që po ta thotë, do t'i largohet ajo që ka brenda." Dikush shkoi dhe i tregoi atij fjalën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i tha: *"Kërko mbrojtje tek Allahu nga shejtani."* Por ai iu kthye: "Mos jam i sëmurë unë? Mos jam i çmendur unë? Largoju!"[626] - kjo ishte shenjë e ashpërsisë së reagimit dhe mungesës së maturisë në momentet e zemërimit.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* këshilloi heshtjen në rast zemërimi: *"Kur ndokush prej jush zemërohet, le të heshtë."*[627] Kjo, sepse njeriu në zemërim humbet kontrollin mbi fjalët e veta dhe zgjedhjen e shprehjeve.

Ai këshilloi, gjithashtu, qetësimin fizik: *"Kur ndokush prej jush zemërohet nëse është në këmbë, le të ulet. E nëse i kalon zemërimi, mirë. Përndryshe, le të shtrihet..."*[628]

Ai që është në këmbë është më i gatshëm për lëvizje dhe sulm, ai që është ulur është më pak i tillë, ndërsa ai që është i shtrirë është edhe më pak. Prandaj është urdhëruar të ulet ose të shtrihet, në mënyrë që të mos i shpëtojë ndonjë reagim i menjëhershëm për të cilin më pas do të pendohet.[629]

I Dërguari dhe bukuria

Allahu është i Bukur dhe e do bukurinë, prandaj krijoi gjithësinë të bukur dhe të zbukuruar: ***"Ne jua kemi zbukuruar qiellin më të afërm me yje të shkëlqyeshme."*** (El-Mulk: 5) Krijoi edhe njeriun të bukur: ***"Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer."*** (Et-Tin: 4) Bukuria gjendet edhe te kafshët, te pemët, në trupin dhe frytet e tyre, si dhe në bimësinë e tokës, që është plot bukuri dhe gjallëri.

---

[626] Buhariu, 6048.
[627] Ahmedi, 2136.
[628] Ebu Davudi, 4782.
[629] "*Mealimu el Sunen*", 4/108.

Allahu e ka bërë dashurinë për bukurinë një prirje të natyrshme të shpirtrave të shëndoshë, të cilët mahniten prej saj, e kërkojnë dhe e dëshirojnë. Prandaj, edhe Pejgamberi ynë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte një lidhje të thellë me bukurinë, e cila shfaqej në shumë mënyra:

1. I Dërguari ishte i bukur në pamjen e jashtme. Askush që e kishte parë, nuk kishte parë dikë më të bukur dhe me sjellje më madhështore. Fytyra e tij shkëlqente si dielli dhe hëna. Kush e kishte parë thoshte: "Nuk kam parë para tij e as pas tij dikë si ai." Bukuria e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte e mbështjellë me madhështi.

2. Ashtu siç ishte i bukur në pamje, ishte i bukur edhe në paraqitje. Ishte elegant në veshje, i rregullt dhe me dukje të hijshme. Kishte kujdes për veshjen dhe nuk është transmetuar që ndonjëherë të ketë veshur rroba të vjetra a të pahijshme. Veshjet e hijeshonin dhe dukeshin si të krijuara posaçërisht për të.

3. I Dërguari ishte i bukur edhe në përzgjedhje. Gratë e tij, nënat e besimtarëve, ishin të bukura. Kur Xhuvejrija bintu el Harith erdhi tek i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pas Betejës së Benu Mustalik për ta ndihmuar në pagesën për lirinë e saj, Aishja tha: "Ajo ishte një grua e hijshme dhe e këndshme." Ajo i kërkoi ndihmë Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, por ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"A dëshiron diçka më të mirë se kjo?"* Ajo u përgjigj: "Po!" Tha: *"Unë do ta paguaj lirimin tënd dhe do të martohem me ty."* Ajo pranoi dhe ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u martua me të.[630]

4. I Dërguari e përhapte dashurinë për bukurinë dhe njihej për të. Ai sillej me të afërmit e tij me këtë shije të bukur. Kur thërriste nipin e tij Hasanin: *"A është këtu vogëlushi?"*[631] Fatimja e ndalte për ta rregulluar, e lante dhe i vinte një varëse zbukuruese prej rruazash dhe karafili, që ishte zbukurim për fëmijët.[632] Vëmendja e

[630] Ebu Davudi, 3931.
[631] Buhariu, 2122. Muslimi, 2421. *"El Nihajetu"*, 4/268.
[632] *"Fet'hu el Bari"*, 4/342.

saj ndaj pastërtisë dhe bukurisë së djalit të saj ishte sepse njihte shijen dhe dashurinë e babait të saj *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për bukurinë.

5. Ashtu siç përzgjidhte bukurinë në pamje, ai përzgjidhte edhe bukurinë në tingull. I kishte thënë Abdullah bin Zejdit kur kishte parë në ëndërr fjalët e ezanit: *"Mësoja Bilalit, sepse zëri i tij është më i butë se i yti."*[633] Kur dëgjoi leximin e Kuranit nga Ebu Musa El-Esh'ari, u mahnit dhe i tha: *"Ti ke marrë një zë të ëmbël si i familjes së Davudit."*[634] Pra, pamja ka bukurinë e saj në hijeshi dhe ndriçim, ndërsa zëri në tingull dhe emocion.

6. I Dërguari vlerësonte dashurinë e njerëzve për bukurinë dhe bashkëndjente me ta. Një ditë tha para shokëve të tij: *"Në Xhenet nuk hyn kush ka në zemër sado pak mendjemadhësi."* Njëri prej tyre, që ishte në mexhlis dhe ishte elegant dhe i bukur, tha: "O i Dërguar i Allahut, Allahu më ka dhënë nga bukuria atë që po sheh dhe më pëlqen që rrobat dhe këpucët e mia të jenë të bukura. A është kjo mendjemadhësi?"

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Jo! Kjo nuk është mendjemadhësi. Allahu është i Bukur dhe e do bukurinë. Mendjemadhësi është të mohosh të vërtetën dhe të përçmosh njerëzit."*[635] Pra, e qetësoi këtë njeri se dashuria e tij për bukurinë është përputhje me atë që do Allahu.

7. Pejgamberi i njihte prirjet natyrore për bukuri dhe bashkëndjente me gëzimin e të tjerëve. Kur ndau disa rroba për gratë e shokëve të tij, mbajti një copë, rrobë shumëngjyrëshe me vija të verdha dhe tha: *"Ma thirrni Umu Halidin."* Këtu, ai i drejtohet ndjenjave të dashurisë për bukurinë që është element i përbashkët për të vegjlit e të mëdhenjtë, burrat e gratë.

8. Ashtu siç e donte bukurinë për vete, e donte edhe për shokët e tij. I kështillonte që të kujdeseshin për pamjen. Xhabiri transmeton: "I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*

[633] Ebu Davudi, 499.
[634] Buhariu, 5048. Muslimi, 793.
[635] Muslimi, 91.

erdhi për vizitë në shtëpinë tonë dhe pa një burrë të pakrehur. Tha: "A nuk ka ky njeri ndonjë gjë me të cilën të rregullojë flokët e tij?"[636] Pa një tjetër me rroba të pista dhe tha: "A nuk ka ky njeri ujë që të pastrojë rrobat e tij?"[637] Kur ia sollën Ebu Kuhafën, babain plak të Ebu Bekrit, me flokë dhe mjekër të zbardhura si lulja e thumit[638], Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Ndryshojani ngjyrën me diçka."*[639] Këto këshilla për rregullimin e flokëve, pastërtinë e rrobave dhe ndryshimin e thinjave ishin edukatë për t'u kujdesur për bukurinë e pamjes së jashtme.

Prandaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, përveçse ishte i bukur dhe i rregullt, e ngriti ndjenjën për bukurinë te të tjerët. Ai i dha bukurisë vlerën dhe rëndësinë e saj dhe e vlerësoi këtë prirje njerëzore që kërkon bukurinë. Kështu, ata që e rrethonin u ndikuan nga bukuria e tij, nga kujdesi i tij për pamjen dhe nga dashuria e tij për bukurinë dhe dashuria për bukurinë u bë pjesë e ndjenjës së përgjithshme.

Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë që i ktheu njerëzimit bukurinë dhe përsosmërinë e tij!

I Dërguari dhe ndjeshmëria në sjellje

Ndjeshmëria është përkryerje në personalitet, lartësi në sjellje dhe hijeshi në marrëdhënie. Ajo kuptohet mirë nga ata që kanë ndjeshmëri të hollë dhe shpirt të pastër, ndërsa tek ata me natyrë të ashpër dhe të vrazhdë, kjo hijeshi mungon.

Kur vështrojmë ndjeshmërinë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, shohim një nivel të lartë përkushtimi dhe shkëlqimi të admirueshëm, përmes të cilit Ai edukoi Umetin mbi përsosmëri të mahnitshme në sjellje, etik dhe marrëdhënie.

[636] Ebu Davudi, 4062.
[637] Ebu Davudi, 4062.
[638] Një lule e bardhë. Shiko: *"El Nihajetu"*, 1/214.
[639] Muslimi, 2102.

1. Ndjeshmëria e plotë në personalitet, sjellje dhe marrëdhënie: Kjo ndjeshmëri e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shfaqej në kujdesin për pastërtinë. Ai ishte i pastër dhe i këndshëm në trupin, veshjen dhe paraqitjen e tij. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte kujdes të veçantë për veshjen në raste të veçanta, si xhumaja, Bajrami dhe pritja e delegacioneve, ku vishej me rroba që përshtateshin me madhështinë e ngjarjes dhe tregonin respekt ndaj të pranishmëve.

2. Kujdesi për aromën e mirë: I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e donte erën e mirë dhe kujdesej për trupin e tij me parfum. Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Nuk kam prekur as mëndafsh e as kadife më të butë se dora e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe nuk kam nuhatur ndonjëherë erë më të këndshme se ajo e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."*[640]

3. Kujdesi për erën e gojës: Kur hynte në shtëpinë e vet, fillonte me misvak, sepse njeriu kur hyn në shtëpi do t'i afrohet familjes, t'i përqafojë ata, prandaj pastronte gojën për këtë takim. Edhe kur zgjohej nga gjumi, e përdorte misvakun për të larguar ndonjë erë të padëshirueshme. Ai shmangte ushqimet me erë të fortë si hudhra dhe qepa.

4. Zgjedhja e fjalëve më të hijshme në të folur: Prandaj, në gjithë fjalët e shumta të transmetuara nga i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, nuk gjejmë kurrë një shprehje të ulët apo fjalë të pahijshme. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ishte as fyes e as përdorues i fjalëve të ndyra.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shmangte të fliste hapur për çështje të ndjeshme apo që mund të vënë dikë në siklet, por përdorte aluzione dhe fjalë të tërthorta për t'u shprehur. Njëherë erdhi një grua tek ai dhe e pyeti rreth pastrimit pas menstruacioneve. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu përgjigj: "*Secila prej jush le të merr ujin dhe sidrin* (erë të mirë)*, të pastrohet mirë me të, më pas të hedh ujë mbi kokën e saj, të fërkojë mirë*

[640] Buhariu, 3561. Muslimi, 2320.

derisa uji të arrijë rrënjët e flokëve, pastaj të hedh ujë mbi tërë trupin. Pastaj le të marrë një copë pambuk të parfumuar[641] *me misk dhe pastrohet me të."*

Gruaja pyeti përsëri: "Po si të pastrohem me të, o i Dërguari i Allahut?" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Pastrohu me të."* Ajo përsëriti pyetjen: "Si?" Atëherë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Subhanallah! Pastrohu!"*

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndjeu turp dhe e ktheu fytyrën mënjanë, e kuptova se çfarë dëshironte i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, prandaj e tërhoqa gruan pranë vetes dhe i thashë: "Përdore copën e parfumuar për të ndjekur gjurmët e gjakut."[642]

Pra, shiko se si Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përdori një mënyrë jashtëzakonisht të butë dhe të ndjeshme për të komunikuar një temë të ndjeshme për një grua dhe se si ai u tërhoq me turp dhe ia ktheu fytyrën për shkak të ndjeshmërisë së çështjes.

5. Përshkrimi me fjalë të bukura:

a) Një rast i tillë është kur Xherir ibn Abdullah el Bexheli hyri në xhami dhe njerëzit u kthyen nga ai për ta parë. Atëherë, ai i tha një njeriu pranë tij: "A më ka përmendur mua i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*?" Ai i tha: "Po!" Xheriri e pyeti: "Çfarë ka thënë?" Ai i tha se ka thënë: *"Nga kjo derë do të hyjë tek ju një burrë nga më të mirët e Jemenit, që fytyra e tij ka hijeshi engjëllore."*[643]

Çfarë bukurie dhe elegance ka ky përshkrim i mrekullueshëm! Mund ta imagjinojmë se çfarë ndjenjash ka përjetuar Xheriri kur dëgjoi këto fjalë të të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të!

b) Kur Ikrima ibn Ebu Xhehli erdhi tek i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pasi ishte arratisur drejt detit (kur muslimanët po vinin për çlirimin e Mekës), i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e priti duke i thënë: *"Mirë se vjen Muhaxhiri Kalorës!"*[644]

---

[641] *"El Nihajetu"*, 3/431.
[642] Buhariu, 314. Muslimi, 332.
[643] Ahmedi, 19180. Nesaiu, 8244.
[644] Tirmidhiu, 2735.

Shiko çfarë elegance dhe ndjeshmërie ka në këto fjalë me të cilat përshkroi kthimin e Ikrimes nga arratisja! E quajti "*Muhaxhir*" - një fjalë që shpreh mirëseardhje dhe nder, pa qortim e pa vërejtje, pasi ai vërtetë e la rrugën që kishte zgjedhur dhe bëri *Hixhret* për tek Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Kjo ishte mënyra e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për ta përqafuar atë me respekt dhe dashamirësi, pa e rënduar për të kaluarën.

6. Ndryshimi i emrave të shëmtuar: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndryshoi emrin e një gruaje që quhej *Asija (e pabindur)* në *Xhemile (e bukur)*[645]. Kjo tregon për përkushtimin e tij për pastrimin e gjuhës së komunikimit dhe ngritjen e ndjeshmërisë estetike.

7. Kujdesi për ndjenjat dhe natyrat e ndryshme të njerëzve: Kur Uthman ibn Affani kërkoi leje të hyjë, i Dërguari - ndonëse ishte i shtrirë dhe veshur me rrobat e Aishes - u ngrit, u rregullua dhe i tha Aishes: "Mbuloju mirë." Ai shpjegoi: "*Uthmani është njeri shumë i ndrojtur dhe kam frikë që, nëse e lejoj kështu, të mos mund të shprehë nevojën e tij.*" Ai tha: "*A të mos turpërohem nga ai prej të cilit edhe melekët ndihen në turp?*"

Nga shprehjet e mirësjelljes dhe delikatesës së lartë në sjellje të të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte edhe respektimi i ndjenjave dhe emocioneve të njerëzve, në përputhje me karakterin e secilit. Kurse për njerëzit e turpshëm ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregonte edhe më shumë ndrojtje dhe përkujdesje, që të mos ndiheshin në siklet apo të mos u vinte zor.

Për shembull, kur Ebu Bekri kërkoi leje për të hyrë tek i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte shtrirë në shtratin e tij dhe ishte mbuluar me një rrobë leshi të Aishes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* dhe e lejoi të hynte ashtu siç ishte. Po kështu, qëndroi edhe kur kërkoi leje Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Mirëpo, kur kërkoi leje për të hyrë Uthmani *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* siç ishte shtrirë, u ndreq dhe mori rrobat e tij, e pastaj i tha Aishes: "*Mblidhi rrobat e tua.*" E kur ajo e

[645] Muslimi, 2139.

pyeti përse veproi kështu, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Uthmani është njeri shumë i turpshëm dhe unë kam frikë që, nëse do i lejoj të hyjë në atë gjendje, ai do të largohet pa e treguar nevojën për të cilën ka ardhur."*[646]

E gjitha kjo dëshmon për ndjeshmërinë dhe respektin e jashtëzakonshëm që i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregonte për turpin dhe ndjeshmërinë e Uthmanit *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, ndaj edhe ka thënë për të: *"A të mos ndjej turp nga një burrë, prej të cilit edhe engjëjt ndjejnë turp?"*[647]

8. Edukimi mbi ndjeshmërinë në sjellje:

Ashtu siç i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* sillej me këtë ndjeshmëri dhe delikatesë të lartë, gjithashtu, ai edukonte njerëzit që të kenë kujdes për mirësjelljen dhe ndjeshmërinë në sjellje dhe marrëdhënie me të tjerët.

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri tek ata në xhaminë e tyre dhe në dorë mbante një degë palme[648]. Ai pa një pështymë në drejtim të kibles në xhami, u zemërua dhe qortoi këtë veprim, pastaj e fshiu me degën që kishte në dorë. Më pas tha: *"Na sillni pak erë të mirë* (aromë të këndshme)*!"* Doli një djalë nga lagjja me nxitim për te familja e tij dhe u kthye me parfum në pëllëmbët e duarve. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e mori atë, e vendosi mbi majën e degës dhe e vendosi mbi vendin ku kishte qenë pështyma.[649]

Ky është edukimi i shoqërisë mbi ndjeshmërinë dhe estetikën e sjelljes dhe mbi largimin e gjërave që shëmtojnë bukurinë e jetës. Prandaj, ai vetë e pastroi pështymën dhe vendosi aromë të mirë në vend të saj, sikur donte të fshinte çdo gjurmë dhe kujtim të saj.

Nga kujdesi i tij për ndjeshmërinë dhe hijeshinë e sjelljes është edhe ndalimi i gromësimës nëpër mbledhje. Ai thoshte atij që gromësinte: *"Ndaloje gromësimën tënde mes nesh!"*[650] Gjithashtu, porosiste mbylljen e gojës (mbulimin e saj) kur hapet goja (për shkak të

[646] Muslimi, 2402.
[647] Muslimi, 2401.
[648] *"El Nihajetu"*, 3/203.
[649] Muslimi, 3008.
[650] Tirmidhiu, 2646. *"Lisanu el Arab"*, 1/48.

lodhjes apo gjumit) dhe thoshte: "*Le ta mbajë gojën të mbyllur aq sa të mundet!*"[651] Po ashtu, mbulimin e fytyrës gjatë teshtitjes,[652] që të mos shpërndahet pështyma mbi të tjerët përreth dhe ndalonte fryrjen[653] në enë gjatë pirjes nga to, sepse enët ishin të përbashkëta dhe fryrja në to i bëhej e neveritshme të tjerëve.

Nga edukata e ndjeshme që ai mësonte ishte edhe urdhri për të pasur pamje të hijshme nëpër tubime publike, përfshirë ditën e xhuma. Prandaj, ai urdhëroi të lahet për xhuma dhe të vendosë pak parfum, që ta ndjekë faljen e xhumasë me trup dhe rroba të pastra dhe me aromë të mirë. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Kush lahet ditën e xhuma, vendos nga parfumi i gruas së tij nëse nuk ka vetë, vesh rrobat më të mira, nuk kalon përmes njerëzve duke i shqetësuar dhe dëgjon e hesht gjatë hytbes, kjo xhuma do t'i jetë shlyerje për mëkatet ndërmjet saj dhe xhumasë tjetër. Por ai që flet ose kalon përmes njerëzve* (duke i shqetësuar)*, ai e ka humbur shpërblimin e saj.*"[654]

E gjithë kjo është edukim mbi ndjeshmëri të bukur në sjellje, për të cilën mjedisi arab i asaj kohe ishte mësuar ta anashkalojë, pasi mbi të rëndonte varfëria, thatësia dhe ashpërsia. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po e rindërtonte ndjeshmërinë publike që të kishte kujdes ndaj bukurisë së jetës, normave të sjelljes, edukatës dhe finesës në marrëdhënie, me këtë moral të lartë dhe ndjeshmëri fisnike.

I Dërguari dhe dhuratat

Dhurata është lajmëtari i dashurisë dhe çelësi i zemrës. Dhënia e dhuratave është nder për atë që i dhurohet dhe pranimi i saj është nder për atë që e ka dhuruar. Me dhurimin e dhuratave zhduken urrejtjet, forcohen lidhjet, qetësohen shpirtrat dhe hapen zemrat. Prandaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi*

[651] Muslimi, 2994.
[652] Tirmidhiu, 2745.
[653] Buhariu, 153. Muslimi, 267.
[654] Ebu Davudi, 347.

të) porosit për dhënien e dhuratave duke thënë: *"Dhuroni mes vete që të duheni mes vete."*[655] Ai ndaloi refuzimin e dhuratës, duke thënë: *"Përgjigjuni ftesës dhe mos e refuzoni dhuratën."*[656]

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte shije dhe sjellje të veçantë në lidhje me dhuratën, por edhe udhëzime për ne, ndër to:

1. Pranimi i dhuratës, edhe nëse ishte pak ose diçka e thjeshtë

Mund të ishte edhe një gotë qumësht ose një pogaçe elbi. Ai e pranonte dhuratën nga kushdo. Askush nuk ngurronte t'i dhuronte dhe ai nuk ndjehej i lartë për të mos e pranuar dhuratën e dikujt. Ai hëngri nga mishi që i ishte dhuruar shërbëtores së tij, Berires, nga një sadeka që ajo kishte marrë dhe tha: *"Ai është sadaka për të, por për ne është dhuratë."*[657]

Sa gëzim dhe lumturi mund të ketë ndjerë Berire, kur pa se vetë ajo po i dhuronte të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ai e pranoi, madje hëngri nga mishi që ajo i dhuroi, edhe pse asaj i ishte dhënë sadaka, madje ai tha: *"Ai është dhuratë për ne."*

2. Siç i pranonte dhuratat, edhe i shpërblente ato

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton: **"**I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pranonte dhuratën dhe e shpërblente atë."[658] Një beduin i dhuroi një deve dhe ai e shpërbleu me gjashtë deve të reja.[659] Pranimi dhe shpërblimi i dhuratës është një konfirmim i lidhjes dhe një respekt i ndërsjellë.

Ai i pranonte dhuratat nga muslimanë dhe jomuslimanë; pranoi dhuratën e Mukavkisit (udhëheqës i koptëve) dhe të mbretit të Eilës.

---

[655] Tirmidhiu, 2130.
[656] Ahmedi, 3838.
[657] Buhariu, 1493. Muslimi, 1074.
[658] Buhariu, 2585.
[659] Tirmidhiu, 3945.

3. Siç pranonte dhurata nga jomuslimanët, edhe u dhuronte atyre

Këtë e kuptuan edhe sahabët, të cilët dhuronin edhe me idhujtarët. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i dha një rrobe të shtrenjtë mëndafshi Umerit dhe ky ia dhuroi një vëllai të tij në Mekë, i cili ishte idhujtar.

Kjo rrobë mëndafshi ishte e çmuar dhe përfaqësonte ndërlidhjen njerëzore që ruan gjallërinë e marrëdhënieve. Kjo përputhet me fjalën e Allahut: ***"Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët."*** (El-Mumtehine: 8)

Sjellja me ta me mirësi dhe moral të lartë ishte pjesë e udhëzimit profetik, duke përfshirë dhuratat për ta dhe pranimin e dhuratave të tyre.

4. Nga edukata e tij në lidhje me dhuratën ishte edhe vlerësimi i saj dhe shfaqja e gëzimit për të

Një grua i dhuroi një mantel dhe i tha e kam qepur vetëm për ty me duart e mia. Ai e veshi atë dhe doli me të veshur para shokëve të tij.[660] Pa dyshim, ajo grua u gëzua kur e pa të veshur dhuratën e saj.

5. Nëse ndodhte ta kthente një dhuratë për ndonjë arsye, ai e shpjegonte shkakun dhe qetësonte dhuruesin

Kur ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zbriti në Ebva gjatë udhëtimit për *Haxhin e Lamtumirës*, Sahabiu Ibn Xhethama *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* i dhuroi mish gjahu. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ktheu atë, por kur pa trishtimin në fytyrën e tij, i tha me butësi: *"Nuk ta kthyem atë nga mospëlqimi, por sepse jemi në ihram* (jemi nisur për Haxh) *dhe nuk mund të hamë mish gjahu."*[661]

[660] Buhariu, 1277.
[661] Buhariu, 1825. Muslimi, 1193.

Një skenë e lartë e ndjeshmërisë dhe butësisë: ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e lexoi gjendjen shpirtërore të dhuruesit dhe nxitimthi e qetësoi duke shpjeguar shkakun.

6. Dhuratat e tij ishin të bollshme, fisnike dhe të ndara me zemërgjerësi

Me këtë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dëshironte të fisnikëronte shokët, të afronte zemrat dhe të zbuste shpirtrat. Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* i dërgoi një copë ari nga Jemeni dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndau atë mes katër krerëve të Arabisë: Ekrea bin Habis el Handhali, Ujejne bin Bedr el Fezari, Alkame bin Alathe el Amiri dhe Zejd el Khajr el Taij. Kur disa nga kurejshët dhe ensarët u mërzitën, ai tha: "*Unë veprova kështu për t'i afruar zemrat e tyre.*"[662]

7. Ashtu siç pranonte dhurata të vogla, edhe ai vetë i dhuronte ato.

Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Iu dhurua të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* një sasi hurmash dhe ai filloi t'i shpërndante këtu e atje."[663]

Edhe nëse dhurata është e vogël, ajo mbetet një mesazh dashurie dhe ngushëllimi, sidomos kur vjen në moment të duhur.

Nga ato raste është edhe ajo që ka transmetuar Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*: Hebrenjtë, kur gratë e tyre ishin me menstruacione, nuk hanin me to dhe nuk rrinin bashkë me to në shtëpi. Shokët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyetën për këtë çështje dhe atëherë Allahu zbriti: "***Të pyesin ty*** (Muhamed) ***për të përmuajshmet e femrave. Thuaju: "Ajo është gjendje e dëmshme." Prandaj, gjatë kësaj kohe, mos iu afroni atyre*** (për marrëdhënie) ***derisa të pastrohen. Pasi të pastrohen, atëherë afrohuni tek ato ashtu si ju ka urdhëruar Allahu. Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort*** (për gjynahet) ***dhe ata që pastrohen.***" (El-Bekare: 222)

[662] Buhariu, 3344. Muslimi, 1064.
[663] Darimiu, 651.

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Bëni me to çdo gjë, përveç marrëdhënieve intime."* Kur hebrenjtë e dëgjuan këtë, thanë: "Ky njeri nuk do të lërë asnjë çështje tonën pa u kundërvënë në të!"

Pastaj erdhën Usejd bin Hudajri dhe Ubade bin Bishr dhe i thanë Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "O i Dërguari i Allahut! Hebrenjtë po thonë kështu e ashtu. Si thua, a të mos rrimë me gratë?!" Atëherë, të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i ndryshoi fytyra (u zbeh prej pakënaqësisë), derisa ne menduam se ishte zemëruar me ta. Ata dolën jashtë dhe duke dalë panë[664] që dikush po hynte për t'i sjellë ca qumësht dhuratë Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dërgoi dikë pas tyre dhe u dha që të pinin prej qumështit. Atëherë, ata e kuptuan se Pejgamberi nuk ishte zemëruar me ta."[665]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me atë dhuratë të thjeshtë e largoi dyshimin e zemërimit apo pakënaqësisë që shokët e tij menduan se ai ndiente ndaj Usejdit dhe Ubades. Me siguri gëzimi i tyre për dhuratën e tij dhe lumturia për ftesën e tij ndaj tyre ishte e madhe, sepse ajo ishte një mesazh dashurie e posaçme dhe një shenjë e pastërtisë së zemrës së tij ndaj tyre.

Sjellja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj dhuratës - si në pranimin e saj, ashtu edhe në dhurimin e saj - ishte prej shenjave të edukatës së tij të mirë dhe moralit të tij të lartë. O Allah, sa shumë gëzim, hare dhe lumturi kanë ndier ata njerëz fisnikë që i dhuruan Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe u lumturuan me pranimin dhe vlerësimin që ai u bëri dhuratave të tyre!

Sa të lumtur ishin ata që morën dhurata nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndien gëzimin e përzgjedhjes së tij për ta. Sikur dhuratat që jepeshin prej tij dhe atij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të ishin zogj dashurie që fluturonin midis zemrave të tyre dhe zemrës së tij të madhe e bujare.

---

[664] El Adhijm Abadi, "*Avnu el Meabud"*, 1/107.
[665] Muslimi, 302.

I Dërguari dhe kujdesi për ndjenjat

Kur i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri në Mekë vitin e çlirimit me ushtrinë e tij, flamuri i ensarëve ishte në duart e Sead bin Ubades, udhëheqës i fisit Hazrexh. Ai kaloi pranë Ebu Sufjanit, prijës i kurejshëve dhe i tha: "Sot është dita e gjakderdhjes, sot lejohet gjaku në Qabe!"

Ebu Sufjani u trondit dhe shkoi menjëherë te i Dërguari për t'u ankuar për atë që tha Seadi. I Dërguari tha: "*Jo! Sot është ditë kur madhërohet Qabja!*" Më pas ia mori flamurin Seadit dhe ia dha të birit të tij, Kajs bin Sead.[666]

Me këtë veprim, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori parasysh ndjenjat e kurejshëve dhe udhëheqësit të tyre, Ebu Sufjanit, duke mos e pranuar fjalën fyese të Seadit dhe duke ia hequr flamurin, por pa lënduar ensarët dhe udhëheqësin e tyre, Seadin, sepse ia dha të birit të tij, gjë që do të thoshte se nderi nuk kishte dalë nga familja e tij.

Është sikur ta shohim këtë skenë: Ebu Sufjani ndjen se fjala e tij u mor parasysh dhe se nderi i kurejshëve u ruajt, ndërsa Sead bin Ubades i mbetet krenaria për nderimin që i bëri i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* djalit të tij dhe nuk ndjen se iu mor flamuri. Sepse njeriu natyrshëm nuk dëshiron që dikush të jetë më i mirë se ai, përveç djalit të tij.

Kështu, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zgjidhi me zgjuarsi një moment tensioni, parandaloi një përplasje të mundshme midis ensarëve dhe kurejshëve, ruajti ndjenjat dhe pozitën e të gjithëve - një mjeshtëri e rrallë në ruajtjen e ndjenjave.

E njëjta vërehet edhe kur Halid bin Velidi u kthye me ushtrinë nga beteja e Mu'tes dhe disa thanë: "*Ia mbathët, o frikacakë!*" Por i Dërguari tha: "*Jo, ata nuk ia mbathën, por manovruan për të sulmuar, në dashtë Allahu!*"[667]

---

[666] Buhariu, 4280.

[667] "*Siretu Ibn Hisham*", 4/24.

Me këtë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ruajti moralin e tyre, qetësoi ndjenjat dhe hapi horizontin e shpresës për një përballje tjetër dhe për një fitore të premtuar.

Kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u nis nga Meka pas Umres së kompensimit (Umretul-Kada), e ndoqi duke vrapuar vajza e xhaxhait të tij, vajza e Hamzës, e cila ishte vajzë e vogël dhe thërriste: "O xhaxha, o xhaxha!" Aliu e mori për dore dhe i tha Fatimes: "Merre vajzën e xhaxhait tënd!"

Aliu, Xha'feri dhe Zejdi u grindën mes tyre sepse secili donte ta merrte për t'u kujdesur për të:

Aliu tha: "Unë e kam më shumë të drejtë, ajo është vajza e xhaxhait tim."

Xha'feri tha: "Ajo është vajza e xhaxhait tim dhe tezja e saj është gruaja ime."

Zejdi tha: "Ajo është vajza e vëllait tim."

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vendosi që ajo të qëndrojë me tezen e saj (Esma, gruaja e Xha'ferit) dhe tha: *"Tezja është si nëna!"*

Pastaj u shpërndau të gjithëve fjalë nderimi:

Aliut i tha: "Ti je prej meje dhe unë prej teje."

Xhaferit i tha: "Ti i ngjan pamjes dhe sjelljes sime."

Zejdit i tha: "Ti je vëllai ynë dhe çlirëtari ynë."[668]

Shihni këtë mjeshtëri në ruajtjen e ndjenjave: veproi zgjidhjen më të drejtë dhe, në të njëjtën kohë, nderoi të tre që askush të mos ndihej më pak i rëndësishëm.

Dhe, nëse prej tij dilte ndonjë veprim që mund të kuptohej si shenjë pakënaqësie apo qortimi, ai nuk e linte shokun e vet të mbetej në mëdyshje apo nën hijen e zemërimit dhe qortimit. Përkundrazi, shumë shpejt e pasonte atë me diçka që e sqaronte keqkuptimin dhe ia rikthente ndjenjën e vlerës dhe dashurisë në shpirt.

Në betejën e Hunejnit, një burrë shkeli pa dashje me këpucën e tij të rëndë në këmbën e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* reagoi

[668] Buhariu, 2699.

menjëherë dhe e goditi lehtë me një shkop që kishte në dorë dhe tha: *"Bismilah, më lëndove!"*

Ky njeri ndjeu brengë dhe tha: "E lëndova të Dërguarin e Allahut! *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."* Nuk fjeti atë natë, i rënduar nga turpi duke qortuar veten.

Në mëngjes, një njeri e thërret dhe i thotë se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po të kërkon. U frikësua për atë që kishte ndodhur dhe gjithë frikë shkoi. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Ti më shkele dje dhe më dhembi dhe unë të godita me shkop. Ja ku ke tetëdhjetë dele - merri në këmbim!"*[669]

Shihni këtë butësi dhe kujdes për ndjenjat. Edhe pse ishte një reagim i natyrshëm ndaj dhimbjes, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk deshi që ky njeri të mbetej me ndjenjën e fajit dhe turpit, por u kujdes që të ndjehej i nderuar dhe i falur.

Nga kujdesi i tij i jashtëzakonshëm për ndjenjat, kur i arrinte diçka që nuk i pëlqente nga dikush, nuk thoshte: "Pse filani thotë kështu?" Por thoshte: *"Pse disa njerëz thonë kështu e kështu?"*[670]

Nuk ia thoshte askujt në sy atë që e mërziste, por shprehja e fytyrës së tij e tregonte pakënaqësinë. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu më i lumtur me kujdesin dhe respektin për ndjenjat e tyre. Ishte më i miri i njerëzve për njerëzit dhe më i miri për familjen e tij.

Kujdesi i tij për ndjenjat e bashkëshorteve të tij ishte plot ndjesi dhe butësi. Në një rast, Umu Seleme rrëfen se ishte në shtrat me të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i erdhën menstruacionet. Ajo u ngrit me kujdes, veshi rrobat e menstruacioneve dhe u kthye. Ai e pyeti: *"Ç'të ndodhi?* A të erdhën ato?" - "Po!" - tha ajo. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e afroi pranë vetes dhe e mbuloi me jorgan.[671]

Ajo kishte tetë ditë duke pritur burrin e saj dhe, kur më në fund ishte me të, ndodhi një gjë që mund ta lëndonte shpirtërisht, por i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e la me atë ndjenjë dhe e afroi me ngrohtësi, me kujdes dhe dashuri.

---

669 "*Sunen el Daimij*", 73.

670 Muslimi, 1401.

671 Buhariu, 298. Muslimi, 296.

Në Haxhin e Lamtumirës, kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po përgatitej për largim nga Meka dhe do bënte Tavafin e lamtumirës, Aishja i tha: "O i Dërguari i Allahut, njerëzit po kthehen me Haxh dhe Umre, kurse unë vetëm me Haxh?" Ajo kishte qenë me menstruacione dhe s'mund të bënte Umre më parë si gratë e tjera.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Mjafton Tavafi yt për Haxhin dhe Umren."* Por ajo nuk u qetësua dhe tha: "Ata kthehen me dy shpërblime, unë vetëm me një?"

Atëherë, edhe pse i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kishte sqaruar dhe ajo e dinte përgjigjen fetare, ai e kuptoi ndjenjën e saj dhe tha: *"Në rregull bëje edhe ti atë që bënë njerëzit"* Ajo tha: "Unë nuk ndihem mirë, sepse nuk kam bërë Tavaf rreth Shtëpisë (Qabes) derisa kreva Haxhin."

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeri i butë dhe i lehtë në sjellje, kur ajo dëshironte diçka, ai e përkrahte në atë që dëshironte.

Atëherë, ai thirri vëllain e saj, Abdurrahmanin, dhe i tha:

"Ti ke (nga Allahu) *shpërblimin e njëjtë sikur atyre që kanë marrë pjesë në Haxh."*

"Shko me motrën tënde në Ten'im. Atje le të fillojë nisjen për Umre, sepse është Umre e pranuar! Pastaj bëni Tavafin! Unë do t'ju pres këtu."[672]

Shikoje këtë kujdes dhe ndjeshmëri ndaj ndjenjave të gruas së tij, Aishes, dhe përfytyroje skenën: pas një udhëtimi të lodhshëm dhe në momentin e përgatitjes për t'u nisur, ajo i thotë: "Njerëzit po kthehen me Haxh dhe Umre, kurse unë vetëm me Haxh?" dhe kërkon të kryejë një Umre të veçuar.

Edhe pse ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia kishte sqaruar asaj dhe kishte dhënë përgjigjen - duke qenë ai që e përcillte fenë e Allahut - shpirti i saj nuk ishte qetësuar dhe kishte ende dëshirë për të kryer Umren.

Prandaj ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përkrahu në atë që dëshironte, derisa shpirti i saj të qetësohej dhe të mos ndjente se të tjerët arritën diçka që ajo nuk e kishte arritur.

[672] Buhariu, 1788. Muslimi, 1211.

Dhe priti derisa ajo të përfundonte Umren.

Ashtu siç ishte i shkëlqyer *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në kujdesin ndaj ndjenjave, po ashtu ai e ndalonte lëndimin dhe plagosjen e tyre.

Ndër shembujt e kësaj është ndalimi që dy veta të bisedojnë në fshehtësi duke përjashtuar të tretin, sepse kjo lëndon ndjenjat e tij.

Nga Ibn Mesudi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "Kur të jeni tre veta, të mos bisedojnë dy prej tyre fshehurazi pa e përfshirë edhe tjetrin, sepse kjo e trishton atë."[673]

Po ashtu, prej kësaj është ndalimi i përçmimit apo nënvlerësimit të tjetrit, siç ka thënë i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "*Muslimani është vëllai i muslimanit; ai nuk i bën padrejtësi, nuk e braktis dhe nuk e përçmon atë. Devotshmëria është këtu* - dhe tregoi nga kraharori i tij tri herë. *Mjafton si mëkat që një njeri ta përçmojë vëllain e tij musliman. Muslimani është i shenjtë për muslimanin: gjaku i tij, pasuria e tij dhe nderi i tij.*"[674]

I Dërguari dhe çelësat e zemrave

Një nga shfaqjet e madhështisë së moralit profetik ishte aftësia për të përfshirë zemrat, mjeshtëria në lumturimin e atyre që ishin rreth tij dhe dashuria për ta derisa dashuria e tij mbushte thellësitë e shpirtit të tyre. Ai kishte mënyra të njohura për hapjen e dyerve të zemrave dhe për të mbjellë dashurinë në to. Nga këto janë:

Së pari: Buzëqeshja

Buzëqeshja e fytyrës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte e qetë, e ndritshme, me një buzëqeshje të ëmbël dhe të kënaqur. Ai buzëqeshte në fytyrën e çdo personi që takonte, në atë mënyrë që secili që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut*

[673] Buhariu, 6290. Muslimi, 2484.
[674] Muslimi, 2564.

qofshin mbi të) buzëqeshte ndaj tij të ndjente sikur ishte një buzëqeshje e veçantë dhe e ruajtur për të.

Xherir ibn Abdullah el Bexheli thotë: "Që kur u bëra musliman, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk më privoi kurrë nga takimi me të dhe nuk ndodhi kurrë që të më takonte pa më buzëqeshur."[675] Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* buzëqeshte ndaj çdo njeriu që takonte, por Xheriri ndjeu se kjo buzëqeshje ishte një mesazh i veçantë vetëm për të.

Kur Halid bin Velidi erdhi dhe deklaroi Islamin, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Falënderimi i qoftë Allahut që të udhëzoi. Unë e shihja tek ti mençurinë dhe shpresoja se ajo do të çonte vetëm drejt së mirës."*[676] Halidi i tha: "O i Dërguar i Allahut, ti ke parë se unë isha dëshmitarë i luftës kundër teje në shumë beteja duke kundërshtuar të vërtetën, lutju Allahut që të më falë!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Hyrja në Islam i fshin mëkatet e mëparshme."* Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lut: *"O Allah, fale Halid Bin Velidin për çdo gjë që ka bërë në luftë kundër fesë Tënde!"*[677]

Buzëqeshja profetike ishte çelësi që hapte dyert e zemrave. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* na mësoi se buzëqeshja është mirësjellje dhe bamirësi: *"Mos e nënvlerëso asnjë të mirë, qoftë edhe ta takosh vëllain tënd me fytyrë të qeshur."*[678]

Fjala *"me fytyrë të qeshur"* do të thotë se e gjithë fytyra qesh, ajo nuk është vetëm buzëqeshje e burgosur në buzë, por një shkëlqim që ndriçon gjithë fytyrën.

Së dyti: Vlerësimi

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e bënte secilin të ndiente vlerën, rëndësinë dhe vendin e tij, aq sa çdo kush mendonte se ishte më i dashuri për të *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nga të gjithë ata që e rrethonin.

---

[675] Buhariu, 3035. Muslimi, 2475.
[676] Bejhakiu, *"Delailu el Nubuveti"*, 4/351.
[677] *"Delailu el Nubuveti"*, 4/351.
[678] Muslimi, 2626.

Kur u bë musliman Amr ibn el Asi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, ai ndjeu rëndësinë e tij tek i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i dërgonte mesazhe dhe sinjale që i jepnin ndjesinë e veçantë dhe të rëndësishme, saqë Amri mendoi se ai ishte njeriu më i dashur për të *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, edhe pse ishte bërë musliman në vitin e shtatë të *Hixhretit*, pas njëzet vitesh nga shpallja e misionit profetik.

Për këtë arsye, ai e pyeti Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "O i Dërguar i Allahut, kush është njeriu më i dashur për ty?" Ai e bëri këtë pyetje duke menduar se Pejgamberi e do t'i përgjigjej menjëherë: "Ti!", për shkak të shenjave të shumta të rëndësisë që kishte marrë. Por përgjigjja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi menjëherë: "*Aishja!*" Amri tha: "*Po nga burrat?*" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Babai i saj* (Ebu Bekri)*!*" Amri pyeti: "*Pastaj kush?*" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Umeri!*"[679]

Çfarë e shtyu Amr ibn el Asin të bëjë këtë pyetje? Ishte ndjesia e rëndësisë që i kishte dhënë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, aq sa mendonte se ishte më i dashuri i tij.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte mënyra të ndryshme për të përcjellë ndjesinë e rëndësisë. Një shembull tjetër është rasti i Ka'b ibn Malik, kur ai shkoi tek i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bashkë me fisin e tij për të dhënë besën e Akabes. Ai ishte i ri, rreth të njëzetave. Ishte xhaxhai i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, Abasi ibn Abdulmutalib, ai që e prezantonte secilin tek Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "*Ky është filani, ky është filani...*" Kur arriti tek Ka'bi, tha: "Ky është Ka'b ibn Malik." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pyeti: "*Poeti?*"

Fjala "poeti" që tha Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte një mesazh: *Kam dëgjuar për të, kam dëgjuar poezinë e tij*. Dhe kjo fjalë mbeti në mendjen e Ka'bit gjatë gjithë jetës, aq sa,

[679] Buhariu, 3662.

kur u bë plak, ai thoshte: "Nuk e harroj kurrë fjalën e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: *"Poeti?"*[680]

Së treti: Interesimi

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregonte kujdes për hallet dhe shqetësimet e shokëve të tij, duke bërë që çdo njeri të ndiente: Brengat e tua më interesojnë mua, angazhimet e tua më preokupojnë mua, çështjet e tua janë edhe të miat. Kjo mbart një mesazh të fuqishëm për kujdes, përkushtim dhe dashuri të veçantë.

Një shembull për këtë është rasti i Xhabir ibn Abdullah ibn Haramit *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)*, i cili kishte marrë pjesë në një betejë bashkë me të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Gjatë kthimit, deveja e Xhabirit u lodh, u ngadalësua dhe mbeti në fund të karvanit. Ushtria u largua dhe Xhabiri u shqetësua, saqë mendoi ta linte devenë dhe të ndiqte ushtrinë në këmbë. Ndërsa ishte duke marrë këtë vendim, papritmas dëgjoi një zë që vinte nga prapa: *"Xhabir!"* Ai u kthye dhe pa se ishte i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nganjëherë qëndronte pas karvanit për të ndihmuar ata që mbeteshin prapa ose kishin nevojë. Kishte me vete një shkop, me të cilin e preku lehtë devenë dhe ajo u ngrit menjëherë dhe filloi të ecte.

Pastaj i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti Xhabirin: *"A je martuar, o Xhabir?"* Ai tha: "Po, o i Dërguar i Allahut!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Me ndonjë beqare apo me ndonjë të ve?"* Ai tha: "Me një të ve." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "Pse nuk u martove me një beqare që të luante me ty dhe të luaje me të?" Xhabiri tha: "O i Dërguar i Allahut! Babai im ra dëshmor dhe la pas nëntë vajza dhe nuk më pëlqeu të martohesha me një vajzë të vogël si ato, prandaj desha të martohem me një grua me përvojë, që të mund të kujdeset për to."

[680] Ahmedi, 15798.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u mrekullua nga mençuria e tij dhe i tha: *"Mirë e ke bërë! Allahu të bekoftë!"*[681]

Vallë, si duhet të jetë ndier Xhabiri ndërsa ecte pranë Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ai e pyeste për gjërat më të ndjeshme e personale si martesa dhe gruaja e tij, dhe i tregonte kujdes për hallet e tij?

Nëse ti i bën njerëzit të ndiejnë se të shqetëson ajo që i shqetëson ata, atëherë zemrat e tyre do të të hapen.

Së katërti: Ndjeshmëria emocionale

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte ndjeshmëritë e tij emocionale që shokët e tij i kujtonin gjithë jetën, sikur ende ndjenin ëmbëlsinë dhe kënaqësinë e tyre. Një shembull i kësaj është rasti i të riut që erdhi tek Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, më lejo të bëj zina!" Të pranishmit u kthyen nga ai, e qortuan dhe i thanë: "Mos! Mos!"

Por i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Afrohu!"*

Ai u afrua, derisa qëndroi aq pranë sa të ishte në shtrirjen e dorës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Pastaj Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti:

- *"A do ta doje këtë për nënën tënde?"*

Ai u përgjigj:

- "Jo, pasha Allahun! Allahu më bëftë flijim për ty!"

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha:

- *"As njerëzit nuk e duan këtë për nënat e tyre."*

Pastaj e pyeti:

- *"A do ta doje këtë për vajzën tënde?"*

Ai u përgjigj:

- "Jo, pasha Allahun, o i Dërguari i Allahut! Allahu më bëftë flijim për ty!"

[681] Ahmedi, 15026.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha:
- *"As njerëzit nuk e duan këtë për vajzat e tyre."*
Pastaj e pyeti:
- *"A do ta doje këtë për motrën tënde?"*
Ai u përgjigj:
- "Jo, pasha Allahun! Allahu më bëftë flijim për ty!"
Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha:
- *"As njerëzit nuk e duan këtë për motrat e tyre."*
Pastaj e pyeti:
- *"A do ta doje këtë për hallën tënde?"*
Ai u përgjigj:
- "Jo, pasha Allahun! Allahu më bëftë flijim për ty!"
Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha:
- *"As njerëzit nuk e duan këtë për hallat e tyre."*
Pastaj e pyeti:
- *"A do ta doje këtë për tezen tënde?"*
Ai u përgjigj:
- "Jo, pasha Allahun! Allahu më bëftë flijim për ty!"
Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha:
- *"As njerëzit nuk e duan këtë për tezet e tyre."*

Pastaj i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zgjati dorën e tij të bekuar dhe të ndershme, ia vendosi atij të riu mbi kraharor, derisa ai ndjeu freskinë e dorës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbi zemrën e tij. Çfarë ndjenje do të kishte ai i ri, kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i vendosi dorën mbi gjoks dhe e afroi pranë vetes? Pastaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lut për të duke thënë:

- *"O Allah, falja mëkatin e tij, pastroja zemrën dhe ruaje nderin e tij!"*[682]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mund të ishte lutur për të edhe pa e vendosur dorën mbi kraharorin e tij, por kjo prekje e butë profetike pati ndikimin e saj: e bëri të ndiejë afërsi, dashuri të ngrohtë dhe dhembshuri nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe e bindi se pyetja e tij nuk e

[682] Ahmedi, 22211.

kishte larguar nga ai dhe nuk e kishte bërë të ndihej i huaj. Kjo prekje largoi nga zemra dhe kraharori i tij çdo mendim për amoralitet dhe pas kësaj ai kurrë nuk anoi drejt ndonjë gjëje të tillë.

Së pesti: Kujdesit për fëmijët

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i hapte kyçet e zemrave duke vlerësuar të rriturit përmes kujdesit ndaj të vegjëlve. Ai i bënte të rriturit të ndiheshin të dashur duke treguar dashuri për fëmijët e tyre.

Ibn Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Ishim me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në një udhëtim dhe unë isha mbi një deve të egër[683] të babait tim, Umerit. Deveja nuk më përgjigjej mua dhe dilte përpara karvanit. Umeri e trembte atë dhe e kthente pas, por ajo përsëri dilte përpara dhe Umeri e trembte dhe e kthente përsëri. Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha Umerit: *"Ma shit mua!"* Umeri tha: "Ajo është jotja, o i Dërguari i Allahut!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Ma shit mua!"* Dhe Umeri ia shiti të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Pastaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Ajo është jotja, o Abdullah, biri i Umerit. Bëj me të ç'të duash!"*[684]

Mund ta imagjinosh se si ndihej Umeri kur shihte butësinë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj të birit të tij, që ishte më e madhe se butësia e tij vetë si baba. Ai pa se sa shumë e donte Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* djalin e tij dhe sa vend kishte ai në zemrën dhe vëmendjen e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Së gjashti: Dhuratat

Ndër çelësat e zemrave ishin edhe dhuratat bujare që i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i jepte për të fituar zemrat dhe për t'i afruar edhe pasi ato ishin larguar.

---

683 *"Keshfu el Mushkil min Hadithi el Sahijhajni"*, 2/591.

684 Buhariu, 2115.

Safvan bin Umeje thotë: "Më dha i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në ditën e Hunejnit, kur ai ishte njeriu më i urryer për mua, e vazhdoi të më japë derisa u bë njeriu më i dashur për mua."[685]

Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se një burrë i kërkoi Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* një tufë delesh që ndodheshin mes dy maleve dhe ai ia dha. Ai shkoi tek fisi i tij dhe tha: "O populli im, bëhuni muslimanë, sepse, pasha Allahun, Muhamedi jep dhurata sikur nuk ka frikë nga varfëria!" Enesi shton: "Ndodhte që njeriu ta pranonte Islamin vetëm për të përfituar diçka materiale, por nuk vononte shumë dhe Islami bëhej më i dashur për të se bota dhe gjithçka që gjendet në të."[686]

Së shtati: Lavdërimi për meritat

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjithmonë lavdëronte meritat e njerëzve. Këtë e bënte natyrshëm për t'i gëzuar, për të konfirmuar vlerat e tyre dhe për të ngritur pozitën e tyre.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha dikujt: *"Ti ke dy cilësi që i do Allahu."* Ai pyeti: "Cilat janë ato?" Tha: *"Butësia dhe durimi."* Në një transmetim tjetër thuhet: *"Butësia dhe turpi."* Njeriu e pyeti: "O i Dërguar i Allahut, a jam unë që i kam fituar këto cilësi me përpjekje, apo Allahu më ka krijuar me to?" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Jo, Allahu të ka krijuar me to."* Ai tha: "Falënderimi i qoftë Allahut që më ka krijuar me dy cilësi që Ai i do!"[687]

Po ashtu, kur Halid ibn Velidi erdhi si musliman, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Falënderimi i qoftë Allahut që të udhëzoi. Unë e shihja tek ti mençurinë dhe shpresoja se ajo do të çonte vetëm drejt së mirës."*[688] Këto janë disa prej çelësave të zemrës dhe ka shumë të tjerë të përmendura në librat e Sunetit

[685] Tirmidhiu, 666.
[686] Muslimi, 2312.
[687] Muslimi, 17.
[688] Bejhakiu, "*Delailu el Nubuveti*", 4/351.

Profetik. Disa prej tyre gjenden edhe në librat e marrëdhënieve me publikun apo të artit të komunikimit me të tjerët. Mirëpo, kur ne zbatojmë këto metoda të Profetit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, e ndjejmë se po bëjmë një adhurim për hir të Allahut të Lartësuar, sepse besojmë se gëzimi që u japim të tjerëve është një afrim tek Allahu dhe se morali i mirë është gjëja që peshon më e rëndë se çdo gjë tjetër në peshoren e veprave të njeriut.

Kështu, përhapim këto ndjenja si akte adhurimi, jo vetëm si aftësi komunikimi, sepse gëzimi i zemrave është një shenjë e Islamit, një moral dhe udhëzim i të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Kapitulli i Pestë:

I Dërguari dhe gjendjet e jetës së tij

I Dërguari dhe begatitë

Sa më e madhe të jetë njohja e njeriut për Zotin e tij, aq më e madhe bëhet mirënjohja ndaj Tij, më e bukur bëhet pritja e begative dhe mirësive të Tij, dhe për çdo begati e ndien thellë fjalën: "***Çdo mirësi që keni, është nga Allahu.***" (En-Nahl: 53)[689] Përjeton ndjesinë e begative të shumta, të llojllojshme dhe të pandërprera: "***Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni dot.***" (Ibrahim: 34) Ndien se është i pafuqishëm të falënderojë siç duhet për këto begati dhe e pranon mangësinë e tij për t'ia dhënë hakun secilës: *"Të shpreh mirënjohjen time për mirësinë Tënde ndaj meje, e pranoj mëkatin tim. Më fal mua!"*[690]

Nëse kjo vlen për njeriun e thjeshtë, atëherë ç'mund të themi për të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, njeriun që e njeh më mirë se çdo kush tjetër Zotin e tij, si vepronte ai, kur i shihte dhe i përjetonte begatitë e Allahut!

Si ishte gjendja e tij me begatitë? Si i shijonte ato? Si fliste për to?

Ndër gjërat e para që iu shpallën në fillim të misionit profetik ishte surja *Ed-Duha*, e cila përfundon me këtë ajet madhështor: ***"Dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!"*** (Ed-Duha: 11)

Ky udhëzim iu dha të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që në fillim të shpalljes, sepse ishte udhëzim për një çështje që do ta shoqëronte përgjatë gjithë misionit të tij dhe gjithë jetës.

Allahu nuk përcakton se kujt duhet t'i tregohet për këto begati ***"Dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!"*** (Ed-Duha: 11), por la të kuptohet se: i pari, të cilit duhet t'i flitet për begatitë, është vetvetja, pastaj i pari, të cilit duhet t'ia shprehësh këtë begati, është Zoti yt. Ia kujton vetes tënde për t'i shijuar dhe për të qenë mirënjohës. Ia shpreh Zotit tënd për ta falënderuar dhe për ta madhëruar.

---

[689] **Shënim i përkthyesit**: Përkthimi i ajeteve të Kuranit është marrë nga përkthimi i Hasan Nahit.

[690] Buhariu, 6306.

Nga momentet e përjetimit të begative dhe përmendjes së tyre në jetën e Profetit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* janë:

1. Para gjumit

Kur shtrihej në shtrat për të fjetur. Aty ku do të ndahej nga gjallëria e ditës për të hyrë në pavëmendjen e gjumit të natës. Pikërisht aty, në ato momente e mbyll ditën me disa fjalë falënderimi ndaj Allahut për begatitë: *"Falënderimi i takon Allahut që na mundësoi të hamë, të pimë, të mbrohemi dhe të strehohemi. E sa të shumtë janë ata që nuk janë as të mbrojtur, as të strehuar!"*[691]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e sqaroi se nga çfarë na ka mbrojtur Allahu, sepse ato janë aq të shumta, sa s'mund të përmenden. Mjafton të kujtojmë sa të shumtë janë ata që nuk i kanë këto begati që na janë dhënë neve.

Ky shijim i begative bënte që njeriu të flinte me zemrën të qetë, i gëzuar për mirësitë që sapo i kishte përmendur dhe mirënjohës ndaj Allahut që ia ka dhuruar. Pastaj të flinte i qetë, mirënjohës dhe falënderues.

2. Pas zgjimit

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zgjohej nga gjumi, fjala e parë që shqiptonte ishte falënderimi drejtuar Zotit të tij: *"Falënderimi i takon Allahut që na e dha jetën dhe njëherë, pas këtij gjumi, sepse tek Ai është kthimi."*[692]

Kjo është ndjesia e falënderimit për zgjimin nga gjumi - një dhuratë jete, një fillim i ri. Është vetëdijesim për mirësitë, përmendje e tyre me mirënjohje dhe falënderim. Kjo e bën shpirtin të ndiejë freski, gëzim dhe një lumturi të re për vazhdimin e jetës.

[691] Muslimi, 2715.
[692] Buhariu, 6312. Muslimi, 2711.

3. Me shokët e tij

Një ditë, në një vapë të madhe të mesditës - në një orar kur njerëzit zakonisht nuk dalin jashtë - Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli nga shtëpia sepse nuk kishte asgjë për të ngrënë. Aty takoi Ebu Bekrin dhe më pas takuan Umerin. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i pyeti: "*Çfarë ju nxori nga shtëpia në këtë orë?*" Ata thanë: "*Uria, o i Dërguari i Allahut.*" Tha: "*Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, edhe mua më nxori ajo që ju nxori juve.*"

Pastaj shkuan te Ebu el Hajthem ibn el Tejihan, që kishte një kopsht me palma. Ai i priti me gëzim dhe tha: "Kush ka mysafirë më të nderuar se unë?" Pastaj i çoi në kopshtin e tij dhe i uli nën hije. Shkoi dhe solli një degë me hurma të freskëta, të pjekura dhe të thata, si dhe ujë të ftohtë. U tha: "Hani!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u drejtua nga shokët e tij dhe tha: "*Me të vërtetë, për këtë begati do të pyeteni Ditën e Gjykimit!*"[693] Pastaj filloi t'ua numërojë begatitë: "*Hije e freskët, hurma të shijshme, ujë i ftohtë. Do të pyeteni për këtë begati.*"[694]

Kjo pyetje nuk është për të llogaritur rëndë, por për t'i rikujtuar dhe për t'i përmendur begatitë. Vëre si i shijoi, i përmendi me detaje dhe i numëroi: hije e freskët, hurma nga dega, ujë i ftohtë.

4. Pritja e bukur e begative

Kur i sillnin hurmat e para të pjekura, Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i merrte, i puthte ato dhe pastaj ua jepte fëmijëve të vegjël që ishin të pranishëm. Ky është një moment nderimi për frutin, respekt për begatinë dhe falënderim ndaj Atij që e dha.

Vallë, a ndalemi ne, para begative që na rrethojnë dhe nuk mund t'i numërojmë, për t'i kujtuar me mirënjohje dhe falënderim ndaj Allahut?

Karuni i përmendte të mirat me mburrje, duke thënë: ***"Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime."*** (El-Kasas: 78) Ndërsa i

[693] Muslimi, 2038.
[694] Tirmidhiu, 2369.

Dërguari i Allahut, Sulejmani *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* i përmendte me falënderim dhe thoshte: ***"Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon,*** (ta dijë se) ***Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Dhurues."*** (En-Neml: 40)

5. Prej begative më të mëdha: Udhëzimi

Ndër begatitë më të mëdha është begatia e udhëzimit, dritës së zemrës për ta njohur Zotin dhe për të ecur drejt Tij. Allahu ia përmendi këtë mirësi të Dërguarit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke thënë: ***"A nuk të gjeti të paditur*** *(për Islamin)* ***e të udhëzoi?"*** (Ed-Duha: 7)

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* jetoi me ndjenjën e mirënjohjes ndaj kësaj begatie. Ndër shenjat e kësaj është lutja e tij e shpeshtë për qëndrueshmëri siç tregon Ummu Seleme: *"O Ti që i kthen zemrat, forcoje zemrën time në fenë Tënde."*

Po ashtu, ndjente mirësinë e Allahut për çdo vepër të mirë që ia lehtësonte. Dhe e kuptonte se pa udhëzim dhe ndihmë nga Allahu, nuk do të mund ta kryente atë vepër.

Kur hyri në Mekë si fitimtar, pas një rrugëtimi prej 20 vitesh, me qëndresë dhe durim, përballje me vështirësi, i detyruar të emigrojë, të përballet me luftë, t'i vriten shokët dhe të afërmit, uli kokën me përulësi duke kënduar: ***"Ne të dhamë ty një fitore të qartë..."*** (El-Fet'h: 1) Si të thoshte: O Zot, nuk isha unë që fitova, por Ti je që ma dhe fitoren!

6. Shkallët e falënderimit

Të shohësh begatitë dhe të ndiesh mirësinë e Allahut përmes tyre është shkallë e lartë e falënderimit - që profetët e Allahut ishin më të dalluarit në përmbushjen e tij.

Jusufi *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* lutej: "***O Zoti im! Ti më ke dhënë pushtet dhe më ke mësuar shpjegimin e ëndrrave! O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im edhe në këtë botë, edhe në***

botën tjetër! Bëj që të vdes si musliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)***!***" (Jusuf: 101)

Sulejmani *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* lutej: "***O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!***" (En-Neml: 19)

Allahu i Madhërishëm i tha Musait *(paqja e Allahut qoftë mbi të)*: ***"Zoti tha: "O Musa! Unë të kam zgjedhur ty mbi të tjerët me kumtet e Mia dhe të Folurin Tim*** *(pa ndërmjetës, por të drejtpërdrejtë)****. Merre atë që ta kam dhënë dhe bëhu mirënjohës!"*** (El-A'raf: 144)

Kurse Lukmanit *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* i tha: ***"Falënderoje Allahun! Kush është falënderues, e bën për të mirën e vet dhe, kush mohon, ta dijë se vërtet Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për lavdërim."*** (Lukman: 12)

Ndërsa të Dërguarit të Tij, Muhamedit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i tha: ***"Prandaj, adhuro vetëm Allahun dhe bëhu falënderues!"*** (Ez-Zumer: 66)

Prandaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndroi në shkallët më të larta të falënderimit - i ndiente dhuntitë, ishte mirënjohës dhe përpiqej për falënderim. Qëndronte në namaz nate derisa këmbët i ënjteshin nga lodhja. Kur e pyetën: "*Si e bën këtë kur Allahu të ka falur mëkatet e mëparshme dhe të mëvonshme?*" Ai tha: "*A të mos jem një rob falënderues?*"[695]

I Dërguari dhe vështirësitë

Jeta e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte e përshkuar nga sprova të mëdha. Çdo etapë e jetës së tij pati sfidat dhe vështirësitë e veta, saqë është vështirë të dallosh cilat ishin më të rëndat: a ishte rrethimi dhe bojkoti në "lagje", apo pikëllimi gjatë vitit të hidhërimit, apo largimi nga vendlindja dhe emigrimi, apo goditja që i ndodhi në Uhud, apo rrethimi në betejën

[695] Buhariu, 4836. Muslimi, 2820.

e Hendekut (Ahzab), apo pikëllimi për vrasjen e shokëve të tij që ishin këndues (të Kuranit) pranë pusit të Maunes?

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* e sqaroi këtë çështje kur i bëri një pyetje të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "O i Dërguar i Allahut, a ka pasur ndonjë ditë më të rëndë për ty se dita e Uhudit?" Ai tha: "*Unë kam përjetuar nga populli yt atë që kam përjetuar, por dita më e rëndë për mua prej tyre ishte dita e Akabes,*[696] *kur i kërkova ndihmë Ibën Abd Jalil bin Abd Kulalit, dhe ai nuk e pranoi kërkesën time.*"[697]

Kjo ndodhi kur shkoi në Taif dhe ua paraqiti thirrjen e tij prijësve të Taifit, por ata nuk pranuan. Ai u mërzit, sepse do të duhej të kthehej te Kurejshët, të cilët, tashmë, do të ishin edhe më të ashpër ndaj tij pas vdekjes së Ebu Talibit. Ai ndjeu ngushtim nga refuzimi i njerëzve të Taifit dhe nga përqeshja dhe dhuna e mekasve nëse do të kthehej te ata.

Atëherë iu drejtua Allahut me lutjen e njohur: "*O Allah, unë tek Ti ankohem për dobësinë e forcës sime, për mundësitë e mia të pakta, për përçmimin që më bëjnë njerëzit. O Mëshiruesi i mëshiruesve! Ti je Zoti i të shtypurve, Ti je Zoti im! Në dorën e kujt do të më lësh? Në dorën e të huajit që më trajton me egërsi, apo në dorën e armikut që i ke dhënë pushtet mbi çështjen time? Nëse Ti nuk je i zemëruar me mua, atëherë nuk ka rëndësi asgjë. Por mirësia Jote është më e gjerë për mua. Të kërkoj mbrojtje me dritën e fytyrës Tënde, me të cilën janë ndriçuar të gjitha errësirat dhe është rregulluar çështja e kësaj bote dhe botës tjetër. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga zemërimi dhe hidhërimi Yt. Ty të takon falja deri sa të jesh i kënaqur. Nuk ka fuqi dhe as forcë pa mbështetjen Tënde.*"[698]

---

[696] Ekzistojnë disa mendime lidhur me përcaktimin e vendndodhjes së Akabes: Shumëkush mendon se bëhet fjalë për kodrën Akabe në Mina të Mekës, ndërsa disa të tjerë mendojnë se është fjala për kodrën Akabe në vendin e quajtur Karn el-Menazil, që ndodhet mes Mekës dhe Taifit. Ky mendim i dytë duket më i besueshëm, pasi njerëzit të cilëve Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ua paraqiti Islamin në Akaben e Minas dhe që nuk e pranuan, kanë qenë të shumtë. Megjithatë, kjo nuk ishte arsyeja që e trishtoi më së shumti Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ajo që e brengosi vërtet ishte momenti kur po kthehej nga Taifi, pasi ishte refuzuar atje, duhej të kthehej në Mekë, ku, tashmë, nuk kishte më asnjë mbështetje dhe ku persekutimi pritej të shtohej edhe më shumë.

[697] Buhariu, 3231. Muslimi, 1795.

[698] "*Siretu Ibn Hisham*", 1/420.

Kur u kthye nga Taifi, i pikëlluar për qëndrimin e tyre, u ndal në *Karn el Thealib*. Ai vetë rrëfen: "U nisa i trishtuar dhe nuk u vetëdijesova për veten derisa arrita në Karn el Thealib. E ngrita kokën dhe pashë një re që më kishte bërë hije. Aty ishte Xhibrili, i cili më thirri dhe më tha: 'Allahu i ka dëgjuar fjalët e popullit tënd dhe përgjigjen që të dhanë. Të ka dërguar engjëllin e maleve që ta urdhërosh për çfarë të duash kundër tyre.' Më foli engjëlli i maleve dhe më dha selam pastaj më tha: 'O Muhamed, çfarë të duash ti, nëse do, ua shembi dy malet (që rrethojnë Mekën) *mbi ta.*' Por Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) tha: *"Jo! Unë shpresoj që Allahu të nxjerrë nga pasardhësit e tyre njerëz që do ta adhurojnë vetëm Atë, pa i shoqëruar Atij asgjë."*

Disa mësime nga qëndrimi i Pejgamberit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) përballë vështirësive:

Së pari: Në kohë vështirësish dhe sprovash, ai ushtronte adhurimin e lutjes me përulje ndaj Allahut, kërkonte ndihmën dhe mbështetjen e Tij. Kur ecte i trishtuar, i lutej Allahut me përulje dhe durim: *"O Allah, unë tek Ti ankohem për dobësinë e forcës sime, për mundësitë e mia të pakta, për përçmimin që më bëjnë njerëzit. O Mëshiruesi i mëshiruesve! Ti je Zoti i të shtypurve, Ti je Zoti im!..."*

Ngjashëm me këtë bëri edhe në natën e betejës së Bedrit, ku e kaloi natën në tendën e tij duke iu lutur Zotit të tij: *"O Allah, përmbushe premtimin që më ke dhënë! O Allah, më jep atë që më ke premtuar! O Allah, nëse zhduket ky grusht njerëzish prej muslimanëve, nuk do të adhurohesh më në Tokë!"*[699]

Në rrethimin e betejës Hendekut (Ahzab), ai u lut në xhaminë e Fet'h të hënën, të martën dhe të mërkurën, derisa i erdhi lajmi i mirë për fitoren.[700]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, kur e kaplonte ndonjë çështje e rëndë,[701] falej, duke zbatuar urdhrin e Allahut: ***"O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit."*** (El-Bekare: 153)

[699] Nesaiu, 8574.
[700] Ahmedi, 14563.
[701] Ebu Davudi, 1319.

Së dyti: Në kulmin e fatkeqësisë dhe sprovës, ai shfaqte qëndrueshmëri dhe vetëpërmbajtje të lartë. Kështu ndodhi kur muslimanët u plagosën në Uhud, kur mori lajmin për thyerjen e marrëveshjes nga Benu Kurejdha gjatë Hendekut dhe, po ashtu, në Hunejn.

Së treti: Në kohën e sprovës dhe vështirësisë së madhe, ai tregonte bindje dhe nënshtrim ndaj Allahut, si dhe durim të bukur ndaj sprovës së Tij, duke shpresuar shpërblimin dhe mëshirën nga Ai. Durimi i tij ishte i thellë, i larguar nga ankesat, shqetësimi dhe pakënaqësia. Nga shenjat e këtij durimi të bukur ishte shprehja e nënshtrimit dhe bindjes ndaj Allahut, ai thoshte: *"Nëse Ti nuk je i zemëruar me mua, atëherë nuk më shqetëson asgjë. Por mirësia Jote është më e gjerë për mua."*

Kur Ibn Mes'udi hyri tek ai dhe e gjeti të sëmurë rëndë para vdekjes, tha: *"E preka me dorën time dhe i thashë: O i Dërguar i Allahut, ti je me të vërtetë shumë i sëmurë!"* Ai tha: *"Unë jam duke vuajtur sa dy njerëz nga ju."* Thashë: *"A është kjo që të jep dyfish shpërblim?"* Tha: *"Po! Për çdo vështirësi që e godet muslimanin, Allahu ia shlyen mëkatet, ashtu siç bien gjethet nga pema."*[702]

Ai, gjithashtu, thoshte: *"Më të sprovuarit nga njerëzit janë pejgamberët, pastaj ata që u ngjajnë më së shumti pejgamberëve, pastaj ata që vijnë pas tyre."*[703]

Së katërti: Në kohën e vështirësive nuk e humbte asnjëherë shpresën dhe bindjen. Ishte gjithmonë optimist dhe përcillte gëzim. Shpresa e tij u shfaq kur i tha Engjëllit të maleve: *"Jo! Unë shpresoj që Allahu të nxjerrë nga pasardhësit e tyre njerëz që do ta adhurojnë vetëm Atë, pa i shoqëruar Atij asgjë."* Shpresa e tij shtrihej drejt brezave të ardhshëm, edhe nëse elitat vazhdonin me arrogancën e tyre.

Në betejën e Hendekut, kur sytë ishin të trembur, zemrat kishin arritur në fyt dhe besimtarët u shkundën fuqishëm, një shkëmb i madh u paraqit në hendek. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e goditi atë me kazmë duke pasur një gur të lidhur pas barku nga uria dhe me çdo goditje, shkëmbi nxirrte shkëndija, dhe ai thoshte: *"Allahu është më i Madhi! M'u dhanë çelësat*

[702] Buhariu, 5648. Muslimi, 2571.
[703] Tirmidhiu, 2561.

e Shamit! Allahu është më i Madhi! M'u dhanë çelësat e Persisë! Allahu është më i Madhi! M'u dhanë çelësat e Jemenit! Pasha Allahun, unë po i shoh portat e Sanasë nga vendi ku jam!"[704]

Kështu ishte ai edhe në kulmin e krizave dhe sprovave: përgëzonte me optimizëm dhe e priste premtimin e Allahut sikur po e shihte me sytë e tij.

Së pesti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përjetoi lloje të ndryshme të sprovave, si fizike ashtu edhe shpirtërore: përjetoi dëmtimet, përjetoi pikëllimin e humbjes së fëmijëve dhe të dashurve, përjetoi dhimbjen e sëmundjes së rëndë. Megjithatë, të gjitha këto përjetime ai i pranoi me durim të bukur, me bindje ndaj Allahut dhe me shpresë në shpërblimin e Tij.

Së gjashti: Në këto sprova që përjetoi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjendet ngushëllim për çdo njeri të mërzitur, shpresë për çdo të tronditur dhe shembull për çdo të sprovuar. Muslimani mëson se më i dashuri i Allahut dhe më i miri i njerëzve përjetoi në këtë botë çfarë përjetoi, duroi dhe shpresoi. Kjo tregon se kjo botë nuk është vend i begatisë së përhershme për të dashurit e Allahut, madje ajo është pjesë e mundimeve dhe vështirësive. ***"Se, në të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun për të luftuar në vështirësi!"*** (El-Beled: 4)

Ndërsa begatia e përhershme, e pastër dhe e pandryshueshme është rezervuar në botën e përjetshme.

Së shtati: Nuk e mbante me vete vazhdimisht dhimbjen e sprovave të kaluara. Në këtë hadith kjo shfaqet qartë: po të mos e pyeste Aishja për ditën më të vështirë që kishte përjetuar, nuk do ta kishim ditur për këtë përvojë të rëndë, sepse nuk është përmendur në ndonjë transmetim tjetër. Edhe pse Uhudi ishte një sprovë e rëndë, ai nuk e shndërroi atë në një ditë zie që e përkujtonte dhe rigjallëronte dhimbjen, por, përkundrazi, e përmendte dashurinë e tij për atë vend dhe jo dhimbjen për humbjen në të.

Pra, sprovat dhe fatkeqësitë kanë dhimbje dhe trishtim të momentit, të cilat i shpreh në kohën e tyre dhe nuk i mohon, por ato nuk zgjaten, nuk rinovohen e nuk mbahen me vete gjatë jetës.

---

[704] Ahmedi, 18694.

Së teti: Aftësia për të rifilluar jetën dhe për të ringjallur vendosmërinë. Çdo vështirësi që e kalonte e bënte më të vendosur dhe më të fuqishëm, me shpresë përpara dhe jo me dhimbje pas. Kur emigroi në Medine nga Meka - qyteti më i dashur për Allahun dhe për të - nuk i la ndjenjat të mbeteshin në kujtimet e shtëpive dhe fëmijërisë së tij. E nisi jetën si i shkëputur nga e kaluara dhe i kthyer nga e ardhmja. Kjo frymë u përhap edhe te emigrantët e tjerë, të cilët nuk ndalën projektet e tyre.

Kur u kthye fitimtar në Mekë, pushoi në El Ebtuh dhe nuk pyeti për shtëpitë e tij.

Kështu e kuptuan sahabët këtë frymë nga ai: sapo i shkundën duart nga varrimi i tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pas fatkeqësisë më të madhe që përjetuan - vdekjes së tij - ata rifilluan jetën e tyre dhe u angazhuan në projektin e madh: përhapjen e mesazhit të Pejgamberit të tyre. Ushtritë e tyre u shpërndanë nëpër botë jo për të vajtuar të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, por për të përçuar fenë dhe mesazhin e tij, duke vazhduar rrugën e thirrjes dhe përçimit të së vërtetës.

I Dërguari dhe pasuria

Allahu e bëri pasurinë një mjet jetese për njerëzit, siç thotë: "***Mos e lini në dorë të të paaftëve mendërisht pasurinë tuaj që Allahu jua ka dhënë si mjet jetese për ju; ushqejini dhe vishini ata prej saj dhe u thoni atyre fjalë të mira.***" (En-Nisa: 5)

Dhe Ai e mbolli në natyrën e njeriut dashurinë për pasuri, siç thotë: ***"Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri."*** (El-Adijat: 8) Njeriu përpiqet të fitojë, të grumbullojë e të shtojë pasuri dhe pastaj ngurron të japë: ***"Njerëzit janë të prirë nga koprracia."*** (En-Nisa: 128)

Prandaj, kapërcimi i këtyre prirjeve përmes dhënies së pasurisë, bujarisë në shpenzim dhe fisnikërisë në dhurim, është një virtyt i madh dhe sjellje e lartë, që e bën njeriun të dashur tek Allahu dhe tek njerëzit. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu më bujar dhe më i gatshëm për të dhënë nga pasuria e

tij, më i gatshmi për të ndarë me të tjerët dhe më asketi në grumbullim apo ruajtje pasurie.

Kur shohim marrëdhënien e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me pasurinë, shfaqen disa aspekte:

Së pari: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vinte nga një familje e pasur. Stërgjyshi i tij, Hashimi, ushqente haxhinjtë, dhe gjyshi, Abdulmuttalibi, ishte udhëheqësi i Mekës. Udhëheqja nuk arrihej pa pasuri dhe ndikim. Nuk ka asnjë dëshmi se ai jetoi në varfëri gjatë periudhës mekase.

Së dyti: Para se të martohej me Hadixhen, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte pasuri dhe tregti. Edhe pse kur ishte i ri ruante bagëtinë, ai në rininë e tij ishte punëtor dhe fitimtar. Hadixhja nuk do t'ia besonte pasurinë e saj dikujt që nuk kishte përvojë tregtare dhe nuk kishte kapital. Duhet të kemi parasysh që tregtia në Mekë nuk ishte si sot me dyqane e transaksione të vazhdueshme, por kryhej në tregje sezonale, si në Mina, Ukadh dhe Dhu el Mexhaz. Tregtarët merrnin pjesë me mallrat e tyre ose i bashkoheshin karvanëve që shkonin në Sham ose Jemen, pa qenë nevoja që gjithmonë të udhëtonin vetë. Kjo mënyrë tregtie u praktikua në Mekë deri në fillim të shekullit të kaluar.

Sa për ajetin: ***"A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt?"*** (Ed-Duha: 8) është si dy ajetet më përpara: ***"A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë?"*** (Ed-Duha: 6) Kuptimi është se Allahu e mbrojti nga varfëria ashtu siç e mbrojti nga jetimëria dhe humbja dhe jo se ai realisht ra në varfëri të rëndë e më pas u pasurua.

Nuk do të thotë se ai ishte realisht në gjendje humbjeje për shkak të jetimërisë së tij, e pastaj Allahu e strehoi, dhe as që ai kishte rënë në humbje e më pas Allahu e udhëzoi; por kuptimi është se ai ishte i ekspozuar ndaj rrezikut të humbjes për shkak të jetimërisë, por Allahu e strehoi; ishte i ekspozuar ndaj rrezikut të humbjes në udhëzim, por Allahu e udhëzoi dhe e ruajti; dhe ishte i ekspozuar ndaj varfërisë, por Allahu e begatoi. Që në fillimet e ecjes së tij në jetë, kujdesi hyjnor e përqafoi me strehim, udhëzim dhe pasuri.

Së treti: I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* emigroi në Medinë dhe atij iu konfiskua pasuria e tij në Mekë, por ai mori me vete pasuri sa për t'u ngarkuar mbi deve. Kjo kuptohet

nga fjala e tij drejtuar Ebu Bekrit, kur ky i ofroi një kafshë udhëtimi (deve), e ai i tha: "*Me pagesë*"[705] dhe nuk do t'ia kishte thënë këtë nëse nuk do të kishte pasur mundësi financiare.

Së katërti: Në Medinë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori përgjegjësinë për çështjet e muslimanëve dhe iu përkushtua plotësisht atyre, dhe nuk është transmetuar që ai të ketë ushtruar ndonjë punë tjetër për të fituar pasuri, qoftë ajo tregti, bujqësi apo punë me dorë. Jeta e tij në Medinë, nga fillimi i Hixhretit deri në betejën e Bedrit, ishte me një nivel jetese të thjeshtë dhe të kufizuar. Duket se ai shpenzonte nga pasuria që kishte sjellë me vete nga Meka dhe përfitonte, gjithashtu, nga dhuratat që i sillnin shokët e tij. Ndër to është edhe përshkrimi i Aishes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* për martesën e saj me të Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u martua me mua dhe në shtëpinë tonë nuk u ther për mua ndonjë deve, e as ndonjë dele, derisa Sead ibn Ubade na dërgoi një enë të madhe me ushqim..."[706]

Nga Jahja bin Ebi Kethir transmetohet: "I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte një enë të madhe ushqimi që e kishte Sead ibn Ubaden, e cila sillej me të kudo që të shkonte tek gratë e tij."[707]

Së pesti: Në Medinë, ndonjëherë e përjetoi gjendjen e vështirësisë dhe të varfërisë, të cilat i përballoi me durim të bukur dhe me qëndrim të hijshëm. Ndër shembujt e kësaj janë:

1. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ka thënë: "*Kalonin dy muaj dhe shihnim hënën e re dhe në shtëpitë e të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ndizej zjarr (për gatim)." U pyet: "Si jetonit, atëherë?" Ajo tha: "Me dy gjëra: hurma dhe ujë. Mirëpo, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte disa fqinjë nga ensarët që kishin bagëti qumështi[708], ata i

[705] Buhariu, 3905.
[706] Ahmedi, 25769
[707] "*Musannef*", Ibn Ebi Shejbe, 28318.
[708] Bagëti (deve ose dele) që dhuroheshin në pronësi ose në përdorim. "*Fet'h El Bari*".

dhuronin të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nga shtëpitë e tyre, e ai na e jepte ne."[709]

Nga Ebu Hurejra *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet se një burrë erdhi te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ai dërgoi njerëz te gratë e tij për të kërkuar ushqim, por ato thanë: "Nuk kemi tjetër veç ujit." Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Kush do ta mikpresë këtë burrë?"* Një burrë nga ensarët tha: "Unë!"[710]

Këto raste të vështirësisë ishin të përkohshme, jo të vazhdueshme. Ato duket se ndodhën në fillim të Hixhretit, para se Allahu ta begatonte me fitore, dhe ishin pjesë e gjendjes së përgjithshme në Medinë në atë kohë. Ishte një vështirësi e përbashkët që e përjetonin të gjithë dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në këtë gjendje bashkë me popullin e tij, jo se ishte ndonjë veçori e shtëpisë së tij.

Së gjashti: Pas betejës së Bedrit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori pjesën e tij nga plaçka e luftës, gjë që solli një zgjerim relativ në shpenzime. Pastaj ndodhi zgjerimi më i madh pas fitores ndaj fisit Benu Nadir, pasuri kjo që Allahu ia dha të Dërguarit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* si plaçkë pa luftë *(fej).* Ai ruante për gratë e tij furnizimin për një vit. Transmetohet nga Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* se: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shiste hurmat e palmave të Benu Nadirit dhe siguronte për familjen e tij furnizimin për një vit."[711]

Ajo që shiste Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte pjesa që e ndahej për arkën e shtetit (*Bejtu el mal*) dhe për nevojat e muslimanëve. Prandaj është transmetuar se ai e vendoste këtë pasuri për furnizimin me kuaj, deve dhe armë[712] për përgatitje në rrugë të Allahut. Ndërsa pasuria që zotëronte personalisht, nuk është transmetuar se ka shitur diçka prej saj në Medinë. Nga ajo nuk doli asgjë me shitje, por vetëm si dhuratë ose sadaka.

---

[709] Buhariu, 6459. Muslimi, 2972.
[710] Buhariu, 3798.
[711] Buhariu, 5357.
[712] Muslimi, 1757.

Pastaj ndodhi një zgjerim i mëtejshëm deri në pasuri të bollshme pas fitores në Hajber dhe Fedek.

Së shtati: Pasuria kalonte në duart e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, por nuk qëndronte aty. Ai e jepte me dorë të hapur, si ai që nuk frikësohet nga varfëria. Nuk e llogariste dhënien, por jepte bujarisht.

Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton: "I erdhi të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pasuri nga Bahrejni, dhe ai tha: *'Shpërndajeni në xhami!'* – Ishte kjo pasuria më e madhe që i kishte ardhur ndonjëherë të Dërguarit të *Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).* Nuk u ngrit prej vendit të tij në xhami derisa nuk mbeti asnjë dërhem pa u shpërndarë."[713]

Ibn Abasi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu më bujar dhe më bujar se gjithmonë bëhej në Ramazan, kur takohej me Xhibrilin. Ai e takonte atë çdo natë të Ramazanit dhe mësonin së bashku Kuranin. Me të vërtetë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte më bujar në të mira se era që fryn lirshëm gjithandej."[714]

Së teti: Sa i përket të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai nuk grumbulloi pasuri nga ky begatim dhe nuk e shtoi pasurinë e tij. Shtëpia e tij dhe mobilimi nuk ndryshuan. Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* hyri tek ai në vitin e nëntë pas çlirimit të Mekës, kur, tashmë, gjithë Gadishulli Arabik ishte nën autoritetin e tij. Umeri rrëfen: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte shtrirë mbi një hasër dhe mes tij dhe hasrës nuk kishte asgjë tjetër. Nën kokën e tij kishte një jastëk prej lëkure të mbushur me fije palme. Pranë këmbëve kishte gjethe[715] të thata të hedhura dhe pranë kokës kishte lëkura[716] të varura në mur. E pashë gjurmën e hasrës në anën e trupit të tij dhe fillova të qaj. Ai më tha: "Çfarë të bëri të qash?" I thashë: "O i Dërguari i Allahut! Kisra dhe Kajseri (mbretërit e Persisë dhe Bizantit) jetojnë në të

[713] Buhariu, 421.
[714] Buhariu, 6. Muslimi, 2308.
[715] "*El Nihajetu*", *3/9, 4/43.*
[716] Lëkura të paregjura akoma. "*Umdetu el Kari*", *19/251.*

mira e rehati, ndërsa ti je i Dërguari i Allahut!" Ai tha: *"A je i kënaqur që ata ta kenë këtë botë, kurse ne të kemi botën tjetër?"*[717]

Në vitin e nëntë, pasi Allahu i kishte dhënë fitoren dhe begatinë, gratë e tij u mblodhën dhe i kërkuan një zgjerim në shpenzime. Ai u largua prej tyre për një muaj, pastaj i vendosi para zgjedhjes: ose Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ose jetën e kësaj bote. Të gjitha gratë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zgjodhën Allahun dhe të Dërguarin e Tij në vend të kësaj bote kalimtare.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndërroj jetë, ndërsa parzmorja e tij ishte peng te një hebre, në këmbim të tridhjetë babune *Saë* elbi, dhe nuk pati ç'të jepte për ta shlyer borxhin derisa ndërroi jetë.[718] Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Ndërroi jetë i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe në shtëpinë time nuk kishte asgjë që të mund ta hante dikush, përveç pak elb në një raft. Hëngra prej tij për një kohë të gjatë, pastaj një ditë e peshova, atëherë ai u mbarua."[719]

Ato raste të varfërisë dhe mungesës që i ndodhën Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin pjesë e larmisë së kushteve të jetës së tij, në mënyrë që ai të ishte shembull për Umetin e tij si në pasuri ashtu edhe në varfëri. Nuk e kishte synim varfërinë, as nuk e zgjodhi atë për hir të saj. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i kërkonte mbrojtje Allahut prej varfërisë: *"O Allah! Kërkoj mbrojtjen Tënde nga femohimi dhe nga varfëria."*

Kërkonte, gjithashtu, mbrojtje nga shkaqet e varfërisë, si borxhet dhe nënshtrimi ndaj tyre. Ndër lutjet e tij ishte: *"O Allah! Të kërkoj udhëzim, devotshmëri, ndershmëri dhe pasuri."*

Ai tregoi, gjithashtu, se pasuria e mirë është një mirësi për njeriun e mirë: *"Sa e mirë është pasuria e pastër në dorën e njeriut të pastër!"*[720]

Rreth Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte sahabë të pasur dhe të ndershëm, prandaj fitimi i pasurisë dhe bollëku në duart e të devotshmëve është në dobi të shoqërisë

[717] Buhariu, 4913. Muslimi, 1479.
[718] Buhariu, 2916. Muslimi, 1603.
[719] Buhariu, 3097. Muslimi, 2973.
[720] Ahmedi, 17763. *"El Edeb el Mufred", 299.*

muslimane dhe një shenjë e forcës së saj: *"Besimtari i fortë është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu i Madhërishëm se besimtari i dobët."*[721]

Së nënti: Dëshmi e plotë se ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk jepej pas pasurisë, apo pas dynjasë, është fakti që nuk la pas asnjë dinar e asnjë dërhem trashëgimi. Ai tha: *"Ne, Pejgamberët, nuk lëmë trashëgimi; ajo që lëmë pas është sadaka."*[722] Dhe tha: *"Trashëgimtarët e mi nuk do të ndajnë ndonjë dinar apo dërhem. Ajo që kam lënë përtej furnizimit të grave të mia dhe shpenzimeve të shërbyesit, është sadaka."*[723]

I Dërguari dhe aktiviteti fizik

1. Natyra e jetës në mjedisin arab, ku jetoi i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ishte natyrë e mbushur me veprimtari fizike, të cilat nuk ishin ushtrime të qëllimshme, por pjesë e domosdoshme e veprimtarive të përditshme. Punëtori bënte përpjekje fizike në arën e tij, bariu me kopenë e tij, tregtari në tregtinë e tij dhe njerëzit në udhëtimet e tyre zakonisht ecin me hap të shpejtë.

2. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte një elegancë të shkëlqyer fizike: trupi i tij ishte i fuqishëm dhe i lidhur mirë, lëvizjet e tij ishin të shpejta dhe energjike. Prandaj, në përshkrimin e ecjes së tij thuhet se kur ecte, i ngrinte këmbët duke i shkëputur nga toka dhe nuk i tërhiqte.

Kur bëri *Sa'jin* - ecjen mes Safas dhe Merves - ai shpejtoi ecjen me vrap në fundin e luginës duke thënë: *"Ky vend përshkohet vetëm me vrap!"*[724]

Kur u varros Uthman ibn Medh'uni, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi një burrë që t'i sillte një gur, por ai nuk e përballoi dot peshën. Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vetë u ngrit, zbuloi

[721] Muslimi, 2644.
[722] Buhariu, 3092. Muslimi, 1757.
[723] Buhariu, 2776. Muslimi, 1760.
[724] Ibn Maxhe, 1987.

parakrahët dhe e ngriti gurin duke e vendosur pranë kokës së varrit dhe tha: *"Me këtë do të njoh varrin e vëllait tim dhe aty do të varros të afërmit e mi që do të vdesin."*[725]

El Bera ibn Azibi rrëfen: "Na urdhëroi i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të hapnim hendekun (në betejën e Hendekut) dhe në një pjesë të hendekut na doli përpara një shkëmb që nuk e thyenin dot kazmat. Ia treguam këtë të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).* Ai erdhi, mori kazmën dhe tha: *"Bismilah!"* Pastaj goditi një herë dhe nga shkëmbi dolën shkëndija; e çau një pjesë. Pastaj goditi për herë të dytë dhe e çau më tej, duke lëshuar përsëri shkëndija. Pastaj për herë të tretë tha*:* *"Bismilah"* dhe e çau tërësisht, duke dalë edhe njëherë shkëndija."

Kjo goditje e fuqishme që nxirrte shkëndija dhe thyen gurin tregon për një formë të shkëlqyer fizike dhe forcë trupore. Kjo gjendje fizike ishte e rrethuar nga ushtrime që i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i ushtronte si pjesë natyrale e jetës së tij të përditshme.

3. Në kohën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin disa sporte që ushtroheshin si aftësi të veçanta për të cilat zhvillohej garë. Ato mbetën të lejuara edhe pas shpalljes…

a) Vrapimi me këmbë: Ky është një sport trupor dhe garë që është ushtruar në shumë kombe që në lashtësi. Sipas një transmetimi nga Seleme bin el Ekvea, gjatë kthimit nga ekspedita e Dhu Karad, një burrë nga ensarët që ishte vrapues i shkëlqyer, filloi të sfidonte të tjerët: "A ka kush që guxon të garojë me mua deri në Medinë?" dhe e përsëriti disa herë. Seleme thotë se kur dëgjova fjalët e tij, i thashë: "A nuk e nderon njeriun fisnik dhe nuk ke fare respekt për të ndershmin?" Ai tha: "Jo, përveç nëse është i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*." Unë thashë: "O i Dërguari i Allahut, qoftë jeta ime për ty! Më lër të garoj me të." Ai më lejoi, duke thënë: *"Nëse dëshiron!"*

Ne u vumë në garë. Unë i thashë: "Kalo përpara!" - dhe palosa këmbën time, pastaj u hodha dhe nisa të vrapoj, pastaj u ndala për

[725] Ebu Davudi, 3206.

të marrë frymë dhe e lashë sa kaloi dy apo tri kodrina,[726] pastaj nisa të vrapoj pas tij dhe sërish ndalova dhe e lashë sa kaloi dy apo tri kodrina, pastaj unë përshpejtova derisa e arrita, dhe e godita lehtë mes shpatullave. I thashë: "Pasha Allahun, ke humbur garën!" Ai tha: "E mendoja që do të ndodhte." Pastaj e arrita i pari Medinën."[727]

Kjo garë midis Selemes dhe ensariut ishte një garë ndërmjet tyre dhe një zbavitje për karvanin që i shoqëronin dhe i shikonin ata teksa garonin. Sportet garuese janë zbavitje për garuesit dhe për shikuesit.

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* garoi me gruan e tij, Aishen, dy herë gjatë udhëtimeve dhe herën e dytë qeshi me të duke i thënë: "*Një me një!*"[728]

Kjo garë mes të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe bashkëshortes së tij, Aishes, ishte një lojë e këndshme dhe një formë afrimi mes burrit dhe gruas. Ajo është forma më e bukur e sportit dhe zbavitjes më të ëmbël.

b) Një garë tjetër ishte gara me deve dhe gara me kuaj. Abdullah ibn Umeri transmeton se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* organizoi garë mes kuajve që ishin përgatitur[729] posaçërisht, prej vendit të quajtur Hafja deri në vendin e quajtur Thenijetu el Veda. Po ashtu, organizoi garë edhe mes kuajve që nuk ishin përgatitur posaçërisht, nga Thenijetu el Veda deri te xhamia Benu Zurejk.[730]

c) Një sport tjetër i njohur është edhe mundja mes të rinjve. Për këtë është transmetuar nga Semure ibn Xhundub se ai ka thënë*:* "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i merrte në prova të rinjtë e ensarëve çdo vit dhe pranonte në shërbim ata që kishin arritur moshën e duhur. Ai thotë se u paraqita një vit dhe ai e pranoi një djalë tjetër dhe më refuzoi mua. I thashë: 'O i Dërguari i Allahut, e pranove atë dhe më ktheve mua, por nëse përballëm me të unë do ta mund atë.' Atëherë, ai tha: 'Provojeni!'

---

[726] "*Ikmal el Mu'lim*", 6/199.
[727] Muslimi, 1807.
[728] Ebu Davudi.
[729] Stërvitur për garë. "*Fet'hu el Bari*", 6/72.
[730] Buhariu, 420.

Ne u përballëm dhe unë e munda atë, dhe kështu më pranoi edhe mua në shërbim."[731]

ç) Një tjetër lloj sporti ishte edhe gjuajtja, e cila atëherë bëhej me harqe dhe shigjeta. Transmetohet nxitja dhe inkurajimi për këtë, sepse është prej aftësive luftarake dhe mësimi i saj është përgatitje për luftë. Nga Ukbe ibn Amir transmetohet se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur ishte në minber, duke thënë:

"Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni." (El-Enfal: 60*)*, pastaj tha:

"Me të vërtetë, fuqia është gjuajtja!"
"Me të vërtetë, fuqia është gjuajtja!"
"Me të vërtetë, fuqia është gjuajtja!"[732]

Nga Seleme ibn El Ekvea thuhet se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kaloi pranë një grupi nga fisi Eslem, të cilët po stërviteshin me harqe. Ai tha: *"Gjuani, o bij të Ismailit! Sepse babai juaj ka qenë shigjetar. Gjuani, dhe unë jam me filanin!"* Atëherë, njëri grup ndaloi. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i pyeti: *"Pse nuk po gjuani?"* Thanë: "Si të gjuajmë, kur ti je me ta?" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Gjuani, sepse unë jam me të gjithë ju!"*[733]

d) Ndër sportet është edhe noti. Është transmetuar se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kishte mësuar notin në fëmijëri, në puset e fisit Benu Adij ibn el Nexhar, kur kishte ardhur me nënën e tij në Medinë. Nga Ibn Abasi transmetohet se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: *"Notin e kam mësuar mirë në pusin e Benu Adij ibn el Nexhar."* Tha: *"Dhe disa nga jehudët vinin fshehtas për të më parë duke notuar."*[734]

---

[731] "*El Mustedrek"*, 2356. Ka edhe një transmetim që flet për mundjen e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me Rukanen, por është transmetim i paqëndrueshëm si nga zinxhiri si nga përmbajtja.
[732] Muslimi, 1917.
[733] Buhariu, 2899.
[734] "*El Rasfu lima ruvije an el Nebijji min el fiali ve el Vasfi"*, 1/35.

Inkurajimi për të mësuar notin vjen në hadithin e përmendur më parë nga Xhabiri, ku thuhet: *"Çdo gjë që nuk është përmendje e Allahut është zbavitje dhe hutim, përveç katër gjërave..."* - dhe ndër to përmendi: *"Të mësuarit e notit."*[735]

Nga Umeri është përcjellë se ai i shkroi Ebu Ubejde ibn Xherrrahut: *"Mësojuani fëmijëve tuaj notin, dhe luftëtarëve tuaj gjuajtjen."*[736]

e) Ndër sportet është edhe peshëngritja. Është transmetuar nga Enes ibn Maliku se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kaloi pranë disa njerëzve që po ngrinin një gur të madh për të provuar forcën e tyre. Ai pyeti: *"Çfarë po bëjnë këta?"* I thanë: "Po garojnë kush e ngre gurin për të provuar forcën." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"A doni t'ju tregoj një forcë më të madhe se kjo? Ai që e zotëron vetveten në momentin e zemërimit."*[737]

Këtu shohim se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e aprovoi ushtrimin e këtij sporti që tregon forcë dhe qëndrueshmëri, por, gjithashtu, u tërhoqi vëmendjen drejt forcës morale - që është fuqia e vetëkontrollit në momente zemërimi.

4. Këto aftësi fizike ishin të njohura në mjedisin dhe kohën e Sahabëve. Ato nuk ishin shpikje islame, por aftësi të trashëguara në atë mjedis, të cilat legjislacioni islam i përfshiu brenda hapësirës së gjerë të lejueshmërisë, disa prej të cilave Islami i inkurajoi për dobitë që kishin, kurse disa të tjera i ndaloi, sidomos ato që përbënin dëmtim për njeriun ose për kafshën. Kështu, e ndaloi *el khadhef*, që është hedhja e guralecëve[738], dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Ajo* (hedhja e gurit) *as nuk vret prenë, as nuk lëndon armikun, por mund të nxjerrë syrin apo të thyejë dhëmbin."*[739] Kjo ndalesë është bërë për shkak të dëmit dhe shkatërrimit që mund të sjellë.

---

[735] Taberani, *"El Muaxhemu el Evsatu", 8147.*
[736] Ahmedi, 323.
[737] El Albani, *"El Silsiletu el Sahihatu"*, 3295.
[738] El khadhef: Lojë që luhet për të gjuajtur një guralec ose bërthamë hurme me dy gishta, gishtin e madhe dhe gishtin tregues. Shiko *"El Nihajetu"*, 2/16.
[739] Ibn Maxhe, 3227.

Po ashtu, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaloi që të merret diçka që ka shpirt si objekt për t'u qëlluar. Ibn Abasi transmeton se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: *"Mos e merrni asgjë që ka shpirt si objekt për qëllim* (për ushtrime me qëllim goditjeje)."[740] Kjo, për shkak të torturës që i shkaktohet kafshës dhe rrezikimit të jetës së saj.

Prandaj, çdo lojë apo sport që ekziston te ndonjë popull ose në ndonjë periudhë të caktuar, si futbolli, volejbolli, tenisi, kriketi, ragbi, kërcimi me shkop dhe të tjera aftësi sportive, konsiderohen të lejueshme për sa kohë që nuk shoqërohen me diçka të ndaluar.

Për shembull: Sportet e dhunshme si mundja e ashpër dhe boksi ndalohen për shkak të dëmit që shkaktojnë.

Ndeshjet me dema ndalohen për shkak të torturës së kafshëve.

Sportet që shoqërohen me bixhoz dhe lojëra fati ndalohen për shkak të përzierjes me të ndaluarën.

I Dërguari dhe sëmundja[741]

Pejgamberi ynë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte me shëndet të mirë, me trup të fortë, i fuqishëm dhe i fortë. Ai që e shihte, mendonte se ishte më i ri se mosha e tij reale. Prandaj, kur ai hyri në Medinë bashkë me Ebu Bekrin, transmetuesi tha: "Ebu Bekri ishte plak, ndërsa i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i ri." Ndonëse ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte më i madh në moshë se Ebu Bekri.

Ebu Hurejre ka thënë: "Nuk kam parë askënd që ecte më shpejt se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - ishte sikur toka mblidhej për të nën këmbët e tij. Ne lodhnim veten për të ecur me të, ndërsa ai ecte pa asnjë lodhje."[742]

---

[740] Muslimi, 58.

[741] Shiko: *"El Tarijkhu el Sihhiju li el Resuli (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)",* dr. Husejn Mu'nis.

[742] Tirmidhiu, 3648.

Ai kishte forcë dhe imunitet trupor. Kur hyri në Medinë, shumë prej shokëve të tij u prekën nga ethet, por nuk është transmetuar që ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të jetë prekur prej tyre, përveçse gjatë periudhës kur u sëmurë, që i parapriu vdekjes. Nuk është përmendur ndonjë sëmundje tjetër që e kishte kapluar para asaj, përveç një dhimbjeje të fortë koke që e goditi dy herë: një herë gjatë betejës së Hajberit[743] dhe një herë tjetër gjatë rrugës për Haxhin e Lamtumirës[744].

Ashtu ishte jeta e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në përgjithësi - jeta e një njeriu të fuqishëm, të fortë dhe të vendosur. Më pas, filluan ta godisnin dhembjet dhe kjo ndodhi në dy vitet e fundit të jetës së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Një nga shkaqet ishte se viti i delegacioneve ishte një vit në të cilin shumë njerëz vinin tek i Dërguari i Allahut. Nëna jonë, Aishja, ka thënë: "*E lodhën vizitorët* (delegacionet)."[745]

Kur delegacionet u shtuan te ai, ai ua kushtoi veten atyre, ulej pranë tyre dhe qëndronte me ta, derisa humbi fuqinë e tij fizike dhe u rëndua. Ky përkushtim për njerëzit dhe përballja me çështjet e tyre e rraskapitën atë dhe i lodhën trupin. Filloi ta falte gjithnjë e më shpesh namazin e natës ulur, sepse trupi i ishte rënduar nga qëndrimi i tij i vazhdueshëm me njerëzit.

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ndërroi jetë pa qenë pjesa më e madhe e namazit të tij ulur."[746]

Kur falej me sahabët, u thoshte: "*Unë jam rënduar* (nga trupi), *prandaj mos më parakaloni në ruku dhe as në sexhde.*"[747]

Dhembjet filluan ta godisnin atë. Aishja tregon: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u sëmur në fund të jetës së tij, ose afër fundit të jetës së tij."[748]

---

[743] "*El Mustedrek*", 4339.
[744] Buhariu, 5700.
[745] Muslimi, 1290.
[746] Muslimi, 732.
[747] Ebu Davudi, 619.
[748] Ahmedi, 24380.

Sa i përket qëndrimit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* **ndaj sëmundjes:**

1. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e fshehte dhimbjen e tij; ai fliste hapur për të dhe nuk ngurronte t'u tregonte dhimbjet atyre që e donin dhe që ai i donte. Një herë, kur Aishja i tha: "*Ah, koka ime!*" Ai tha: "*Jo ti, por unë moj Aishe, ah, koka ime!*"[749] Dhe kjo shënoi fillimin e etheve dhe dhimbjes së sëmundjes që çoi në vdekjen e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Për këtë arsye, dijetarët kanë nxjerrë nga ky shembull se lejohet që i sëmuri të tregojë sëmundjes dhe të shprehet për dhimbjet e tij me qëllim njoftimi, jo me qëllim ankimi apo pakënaqësie.

2. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur sëmurej kurohej me rukje (lutje mbrojtëse) dhe me ilaçet që njiheshin në atë kohë në mjedisin arab, si: hixhame (terapia me kupa gjaku), bimët mjekësore dhe të ngjashme.

Xhibrili *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* i bënte rukje kur ai ankonte ndonjë gjë. Ebu Seid el Hudrij transmeton se Xhibrili erdhi te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i tha: "O Muhamed, a ankon diçka?" Tha: "*Po.*" Atëherë, (Xhibrili) tha*:* "Të mbroj me Emrin e Allahut, nga çdo gjë që të shqetëson, nga e keqja e çdo krijese dhe nga çdo sy smirëzi. Të mbroj me Emrin e Allahut, Allahu të shëroftë!"[750]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e mbronte veten me lutje, ashtu sikurse bënte edhe Aishja për të. Urve transmeton se tezja e tij i ka treguar: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, kur ankonte diçka, këndonte suret mbrojtëse (Felek dhe Nas) dhe fshinte trupin me dorën e vet. Por kur u sëmur rëndë, në sëmundjen e vdekjes, fillova t'ia këndoj unë ato sure që zakonisht i këndonte ai vetë dhe e fshija me dorën e tij (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."[751]

Ai është mjekuar edhe me hixhame - një formë mjekësie e përhapur në Arabinë e atëhershme dhe e përshtatshme për mjedisin e saj.

[749] Buhariu, 7217.
[750] Muslimi, 2186.
[751] Buhariu, 4439.

Gjithashtu, u mjekua me bimë dhe përzierje natyrore. Transmetohet nga Urve se e pyeti Aishen *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*: "Si e mësove mjekësinë?" Ajo tha: "*I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u sëmur në fund të jetës, dhe nga çdo drejtim vinin delegacione arabe që i përshkruanin mjekime të ndryshme, dhe unë përgatisja për të ato mjekime."[752] Që prej asaj kohe fitova njohuri mbi mjekësinë dhe përzierjen e barnave.

Pra, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është mjekuar vetë, ka mjekuar disa prej shokëve të tij dhe e ka urdhëruar Umetin që të mjekohet. Prandaj kur e pyetën për mjekimin, tha: "*Po, mjekohuni, o robër të Allahut! Sepse Allahu i Madhërishëm nuk ka zbritur ndonjë sëmundje, veçse ka zbritur edhe shërimin për të - përveç një sëmundjeje.*" Kur e pyetën: "Cila është ajo, o i Dërguar i Allahut?" Ai tha: "*Plakja!*"[753]

3. Në sëmundjen e vdekjes së tij, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përjetoi dhimbje shumë të forta, saqë Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ka thënë: "Nuk kam parë askënd që të ketë pasur më shumë dhimbje se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*."[754]

Trupi i tij u përfshi nga ethet e larta dhe kjo ndodhi në verë, në muajin qershor. Abdullah ibn Mesudi ka thënë: "E vendosja dorën time mbi mbulesën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ndjeja nxehtësinë e trupit të tij edhe përmes mbulesës." Nga temperatura e lartë i binte të fikët.

Mbi trupin e tij i hidhej ujë i freskët nga shtatë enë të mbushura nga puse të ndryshme.

4. Edhe në këtë gjendje dhimbjeje Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i llogariste vuajtjet e tij si një burim shpërblimi tek Allahu i Madhërishëm. Ai ka thënë: "*Me të vërtetë, për çdo gjë që e godet besimtarin qoftë lodhje, qoftë sëmundje, qoftë shqetësim, qoftë pikëllim, qoftë vuajtje, qoftë brengë - madje qoftë edhe një therje gjembi - Allahu ia fshin mëkatet e tij, ashtu siç bien gjethet nga pema.*"[755]

---

[752] Ahmedi, 24380.
[753] Ebu Davud, 2015. Tirmidhiu, 2159. Ibn Maxhe, 3436.
[754] Muslimi, 2570.
[755] Buhariu, 5641, 5648. Muslimi, 2571.

Kështu, edhe pse po vuante nga dhimbjet, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përkushtohej Allahut duke shpresuar në shpërblim dhe pastrim (nga mëkatet). Ai i jepte një shembull të lartë Umetit të tij, si të përballen me dhimbjet e sëmundjes: me durim dhe me shpresë për shpërblimin hyjnor.

5. Dhimbjet dhe vuajtjet e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur u sëmurë nuk e larguan nga marrëdhëniet dhe dashuria për të afërmit.

Ja, kur u sëmurë përpara ndërrimit jetë, ai e thërret Fatimen *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* dhe, kur ajo vjen, ai e mirëpret me përzemërsi, e ul pranë vetes, i flet diçka fshehtas dhe i tregon për afërsinë e vdekjes së tij - dhe ajo qan. Pastaj e përgëzon se ajo do të jetë zonja e grave të Xhenetit, dhe ajo qesh.

Teksa gjendja i rëndohet, tek ai hyn Usame ibn Zejdi, por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk mund të flasë më. Ai vetëm ngriti gishtin drejt qiellit e pastaj e drejtoi kah Usama. Usama thotë: "E kuptova se po lutej për mua."[756] Skena e fundit që Usama pa nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte dashuria dhe lutja e tij për të.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i thoshte Aishes: "*Më lehtësohet dhimbja kur e mendoj bardhësinë e dorës së Aishes në Xhenet.*"[757]

Shiko si edhe në kulmin kur u sëmurë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shpreh ndjenja të sinqerta dhe të ngrohta - dashuri, kujdes dhe përkujdesje për më të dashurit e tij.

6. As kur u sëmurë, as dhimbja dhe vuajtjet nuk e larguan Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nga gjëja më e dashur për të - nga dritësyri i tij, qetësia e shpirtit të tij: namazi. Kur ra në gjendje të fikëti gjatë periudhës kur u sëmurë përpara vdekjes, familjarët e tij u mblodhën rreth tij, duke i vështruar fytyrën dhe duke vëzhguar buzët e tij. Kur u përmend, fjalët e para që tha ishin: "*A janë falur njerëzit?*" Ata i thanë: "Jo, po të presin ty."[758]

---

[756] Tirmidhiu, 3817.

[757] Ahmedi, 25076.

[758] Buhariu, 687. Muslimi, 418.

7. Dhimbjet kur u sëmurë nuk e larguan as nga Umeti i tij dhe kujdesi për të. Edhe pse i lodhur dhe i rënduar, ai mbështetet mbi Aliun dhe Abasin - trupin e tij nuk e mbanin më këmbët - dhe del nga dhoma. Derisa i tërhiqeshin këmbët në tokë, e ulën pranë Ebu Bekrit. Fali namazin me njerëzit, pastaj mbajti një hytbe[759] - ishte hytbe lamtumire.

Frymën e fundit të tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ruajti për t'ia kushtuar një thirrjeje për Umetin e tij, për të theksuar çështjen e namazit. Fjalët e fundit që u dëgjuan prej tij ishin: *"Namazi, namazi! Dhe ato që keni në të djathtën* (besën) *tuaj!"*[760] Ai mezi i shqiptonte këto fjalë me zë, por zemra e tij fliste me dashuri të thellë.

I Dërguari dhe mjekësia[761]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi me mesazhin udhëzues për njerëzimin, që tregon rrugën e tij drejt Allahut. Ndërsa çështjet e jetesës së njerëzve dhe punët e dynjasë i la brenda një hapësire heshtjeje dhe lejimi. I la në dorën e përpjekjes dhe përvojës njerëzore; për shkak të ndryshimit të tyre sipas kushteve, kohëve dhe vendeve të ndryshme, me kusht që të largohen nga gjërat e ndaluara, të cilat dëmtojnë fenë apo dynjanë e tyre. Ndër këto çështje është edhe mjekësia, e cila, si gjithë dijet dhe përvojat e tjera njerëzore, ndërtohet mbi grumbullimin e përvojës, si shkenca e bujqësisë, e industrisë, e ndërtimit dhe të ngjashme me to. Po të vëzhgojmë hadithet për mjekësinë në Sunetin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe zbatimin e tyre në jetën e tij, i gjejmë ato brenda këtij kuadri, pra në këtë hapësirë të gjerë, që është hapësira e gjërave të lejuara të lëna në heshtje, të lëna në dorën e përpjekjes dhe përvojës njerëzore. Megjithatë, në jetën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shpeshherë gjejmë edhe shenja udhëzuese, ndër to:

---

[759] Buhariu, 713. Muslimi, 418.

[760] Ebu Davudi, 5156.

[761] Për këtë shiko librin "*Fikhu el Tibbi el Nebevijji*" të Shejh Hani el Xhubejr. Prej tij kam përfituar për të punuar këtë temë. Pasi ai është një studim i fortë.

Së pari: Porosia i tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të kërkuar shërim. Gjatë Haxhit të Lamtumirës, ditën e Kurbanit, beduinët e pyetën: "O i Dërguar i Allahut, a të kurohemi (me mjekim)*?*" Ai tha: "*Shërohuni, sepse Allahu nuk e ka zbritur ndonjë sëmundje pa i zbritur edhe shërimin për të. Kjo është e njohur për ata që kanë dije dhe është e panjohur për ata që nuk kanë dije.*"[762]

Ebu Derda transmeton se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Allahu e ka zbritur sëmundjen dhe shërimin. Për çdo sëmundje ka bërë ilaç. Prandaj mjekohuni, por mos u mjekoni me diçka të ndaluar!*"[763]

Së dyti: I Dërguari, sal Allahu alejhi ve selem, ashtu siç porositi për t'u mjekuar, edhe vetë u mjekua. Ai u mjekua me mjetet e njohura në kohën e tij, me metodat e zakonshme të mjekimit. Ai u mjekua edhe me hixhame (nxjerrje gjaku). Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u sëmur në fund të jetës dhe nga çdo drejtim vinin delegacione arabe që i përshkruanin mjekime të ndryshme, dhe unë përgatisja për të ato mjekime."[764]

Së treti: Ashtu siç u mjekua vetë i Dërguari, sal Allahu alejhi ve selem, ai mjekoi edhe të tjerët. Një burrë erdhi tek ai dhe i tha: "Vëllai im ka diarre." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*Jepi mjaltë.*" Ai shkoi, pastaj u kthye dhe tha: "Ia dhashë, por vetëm ia shtoi diarrenë." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përsëriti: "*Jepi mjaltë.*" Kjo ndodhi disa herë dhe herën e katërt ai i tha: "*Jepi mjaltë.*" Ai ia dha përsëri dhe vëllai i tij u shërua. Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në herën e katërt tha: "*Allahu ka thënë të vërtetën, ndërsa barku i vëllait tënd ka gënjyer.*"[765] (Nuk iu përgjigj ilaçit derisa mori dozën e mjaftuar).

Ai, gjithashtu, e mjekoi edhe plagën e Sead ibn Muadhit. Xhabiri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Gjatë betejës së Hendekut, Seadi u godit me shigjetë dhe iu prenë damarët e krahut. I Dërguari i

[762] Ahmedi, 18456.
[763] Ebu Davudi, 3874.
[764] Ahmedi, 24380.
[765] Ahmedi, 11146. Buhariu, 5684. Muslimi, 2217.

Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia dogji (plagën) me djegie (Kej)[766] për ta mbyllur." Pasi përfundoi lufta, plaga u çel përsëri dhe Seadi vdiq."[767] Ai vdiq nga ajo plagë dhe nuk u shërua me mjekimin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* , sepse mjekimi i tij ishte një veprim njerëzor, jo shpallje hyjnore.

Së katërti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka udhëzuar drejt mjekimit me ilaçe dhe mbrojtjes përmes lutjeve dhe dhikrit, siç janë suret mbrojtëse që njihen si mbrojtje e lejuar e ligjshme.

Thelbi i tyre është lutja drejtuar Allahut dhe kthimi tek Ai, duke e kërkuar vetëm shërim vetëm prej Tij dhe askujt tjetër. Kjo sepse gjendja e të sëmurit është gjendje nevoje dhe varësie të thellë, në të cilën njeriu i drejtohet vetëm Allahut me përulësi të plotë. Në këtë gjendje, lutja përkon me nevojë të ngutshme dhe sinqeritet të thellë. Allahu i Madhërishëm ka thënë: ***"A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?! Sa pak që reflektoni!"*** (En-Neml: 62)

Xhibrili *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* e mbronte Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me *lutje*, këtë bënte edhe Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Ibën Abasi *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* transmeton se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lutej për Hasanin dhe Husejnin, duke thënë: "Babai juaj i lutej Allahut për Ismailin dhe Is'hakun me këtë lutje*: "Kërkoj mbrojtje për ju me fjalët e plota të Allahut nga çdo djall dhe nga çdo* (krijesë) *helmues, si edhe nga çdo njeri me sy të keq."*[768]

Ai, po ashtu, e miratoi kurimin e shokëve të tij përmes lutjes. Arabët kishin lutjet e tyre të veçanta për kurim. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i aprovoi ato praktika, përveç atyre që përmbanin shirk (idhujtari), sepse lutja është vetëm për Allahun dhe Allahu i përgjigjet lutjes së atij që i lutet, qoftë musliman apo jo. Këtë e dinin edhe idhujtarët arabë, të cilët, kur hipnin në anije dhe

[766] Ia ndali gjakun me djegie. Shiko: "*El Nihajetu"*, 1/386.
[767] El Tahaviju, "*Sherhu Mushkili el Athari"*, 3579.
[768] Buhariu, 3371.

përballeshin me rrezik, i luteshin Allahut me përkushtim të sinqertë, dhe Ai u përgjigjej e i shpëtonte duke i nxjerrë në breg.

Së pesti: Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, ndaloi disa forma të mjekimit që ishin të përhapura mes arabëve, si: kurimi me lutje që përmbanin shirk (idhujtari), kërkimi i shërimit përmes fallxhorëve, kërkimi i ndihmës nga xhinët dhe përdorimi i gjërave të ndaluara për mjekim.

Vail el Hadrami tregon se Tarik bin Suvejdi el Xheafi e pyeti Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për verën. Ai e ndaloi atë, ose nuk e pëlqeu që të përgatitej. Tariku tha: "*Unë e përgatis vetëm si ilaç*." Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, u përgjigj: "*Jo, ajo nuk është ilaç, por është sëmundje.*"[769]

Gjithashtu, ka thënë: "*Allahu nuk e ka lënë shërimin tuaj në gjëra të ndaluara.*"[770]

Së gjashti: Nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* janë transmetuar disa hadithe në të cilat përmenden lloje të ndryshme ilaçesh:

1.Nga Ibën Abasi *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* transmetohet se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Shërimi është në tre gjëra: në një gllënjkë mjalti, në një prerje me hixhame dhe në djegie me djegie* (Kej). *Por unë ia ndaloj Umetit tim përdorimin me djegie.*"[771]

2. Nga Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet se disa njerëz nuk u përshtatën me klimën[772] e Medinës dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i urdhëroi të shkonin te bariu i deveve, që të pinin nga qumështi dhe urina e deveve. Ata shkuan dhe pinë prej tyre, derisa trupat e tyre u përmirësuan.[773]

3. Nga Ebu Hurejre transmetohet se e ka dëgjuar Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të thotë: "*Vërtet, në farën e zezë ka shërim për çdo sëmundje, përveç vdekjes.*"[774]

---

[769] Muslimi, 1984.
[770] Ibn Hibbani, 1391.
[771] Buhariu, 5680. Djegia *Kej* bëhet me hekur të nxehtë ose direkt me zjarr. Shiko: "Umdetu el Kari", 8/249.
[772] I kapi dhimbje fyti për shkak të ndryshimit të klimës. "*El Nihajetu*", 1/318.
[773] Buhariu, 5686. Muslimi, 1671.
[774] Buhariu, 5688. Muslimi, 2215.

4- Nga Sead bin Ebi Vekas *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Kush i ha çdo mëngjes shtatë hurma të njoma, atë ditë nuk do ta dëmtojë as helmi e as magjia deri në mbrëmje.*"[775]

Këtu është e nevojshme të theksohen disa çështje:

1. Disa dijetarë janë të mendimit se hadithet që kanë të bëjnë me mjekësinë janë shpallje dhe si rrjedhojë janë të padiskutueshme. Ndër ata që kanë përkrahur këtë mendim janë Neveviu në "*Sharhu Muslim*"[776], Ibën Kajimi në "*Zadu el Mead*", si dhe Dhehebiu dhe Dija el Makdisi.

2. Ndërkohë, një grup tjetër dijetarësh - nga të hershmit dhe të mëvonshmit - janë të mendimit se hadithet për mjekësinë janë pjesë e përvojës njerëzore dhe përfaqësojnë mjekësinë e mjedisit, të mbështetur në përvojë praktike. Ibn el Arabi ka thënë: "Ajo që ka përmendur Pejgamberi rreth mjekimit dhe ilaçeve, dijetarët kanë thënë se hyn në një nga dy llojet e mjekësisë, që është mjekësia eksperimentale - ajo e Indisë dhe e arabëve. Andaj, fjalët e Pejgamberit, sal Allahu alejhi ve selem, janë shpjeguar si pjesë e metodave të njerëzve të përvojës, për t'ua sjellë arabëve në mënyrë të afërt dhe të përshtatshme atë që ata tashmë e praktikonin." Të këtij mendimi janë edhe El Hatabi, Kadi Ijadi, Veliju Allah el Dehlevij dhe të tjerë.[777]

Ibën Halduni ka thënë: "Arabët kishin njohuri të shumta nga kjo lloj mjekësie dhe ndër ta kishte mjekë të njohur si Harith bin Kelde dhe të tjerë. Mjekësia që është transmetuar si e lejuar i përket këtij lloji dhe nuk është pjesë e shpalljes hyjnore. Ajo është diçka që ishte e zakonshme mes arabëve. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) është dërguar për të na mësuar dispozitat fetare, jo për të përkufizuar mjekësinë apo fusha të tjera të natyrshme. Prandaj, nuk është e drejtë të konsiderohet se mjekësia e përmendur në hadithet e sakta është pjesë e dispozitave fetare, sepse nuk ka asgjë që e vërteton këtë."

---

[775] Buhariu, 5768. Muslimi, 2047.

[776] "*Sherhu el Neveviju ala Muslim*", 14/3.

[777] Shiko: "*El Mesalik li Ibn el Arabi*", 7/453. El Hattabi, "*Ealamu el Hadithi*", 3/2107. El Hattabi, "*Ikmalu el Mual-limi*", 6/531. El Dehlevij, "*Huxhxhetu Allahi el Baligati*", 1/224.

3. Ka edhe prej dijetarëve që, ndonëse nuk kanë deklaruar qartë se hadithet për mjekësinë nuk janë shpallje hyjnore, ata kanë shprehur një mendim të afërt me këtë, duke kufizuar shumë kuptimin dhe zbatimin e tyre, në mënyrë që t'i përshtaten asaj që është dëshmuar në realitet dhe përvojë praktike, si, për shembull, trajtimi i etheve me ujë, apo ngrënia e hurmave të njoma në mëngjes për t'u mbrojtur nga helmimi dhe magjia.

Ibn el Tejni, në komentimin e hadithit: "*Kush i ha çdo mëngjes shtatë hurma të njoma, atë ditë nuk do ta dëmtojë as helmi e as magjia deri në mbrëmje*", ka thënë: "Mund të jetë që qëllimi të jetë një lloj i veçantë hurme i kohës së Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)."

Ibn Kajimi e ka kufizuar këtë efekt te banorët e Medinës në veçanti, duke thënë se kjo u përshtatet atyre dhe jo të tjerëve.

Mazeriu ka thënë se kjo është nga ato gjëra që nuk kuptohen me logjikën e mjekësisë. Edhe nëse do të mund të argumentohej në aspekt mjekësor për dobinë e hurmës kundër helmimit, nuk do të ishte e mundur të kuptohej pse saktësisht shtatë (copë) dhe pse pikërisht lloji të njoma.

Ndoshta kjo ka qenë e veçantë për njerëzit e kohës së tij (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*).

Vërehet se këta dijetarë kanë ngushtuar kuptimin e hadithit, duke e kufizuar atë në një vend apo kohë të caktuar.

Ekziston edhe një vështirësi tjetër që dijetarët nuk e kanë trajtuar: Fakti që i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u godit nga magjia dhe helmi në Medinë, megjithëse hurma ishte ushqimi kryesor i banorëve të Medinës.

Ndoshta më afër së vërtetës - dhe Allahu e di më mirë - është të konsiderojmë hadithet që flasin për mjekësinë si çështje të jetës së kësaj bote, për të cilat Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Ju jeni më të ditur për çështjet e botës suaj.*"[778] Dhe se ajo që është transmetuar prej tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në këtë fushë është nga ato që ai i ka vëzhguar me

[778] Muslimi, 2363.

përvojë dhe ka menduar se kanë dobi, e jo diçka që e ka marrë përmes shpalljes.

Prandaj, ka gjasa që ndonjëherë të përputhet me realitetin dhe ndonjëherë jo, sepse mjekësia hyn në rrethin e çështjeve të zakonshme dhe hadithet që lidhen me të - qofshin të sakta apo jo - nuk hyjnë në fushën e shpalljes hyjnore.

Sepse misioni i pejgamberisë është shërimi i shpirtrave, jo i trupave, dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, megjithëse ishte i dërguar hyjnor, nuk ndahej nga natyra e tij njerëzore: ai hante, pinte, martohej dhe përdorte njohuritë dhe shkaqet që përdornin edhe njerëzit e kohës së tij në çështjet jetësore.

Ajo që e përforcon dhe e vërteton këtë mendim është:

1. Nuk gjejmë që Sahabët të kenë ndjekur me përpikëri ilaçet e përdorura nga i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, apo që të jenë kujdesur t'i përdorin ato për t'u kuruar. Për më tepër, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka përdorur ilaçe që ia kanë përshkruar mjekët arabë, ka thirrur mjekë për shokët e tij, madje edhe vetë Sahabët i janë drejtuar mjekëve dhe janë konsultuar me ta.[779]

Transmetohet nga Sead ibn Ebi Vekas se ai u sëmur dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkoi ta vizitonte dhe i tha: "*Ti je njeri që ka nevojë për ilaç. Shko te Harith ibn Kelde, vëllai i fisit Thakif, sepse ai është njeri që praktikon mjekësinë.*"[780]

2. Edhe njerëzit e shtëpisë së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kanë përdorur "ludd"[781] (një lloj kurimi duke i hedhur ilaç me forcë në gojë të sëmurit) për mjekimin e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ka thënë: "Ne ia dhamë ilaçin kur u sëmurë, por ai filloi të na bënte shenjë të mos ia jepnim. Ne menduam se ai e bënte nga mospëlqimi i zakonshëm i të sëmurit për ilaçin. Por kur u përmend, tha: "*A nuk ju ndalova që të mos më jepni ilaç?!*" Ne i thamë: "Menduam se ishte thjesht mospëlqim i të sëmurit për ilaçin." Ai tha: "*Nuk duhet të*

[779] Ebu Naim *el Tibbu el Nebeviju,* 1/19. 2/646. *Fikhu el Tibbi el Nevevij,* 61.
[780] Ebu Davudi, 3875.
[781] El Kastalani, "*Irshadu el Sari*", 8/376.

mbetet askush në këtë shtëpi pa e marrë të njëjtin ilaç - dua t'ju shoh duke e pirë - përveç Abasit, sepse ai nuk ishte i pranishëm."[782]

Nga kjo kuptohet se ata e mjekuan me atë që e konsideronin si trajtim të dobishëm, edhe pse ai nuk e pranonte, dhe menduan se ai po vepronte si çdo i sëmurë tjetër që nuk e do ilaçin. Kjo tregon se ata nuk e konsideronin qëndrimin e tij ndaj mjekimit si shpallje hyjnore apo çështje fetare, por thjesht një gjykim personal si çdo njeri tjetër.

3. Kur Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* po nisej për në Sham, i arriti lajmi për shpërthimin e epidemisë së murtajës.

Ibnu Abasi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se Umeri më tha: "Më thirr muhaxhirët e parë!" Kështu që unë i thirra. Ai u konsultua me ta dhe u tregoi se epidemia kishte rënë në Sham. Ata dhanë mendime të ndryshme. Disa prej tyre thanë: "Ti je nisur për një çështje dhe ne mendojmë se nuk duhet të tërhiqesh prej saj." Disa të tjerë thanë: "Me vete ke njerëzit e mbetur nga Sahabët e të Dërguarit të Allahut dhe ne mendojmë se nuk duhet t'i dërgosh në këtë epidemi." Ai tha: "Shpërndahuni!" Pastaj më tha: "Më thirr ensarët!" Unë i thirra. Ai u konsultua me ta. Ata dhanë mendime të ndryshme ashtu si Muhaxhirët. Ai tha: "Shpërndahuni!" Pastaj më tha: "Më thirr të moshuarit e kurejshëve që emigruan në vitin e çlirimit të Mekës!" Unë i thirra dhe ata të gjithë ishin të një mendimi. Ata thanë: "Ne mendojmë se ju duhet të ktheheni me njerëzit dhe të mos i dërgosh në këtë epidemi." Në këtë kohë erdhi Abdurrahman ibn Avf, i cili ishte larguar për çështje personale, dhe tha: "Unë kam njohuri për këtë çështje. Kam dëgjuar të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të thotë: *Kur të dëgjoni për murtajën në një vend, mos shkoni atje. E kur murtaja të ndodh në një vend ku ndodheni ju, mos dilni të largoheni prej saj."* Umeri falënderoi Allahun pastaj u largua.[783]

Çfarë vërejmë në këtë ngjarje është se ata që pranuan Islamin në vitin e çlirimit të Mekës nuk patën mendime të ndryshme, por u pajtuan të gjithë që njerëzit të ktheheshin dhe të mos përballeshin me murtajën. Arsyeja e këtij pajtimi ishte besimi i tyre në përvojën mjekësore të kohës mbi transmetimin e sëmundjeve ngjitëse.

[782] Buhariu, 4458.
[783] Buhariu, 5729

Kështu, thëniet profetike përputheshin me këtë përvojë jetësore dhe vëzhgim praktik. Ndërsa emigrantët e tjerë u ndanë, sepse disa prej tyre e panë kthimin si një mungesë besimi ndaj Allahut në çështjen e mbështetjes te Allahu (tevekkul).

4. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Mendova t'i ndaloj njerëzit nga "el Gijla"*[784] *derisa mu kujtua se romakët dhe persët e bëjnë këtë, dhe kjo nuk i dëmton fëmijët e tyre."*[785] Kjo është një dëshmi e qartë se ky qëndrim i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bazohet në vëzhgimin njerëzor dhe jo në shpallje. Dhe në këtë kuadër hyn edhe pjesa tjetër që lidhet me menaxhimin e shëndetit.

5. Ilaçet që përmendi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin të përgjithshme, ai nuk përmendi sasi, as mënyrën e përgatitjes, as mënyrën e trajtimit me to, si në fjalën e tij për tartufin (kem'et): *"Uji i tyre është shërim për syrin"*[786], por nuk tha se çfarë është ky ujë, a duhet të shtrydhet prej tyre apo të zihet bashkë me to? Për këtë arsye, dijetarët kanë ndryshuar mendje për mënyrën e zbatimit të këtij përshkrimi: disa e kanë përdorur fjalë për fjalë dhe kjo u ka shkaktuar dëm, madje humbje shikimi dhe verbëri. Ndërsa sahabët nuk kanë kërkuar detaje dhe nuk kanë pyetur më tepër, që tregon se ajo që tha Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte një formë trajtimi që ata e njihnin mirë në hollësi dhe ishte e mjaftueshme që ai të tregonte vetëm në mënyrë të shkurtër, sepse ata e dinin recetën, sasinë dhe mënyrën e përdorimit.

Pra, përmendja e trajtimit me to ishte për ata që njihnin mënyrën dhe ne sot nuk mund të pretendojmë të dimë si e zbatonin ata.

El Mazeri ka thënë: "Shkenca e mjekësisë është nga shkencat që kërkojnë më shumë hollësi, saqë për një të sëmurë, një ilaç në një moment mund të jetë shërim, e në momentin tjetër mund të jetë sëmundje për shkak të një ndryshimi tjetër që ndodh. Madje, edhe nëse supozojmë se ai është një ilaç shërues për një person në një

[784] Marrëdhëniet bashkëshortore gjatë dhënies së gjirit. Po ashtu, shtatzënia gjatë dhënies së gjirit. Shiko: "*El Nihajetu*", 3/402.
[785] Muslimi, 1442.
[786] Buhariu, 4478. Muslimi, 2049.

rast të caktuar, kjo nuk do të thotë se ai është ilaç shërues për atë person apo për të tjerë në çdo rast."[787]

Atëherë, ku janë këto hollësi mjekësore në recetat që përmenden nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*? Çdo përpjekje për të përcaktuar me saktësi sasinë, hollësitë dhe mënyrën e trajtimit është një përpjekje e tepërt dhe pretendim jashtë asaj që ka ardhur në tekstin e transmetuar.

Ne nuk kemi nevojë për asnjërën nga këto nëse themi se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka përcjellë një eksperiencë njerëzore dhe jo një shpallje qiellore.

6. Nëse do ta përshkruajmë mjekësinë si profetike, atëherë do duhet të përshkruajmë edhe veshjen si profetike, ushqimin si profetik, udhëtimin si profetik dhe kështu udhëzimi profetik që është i gjallë dhe lëvizës do të shndërrohet në një ngecje përpara lëvizjes dhe zhvillimit të jetës.

7. Ka fusha më të rëndësishme në jetë se mjekësia, për të cilat Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ka përcaktuar një sistem të veçantë funksionimi, si, për shembull, fusha ushtarake. Në betejën e Uhudit ai i grumbulloi Sahabët dhe i pyeti për mendimin e tyre dhe kur erdhën koalicionet (ahzab) nuk priti shpalljen, por edhe atëherë grumbulloi Sahabët dhe i pyeti për këshilla. Ai mori si strategji hapjen e hendekut që ishte e ndryshme nga strategjia në Uhud, sepse çdo betejë ka rrethanat dhe zhvillimet e veta. Kështu ndodhi edhe me çështjet e tjera të jetës së kësaj bote në përgjithësi, e cila bazohet në ndryshim dhe zhvillim, si në metodat e bujqësisë, industrisë, ndërtimit, mjekësisë dhe të ngjashme.

8. Në ligjet e profetëve nuk ka legjislacion për mjekësinë praktike dhe mjetet e saj dhe ato që kanë ardhur për Isain *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* janë mrekulli që tregojnë për profetësinë e tij.

9. Mjekësia profetike duhet të jetë e kufizuar vetëm në atë që ka lidhje me adhurimin, si: lutjet, mbrojtjet dhe të ngjashme, sepse këto janë ligje me burim shpalljen, dhe janë një marrëdhënie dhe adhurim ndaj Allahut sipas asaj që Ai ka urdhëruar. Ndërsa trajtimi me ushqime, barna dhe bimë, i përket përvojës dhe praktikës.

---

[787] "*Fet'hu el Bari*", 10/77.

10. Është e tepërt të thuhet se barnat e përmendura në hadithe bëjnë mirë vetëm nëse përdoren me besim në dobinë e tyre, sepse kjo e largon mjekësinë nga natyra e saj si shkencë. Mjekësia është përpjekje për të kuptuar shkaqet universale që çojnë në largimin e sëmundjes dhe rikthimin e shëndetit dhe Allahu e ka vënë botën të funksionojë kryesisht sipas këtyre shkaqeve, pa marrë parasysh besimin e përdoruesit.[788]

11. Këto receta mjekësore janë receta të thjeshta, jo të ndërlikuara dhe jo të përziera, dhe janë të ngjashme me ushqimet e mjedisit arab, të cilat zakonisht janë të thjeshta dhe me pak përbërës. Mjekimi me to ishte një kulturë arabe e përhapur në atë epokë dhe ishte e pranishme në mjedisin arab në shkretëtirën e Hixhazit dhe në mjedise të ngjashme, si në vendet e Nexhdit dhe shkretëtirën e Irakut dhe të Shamit. Ata i njihnin këto receta, i trashëgonin dhe përdornin për trajtim si mjekësi eksperimentale dhe jo si mjekësi profetike. Madje ata zakonisht nuk e dinin për ekzistencën e këtyre haditheve për mjekësinë dhe nuk i përcillnin ato, për shkak të analfabetizmit të gjerë midis tyre.

Një shembull i kësaj është trajtimi me urinën dhe qumështin e deveve, që është një kulturë mjekësore *beduine* e njohur në vendet arabe edhe sot, dhe përdoret për trajtimin e sëmundjeve të brendshme jo duke u mbështetur në hadithe, por në përvojën dhe praktikën. Ata përzien qumështin e deveve me pak urinë të një deveje të virgjër dhe e quajnë atë "vezr", një recetë e përshtatshme për mjedisin beduin, dhe prandaj Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e udhëzoi këtë për arabët nomadë, por nuk ia përmendi këtë njerëzve të Medinës. Kur një burrë iu ankua Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* se vëllai i tij kishte dhimbje barku, ai e udhëzoi atë të përdor mjaltin, që është mjekësi qytetare. Prandaj nuk dihet që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të jetë trajtuar me qumësht dhe urinë deveje, as që ka udhëzuar dikë nga shokët e tij për këtë, dhe kjo është përmendur vetëm në hadithin e beduinëve, sepse ata janë arabë nomadë dhe kjo recetë u përshtatej më shumë atyre në mjedisin e tyre shkretëtire ku jetonin.

[788] "*Fikhu el Tibbi el Nebevijj*", *64.*

Prandaj, nuk është e saktë të quhen të gjitha hadithet për mjekësi si mjekësi profetike, sepse duke i lidhur ato me profetësinë nënkuptohet se burimi i tyre është shpallja, ndërsa burimi i shumicës së tyre është përvoja njerëzore dhe kultura e mjedisit, që sot quhet mjekësi popullore.

12. Nëse ka ndodhur një farë zgjerimi, tejkalimi dhe interpretimi i tepruar në atë që quhet "mrekullia shkencore" në Kuran dhe Synet, ku kuptimet e teksteve u kthyen nga një thirrje që i drejtohet natyrës së shëndoshë njerëzore për të mediturar ku krijesat tregojnë qartë për madhështinë e Krijuesit të tyre dhe nëpërmjet së cilës realizohet argumenti sipas perceptimit të përbashkët njerëzor "***Ky është krijimi i Allahut! Më tregoni çfarë kanë krijuar të tjerët pos Tij?***" (Lukman: 11) Këto tekste u kthyen dhe u interpretuan si mrekulli të shkencës së astronomisë, embriologjisë dhe biologjisë, të cilat mund të kuptohen vetëm në laboratorë, observatorë dhe kompjuterë.

Ky zgjerim i tepërt është edhe më i madh në atë që quhet "mrekullia shkencore" në mjekësinë profetike, por këtu u përzie edhe një e keqe tjetër serioze, që është dëshira për fitim dhe tregti, dhe shfrytëzimi i fesë për interesa botërore, duke përgatitur receta, preparate dhe përzierje që paraqiten si pjesë e mjekësisë profetike. Madje, hapet edhe dera për mashtrime dhe trillime, si pretendimi për zbulimin e barnave profetike për sëmundje të rënda si kanceri dhe AIDS-i, dhe pretendimi se kompanitë farmaceutike luftojnë mjekësinë profetike, që ky "zbulim" të mbetet sekret dhe t'i njohin vetëm ata që e tregtojnë këtë mashtrim në emër të mjekësisë profetike.

I Dërguari dhe udhëheqja[789]

Udhëheqja është aftësia për të arritur qëllimet nëpërmjet fitimit të zemrave të njerëzve dhe bindjes së tyre për të përqafuar një vizion të caktuar, si dhe nxitjes së tyre për të dhënë maksimumin me besim dhe entuziazëm për realizimin e tyre. Ky përshkrim i

[789] Shiko: "*El Kijadetu ve Etheruha fi Kesbi el Velai"*, dr. Fejsal Xhasim Al Thani, "*Kijadetu el Resuli el Sijasijeti ve el Askerijeti"*, Ahmed Ratib Armush.

udhëheqjes përmbushet në mënyrë të përsosur në udhëheqjen profetike. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* fitoi zemrat e shokëve të tij - ai ishte njeriu më i dashur për ta - dhe i bindi ata për fenë dhe shpalljen e tij, duke arritur një bindje të thellë besimi tek Mesazhi dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai i motivoi ata që të përkushtohen me zell dhe përkushtim të plotë për hir të Mesazhit dhe kështu u arrit arritja më e madhe: përçimi i shpalljes dhe hyrja e njerëzve në fenë e Allahut në grupe.

Të gjithë përbërësit, cilësitë dhe detyrat e udhëheqjes u bashkuan në personalitetin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Udhëheqja ishte një nga funksionet e tij dhe një nga aspektet dalluese të personalitetit të tij, që përfshihej në funksionin e tij më të lartë - përçimi i shpalljes nga Allahu tek robërit e Tij. Udhëheqja e njerëzimit ishte një ndër mjetet për realizimin e kësaj shpalljeje, për përmbushjen e misionit dhe për shpëtimin dhe lumturimin e njerëzimit - jo një udhëheqje e dominimit dhe ngritjes mbi tokë.

Prandaj, Pejgamberi fisnik *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ruajti moralin e tij të lartë edhe kur i gjithë Gadishulli Arabik iu nënshtrua dhe kur mbretërit e prijësit i shtrinë dorën e bindjes, ashtu siç ishte kur ishte në Mekë, me shokët e tij pakicë të dobët. As forca, as fitorja nuk ia shtuan asgjë tjetër veçse përulësi, afërsi, mëshirë dhe mirësi.

Prandaj, nuk është e drejtë të krahasohet udhëheqja dhe prijatarët e tij me udhëheqjet e prijësve të mëdhenj, mbretërve dhe perandorëve, për të cilët udhëheqja ishte ambicia më e madhe dhe dëshira më e zjarrtë, dhe kualifikimet e tyre për të ishin aftësitë e tyre personale. Ndërsa prijësia e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, megjithëse ai zotëronte aftësi të jashtëzakonshme dhe dhunti të mëdha, kualifikimi i tij kryesor ishte shpallja hyjnore që iu zbrit atij dhe mesazhi me të cilin u dërgua, si dhe përkrahja hyjnore që e shoqëronte. Prandaj, udhëheqja e tij ishte udhëheqje drejt lumturisë, përfshirje e njerëzve me dashuri dhe shpëtim për ta nga shkatërrimi - pa zgjedhur për vete ndonjë përfitim dhe pa kërkuar prej tyre shpërblim.

Kur e shikojmë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* si udhëheqës, në të vërtetë shikojmë një prej anëve madhështore të personalitetit të tij, i cili përbëhet nga një bashkësi cilësish dhe aftësish që e karakterizonin atë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, dhe që bënë që shokët e tij të bashkohen rreth tij, pavarësisht dallimeve të tyre në fise, vende apo moshë. Ata i bashkoi besimi në të, dashuria për të dhe bindja e patundur për vërtetësinë e shpalljes së tij dhe për obligimin për ta ndjekur dhe për t'iu bindur. Kështu, të gjithë së bashku u bënë si një trup i vetëm me lëvizje të harmonizuara dhe udhëheqja profetike ishte si një shpirt ndriçues që i bashkonte dhe i harmonizonte.

Kur përshkruajmë cilësitë udhëheqëse të Pejgamberit, sal Allahu alejhi ve selem, na shfaqen pamje ndriçuese, prej të cilave janë:

Së pari: Qartësia e idesë dhe qëllimit

Thirrja e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte plotësisht e qartë dhe pa asnjë paqartësi — e kuptueshme për beduinin dhe analfabetin ashtu siç e kuptonte njeriu i ditur dhe me njohuri. Për këtë arsye, Xhafer ibn Ebi Talibi, si besimtar në këtë thirrje, ia shpjegoi atë Nexhashiut në mënyrë të qartë, ashtu siç ia shpjegoi edhe Ebu Sufjani - ndonëse jobesimtar - Herakliut, për shkak të qartësisë së saj të madhe.

Po kështu, kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e dërgoi Muadhin në Jemen për të thirrur Ithtarët e Librit, ia përcaktoi qartë pikat kryesore, pa asnjë paqartësi apo konfuzion: *"Ti po shkon te një popull që janë Ithtarë të Librit. Prandaj, thirrja e parë le të jetë që të adhurojnë Allahun. Nëse e njohin Allahun, atëherë njoftoji se Allahu ua ka bërë obligim pesë falje gjatë ditës dhe natës. Nëse ata e bëjnë këtë, atëherë njoftoji se Allahu ua ka bërë obligim zekatin nga pasuria e tyre, për t'iu dhënë të varfërve të tyre. Nëse e pranojnë këtë, atëherë merre prej tyre, por mos merr pasurinë më të mirë të njerëzve."*[790]

[790] Buhariu, 1458. Muslimi, 19

Përmbajtja e kësaj thirrjeje është shumë fisnike. Asaj i përgjigjet çdo njeri me natyrë të shëndoshë dhe afron rreth vetes mendjet e arsyeshme.

Ashtu siç ishte thirrja e tij e qartë dhe e ndritshme, edhe qëllimi i saj ishte i qartë dhe madhështor — një qëllim përballë të cilit zbehen të gjitha qëllimet e kësaj bote, tokësore dhe kalimtare: është shpërblimi në botën tjetër, në shtëpinë e përjetshme. Këtë premtim e vuri përherë para syve të pasuesve të tij. Kjo duket qartë në besëlidhjen e dytë të Akabes, kur i tha Ensarëve: *"Nëse i përmbaheni kësaj besëlidhje, ju keni Xhenetin."*[791] Dhe nuk u premtoi diçka tjetër.

Së dyti: Nxitja për marrje e detyrave përsipër

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte mënyra të ndryshme për të motivuar njerëzit, në përputhje me situatën dhe gjendjen. Një shembull i kësaj është edhe nxitja pak para betejës së Bedrit: *"Askush të mos bëjë ndonjë veprim apo të afrohet me armikun para meje!"* Kur u afruan idhujtarët, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u tha shokëve të tij: *"Ngrihuni drejt Xhenetit, gjerësia e të cilit është sa qiejt dhe toka."*

Atëherë Umejr ibn el Humam el Ensariu tha: "O i Dërguar i Allahut, një Xhenet gjerësia e të cilit është sa qiejt dhe toka?!" Tha: *"Po!"* Ai tha: "Bakh! Bakh!" I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: *"Çfarë të shtyu të thuash: "Bukur! Bukur!?"* Ai u përgjigj: "Pasha Allahun, o i Dërguar i Allahut, nuk më shtyu asgjë tjetër veçse dëshira që të jem nga banorët e tij." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Ti je nga banorët e tij."* Pastaj Umejri nxori disa hurma nga çanta e tij dhe filloi të hante. Më pas tha: *"Nëse do të jetoj derisa t'i ha këto hurma, atëherë kjo do të jetë një jetë shumë e gjatë!"* I hodhi tutje hurmat që kishte me vete dhe u fut në betejë derisa u vra.[792]

Ditën e Uhudit, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori një shpatë në dorë dhe tha: *"Kush do ta marrë këtë*

[791] Ahmedi, 22754.
[792] Muslimi, 1901.

shpatë?" Disa njerëz u afruan për ta marrë dhe e shikonin atë, por ai tha: "*Kush do ta marrë dhe t'i japë hakun?"* Atëherë, njerëzit u tërhoqën, derisa u ngrit Ebu Duxhane, Simak ibn Harsheh, dhe tha: "Unë do ta marr dhe do t'ia jap hakun!" E mori shpatën dhe filloi të godiste kokat e idhujtarëve.[793]

Ky motivim para betejës ishte një forcë shtytëse për të tërë ushtrinë dhe prandaj u shfaq ndikimi i tij në reagimin e Ebu Duxhanes, Umejr ibn el Humamit dhe të tjerëve.

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, gjithashtu, dikë e motivonte duke i dhënë diçka, dikë tjetër e motivonte duke e lavdëruar dhe dikë tjetër duke e ngarkuar me një përgjegjësi. Amr ibn Teglib rrëfen se të Dërguarit të Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i erdhi një sasi pasurie të cilën e shpërndau, dikujt i dha dhe dikujt nuk i dha gjë. Pastaj ai mori vesh se ata që nuk u dha gjë u mërzitën. Kështu që ai lavdëroi Allahun dhe e falënderoi Atë, pastaj tha: "*E më pas: Pasha Allahun! Unë dikujt i jap dhe dikujt tjetër nuk i jap, por ai që nuk i jap është më i dashur për mua se ai që i jap. Unë i jap disa njerëzve që shoh se në zemrat e tyre ka dobësi dhe lakmi, ndërsa të tjerët i lë sepse Allahu ka vendosur në zemrat e tyre pasuri dhe mbështetje. Dhe një prej këtyre është Amr ibn Teglib."* Amri thotë: "Pasha Allahun! Nuk do ta ndërroja këtë fjalë të të Dërguarit të Allahut, sal Allahu alejhi ve selem, edhe sikur të më jepnin pasurinë më të mirë (devetë e kuqe)."[794]

Po ashtu, ai motivonte njerëzit me aftësi dhe i nxiste ata të shprehnin talentin e tyre. Ubej ibn Ka'b tregon se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i ka thënë: "O Ebu Mundhir! A e di cili është ajeti më madhështor nga Libri i Allahut që ke me vete?" I thashë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!" Ai përsëriti: "*O Ebu Mundhir! A e di cili është ajeti më madhështor nga Libri i Allahut që ke me vete?"* I thashë: "***Allahu la ilahe il-la huvel Hajjul Kajumu...***" Atëherë më ra në kraharor dhe tha: "*Pasha Allahun! Përgëzime për diturinë, o Ebu Mundhir!"*[795]

[793] Muslimi, 2470.
[794] Buhariu, 923.
[795] Muslimi, 810.

Metodat profetike të motivimit i vendosën shokët e tij në gjendje mobilizimi të plotë, madje në një garë, një nxitim dhe konkurrencë për punë të mira.

Së treti: Urtësia në marrjen e vendimeve

Urtësia dhe pjekuria në marrjen e vendimeve, si dhe menaxhimi i mirë i situatave, janë ndër domosdoshmëritë e udhëheqjes dhe ndër cilësitë më të rëndësishme të një udhëheqësi. Kjo shfaqet qartë në shumë prej qëndrimeve profetike:

1. Në Marrëveshjen e Hudejbijes, ai pranoi të tërhiqej nga shumë kërkesa, derisa marrëveshja u arrit. Ai nuk u ndal te ngulmimi dhe kokëfortësia e përfaqësuesit të kurejshëve, i cili refuzonte të shkruhet: "***Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim***" (Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit), kështu që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Shkruaj: Bismike Allahume (Me emrin Tënd, o Allah).*" Po ashtu, kur ai shkroi: "*Muhamedi, i Dërguari i Allahut*", përfaqësuesi i kurejshëve tha: "Shkruaj emrin tënd dhe emrin e babait tënd", atëherë Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, pranoi, sepse kjo i kënaqte ata dhe nuk i bënte dëm atij. Kështu u arrit marrëveshja, e cila rezultoi të ishte një fitore e qartë.[796]

2. Ndalimi i vrasjes së kryetarit të hipokritëve, Abdullah ibn Ubejj ibn Selulit, pavarësisht dëmit të madh dhe dredhive që ai i shkaktoi. Ky ndalim u bë që të mos tronditen ndjenjat e Ensarëve dhe që të mos flitet: "*Muhamedi vret shokët e tij*."[797]

3. Angazhimi me udhëtimin e lodhshëm që të mos i lihet hapësirë përhapjes së shpifjes që u bë, në mënyrë që t'i shmangte bisedat që nxisnin përçarje dhe përhapjen e fjalëve[798] që krijojnë trazira. Me këtë, ai parandaloi fitnen dhe e kufizoi ndikimin e saj.

Kur i vështrojmë sot veprimet e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, nuk gjejmë asnjë veprim që ai e bëri dhe që ndonjë tjetër të kishte qenë më i përshtatshëm, as ndonjë fjalë që ai e tha dhe që një tjetër të kishte qenë më e mirë se ajo. Të gjitha veprimet,

[796] Buhariu, 2731. Muslimi, 1748.
[797] Buhariu, 3518. Muslimi, 2584.
[798] "*Siretu Ibn Hisham*", 2/291.

fjalët dhe menaxhimi i situatave nga ana e tij ishin vetë urtësia dhe vendimi më i përshtatshëm për ato rrethana.

Së katërti: Planifikimi i mirë

Kjo cilësi u shfaq qartë në planifikimin e betejave, menaxhimin e situatave dhe pritjen e delegacioneve. Një shembull i kësaj është ajo që bëri në betejën e Uhudit, ku mushrikët (idhujtarët) kishin zënë pozicion përballë qytetit të Medinës, duke pritur që i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të vinte drejt tyre. Kur u gdhi dita, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u tha shokëve të tij: *"Kush na gjen një rrugë që na nxjerrë pas armikut dhe jo përballë tyre?"*[799] Kështu që ata kaluan përmes palmave të fisit Benu Harithah derisa dolën nga ana tjetër e kodrës së shigjetarëve dhe i befasuan armiqtë nga prapa. Ata nuk e prisnin fare këtë lëvizje, gjë që çoi në çorientimin e planit të tyre, i cili ishte ndërtuar mbi supozimin se do të përballeshin ballë për ballë.

Përpara fillimit të betejës, ai vendosi një grup prej 50 shigjetarësh mbi kodrën e shigjetarëve dhe në krye të tyre emëroi Abdullah ibn Xhubejrin. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u tha: *"Mos u largoni nga kodra derisa t'u dërgoj lajm, edhe nëse na shihni duke na shqyer shpendët! Mos u largoni nga kodra derisa t'u dërgoj lajm, edhe nëse na shihni se i mundëm armiqtë dhe po i shkelim me këmbë!"*[800] Kështu, ai e siguroi krahun e pasmë të ushtrisë dhe e kufizoi betejën në një luginë të ngushtë, duke reduktuar kështu efektin e shumicës së madhe të idhujtarëve. Kjo strategji çoi në fitoren fillestare të muslimanëve, derisa armiku u thye dhe flamuri i tyre ra. Por, kur shigjetarët shkelën urdhrin dhe zbritën nga kodra, u hap një boshllëk në mbrojtje, përmes të cilit depërtuan kalorësit e armikut dhe përmbysën rrjedhën e betejës dhe rezultatin e saj.

Po ashtu, në betejën e Ahzabit, ai befasoi kurejshët me një lëvizje që ata nuk e kishin menduar: gërmimin e një Hendeku rreth Medinës. Kjo ishte një surprizë që prishi planin e tyre dhe bëri që

[799] *"Siretu Ibn Hisham"*, 2/65.
[800] Ebu Davudi, 2662.

aleanca e tyre e madhe të mos kishte efekt, duke u kthyer atë në barrë për ta vetë.

Së pesti: Menaxhimi i krizave

Kjo bëhet përmes qëndrueshmërisë, durimit, veprimit të kujdesshëm gjatë menaxhimit të krizave dhe kapërcimit me paqe. Një shembull i tillë është menaxhimi i situatës pas betejës së Uhudit, ku i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i nxiti muslimanët që të ndjekin ushtrinë e mushrikëve në Hamra el Esed. Ky veprim krijoi frikë dhe terror te mushrikët, të cilët ndjenë se muslimanët ishin ende të motivuar dhe të vendosur për të luftuar.

Po ashtu, menaxhimi i situatës gjatë betejës së Hendekut, në një çast të vështirë dhe të tmerrshëm ku sytë humbën shikimin dhe zemrat arritën në fyt. Pjesëmarrja e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në procesin e hapjes së hendekut krah për krah me shokët e tij u dha forcë dhe përkrahje zemërgjerë. Ata e panë atë duke bartur dhe mbi supet e tij derisa trupi i tij ishte mbuluar nga pluhuri. Në gjithë këtë vështirësi tek ai shihnin shpresën e fuqishme dhe përgëzimin që jepte për ardhjen e fitores.

Së gjashti: Vëmendja dhe parapërgatitja

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte jashtëzakonisht i kujdesshëm dhe vigjilent, dhe kishte agjentë që i sjellin lajme, si dhe skuadra të fshehta që vëzhgojnë lëvizjet e armiqve dhe i sjellin informacion rreth tyre. Në vitin e parë të Hixhretit, ai dërgoi një skuadër nën drejtimin e Abdullah bin Xhahsh dhe i dha një letër, duke i urdhëruar ta hapë vetëm pas dy ditësh udhëtimi. Kur Abdullah udhëtoi për dy ditë dhe hapi letrën, aty gjeti: "Kur të lexosh këtë letër, vazhdo derisa të arrish te hurmat midis Mekes dhe Taifit, pastaj qëndro aty dhe vëzhgo lëvizjet e kurejshëve dhe na dërgo lajme rreth tyre."[801] Ky ishte një mision vëzhgimi i vëmendshëm për të njohur nga afër gjendjen e armikut.

[801] "*Siretu Ibn Hisham*", 1/602.

Kur karvani i Ebu Sufjanit u kthye nga Siria, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dërgoi një njeri për të marrë lajme rreth tyre. Enes ibn Maliku rrëfen: "I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dërgoi një njeri të quajtur Busejsa për të parë çfarë kishte bërë karvani i Ebu Sufjanit. Kur ai erdhi, në shtëpi nuk ishte askush përveç meje dhe të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai i tregoi lajmet, pastaj i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli dhe thirri: "*Ne po dalim për një kërkesë, prandaj kush të ketë mjet udhëtimi gati le të dalë me ne.*" Disa njerëz kërkuan leje për t'u bashkuar në dalje të qytetit, por i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Jo, vetëm kush të ketë mjetin gati tani.*" Më pas ai dhe shokët e tij u nisën për në Bedër dhe mbërritën para mushrikëve.[802]

Kur kurejshët u përgatitën për të shkuar në betejën e Uhudit, të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i edhi një letër nga Abasi para se të niseshin mushrikët, ku e informonte për lëvizjet e tyre, numrin dhe përgatitjet. Po ashtu, i erdhën lajmet për lëvizjet e Kurejshëve dhe aleatëve të tyre para betejës së Ahzabit, gjë që i mundësoi të merrte masat e duhura dhe të hapnin hendekun para ardhjes së tyre.[803]

Së shtati: Zgjedhja e personave të aftë

Kjo duket në zgjedhjen e personave të përshtatshëm për detyrat, ku secilit i jepet përgjegjësia që i përshtatet dhe ai ka aftësi dhe shkathtësi për ta kryer atë. Ka shumë shembuj për këtë, si:

Hudhejfe *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Ne kemi qenë me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* natën e betejë së Ahzabit dhe na mori një erë e fortë dhe e ftohtë. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Kush më sjellë lajm* (informacion) *rreth armiqve? Allahu e bëftë shok me mua Ditën e Ringjalljes!*" Ne të gjithë heshtëm dhe askush nuk u përgjigj.

[802] Muslimi, 1901.
[803] Shiko kapitullin "*El Resul ve el Shuxha'a*".

Atëherë tha: *"Ngrihu, o Hudhejfe, dhe më sill lajmet e tyre, dhe kujdes mos tërhiq vëmendjen*[804] *e tyre."*

Hudhejfe ishte një djalë i ri i guximshëm dhe kujdesshëm, prandaj hyri me vendosmëri mes tyre dhe përmbushi urdhrin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pa tërhequr vëmendjen e tyre.

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dinte të zgjidhte personat e aftë dhe të ndante përgjegjësitë; ai zgjidhte njerëz me aftësi nga shokët e tij dhe ua jepte kompetencat. Ai dërgoi Muadhin si guvernator dhe mësues në Jemen kur ai ishte i ri. Caktoi Usamën komandant në krye të ushtrisë, ku ishte Ebu Bekri dhe Umeri, edhe pse ishte ende i ri. I besoi komandën Amr bin el Asit dhe Halid bin Velidit menjëherë pas hyrjes së tyre në Islam. Nuk ka ndonjë transmetim se ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zgjodhi Ebu Dherr el Gifarin, Bilalin apo Ibn Mes'udin, edhe pse kishin shumë vlera dhe kishin kohë që kishin hyrë në Islam, sepse secilit i jepte detyrën që i përshtatej talentit dhe aftësive të tij.

Përmes këtyre detyrave që u ngarkoi, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përgatiti lidershipin e ardhshëm që do të merrte përgjegjësinë pas tij dhe do të udhëhiqte pas vdekjes së tij.

Së teti: Konsultimi (Shura)

Allahu i Madhërishëm e urdhëroi Pejgamberin e Tij të konsultohet me shokët e tij: ***"Këshillohu me ata për çështje të ndryshme."*** (Ali Imran: 159)

Ebu Hurejre thotë: "Nuk kam parë askënd që të konsultohet më shumë me shokët e tij se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*."[805]

Konsultimi është një mënyrë për t'i bërë ata pjesëmarrës në vendim dhe për t'i bërë bashkëpërgjegjës në atë vendim.

[804] Shiko "*Sherh el Nevevij ala Muslim*", 12/145.
[805] Ahmedi, 18928.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u konsultua me shokët e tij në shumë raste:

Shembulli në Bedër: Kur po nisej për në betejën e Bedrit dhe u informua për daljen e Kurejshëve për luftë, ai u konsultua me shokët e tij dhe tha: *"Çfarë mendoni, o njerëz?"*

Atëherë u ngrit Ebu Bekri, dha një mendim të mirë, pastaj u ngrit Umeri dhe dha një mendim të mirë, pastaj u ngrit Mikdad bin Amri dhe, gjithashtu, dha një mendim të mirë. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, në fakt, po kërkonte mendimin e ensarëve, sepse ata ishin shumica. Ai kishte frikë që ensarët mund të mendonin se ndihma ndaj tij është vetëm në Medinë dhe nuk duhet të ecnin me të kundër armikut jashtë vendit të tyre. Pastaj u ngrit Sead ibn Muadhi nga ensarët dhe tha: "... Vërtet Allahu do të tregojë nga ne atë që do të kënaqë syrin tënd. Le të nisemi me bekimin e Allahut!"

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u gëzua me këtë përgjigje, sepse kjo tregonte se ata ishin para një udhëheqësi të madh që po fliste me drejtues kompetentë, me krenari, besim të fortë dhe siguri në premtimin e Allahut, pavarësisht nga kufizimet materiale që kishin në atë kohë. Kështu u unifikua qëndrimi i tyre, u bashkuan fjalët e tyre dhe ndjenë se ishin pjesëmarrës në mendim dhe konsultim.

Nëse dikush nuk do të kishte arsye të konsultohej, ai do të ishte i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, të cilit i vjen shpallje nga qielli. Megjithatë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zhvillonte këtë dialog të bukur dhe të lartë, për të marrë mendimet e udhëheqësve që ka me vete dhe për të siguruar njohjen e të gjitha pikëpamjeve nga grupet e ndryshme.

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u nis dhe arriti te "ujërat më të afërta të Bedrit", u ndal aty, por Hababi i tha: "O i Dërguar i Allahut, ky nuk është vend i përshtatshëm për të ndaluar, prandaj të ngrihemi dhe t'i lëmë të gjitha burimet[806] pas shpinës tonë."

[806] Shiko "*El Nihajetu*", 4/98.

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Ke dhënë mendimin e duhur.*" - dhe kështu veproi.[807]

Shembulli në Uhud: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u konsultua me shokët para betejës së Uhudit. Nga Urve bin Zubejri transmetohet se ka përmendur ngjarjen e Uhudit dhe sinjalizimin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të qëndruar në Medinë, por shumë njerëz refuzuan dhe donin të dilnin për t'u përballur me armikun. Kur i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* fali namazin e xhumasë, i foli njerëzve, i përkujtoi dhe i urdhëroi për qëndresë dhe vendosmëri të madhe. Disa prej njerëzve më të mençur kur e panë këtë, thanë: "O Pejgamber i Allahut, a të qëndrojmë këtu, ashtu siç urdhërove ti?"

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Nuk i shkon një Pejgamberi, të kthehet pa luftuar, pasi të ketë veshur rrobat për të luftuar dhe pasi i ka përgatitur njerëzit për të dalë përballë armikut. Unë ju ftova të qëndrojmë, por ju nuk pranuat të qëndroni pa dalë, prandaj keni drojë Allahun, qëndroni kur të takoni armikun dhe mbani mend mirë dhe veproni atë që ju kam urdhëruar.*"[808]

Pastaj i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli së bashku me muslimanët.

Këtu vërejmë se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte një mendim që ua prezantoi atyre, që ishte të mos dilnin, por kur pa se shumica donin të dilnin, u tërhoq nga mendimi i tij dhe u pajtua me mendimin e tyre, veshi rrobat, mori armët dhe doli me ta. Kur ata u tërhoqën nga mendimi i tyre, ai nuk u tërhoq nga mendimi i vet, sepse udhëheqësi nuk duhet të hezitojë dhe të ketë shumë ndryshime, por duhet të ketë vendosmëri dhe qëndrueshmëri. Konsultimit ia dha vendin e vet dhe tani erdhi koha e vendosmërisë, siç tha Allahu i Madhërishëm: ***"Këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai."*** (Ali Imran: 159)

---

[807] "*El Mustedrek*", 5801.

[808] El Bejhakiu në "*El Sunen el Kubra*", 13281.

Pas goditjes në Uhud, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ua përmendi njerëzve mendimin e tij për të mos dalë në luftë, nuk i qortoi ata që patën idenë të dilnin, dhe as nuk u bëri asnjë vërejtje, sepse vendimi u mor në mënyrë kolektive dhe të gjithë së bashku ndajnë përgjegjësinë.

Së nënti: Guximi

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte trim dhe guximtar, ecte në krye të ushtrisë, merrte pjesë vetë në beteja dhe luftoi përkrah me shokët e tij, të cilët kërkonin mbrojtje pranë tij kur beteja bëhej e ashpër. Allahu i Madhërishëm i kishte dhënë atij forcë, fuqi dhe guxim të madh. Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Pasha Allahun! Kur lufta bëhej e egër, ne mbroheshim pas tij, dhe më guximshmi prej nesh mund të qëndronte vetëm përkrah, Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e jo të dilte para tij."[809]

Së dhjeti: Ndershmëria dhe besueshmëria

Kjo është cilësia që ia njohën armiqtë para shokëve dhe që krijon besim ndaj udhëheqësit dhe i jep çdo fjale të tij peshë dhe besueshmëri të lartë në zemrat e ndjekësve. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte këtë përkryerje në maksimum; para se të nisë misionin, ai njihej si "i ndershmi dhe i besuari".

Së njëmbëdhjeti: Falja dhe përfshirja

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i jepte përparësi maturisë dhe butësisë, faljes dhe mëshirës sa më shumë që mundej. Me këtë ai përfshiu armiqtë, shoi armiqësitë dhe bashkoi zemrat. Ai ishte më afër faljes dhe durimit sesa ndëshkimit. Dëshmi për këtë ka shumë:

[809] Buhariu, 4317. Muslimi, 1776.

Ai refuzoi shkatërrimin e popullin të tij kur i erdhi Meleku i maleve dhe po priste urdhrin e tij që t'i shembte dy malet mbi ta, por ai e shtyu dënimin me shpresë se Allahu do t'i udhëzojë ata ose pasardhësit e tyre në Islam.[810]

Po ashtu, falja dhe mëshira që tregoi kur çliroi Mekën, pavarësisht krimeve që banorët e Mekës kishin bërë ndaj tij dhe ndaj muslimanëve, ai i fali dhe nuk i ndëshkoi.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha politeistëve ditën e çlirimit të Mekës: *"Çfarë mendoni se do të bëj me ju?"* Ata thanë: "Mirë, është një vëlla fisnik dhe biri i një vëllai fisnik." Ai tha: *"Shkoni! Jeni të lirë."*[811]

Kështu ata përqafuan Islamin dhe u bënë ushtria e Islamit dhe pasuesit e tij.

Ai miqësoi edhe ata që ishin armiqtë dhe luftëtarët më të egër të tij.

Së dymbëdhjeti: Ruajtja e pozitës së udhëheqësve dhe fisnikëve

Një shembull i kësaj ishte përfshirja dhe miqësimi i tyre duke ruajtur udhëheqjen e secilit prej tyre. Ai i la të gjithë udhëheqësit në vendet e tyre dhe i miqësoi me dhurata, pa lejuar që dikush të humbiste pozitën e tij për shkak të përqafimit të Islamit. Ai mbylli armiqësitë e mëparshme që kishin mes tyre.

Ebu Hurejre tregon se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ditën e çlirimit të Mekës tha: *"Kush mbyllet në shtëpinë e tij është i sigurt dhe kush hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit është i sigurt."*[812]

Këtë e bëri për t'i dhënë Ebu Sufjanit një pozitë të veçantë dhe krenari për pozitën dhe vendin e tij në Mekë, dhe kështu ata ndjenë se ruanin vendin dhe pushtetin e tyre me të. Me fitimin e udhëheqësve, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* fitoi edhe ndjekësit dhe bashkëpunëtorët e tyre.

---

[810] Buhariu, 3231. Muslimi, 1795.

[811] *"Siretu Ibn Hisham"*, 2/412. *"Tarijhu el Tabari"*, 2/161. *"Zadu el Mead"*, 3/307-309. *"El Bidajetu ve el Nihajetu"*, 6/567-568.

[812] Muslimi, 1780.

Së trembëdhjeti: Fitimi i zemrave të njerëzve dhe përmbushja e nevojave të tyre

Mënyra si Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i trajtonte njerëzit ndezte dashurinë në zemrat e tyre dhe hapte dyert e tyre, saqë ai u bë më i dashur për ta se vetja e tyre. Ai kombinonte sjelljen e mirë dhe dashamirësinë me përpjekjen për të plotësuar nevojat e tyre dhe për t'iu përgjigjur kërkesave me bujari dhe zemërgjerësi.

Nga Ebu Said el Hudri transmetohet se disa nga ensarët i kërkuan Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të),* dhe ai ua dha; pastaj i kërkuan përsëri, dhe ai ua dha, edhe një herë i kërkuan dhe ai ua dha derisa u shterua ajo që kishte. Pastaj tha: *"Nëse kam diçka, kurrë nuk do ta kursej për ju! Kush mundohet të mos shtrijë dorën, Allahu do ta furnizojë; kush mundohet të vetëmjaftohet, Allahu do ta mjaftojë; kush mundohet të durojë, Allahu do t'i japë durim. Nuk ka dhuratë më të mirë dhe më të bollshme se durimi."*[813]

Këtu shihet se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dha me shumë zemër, pastaj dha përsëri, pastaj dha përsëri, pastaj sqaroi se nuk do të kursehet për ta, pastaj këshilloi për durim të mirë. Përkushtimi ndaj nevojave të njerëzve dhe ndihma ndaj tyre janë nga detyrat më të rëndësishme të udhëheqjes dhe përgjegjësive të saj.

Ai thoshte: *"Kush lë pas pasuri apo dikë që ka nevojë për përkujdesje, atëherë ajo i takon trashëgimtarëve të tij. E kush lë pas borxh apo nevojë* (varfëri)*, atë e marr përsipër unë. Unë jam më i afërt me çdo musliman se vetvetja e tij."*[814]

Kështu Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përfshiu zemrat dhe mendjet dhe udhëhoqi njerëzit me ndjenja dhe bindje, sepse natyra njerëzore është e prirë të dojë atë që i bën mirë.

Gatishmëria për të ndihmuar të tjerët, kujdesi për çështjet e tyre dhe vëmendja ndaj shqetësimeve të tyre janë nga parimet më ndikuese të udhëheqjes dhe aq më shumë kur ato ofrohen si fe dhe adhurim ndaj Allahut të Madhëruar.

---

[813] Buhariu, 1469.
[814] Buhariu, 2399. Muslimi, 867.

Së katërmbëdhjeti: Vendosja e drejtësisë

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i përkushtuar ndaj drejtësisë dhe llogaridhënies së drejtë për të gjithë, pa dallim dhe pa privilegje. Një nga shembujt është qëndrimi i tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj ndërhyrjes së Usama bin Zejdit për një grua nga fisit Mehzum që vodhi. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e refuzoi atë ndërhyrje dhe u zemërua shumë dhe tha: *"Ata që ishin para jush u shkatërruan, sepse ndëshkimi zbatohej vetëm ndaj të dobëtëve dhe jo ndaj fisnikëve. Betohem në Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, sikur Fatimja, të vidhte, do t'ia prisja dorën."*[815]

Fisi Mehzum ishte nga fiset e mëdha dhe të nderuara të Mekës, me ndikim të madh në shoqëri dhe në fushën ushtarake; ata ishin dajat e Abdullahut, babait të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, dhe disa prej tyre ishin miqtë e tij, sepse nëna e besimtarëve, Umu Seleme *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, gruaja e Pejgamberit, është bija e tyre. Megjithatë, lidhjet e afërsisë dhe familjare nuk ndikuan në zbatimin e së drejtës, drejtësisë dhe ekzekutimin e ligjit.

Me vendosjen e drejtësisë dhe realizimin e së drejtës, njerëzit ndjeheshin të sigurt që të drejtat e tyre nuk do t'u cenoheshin ose monopolizoheshin nga të tjerët, dhe muslimanët si dhe ata që kishin marrëdhënie marrëveshjeje me ta ndjenë qetësinë dhe kënaqësinë. Madje, hebrenjtë thanë: "Kjo është e drejta me të cilën u ngritën qiejt dhe toka, ne jemi të kënaqur me të."

Së pesëmbëdhjeti: Shembulli i mirë

Vlerat dhe parimet që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i predikonte ishin të mishëruara në gjendjen dhe veprimet e tij dhe mënyra e tij e veprimit ishte më e përkryera. Prandaj, Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tha: *"Moral i tij ishte Kurani."*[816] Çdo udhëzim i Kuranit pasqyrohej në moralin e tij dhe,

[815] Buhariu, 3475. Muslimi, 1688.
[816] Muslimi, 746.

për këtë arsye, Allahu e bëri atë shembull për robërit e Tij, për shkak të përmbushjes së plotë të mësimeve të fesë në personalitetin dhe sjelljen e tij: "***Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.***" (El Ahzab: 21)

Zbatimi profetik ishte horizonti më i lartë që pasuesit e tij përpiqeshin ta arrinin, edhe nëse nuk e përmbushnin plotësisht.

Ky moral profetik që ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregonte si adhurim ndaj Allahut dhe bindje ndaj urdhrit të Tij, është njëkohësisht edhe një nga parimet themelore të udhëheqjes. Këto cilësi udhëheqëse dhe të tjera nga përsosmëria e personalitetit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e bënë atë një udhëheqës të jashtëzakonshëm, për të cilin historia nuk njeh një shembull të ngjashëm dhe nuk do të njohë. Ai udhëhoqi Umetin me dashuri, mbolli në zemrat e tyre bindjen e fuqishme të besimit, ngriti shikimin e tyre drejt qëllimeve më të larta dhe idealeve më fisnike, dhe realizoi me ta arritjet më të mëdha që njerëzimi i ka kryer në të gjithë historinë e tij të gjatë.

I Dërguari dhe njohja e realitetit

Njohja që kishte Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, për realitetin në kohën e tij ishte e gjerë dhe e vetëdijshme, megjithëse vendet ishin të largëta, komunikimi i dobët dhe përhapja e informacionit e vështirë. Megjithatë, ne shohim se njohja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për realitetin ishte e detajuar, gjithëpërfshirëse dhe e ndërgjegjshme.

Kjo shfaqet në disa aspekte, si njohja e tij për situatën politike të shteteve përreth, njohja e tij për fiset, individët, besimet, zakonet dhe mjedisin.

1. Sa i përket njohjes së tij për realitetin politik, kjo shfaqet qartë në dërgimin e sahabëve në Habeshe (Etiopi), ku ai e përshkroi mbretin e saj si një mbret të drejtë, te i cili njerëzve nuk u bëhet padrejtësi. Kur ata emigruan tek ai, gjetën drejtësi dhe siguri. Më

pas, kjo vetëdije u shfaq në letrat që i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i dërgoi mbretërve dhe udhëheqësve të viseve të ndryshme, si Kisra (mbreti i Persisë), Kajseri (Perandori Bizantin), Mukavkisi (sundimtari i Egjiptit), mbreti i Omanit dhe të tjerë.

2. Ndërsa sa i përket njohjes së tij për individët, kjo shfaqet në disa raste, si në hadithin e Ka'b ibn Malikut *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* kur ai erdhi me ensarët në vizitën e tyre të parë te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në Mekë, para Besëlidhjes së Akabes. Xhaxhai i tij, Abasi, po ia prezantonte ata Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe kur tha: "Ky është Ka'b ibn Maliku", Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pyeti: *"Poeti?"* Ka'bi rrëfen: "Nuk e harroj kurrë këtë fjalë të tij." *"Poeti"*[817].

Ka'bi atëherë ishte një i ri dhe poezia e tij nuk ishte ende e njohur gjerësisht, megjithatë lajmi dhe gjendja e tij kishin arritur te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Ndër shembujt e tjerë të njohjes së tij për individët është hadithi i Munkidh ibn Hajani, i cili ishte nga banorët e Xhuvathas në Bahrejn. Ai kishte tregtinë e tij në Jethrib në kohën e injorancës. Pas Hixhretit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai u nis drejt Medinës me disa mbulesa dhe hurma nga vendi i quajtur Hexher. Ndërsa Munkidhi po rrinte ulur, aty pranë kaloi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Munkidhi u ngrit për ta takuar dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"A je ti Munkidh ibn Hajan? Si është gjendja jote dhe ajo e popullit tënd?"* Pastaj e pyeti për fisnikët e fisit të tij një nga një, duke i përmendur me emër.[818]

Mund të imagjinosh ndjenjën e një të huaji që në vend të huaj gjen dikë që e pyet për vendlindjen dhe fisin e tij, dhe që njeh emrat e të afërmve dhe burrave të fshatit të tij! Munkidhi e përqafoi Islamin dhe më pas u kthye te populli i tij me mesazhin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ku i fton për në Islam, dhe ata e pranuan.

[817] Ahmedi, 15798.
[818] *Sherh el Nevevij ala Muslim,* 1/181.

3. Sa i përket njohjes së tij për fetë, ajo shfaqet qartë në bisedën që pati me Adij ibn Hatim. Kur Adij erdhi tek ai - e ai ishte i krishterë dhe kishte varur një kryq në qafë - Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia paraqiti Islamin. Adij tha: "Unë i përkas një feje." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Unë e njoh fenë tënde më mirë se ti vetë."* Adij u habit dhe pyeti: "Ti e njeh fenë time më mirë se unë?" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu përgjigj: *"Po. A nuk je ti një Rakusi?"* Ai tha: "Po." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pyeti: *"A nuk je ti udhëheqës i popullit tënd?"* Ai tha: "Po." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pyeti: *"A nuk merr ti një të katërtën e pasurisë së popullit tënd?"* Ai tha: "Po." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Po kjo nuk lejohet në fenë tënde!"* Adij thotë: "Kur i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha këtë, më erdhi turp prej vetes."[819]

Ai ia tërhoqi vëmendjen se ai po mbahej pas një feje, të cilën, në fakt, po e kundërshtonte në sjelljet e veta. Prandaj, Adij u habit nga njohuria e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për detaje të thella të fesë së tij dhe për faktin që ai e dinte se Adij po i shkelte ato.

4. Ndër shenjat e njohjes së tij për zakonet e popujve është edhe fjala e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: *"Desha të urdhëroj ndalimin e Gijles*[820] (marrëdhënia intime bashkëshortor gjatë gjidhënies), *por pashë se romakët dhe persët, e praktikojnë këtë dhe nuk dobësohen fëmijët e tyre."*[821]

Pra, ai vuri re se marrëdhënia intime bashkëshortore me gruan që ushqen me gji ishte një zakon i përhapur në Persi dhe Romë dhe se nuk u kishte shkaktuar dëm fëmijëve të tyre, prandaj ai hoqi dorë nga ndalimi i saj.

Po ashtu, kur i erdhi delegacioni i fisit Abdu el Kajs - që ishin nga zona e Hexherit, në lindje të Gadishullit Arabik - ata e pyetën për enët në të cilat fermentonin pijen e tyre. Ai tha: *"Po ju ndaloj nga katër*

[819] Ahmedi, 18260.
[820] *Gijle* quhet marrëdhënia bashkëshortore gjatë gjidhënies, si dhe shtatzënia gjatë saj (fëmija është në moshën e ushqyerjes me gji), *"El Nihajetu,* 3/402.
[821] Muslimi, 1442.

(lloje enësh).” Ata e pyetën: “Po ti nga e di se çfarë është el Nekijru?” Ai tha: *“El Nekijru është trung palme që është zgavruar, aty hidhen fruta ose hurma të thata dhe ujë, dhe kur fermentohet e ndalon zierjen, ju e pini.”*

Kjo tregon se ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i njihte zakonet e banorëve të lindjes së Gadishullit Arabik, megjithëse ai jetonte në skajin më perëndimor të tij.

5. Sa i përket njohjes së tij për mjedisin, një nga dëshmitë për këtë është përshkrimi i tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për grepat (çengela) që ndodhen mbi Xhehenem dhe që kapin banorët e zjarrit për t’i hedhur brenda. Ai tha: *“Në dy krahët e urës së Siratit ka grepa, kanxha dhe gjemba si boçë poshtë janë të sheshta sipër kanë gjemba me maje të kthyer pas si gjembat e bimës së quajtur Sa’dan që gjenden në rajonin e Nexhdit.”* Pastaj i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) pyeti*: *“A i keni parë ndonjëherë gjembat e Sa’danit?”* Ata thanë: “Po.” Ai tha: *“Janë si gjembat e Sa’danit, por askush nuk e di madhësinë e tyre përveç Allahut.”*[822] Gjembat e Sa’danit janë nga bimët e shkretëtirës.

Gjithashtu, kur përshkroi gjethet e *Sidretu el Munteha*, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *“Gjethet e saj janë si veshët e elefantëve.”*[823] Elefanti është një kafshë afrikane që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e kishte parë kurrë në jetën e tij, por e dinte përshkrimin e tij, dhe prandaj e përdori si krahasim për të treguar madhësinë e gjetheve të kësaj peme.

Dhe për çështjet e dijes që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk i dinte vetë, por kishte nevojë për to, ai i kërkonte ndihmë atyre që i zotëronin. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte analfabet, por rreth vetes kishte një grup shkruesish që shkruanin dhe lexonin për të. Numri i tyre arritën deri në 48 shkrues,[824] ata shkruanin Kuranin para tij, ajet pas ajeti, menjëherë pas shpalljes.

[822] Buhariu, 806. Muslimi, 182.
[823] Buhariu, 3887. Muslimi, 162.
[824] Shiko librin *“Kuttabu el Nebij”* të autorit Muhamed Mustafa el Eadhami.

Ai ngarkoi Zejd ibn Thabitin të mësonte gjuhën hebraike, që të ishte në gjendje të shkruante për hebrenjtë dhe të lexonte atë që ata shkruanin.[825]

6. Këtu shtrohet pyetja: A ishte burimi i kësaj dijeje (të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për realitetin) përvoja dhe vetëdija, apo e kishte nga shpallja hyjnore?

Ajo që shfaqet më qartë - Allahu e di më së miri - është se burimi i kësaj dijeje për realitetin ishte: saktësia në vëzhgim, fuqia e kujtesës dhe përdorimi i mirë i informacionit dhe përfitimi prej tij.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* jetonte në Mekë - një vend ku takoheshin fiset, një vend i Haxhit për njerëzit dhe një qendër për ta. Banimi në Mekë, takimi me vizitorët dhe vëzhgimi i gjendjes së tyre, dëgjimi me vëmendje i fjalëve të tyre - të gjitha këto ndihmonin për të bashkuar njohuri të shpërndara dhe për të afruar dijet e largëta.

Ajo që e përforcon këtë mendim është se kishte informacione të këtij lloji që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk i dinte dhe kërkonte ndihmë nga ata që i njihnin. Për shembull, ai nuk e dinte se mbretërit nuk i pranonin letrat pa vulë dhe kur e informuan shokët e tij për këtë, ai e bëri një unazë me të cilën vuloste letrat.[826]

Po ashtu, ai konsultohej me shokët e tij që kishin përvojë, për çështje që ai nuk i njihte. Kur ai takohej me fiset për t'i thirrur në Islam, ishte Ebu Bekri që e prezantonte me fiset dhe burrat e tyre.[827] Dhe kur u takua me delegacionin e ensarëve, ishte xhaxhai i tij, Abasi, që i prezantoi burrat e tyre, sepse ai i njihte prej vizitave të shpeshta në Medinë.[828]

Këto raste të pakta dhe të veçuara tregojnë se gjerësia e njohurive të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe njohja e tij për realitetin ishin rezultat i vetëdijes, vëzhgimit dhe aftësisë për të mbledhur dhe përdorur me mençuri informacionin.

---

[825] "*Xhamiu el Tirmidhi*", 2715.
[826] Buhariu, 2938. Muslimi, 2092.
[827] "*Tarihu Dimeshk*", Ibn Asakir, 17/297. "*El Revdu el Unufu*", 4/36. "*Fet'hu el Bari*", 7/220.
[828] Ahmedi, 14808.

Kjo është baza për sa i përket diturisë së tij në çështjet e kësaj bote, ndërsa sa i përket diturisë që ai përcillte nga Allahu për ligjet e Tij, burimi i saj ishte shpallja hyjnore, siç thotë Allahu: ***"Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo*** (që thotë) ***është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij."*** (En-Nexhm: 3-4)

7. Dhe për shkak të shumëllojshmërisë së detyrave të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - si i Dërguar, imam, udhëheqës shtetëror, komandant, mësues dhe gjykatës - edhe dijet e tij ishin të larmishme dhe të gjera. Kështu ishin edhe shumica e sahabëve *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)*; secili prej tyre kishte njohuri të thella në fushën në të cilën ishte përqendruar dhe për të cilën ishte angazhuar.

I Dërguari dhe udhëtimi

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka bërë disa udhëtime para shpalljes dhe pas saj, si edhe para Hixhretit dhe pas tij. Qëllimet dhe arsyet e udhëtimeve në jetën e tij kanë qenë të ndryshme.

Udhëtoi si fëmijë me nënën e tij për në Medinë, për të vizituar varrin e babait dhe dajallarët e gjyshit të tij.[829] Udhëtoi në moshën dymbëdhjetë vjeç për në Sham në shoqërinë e xhaxhait të tij, Ebu Talibit.[830] Pastaj, në moshën njëzet e katër vjeç udhëtoi përsëri për në Sham, në tregtinë e Hadixhes.[831]

Dhe pas shpalljes, udhëtoi për në Taif për thirrje,[832] pastaj për në Medinë për Hixhret, pastaj pati udhëtimet e tij për Xhihad dhe çlirim, për Umre dhe Haxh, si edhe për shëtitje, kur dilte[833] drejt kodrinave rreth Medinës, kur ato gjelbëroheshin.[834]

---

[829] "*Siretu Ibn Hisham*", 1/204.
[830] "*Xhmi el Tirmidhi*", 3620.
[831] Ibn Sead, "*El Tabakatu el Kubra*", 1/107.
[832] Buhariu, 3231. Muslimi, 1795.
[833] Dilte në natyrë larg qytetit, për të qëndruar në vetmi etj. Shiko "*Avnu el Meabud*", 2/312.
[834] Ebu Davudi, 4808.

Në atë kohë, udhëtimi ishte një pjesë vuajtjeje dhe nuk e ndërmerrte askush përveçse nga nevoja.

Duke vërejtur gjendjen e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* si udhëtar, na shfaqen disa tipare, ndër to:

Së pari: Përmendja e Allahut gjatë udhëtimit.

Udhëtimet e tij ishin të mbushura me përmendjen e Allahut, me madhërimin, njësimin, falënderimin dhe lutjen ndaj Allahut të Madhëruar.

Në këtë largim përmes udhëtimit, kishte shikime të reja mbi madhështinë e Allahut në krijesat dhe në gjithësinë e Tij, gjë që e bënte të domosdoshme përmendjen dhe lavdërimin e Tij.

Dhikri i udhëtimit fillonte që në momentin e nisjes së tij. Është transmetuar se kur i sillnin kafshën që të hipte mbi të, ai thoshte: *"Bismilah"* kur vendoste këmbën në vendin e hipjes, dhe kur vendosej mirë mbi shpinën e saj, thoshte: ***"Qoftë lavdëruar Ai që i nënshtroi këto për ne, se vetë ne këto nuk do të mund t'i kishim nën pushtet dhe ne, me siguri, do të kthehemi te Zoti ynë!"*** (Ez-Zuhruf: 13-14)

Pastaj thoshte*: "Elhamdulilah, elhamdulilah, elhamdulilah"*, pastaj: *"Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber!"* Mandej lutej: *"O Allah, na jep mirësi dhe devotshmëri, në këtë udhëtim, na mundëso vepra që Ti i pëlqen! O Allah, lehtësoje për ne këtë udhëtim dhe shkurtoje largësinë e tij! O Allah, Ti je shoqëruesi në udhëtim dhe kujdestari për familjen! O Allah, më ruaj nga vështirësia e udhëtimit, nga pamjet që të hidhërojnë, dhe nga kthimi i keq në pasuri apo familje!"*

Kur nisej për kthim nga udhëtimi, i thoshte po këto dhe shtonte: *"Tek Ti kthehemi! Tek Ti pendohemi! Ty të adhurojmë! Zoti ynë! Ty të falënderojmë!"*[835]

Udhëtimi kishte lutjet e veta të posaçme, si në ndalesat e tij, ashtu edhe në kohët e tij, krahas lutjeve të zakonshme të përditshme. Ai ishte i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i cili e përmendte Allahun në çdo gjendje dhe në çdo rrethanë.

[835] Muslimi, 1342.

Së dyti: Nga ajo që vërehet në udhëtimet e tij është përulësia dhe barazimi i gjendjes së tij me gjendjen e shokëve të tij. Ai nuk kishte shenja të njerëzve që madhërohen, por ecte bashkë me shokët e tij, i përfshirë mes tyre, pa pasur ndonjë veçori në pamjen apo gjendjen e tij që ta dallonte nga ata.

Prandaj, kur takoi një karvan teksa kthehej nga Haxhi i Lamtumirës, ai tha: "*Kush jeni ju?"* Ata thanë: "Ne jemi muslimanë." Ata e pyetën: "*Po ti, kush je?*" Ai tha: "*Jam i Dërguari i Allahut."*

Një grua nga ata u frikësua, mori përdore një djalë të vogël të saj, e nxori nga mbulesa e saj[836], duke thënë: "O i Dërguar i Allahut, a ka ky (fëmija) Haxh?" Ai tha: "*Po, dhe për ty ka shpërblim."*[837]

Ajo që të bën përshtypje më shumë se pyetja e tyre: "Po ti, kush je?" është fakti se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk kishte asnjë shenjë që ta dallonte, as ndonjë pamje apo rregull të veçantë vetëm për të. Ai ishte mes njerëzve, i përfshirë me ta, i afërt me ta - ashtu si vëllezërit e tij, Pejgamberët dhe të Dërguarit e Allahut, paqja qoftë mbi ta - për të cilët Allahu thotë: ***"Ne edhe para teje kemi nisur vetëm të dërguar, të cilët hanin ushqim dhe shëtisnin nëpër tregje."*** (El-Furkan: 20)

Së treti: Duke marrë parasysh natyrën e udhëtimit në atë kohë - hyrje në shkretëtira të zbrazëta, fusha të mëdha të pabanueshme, ku udhëtari ishte i ekspozuar ndaj rreziqeve – Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, udhëzoi për disa rregulla dhe norma që vlejnë sa herë që ekzistojnë rrethanat e tyre, ndër to:

1. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaloi që njeriu të udhëtojë vetëm, dhe tha: "*Udhëtari i vetëm është shejtan, po ashtu dy udhëtarë vetëm janë dy shejtanë, ndërsa tre udhëtarë janë karvan."*[838]
2. Urdhëroi që nëse janë tre vetë ose më shumë, të caktojnë njërin prej tyre si drejtues.[839]

[836] "*Metaliu el Envar ala sihahi el Athar",* 2/337. "*Avnu el Meabud",* 5/110.
[837] Muslimi, 1336.
[838] Ebu Davudi, 2607.
[839] Ebu Davudi, 2609.

3. Ndaloi që gruaja të udhëtojë një udhëtim të një dite e një nate, pa të afërm.[840]
4. Ndaloi shpërndarjen e udhëtarëve kur ndalojnë diku. Nga Ebu Thealebe el Husheni transmetohet se njerëzit, kur ndaleshin në një vend, shpërndaheshin…

Së katërti: Kur kishte ndër mend të udhëtonte, ai hidhte short mes grave të tij, dhe ajo që i binte shorti, udhëtonte me të. Kur bëri Haxhin, i mori të gjitha gratë e tij me vete.

Së pesti: Në udhëtim, ashtu si në çdo gjendje të tij, ai ishte thirrës dhe mësues. Prandaj, edhe në udhëtimet e tij gjendeshin udhëzime arsimore dhe norma mirësjelljeje. Nga këto është ajo që transmeton Imran ibn Husajni, i cili thotë: "Ndodhi që i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në një nga udhëtimet e tij dhe një grua nga ensarët ishte mbi një deve. Ajo u mërzit prej saj dhe e mallkoi. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e dëgjoi këtë dhe tha: "*Merrni atë që është mbi deve dhe lëreni devenë, sepse ajo është e mallkuar.*'" Imrani tha: "Sikur po e shoh tani, teksa ecte mes njerëzve, dhe askush nuk i afrohej."[841]

Me këtë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* jep një mësim të madh në etikën e të folurit dhe në ruajtjen e gjuhës nga mallkimi. Nëse kjo është e ndaluar për mallkimin e një kafshe, e cila nuk e kupton atë që i thuhet, atëherë ç'mund të thuhet për mallkimin e familjarëve, fëmijëve apo shokëve?!

Po ashtu, në këtë ka udhëzim për të qenë të butë me kafshët. Nëse kjo ndalesë dhe ky ndëshkim u bë për shkak të mallkimit të tyre, atëherë ç'duhet thënë për rrahjen, urinë apo ngarkimin e tyre me atë që nuk e përballojnë dot?!

Nga shembujt e tjerë, është se kur kaloi pranë malit Xhumdan gjatë rrugës së tij në Haxhin e Lamtumirës, ai tha: "*Ku janë pararendësit?*" Ata thanë: "O i Dërguar i Allahut, disa njerëz kanë shkuar përpara dhe disa kanë mbetur pas." Ai tha: "*Ecni, ky është*

[840] Buhariu, 1086. Muslimi, 827.
[841] Muslimi, 2595.

Xhumdani. Kanë fituar të veçuarit, kanë fituar të veçuarit." Ata thanë: "E kush janë të veçuarit, o i Dërguar i Allahut?" Ai tha: "*Ata janë burrat që e përmendin shumë Allahun dhe ato gra që e përmendin shumë Allahun, ata të cilët nuk e ndalin*[842] *përmendjen e Allahut. Përmendja e Allahut ua lehtëson barrën e mëkateve prandaj Ditën e Ringjalljes do të vijnë të lehtësuar."*[843]

Fjala *muferrid* i veçuar nënkupton njeriun që ka hipur i vetëm mbi deve dhe nuk ka ngarkesë tjetër mbi të, gjë që e bën të lehtë, të shpejtë dhe pararendës. Por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ktheu vëmendjen e njerëzve te një kuptim shumë më madhor: pararendja në botën tjetër. Ata që vijnë të lehtësuar nga mëkatet dhe i kalojnë të tjerët në shpërblim janë ata që e përmendin shpesh Allahun, qofshin burra, apo qofshin gra, sepse përmendja e shumtë e Allahut ua heq barrët e mëkateve.

Shiko pra se sa e hollë është kjo shenjë dhe sa i shkurtër është ky mësim, por sa i thellë dhe i fuqishëm është ky kuptimi i tij.

Së gjashti: Megjithëse udhëtimi është lodhje e rëndë që shteron energjinë shpirtërore, shkakton tension dhe e largon durimin, megjithatë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në udhëtimet e tij e gjejmë në kulmin e qetësisë, durimit dhe larg nga çdo reagim i ashpër, sikur të ishte në rehati të qëndrimit e jo në ngut të udhëtimit.

Ndodhi që një herë i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po kthehej nga një udhëtim, dhe kur iu afrua Medinës, zbriti në Bejda, një kodër prej ku shikon mbi luginën e *Akikut* pranë Medinës. Kur u bë gati për t'u nisur, Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* humbi një varëse që ia kishte marrë hua motrës së saj. Ajo u trondit nga humbja dhe ia shprehu Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hidhërimin e saj. Atëherë ai, me gjithë udhëtimin dhe lodhjen, e mori çështjen me kujdes, dërgoi një grup sahabësh që ta kërkonin varësen, dhe qëndroi aty duke i pritur. Edhe njerëzit që ishin me të qëndruan, derisa erdhi mbrëmja dhe ra nata.

---

[842] "*El Nihajetu*", 5/243.
[843] Muslimi, 2676.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe njerëzit e tjerë e kaluan natën aty dhe u shqetësuan për këtë vonesë. Ata shkuan tek Ebu Bekri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* për t'u ankuar për të bijën. Ebu Bekri, i shqetësuar, hyri tek Aishja i zemëruar dhe filloi ta qortonte me ashpërsi. Ndërkohë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po flinte qetësisht, derisa u zbardh mëngjesi dhe drita e agimit ndriçoi. Në atë moment Allahu shpalli ajetin e **tejemumit**.

Kur më vonë e ngritën devenë e Aishes, gjetën vargun nën të.[844]

Ky episod tregon se udhëtimi, veçanërisht në fund të tij, është një moment i prirë për lodhje fizike dhe shterim emocional, gjë që zakonisht zvogëlon aftësinë e njeriut për durim dhe butësi. Megjithatë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në këtë situatë ishte ashtu si në të gjitha gjendjet e tij: i butë, dashamirës, i qetë dhe larg tensionit e zemërimit.

Së shtati: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bënte që udhëtimi të jetë edhe një kohë relaksimi, zbavitjeje dhe kënaqësie shpirtërore. Një nga shembujt është hadithi i Seleme bin el Ekva, i cili tregon kthimin e tyre nga beteja e *Dhi Kird*, ku gara mes të rinjve në udhëtim ishte një mënyrë argëtimi, sporti dhe sfide, që ngjallte gëzim dhe bashkonte udhëtarët në kënaqësi dhe shikim të ngjarjeve.

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon për një udhëtim me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur ishte e re: "Nuk isha e shëndoshë." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u tha shokëve të tij: *"Ecni përpara!"* Ata ecën përpara, e pastaj më tha: *"Hajde të vihemi në garë!"* Ne u vumë në garë dhe unë ia kalova, ai nuk tha asgjë, por pas disa kohësh në një udhëtim tjetër kur unë isha shëndoshur pak dhe e kisha harruar atë garë, i tha shokëve të tij: *"Ecni përpara!"* Ata ecën përpara, e pastaj më tha: *"Hajde të vihemi në garë!"* Unë e kisha harruar garën e parë dhe tashmë që isha e shëndoshë i thashë si të vihemi në garë në këtë

[844] Buhariu, 334. Muslimi, 367.

gjendje? Ai i tha: *"Do ta bësh patjetër!"* Ne u vumë në garë, por ai ma kaloi, dhe filloi të qeshte duke thënë: *"Tani jemi një me një"*[845]

Së teti: Inkurajimi për bashkëpunim dhe shërbim ndaj shokëve të udhëtimit.

Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se ishin me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në një udhëtim, ku disa prej nesh ishin agjërueshëm e disa jo dhe ndaluam nën një hije në një ditë të nxehtë. Ata që ishin agjërueshëm, u lodhën shumë dhe nuk mundën të bëjnë asnjë punë. Ndërsa ata që nuk agjëruan u desh që të kryejnë të gjitha punët, t'u shërbejnë dhe të kujdesen për agjëruesit dhe t'u lirojnë kafshët për të hipur. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Sot shpërblimin e morën ata që nuk agjëruan."*[846]

Së nënti: Kur kthehej nga udhëtimi, ai ndalej në një vend afër Medinës, në Sarar,[847] Bejda[848] dhe vende të ngjashme, derisa lajmi të mbërrinte te banorët e Medinës që gratë të përgatiteshin për të pritur burrat e tyre. Madje, Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, porosit që burri të mos vijë papritmas natën te familja, sikur t'i spiunojë ata, sepse gruaja mund të jetë në gjendje të papërshtatshme për pritjen e burrit në atë gjendje.

Kjo ishte e përshtatshme për kohën kur lajmi për udhëtarin shkëputej që nga momenti që ai largohej deri kur kthehej, por sot kjo situatë ka ndryshuar për shkak të mjeteve moderne të komunikimit, kështu që kthimi nuk është më i papritur gjatë ditës apo natës.

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pritej nga fëmijët e familjes së tij. Nga Abdullah bin Xhaferi transmetohet se: "Kur i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kthehej nga një udhëtim, fëmijët e familjes së tij i dilnin përpara.

---

[845] Ahmedi, 26277.

[846] Buhariu, 2890.

[847] Pranë një pusi të vjetër, tre milje larg Medinës, në drejtim të Irakut. *"Muaxhemu el Mealim el Xhografije fi el Sireti el Nebevijeti"*, f. 175, Atik el Biladi .

[848] Një vend afër Medinës, 9 km larg, në drejtim të jugut. *"El Mealim el Ethiretu fi el Sunneti ve el Sireti"*, f. 67.

Një herë kur u kthye nga udhëtimi isha unë i pari që më nxorën përpara, ai më mori në krahë dhe më vuri përpara vetes mbi kafshë, pastaj sollën njërin nga fëmijët e Fatimes, të cilin e mori dhe e vuri pas shpine mbi kafshë dhe të tre së bashku hymë në Medinë hipur mbi kafshë."[849]

Ai synonte të shkonte fillimisht në xhami. Nga Ebu Thalebe el Husheni transmetohet se: "I Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kthehej nga udhëtimi vetëm në orët e mëngjesit dhe fillonte me xhaminë, falte dy rekate namaz dhe qëndronte aty."[850]

Ai qëndronte pak me njerëzit dhe ata që e prisnin në xhami i jepnin selam, pastaj hynte te familja e tij, fillonte nga shtëpia e Fatimes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* i jepte selam, pastaj vizitonte shtëpitë e grave të tij një nga një.[851] Ndërsa banorët e Medinës vinin te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më pas gjatë pjesës së mbetur të ditës për t'i dhënë selam.

I Dërguari dhe lufta

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjatë thirrjes së tij kaloi në një rrugë të vështirë, plot pengesa, armiqësi dhe kurthe. Nuk mundet asnjë bartës i një thirrjeje, sado paqedashës të jetë, të shpëtojë nga armiqësia e atyre që e kundërshtojnë atë thirrje. Askush nuk mund të jetë më i butë dhe më i drejtë në thirrje se pejgamberët dhe të dërguarit e Allahut, megjithatë ata u penguan nga armiqtë me kurthe dhe u përballën me armiqësi.

"Dhe, kështu Ne, çdo profeti i kemi kundërvënë një armik nga keqbërësit. Por ty të mjafton Zoti yt si udhërrëfyes dhe ndihmës!" (El-Furkan: 31)

[849] Muslimi, 2428.
[850] Ahmedi, 27170.
[851] Ebu Davudi, 4213.

Prandaj, përballja me armiqësitë e padrejta dhe agresive është e përsëritur në shumicën e thirrjeve, sidomos kur ato e nisin thirrjen drejtuar atyre që e kundërshtojnë.

Përballja me këto armiqësi ka rrugë dhe mjete të ndryshme, sipas gjendjes së thirrësit dhe të atij që e armiqëson. Ndër to mund të jetë edhe përballja në luftë, ku humbin jetë dhe derdhet gjak, kur kjo është zgjidhja e vetme për të ndalur ose shpartalluar agresionin.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në përballjet e tij luftarake, kishte udhëzimet dhe porositë e veta, dhe ne do të ndalemi tek to në disa aspekte:

Së pari: Lufta nuk është një projekt i hapur, as qëllim që kërkohet në vetvete, por është mjet për një qëllim të caktuar, që përdoret vetëm kur është e nevojshme dhe shmanget kur është e mundshme. Prandaj Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thotë: *"Mos e dëshironi përballjen me armikun, lutuni Allahut të mos ketë luftë, por, nëse përballeni, atëherë qëndroni fort."*[852]

Duke parë shkaqet e luftës, i gjejmë ato të kufizuara në dy situata:

1. Lufta kundër një agresioni konkret ose një agresioni që pritet të ndodhë, siç thuhet në fjalën e Allahut: ***"Luftoni në rrugën e Allahut ndaj atyre që luftojnë kundër jush, por mos e kaloni kufirin, se Allahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin."*** (El-Bekare: 190)

Ky është një ajet i qartë dhe i drejtpërdrejtë që e kufizon luftën vetëm kundër atyre që luftojnë dhe e quan çdo gjë tjetër agresion. Nuk është e drejtë të thuhet se ky ajet është i shfuqizuar, sepse ky urdhër është i lidhur me një çështje të besimit, që është një cilësi e Allahut: ***"Allahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin."*** (El-Bekare: 190) Kjo nuk është çështje që mund të përfshihet nga shfuqizimi. Pra, kush na lufton, kush na kërcënon me luftë, apo përgatitet për luftë kundër nesh, ne do të luftojmë kundër tij me urdhër të Allahut: ***"Luftoni në rrugën e Allahut ndaj atyre që luftojnë kundër jush ..."*** (El-Bekare: 190)

[852] Buhariu, 2965. Muslimi, 1742

2. Lufta kundër atyre që i pengojnë njerëzit të ndjekin fenë, ose i sulmojnë ata nëse ndjekin të vërtetën! Sepse në këtë mënyrë bëjnë armiqësi që duhet ndalur, qoftë edhe me luftë. Kjo është përmendur në fjalën e Allahut: ***"Luftoni kundër tyre, derisa të zhduket idhujtaria dhe derisa të mbetet vetëm feja e Allahut. Nëse ata heqin dorë*** (prej mohimit)***, Allahu i sheh punët e tyre."*** (El-Enfal: 39)

"Ç'keni ju që nuk luftoni në udhë të Allahut dhe për shpëtimin e të shtypurve: për meshkujt e pafuqishëm, gratë dhe fëmijët, të cilët thërrasin: "O Zoti ynë! Nxirrna nga ky qytet, banorët e të cilit janë keqbërës! Na cakto një mbrojtës dhe na dërgo nga ana Jote dikë që të na ndihmojë!" (En-Nisa: 75)

Ndërsa kush nuk bën agresion, nuk sulmon besimtarët në fenë e tyre dhe nuk pengon askënd të zgjedhë të vërtetën, nuk është objekt luftimi. Përkundrazi të sulmosh të tillë është agresion dhe shkelje e fjalës së Allahut: ***"Por mos e kaloni kufirin, se Allahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin."*** (El-Bekare: 190)

Me këtë, Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, unifikoi qëllimin e luftës dhe e ngriti në shkallën më të lartë. Sepse lufta nuk është për lakmi apo plaçkë, as për sundim në tokë, por ka një qëllim të lartë dhe një synim fisnik: "*Kush lufton që fjala e Allahut të jetë më e larta, ai është në rrugën e Allahut.*"[853]

Sa shumë luftëra dhe beteja janë zhvilluar ku humbën miliona jetë dhe u shkatërruan vende dhe qytete për dëshira egoiste të një individi të egër dhe tiran. Sa jetë u morën në luftërat e Aleksandrit të Madh! Për çfarë? Dhe në luftërat e Xhingiz Khanit, Holakut dhe Timorlenkut! Dhe në dy luftërat botërore të parën dhe të dytën! Për çfarë qëllimesh?

Së dyti: Kujdesi i Pejgamberit, sal Allahu alejhi ve selem, për balancën e forcës ndaj armikut dhe shmangia e ekspozimit të Sahabëve ndaj përballjeve të pabarabarta.

Një shembull i kësaj është ndalimi i përballjes në Mekë, pavarësisht dëmeve dhe provokimeve të politeistëve. Urdhri ndaj tyre ishte: ***"Tërhiqni duart tuaja nga lufta, falni namazin dhe jepni***

[853] Buhariu, 3126. Muslimi, 1904.

zekatin!" (En-Nisa: 77), sepse nuk ishte në dobi të hynin në përballje të dhunshme në një kohë kur thirrja ishte ende në fazën e parë të zhvillimit dhe muslimanët ishin të dobët dhe të pakët.

Gjithashtu, fortifikimi i muslimanëve në ditën e betejës së Hendekut dhe mos dalja në përballje, pasi numri i politeistëve ishte trefishi i muslimanëve dhe përballja ishte shumë e rrezikshme.

Kur Mlaib el Esne kërkoi të dërgohen me të një grup dijetarësh të Kuranit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Unë kam frikë për ta."* Ai i tha: "Ata janë nën kujdesin tim"[854] dhe kështu i dërgoi ata me të. Dhe kur u tradhtuan dhe u vranë shtatëdhjetë dijetarë te Bunari i Maunës[855] nga Amir ibn el Tufajli dhe fisi i tij, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk dërgoi ushtri për t'i ndëshkuar, edhe pse ata nuk ishin larg Medinës më shumë se rreth 190 km. Kjo ishte për shkak se gjendja e muslimanëve pas Betejës së Uhudit nuk i lejonte përballje ushtarake, pasi ata ishin të dobët dhe të plagosur.

Ky pejgamber i nderuar, i premtuar me fitore të mbështetur nga ndihma e engjëjve, megjithatë nuk lejonte aventurizëm të papërgjegjshëm në luftërat e tij, duke zbatuar urdhrin e Zotit të tij: ***"O besimtarë! Bëhuni syçelë*** (kundër armikut) ***e luftojeni atë, qoftë grupe-grupe ose të gjithë së bashku!"*** (En-Nisa: 71); ***"Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t'ju shpërblehet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi."*** (El-Enfal: 60)

Prandaj, Allahu e ndaloi Pejgamberin dhe besimtarë me të në Ditën e Hudejbijes të luftonin, për të ruajtur sigurinë e besimtarëve të dobët të fshehur në Mekë, që të mos bëheshin viktima të asaj përballjeje.

Së treti: Luftërat deri atëherë kryheshin për kënaqësi, hakmarrje, shfarosje, vrasje e kujt të jetë e mundur, brutalitet në vrasje,

---

[854] "*Tarijhu el Tabari"*, 2/546.

[855] Një vend midis maleve që quhet Ebla, në rrugën që të çon nga Medina për në Mekë. Shiko "*Muaxhemu el Buldani"*, 1/302.

dëmtim i trupave të vrarë dhe keqtrajtim i të burgosurve. Nuk kishte rregulla apo etikë lufte.

Kur erdhi Pejgamberi i nderuar *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vendosi vlera, rregulla dhe etikë për luftën. Ato i respektoi vetë dhe i obligoi muslimanët t'i respektojnë. Prej tyre janë:

1. Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po shkonte për çlirimin e Mekës, pa një grua të vrarë dhe e dënoi këtë duke thënë: "*Kjo nuk duhet të luftonte.*" Pastaj ai dërgoi një grup përpara ushtrisë dhe ndaloi vrasjen e grave dhe të fëmijëve.

2. Sa herë që emëronte një njeri komandant të ushtrisë, ai e këshillonte. Këto këshilla i përmbledh Ebu Bekri në porosinë e tij: "*Mos vrisni fëmijë, as gra, as pleq, as të sëmurë, as askush që ka frikë; mos prisni pemë, mos shkatërroni ara, mos therni bagëti e lopë përveç për ushqim, mos mbytni bletë, mos digjni.*"[856]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* solli këto mësime në një kohë kur e gjithë bota nuk i njihte dhe nuk i zbatonte ato. Megjithatë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i porositi muslimanët t'i respektonin, edhe sikur e gjithë bota t'i mohonte ato.

Ai iu përmbajt besnikërisë ndaj marrëveshjeve me armiqtë e tij dhe porositi për t'i përmbushur ato. Kur doli për në Bedër dhe kurejshët dolën për ta luftuar, në duart e tyre ranë Hudhejfe ibn el Jemani dhe babai i tij, të cilët po shkonin për në Medinë.

Hudhejfe tregon: "Na kapën idhujtarët e kurejshëve dhe na thanë: "Ju doni të shkoni te Muhamedi." Ne u thamë: "Jo, duam vetëm Medinën." Ata morën prej nesh betimin dhe besëlidhjen në Allahun që të kthehemi në Medinë dhe të mos luftojmë përkrah Muhamedit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).* Kur i lamë pas, shkuam te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i treguam çfarë na thanë ata dhe çfarë u thamë ne. Çfarë mendon? Ai tha: "Ne do t'i kërkojmë ndihmë Allahu kundër tyre, por do t'i përmbahemi marrëveshjes me ta."[857]

Kur Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, përcaktoi këto rregulla për luftën, ai nuk po merrte parasysh ndonjë opinion

[856] "*El Muvatta*", 918.
[857] "*El Mustedrek*", 4908.

publik botëror, apo ndonjë organizatë ndërkombëtare, apo marrëveshje shtetërore. Por ai po shpallte dhe zbatonte një ligj hyjnor udhëzues që e kthente njerëzimin në rrugën e drejtë.

Së katërti: Në udhëheqjen e tij ushtarake, ai, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të),* bashkonte në vetvete cilësitë e udhëheqësit, moralin dhe talentet e tij. Marrëdhënia e ushtrisë me të ishte e mbushur me dashuri të sinqertë dhe besim të palëkundur. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përfshinte ushtarët në vendimmarrje dhe merrte këshilla nga ata që ishin të aftë, pastaj e ndiqte këtë me vendosmëri në zbatimin e vendimit të saktë, duke treguar kujdes e vigjilencë, duke dërguar zbulues për të mbledhur informacion, duke parandaluar planet e armikut dhe duke e befasuar atë me gjëra për të cilat nuk ishte i përgatitur, si dhe me aftësi të tjera të shumta të tij si udhëheqës *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.[858]

Së pesti: Në betejat e tij, ai ishte shembull i guximit, qëndrueshmërisë dhe qetësisë së shpirtit, sidomos kur beteja bëhej e ashpër dhe rreziku ishte i madh. Më trimat nga sahabët në luftë ishin ata që qëndronin më afër Profetit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.[859]

Së gjashti: Sahabët rreth tij përbënin një ushtri gjithmonë të gatshme dhe ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i motivonte të gjithë për gatishmëri ushtarake, në mënyrë që ata të ishin si në një sistem shërbimi të detyrueshëm ushtarak. Të gjithë ishin të mobilizuar e të përgatitur dhe kjo shihej në nxitjen për zotërimin e aftësive luftarake dhe përgatitjen për beteja, të cilave shoqëria mund t'u ekspozohej në çdo moment.

Nga nxitja për aftësinë e qitjes, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*A nuk është forca* (në luftë) *aftësia për qitje* (gjuajtje me shigjetë)*?*"[860] - dhe ai inkurajonte garën në këtë aftësi. Ai, gjithashtu, nxiste përgatitjen e tillë që çdo individ të ishte pjesë e mekanizmit të mbrojtjes.

[858] Shiko pjesën "I Dërguari dhe udhëheqja".
[859] Shiko pjesën "I Dërguari dhe guximi".
[860] Muslimi, 1917.

E gjithë kjo hyn në kuptimin e përgatitjes së përmendur në fjalën e Allahut të Lartësuar:

"***Përgatisni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t'ju shpërblehet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi.***" (El-Enfal: 60)

Së shtati: Me gjithë ashpërsinë e armiqësive dhe ekspeditat e shumta ushtarake, Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk hyri në betejë të drejtpërdrejtë luftarake nga betejat e tij, përveçse në tetë prej tyre: Bedri, Uhudi, El Murejsi, Hendeku, Kurejdha, Hajberi, Çlirimi i Mekës dhe Hunejni.

Numri i të vrarëve në të gjitha betejat e tij, nga muslimanët dhe armiqtë e tyre, nuk i kaloi **rreth një mijë të vrarë** gjithsej.

Kjo na tregon se Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ishte i etur për gjak dhe as që kënaqej me vrasje, por luftonte sikur të trajtonte me bisturi kirurgu - nuk niste luftë përveçse kur ajo ishte zgjedhja e vetme, dhe nuk vriste përveçse kur vrasja ishte e merituar dhe të gjitha rrugët e pajtimit ishin mbyllur.

Për këtë arsye, shumicën e atyre që i mundte, i falte dhe shumica e atyre që kishin luftuar kundër tij, më pas luftuan përkrah tij dhe në mbrojtje të tij.

Së teti: Besnikëria e tij ndaj dëshmorëve dhe përgëzimi i familjarëve të tyre për përfundimin e mirë që i priste. Nga Xhabiri transmetohet: "U soll babai im i vrarë në ditën e Uhudit dhe motra e tij, Fatimja, filloi të qante për të. Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*Mos e qaj për të, sepse engjëjt nuk kanë reshtur ta mbulojnë me krahët e tyre derisa u ngrit.*"[861]

Po ashtu, nga Enesi transmetohet se Harithe u vra ditën e Bedrit, ndërsa ishte ende djalosh, dhe nëna e tij erdhi te Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e i tha: "O i Dërguar i Allahut, ti e di vendin që Harithe kishte në zemrën time; nëse është në Xhenet, do të duroj dhe do të kërkoj shpërblim nga Allahu, por, nëse është ndryshe, ti e di çfarë do të bëj." Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin*

[861] Buhariu, 2816.

mbi të) tha: "*Oj nëna e Harithes, Xheneti nuk është një kopsht i vetëm, por ka shumë kopshte, dhe ai është në Firdeusin më të Lartë.*"[862]

Nga besnikëria e tij ndaj tyre ishte edhe kujdesi për familjet e tyre. Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha për Umu Sulejmin: "Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk hynte në asnjë shtëpi në Medinë përveç shtëpive të bashkëshorteve të tij dhe shtëpisë së Umu Sulejmit. Kur e pyetën për këtë, tha: "*E kam mëshiruar atë, sepse vëllai i saj u vra duke luftuar me mua.*"[863]

Po ashtu, nga besnikëria e tij ishte vizita e varreve të tyre në Uhud, para vdekjes së tij, si një përshëndetje e lamtumirës për të gjallët dhe të vdekurit.

Së nënti: Lufta e tij nuk ishte për lakmi tokësore apo për fitimin e plaçkës së luftës dhe grumbullimin e saj. Kur e dërgoi Aliun me flamurin drejt kështjellës së Khajbarit - dhe kështjellat e saj ishin thesare ari e argjendi - ai e urdhëroi që t'i thërriste ata në dëshminë "*La ilahe il-lAllah*" (nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut), dhe tha: "*Pasha Allahun! Nëse një njeri i vetëm udhëzohet përmes teje, është më mirë për ty se devetë e kuqe.*"[864]

Po kështu, në ndarjen e plaçkës së luftës pas betejës së Hunejnit, ai e shpërndau atë tek ata që deri dje ishin armiqtë e tij të afërt, për t'i fituar zemrat e tyre dhe për t'i afruar me Islamin.

I Dërguari dhe fitorja

Fitorja ka një eufori që e huton mendjen, një dehje më e fortë se ajo e verës, me të cilën bëhet e vështirë të kontrollosh emocionet ose të përmbash sjelljet. Ne shohim shembuj të kësaj në momentet e fitoreve të vogla, si fitorja në një ndeshje sportive. E ç'mund të themi për fitoren në betejë, ku e di se armiku yt është tepër i vendosur të asgjësojë e të zhduk, çfarë do të thotë ngadhënjimi mbi të dhe futja e tij në dorë?

[862] Ahmedi, 13871. Buhariu, 3982.
[863] Buhariu, 2844. Muslimi, 2455.
[864] Buhariu, 2942.

Po Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* si veproi në fitore?!

Për ta kuptuar më qartë pamjen, le të marrim si shembull fitoren në Çlirimin e Mekës, e cila ishte fitorja e qartë dhe ngadhënjimi madhështor.

Aty vërejmë disa gjëra të mrekullueshme, ndër të cilat:

1. Në çastin e fitores - që për të tjerët është moment krenarie dhe për mendjemëdhenjtë çast i mbushur me arrogancë - ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri në Mekë me përulësinë dhe devotshmërinë më të thellë ndaj Allahut. I shoqëruar nga dhjetë mijë ushtarë, hyri me kokën ulur mbi devenë e tij, aq sa balli i tij i bekuar prekte pjesën e përparme të shalës, ndërsa këndonte: ***"Ne të dhamë ty një fitore të qartë..."*** (El-Fet'h: 1)

E këndonte duke e zgjatur zërin[865] dhe duke e përsëritur me një zë të dridhur e valëzues nga përulësia ndaj Allahut, sikur të shpallte para Tij largimin e plotë nga vetëmburrja dhe ndjenjat e lavdisë. Ishte përulësi ndaj Allahut, falënderim dhe mirënjohje ndaj dhuntisë së Tij, e jo vështrim drejt vetes dhe përfitimeve të saj.

Dhe kur u krye çlirimi dhe e gjithë Meka iu nënshtrua atij, ai nuk bëri paradë ushtarake; por hyri në shtëpinë e Umu Hanit, bijës së xhaxhait të tij, u la dhe pastaj fali namazin e fitores - tetë rekate - si shenjë falënderimi ndaj Allahut[866] dhe shpallje e përulësisë dhe mirënjohjes ndaj Tij.

2. Ndër shenjat e fitores në jetën e Pejgamberit, sal Allahu alejhi ve selem, të cilat i shohim qartë në Çlirimin e Mekës, është nxitimi për të thënë: "*Shkoni! Jeni të lirë.*"[867] Dhe: "*Kush mbyllet në shtëpinë e tij, është i sigurt; kush hyn në xhami, është i sigurt dhe kush hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit, është i sigurt.*"[868]

Kështu u përhap siguria, pushtoi qetësia dhe zemrat u mbushën me paqe të brendshme.

---

[865] Buhariu, 7540. Muslimi, 794.
[866] Buhariu, 357. Muslimi, 336.
[867] "*Siretu* Ibn Hisham", 2/412. "*Tarijhu el Tabari*", 2/161. "*Zadu el Mead*", 3/307-309. "*El Bidajetu ve el Nihajetu*", 6/567-568.
[868] Ebu Davudi, 3021.

Gjithashtu, shohim mungesën e hakmarrjes dhe të dëshirës për t'u shfryer; nuk u përdor shpata, nuk u dhunua qyteti dhe nuk u grabit pasuria. Përkundrazi, ai e la Mekën të qëndrueshme, të sigurt, të qetë dhe të mbrojtur. Fitorja profetike erdhi bashkë me sigurinë, qetësinë dhe paqen.

3. Ndër gjërat që vërejmë në fitoren profetike gjatë Çlirimit të Mekës është përmbajtja dhe shuarja e armiqësive, jo thellimi i tyre. Kryetari i Mekës, Ebu Sufjani, fitoi medaljen e nderit: "*Kush hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit, është i sigurt.*"

Edhe Ikrima ibn Ebu Xhehlit, i cili u arratis nga Meka drejt detit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia dërgoi sigurinë. Kur u kthye, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përgatiti atmosferën përpara ardhjes së tij duke thënë: "*Po vjen Ikrima, biri i Ebu Xhehlit, besimtar dhe muhaxhir; mos e shani babanë e tij, sepse sharja e të vdekurit lëndon të gjallin, dhe nuk arrin tek i vdekuri.*"[869]

Kur erdhi Ikrima, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e priti me fytyrë të qeshur dhe të gëzuar, duke thënë: "*Mirë se vjen muhaxhiri kalorës!*"[870]

Shiko sa bukur e shpreh Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ardhjen e tij pas arratisjes me shprehje të butë dhe të hijshme: "*Muhaxhiri kalorës!*"

4. Pas fitores, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përpoq të kurojë plagët, të riparojë marrëdhëniet, të zbusë zemrat dhe të rikthejë unitetin e shoqërisë. Për këtë arsye, ai i dha muslimanëve të sapo hyrë në Islam gjatë Çlirimit dhurata të mëdha nga plaçka e luftës së Hunejnit, aq sa Ensarët ndjenë në zemrat e tyre se ai nuk u kishte dhënë nga plaçka, siç u dha mekasve. Këtu Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Kurejshët sapo kanë dalë nga injoranca dhe nga një sprovë e rëndë, ndërsa unë desha t'i afroj ata dhe t'i fitoj zemrat e tyre.*"[871]

5. Vërejmë, gjithashtu, se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në ditën e Çlirimit të Mekës, nuk e favorizoi asnjë nga të afërmit e tij me ndonjë post, dhuratë apo shpërblim,

[869] "*El Mustedrek*", 5055.
[870] Tirmidhiu, 2735.
[871] Buhariu, 5/159.

megjithëse aty ishin xhaxhai i tij, Abasi, Akili djali i Ebu Talibit, Ebu Sufjan djali i Harithit (dy kushërinjtë e tij) dhe të tjerë nga të afërmit dhe familja e tij. Nuk na është transmetuar se ndonjë prej tyre mori një nderim apo shpërblim të veçantë.

Gjithashtu, vërejmë se kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u largua nga Meka, nuk caktoi asnjë nga Beni Hashimi si udhëheqës të saj, por e caktoi një të ri nga të afërmit e Ebu Sufjanit, Atab ibn Esid, i cili ishte vetëm njëzet vjeç.

Mbetet një pyetje që e shtrojmë dhe themi: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri në Mekë si fitimtar me dhjetë mijë njerëz dhe u soll si fitues me këtë sjellje të mëshirshme dhe fisnike. Ndërsa tre vjet më parë, Ebu Sufjani ishte me dhjetë mijë idhujtarë duke rrethuar Medinën, ku ndodhej i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Po sikur ai të kishte fituar dhe të kishte hyrë në Medinë, si do të ishte sjellë me qytetin dhe banorët e tij? A do të kishte vepruar me të njëjtën moral dhe do t'i trajtonte banorët e Medinës në atë mënyrë?

Përgjigjen e ka dhënë vetë Ebu Sufjani më herët, në Uhud: "Do të gjeni gjymtime të trupave (të vrarëve) për të cilat unë nuk kam urdhëruar, por as që më kanë shqetësuar."[872]

Atëherë, si ka mundësi që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në momentet e fitores dhe ngadhënjimit, i trajtoi banorët e Mekës në këtë mënyrë? Përgjigjja është ajo që tha xhaxhai i tij, Abasi: "Kjo është profetësia[873], ky është morali i pejgamberëve."

I Dërguari dhe paqja shoqërore[874]

Paqja shoqërore është një term bashkëkohor, kuptimi i të cilit sillet rreth mungesës së shenjave të përçarjes, ndarjes dhe dhunës brenda shoqërisë.

Paqja shoqërore ka rëndësinë e saj në stabilitetin dhe sigurinë e shoqërisë, në zhvillimin dhe përparimin e saj, si dhe në përhapjen e

[872] Buhariu, 3039. Muslimi, 336.
[873] "*Tarihu el Tabari*", 3/54.
[874] Shiko "*El Silm el Ixhtimai fi el Sireti el Nebevijeti*", Luluete bint Muhamed el Lejli.

thirrjes dhe përcjelljen e fesë. Paqja shoqërore shprehet me siguri të përgjithshme. El Maverdi, duke folur për rregullat e përmirësimit të kësaj bote dhe rregullimin e punëve e gjendjeve të saj, ka thënë se rregulli i katërt: Një siguri e përgjithshme në të cilën qetësohen shpirtrat, përhapen ambiciet, gjen prehje i pafajshmi dhe ndien afërsi i dobëti. Sepse ai që ka frikë nuk ka rehati dhe ai që është i kujdesshëm nga frika nuk ka qetësi. Disa të mençur kanë thënë: "Siguria është jeta më e këndshme dhe drejtësia është ushtria më e fortë."[875]

Në atmosferën e paqes shoqërore arrihet qetësia që largon frikën dhe ankthin nga individët dhe komunitetet, duke mundësuar komunikimin dhe bashkëpunimin e tyre në fushat e zhvillimit të kësaj bote dhe përgatitjes për botën tjetër. Dëshmi për këtë është fakti që Allahu e quajti Marrëveshjen e Hudejbijes një "***fitore të qartë***" - ***"Ne të dhamë ty një fitore të qartë"*** (El-Fet'h: 1) - për shkak të asaj që pasoi: hapja e zemrave, përhapja e fesë dhe përcjellja e mesazhit. Kjo ishte fitorja më e madhe.

Nga El Berau *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet: "Ju e konsideroni fitore çlirimin e Mekës - dhe vërtet, çlirimi i Mekës ishte fitore - por ne e konsiderojmë fitore Betimin e Ridvanit në ditën e Hudejbijes."[876]

El Zuhriu thotë: "Nuk u arrit në Islam ndonjë fitore para saj që të ishte më e madhe se ajo. Lufta zhvillohej vetëm kur njerëzit përballeshin. Kur u arrit armëpushimi dhe u hoqën armët e luftës, njerëzit i siguruan njëri-tjetrit paqe, u takuan dhe negociuan me bisedime dhe diskutime. Çdokujt që iu fol për Islamin - nëse kishte pak arsye - e përqafoi atë. Në ato dy vite hyri në Islam një numër i barabartë, madje më i madh, se ai që kishte hyrë deri atëherë."[877]

Ibn Hishami thotë: "Dëshmia për fjalën e El Zuhriut është se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) doli për në Hudejbije me një mijë e katërqind burra, sipas fjalës së Xhabirit. Pastaj, dy vjet më vonë, doli për çlirimin e Mekës me dhjetë mijë veta."[878]

---

875 "*Edebu el Dunja ve el Din*", El Maverdi.
876 Buhariu, 4150.
877 "*Tarihu el Tabari*", 2/638.
878 "*El Bidajetu ve el Nihajetu*", 6/221.

Kjo, sepse thirrja islame u përhap nëpërmjet kësaj marrëveshjeje paqësore; thirrësit u shpërndanë, fiset u njohën me Islamin dhe shumë prej tyre hynë në të. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dërgoi letra te mbretërit brenda Gadishullit Arabik dhe jashtë tij, dhe thirrja e Islamit u përhap deri në një horizont botëror - e gjitha kjo para çlirimit të Mekës.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregoi një kujdes të madh për thellimin dhe mbrojtjen e paqes shoqërore, përhapjen e dashurisë dhe paqes në shoqëri, si dhe për largimin e çdo gjëje që cenon qetësinë e shoqërisë dhe prish paqen e saj.

Kjo u arrit nëpërmjet disa gjërave:

Së pari: Ruajtja e paqes shoqërore

Kjo u bë duke u kujdesur për stabilitetin dhe qetësinë e shoqërisë, vazhdimësinë e harmonisë së saj dhe ruajtjen e bashkëjetesës mes anëtarëve të saj. Për këtë arsye, hapi i parë në formimin e shoqërisë së Medinës ishte garantimi i paqes shoqërore mes përbërësve të saj të ndryshëm në fe dhe fise. Në atë kohë, pas Hixhretit, shoqëria në Medinë përbëhej nga muslimanë, hebrenj dhe idhujtarë, kurse fiset ishin kurejshët, evsit, hazrexhit dhe fiset hebreje.

Prandaj, lidhja e parë që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* forcoi mes fijeve të shoqërisë ishte **vëllazërimi mes muhaxhirëve dhe ensarëve**, i cili arriti deri në trashëgimi mes tyre, derisa kjo u abrogua më vonë, por vëllazëria mbeti. Me këtë vëllazëri fetare midis muhaxhirëve dhe ensarëve u forcua lidhja, edhe pse ishin të ndryshëm në prejardhje dhe vendbanim.

Më pas, ai shkroi në **Kushtetutën e Medinës** marrëveshje që ruanin marrëdhëniet paqësore mes të gjithë përbërësve të shoqërisë dhe vendosnin bazat e bashkëjetesës mes tyre. Prandaj, në të gjejmë dispozita që theksojnë paqen dhe ruajnë vazhdimësinë e saj, ndër të cilat:

1. Hebrenjtë janë një bashkësi me besimtarët; hebrenjtë kanë fenë e tyre dhe muslimanët kanë fenë e tyre, së bashku me aleatët e tyre dhe vetveten, përveç atij që bën padrejtësi ndaj vetes.

2. Hebrenjtë mbulojnë shpenzimet e tyre dhe muslimanët mbulojnë shpenzimet e tyre; mes tyre është ndihma e ndërsjellë kundër kujtdo që lufton pjesëtarët e kësaj marrëveshjeje; ata kanë mes tyre këshillim të sinqertë dhe bamirësi, pa mëkat.

3. Ky dokument nuk mbron asnjë që është zullumqar apo mëkatar; kushdo që del (nga qyteti) është i sigurt dhe kushdo që qëndron në Medinë është i sigurt, përveç atij që bën padrejtësi ose mëkat.

Me këtë, Ithtarët e Librit që jetonin në Medinë u konsideruan qytetarë dhe se ata janë një bashkësi me besimtarët, përderisa u përmbahen dhe i përmbushin detyrimet që u takojnë. Ndryshimi i fesë nuk ishte shkak për t'i privuar nga qytetaria dhe të drejtat qytetare.

Para Betejës së Bedrit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, duke kaluar rrugës, hasi një tubim ku ishin mbledhur bashkë muslimanë, idhujtarë dhe hebrenj. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e shfrytëzoi këtë situatë për polemikë, por menjëherë përshëndeti me selam dhe dha urimin e paqes, pastaj u ul me ta dhe i ftoi në rrugën e Allahut, duke iu lexuar Kuranin.

Atëherë, Abdullah ibn Ubej veproi me një mënyrë tjetër për të nxitur përçarje - një qasje e mbushur me qëllime të liga dhe dyshime ndaj sinqeritetit të të Dërguarit të vërtetë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Debati u ndez derisa muslimanët, idhujtarët dhe hebrenjtë u grindën, duke kaluar edhe në goditje me duar, me shkopinj dhe me sandale.

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përpoq t'i qetësonte dhe t'i ulte tensionet; turma u qetësua, sepse ai synonte stabilitetin dhe qetësinë e shoqërisë.

Pastaj, pasi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i qetësoi, ai u largua për të shuar plotësisht fitilin e konfliktit, sepse po të kishte qëndruar, përçarja dhe mosmarrëveshja do të vazhdonin.

Vërejmë, gjithashtu, se ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk i qortoi muslimanët për uljen e tyre në atë mbledhje të përzier dhe nuk u kërkoi të largoheshin prej saj pasi ai vetë u largua, sepse shoqërimi dhe takimi janë nga shkaqet e bashkëjetesës, pajtimit dhe ruajtjes së paqes shoqërore.

Këtë nuk ua ndaloi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Përkundrazi, ai ndoqi rrugën e përfshirjes, mirëkuptimit dhe shoqërimit të mirë, duke ruajtur sigurinë dhe paqen e shoqërisë, në mënyrë që thirrja të përhapej duke kapërcyer pengesat e armiqësisë dhe urrejtjes.

Kur vdiq Abdullah ibn Ubej, në vitin e nëntë pas çlirimit të Mekës, pasi i gjithë Gadishulli Arabik, tashmë, e njihte autoritetin e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai veproi me një madhështi të jashtëzakonshme morale.

Xhabir ibn Abdullahu *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* tregon: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi te Abdullah ibn Ubej pasi ai ishte vendosur, tashmë, në varrin e tij. Ai urdhëroi ta nxirrnin, e vendosi mbi gjunjët e tij, i pështpëriti mbi të me pështymën e tij dhe e mbështolli me këmishën e tij. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte dy këmisha dhe biri i Abdullahut i tha: "O i Dërguari i Allahut, vishi babait tim këmishën tënde që prek lëkurën tënde."[879]

Në këtë gjest kishte ngushëllim për familjen e Abdullah ibn Ubejit, përfshirje dhe afrimitet ndaj pjesës tjetër të fisit të tij nga hazrexhët, si dhe mbylljen e faqes së armiqësisë së tij, pavarësisht ashpërsisë dhe hidhërimit që ajo kishte.

Së dyti: Shmangia e asaj që mund të prishë paqen shoqërore

1. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i kujdesshëm për të shuar shkaqet e tensioneve që mund të prishnin paqen shoqërore, të krijonin armiqësi në zemrat e njerëzve dhe të përgatitnin terrenin për përçarje brenda shoqërisë.

2. Kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shpërndau plaçkën e luftës në betejën e Hunejnit, ai u dha udhëheqësve të kurejshëve - të cilët sapo kishin lënë pas armiqësinë dhe luftën kundër tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - dhurata të mëdha e bujare. Ndërsa muhaxhirët dhe ensarët nuk morën asgjë

[879] Buhariu, 1350. Muslimi, 2773.

prej saj. Kjo bëri që disa nga ensarët të ndienin në zemrat e tyre pakënaqësi dhe të thoshin: "Allahu ia faltë të Dërguarit; ai po u jep kurejshëve, ndërkohë që shpatat tona ende pikojnë nga gjaku i tyre!"

Atëherë, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mblodhi ensarët dhe u mbajti një fjalim ku tha: "*Kurejshët sapo kanë dalë nga injoranca dhe nga një sprovë e rëndë, ndërsa unë desha t'i afroj ata dhe t'i fitoj zemrat e tyre. A nuk jeni të kënaqur që njerëzit të kthehen në shtëpitë e tyre me pasuri, ndërsa ju të ktheheni në shtëpitë tuaja me të Dërguarin e Allahut? Sikur njerëzit të ndiqnin një luginë dhe ensarët një shteg malor, unë do të ndiqja shtegun e ensarëve.*"[880]

Kështu, ai e trajtoi plagën psikologjike te kurejshët me dhurata bujare, si shenjë nderimi, dhe e qetësoi zemrën e ensarëve duke mos lejuar që ndjenja e dhënies përparësi të tjerëve para tyre të zmadhohej. Ata u prekën nga fjalët e tij, qanin para tij dhe u kthyen të lumtur për pozitën që kishin tek ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. E gjitha kjo ishte për ruajtjen e harmonisë dhe paqes shoqërore.

3. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Oj Aishe! Sikur populli yt të mos ishte i sapo dalë nga shirku, do ta shembja Qaben dhe do ta niveloja me tokën; do t'i vendosja asaj dy dyer: një në lindje dhe një në perëndim; dhe do ta zgjeroja gjashtë krahë deri te themelet e saj* (pjesën e Hixhrit). *Sepse kurejshët e ngushtuan atë kur e rindërtuan.*"[881]

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha këtë pasi u çlirua Meka dhe u fuqizua pushteti i tij; ai u bë komandanti i pranuar në Gadishullin Arabik. Sikur të vepronte atëherë sipas dëshirës së tij, askush nuk do të mund t'i kundërshtonte urdhrin, por ai preferoi të qetësonte zemrat e njerëzve për të mos shkaktuar largim ose kundërshtim ndaj këtij veprimi. Prandaj, ai vendosi paqen shoqërore mbi dëshirën e tij për rindërtimin e Qabes mbi themelet e Ibrahimit *(paqja e Allahut qoftë mbi të)*, sepse ndërtimi i fesë dhe ruajtja e paqes së shoqërisë ishte më e rëndësishme se rindërtimi i Qabes.

[880] Muslimi, 1059.
[881] Buhariu, 1585. Muslimi, 1333.

Së treti: Trajtimi i situatave që mund të shkaktojnë përçarje

Ndonjëherë lindin situata që mund të jenë shkak për trazira ose sprova dhe që mund të zhvillohen në përçarje, konflikt dhe luftë. Prandaj *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjithmonë ndërhynte për t'i menaxhuar këto situata, duke trajtuar shkaqet e tyre, duke qetësuar tensionet dhe duke zvogëluar ndikimin e tyre.

Disa nga këto janë:

1. Gjatë betejës së Beni el Mustalik, Abdullah ibn Ubej tha: "Nëse kthehemi në Medinë, më i fuqishmi do të nxjerrë më të dobëtin prej saj", duke nënkuptuar veten më të fuqishmin dhe të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më të dobëtin. Kur arriti lajmi te i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai u frikësua që fjalët e tij të përhapen mes ushtrisë. Prandaj, urdhëroi marshim në një orë jo të zakonshme dhe i shpërndau gjatë natës, duke i lodhur deri në atë masë sa nuk dëshironin gjë më shumë se t'i shtrinin trupat e tyre në tokë për të pushuar.

Kur Umeri i tha: "O i Dërguari i Allahut, më lër t'ia godas qafën e tij!" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu përgjigj: *"Njerëzit nuk duhet të flasin se Muhamedi po eliminon shokët e tij."*[882]

Kur djali i Abdullah ibn Ubejit u frikësua se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mund të urdhëronte vrasjen e babait të tij, shkoi tek i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, më ka arritur lajmi se dëshiron të vrasësh Abdullah ibn Ubejin. Nëse patjetër duhet bërë, më urdhëro mua, unë do ta sjell kokën e tij." I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu përgjigj: *"Jo, ne do të tregohemi të butë dhe do të sillemi mirë me të, sa të jetë pranë nesh."*[883]

Shiko se si Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i shpërndau njerëzit duke i bërë të lëvizin gjatë natës, për t'i shmangur nga përqendrimi mbi këtë fjalë të rrezikshme dhe pasojat e saj. Pastaj vëre se si mori parasysh pasojat nëse ai do të kishte vrarë Abdullah ibn Ubejin - çfarë do të thoshin njerëzit dhe si do të ndikonin këto fjalë në shoqëri.

---

[882] Buhariu, 3518. Muslimi, 2584.

[883] *"Siretu Ib Hisham"*, 2/292.

Shiko, gjithashtu, butësinë dhe delikatesën e tij ndaj djalit të Abdullahut, dhe mënyrën se si nuk tha thjesht "le ta lëmë", por tha: "*Jo, ne do të tregohemi të butë dhe do të sillemi mirë me të, sa të jetë pranë nesh.*"

Së katërti: Parandalimi i shkaqeve të përçarjes shoqërore

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndalonte gjithçka që mund të shkaktonte trazira dhe përçarje brenda shoqërisë. Një nga këto ishte **mburrja fisnore**, një zakon i trashëguar nga koha e injorancës, madje një zakon i rrënjosur në shoqërinë arabe të asaj kohe.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndaloi këtë dhe paralajmëroi për të, sepse ishte shkak për ndarjen e shoqërisë. Prandaj, paralajmërimi i tij ishte i thellë dhe i qartë, saqë e konsideroi çështje të injorancës.

Xhabir ibn Abdullahu *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* tregon: "Ishim në një betejë, dhe një njeri nga muhaxhirët u përplas[884] me një nga ensarët. Ensariu tha: 'O ensarë' dhe muhaxhiri tha: 'O muhaxhirë'."

Për këtë arsye, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e paralajmëroi fuqishëm duke thënë: "*Lëreni atë thirrje, sepse është e ndyrë.*"

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* sqaroi se nxitja e përçarjeve dhe trazirave mes tyre është pasion i djallit, i cili nuk dorëzohet nga përpjekjet për të ndarë njerëzit: "*Djalli e ka humbur shpresën që namazfalësit e Gadishullit Arabik ta adhurojnë atë, por ai vazhdon t'i nxisë kundër njëri-tjetrit.*"[885]

Gjithashtu, ndalohen shkaqet e grindjeve. Ebu Hurejre transmeton se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Kini kujdes nga paragjykimi, sepse paragjykimi thotë gjërat më të rreme; mos u bëni alergjikë, mos e spiunoni njëri-tjetrin, mos kini smirë njëri-tjetrin, mos u distanconi nga njëri-tjetri, mos urreni njëri-tjetrin, dhe jini robër të Allahut, vëllezër mes jush.*"[886]

---

[884] E goditi me dorë vitheve. "*El Nihajetu*", 4/173.
[885] Muslimi, 2812.
[886] Buhariu, 6064. Muslimi, 2563.

Së pesti: Përgatitja e shoqërisë me shkaqet e afërsisë dhe harmonisë shoqërore

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* synonte të kultivonte moral të lartë dhe të bukur, që të rrisë afërsinë, të zvogëlojë grindjet dhe të përhapë dashurinë dhe përkujdesjen mes njerëzve. Kjo shihet në shumë hadithe:

Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: *"Obligimet e muslimanit ndaj muslimanit janë pesë: t'i përgjigjet selamit, të vizitojë të sëmurin, të shoqërojë xhenazen, t'i përgjigjet ftesës, dhe të lutet kur teshtin."*[887] Këto cilësi janë shkak i afërsisë dhe përhapjes së paqes shoqërore.

Gjithashtu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Për çdo kyç të trupit duhet dhënë sadaka çdo ditë! Të ndihmosh njeriun të hipë mbi kafshën e tij apo të ngarkojë plaçkat e tij është sadaka. Fjala e mirë dhe çdo hap që e bën për te namazi është sadaka. Të orientosh dikë në rrugë është sadaka."*[888]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, gjithashtu, tha: *"Nuk hyni në Xhenet derisa të besoni! Dhe nuk besoni derisa ta doni njëri-tjetrin! A doni t'ju tregoj diçka që, nëse e bëni, do ta doni njëri-tjetrin!? Përhapni selamin mes jush."*[889]

Pra, buzëqeshja, përhapja e selamit, fjala e mirë, vizita e të sëmurit, pranimi i ftesave, lutja për teshtitjen, namazi me xhemat dhe bashkëpunimi qoftë edhe me gjëra të vogla si mbushja e kovës së shokut me ujë nga kova jote, të gjitha këto janë mënyra për të përhapur dashurinë dhe miqësinë në shoqëri, duke e bërë atë një shoqëri të paqes dhe dashurisë.

Së gjashti: Paralajmërimi kundër përçarjes së bashkësisë së përbashkët

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* paralajmëroi për çdo gjë që mund të shpërndajë bashkësinë e muslimanëve,

[887] Buhariu, 2162. Muslimi, 1240.
[888] Buhariu, 2891. Muslimi, 720.
[889] Muslimi, 54.

të dobësojë unitetin e tyre dhe të shkaktojë përçarje ose luftë mes tyre. Prandaj, ai urdhëroi qëndrimin të bashkuar dhe ndaloi ndarjet.

Hadithet theksojnë domosdoshmërinë e dëgjimit dhe bindjes ndaj prijësit. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Dëgjoni dhe binduni, edhe sikur t'ju drejtojë një abisinas koka e të cilit është si rrush i thatë."*[890]

Kjo, sepse paqja dhe siguria e bashkësisë varen nga uniteti i saj dhe stabiliteti i udhëheqjes. Kur prishet uniteti, lind përçarja; dhe kur dobësohet pushteti, lind kaosi dhe trazira.

I Dërguari dhe politika e jashtme

1. Shumë prej atyre që jetonin në zonat e ndryshme të Gadishullit Arabik kishin pak kontakt me politikën ndërkombëtare, për shkak të largësisë së gadishullit nga kryeqytetet e perandorive dhe ndikimit të tyre, si dhe sepse qeverisja në Gadishullin Arabik nuk ishte një qeverisje perandorake, por një qeverisje fisnore dhe krahinore.

Megjithatë, kurejshët dalloheshin për komunikimin e tyre ndërkombëtar, pasi Meka ishte një vend ekonomikisht i lidhur me botën dhe i ndërvepruar me zhvillimet ndërkombëtare. Banorët e saj kishin delegacione drejtuar mbretërve të romakëve, persëve dhe abisinëve, udhëtime tregtare në këto vende dhe marrëveshje me ta.

2. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* udhëtoi dy herë në Shamin e asaj kohe, gjatë të cilave u njoh me shtetet e mëdha dhe perandoritë, dhe fitoi një përfytyrim të drejtpërdrejtë për gjendjen politike të Perandorisë Romake dhe vendeve arabe veriore që ishin nën varësinë e saj, si dhe për rivalen e saj nga lindja - Perandorinë Persiane.

3. Në Mekë, bashkësia muslimane nuk përbënte ende një entitet politik dhe as një udhëheqje fisnore, prandaj komunikimi politik me rrethin e jashtëm ishte i kufizuar. Kontakti i parë ishte me mbretin e Abisinisë, Nexhashiun, në vitin e pestë të shpalljes, për të strehuar emigrantët tek ai. Më pas ndodhi emigrimi i dytë në Abisini në vitin

[890] Buhariu, 693.

e shtatë të shpalljes. Pastaj erdhi Besëlidhja e dytë e Akabes nga ensarët drejtuar të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për t'u shpërngulur në Medinë, për ta strehuar dhe për t'i dhënë atij ndihmë. Kjo ishte besëlidhja dhe marrëveshja më e rëndësishme në historinë e njerëzimit, me të cilën ndryshoi rrjedha e historisë dhe drejtimi i ngjarjeve të saj. Ndikimet e kësaj besëlidhje vazhdojnë deri më sot e deri në Ditën e Gjykimit. Me këtë besëlidhje feja u shndërrua nga një thirrje në një shtet dhe nga një grup në një bashkësi ku mishërohen mësimet dhe dispozitat e fesë.

Më pas, pas Hixhretit, u arrit marrëveshja midis Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe fiseve hebreje që banonin në Medinë për të bashkëjetuar ndërmjet tyre dhe për t'u ndihmuar kundër armikut të përbashkët, gjë që i ngjante një marrëveshjeje mbrojtjeje të përbashkët. Pastaj ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bëri marrëveshje me fiset që ndodheshin përreth Medinës, si Xhuhejna, Gifar dhe Benu Damra, të ngjashme me një marrëveshje për të mos sulmuar njëri-tjetrin.

Marrëveshja politike më e rëndësishme pas Hixhretit ishte Marrëveshja e Hudejbijes me Kurejshët, e cila ishte një armëpushim që Allahu e quajti ***"fitore të qartë"***; me këtë marrëveshje u forcua fronti i brendshëm dhe u zgjeruan marrëdhëniet e jashtme.

4. Në vitin e shtatë pas Hixhretit, pasi u sigurua fronti i brendshëm me Marrëveshjen e Hudejbijes, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dërgoi letrat e tij tek shtetet e mëdha në Azi, Evropë dhe Afrikë. Ai dërgoi letër tek Kisra i Persisë, tek Cezari i Romës, dhe tek udhëheqësi i koptëve në Aleksandri. Po ashtu, i shkroi mbretërve dhe princave që vareshin drejtpërdrejt prej tyre, si mbretërve të Abisinisë, Bahrejnit, Omanit, Jemenit, Nexhranit, Jemames, Hadrameutit, Ailes dhe të tjerëve. Disa prej tyre iu përgjigjën dhe shpëtuan, ndërsa disa të tjerë u kthyen mbrapsht dhe u shkatërruan.[891]

Në letrat e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* drejtuar mbretërve vërejmë ndërthurjen mes përgëzimit dhe paralajmërimit, dhe se ato ishin një ftesë për në Islam, jo për pushtet e as për nënshtrim politik.

[891] Shkurtimisht nga koleksioni "*Mexhmuatu el Vethaiki el Sijasijeti li el Ahdi el Nebeviji ve el Hilafeti el Rashidi*", 26, 27.

Ebu Sufjani ibn Harbi tregon se Herakliu kërkoi letrën e të Dërguarit të Allahut, sal Allahu alejhi ve selem, të cilën ai e kishte dërguar me Dihjen tek udhëheqësi i Basras, dhe ky ia dorëzoi atë Herakliut. Herakliu e lexoi dhe në të ishte shkruar:

"*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Nga Muhamedi, robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij, drejtuar Herakliut, udhëheqësit të romakëve. Paqja qoftë mbi atë që ndjek të vërtetën. Më pas: Unë të thërras me thirrjen e Islamit – pranoje dhe do të shpëtosh. Prano dhe Allahu do të të japë shpërblimin tënd dyfish. Por nëse kundërshton, atëherë mbi ty bie mëkati i arianëve.* ***"Thuaj: "O Ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë*** (në adhurim) ***dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!" Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: "Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!"*** (Ali Imran: 64)

Komunikimi me mbretërit, qoftë mbret apo udhëheqës, ka kriteret e tij të veçanta, ashtu siç veproi Pejgamberi i Allahut, Sulejmani *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* me mbretëreshën e Sebës, kur i shkroi: ***"Ajo është nga Sulejmani dhe është: "Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Mos u madhështoni para meje dhe ejani të përulur si besimtarë"!"*** (En-Neml: 30-31)

Prandaj, në letrat e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që na janë transmetuar, gjejmë forcë dhe siguri, përgëzim dhe paralajmërim, si dhe një mesazh të qartë e të hapur.

5. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i kushtonte rëndësi zakoneve të pranuara botërisht, të cilat ngjasojnë me marrëveshjet ndërkombëtare, si, për shembull, parimi që lajmëtarët (emisarët) nuk vriten. Gjithashtu, ai mori parasysh edhe rregullin ndërkombëtar në korrespondencë, që letrat zyrtare të ishin të vulosura. Për këtë arsye, "ai bëri një unazë prej argjendi, mbi të cilën ishte gdhendur: Muhamedi, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*".[892]

[892] Buhariu, 65. Muslimi, 2092.

6. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e së drejtës së përbashkët dhe të pranuar nga të gjithë. Për këtë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha për kurejshët në Hudejbije:

"Betohem në Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, nëse më kërkojnë ndonjë plan ku madhërohen shenjtëritë e Allahut, unë do t'ua jap."[893]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, gjithashtu, tha:

"Kam qenë i pranishëm në shtëpinë e Abdullah bin Xhud'an në një marrëveshje, nëse do të ftohem për të edhe në Islam, do t'i përgjigjem."[894]

Vini re se ai tha: *"Nëse do të ftohem"*, e jo "nëse do të ftoja", që do të thotë se ai do t'i përgjigjej çdo ftese që synon të arrijë bashkëpunim në të mirë dhe bamirësi, edhe nëse ftesa vinte nga një shtet tjetër me fe të ndryshme nga e tij.

7. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndiqte metodën e thirrjes me atë mënyrë që është më e mira dhe zgjidhte butësinë në të folur, por kur përballej me tradhti apo shkelje, merrte anën e vendosmërisë dhe forcës. Kështu veproi me hebrenjtë kur tradhtuan dhe ashtu veproi me kurejshët kur shkelën Marrëveshjen e Hudejbijes. Po ashtu, ai dërgoi ushtrinë në Mu'të kur u vra i lajmëtari i tij që kishte nisur për në Sham.

Kur muslimanët dëgjuan se fisi Gassan po mbathte kuajt me patkonj për të sulmuar të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai i parapriu ngjarjes dhe u nis me ushtrinë drejt Tebukut, e cila ishte më shumë se gjysma e rrugës deri në Sham. Me vete kishte ushtrinë më të madhe që kishte mbledhur ndonjëherë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për një betejë dhe udhëtimin më të largët që kishte bërë pas shpalljes. Kur arriti në Tebuk, gassanët dhe aleatët e tyre romakë u tërhoqën dhe nuk u përballën me të. Kështu gjatë këtij udhëtimi ai realizoi marrëveshje të shumta me të cilat shënuan çlirimin e veriut të Gadishullit Arabik.

8. Politika e jashtme profetike ishte e ndërtuar mbi parimet dhe vlerat e Ligjit Islam, ndërkohë që marrëdhëniet ndërmjet shteteve asokohe arriheshin me luftë, grabitje, shfryrje hakmarrjeje dhe ndëshkim. Për këtë arsye, Ligji Islam vendosi frymën e bashkëpunimit

[893] Buhariu, 2731.
[894] *"El Bidajetu ve el Nihajetu"*, 2/692.

në hapësirën e përbashkët të së mirës dhe të bashkëpunimit në bamirësi e virtyt, si dhe mbrojtjen e lirisë fetare: "***S'ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra!"*** (El-Bekare: 256) Edhe pse i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregoi kujdes të veçantë për udhëzimin e njerëzve dhe bënte përpjekje të mëdha për t'i thirrur ata, megjithatë ai nuk e detyroi askënd të pranonte fenë dhe feja nuk është e vlefshme nëse imponohet me detyrim.

9. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, gjithashtu, respektoi dhe madhëroi marrëveshjet e kontratat, dhe e theksoi domosdoshmërinë e përmbushjes së tyre, duke vepruar sipas fjalës së Allahut: "***O besimtarë! Plotësoni detyrimet!"***[895] (El-Maide: 1) Nga Burejde transmetohet se, kur i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* caktonte një komandant mbi një ushtri ose një ekspeditë, e këshillonte atë në veçanti për devotshmëri ndaj Allahut dhe për kujdes ndaj muslimanëve që kishte me vete, pastaj thoshte:

"*Luftoni me emrin e Allahut, në rrugën e Allahut, luftoni ata që mohojnë Allahun. Luftoni, por mos tradhtoni, mos përvetësoni padrejtësisht* (nga plaçka e luftës), *dhe mos gjymtoni* (trupat e vrarëve)."[896]

I Dërguari dhe e ardhmja

1. Ajetet kuranore theksojnë qartë se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e dinte të fshehtën - *Gajb,* pra nuk e dinte çdo të ndodhte në të ardhmen. Ai vetë nuk ka pretenduar kurrë një gjë të tillë. Ajeti thotë: ***"Thuaj: "Unë nuk ju them se zotëroj thesaret e Allahut apo se e di të padukshmen"*** (El-En'am: 50); ***"Sikur ta dija të padukshmen, do t'i shumoja të mirat dhe nuk do të më prekte asnjë e keqe."*** (El-A'raf: 188)

Prandaj, çdo gjë që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka lajmëruar për të ardhmen nuk është tjetër veçse

[895] Fjala "***el Ukud***" e përkthyer "***detyrimet***" në ajet flet për marrëveshjet, të cilat është detyrim të përmbushen.
[896] Muslimi, 1731.

shpallje nga Allahu ose një e fshehtë e veçantë që Allahu ia ka bërë të ditur. Për këtë Allahu i Madhërishëm thotë: ***"Vetëm Ai e di të padukshmen dhe nuk ia zbulon atë askujt, përveç të dërguarve që ka zgjedhur."*** (El-Xhin: 26-27)

Pra, informacionet për të ardhmen që ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka treguar - qoftë ato që kanë ndodhur, qoftë ato që ende nuk kanë ndodhur - janë *Gajb* i veçantë, të cilin Allahu i Madhërishëm ia ka dhënë Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për një urtësi të veçantë: ngushëllim dhe shpresë, ose për të paralajmëruar dhe këshilluar. Këtu përfshihen lajmet e gëzueshme për përhapjen e fesë dhe çlirimet e ardhshme, si dhe paralajmërimet për sprovat dhe shenjat e Ditës së Kijametit.

Njohja e këtyre të fshehtave - *Gajb* nuk është zgjedhje e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, por shpallje prej Allahut të Lartësuar që ia zbulon atij diçka nga e ardhmja dhe sigurisht vetëm ato gjëra njohja e të cilave ka një urtësi të veçantë. Për shembull, shpallja vonoi në ngjarjen e Shpifjes - *Ifk*, me gjithë dhimbjen, ashpërsinë dhe vështirësinë e situatës, por kjo për urtësi të shumta një prej tyre është për të treguar se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk i di të panjohurat dhe shpallja vjen vetëm me urdhër të Allahut.

Në ngjarjet e *Sires* tregohet se deveja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* humbi gjatë kthimit nga Beteja e Tebukut. Njëri prej hipokritëve tha: "Muhamedi pretendon se i vijnë lajme nga qielli, ndërkohë që nuk di ku është deveja e tij!"

Kur i erdhi lajmi të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për fjalët e tij, për të dhe për devenë e tij, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Dikush tha se Muhamedi pretendon se i vijnë lajme nga qielli ndërkohë që nuk di ku është deveja e tij! Është e vërtetë! Pasha Allahun! Unë nuk di gjë tjetër përveç asaj që më mëson Allahu! Allahu më tregoi edhe për devenë, ajo është në këtë luginë dhe kapistra e saj është penguar në degët e një peme!"* Disa burra nga muslimanët shkuan dhe e gjetën atë pikërisht aty

ku kishte thënë i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ashtu si e kishte përshkruar.[897]

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lajmëroi për disa të panjohura që Allahu ia zbuloi atij, por ai paralajmëroi pretendimin për njohjen e të panjohurave, qoftë të pretendojë se i di vetë apo të besojë pretendimin e dikujt tjetër, gjë që ishte mjaft e përhapur mes arabëve. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thotë: "*Kush shkon tek një fallxhor apo një njeri që pretendon se di të fshehtën dhe i beson fjalëve të tij, atëherë ai ka mohuar atë që është zbritur mbi Muhamedin.*"[898]

2. Lajmet që dha i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të ardhmen flisnin për fitoren e Islamit dhe përhapjen e tij, edhe në rrethana nga më të errëtat dhe më të vështirat. Kur ai ishte në Mekë, i shoqëruar vetëm nga një grup i vogël i dobët e i shtypur, të cilët i ankoheshin për vështirësitë dhe padrejtësitë, ai u thoshte: "*Pasha Allahun! Allahu do ta plotësojë këtë çështje derisa një udhëtar të ecë nga Sanaja deri në Hadrameut pa pasur frikë tjetër veç Allahut të Lartësuar dhe ujkut për kopenë e tij. Por ju po nxitoni.*"[899]

Po aty në Mekë, ndërsa Kurejshët ishin në kulmin e arrogancës dhe pushtetit të tyre, iu shpall fjala e Allahut: ***"Së shpejti do të thyhet grupi dhe*** (secili prej tyre) ***do t'ia mbathë."*** (El-Kamer: 45)

Gjithashtu, kur ishte në momentet e rënda dhe të vështira të Betejës së Hendekut, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dha lajmin për hapjen e pallateve të Shamit, të Persisë dhe të Sanasë. Kjo ishte një mrekulli profetike, sepse ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* fliste për një rezultat që ende nuk kishte asnjë shenjë apo parathënie për të: triumfin e fesë dhe përhapjen e saj. Përkundrazi, një vështrim sipërfaqësor e i shpejtë i rrethanave të asaj kohe tregonte të kundërtën. Megjithatë, ai e tha këtë me siguri dhe besim të plotë - gjë që është nga dëshmitë e profetësisë. Pastaj Allahu ia vërtetoi premtimin dhe ai vetë ose shokët e tij panë me sytë e tyre përmbushjen e asaj me të cilën i kishte përgëzuar.

---

[897] "*Siretu Ibn Hisham*", 2/125.

[898] Ahmedi, 9536.

[899] Ebu Davudi, 2649.

Këto lajme ishin një mbështetje për zemrën e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe një forcim për bindjen e sahabëve, të cilët në çastet e vështira e të rënda gjenin tek ato frymë shprese dhe përgëzimi.

3. Shumë prej atyre që njoftoi i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndodhën gjatë jetës së tij. Fjalët e Allahut të Lartësuar: "***Së shpejti do të thyhet grupi dhe*** (secili prej tyre) ***do t'ia mbathë***" u realizuan në Betejën e Bedrit. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli nga çadra e tij duke thënë[900]: ***"Së shpejti do të thyhet grupi dhe*** (secili prej tyre) ***do t'ia mbathë. Madje, Ora*** (e Kijametit) ***do të jetë takimi i tyre dhe Ora do të jetë më e tmerrshme dhe më e hidhët."*** (El-Kamer: 45-46)

Gjithashtu, fjala e Allahut: ***"Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi*** (i Mekës) ***dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe."*** (En-Nasr: 1-2) u realizua në jetën e tij, në vitin e nëntë të Hixhretit, i cili u quajt "*Viti i delegacioneve*", për shkak të numrit të madh të fiseve që vinin për të dhënë besën dhe për të shpallur Islamin e tyre e hyrjen në fenë e Allahut.

Po ashtu, fjala e Allahut: ***"Elif, Lâm, Mîm. U mundën bizantinët, në afërsi të tokës*** (arabe)**, por, pas thyerjes së tyre, me siguri do të fitojnë"** (Er-Rum: 1-3) iu shpall atij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në një kohë kur romakët kishin pësuar një disfatë të rëndë shkatërruese, aq sa rrethimi kishte mbërritur deri në kryeqytetin e tyre, Kostandinopojë. Çdo tregues i asaj kohe dëshmonte se ata nuk do të mund të ringriheshin më kurrë. Megjithatë, Kurani e pohonte me siguri se ata do të fitonin përsëri, madje brenda një afati të caktuar: ***"Por pas thyerjes së tyre, me siguri do të fitojnë."*** (Er-Rum: 3) Këtë e përjetuan vetë muslimanët që dëgjuan shpalljen e tij.

4. Shumë prej lajmeve të ardhshme që dha i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u realizuan në jetën e Sahabëve, të cilëve ua tregoi, siç ishte përgëzimi i tij për hapjen e pallateve të Shamit dhe të Persisë, çlirimin e *Bejtu'l Makdisit*, si edhe sigurinë aq të madhe saqë një grua udhëtare do të mund të nisej nga Hira deri në Mekë pa frikë tjetër veç Allahut.

---

[900] Buhariu, 2915. Muslimi, 1763.

Po ashtu, kur i tha Umu Haram bint Milhanit - pasi u zgjua nga gjumi duke qeshur: *"Disa njerëz nga Umeti im mu shfaqën si luftëtarë në rrugë të Allahut, duke lundruar mbi valët e këtij deti, sikur të ishin mbretër të ulur mbi frone."*

Ajo i tha: "O i Dërguar i Allahut, lute Allahun që të më bëjë prej tyre." I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lut për të. Pastaj vuri sërish kokën dhe ra në gjumë, pastaj u zgjua përsëri duke qeshur. Ajo e pyeti: "O i Dërguar i Allahut, pse po qesh?" Ai tha: *"Disa njerëz nga Umeti im mu shfaqën si luftëtarë në rrugën e Allahut"* - njësoj siç kishte thënë herën e parë.

Ajo i tha: "O i Dërguar i Allahut, lute Allahun që të më bëjë prej tyre." Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu përgjigj: *"Ti do të jesh ndër të parët."* Dhe vërtet, ajo lundroi në det bashkë me ushtrinë gjatë kohës së Muavije ibn Ebi Sufjanit, por ra nga kafsha e saj kur sapo kishte dalë nga deti dhe vdiq.[901]

Në atë kohë arabët nuk kishin asnjë njohuri për luftërat detare, por Umu Haram e pranoi këtë me bindjen e një besimtareje. Ajo nuk pyeti: Si është e mundur? Si do të ndodhë kjo?", por menjëherë tha: "*Lute Allahun që të më bëjë prej tyre.*" Dhe ndodhi ashtu që ajo ishte prej tyre, duke rënë dëshmore në Ekspeditën e Qipros.

Ndër lajmet e së ardhmes që dha i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe që u realizuan më pas në periudha të ndryshme, është fjala e tij: *"Me të vërtetë, Allahu ma afroi tokën para syve të mi dhe pashë lindjen dhe perëndimin e saj. Mbretëria e Umetit tim do të shtrihet deri atje ku mu afrua mua. Mua më janë dhënë dy thesaret: i kuqi dhe i bardhi."*[902]

Ky zgjerim i Islamit ndodhi me kalimin e kohës derisa përfshiu skajet më lindore dhe më perëndimore të botës.

Po ashtu, ai njoftoi përhapjen e fesë, derisa të mos mbetet shtëpi prej druri a prej balte pa hyrë në të Islami.[903] Këtë e shohim të realizuar sot, falë shumëllojshmërisë së mjeteve të medias dhe mjeteve të komunikimit, saqë nuk gjen një cep të botës ku nuk ka mbërritur thirrja e Islamit.

---

[901] Buhariu, 2788.
[902] Muslimi, 289.
[903] Ahmedi, 23814.

5. Edhe pse i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori prej Allahu përgëzimet për fitoren dhe përhapjen e fesë, dhe ai vetë bashkë me shokët e tij i pritën ato me bindje të plotë, sikur t'i kishin parë me sytë e tyre, kjo nuk e pengoi atë të merrte masat e duhura, të vlerësonte rrethanat dhe t'i drejtonte ato me urtësi. Ai bënte përpjekje të mëdha për kujdes, përgatitje dhe vigjilencë. Për këtë arsye, gjatë Hixhretit ai mori rrugën bregdetare dhe shmangu rrugën e zakonshme që ndiqnin të gjithë.

Ndërsa në Betejën e Bedrit, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli me urdhër të Allahut, i Cili ia kishte premtuar njërën nga dy palët (karvanin ose ushtrinë), por, megjithatë, atë natë ai qëndroi gjatë në falje, duke iu lutur Allahut me përkushtim që t'i jepte ndihmën dhe përkrahjen e Tij.

Kjo tregon se besimi i plotë në premtimin e Allahut nuk e pengonte atë nga detyra e adhurimit ndaj Allahut, ndjenja e nevojës së vazhdueshme për Të dhe ngulmimi në lutje.

Prandaj, bindja e palëkundur në fitoren e Allahut dhe realizimin e premtimeve të Tij nuk do të thotë të shpërfillësh botën e shkaqeve dhe ecjen sipas ligjeve të vendosura nga Allahu në lidhje me funksionimin e gjërave në jetë. Për këtë arsye, në asnjë nga betejat e tij nuk gjejmë guxim të pamatur, aventurë të pa llogaritur, por, përkundrazi, përkushtim maksimal, marrje të masave dhe kujdes të madh për planifikim dhe drejtim të çështjeve.

6. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ashtu siç njoftoi për të ardhmen që iu zbulua përmes shpalljes, po ashtu njoftoi parashikime të tij për të ardhmen që mund të kuptohen si rezultat i largpamësisë dhe saktësisë së gjykimit të tij. Një shembull është fjala e tij për kurejshët pas Betejës së Hendekut, kur ata u kthyen të dështuar në Mekë: *"Tani e tutje, ne do t'i sulmojmë ata dhe jo ata neve."*[904]

Kjo, sepse forcat e mëdha që ata mblodhën për këtë betejë të humbur nuk mund të mblidheshin më kurrë njëherësh dhe sepse ata, tashmë, kishin shteruar fuqinë dhe burimet e tyre duke ardhur nga Meka dhe duke zgjatur rrethimin. Për këtë arsye, ky ishte fillimi

[904] Buhariu, 4110.

i reflektimit të disa prej mendimtarëve të tyre, si Amr ibn el Asi dhe Halid ibn el Velidi, për të rishikuar qëndrimet e tyre armiqësore të mëparshme - dhe ashtu ndodhi, sepse, vetëm një vit më vonë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi në Mekë për Umren e Hudejbijes dhe më pas erdhi për Çlirimin e Mekës.

Këto raste dhe të ngjashmet me to janë shembuj të largpamësisë dhe parashikimit të saktë, bazuar mbi shenjat dhe të dhënat që i tregonin ato. Nuk është e domosdoshme që të jenë shpallje hyjnore.

Dallimi mes tyre dhe lajmeve të fshehta - *Gajb*, për të cilat Allahu e ka njoftuar të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, është se *Gajbi* është zbulim i së fshehtës, për të cilën nuk kishte asnjë tregues në realitetin e jashtëm dhe nuk mund të arrihej tek ajo veçse përmes shpalljes hyjnore. Prandaj, ato janë një mrekulli profetike dhe jo një aftësi njerëzore.

7. Ndër shenjat e parashikimit të së ardhmes nga i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte edhe shumëllojshmëria e zgjidhjeve që ai bënte dhe kërkimi i mundësive, pa u ndalur përballë një dere të mbyllur. Prej shembujve të kësaj ishte paraqitja e tij te fiset e ndryshme, kur iu bë e qartë ashpërsia e prijësve të kurejshëve dhe këmbëngulja e tyre në mohim. Po ashtu, edhe udhëtimi i tij në Taif në kërkim të një toke të re ku të mbillej thirrja e tij.

Gjithashtu, edhe parapërgatitja për etapat e ardhshme dhe mirëpërgatitja për to. Për shembull, në udhëtimin e tij drejt Tebukut - me ushtrinë më të madhe që kishte drejtuar ndonjëherë dhe në distancën më të largët që kishte përshkuar prej se u dërgua - me gjithë vështirësitë, ai shoi arrogancën e romakëve dhe të pasuesve të tyre nga fisi i gasanitëve, të cilët përhapnin lajme se po mbathnin kuajt e tyre për të sulmuar të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në Medinë. Por, kur ai u nis drejt tyre dhe arriti në Tebuk, ata u tërhoqën nga ajo që kishin planifikuar.

Kjo betejë ishte një shtytje për Umetin dhe një përgatitje për të vazhduar çlirimet pas vdekjes së tij, për të cilat ai kishte përgëzuar me lajmin e fitores mbi pallatet e Kisras dhe Cezarit.

Po ashtu, largpamësia rreth përfundimeve dhe **vlerësimi i pasojave** dhe konsiderimi i ndikimit që mund të sjellin veprimet, gjë që dëshmohet nga fjala e tij drejtuar Aishes: *"Sikur populli yt të*

mos ishte i sapo dalë nga injoranca, do ta shpenzoja thesarin e Qabes në rrugë të Allahut, do ta ulja derën e saj në nivel me tokën dhe do ta zgjeroja për të përfshirë edhe Hixhrin."[905]

8. Ndër të fshehtat - *Gajb*, për të cilat ai ka lajmëruar janë edhe ngjarjet e mëdha dhe sprovat që do të ndodhin në fund të kohës. Këto nuk janë një parashikim për të ardhmen, e as diçka për të cilën Umeti duhet të punojë që ta realizojë, por thjesht një njoftim për atë që do të ndodhë patjetër. E njëjta gjë është edhe me ato që përmenden në Kuran lidhur me shenjat paralajmëruese të Ditës së Kijametit.

Është me rëndësi të theksohen disa çështje thelbësore në këtë drejtim:

a) Ajo që transmetohet mbi ngjarjet e mëdha dhe sprovat që do të ndodhin disa janë transmetime të dobëta, disa shumë të dobëta dhe disa janë shpifje.

b) Kërkimi që ato të ndodhin nuk është në dorën tonë; ato janë ngjarje që do të ndodhin patjetër dhe nuk presin që ne t'i shkaktojmë. Sa gjak është derdhur dhe sa luftëra janë ndezur me pretendime për të zbatuar disa nga tekste që flasin për fundin e kohës, duke pretenduar se ky është interpretimi dhe vërtetësia e tyre, siç ndodhi me pretendimet për Mehdiun, si Mehdiu i Muvahidinëve në Marok dhe Mehdiu në Sudan.

c) Një nga arsyet e përhapjes së këtyre pretendimeve është presioni i realitetit të rëndë të muslimanëve, vuajtjet e rënda dhe fatkeqësitë e njëpasnjëshme. Disa prej atyre që kanë pak dijeni shpesh i ndjekin këto lajme dhe i lidhin me ngjarje të caktuara, për t'iu shmangur vuajtjeve të jetës reale dhe për t'u strehuar nën atë që e quajnë çlirim dhe shpëtim për Umetin.

[905] Muslimi, 1333.

Kapitulli i Gjashtë:

I Dërguari dhe thirrja e tij - daveti

Edukimi profetik[906]

Allahu i Madhërishëm e dërgoi Pejgamberin e Tij, sal Allahu alejhi ve selem, mësues dhe e bëri mësuesin më të mirë për njerëzit që do t'u mësonte mirësinë. Ai, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të),* thotë: "*Allahu nuk më dërgoi as vështirësues as ashpërsues, por më dërgoi mësues dhe lehtësues."*[907] Ajetet kuranore i sqarojnë Umetit detyrën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe misionin me të cilin ai u dërgua, si dhe i ngarkojnë besimtarët që të marrin mësim prej tij. Allahu i Madhërishëm thotë: ***"Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin*** (Kuranin) ***e urtësinë*** (diturinë e thellë fetare)**, *edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar."*** (Ali Imran: 164)

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përdori mënyra të larmishme në edukim, në përputhje me dallimet e njerëzve në kapacitetet e tyre mendore dhe mjediset ku jetonin. Boshti i të gjitha këtyre mënyrave ishte edukimi i gjithanshëm në çdo fushë të jetës dhe përfshirja pjesëmarrëse dhe ndërvepruese e nxënësit në procesin edukativ.

Kur shikojmë edukimin profetik, e gjejmë të ndërthurur me vetë jetën; ai nuk kishte as vend të veçantë për mësim, as kohë të posaçme për të. Edukimi profetik ishte në harmoni me ritmin e jetës dhe shtrihej në veprimtaritë e saj. Për këtë arsye, e shohim Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të vëmendshëm dhe vigjilent, teksa shfrytëzonte rastet e ndryshme që i dilnin përpara gjatë rrugës ku ecte, në ushqimin që hante, në tubimin ku bisedonte, apo në një skenë që shihte bashkë me shokët e tij, të cilën e përdorte për t'ua tërhequr vëmendjen drejt një kuptimi më të thellë, të cilin e nënkupton situata konkrete. Këtë e gjen të shpërndarë kudo në *Siran* e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

---

[906] Rreth kësaj teme shiko librin "*El Resulu el Mual-limu"* të shejhut tonë, Abdu el Fettah Ebu Guddeh *(Allahu e mëshiroftë).* Prej tij kam përfituar për këtë temë.
[907] Muslimi, 1478.

Për këtë dëshmojnë:

Në një rast Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ulur me shokët e tij në Xhearana, kur papritur pa një grua të dëshpëruar që kërkonte me ankth e hutim foshnjën e saj të humbur. Gjendja e saj ishte e dhimbshme dhe prekëse: sytë i ishin cakërruar, flokët i ishin çrregulluar, gjiri i saj lëshonte qumësht dhe pamja e saj zgjonte dhembshuri për të dhe për fëmijën e humbur. Teksa ata po shikonin, gruaja më në fund e gjeti të birin. Zemra e saj u shpërthye nga ndjenjat, e mori në duar me padurim, e shtrëngoi në gjoks duke qarë me ngashërim dhe menjëherë e vuri në gji për ta ushqyer plot dashuri e përkujdesje.

Në atë çast të mbushur me emocion e dhembshuri, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u kthye nga sahabët dhe i pyeti: "*A mendoni se kjo nënë mund ta braktisë fëmijën e saj në zjarr?"* Ata iu përgjigjën menjëherë: "*Jo, pasha Allahun, kurrë nuk do ta braktisë, përderisa ka mundësi ta mbrojë*."

Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shfrytëzoi këtë pamje të afërt për t'u shpjeguar një të vërtetë të madhe dhe tha: "*Allahu është më i mëshirshëm me robërit e Tij se kjo nënë me fëmijën e saj."*[908]

Ky mësim nuk erdhi si rezultat i një përgatitjeje paraprake, e as situata nuk u sajua enkas për të, por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shfrytëzoi domethënien dhe gjendjen emocionale që krijoi ai moment, duke e kthyer në një skenë të mësimit. Ajo situatë mund të kishte kaluar si një pamje e zakonshme e jetës, por ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shndërroi në një mësim me kuptim të thellë dhe ndikim të madh. Dhe shokët e tij nuk do të na e kishin transmetuar këtë ngjarje, po të mos kishte qenë e lidhur me edukimin profetik.

Një shembull tjetër: Një burrë kaloi pranë Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Shokët e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* panë fuqinë dhe energjinë e tij dhe u mahnitën prej saj dhe thanë: "*O i Dërguar i Allahut, sikur kjo të*

[908] Buhariu, 5999. Muslimi, 2754.

ishte në rrugën e Allahut!" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*E ç'është rruga e Allahut, vallë, vetëm ai që lufton?! Nëse ai ka dalë për të punuar e për t'u kujdesur për fëmijët e tij të vegjël, atëherë ai është në rrugë të Allahut. Nëse ka dalë për të punuar për prindërit e tij të moshuar, atëherë ai është në rrugë të Allahut. Nëse ka dalë për të punuar e për ta ruajtur veten dhe nderin e tij, atëherë ai është në rrugë të Allahut. Por nëse ka dalë për t'u mburrur e për t'u dukur, atëherë ai është në rrugë të shejtanit.*"[909]

Ky njeri po kalonte pranë tyre duke ecur në rrugën e tij drejt punës. Pamja mund të kishte kaluar si shumë të tjera të zakonshme, por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shfrytëzoi admirimin e shokëve për forcën e tij dhe pyetjen e tyre se në çfarë do të ishte më e vlefshme ajo forcë, duke e kthyer këtë çast të thjeshtë në një mësim mbi vlerën e punës, mbajtjen e përgjegjësisë dhe zgjerimin e kuptimit të "*Xhihadit në rrugë të Allahut*", në mënyrë që të përfshijë çdo punë të mirë dhe të drejtë.

Të dy këtyre shembujve u ngjajnë shumë të tjerë, të shpërndarë në tekstet e Sunetit, ku çdo vepër nga veprat e tij dhe çdo cilësi nga morali i tij janë si argumente që recitohen, të gjitha shprehin me atë që urdhëron Kurani.[910]

Një kuptim tjetër i thellë i edukimit profetik është edhe përfshirja e nxënësit në procesin e edukimit, duke e bërë atë pjesëmarrës në arritjen e përfundimit: ndonjëherë përmes dialogut të drejtpërdrejtë, ku ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pyet dhe tjetri përgjigjet, e ndonjëherë përmes dialogut të tërthortë, ku ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bën një pyetje të përgjithshme dhe secili jep përgjigjen në vetvete.

Një shembull për këtë është hadithi i gruas që e pyeti Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "Obligimi i Allahut - d.m.th. Haxhi - e ka zënë babanë tim në pleqëri të thellë dhe ai nuk mund të qëndrojë mbi deve. A mund të kryej Haxhin në vend të tij?"

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*Ç'mendon, sikur babai yt të kishte një borxh, a do ta shlyeje ti për të?*" Ajo tha: "Po!" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha:

[909] "*El Muaxhemu el Evsatu*", Taberaniu, 6835.
[910] Shkurtimisht nga libri "*Tearifun Aam bi dijni ele Islam*" të Ali Tantavi, fq171.

"Atëherë, shlyejeni borxhin ndaj Allahut, sepse Allahu është më i denjë të shlyhet borxhi ndaj Tij."[911]

Sa i përket mënyrave të edukimit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ato ishin të shumta e të larmishme, sipas rastit dhe çfarë i përshtatej më së miri situatës. Por të gjitha ato përmblidhen në: tërheqjen e vëmendjes, çlirimin e mendjes nga shpërqendrimi dhe shpjegimin e qartë të kuptimit.

Nga këto janë:

1. Ngritja e pyetjes dhe kërkesa për përgjigje, pastaj sqarimi i përgjigjes së synuar

Një shembull për këtë është fjala e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: *"Në mesin e pemëve është një pemë që nuk i bien gjethet dhe ajo i ngjan muslimanit. Më tregoni cila është ajo?"*

Ai e bëri këtë pyetje ndërsa përpara tij kishte një palmë hurme. Shokët e tij u hutuan dhe menduan për pemët e shkretëtirës, si, për shembull, *samuri, salmi, tarfa* e të tjera të ngjashme. Por nuk e gjetën përgjigjen e saktë. Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ua sqaroi dhe tha: *"Ajo është palma e hurmës."*[912]

2. Përdorimi i mjetit ilustruese

Një shembull për këtë është hadithi i kalimit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në treg. Nga Xhabiri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* përcillet se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kaloi nëpër treg, duke hyrë nga njëra anë e lartë e Medinës dhe njerëzit ishin pranë tij. Aty pa një kec të ngordhur - *el Esek*[913]. Ai tha: *"Kush nga ju do ta blejë këtë me një dërhem?"* Ata thanë: "Nuk e duam, qoftë edhe për asgjë! Çfarë duhet ai?" Ai tha: *"A do të dëshironit ta kishit?"* Ata thanë: "Pasha Allahun, edhe sikur të ishte gjallë, do të ishte me të metë, sepse ka veshët e prerë; lëre më tani që është i ngordhur?!"

---

[911] Buhariu, 1513. Ibn Maxhe, 2909.

[912] Buhariu, 61. Muslimi, 2811.

[913] Përshkrimi i kecit *el Esek* do të thotë me veshë të prerë. *"El Nihajetu"*, 2/382.

Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Pasha Allahun, kjo botë është më e pavlerë për Allahun se ky për ju.*"[914]

Shiko, pra, se si në këtë skenë shumë të shkurtër, por jashtëzakonisht të fuqishme, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bashkoi një mori mënyrash mësimore: vendosjen e pyetjes, përdorimin e mjetit ilustruese, dhënien e shembullit krahasues, ndërsa të pranishmit ishin të përfshirë në pyetje e në arritjen e përfundimit.

3. Dhënia e shembullit krahasues

Kjo mënyrë zë një fushë shumë e gjerë në edukimin profetik, prandaj janë shkruar libra të tërë me titull "*Shembujt profetikë*". Këta shembuj edukativë ndihmojnë në afrim dhe sqarim të kuptimit. Ata merren nga mjedisi dhe përvoja e dëgjuesve, në mënyrë që përfytyrimi i tyre të jetë i lehtë.

Një shembull për këtë është hadithi: "*Shembulli i besimtarit që lexon Kuranin është si shembulli i limoni cedër: era e tij është e këndshme dhe shija e tij është e mirë. Shembulli i besimtarit që nuk lexon Kuranin është si shembulli i hurmës: nuk ka erë, por shija e saj është e ëmbël. Shembulli i hipokritit që lexon Kuranin është si shembulli i borzilokut: era e tij është e këndshme, por shija e tij është e hidhur. Ndërsa shembulli i hipokritit që nuk lexon Kuranin është si shembulli i kungullit të hidhur: nuk ka erë dhe shija e tij është e hidhur.*"[915]

4. Përafrimi i kuptimit me anë të skenës imagjinare

Kjo ndodh kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përshkruan një skenë të fuqishme për imagjinatën dhe e lidh atë me kuptimin e synuar. Është një lloj shembulli krahasues, por me një skenë të përfytyruar.

Shembull për këtë është hadithi: "*Pa mendoni sikur para derës së ndonjërit prej jush të kishte një lumë, ku ai lahet pesë herë çdo ditë. A do të mbetet tek ai ndonjë papastërti?*"[916] Ata thanë: "*Jo, nuk do të mbetet*

[914] Muslimi, 2857.
[915] Buhariu, 5427. Muslimi, 797.
[916] "*El Nihajetu*", 2/115.

tek ai asnjë papastërti." Ai tha: *"Ky është shembulli i pesë namazeve, me të cilat Allahu i fshin gjynahet."*[917]

Dhe mjafton të imagjinosh mjedisin e Medinës së thatë e shkretinore, ku njerëzit prisnin që ndonjëherë në vit të rridhte uji në luginën e Akikut, e të dilnin burrat dhe gratë për ta parë e për t'u gëzuar me rrjedhën e tij. Kurse Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e vendosi para tyre një pamje të tillë: një lum i bollshëm, jo larg, por te porta e secilit prej tyre. Pastaj e plotësoi skenën duke thënë: *"Ku ai lahet pesë herë çdo ditë."*

Si mund të jetë pastrimi i një personi që lahet pesë herë në ditë? Çfarë imazhi të pastërtisë dhe virtytit krijon kjo pamje?

Pastaj vjen pyetja: *"A do të mbetet tek ai ndonjë papastërti?"* Përgjigjja e menjëhershme ishte: *"Jo, nuk do të mbetet tek ai asnjë papastërti."* Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Ky është shembulli i pesë namazeve, me të cilat Allahu i fshin gjynahet."*

Do të mjaftonte që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thjesht të thoshte: "Namazet i fshijnë gjynahet", por sa larg është kjo nga mënyra që ai përdori, duke e paraqitur kuptimin me këtë fuqizim të ndjeshëm dhe këto metoda edukative, duke përfshirë edhe tërheqje të imagjinatës, që prek të gjitha pjesët e shpirtit dhe tërheq dëshirën e zemrës për të kuptuar mesazhin.

5. Kujdesi i veçantë për ata me mendje të shëndoshë dhe dijeni

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i kushtonte vëmendje dhe nxitje të veçantë njerëzve me aftësi të larta intelektuale dhe me njohuri, duke i inkurajuar dhe lavdëruar me fjalë që ishin si dëshmi e diplomimit dhe e përparimit të tyre.

Nga Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* përcillet se ai tha: "O i Dërguar i Allahut, kush është më i lumturi i njerëzve me ndërmjetësimin tënd Ditën e Ringjalljes?" Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Më shkoi mendja se askush tjetër nuk do ta bëjë këtë pyetje para teje, o Ebu Hurejre, nga kujdesi yt që ke për*

[917] Buhariu, 528. Muslimi, 667.

dijen. Më i lumturi i njerëzve me ndërmjetësimin tim Ditën e Kijametit është ai që kanë thënë: 'Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut', me sinqeritet të plotë nga zemra e tij."[918]

Po ashtu, Ubej bin Ka'bi tregon se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vuri dorën në kraharorin tim dhe më tha: "*Urime për diturinë, o Ebu el Mundhir!"*[919]

6. Edukimi profetik iu jepej me dashuri, mëshirë dhe kujdes prindëror

Muadh bin Xhebel *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më mori për dore dhe më tha: "*O Muadh! Vallahi, unë të dua ty! Vallahi, unë të dua ty! Të këshilloj, o Muadh! Mos e lër asnjëherë pas çdo namazi pa thënë: 'O Allah, më ndihmo të përkujtoj Ty, të falënderoj dhe të adhuroj siç duhet!'."*[920]

Shiko si e dha këtë këshillë me këtë afërsi, duke deklaruar dashurinë që ka për të, teksa e mban për dore, sikur kjo dashuri dhe mëshirë të rridhte nga dora e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tek dora e Muadhit.

Vallë! Si e priti dhe e përjetoi Muadhi këtë deklaratë profetike: "*O Muadh! Vallahi, unë të dua ty! Vallahi unë të dua ty!"*? Si mund të jetë ndjerë ai nga shoqëria kaq pranë e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe drita e fytyrës së tij fisnike ta ndriçojë atë!? Çfarë ndjenje do të ketë pasur teksa dora e tij ishte në dorën e të Dashurit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, e mbushur me dashuri dhe ngrohtësi!?

Një shembull tjetër: Abdullah bin Mes'udi tregon: "*Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) më mësoi Etehijatin teksa dorën time e kishte mbajtur me dy duart e tij, ashtu siç më mësonte suret e Kuranit."*[921]

A mund ta imagjinosh dorën e bin Mes'udit të mbjtur me dy duart e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* teksa

[918] Buhariu, 99.
[919] Muslimi, 810.
[920] Ebu Davudi, 1522.
[921] Buhariu, 6265. Muslimi, 402.

ai i mëson Etehijatin? Sa afërsi, ngrohtësi dhe ndjesi të veçantë dashurie dhe kujdesi përçon ky kontakt i drejtpërdrejtë! Dhe sa fort do të rrënjoset dituria kur jepet me dashuri dhe pozicionohet thellë në zemër?

7. Në një skenë të vetme edukative mund të gjejmë shumë lloje stimulimesh, nxitjesh dhe ilustrimesh, të cilat nuk përshkruhen dot vetëm me emërtim. Një shembull për këtë është rrëfimi i Muadh bin Xhebelit *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* në një situatë me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Shiko mjeshtërinë profetike në edukim, nxitjen e mendjes, përfshirjen e nxënësit në arritjen e dijes dhe nxitjen për ta pranuar atë:

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zgjodhi të jepte një mësim në një moment kur Muadhi ishte në një gjendje afërsie shpirtërore dhe mendore, duke përfshirë afërsinë fizike që vinte nga vendi ku të dy ishin ulur mbi shpinën e kafshës duke udhëtuar. Është shumë magjepsëse mënyra si e thërret Muadhin me emrin e tij dhe të atit të tij, sikur ta thërriste nga një vend i largët, edhe pse ishte aq afër tij. Kur Muadhi e gëzon me përgjigjen e tij, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hesht, duke lënë që kjo pritje e heshtur të nxisë kujdesin për vëmendje.

Duke qenë Muadhi në kulmin e vëmendjes për të pranuar atë që do të thotë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mësimi i jepet në formën e një pyetjeje: "*A e di se cili është haku i Allahu që njerëzit kanë ndaj Tij?*"

Muadhi përgjigjet si një nxënës i etur: "*Allahut dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë.*"

Prandaj nuk është çudi që Muadhi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* e mësoi këtë hadith dhe e mbajti mend. Duket sikur ato fjalë i tingëllonin në vesh përgjatë gjithë jetës së tij. Sa mahnitëse është që as dhimbjet e sëmundjes, as trishtimi i vdekjes nuk e bënë të harrojë këtë skenë. Ai e rrëfen këtë hadith me të gjitha hollësitë e tij për herë të parë, pikërisht në çastet e fundit të jetës, sikur ngjarja të kishte ndodhur vetëm pak më parë.

E gjithë kjo larmi edukative profetike, gjithmonë shoqërohej me nxitjen e njerëzve për të mësuar njëri-tjetrin; çdo nxënës bëhej

mësues për atë që kishte mësuar. Kështu, dija përhapej dhe përçohej në kohë rekord pasi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nxiti çdo nxënës t'i mësojë të tjerëve atë që ka mësuar. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbajti një ligjërim pastaj i tha njerëzve: *"E ndriçoftë Allahu njeriun që e dëgjon fjalën time dhe e përcjell atë. Sepse ndodh që dikush t'ia përcjellë të kuptuarit dikujt që është më i aftë se ai ta kuptojë, dhe ndodh që dikush të jetë bartës i të kuptuarit, por nuk kupton."*[922]

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi mësuesin më të mirë që i mësoi njerëzve mirësinë!

I Dërguari dhe leximi

1. Analfabetizmi (mosdija e leximit dhe shkrimit) është shenjë mangësie për çdo njeri, por, në rastin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ajo është shenjë përsosmërie. Arsyeja është se nxënësi lexon atë që kanë shkruar të tjerët dhe leximi është burim njohurish për të. Ndërsa dija që i është dhënë Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe që e transmetoi te njerëzit, nuk buron nga ajo që e kanë shkruar njerëzit, por nga ajo që Allahu ia shpalli.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi për t'i mësuar njerëzve atë që është zbuluar nga qielli, jo atë që është shkruar në tokë. Prandaj, Kurani thekson faktin e analfabetizmit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të treguar burimin e vetëm të dijes së tij: "***Para këtij, ti*** (Muhamed) ***nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e së pavërtetës do të dyshonin.***" (El-Ankebut: 48)

Atij i mjaftonte ajo që i mësonte Allahu dhe nuk kishte nevojë për atë që mësonin dhe lexonin njerëzit nëpër libra.

Analfabetizmi i tij nuk ishte sinonim i padijes pasi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte dije të gjerë dhe

[922] Ebu Davudi, 3660. Tirmidhiu, 2847. Ibn Maxhe, 230.

mënyra e tij për të marrë dije ishte nëpërmjet mësimit verbal, siç ishte zakon i shumicës së arabëve dhe jo mësimit të shkruar. Gjithashtu, ai kishte një vëzhgim të mprehtë dhe komunikim me delegacionet e fiseve dhe qyteteve.

Nga vëzhgimi i vendimeve dhe administrimit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kuptojmë se ato bazohen në njohuri të gjera për dijet e kohës, përfshirë njohuritë gjeografike, politike, fisnore, letrare dhe të tjera.

2. Një mrekulli tjetër e veçantë është se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte analfabet, fjala e parë që mori nga shpallja dhe që ai ia transmetoi njerëzve si një urdhër hyjnor ishte fjala: ***"Ikra - Lexo!"*** (El-Alek: 1)

Rëndësia e shpalljes së kësaj fjale të parë në Kuran për një njeri që nuk di të lexojë tregon për sinqeritetin e Pejgamberisë së tij. Nëse Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* do të ishte një person që pretendonte të ishte Pejgamber, ai do të kishte zgjedhur t'i fillonte shpalljet me fjalë që i njihte dhe i zotëronte, sepse çdo pretendues nis me fuqitë e tij të njohura, e jo me atë që dihet që ai nuk e di dhe nuk mund ta di. Por kur shpallja e parë ishte "Lexo!", ndërsa ai nuk dinte të lexonte. Kur ai ia transmetoi këtë fjali njerëzve, kjo tregoi se nuk ishte zgjedhja e tij ajo që po shpallte, por se ai po e merrte atë si shpallje hyjnore nga Allahu dhe ia transmetonte saktësisht si e kishte marrë. Edhe pse ai ishte analfabet, ky fakt ishte një nga shenjat e Pejgamberisë dhe dëshmitë e sinqeritetit të tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Për më tepër, Pejgamberi analfabet, i dërguar tek një popull analfabet, erdhi me një libër që lexohet - Kuranin - dhe që shkruhet - libri i shenjtë. Vetë ajetet kuranore e përshkruanin atë si libër, edhe ndërsa shpallja vazhdonte: ***"Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim."*** (El-Bekare: 2)

3. Shikojmë se si Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i zgjidhte të rinjtë me talent dhe aftësi për të mësuar dhe i orientonte drejt mësimit të gjuhëve, leximit dhe shkrimit. Për këtë arsye, Zejd bin Thabiti e mësoi gjuhën siriake dhe hebraike.

4. Para Kuranit, nuk njihej ndonjë libër tek arabët; ai ishte libri i parë që ata patën dhe nuk kishin libra përpara tij. Sa e çuditshme

është që libri i parë i këtij Umeti të ishte një libër i marrë nga një Pejgamber analfabet! Dhe sa madhështore është që libri i parë në gjuhën arabe të ishte libri i Allahut, i shpallur Pejgamberit të Tij analfabet!

5. Pastaj, zakonisht njeriu që nuk e zotëron një gjë qëndron larg saj dhe e përçmon atë. Dikur është thënë: "Ai që nuk di diçka, e lufton atë." Por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, edhe pse analfabet ishte vlerësues i rëndësisë së leximit. Tregues për këtë është numri i madh i shkrimtarëve rreth tij nga Sahabët, saqë numri i shkrimtarëve të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte rreth 48.[923]

Katër pasuesit e tij - Ebu Bakri, Umeri, Uthmani dhe Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* - njerëzit më pranë tij, të gjithë ishin shkrimtarë.

Kurani shkruhej para tij menjëherë sapo shpallej. Madje, një nga shenjat e vlerësimit për rëndësinë e leximit dhe shkrimit ishte se pas Betejës së Bedrit, për disa robër që donin të liroheshin, kushti i lirimit ishte t'i mësonin fëmijëve të ensarëve të shkruanin, duke e bërë këtë dituri çmim shpëtimi për ta.

6. Analfabetizmi ishte një mrekulli dhe një përsosmëri për Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, por atë nuk e bëri vlerë për asnjërin nga Umeti i tij. Përkundrazi, ai nisi një fushatë për zhdukjen e analfabetizmit dhe mësimin e leximit dhe shkrimit. Leximi dhe shkrimi u zgjeruan shumë gjatë jetës së tij dhe pas tij. Kështu, ai ishte analfabeti që e largoi analfabetizmin nga Umeti i tij.

7. Duhet të kujtojmë se vërtet ky Pejgamber analfabet u shpall Pejgamber kur ishte analfabet dhe u largua nga kjo botë analfabet, por Umeti i tij brez pas brezi vazhdojnë të shkruajnë rreth diturisë së tij. Sa fusha të reja shkencore u themeluan nga Umeti i tij duke u bazuar mbi diturinë e tij, si: shkenca e Fikhut, shkenca e Hadithit, shkenca e Tefsirit, shkenca e Usulit dhe shkenca e Akides! Sa libra e vepra janë shkruar në secilën prej tyre!

E gjithë kjo është ndërtuar mbi diturinë e një Pejgamberi analfabet, i cili kurrë nuk lexoi diçka të shkruar as nuk shkroi diçka të lexuar.

---

[923] "*Kuttabu el Nebij*", dr. Mustafa el Eadhamiju.

I Dërguari dhe thirrja - daveti

Jeta e tij ishte thirrje dhe thirrja e tij ishte jetë.

E si mund të jetë ndryshe thirrja e atij që urdhrin për thirrje e mori nga Zoti i tij: "***Thirr në rrugën e Zotit ...***" (En-Nahl: 125)?! Të flasësh për thirrjen e tij do të thotë të flasësh për jetën e tij, të cilën e vuri tërësisht në shërbim të thirrjes. Prandaj, ne nuk do të ndalemi në hollësi, por do të mjaftohemi me disa pika përmbledhëse që pasqyrojnë gjendjen pa hyrë në detaje.

Së pari: Thirrja ishte një mobilizim i plotë në jetën e tij; në çdo gjendje dhe në çdo kohë ai nuk linte asnjë rast t'i kalonte pa e kthyer në një mesazh të thirrjes së tij. Aq sa nuk mund të ndahet thirrja e tij nga asnjë veprimtari e jetës së tij.

Prandaj Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e gjejmë thirrës në mexhlisin e tij, në xhaminë e tij, në rrugën e tij, në qëndrimin e tij, në udhëtimin e tij, mbi tryezën e ushqimit, në shtratin e sëmundjes dhe në frymën e fundit të jetës së tij.

Një ditë, ai u ul me shokët e tij për të ngrënë ushqim dhe, para tij, i vendosën një parakrah mishi, të cilin ai e pëlqente. Mori një kafshatë[924] prej saj dhe tha: "*Unë jam zotëria i njerëzimit Ditën e Kijametit.*" Pastaj mori sërish një kafshatë dhe tha: "*Unë jam zotëria i njerëzimit Ditën e Kijametit.*" Kur pa se shokët e tij nuk po e pyesnin, tha: "*A nuk po pyesni se si?*" Ata menjëherë pyetën: "Si do të ndodhë, o i Dërguar i Allahut?"

Ai tha: "*Allahu do t'i mbledhë të gjithë njerëzit, të parët dhe të fundit në një vend të vetëm. Zërin e thirrësit do ta dëgjojnë të gjithë dhe shikimi do t'i përfshijë të gjithë…*"

Pastaj vazhdoi duke treguar hadithin e gjatë për ndërmjetësimin. Kjo bisedë u zhvillua teksa ishin ulur në tryezën e ushqimit.[925]

Madje, as ashpërsia e sëmundjes, dhimbjet dhe vështirësitë e saj nuk e bënin të harronte apo të shpërqendrohej nga thirrja e tij. Në sëmundjen e vdekjes, e pushtonte rëndesa dhe filloi të vendoste

[924] *Nehese:* mori mishin me majat e dhëmbëve. Shih: "*El Nihajetu*", 5/136.
[925] Buhariu, 2340. Muslimi, 194.

një pëlhurë të hollë mbi fytyrën e tij; kur e rëndonte, e hiqte nga fytyra dhe thoshte: "*Mallkimi i Allahut qoftë mbi çifutët dhe të krishterët, të cilët i kthyen varret e pejgamberëve të tyre në vende adhurimi.*" Aishja tha: Me këtë ai paralajmëronte Umetin nga ajo që kishin bërë ata.[926]

Edhe frymën e fundit dhe çastet e fundit të jetës i ktheu në thirrje për Umetin e tij dhe në amanet për ta, ai përsëriste fjalët: "*Namazin, namazin! Dhe ato që i keni nën amanetin tuaj.*"[927]

Së dyti: E shohim se thirrja e tij ishte e përzier me ndjenjat e tij dhe e lidhur fort me zemrën e tij; për të ai gëzohej dhe hidhërohej, i vinte keq dhe brengosej. Deri aty sa Zoti i tij që e dërgoi e qortonte, duke i thënë: "***A mos vallë do të vrasësh veten nga pikëllimi, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë*** (Kuran)**?**" (El-Kehf: 6) që do të thotë se *po e shkatërron veten nga mërzia*; ose ajeti tjetër: "***Ti mos e shqetëso veten deri në shkatërrim për humbjen e tyre!***" (Fatir: 8)

Ai e shkrinte thelbin e shpirtit të tij për thirrjen, derisa gati ta humbiste jetën nga hidhërimi për ata që nuk besonin.

Ashtu siç mërzitej për ata që refuzonin, ai ndiente gëzim dhe lumturi për ata që besonin. Kur erdhën muslimanët e rinj në çlirimit e Mekës, ai i priste grup pas grupi dhe fytyra e tij shndriste nga gëzimi. Gëzimi i tij për udhëzimin e tyre e fshiu armiqësinë që ata kishin shprehur deri atëherë.

Së treti: Thirrja për Umetin dhe shpëtimi i tyre me udhëzim ishte qëllimi më i madh, i cili i udhëhiqte të gjitha qëllimet e tjera. Për këtë arsye, asnjë qëllim i vogël apo i përkohshëm nuk mund ta largonte nga ky qëllim madhor.

Tufejl ibn Amr el Devsi shkoi te populli i tij dhe i thirri në Islam, por ata kundërshtuan. Tufejli u kthye te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i zemëruar me ta dhe tha: "*O i Dërguari i Allahut, fisi Devs e kundërshtoi thirrjen, prandaj mallkoi ata.*"

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u lut: "*O Allah, udhëzoje Devsin dhe silli besimtarë!*"[928]

Ky Pejgamber erdhi si mëshirë, jo si ndëshkim e as si mallkim.

---

[926] Buhariu, 3453. Muslimi, 529.
[927] Ahmedi, 26483.
[928] Buhariu, 4392. Muslimi, 2524.

Kur i thanë: "*O i Dërguari i Allahut, mallkoji idhujtarët*", ai tha: "*Unë nuk jam dërguar mallkim, por jam dërguar mëshirë.*"[929]

Ai, madje, lutej që të largohet ndëshkimi nga Umeti i tij dhe të lihen, me shpresë që udhëzimi t'i arrinte ata ose bijtë e tyre.

Egoja për hakmarrje është një nga egot më të forta dhe më të egra, por ajo zbehej përballë dëshirës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për udhëzim dhe përballë largpamësisë së tij të gjatë për popullin e tij. Edhe nëse ata nuk besonin, ai e shtrinte shpresën e tij tek pasardhësit e tyre dhe tek brezat që do të vinin.

Allahu ia gëzoi zemrën pas durimit dhe përballimit të tij, saqë ai pa duke u bërë muslimanë Ikrima i biri i Ebu Xhehlit, Sufjani i biri i Umejja ibn Khalefit, Halidi i biri i Velid ibn Mugiras, Ebu Hudhejfe i biri i Utbe ibn Rebias, Umu Kulthumi e bija e Ukbe ibn Ebi Muajtit… dhe të gjithë këta u bënë sahabë të nderuar, ndërkohë që etërit e tyre kishin qenë krerë të kufrit dhe armiq të ashpër të shpalljes.

Pas betejës së Uhudit, ndërsa i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vuante dhimbjen e humbjes për shokët e tij që ranë dëshmorë dhe plagët që i kishin shkaktuar – kokën e çarë, dhëmbin e përparmë të thyer[930] dhe gjakun që i rridhte në fytyrë - ai fshinte gjakun nga fytyra dhe thoshte: "*Si mund të shpëtojë një popull që e ka goditur në kokë Pejgamberin e vet, ia ka thyer dhëmbin e përparmë, ndërkohë që ai i thërret ata tek Allahu?!*"

Pastaj, nga frika se mos ata ndëshkoheshin menjëherë, tha: "*O Allah, fale popullin tim, sepse ata nuk dinë!*"[931]

Shiko këtë butësi të jashtëzakonshme në lutjen për largimin e ndëshkimit prej tyre: nuk u mjaftua vetëm duke i falur, por iu lut Allahut që t'i falë, që të mos i kapte dënimi menjëherë. Madje, ndërmjetësoi për ta duke i quajtur "*popullin tim*" - nuk tha: "O Allah, fali ata", por tha: "*O Allah, fale popullin tim*!" Pastaj kërkoi falje për ta me arsyetimin: "*Sepse ata nuk dinë*."

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli mbi interesin personal dhe qëndroi i lidhur fort pas thirrjes së tij, duke iu drejtuar njerëzve me të dhe për të.

---

[929] Muslimi, 2599.

[930] "*Sherh el nevevij ala Muslim*", 12/481.

[931] Ibn Hibban, 973.

Allahu ia pranoi lutjen Pejgamberit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Kështu që dhjetë vite pas betejës së Uhudit, tre komandantët e ushtrisë së idhujtarëve - Ebu Sufjani, Halid bin Velidi dhe Ikrima bin Ebu Xhehli - tashmë luftonin në ushtrinë muslimane kundër romakëve në betejën e Jermukut. Pra, ata që dikur luftonin kundër të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, u bënë ushtarë të fesë së tij dhe luftonin në rrugën e Allahut.

Së katërti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përdori të gjitha mjetet që ishin të mundshme në kohën e tij. Ai i thirri njerëzit në kodrën Safa, i thirri në tregje dhe në panaire, mbajti hytbe dhe këshilloi, udhëtoi dhe bëri Hixhret, debatoi dhe bisedoi, dërgoi lajmëtarë dhe caktoi thirrës, mori në shërbim poetë dhe oratorë, i shkroi mbretërve dhe princave, fitoi zemrat e prijësve të fiseve dhe parësisë së tyre. Ai përdori të gjitha mënyrat e mundshme dhe të gjitha mjetet e disponueshme. Këto mjete ishin të larmishme sipas gjendjes së të ftuarve, rrethanat e kohës e vendit.

Së pesti: Ai fillonte thirrjen e tij nga çështjet më të rëndësishme dhe gradualisht shkonte tek të tjerat. Ai fillonte nga baza kryesore, që është adhurimi i Allahut dhe njësimi i Tij, siç tregohet në porosinë që i dha Muadhit kur e dërgoi në Jemen dhe siç shihet në letrën që i dërgoi Herakliut, mbretit të madh të Romës.

Së gjashti: Thirrja ishte një mobilizim kolektiv. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i bënte sahabët të ndienin përgjegjësinë për thirrjen dhe u tregonte atyre se edhe ata janë dërguar dhe janë të ngarkuar me detyrën e thirrjes njëjtë me të . Ai në hytben e Haxhit të Lamtumirës tha: "*Përcillni prej meje qoftë edhe një ajet, flisni për bijtë e Israilit pa asnjë pengesë, por kush gënjen në emrin tim, le ta zgjedhin vendin e vet në Zjarr.*"[932]

Gjithashtu tha: "*E ndriçoftë Allahu njeriun që e dëgjon fjalën time dhe e përcjell atë. Sepse ndodh që dikush të jetë bartës i të kuptuarit, por nuk kupton, dhe ndodh që dikush t'ia përcjellë të kuptuarit dikujt që është më i aftë se ai ta kuptojë.*"[933]

[932] Buhariu, 3461.
[933] Ebu Davudi, 3660. Tirmidhiu, 2847. Ibn Maxhe, 230.

Sahabët e kuptuan mirë këtë mesazh dhe u mbushën me këtë bindje, duke e shprehur pikërisht me të njëjtën formë që u kishte mësuar ai. Kur Jazdegerdi, komandanti i persëve, pyeti Rib'ij bin Amirin para betejës së Kadisijes: "Çfarë ju solli këtu?", ai iu përgjigj: "Allahu na dërgoi që të nxjerrim njerëzit nga adhurimi i njerëzve në adhurimin e Zotit të njerëzve."

Shiko fjalën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "*Ju jeni dërguar...*" dhe fjalën e Rib'ijit: "Allahu na dërgoi…", që të kuptosh se mesazhi i shpalljes kishte arritur tek ata qartë dhe ata e kishin përvetësuar me fuqinë e tij.

Dhe kur ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u nis me shokët e tij për të çliruar Hajberin ku ishin kështjellat e hebrenjve, fortifikimet nga ku ata intrigonin dhe strehoheshin, depozitat e pasurisë së tyre të madhe dhe frutat e bollshme të kopshteve të tyre. Megjithatë, nuk ishin tonelatat e arit ose sasitë e frutave ato që e tërhiqnin, dhe as nuk ishin ato objektiv për shokët e tij. Ajo që ai kujdesej më shumë dhe që u rekomandonte dhe kishte përparësi ishte udhëzimi i tyre drejt drejtësisë dhe fesë së Allahut.

Ai nuk e llogariti kundërshtimin e tyre të mëparshëm dhe intrigat e tyre të vazhdueshme si pengesë për udhëzimin e tyre. Ai i dha flamurin Aliut të birit të Ebu Talibit dhe i tha: "*Ec përpara dhe kur të zbresësh në territorin e tyre, ftoji në Islam dhe informoji ata për detyrimet që kanë ndaj Allahut. Pasha Allahun, nëse ti bëhesh shkak për udhëzimin e qoftë edhe një njeriu të vetëm, është më mirë për ty se sa sikur të kesh devetë më të mira dhe më të shtrenjta.*"[934]

Në këtë mënyrë, shqetësimi për thirrjen dhe përgjegjësia për të u mbollën thellë në zemrat e shokëve të tij *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Për këtë arsye, sapo ata shkundën pluhurin nga duart pas varrimit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ata u shpërndanë nëpër botë për të përçuar mesazhet e Allahut dhe për të përhapur fenë dhe udhëzimin e Tij.

Sahabët që dikur mblidheshin në xhaminë e qytetit të Medinës, tani varret e tyre shtrihen në tre kontinente, ata prehen nëpër shkretëtira dhe vende të largëta të tokës. Secili prej tyre vdiq në një

[934] Buhariu, 2942. Muslimi, 2406.

cep të tokës, qoftë si dëshmor në betejë, qoftë si thirrës dhe mësues që të shpëtonte njerëzimin e humbur. Pishtarët që ata ndezën në pjesë të ndryshme të botës vazhdojnë të ndriçojnë dhe të rrezatojnë. Brezat e pasardhësve trashëgojnë ndriçimin dhe kënaqësinë e udhëzimit të tyre.

I Dërguari ligjërues - *hatib*

Hytbja ka qenë dhe mbetet një nga mjetet më të fuqishme të komunikimit dhe ndër mjetet më të mëdha të ndikimit. Ajo përmbledh shumë elementë ndikues, si elokuenca e hatibit, emocionet e tij, gjuha e trupit. Aty bashkohet ndikimi verbal, vizual dhe emocional. Për këtë arsye, u bënë të njohur hatibët elokuentë. Prandaj një hytbe e fuqishme e ndikuese mbetet në mendje.

Hytbja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përfshiu të gjitha këto veçori, bashkë me fjalën e sinqertë, emocionin e zjarrtë, ndikimin e fuqishëm dhe mesazhin e përmbledhur.

Një ditë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbajti një hytbe dhe tha: *"Ju kam paralajmëruar për Zjarrin! Ju kam paralajmëruar për Zjarrin! Ju kam paralajmëruar për Zjarrin!"* dhe e ngriti zërin aq shumë, sa e dëgjuan edhe ata që ishin në treg dhe mbi supe kishte rrobën e cila i ra te këmbët.[935]

Kjo skenë tregon se sa i përkushtuar ishte për atë që thoshte dhe sa e madhe ishte bindja e tij për të, derisa shfaqet tek ai ky ndikim e ky emocion. Sahabët e vunë re këtë gjendje tek ai në hytben e tij dhe e përshkruan se, kur mbante hytbe, ngrinte zërin, i skuqeshin sytë dhe i shtohej zemërimi, sikur të ishte paralajmërues i një ushtrie, që thotë: "(Armiku) *do t'ju sulmojë në mëngjes ose në mbrëmje!"*[936]

1. Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur mbante hytbe kishte gjendjen e shpëtimtarit që dëshiron të shpëtojë njerëzit nga një shkatërrim në të cilin frikësohej se mos hidhen. Ai

[935] Ahmedi, 18398.
[936] Muslimi, 867.

(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e shkrinte veten e tij me çdo frymëmarrje gjatë hytbes dhe fjalët e tij dilnin me shprehje të sinqertë, me ndjenjë të ngrohtë dhe me emocion të thellë.

Enesi transmeton: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbajti një hytbe që nuk kisha dëgjuar kurrë më parë të ngjashme me të, në të tha: "Sikur të dinit atë që di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë." Atëherë, shokët e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mbuluan fytyrat e tyre dhe qanë me ngashërim."[937]

I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u tregoi se ai di atë që ata nuk e dinë, por nuk ua shpjegoi në hollësi se çfarë dinte. Megjithatë, reagimi dhe ndikimi i tij ishin vetë një sqarim dhe pasqyrim i madhështisë së çështjes për të cilën i paralajmëronte. Për këtë arsye, ata u prekën aq shumë saqë mbuluan kokat e tyre dhe shpërthyen në vaj me ngashërim.

2. Një nga veçoritë më madhështore që e dallonin hytben e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte fakti se ajo kishte një mbështetje të qartë dhe të njohur në realitetin e jetës së tij. Kur fliste për diçka, veprimi i tij, tashmë, i kishte paraprirë fjalës. Rrezet e sinqeritetit shkëlqenin nga fytyra e tij fisnike dhe gjendja e tij e ndritur e vërtetonte dhe e forconte atë që thoshte.

Kur doli në kodrën Safa dhe iu drejtua kurejshëve, tha: "*Si thoni ju! Nëse ju them se një ushtri po qëndron pas, në luginë, gati për t'ju sulmuar, a do të më besoni?*", ndërsa të gjithë thanë: "Po! Ne kurrë nuk të kemi parë ndryshe vetëm se të sinqertë!"[938]

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbërriti në Medinë, erdhi Abdullah bin Selami dhe e gjeti duke mbajtur hytbe para njerëzve. Abdullah bin Selami tregon: "Kur erdhi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* njerëzit nxituan drejt tij dhe unë isha prej atyre që shkuan. Sapo e pashë fytyrën e tij, e kuptova menjëherë se ajo fytyrë, nuk ishte fytyrë gënjeshtari."[939]

Po ashtu, kur mbajti hytben në ditën e Arafatit, në Haxhin e Lamtumirës, i tregoi njerëzve udhëzimet për të rifilluar një jetë të

[937] Buhariu, 4621. Muslimi, 2359.
[938] Buhariu, 4770. Muslimi, 208.
[939] Ibn Maxhe, 1334.

re pas epokës së injorancës, ndër të tjera Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Dijeni se çdo gjë që i përket injorancës sot është nën këmbët e mia. Hakmarrja e injorancës bie dhe gjaku i parë që bie është gjaku i Bin Rabia bin Harithit. Po ashtu, kamata e injorancës bie dhe kamata e parë që bie është kamata e Abas bin Abdulmutalibit. Ajo bie totalisht.*"[940]

Kështu, kur urdhëronte ndonjë të mirë, ishte vetë shembulli i saj dhe kur ndalonte ndonjë të keqe, ishte më i larguari nga ajo. Gjendja e tij fliste para fjalëve të tij, prandaj fjalët e tij kishin një ndikim të madh në zemër dhe një fuqi të veçantë në shpirt.

3. Kur mbante hytbe, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i drejtohej njerëzve me fytyrën e tij dhe ata i drejtoheshin atij me fytyrat e tyre, sepse ai i jepte shumë rëndësi komunikimit vizual midis *hatibit* dhe të pranishmëve, që mesazhi të arrinte i shoqëruar me emocionet dhe mënyrat e shprehjes së tij.

Për shkak të rëndësisë së komunikimit vizual, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shfaqej para njerëzve dhe ngrihej për ta që të mund ta shihnin të gjithë, prandaj mbajti hytbe mbi kodrën Safa,[941] mbajti hytbe mbi deve në Arafat[942] dhe mbajti hytbe mbi mushkë në Mina.[943] Kur njerëzit u shtuan në xhaminë e tij, ai përdori një minber me tre shkallë[944], që të dukej edhe për ata që ishin më larg.

Qëndrimi i hatibit gjatë hytbes është një sqarim shtesë përkrah fjalës së tij, ai e bën më të qartë qëllimin dhe e përcjell më fuqishëm mesazhin.

4. Hytbja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte dy llojesh: lloji i parë është hytbja e caktuar, si hytbja e xhumasë dhe e dy bajrameve. Kurse lloji i dytë është hytbja sipas rastit, që lidhet me ndonjë ngjarje, si: hytbja e eklipsit apo hytbja që mbajti kur erdhi delegacioni i fisit Mudar. Ata ishin të varfër dhe nevojtarë. Prandaj urdhëroi Bilalin të thërrasë ezanin dhe të bëjë ikametin, falën drekën, pastaj u ngjit në një minber të vogël dhe tha:

---

940 Muslimi, 1218

941 Buhariu, 4770. Muslimi, 206.

942 Nesaiu, "*El Sunen el Kubra*", 1573.

943 Ebu Davudi, 1954.

944 Buhariu, 4936. Muslimi, 544.

"Secilit prej jush do t'i flasë Allahu Ditën e Kijametit, pa përkthyes që t'i përkthejë dhe pa roje që ta ndalojë. Ai do t'i thotë: 'A nuk të dhashë pasuri dhe fëmijë? A nuk të dhashë begati?' Ai do të thotë: 'Po.' Atëherë do t'i thotë: 'A nuk të dërgova një të dërguar që të të përcillte mesazhin?' Ai do të thotë: 'Po.' Atëherë do t'i thotë: 'A nuk të dhashë dëgjim dhe shikim?' Ai do të thotë: 'Po.' Atëherë do t'i thotë: 'Ku është ajo që ke përgatitur për veten tënde?' Ai do të shikojë përpara tij, pas tij, në të djathtë dhe në të majtë, e nuk do të gjejë asgjë që ta mbrojë fytyrën e tij nga Zjarri, përveç veprave që ka bërë. Dhe kur të shikojë përballë tij, do t'i dalë përpara Zjarri." Këtu i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: *"Ruajuni nga Zjarri!"* - dhe e ktheu fytyrën e tij anash; pastaj përsëriti: *"Ruajuni nga Zjarri!"* - dhe e ktheu përsëri fytyrën; pastaj përsëriti: *"Ruajuni nga Zjarri!"* - derisa ne menduam se po e shihte para syve. Pastaj tha: *"Njeriu jep sadaka nga dinarët e tij, nga dërhemët e tij, nga rrobat e tij, nga gruri i tij apo nga hurmat e tij."* Derisa tha: *"Kush ka mundësi të mbrohet nga Zjarri qoftë edhe me gjysmën e një hurme, le ta bëjë. E nëse nuk gjen as gjysmën e një hurme, atëherë me një fjalë të mirë."*[945]

Kur erdhi Ibnu el Lutbijje për të sjellur Zekatin e mbledhur tha: *"Kjo është për ju, ndërsa këtë ma kanë dhuruar mua."* Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u ngjit në minber dhe mbajti një hytbe, lavdëroi dhe madhëroi Allahun pastaj tha: *"Çfarë mendon nëpunësi? Ne e dërgojmë, e ai vjen e thotë: "Kjo është për ju, ndërsa këtë ma kanë dhuruar mua!" Le të rrijë në shtëpinë e nënës së tij apo të babait të tij, e të shohë a do t'i dhurohet apo jo? Pasha Allahun! Kushdo prej jush që e bën një gjë të tillë, do ta sjellë Ditën e Kijametit dhe, nëse ka marrë deve, ajo do të vijë duke rënkuar; nëse ka marrë lopë, ajo do të vijë duke pëllitur; e nëse ka marrë dele, ajo do të vijë duke blegëruar."*

Pastaj ngriti duart aq lart saqë pamë të bardhën[946] e sqetullave të tij, dhe tha: *"O Allah! A e përcolla* (mesazhin)*? O Allah! A e përcolla* (mesazhin)*?"*[947]

Nëpërmjet këtyre hytbeve Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* reagonte ndaj ngjarjeve për të sqaruar

[945] Muslimi, 1017.
[946] *"El Nihajetu"*, 3/261.
[947] Buhariu, 2597. Muslimi, 1832.

qëndrimin e duhur në to, duke e lidhur fjalimin me rrethanën që sqaron gjë që thellon ndikimin e tij.

Shpesh hytbja e rastit ishte edhe këshillë për Sahabët dhe këtë ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përsëriste kohë pas kohe, pa i rënduar me teprim.

5. Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kishte zakon që kur mbante hytbe të mbështetej në një shkop[948] ose hark[949]. Ky ishte një zakon arab, që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndoqi sipas traditës së popullit të tij. Prandaj, mbajtja e shkopit gjatë hytbes konsiderohet traditë zakonore dhe jo adhurim.[950]

6. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kujdesej për bukurinë e veshjes gjatë hytbes së Xhumasë. Ai kishte një rrobë që e përdorte vetëm për pritjen e delegacioneve dhe për ditën e Xhuma.

Kujdesi për pamjen gjatë hytbes së Xhumasë shpreh nderim ndaj hytbes dhe respekt për të pranishmit, duke u paraqitur me pamje të bukur dhe të hijshme që i takon vendit ku qëndron para tyre.

7. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e fillonte hytben duke falënderuar Allahun dhe duke e madhëruar me meritat e Tij. Vazhdonte me dy dëshmitë, pastaj thoshte: *"Një hytbe që nuk përmban dy dëshmitë është si dora këputur."*[951]

Shpesh ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbante hytbe vetëm me ajete nga Kurani, sidomos suret këshilluese. Umm Hisham bint el Harith bin el Nuamani tregon: "Suren "Kaf" e kam mësuar vetëm nga goja e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).* Ai e këndonte atë çdo të xhuma në minber gjatë hytbes."[952]

Kjo sepse surja "Kaf" përmban shumë këshilla dhe përkujtim të vdekjes, ringjalljes dhe gjendjes në ahiret.

---

948 "*Musannef*", Abdu el Rezzak, 5400.
949 "*Musannef*", Abdu el Rezzak, 5330.
950 "*El Silsiletu el Sahihatu*", El Albani, 2/20.
951 Ahmedi, 8018.
952 Muslimi, 873.

8. Hytbja e xhumasë ishte mësime dhe këshilla ku Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* theksonte çështjet kryesore të fesë, përcaktonte themelet e besimit dhe përmendte Xhenetin dhe Xhehenemin. Ai tregonte atë që Allahu ka përgatitur për të dashurit e Tij dhe për ata që i nënshtrohen, si dhe paralajmëronte për atë që i pret armiqtë e Tij dhe ata që kryejnë mëkate.

Kjo mbushte zemrat me besim të palëkundur ndaj Allahut, me respekt të thellë dhe nderim për Të dhe me frikë të ngazëllyer për takimin me Të dhe për kthimin te Ai. Xheneti dhe Xhehenemi dukeshin si përpara syve të tyre.

Ndoshta kjo shpjegon arsyen përse nuk janë transmetuar hytbet e xhumasë që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbajti në Medinë, megjithëse ato arrijnë rreth pesëqind hytbe. Kjo sepse ato ishin këshilla të përgjithshme, që theksonin çështje të mëdha dhe përmbajtja e tyre përsëritej në ajetet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Kjo sqarohet edhe nga hadithi i Arbad bin Saria, i cili tha: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* na dha një këshillë të fuqishme, saqë lotët rridhnin nga sytë dhe zemrat dridheshin nga frika. Atëherë, ne i thamë: "O i Dërguar! Duket sikur kjo është këshillë lamtumire, prandaj na jep ndonjë porosi!" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha:

"Ju porosis t'i druheni Allahut! Të dëgjoni dhe të bindeni edhe ndaj një skllavi abisinas. Kush të jetojë nga ju ka për të parë përçarje të mëdha! Kujdes nga çështjet e reja sepse ato janë humbje! Kush prej jush ta arrijë këtë le të veprojë sipas Synetit tim dhe Synetit të Kalifëve të drejtë e të udhëzuar! Kapuni fort për të!"[953]

Vërejmë se Arbad bin Saria përmendi se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i këshilloi një këshillë të fuqishme, por ai nuk e tregoi këshillën. Ai tregoi vetëm porosinë, sepse ajo përmbante një kuptim të veçantë, vendim dhe udhëzime të hollësishme.

9. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zakonisht mbante hytbe të përmbledhur dhe të shkurtër pa e zgjatur.

[953] Ebu Davudi, 4607.

Xhabir bin Semra thotë: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e zgjaste këshillën ditën e xhuma, ajo ishte vetëm disa fjalë të thjeshta."

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thoshte: *"Zgjatja e faljes së namazit, dhe shkurtimi i fjalimit të hytbes janë tregues i mençurisë së njeriut. Pra, zgjateni faljen dhe shkurtojeni hytben. Disa fjalime elokuente janë magjepse!"*[954]

10. Hytbja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kombinonte bindjen logjike, ndikimin emocional dhe përshkrimin e kuptimeve dhe skenave. Ajo e shtonte besimin dhe e forconte bindjen, saqë dukej sikur ahireti është para syve.

Një shembull i kësaj është hytbja e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur ndodhi eklipsi i diellit. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli mbi kafshën e tij në një ditë të nxehtë. Atë ditë ndodhi eklipsi i diellit. Ai doli dhe u fal me njerëzit. Kur përfundoi faljen, eklipsi kishte kaluar. Ai u ngjit dhe u ul në minber. Mbajti një hytbe ku lavdëroi Allahun dhe madhëroi Atë, pastaj tha: *"Dielli dhe hëna janë dy shenja nga shenjat e Allahut me të cilat Ai i frikëson robërit e Tij. Eklipsi i tyre nuk ndodh për vdekjen ose lindjen e dikujt. Kur ta shihni atë, shpejtoni për në xhami dhe faluni derisa të përfundojë."* Pastaj tha: *"Çdo gjë që ju është premtuar, unë e pashë në këtë namaz. Mu paraqit Xheneti dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin të varfrit. Mora një vilë rrushi dhe kur më patë se po përparoja sepse nuk më arriti dora ta kapja. Sikur ta kisha marrë, do të kishit ngrënë prej saj deri sa të jetë jeta. Pastaj mu paraqit Zjarri* (Xhehenemi), *dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin gratë." Ata pyetën: "Përse, o i Dërguari i Allahut?" Ai tha: "Për shkak të mohimit të tyre." U pyet përsëri: "A mohojnë Allahun?" Ai tha: "Ato mohojnë mirësjelljen bashkëshortore dhe mohojnë bamirësinë. Sikur të sillesh mirë me ndonjërën prej tyre gjatë gjithë jetës, po pa prej teje diçka, do të thotë: 'Kurrë nuk kam parë ndonjë të mirë nga ti.' Pashë në Xhehenem një grua nga Beni Israilët, e cila ndëshkohej për macen e saj: e kishte lidhur dhe as nuk e ushqeu as nuk i dha të pijë, por as nuk e la të lirë që të hante prej ushqimit të tokës, derisa ngordhi nga uria. Aty pashë edhe njeriun e shkopit të mbështetur mbi*

[954] Muslimi, 869.

shkopin e tij në zjarr, duke thënë: 'Unë jam hajduti i shkopit.' Me atë shkop ai vidhte hanxhinjtë. Nëse dikush e vinte re, thoshte: 'Nuk jam unë që po ju vjedh, por u mbërthye për shkopin tim.' Dhe nëse nuk e vinte re kush, e merrte me vete. Unë kurrë nuk kam parë pamje të tmerrshme si pamja e sotme. Dhe më është shpallur se ju do të sprovoheni në varre, përafërsisht me sprovën e Dexhalit. Dikujt prej jush i thuhet: 'Çfarë din për këtë njeri?' Besimtari do të thotë: 'Ai është Muhamedi, i Dërguari i Allahut. Ai erdhi tek ne me shenja të qarta dhe udhëzim, ne iu përgjigjëm, i besuam dhe e pasuam.' - dhe e përsërit tri herë. Atëherë i thuhet: 'Ne e dinim se ti beson në të. Fli pra i qetë.'

Ndërsa hipokriti ose dyshuesi do të thotë: 'Nuk e di. Kam dëgjuar njerëzit që thoshin diçka, dhe unë thashë siç thanë ata.'

O njerëz! Kërkoni mbrojtje Allahut nga dënimi i varrit, sepse dënimi i varrit është i vërtetë."

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) thotë: "Pas asaj dite i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e linte pa kërkuar mbrojtje nga dënimi i varrit pas çdo namazi"[955]

11. Ngnjëherë hytbja e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, edhe pse e shkurtër, përmblidhte ligje të shumta dhe çështje të ndryshme, veçanërisht hytbja në tubimet e mëdha, si hytbja në Arafat dhe ajo në Ditën e Kurbanit. Në të ai përmendte shumë ligje dhe porosi.

Këtë arrinte ta bënte sepse atij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i ishte dhënë aftësia e fjalës së përmbledhur. Ai mund të shprehte shumë porosi me pak fjalë, duke përmbledhur të gjitha këshillat me gjuhë të qartë dhe të përmbledhur. Njerëzit shpërndaheshin dhe secili prej tyre ruante atë që kishte dëgjuar dhe ishte e rëndësishme për të.

Të gjitha fjalët e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* janë të mbledhura nëpër transmetime të ndryshme edhe nëse nuk i ka mbledhur të gjitha së bashku vetëm njëri prej tyre.

12-Megjithëse Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përkushtohej hytbes dhe njerëzit i kushtonin vëmendje të plotë, hytbja e tij nuk ishte asnjëherë e ngurtë deri në atë shkallë që të duket e rënduar dhe e tepruar me solemnitet të sforcuar.

[955] Buhariu, 6366. Muslimi, 586.

Madhështia e tij nuk e pengonte askënd që t'i drejtohej, ndërsa ai ishte duke ligjëruar, as nuk e pengonte atë që t'i fliste dikujt gjatë hytbes, madje as ta ndërpriste për një çast, për diçka të rëndësishme dhe pastaj të vazhdonte hytben.

Një ditë të xhuma, ndërsa i Dërguari (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) po mbante hytben, erdhi Sulejk el Gatafani dhe u ul. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"O Sulejk, ngrihu dhe fali dy rekate, dhe mos i zgjat."*[956]

Një herë tjetër, gjatë hytbes së xhumasë hyri një beduin dhe i tha në këmbë: "O i Dërguar i Allahut, pasuria u shkatërrua, fëmijët janë të uritur dhe nuk kemi rrugë tjetër! Lutju Allahut që të zbresë shi."

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e dëgjoi pa e ndërprerë këtë beduin që nuk u ul të dëgjonte hytben dhe pastaj t'i fliste Pejgamberit pasi të mbaronte hytben dhe namazin, por erdhi dhe ndërpreu hytben për të paraqitur nevojën e tij. Kjo nuk e zemëroi aspak Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe nuk e shqetësoi. Ai, përkundrazi, u kujdes për nevojën e beduinit, e ndjeu vërtet urgjencën e tij që e shtyri të bënte këtë ndërprerje. Ai ngriti duart dhe u lut që të bjerë shi derisa shiu ra para se të zbriste nga minberi.[957]

Një herë tjetër, Temim bin Esad hyri në xhami ndërsa i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po mbante hytbe. Beduini iu drejtua: "O i Dërguar i Allahut, një i huaj që pyet për fenë e tij dhe nuk e di çfarë feje ka." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndërpreu hytben iu afrua atij, i sollën një karrige me këmbë hekuri, u ul dhe filloi t'i mësonte prej asaj që i kishte mësuar Allahu. Kur përfundoi u kthye në minber dhe përfundoi hytben e tij.[958]

Gjëja më e vështirë për një hatib është të ndërpritet nga dikush gjatë hytbes së tij, kurse Pejgamberi ynë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pranoi këtë pyetës të huaj me kujdes dhe vëmendje të veçantë. Ai e ndërpreu hytben dhe shkoi vetë tek ai, pa e thirrur, pastaj u ul mbi një karrige që të gjithë të tjerët të

[956] Muslimi, 875.
[957] Buhariu, 1013. Muslimi, 897.
[958] Muslimi, 876.

dëgjonin dialogun dhe të mësonin prej tij. Ai dëgjoi pyetjet dhe dha përgjigjet derisa përfundoi mësimin dhe pastaj vazhdoi dhe përfundoi hytben e tij.

Kjo është një nga skenat që tregojnë madhështinë e karakterit të tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe dhembshurinë e tij të madhe ndaj besimtarëve.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po mbante hytbe në Mina gjatë mesditës së ditëve të *teshrikut*. Rafiu bin Amr el Muzni, që atëherë ishte një djalosh i vogël, tregon:

"Unë dhe im atë iu afruam Pejgamberit, sal Allahu alejhi ve selem, unë vendosa dorën mbi gjurin e tij dhe fërkova këmbën deri te shputa, pastaj futa dorën mes sandaleve dhe këmbës."

Qëndrimi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj fëmijës në këtë pozitë ligjërimi të hytbes ishte një hytbe në vete, një mësim për të gjithë njerëzit, se si duhet të jetë mirësjellja dhe morali i lartë.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte thirrësi që mbante në zemër dashurinë për njerëzit, mëshirën për ta, kujdesin për udhëzimin e tyre dhe mirëkuptimin e dobësive dhe mangësive të natyrës njerëzore, të cilat korrigjohen me edukim të mençur dhe udhëzime të buta dhe të matura.

I Dërguari dhe Umeti i tij

Allahu e bëri Pejgamberin fisnik *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhuratën më të madhe për robërit e Tij, duke e dërguar në mesin e tyre dhe duke e shpallur tek ata: ***"Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin*** (Kuranin) ***e urtësinë*** (diturinë e thellë fetare), ***edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar..."*** (Ali Imran: 164)

Duke parë marrëdhënien e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me Umetin e tij, kuptojmë madhështinë e kësaj dhurate hyjnore.

Allahu i Madhërishëm, që e zgjodhi dhe e dërgoi, e përshkruan kështu: ***"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët."*** (Et-Teube: 128)

Umeti i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte gjithnjë i pranishëm në zemrën e tij. Kujdesi i tij për ta ishte i pashoq, dhembshuria e tij ndaj tyre ishte e pakrahasueshme.

Kjo pozitë dhe dashuri për Umetin shfaqet qartë në shumë aspekte:

Së pari: Interesimi dhe kujdesi i madh për Umetin

Ai interesohej aq shumë për udhëzimin e tyre, saqë Allahu e qortoi për pikëllimin e tepruar ndaj atyre që nuk besonin: ***"Ti mos e shqetëso veten deri në shkatërrim për humbjen e tyre! Allahu është vërtet i Gjithëdijshëm për atë që bëjnë ata."*** (Fatir: 8); ***"A mos vallë do të vrasësh veten nga pikëllimi, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë*** (Kuran)***?"*** (El-Kehf: 6)

Ai nuk i thërriste vetëm për të ngritur argumentin kundër tyre, por i thërriste me gjithë zemër, duke dashur t'i shpëtonte nga zjarri. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Shembulli im dhe shembulli juaj është si një njeriu që ndezi zjarr, dhe insektet e fluturat nisën të bien në të, e ai i largonte. Unë ju tërheq t'ju largoj prej zjarrit, por ju më shpëtoni nga duart.*"[959] Prandaj, gëzimi i tij ishte i madh kur dikush e pranonte thirrjen dhe besonte, dhe keqardhja dhe hidhërimi i tij ishte i thellë kur dikush e refuzonte.

Së dyti: Kujdesi për brezat e ardhshëm

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e donte shkatërrimin e kundërshtarëve të tij. Kur engjëlli i maleve i ofroi që t'i shembë dy malet[960] mbi banorët e mekës dhe t'i varrosë

[959] Muslimi, 2285.

[960] Dy malet që janë në anët e luginës së Mekës, mali Ebu Kubejs në anë të Kodrës Safadhe mali Kaijkaan në anë të kodrës Merva – "*El Nihajetu*", 2/32.

të gjithë nën dhe: "Nëse do, i shembi këto dy male mbi ta", ai iu përgjigj: *"Jo! Unë shpresoj që Allahu të nxjerrë nga pasardhësit e tyre njerëz që do ta adhurojnë vetëm Atë, pa i shoqëruar Atij asgjë"*[961] Ai bartte shqetësimin e brezave të ardhshëm, kujdesej për ta dhe kishte mall për ta: *"Do të doja t'i kishim parë vëllezërit tanë."* Shokët e tij që ishin me të i thanë: "A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguar i Allahut?" Ai tha: "*Ju jeni as'habët* - shokët e mi, *ndërsa vëllezërit tanë janë ata që nuk kanë ardhur ende."* [962]

Kështu brezat e ardhshëm të Umetit ishin prezent në zemrën e tij, mallëngjimi i tij për ta i paraprinte ardhjes së tyre. Prandaj dëshironte sikur t'i kishte parë dhe t'i kishte takuar.

Së treti: Paralajmërimet për sprovat

Nga dhembshuria e tij për brezat e ardhshëm të Umetit, ai i paralajmëroi për sprovat dhe përçarjet me të cilat do të përballen, i këshilloi për qëndrimin e drejtë që duhet të mbajnë përballë çdo sprove dhe të shmangin shkaqet e devijimit dhe shkatërrimit.

Prandaj, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ua sqaroi atyre gjendjet dhe ndryshimet që do ndodhin, dhe i këshilloi për qëndrimin e drejtë që duhej të mbanin përballë tyre.

Nuk ndodh të shfaqet ndonjë shenjë e një fitneje të re, pa ndier sikur ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndron mbi kokat tona duke na thënë: "Kujdes! Kujdes! A nuk ju kam treguar? A nuk ju kam paralajmëruar?"

Ai i jepte porositë e tij për të ardhmen me mall dhe dhembshuri, ku ndjeje nxehtësinë e shqetësimit dhe butësinë e mëshirës së tij. Nga Arbad bin Saria transmetohet se: **"***I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) na këshilloi..."* dhe ai e bëri të qartë për Umetin e tij se dynjaja do t'u hapet, pasuria do të shtohet në duart e tyre, prandaj i porositi të ruhen nga pasojat e dëmshme të saj - si rivaliteti, koprracia dhe përçarja për shkak të saj.

[961] Buhariu, 3231. Muslimi, 1795.
[962] Muslimi, 249.

"Pasha Allahun, nuk kam frikë varfërinë për ju, por kam frikë se do t'ju hapet dynjaja, siç iu hap atyre para jush, e të garoni pas saj siç garuan ata, e ajo t'ju shkatërrojë ju siç i shkatërroi ata."[963]

Ai paralajmëroi për sprovat e kohës së fundit dhe nga ato që do të ndodhin në të ardhmen e largët.

Së katërti: Dashuria për shumimin e Umetit

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dëshironte që Umeti i tij të ishte më i shumti dhe të krenohej me numrin e tyre në Ditën e Kijametit. Ai tha: *"Çdo pejgamberit i ka dhënë Allahu shenja që njerëzit të besojnë. Por ajo që më është dhënë mua është shpallja që Allahu më zbriti. Prandaj shpresoj të jem Pejgamberi me më shumë ndjekës Ditën e Kijametit."*[964]

Kur iu shfaqën në ëndërr umetet e tjera, ai u mallëngjye që Umeti i tij të ishte më i shumti. Për shkak të dashurisë për shumimin e Umetit të tij dhe dëshirës që të mburrej me ta përpara umeteve të tjera Ditën e Kijametit, ai i nxiti njerëzit në martesë dhe shtimin e pasardhësve, duke thënë: *"Martohuni me gra të dashura që lindin shumë, sepse unë do të mburrem me numrin tuaj të madh përpara umeteve."*[965]

Ai, gjithashtu, gëzohej dhe përgëzonte për ata që do të hyjnë në Xhenet nga Umeti i tij. Prandaj i përgëzonte sahabët. Abdullah transmeton se ishim me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në një tendë, afërsisht dyzet vetë. Ai tha: *"A do të kënaqeshit të ishit një e katërta e banorëve të Xhenetit?"* Ne thamë: "Po!" Pastaj tha: *"A do të kënaqeshit të ishit një e treta e banorëve të Xhenetit?"* Ne thamë: "Po!" Pastaj tha: *"Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, unë shpresoj të jeni gjysma e banorëve të Xhenetit. Dhe kjo, sepse në Xhenet nuk hyn veçse një njeriu musliman. Ju, krahasuar me mushrikët, jeni si një qime e bardhë në lëkurën e një demi të zi, ose si një qime e zezë në lëkurën e një demi të kuq."*[966]

---

[963] Muslimi, 2961
[964] Buhariu, 4981. Muslimi, 152.
[965] Ebu Davudi, 2050.
[966] Ahmedi, 3661. Buhariu, 6528. Muslimi, 221.

Së pesti: Lehtësimi për Umetin

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregonte kujdes të madh që të mos u bëheshin detyrim gjëra që do t'u rëndonin dhe i donte gjithmonë lehtësimet për ta. Ai thoshte: *"Sikur të mos kisha frikë se do t'i bëhej e vështirë Umetit tim, do t'i kisha urdhëruar të përdornin misvakun për çdo namaz, dhe do ta shtyja namazin e jacisë deri në një të tretën e natës."*[967]

Nga Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet se: "Një natë, në mes të natës, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli dhe fali namaz në xhami. Disa burra u falën me të. Në mëngjes njerëzit folën për këtë. Në natën tjetër u mblodhën më shumë dhe u falën me të. Në mëngjes njerëzit përsëri e përmendën dhe në natën e tretë u shtuan edhe më tepër. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli dhe ata u falën me të. Natën e katërt xhamia nuk i zinte dot deri në sabah, por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli vetëm për sabah. Pasi kreu namazin e sabahut, u kthye nga njerëzit, dëshmoi (shahadetin), pastaj tha: *"Ju pashë se ndodheni këtu, por nuk dola, nga frika se mos ju bëhet detyrim e ju nuk mund ta përballonit dot."*[968]

Kështu, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjithmonë merrte parasysh që të mos u bëheshin obligime gjëra që do t'u rëndonin, i ndalonte nga futja në vështirësi dhe ngarkesë dhe i orientonte drejt lehtësimit, drejt fesë së drejtë e të butë me të cilën ishte dërguar.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thoshte: *"Merrni përsipër veprime, vetëm aq sa mundeni, sepse Allahu nuk lodhet derisa të lodheni ju."* [969]

Së gjashti: Lutjet e tij për Umetin

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shpesh i lutej Allahut me përulësi për Umetin e tij: *"O Allah, Umeti im! O Allah, Umeti im!"*

---

[967] Tirmidhiu, 23.
[968] Buhariu, 924. Muslimi, 761.
[969] Buhariu, 43.

Me këtë i drejtohej Allahut në këtë botë dhe me të i drejtohet edhe në botën tjetër.

Ai iu lut Allahut për shëndetin dhe sigurinë e Umetit të tij, që të mos shkatërrohet nga uria apo katastrofat, dhe Allahu ia dha këtë. Kjo është një dëshmi se Umeti i tij do të mbetet prezent deri në fund të kohës.

Nga Sead ibn Ebi Vekasi përcillet se një ditë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi nga pjesa e lartë e Medinës, kaloi pranë xhamisë së Benu Muavijes. Hyri aty dhe fali dy rekate, dhe ne u falëm me të. Pastaj iu lut Allahut për një kohë të gjatë. Kur u kthye tek ne, tha: *"Kërkova nga Zoti im tre gjëra. Ai më dha dy, dhe më ndaloi një. I kërkova Zotit që të mos e shkatërrojë Umetin tim me thatësirë shkatërruese - dhe ma dha. I kërkova që të mos e shkatërrojë Umetin tim me përmbytje - dhe ma dha. I kërkova që të mos e bëjë ashpërsinë e tyre kundër njëri-tjetrit - por nuk ma dha."*[970]

Ashtu siç iu lut Zotit të tij për Umetin në këtë botë, ai do t'i lutet edhe Ditën e Kijametit. Në mesin e vuajtjeve të mëdha dhe qëndrimit para Allahut, thirrja e tij do të jetë: *"Umeti im, o Zot! Umeti im, o Zot!"* Ai thotë: *"Atëherë do të afrohem pranë Arshit, do të bie në sexhde para Zotit tim, e Ai do të më mësojë si ta lavdëroj si ta madhëroj ashtu siç nuk e ka bërë askush më parë. Pastaj do të më thuhet: 'O Muhamed, ngrije kokën, kërko dhe do të jepet, ndërmjetëso dhe ndërmjetësimi yt do të pranohet.' Unë do ta ngre kokën dhe do të them: 'O Zot, Umeti im, Umeti im!' Atëherë do të më thuhet: 'O Muhamed, fut në Xhenet prej Umetit tënd ata që nuk do të japin llogari, nga dera e djathtë e Xhenetit. Kurse ata që mbeten, do të hyjnë bashkë me njerëzit e tjerë përmes dyerve të tjera.'"*[971]

Gjithë njerëzimi do të shkojë tek ai për ndërmjetësim, ai do të ndërmjetësojë për ta, por lutja dhe thirrja e tij e përsëritur do të jetë: *"Umeti im, o Zot! Umeti im, o Zot!"*

Umeti i tij është gjithmonë i pranishëm në zemrën e tij, dhe ai nuk qetësohet derisa t'i shohë të sigurt në vendbanimet e tyre në Xhenet.

---

[970] Buhariu, 6304. Muslimi, 2890.

[971] Buhariu, 4712. Muslimi, 194.

E vallë, çfarë dhembshurie, mëshire dhe dashurie më të madhe mund të ketë se kjo e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për Umetin e tij?

Së shtati: Lutja e pranuar, ndërmjetësimi i madh

Çdo pejgamber ka një lutje të pranuar. Pejgamberi Muhamed *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ruajti lutjen e tij të pranuar për Umetin e tij, për çastin kur ata do të kenë më shumë nevojë, për ndërmjetësim Ditën e Kijametit. Ai tha: *"Çdo pejgamber e ka një lutje të pranuar, të gjithë pejgamberët e përdorën lutjen e tyre. Ndërsa unë e kam ruajtur lutjen time për ndërmjetësim për Umetin tim në Ditën e Kijametit. Me leje të Allahut ajo do të përfshijë këdo nga Umeti im që vdes pa i bërë shirk Allahut."*[972]

Këtë lutje të çmuar, të garantuar për t'u pranuar, e ruajti për çastet më të vështira dhe situatën më të rrezikshme - Ditën e shqetësimit dhe hutimit të madh. Dhe shiko si e zgjeroi ndikimin e saj që të përfshinte tërë Umetin që iu përgjigj thirrjes së tij: nuk tha se do të përfshijë vetëm bamirësit, apo luftëtarët, apo adhuruesit natën, por tha: *"Do të përfshijë këdo nga Umeti im që vdes pa i bërë shirk Allahut..."*

Së teti: Largimi i ndëshkimit nga Umeti

Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, kërkoi shmangien e ndëshkimit nga Umeti i tij. Kur i erdhi Engjëlli i Maleve dhe i tha: "Nëse do, i shembi këto dy male mbi ta", ai iu përgjigj: *"Jo! Unë shpresoj që Allahu të nxjerrë nga pasardhësit e tyre njerëz që do ta adhurojnë vetëm Atë, pa i shoqëruar Atij asgjë"*[973]

Në betejën e Uhudit, kur iu ça koka dhe iu thyen dhëmbët e përparmë[974], ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* filloi të fshinte gjakun nga fytyra e tij dhe thoshte: *"O Allah, fale popullin tim, sepse ata nuk dinë!"*[975]

---

[972] Buhariu, 6304. Muslimi, 199.
[973] Ibn Hibban, 973.
[974] "*Sherh el Nevevij ala Muslim*", 12/481.
[975] Buhariu, 3477. Muslimi, 1792.

Imam Kurtubiu thotë: "Nëse një njeri me mend e vëren këtë lutje në një situatë të tillë, do të kuptojë mirë fjalën e Allahut të Lartësuar: ***"Se ti je me virtyte madhore."*** (El-Kalem: 4) Sepse ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk u lut kundër tyre për të marrë hak, nuk u mjaftua vetëm me falje, por bëri lutje për ta. Pastaj nuk u mjaftua vetëm me lutje, por i përfshiu me veten e tij duke thënë "*popullin tim*" nga mëshira. Madje, nuk u mjaftua as me këtë, por edhe u dha si justifikim injorancën e tyre, edhe pse nuk ishte një arsye e plotë. Kjo është maja e virtytit dhe bujarisë, të cilën askush tjetër nuk e arrin."[976]

Kështu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shmangu ndëshkimin që pritej t'i godiste për shkak të krimeve të tyre të mëdha kundër tij. Allahu e pranoi lutjen, aq sa shumica e atyre që e luftuan në Uhud, më pas pranuan Islamin dhe luftuan për fenë e tij gjatë jetës dhe pas vdekjes së tij. Madje, ndër ta ishin edhe udhëheqësit e idhujtarëve në atë betejë: Ebu Sufjani, Ikrima dhe Halid ibn Velidi.

Ditën kur ndodhi eklipsi i diellit, që përkoi me vdekjen e djalit të tij, Ibrahimit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kapërceu dhimbjen e humbjes dhe hidhërimin e tij, duke u shqetësuar më shumë për Umetin e tij, që të mos i vinte ndonjë ndëshkim prej qiellit. Ai iu lut Zotit që ta largojë dënimin prej tyre.

Nga këto pamje ndien se ky Umet, me gjithë brezat e tij, për Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte si një fëmijë i dashur - në dashurinë, dhembshurinë dhe kujdesin e tij për ta.

Pejgamberllëku i tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte një atësi për të gjithë ne.

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!

[976] "*El Mufhim*", Kurtubiu 3/650.

Të folurit e të Dërguarit

Fjalimi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, qoftë kur fliste në bisedë të zakonshme apo kur mbante hytbe, ishte pasqyra më e qartë e thirrjes së tij, shpalosja e misionit dhe përmbajtja e shpalljes hyjnore. Allahu ia kishte dhuruar aftësinë e ligjërimit të bukur dhe shprehjes së qartë. Në gjuhën e tij nuk kishte as ngërç e as ngatërresë, por fjalët i dilnin të pastra, të drejta, të qarta dhe të lira. Këndimi i tij ishte këndimi më i bukur, shqiptimi më i kuptueshëm, e fjala e tij ishte fjala më e pastër ndër njerëz, më e ëmbla dhe më e qarta në shprehje. Nuk fliste me nxitim e pa pushim, por as me ngadalësi të bezdisshme e me copa-copa fjalësh.

1. Mënyra e të folurit

Ai fliste me maturi dhe qartësi. Nuk e rridhte fjalën si rrëfim i pafund, e as nuk e hidhte si fjalë të shpërndara pa lidhje. Përkundrazi, fjalët e tij ishin të ndara mirë, të qarta e të forta, që kuptoheshin lehtësisht dhe mbaheshin mend. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thoshte: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk tregonte me rrëfim të gjatë siç bëni ju, por kur ulej në një mexhlis, fliste me fjalë të qarta e të ndara, që hynin në zemër dhe i mbante mend çdo njeri që i dëgjonte. Fjalët e tij mund t'i numëronte kushdo që donte."[977]

2. Shkurtësia dhe përmbledhja

Fjala e tij dallonte për përmbledhje të ndritur: as e gjatë, as e ngatërruar, por e shkoqur dhe e lehtë për t'u numëruar e për t'u kujtuar. Për këtë arsye, sahabët i ruajtën me lehtësi fjalët e tij dhe na përcollën hadithe të shumta, të qarta, të bekuara. Hadithet e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, në shumicën

[977] Buhariu, 3567. Muslimi, 2493.

e rasteve, nuk i kalojnë dy-tre rreshta. Nëse zgjasin, është sepse përfshin ndonjë tregim.

Allahu ia dha atij aftësinë e "fjalës së përmbledhur" siç dhe ia ka shkurtuar fjalët. Me një fjalë të vetme ai mund të përmbledh shumë domethënie. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Mua më është dhënë fjala e përmbledhur."*[978]

Prandaj detyrat e fesë janë mbledhur në disa fjalë përmbledhëse.

Disa prej këtyre fjalëve janë:

- "*Veprat vlejnë sipas qëllimeve.*"[979]
- "*Musliman është ai nga gjuha dhe dora e të cilit janë të sigurt njerëzit.*"[980]
- "*Kush ruhet nga të dyshimtat, ka shpëtuar fenë dhe nderin e tij.*"[981]
- "*Lëre atë që të ngjall dyshim dhe bëj atë që nuk të ngjall dyshim.*"[982]
- "*Nga bukuria e Islamit të njeriut është lënia e asaj që nuk i përket.*"[983]

3. Dialogu dhe shembujt

Në të folur, shpesh përdorte pyetje, shembuj ose skena të gjalla, duke e futur dëgjuesin në bisedë. Një ditë tha: *"A e dini kush është i falimentuar?"* Ata thanë: *"Tek ne, i falimentuar është ai që nuk ka dërhem as plaçka."* Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"I falimentuar nga Umeti im është ai që në Ditën e Kijametit vjen me namaz, agjërim dhe zekat, por ka sharë këtë, ka akuzuar atë, i ka ngrënë pasurinë këtij, ka derdhur gjakun e atij, ka rrahur tjetrin. Atëherë secili prej tyre do të marrë prej veprave të tij të mira, nëse mbarojnë të mirat e tij para se të shlyejë çfarë u ka borxh, do t'i hidhen sipër mëkatet e tyre dhe më pas do të hidhet në zjarr."*[984]

Ndonjëherë, për ta bërë më të gjallë, e përshkruante gjendjen me gjeste. Si, për shembull, kur tregoi për daljen e shpirtit të

[978] Buhariu, 7013. Muslimi, 523.
[979] Buhariu, 1. Muslimi, 1907.
[980] Buhariu, 10. Muslimi, 40.
[981] Buhariu, 52. Muslimi, 1599.
[982] Tirmidhiu, 2518.
[983] Tirmidhiu, 2317.
[984] Muslimi, 2581.

jobesimtarit, duke përmendur erën e rëndë dhe përçmimin e engjëjve, e ndërkohë mori një copë pëlhurë dhe e vuri mbi hundë, sikur të largonte një erë të keqe, për ta bërë më të qartë mesazhin.

Ndonjëherë ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përshkruante gjendjen që tregonte, madje e sillte para sysh si një skenë, që fjala të lidhej me pamjen. Si në thënien e tij:

"*Kur njeriu jobesimtar jep shpirt* - dhe përmendi erën e rëndë që del prej tij dhe mallkimin që e shoqëron - *banorët e qiejve thonë: 'Një shpirt i keq erdhi nga toka'. Pastaj u thuhet: 'Shpjerjeni atë deri në fund të afatit të caktuar për të!'.*"

Ebu Hurejre tregon: "Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ktheu një rrobë[985] të hollë (që kishte hedhur mbi vete) dhe mbuloi hundën kështu[986]" - duke treguar me gjest, ashtu siç vepron dikush që ndien një erë të keqe. Këtë e bëri për ta sjellë skenën më të gjallë, që kuptimi të bëhej i qartë dhe imazhi të lidhej me rrëfimin.

4. Përsëritja për theksim

Kur donte të theksonte diçka, e përsëriste tri herë. Enesi thotë: "Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thoshte një fjalë, e përsëriste tri herë që të kuptohej." E ndonjëherë e përsëriste më shumë se tri herë, si kur tha: "*A t'ju tregoj për mëkatet më të mëdha? A t'ju tregoj për mëkatet më të mëdha? A t'ju tregoj për mëkatet më të mëdha?*" Kur ata u përgjigjën: "Po, o i Dërguar i Allahut!", tha: "*Shirku ndaj Allahut, mosrespektimi i prindërve…* - siç ishte i mbështetur, u ndreq dhe tha: *Edhe dëshmia e rreme.*" Dhe e përsëriste aq shumë sa shokët thoshin: "Sikur të pushonte!"[987]

5. Pastërtia e fjalës

Fjalët e tij ishin gjithmonë të pastra e të ndershme. Në të folurit e tij nuk kishte asgjë të pahijshme, të ndyrë apo fyese. Edhe kur duhej të përmendej diçka e ndjeshme, ai e shprehte me fjalë të

[985] "*El Nihajetu*", 2/289.
[986] Muslimi, 2872.
[987] Buhariu, 2654. Muslimi, 87.

hijshme. Siç i tha gruas së Rifaa el Kuredhi që kërkonte të ndahej nga burri i saj i ri, Abdurrahman el Zubejri, për t'u kthyer tek i pari: *"Dëshiron të kthehesh te Rifaa? Jo, derisa të shijosh ëmbëlsinë e tij dhe ai të shijojë ëmbëlsinë tënde."*[988] Pra, nuk mund të kthehesh më tek burri i parë derisa të kesh marrëdhënie bashkëshortore në martesën e dytë. Por këtë e shprehu me një metaforë të pastër marrëdhënien martesore, duke na mësuar mirësjelljen në të folur.

Këto nënkuptime në vend të fjalëve të ndjeshme dhe të turpshme janë edukimi që Allahu i dha Pejgamberit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nëpërmjet shpalljes që i dha. Ibn Abasi tregon se edhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i turpshëm, fliste me nënkuptime dhe nuk përdorte kurrë fjalë të pahijshme.

6. Betimi për theksim

Kur donte të theksonte një gjë madhore, betohej me fjalët: "*Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im!*" - siç u betua: *"Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im! Askush prej jush nuk beson derisa të jem më i dashur për të se babai i tij dhe fëmija i tij."*[989]

7. Fuqia e ndikimit

Fjalët e tij kishin një ndikim të thellë në zemra dhe lëviznin shpirtrat, saqë dëgjuesit ndiheshin sikur po shihnin me sy realitetin që ai përshkruante dhe ndjenin të njëjtën gjendje që ndiente ai.

Handhala el Usejdi tregon: "Më takoi Ebu Bekri dhe më pyeti: 'Si je, o Handhala?' I thashë: 'Handhala është hipokrit!' Tha: 'SubhanAllah! Çfarë po thua?' I thashë: 'Kur jemi te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai na përkujton Xhehenemin dhe Xhenetin, derisa na duket sikur po i shohim me sytë tanë. Por kur largohemi prej tij dhe përzihemi me gratë, fëmijët dhe punët e dynjasë, harrojmë shumë gjëra.' Ebu Bekri tha: 'Pasha Allahun, edhe ne e përjetojmë të njëjtën gjë!' Pastaj unë dhe Ebu Bekri shkuam

[988] Buhariu, 5260. Muslimi, 1433.
[989] Buhariu, 14. Muslimi, 44.

te i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. I thashë: 'Handhala është hipokrit! O i Dërguar i Allahut!' Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *'Pse thua kështu?'* I thashë: 'O i Dërguar i Allahut, kur jemi pranë teje, na përkujton Xhehenemin dhe Xhenetin, derisa na duket sikur i shohim me sy. Por kur largohemi prej teje dhe përzihemi me gratë, fëmijët dhe dynjanë, harrojmë shumëçka.' I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *'Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im! Sikur të vazhdonit gjithmonë në gjendjen që jeni me mua dhe në dhikër, engjëjt do t'ju përshëndesnin në shtretërit tuaj dhe në rrugët tuaja. Por, o Handhala, një kohë për këtë dhe një kohë për atë.'* - dhe e përsëriti këtë tri herë."[990]

Ky hadith pasqyron gjendjen shpirtërore të sahabëve kur dëgjonin fjalët e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* aq sa iu dukej sikur po shihnin me sy atë që ai përshkruante. Shpirtrat e tyre ndriçonin dhe ngriheshin në një gjendje gati engjëllore. Për këtë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ua shpjegoi se këto ishin pamje të ndikimit të fjalës dhe të ligjëratës së tij në zemrat e dëgjuesve.

Me gjithë këtë ndikim dhe ngrohtësi të fjalës së tij, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i matur në këshillim, nuk fliste gjatë e pandërprerë, por i përkujtonte shokët e tij herë pas here, që të mos rëndoheshin e të mos ndienin mërzi. Siç thotë Abdullah ibn Mes'udi: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* na këshillonte në ditë të caktuara, duke u frikësuar se mos na bëhej e rëndë e mërzitshme."[991]

El Xhahidhu e përshkruan fjalën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kështu: "Fjala e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka pak shkronja, por përmban shumë kuptime. Ajo është e pastër nga stisja, përdorte gjuhën e qartë dhe të hollë kur duhej, e të shkurtër kur kërkohej. Ai largohej nga fjalët e rralla të pakuptueshme dhe nga shprehjet e ulëta të tregut. Ai fliste vetëm nga trashëgimia e urtësisë dhe çdo fjalë e tij ishte e rrethuar nga mbrojtja hyjnore, e përforcuar me ndihmën e Allahut dhe e

[990] Muslimi, 2750.
[991] Buhariu, 68. Muslimi, 2821.

lehtësuar me udhëzim. Është një fjalë që Allahu e mbushi me dashuri dhe e mbështolli me pranueshmëri, e kombinoi me madhështinë dhe ëmbëlsinë, qartësinë dhe shkurtësinë. Fjala e tij nuk bie, nuk gabon në të, nuk i dështon argumenti, nuk e thyen dot kundërshtari, e as e mposht oratori. Përkundrazi, me pak fjalë tejkalon[992] fjalimet e gjata; nuk kërkon të hesht kundërshtarin përveçse me atë që ai vetë e njeh, nuk argumenton veçse me të vërtetën, nuk kërkon fitore[993] veçse me të drejtën, nuk përdor dredhi[994] e as shmangie.

Njerëzit nuk kanë dëgjuar kurrë fjalë më të dobishme, më të sakta, më të bukura në kuptim e më elokuente se fjala e tij (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)."

Disa prej fjalëve përmbledhëse të tij janë:

"*Pasha Allahun, ju jeni pak kur është puna për të marrë dhe jeni shumë kur është puna për të dhënë.*"[995]

"*Njerëzit janë si dhëmbët e krehrit.*"[996]

"*Askush prej jush nuk beson derisa të dojë për vëllain e tij atë që do për veten e tij.*"[997]

"*Më i miri prej jush është më i miri për familjen e tij, dhe unë jam më i miri prej jush për familjen time.*"[998]

"*Për çdo mëlçi të njomur, ka shpërblim.*"[999]

"*Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet.*"[1000]

[992] "*Taxhu el Arusi*", 9/374.
[993] "*Taxhu el Arusi*", 6/153.
[994] "*Taxhu el Arusi*", 2/377.
[995] "*Mealimu el Sunen*", 4/34. "*Sherhu Sahijhi el Buhari*", Ibn el Battal, 9/254.
[996] "*El Kuna ve el Esma*", El Dulabiju, 2/523.
[997] Buhariu, 13. Muslimi, 45.
[998] Tirmidhiu, 1162.
[999] Buhariu, 2363. Muslimi, 2244.
[1000] Buhariu, 5997. Muslimi, 2318.

Kapitulli i Shtatë:

I Dërguari në mjedisin e tij

I Dërguari dhe mjedisi i Mekës

1. Aty ndodhet trashëgimia e Ibrahimit, alejhi selam: Shtëpia e Allahut që ai ndërtoi me djalin e tij, Ismailin, burimi i Zemzemit dhe vendet e shenjta të Haxhit. Në këtë qytet janë ruajtur gjurmët e fesë së tij dhe adhurimet që ai la pas, ndër më të rëndësishmet Haxhi dhe Umreja tek Shtëpia e Lashtë. Pikërisht kjo trashëgimi i dha Mekës një pozitë të veçantë shpirtërore dhe fetare në të gjithë Gadishullin Arabik.

2. Meka dhe banorët e saj dalloheshin tek arabët për një status të veçantë të afërsisë së tyre pranë Shtëpisë së Allahut, për kujdesin që i jepnin Shtëpisë dhe për shërbimin ndaj pelegrinëve, duke ofruar ushqim dhe ujë. Kjo pozitë dhe ky nder u rrit më tej pas Vitit të Elefantit, kur banorët e gadishullit që ndoqën marshimin e elefantit dhe ushtrisë nga Jemeni në Mekë panë se si Allahu i shkatërroi ata me një dënim hyjnor, pa ndërhyrje nga askush. Allahu triumfoi për ta dhe shkatërroi armikun e tyre. Ngjarja e ushtrisë së elefantit u përhap në të gjithë gadishullin, njerëzit thanë: "Allahu luftoi për banorët e Mekës, dhe Ai i mbrojti nga armiku."

Prandaj, Meka u bë ëndrra e të gjithë banorëve të gadishullit. Shenjtëria dhe respekti për Shtëpinë e Madhëruar u shtua. U shtuan pelegrinët dhe tregtarët që vizitonin qytetin. Çdo ngjarje që ndodhte në Mekë përhapej në të gjithë gadishullin.

Kjo ndihmoi që thirrja e Profetit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të përhapet dhe njerëzit të transmetojnë lajmin për të; delegacionet që vinin për Haxh flisnin për të në të gjithë gadishullin në një kohë të shkurtër.

Në Mekë vinin për te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* delegacione nga fiset, si dhe të prekur nga thirrja e tij, si Ebu Dherr el Ghifari, Amr bin Absa el Eslemi, El Tufejl bin Amr el Devsi dhe të tjerë.

3. Meka, gjithashtu, dallohej për pozicionin e saj gjeografik; nuk ishte një vend i largët, as një vend i afërt.[1001] Ishte një qytet që

[1001] "*Talaiu el Nur*", Abbas el Akkad, 100.

nuk arrinte ndikimi i fuqive të mëdha që ndodheshin, qoftë në Sham, Irak apo Jemen, dhe nuk ndodhej në një vend të izoluar nga bota; ajo ishte e lidhur me botën, por njëkohësisht e veçuar prej saj, larg nga sundimi dhe ndikimi i Kisras, Herakliut dhe Abisinëve, por e lidhur me ta në disa aspekte.

4. Meka ndodhej në një vend me terren të vështirë, klimë të ashpër dhe ujë të pakët, në një hapësirë të ngushtë të rrethuar nga kodrat që ngushtonin sheshin dhe sipërfaqen e saj. Banesat e banorëve ndodheshin në lugina dhe rrëzë[1002] kodrave. Ajo ishte një tokë e shkrehtë, ashtu si e përshkruan Allahu i Madhërishëm në Kuran: "***Në një luginë që nuk mbillet.***" (Ibrahim: 37) Për këtë arsye, ngurrimi i kurejshëve ndaj Profetit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u shfaq kur i kërkuan që të largonte kodrat nga ata dhe të sjellë lumenj[1003] që të rridhnin për ta. Kjo kërkesë, pavarësisht ngurtësisë që përmbante, tregonte për vështirësitë dhe kufizimet me të cilat ata përballeshin. Ajo ishte, gjithashtu, një nga arsyet që i shkëputi lakmitë nga Meka dhe shmangu dëshirën për të pushtuar qytetin nga ata që nuk ishin banorë të tij.

5. Një nga veçoritë e mjedisit të Mekës ishte sistemi i udhëheqjes; udhëheqja nuk ishte e mbledhur në duart e një mbreti apo një udhëheqësi të vetëm. Pas vdekjes së Kusaj bin Kilab, kurejshët nuk kishin një udhëheqës të përgjithshëm, por ata sundoheshin nga një kolegj prej kryetarëve të fisit. Udhëheqja ishte e përbashkët midis kryetarëve të fisit të Kurejsh, ku askush nuk mund të sundonte mbi të tjerët. Secili kryetar i fisit kishte mendimin e tij, duke marrë parasysh interesat e fisit të tij, dhe çdo fis shijonte lirinë e plotë, pa detyrim për t'iu bindur dikujt tjetër.

Për këtë arsye, kur Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thërriste në fe, nuk ishte përballë një fuqie tiranike si Faraoni ose Nemrudi, siç ndodhi me Musain dhe Ibrahimin, paqja qoftë mbi ta. Pozicioni i familjes së Beni Hashimit dhe Beni Muttalibit me Profetin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, qoftë muslimanët apo jo, ndikoi që kurejshët të mos mund të sundoheshin nga

[1002] "*El Nihajetu*", 2/93.
[1003] "*Siretu Ibn Hisham*", 1/263.

individë të tillë si Ebu Xhehli ose Umeje bin Halefi dhe të tjerë. Kjo ishte e shkruar nga Allahu dhe shfaqje e mirësisë së Tij ndaj Profetit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Gjithashtu, kjo ofronte mbrojtje për ata që besuan te Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nga fisi i kurejshëve; askush nga jashtë fisit të tyre nuk guxonte t'i sulmonte. Prandaj, çdo dëm që iu bë shokëve të Profetit në Mekë vinte nga fiset e tyre vetë. Po ashtu, skllevërit dhe shërbëtorët nuk guxonin t'i sulmonin përveç zotëve të tyre. Kjo shpërndarje e ndikimit dhe kujdesi i çdo fisi për bijtë e vet siguronte mbrojtje fisnore për besimtarët dhe i mbronte ata nga çdo dëmtim që mund të pësonin.

6. Mekasit shquheshin për vlera dhe virtyte fisnike, të cilat i mbanin e i nderonin edhe në kohën e injorancës së tyre. Këto virtyte ishin ndër meritat e tyre dhe ndër shkaqet që bënë që i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të mbrohej nga e keqja mes tyre. Allahu thotë: "***Allahu e di më mirë se kujt ia jep mesazhin e Vet.***" (El-En'am: 124)

Ndër këto virtyte ishte neveria e tyre ndaj gënjeshtrës, të cilën e shihnin si të papajtueshme me moralin e udhëheqësisë. Këtë e dëshmon fjala e Ebu Sufjanit, kur Herakliu e pyeti për të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "Sikur të mos kisha frikë që shokët e mi do të më mbanin mend një gënjeshtër, do ta kisha gënjyer."[1004] Pra, ajo që e ndaloi të gënjente përballë Herakliut ishte neveria që të tjerët t'i përmendnin një gënjeshtër.

Po ashtu, qëndrimi i Hind bint Utbes me Zejnebin, e cila dëshironte të shpërngulej drejt Medinës pas Betejës së Bedrit, ishte një shembull i lartë i fisnikërisë. Hindi i tha: "Oj bijë e Muhamedit! A nuk më ka arritur lajmi se ti dëshiron të bashkohesh me babanë tënd?" Zejnebi iu përgjigj: "Jo, nuk e kam ndër mend." Atëherë Hindi i tha: "Oj bija e xhaxhait tim, mos e bëj këtë. Nëse ke nevojë për diçka që të lehtëson udhëtimin ose për pasuri që të të çojë te babai yt, unë i kam ato që të duhen. Mos ngurro[1005] të marrësh nga unë, sepse mes grave nuk ndodh ajo që ndodh mes burrave."

[1004] Buhariu, 2941.
[1005] "*El Nihajetu*", 3/104.

Zejnebi thotë: "Pasha Allahun, nuk e shoh se ajo e tha këtë, veçse sepse vërtet do ta bënte." [1006]

Ky qëndrim i Hindit është kulmi i burrërisë dhe i fisnikërisë, pasi ajo i ofroi Zejnebit ndihmë dhe përkujdesje, duke theksuar se: "Mes grave nuk ndodh ajo që ndodh mes burrave." Megjithëse, Hindi ishte nga gratë më të goditura pas Bedrit, sepse aty ishin vrarë babai i saj, vëllai i saj dhe i biri i saj.

Gjithashtu, i lavdërueshëm është edhe qëndrimi i Uthman bin Talhas, i cili, kur pa Ummu Selemen duke u nisur vetëm për Hixhret, e shoqëroi dhe e mbrojti gjatë rrugës.

Prej këtij moralit të lartë u arritën shumë dobi për thirrjen dhe për muslimanët.

Po kështu, ishte edhe qëndrimi i Mut'im bin Adij dhe Ebu el Buhturi bin Hisham, të cilët morën pjesë në prishjen e dokumentit të bojkotit, si dhe qëndrimi i Mut'imit kur i dha mbrojtje të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në kthimin e tij nga Taifi. Këtyre mund t'u shtohen edhe shumë shembuj të tjerë.

7. Udhëheqësit e Mekës dalloheshin për mençuri, butësi dhe pjekuri mendimi, gjë që i bënte ata të menaxhonin mosmarrëveshjet fisnore me maturi dhe takt, duke shmangur çdo nxitim e marrëzi. Për këtë arsye, mes fiseve të Mekës nuk ndodhën luftëra si ato që shpërthyen mes fiseve të Beni Bekr e Taglibit, apo mes Evsit dhe Hazrexhit, megjithëse këta të fundit i përkisnin një fisi të vetëm.

Ky tipar ndikoi edhe në mënyrën se si ata u sollën me të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe me shokët e tij. Me gjithë armiqësinë e madhe dhe ashpërsinë në përballjen me ata që kishin përqafuar Islamin, madje edhe përpjekjet e tyre të vazhdueshme për t'i larguar muslimanët nga feja, ata nuk shkuan deri te zgjedhja e vrasjes. Asnjë musliman nuk u vra, përveç rastit të Sumejes, të cilën e mbytën zotërinjtë e saj nga fisi Benu Mez'um. Përkundrazi, shpeshherë nga disa prijës të idhujtarëve në Mekë dilnin mendime të arsyeshme.

Një shembull i qartë ishte fjala e Velid ibn Mugires në fillimet e thirrjes së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*,

[1006] "Siretu Ibn Hisham", 2/215.

kur tha: "O bashkëqytetarë kurejshë! Dëgjoni fjalën time, binduni dhe më besoni mua! Lëreni këtë njeri në punën e tij, e qëndroni larg tij. Pasha Allahun, fjala që kam dëgjuar prej tij do të sjellë një ngjarje të madhe. Nëse arabët do ta mposhtin, atëherë do të mjaftoheni me të pa u lodhur ju. E nëse ai ngadhënjen mbi arabët, atëherë sundimi i tij është edhe sundimi juaj, lavdia e tij është edhe lavdia juaj, dhe do të jeni njerëzit më të lumtur me të."

Po kështu, edhe qëndrimi i Utbe bin Rebias ditën e Bedrit, i cili u tha kurejshëve: "O populli im, unë po shoh përballë, një popull të gatshëm të japë jetën dhe ju nuk do të mund t'i arrini ata, ndërkohë që mes jush ka njerëz të mirë." Ky mendim ishte pranë të bërit rrugë, po të mos ishte pengesa dhe ndikimin e fuqishëm i Ebu Xhehlit mbi ta.

8. Pozita fetare dhe tregtare e Mekës e bënte atë një vend tërheqës për njerëzit nga të gjitha anët e Gadishullit Arabik, si gjatë sezonit të Haxhit, ashtu edhe në tregjet sezonale si tregu i Minës, Ukadhit, Mexhnes dhe Dhi el Mexhazit. Këto tubime ku mblidheshin njerëzit ishin një rast i përshtatshëm që i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të takohet me delegacionet që vinin nga kudo, si dhe të paraqiste thirrjen e tij. Kështu, lajmi për thirrjen dhe fenë e tij u përhap në të gjithë gadishullin.

Pas përfundimit të këtyre tubimeve, çdo delegacion i tregonte popullit të vet për atë që kishte dëgjuar nga i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Kjo e lehtësoi përhapjen e mësimeve të Islamit dhe të mesazhit të tij në të gjitha viset e Arabisë, derisa çdo kush në gadishull, tashmë, ishte i përgatitur të ndiqte të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, por priste të shihte se çdo të ndodhte mes tij dhe popullit të tij. Ata thoshin: "Lëreni atë dhe popullin e tij. Nëse ai del fitimtar mbi ta, atëherë është me të vërtetë një Pejgamber i sinqertë."

Prandaj, kur u çlirua Meka dhe kurejshët pranuan Islamin, njerëzit nisën të futen në fenë e Allahut me turma, sepse, tashmë, kishin një njohuri paraprake për këtë fe dhe për vërtetësinë e thirrjes së saj.

9. Kurejshët ishin të njohur për aftësinë e tyre tregtare, sidomos në tregtinë e jashtme - import dhe eksport. Ata udhëtonin me mallrat e tyre drejt Shamit, Jemenit, Abisinisë dhe Irakut, duke

vendosur kontakte me ato shtete dhe duke lidhur me to marrëveshje tregtare.

Hashimi, biri i Abdu Menafit, bëri një marrëveshje me romakët që tregtarët Kurejsh të lejoheshin të hynin në Sham e të bënin tregti aty. Vëllezërit e tij - Mutalibi, Abdu Shemsi dhe Nevfeli - bënë marrëveshje të ngjashme me perandorët persë, Nexhashiu i Abisinisë dhe nga mbretërit e Hiras.

Në këtë mënyrë, kurejshët fituan kontroll mbi shkëmbimet tregtare midis veriut dhe jugut, duke organizuar "Udhëtimin e dimrit" drejt jugut dhe "Udhëtimin e verës" drejt veriut. Allahu ua kujtoi kurejshëve këtë begati: ***"Për të mbrojtur fisin Kurejsh, për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë."*** (El-Kurejsh: 1-2)

Pikërisht, për këtë arsye, fillimi i thirrjes në Mekë bëri që lajmi për thirrjen dhe për temën e saj të përhapej shpejt në të gjitha fiset që kishin lidhje me Kurejshët, si edhe në vendet ku ata arrinin me tregtinë e tyre.

10. Vendosja e njerëzve në Mekë për herë të parë filloi pasi fisi Xhurhum u vendos pranë nënës së Ismailit dhe birit të saj. Ky fis për disa shekuj radhazi ishte më shumë se të tjerët dhe ishte komandues, derisa fisi Huzaa i tejkaloi në numër dhe i dëboi nga Meka, duke marrë në dorë sundimin e saj afërsisht për pesë shekuj. Pikërisht gjatë periudhës së sundimit të Huzasë, nëpërmjet prijësit të tyre, Amr bin Luej el Huzai, u fut idhujtaria në Mekë. Kështu, ajo u shndërrua nga një qendër e teuhidit (njësimit të Allahut) në një vend ku u përhap paganizmi.

Meka mbeti nën sundimin e Huzasë derisa Kusaj ibn Kilab - i pesti nga etërit e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - e rimori prej tyre, rreth njëqind e pesëdhjetë vjet para shpalljes profetike. Ai u bë prijës dhe kujdestar i Mekës, ndërtoi në të "Dar el Nedve" (Shtëpinë e Kuvendit) dhe vendosi fiset e kurejshëve nëpër lugina dhe krahina rreth Qabes. Në fillim, fiset e kurejshëve qëndronin të shpërndara rreth Qabes, secili në anën apo luginën e vet.

Pas Kusajt, udhëheqja e kurejshëve mbeti në duart e prijësve të saj më të mëdhenj, e më pas erdhi Abdulmutalibi, i cili u bë prijësi i Mekës dhe më i madhi ndër udhëheqësit e saj. Ai ishte njeriu i parë që shihej për udhëheqje e nder, prandaj edhe Pejgamberi

(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) shpeshherë njihej me emrin e tij, duke u thënë: "I biri i Abdulmutalibit".

Prejardhja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte nga fisnikëria më e lartë e kurejshëve, nga familjet më të ndritura, më të zgjedhura dhe me më shumë nder. Vendimi dhe lavdia e tij ishin në kulmin e fisit. Për këtë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Allahu zgjodhi Kinanën nga bijtë e Ismailit, zgjodhi kurejshët nga Kinana, zgjodhi Beni Hashimin nga kurejshët, dhe më zgjodhi mua nga Beni Hashimi.*"[1007]

11. Meka shtrihet rreth Qabes, të cilën Allahu e bëri mbështetje për njerëzit, vend pelegrinazhi dhe siguri. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pati nderin e pjesëmarrjes në rindërtimin e Qabes: kjo ndodhi para shpalljes, kur ishte tridhjetë e pesë vjeç. Ai bartte gurë bashkë me xhaxhain e tij, Abasin, nga mali Exhjad deri te Shtëpia e Shenjtë.

Kur erdhi koha e vendosjes së Gurit të Zi, shpërtheu një mosmarrëveshje e fortë mes fiseve të kurejshëve se cili prej tyre do të kishte nderin ta vendoste atë. Atëherë, hyri Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe zgjodhi për ta mendimin më të mençur e më të pranueshëm: ai kërkoi që guri të vihej mbi një rrobë, pastaj çdo fis të merrte nga një cep i saj dhe të gjithë së bashku ta ngrinin në vendin e vet. Më pas, ai vetë e vendosi gurin me dorën e tij të bekuar. Kështu ai luajti një rol të rëndësishëm në shmangien e një grindje midis fiseve të kurejshëve

Më vonë, pas çlirimit të Mekës ishte pikërisht ai që do të vinte dorë në pastrimin e Qabes nga ndyrësitë e idhujtarisë dhe t'i rikthente pastërtinë e teuhidit.

Kur hyri në Mekë ditën e çlirimit, rreth Qabes gjendeshin treqind e gjashtëdhjetë idhuj, ndërsa brenda saj ishte vendosur idhulli Hubel. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nisi t'i shtynte me një shkop që kishte në dorë dhe ata binin përmbys, edhe pse ishin ngulur fort me plumb.

[1007] Muslimi, 2276.

I Dërguari dhe mjedisi i Medinës

1. Marrëdhënia e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me Medinën po endej diku larg në botën e fshehtë. Allahu kishte dhënë lajmin e mirë për të dhe për Medinën në shpalljet e pejgamberëve të mëparshëm dhe përshkrimi i saj kishte ardhur në librat e popujve të mëhershëm. Për këtë arsye, hebrenjtë erdhën në Gadishullin Arabik duke ndjekur shenjat e përshkruara: një tokë me terrene vullkanike dhe palma. Ata u vendosën në disa zona që i përmbushnin këto përshkrime - si në Vadi el Kura, Hajber, Fedek - dhe një pjesë e tyre zbriti në Medinë, kur panë se i përgjigjej më së miri përshkrimit në librat e tyre. Madje, edhe Selman el-Farisij *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* erdhi në Medinë, i udhëhequr nga përshkrimi që i kishin dhënë dijetarët e krishterë të cilët i kishte takuar.

Dija e hebrenjve u përhap edhe ndër fiset e Evsit dhe Hazrexhit, të cilët morën prej tyre disa zakone pa lënë fenë e tyre idhujtare. Ata kishin idhujt e tyre dhe më i njohuri ishte "Menati" në Mushel-lel[1008] ndërmjet Mekës dhe Medinës. Hebrenjtë shpesh ua përsërisnin atyre lajmin se së shpejti do të dilte një profet, të cilin ata do ta ndiqnin dhe me të do të luftonin kundër tyre.

Nga përgatitja hyjnore për Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte edhe martesa e gjyshit të tij, Hashimit ibn Abdu Menafit, në Medinë. Në një nga udhëtimet e tij tregtare drejt Shamit, ai u martua me Selma bint Amr el Nexharije nga fisi Hazrexh, e cila i lindi një djalë me emrin Shejbe dhe një vajzë me emrin Rukaje. Shejbe u rrit në Medinë, derisa u soll në Mekë nga xhaxhai i tij, Mutalibi, dhe që nga ajo kohë u njoh me nofkën "Abdulmutalibi."[1009]

Kështu, në Medinë lindi gjyshi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, Abdulmutalibi, dhe aty ndërroi jetë babai i tij, Abdullahu. Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbushi gjashtë vjeç, nëna e tij e çoi në Medinë për të vizituar

[1008] Një Kodrinë prej ku duket Kadidi. "*Muaxhem ma isteaxheme min esmai el bilad"*, 4/1233.
[1009] "*Siretu Ibn Hisham"*, 1/137-138.

varrin e burrit të saj, Abdullahut. Ajo qëndroi një muaj të tërë te të afërmit e saj nga fisi Nexhar, pranë varrit të burrit që e kishte dashur dhe nuk pranoi të martohet më pas tij.

Kjo vizitë e hershme në fëmijëri dukej si një përgatitje hyjnore për Hixhretin e madh në moshën e pjekurisë. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e mbante mend këtë vizitë dhe disa ngjarje të saj. Ai tregonte: "*Unë isha me djemtë e dajallarëve të mi duke ndjekur një zog që ulej mbi ta.*" Pastaj hodhi vështrimin nga shtëpia dhe tha: "*Këtu zbritëm me nënën time, dhe këtu është varri i babait tim, Abdullah bin Abdulmutalibi. Notin e mësova në pusin e Benu Adij bin Nexhar.*"

2. Pastaj, përgatitja hyjnor për rrethanat kohore për ardhjen e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ngjarjet mes fiseve Evs dhe Hazrexh. Ata kishin mes tyre armiqësi dhe luftëra të njëpasnjëshme, e fundit prej të cilave ishte beteja e njohur si *Jevmu Bu'ath*[1010], që ndodhi tre vite para Hixhretit. Ishte një përplasje e madhe: në fillim fituan hazrexhët, por fitorja përfundimtare iu takoi evsit, megjithëse ishin më pak në numër.

Në këtë betejë u vranë prijësit dhe krerët e të dy fiseve, përfshirë udhëheqësit kryesorë të tyre, si dhe shumë prej njerëzve më me ndikim. Pas kësaj, udhëheqja kaloi te brezi i ri i të rinjve, dhe nga të moshuarit e shquar mbeti vetëm Abdullah bin Ubej ibn Selul.

Pas kësaj beteje, fiset mbetën të përçara, dhe një pajtim mes tyre ishte i vështirë. Kështu, prania e një udhëheqësi nga jashtë radhëve të tyre ishte një zgjidhje që mund ta pranonin të dyja palët.

Shiko, pra, butësinë dhe mençurinë e Allahut në caktimin dhe rregullimin e Tij dhe mënyrën se si i ndryshoi gjendjet në fshehtësi, duke e përgatitur terrenin për të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që të gjente në Medinë vendin ku do të bëjë Hixhret, banesën ku do të strehohet dhe vendin ku do të prehet. Allahu i Madhërishëm thotë: ***"Vërtet, Zoti im është i Butë me kë të dojë; Ai është i Gjithëdijshmi dhe i Urti!"*** (Jusuf: 100)

3-Sa i përket gjeografisë së Medinës, ajo është një tokë pjellore e pasur me ujë, e mbushur me oaza hurmash të shpërndara. Nga

[1010] Një vend i njohur në Medinë. Sot quhet *El Meb'uth,* aty ka ndodhur kjo luftë prandaj ka marrë edhe emrin vendit. "*Muaxhem ma isteaxheme min esmai el bilad",* 1/259.

tri anët - lindja, perëndimi dhe jugu - qytetin e rrethojnë fusha vullkanike të thyer, që i dhanë asaj një mbrojtje natyrore, si një mur rrethues për qytetin. Hapësira e vetme e hapur ishte drejt veriut. Përballë njëri-tjetrit qëndrojnë Mali Uhud në veri, ndërsa Mali Ajr nga jugu. Malet e saj janë të shpërndara, hapësirat e gjera dhe të lira, ndryshe nga Meka që është më e ngushtë në terren.

Nëpër Medinë kalonin disa lugina, si lugina e Akikut, Ranunës dhe Bat'hanit, ku uji grumbullohej shpesh në formë kënetash. Për shkak të kësaj, në qytet u përhap sëmundja e njohur e etheve të Jethribit (bilharzia).

Kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* arriti në Medinë, ai ndërtoi aty xhaminë e tij në vendin që Allahu ia kishte caktuar, pikërisht në mesin e vendbanimeve të fisit Benu Nexhar. Ky vend ndodhej në zonën qendrore të qytetit, duke e bërë xhaminë pikë referimi dhe qendër të jetës së Medinës.

4. Përbërja shoqërore e Medinës ndryshonte nga ajo e Mekës. Në Mekë ishte vetëm një fis dhe një fe e vetme - idhujtaria. Ndërsa në Medinë bashkëjetonin dy grupe të mëdha: arabët dhe hebrenjtë. Arabët ishin dy fise kryesore, Evsi dhe Hazrexhi, ndërsa hebrenjtë ishin Benu Nadir, Benu Kurejdha dhe Benu Kajnuka.

Arabët kishin fenë e tyre pagane dhe idhujt që madhëronin, ashtu si edhe fiset e tjera arabe, kurse hebrenjtë kishin fenë e tyre judaike, librin e shenjtë, shkollat dhe sinagogat. Pas Hixhretit, Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përball me këtë strukturë shoqërore të larmishme në aspektin fisnor e fetar.

Në Medinë gjendeshin muslimanët, idhujtarët, hebrenjtë, fiset e ensarëve, fiset hebraike, si edhe Muhaxhirët Kurejsh. Më vonë iu shtuan edhe muhaxhirë nga fise të tjera dhe kështu larmia fisnore u shtua edhe më shumë.

Mirëpo, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* arriti t'i shkrinte këto dallime fisnore me lidhjen e vëllazërisë dhe besimit, duke i bërë muslimanët një trup të vetëm. Ky trajtim i urtë i kësaj larminë shoqërore ishte hyrje dhe përgatitje për larminë njerëzore botërore, të cilën Islami do ta përfshinte dhe do të shtrihej në hapësirat e tij të gjera.

5. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u dërgua në një kohë ku nuk kishte ndonjë sherr më të madh midis dy fiseve se sherri midis Evsit dhe Hazrexhit. Prandaj, u bë më e lehtë që ata të mblidhen rreth një udhëheqësi jashtë kufijve të fiseve të tyre - dhe ai ishte Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - nëpërmjet të cilit Allahu i bashkoi mes tyre.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shndërroi grindjen e tyre fisnore në një garë për virtyte dhe nxitje për vepra të mira. Sa herë që Evsi e shihte Hazrexhin të kishte arritur një vepër të mirë, nxitonte që të arrinte të njëjtën shkallë dhe madje ta tejkalonte dhe, po ashtu, Hazrexhi ndaj Evsit. Në këtë mënyrë, konflikti dhe armiqësia u shndërruan në një konkurrencë pozitive, siç thotë Allahu: ***"Andaj bëni gara për punë të mira!"*** (El-Maide: 48)

6. Prania e hershme e hebrenjve në Medinë ishte një nga arsyet e përhapjes së njohurive mbi profecitë. Sa e çuditshme është që hebrenjtë të jenë shkak për udhëzimin dhe besimin e ensarëve dhe që ensarët të përfitojnë nga njohuritë e tyre, ndërsa ata vetë zhyten në arrogancën e tyre dhe zgjedhin armiqësinë e thellë ndaj të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe mesazhit të Tij.

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbërriti në Medinë si muhaxhir, ai i përfshiu hebrenjtë duke lidhur me ta një marrëveshje që u përfshi në Kushtetutën e Medinës. Ajo garantonte bashkëpunim dhe ndihmë reciproke në mbrojtjen e qytetit dhe kundër sulmeve.

Në fillim të ardhjes së tij në Medinë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* preferoi mirëkuptim dhe afrim me hebrenjtë. Ai agjëroi Ashurën së bashku me ta dhe tha: "*Ne jemi më afër Musait se ju*."

Drejtimi i tij i gjatë faljes ishte drejt Bejtu'l Makdisit. Flokët i lëshonte si ata dhe nuk i ndante. Ai mundohej të forconte lidhjet duke shpresuar në udhëzimin e tyre, sepse ata ishin Ithtarë të Librit dhe njerëz të dijes. Ai i përfshiu ata në shtëpinë e tij. Kështu që ta duhej të ishin të parët që e ndjekin. Ata e vizitonin në shtëpi Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, kurse ai i përgjigjej ftesës së tyre kur e ftonin në shtëpitë e tyre. Ai i vizitonte të sëmurët e tyre dhe respektonte të vdekurit e tyre.

Në sjelljen e tij me ta ai ishte shembull i mirë për marrëdhënien me kundërshtarin kur ky është paqësor, e kjo arrihet nëpërmjet bashkëjetesës, bamirësisë dhe drejtësisë.

Por zilia e tyre i bëri ata të ngulnin këmbë në armiqësi dhe të arrinin në kulmin e saj; megjithatë, më pas një grup prej tyre besuan.[1011]

Kur erdhi puna të përballet me kurthet që ata ngritën dhe luftën që hapën, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i vendosur. Prandaj hyri në luftë dhe e dëboi fisin Benu Kajnuka pasi ata filluan armiqësinë. Por krimin e tyre nuk ia ngarkoi fiseve të tjera hebraike, kështu që marrëdhëniet me Benu Nadir dhe Benu Kurejdha mbetën në gjendjen e tyre të pa prekura. Pas betejës së Uhudit, Benu Nadir shkelën marrëveshjen dhe shpallën armiqësinë, për këtë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* luftoi kundër tyre dhe i dëboi nga Medina.

Shtëpitë e të Dërguarit[1012]

Shtëpitë ku banonte Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, janë të veçanta, sepse Allahu i ka pastruar nga çdo papastërti dhe i ka bërë plotësisht të shenjta. Ato janë shtëpi të mbushura me shenjtëri, ku ndjehet fryma e adhurimit, këndohet Kurani dhe zbret ndikimi i Shpirtit të Shenjtë. Siç thuhet:

"Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht." (El-Ahzab: 33)

Le të hyjmë në një nga këto shtëpi të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, në shtëpinë e Aishes së sinqertë *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, në atë shtëpi ku Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndro për dhjetë vite nga jeta e tij e bekuar.

Është shtëpia që dëshmoi gjumin e tij të qetë, ngritjen e tij për namazin e natës, që dëgjoi tesbihët e agimit dhe këndimin e Kuranit

[1011] Numri i hebrenjve që besuan arriti në 63. Sipas vlerësimit të bërë nga Ömer Sabuncu në librin e tij "*Yahudi Asilli Sahâbîler*", botuar në gjuhën turke.

[1012] Shih librin "*Bujutu el Nebij ve Huxhuratuha*" të profesorit tonë, dr. Muhamed bin Faris el Xhemil, prej të cilit përfitova në këtë pjesë.

të sabahut. Ajo shtëpi e pa Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* teksa shpërndante gjallëri e hare, dashuri e gëzim, dhe butësinë e jetës me familjen e tij. Sepse ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu me moralin më të lartë, dhe njerëzit më të lumtur me moralin e tij ishin pikërisht familjarët e tij.

Prandaj, me emrin e Allahut kërkojmë leje, afrohemi me respekt dhe përshëndesim…

Nëse afrojmë vështrimin te shtëpia e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, e gjejmë të ngjitur me xhaminë, nga ana lindore e saj, dhe dera e saj hapet drejt xhamisë nga muri lindor i xhamisë. Kjo do të thotë se shtëpia është më afër qoshes lindore të xhamisë. Dhe mbi këtë derë lëshohej një perde, një mbulesë[1013] prej leshi, që e mbulonte dhomën dhe shtëpinë nga pamja prej xhamisë Profetike. Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* donte të dilte për në xhami, ai e largonte këtë mbulesë, dhe fytyra e tij ndriçonte mbi xhaminë e shenjtë.

Në këtë derë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndroi për herë të fundit në jetën e tij, në ditën e fundit të jetës së tij, për t'i hedhur shikimin e lamtumirës Umetit të tij, për t'i përshëndetur ata para se të ndahej nga jeta. Ai i shikonte ata duke qëndruar në këmbë, ndërkohë që sahabët e vështronin fytyrën e tij si të ishte fletë e Kuranit.[1014]

Tani le ta hapim këtë perde dhe të hyjmë brenda, aty do të gjejmë shtëpinë e Aishes të përbërë nga dy njësi të ngjitura:

1. *Huxhre* - oborri i hapur.

2. Shtëpia - ndërtesa e mbuluar me çati.

Do të hyjmë në *Huxhre* nga hyrja e saj në xhami.

Muret e saj nga ana e veriut dhe jugut janë prej gjetheve të renditura të palmës, të lidhura me litarë leshi mbi hunj dëllinje të ngulur, që t'i japin qëndrueshmëri. Muri perëndimor është muri i xhamisë, ndërsa muri lindor është muri i shtëpisë.

Sipërfaqja e kësaj *Huxhre* të hapur është gjashtë me shtatë krahë[1015] (rreth 3 × 3.5 m²), dhe sipërfaqja totale arrin rreth 10.5 m².

[1013] "*Taxhu el Arusi*", 7/122.

[1014] Buhariu, 680. Muslimi, 419.

[1015] "*El Edeb el Mufred*", 451.

Ky është vendi ku depërton dielli, është oborri i shtëpisë ku ata rrinë në ngrohtësinë e diellit gjatë dimrit dhe në freskinë e hijes së tij gjatë verës.

Në këtë oborr vendoset *burma*, ku gatuhet ushqimi, që mund të jetë një tenxhere prej balte ose guri; aty gjendet edhe shakulli i varur, ku ftohet uji.

Kjo *Huxhre* ka ndërmjet saj dhe xhamisë vetëm këtë mbulesë mbi derë, prandaj nga xhamia dëgjon çdo gjë që ndodh në *Huxhre*. Kështu, kur Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* falte namazin e Duhasë, ata që ndodheshin në xhami në pjesën afër *Huxhres* mund të dëgjonin zhurmën e misvakut të saj kur ajo pastronte dhëmbët para faljes.[1016]

Kjo ishte e mundur për arsye të afërsisë së *Huxhres* ngjeshur me xhaminë dhe mungesa e pengesave përveç kësaj mbulesë.

Ndërsa shtëpia e Aishes është ndërtesa e mbuluar me çati, dhe quhet shtëpi, pra vendi ku fle familja, e mbuluar dhe me derë që mund të mbyllet.

Sa i përket ndërtimit të saj, ajo është në të njëjtën mënyrë si xhamia: themeli është prej gurësh, mbi të ndërtohet me tulla balte.

Sipërfaqja e kësaj shtëpie është dhjetë me shtatë krahë (rreth 5 × 3.5 m²), që do të thotë se sipërfaqja e saj është pak më pak se 20 metra katrorë[1017]. Lartësia e saj është po aq sa xhamia, pra pesë krahë.

Shtëpia ka dy dyer: njëra derë hapet nga ana perëndimore, në qoshen veri-perëndimore. Kjo derë çon në *Huxhre* dhe është një derë me një kapak[1018] të vetëm prej drurësh dëllinje, të renditura njëra pas tjetrës. Zakonisht drurët nuk janë të drejtë dhe të ngjeshur në mënyrë të plotë, por mes tyre mbeten boshllëqe të gjatë, që quhen "çarje të derës" për shkak të mos rregullsisë së drurëve.

[1016] Buhariu, 1776. Muslimi, 1255.

[1017] Profesor Muhamed Bin Faris el Xhemil në librin e tij "*Bujutu el Nebij a.s. ve Huxhuratuha*" fq, 41, e përcakton afërsisht 17.5².

[1018] Fjala "*Misrau*" njëri kapak i derës. Kur hyrja është e ngushtë bëhet vetëm me një kapak, por kur është e gjerë bëhet me dy kapakë që bashkohen në mes të hyrjes kur mbyllen. Dera me dy kapakë quhet "*Durfe*". "*Lisanu el Arab", 8/198.*

Prandaj, ndonjëherë syri i një personi që nuk e kupton ende fenë mund të përpiqet të shikojë përmes këtyre boshllëqeve për të parë se çfarë ndodh në shtëpinë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ky është një veprim që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndaloi dhe paralajmëroi ata që bën një gjë të tillë.[1019]

Dera tjetër e shtëpisë hapet nga ana veriore, në fund të pjesës veriore të shtëpisë, në qoshen veri-lindore. Është një derë e vogël që mund të quhet derë shërbimesh.

Sa i përket mobilimit në këtë shtëpi, kur hyni nga dera, në të djathtë do të shihni shtratin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në qoshen jug-perëndimore.

Ky shtrat ishte një dyshek prej lëkure të mbushur me fijet e fibrës së palmave, dhe mbi të një jastëk prej lëkure, po ashtu, i mbushur me fijet e fibrës së palmave. Kur vinte ndonjë mysafir te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai i jepte këtij mysafiri jastëkun për të u ulur mbi të.

Një herë Ibn Abasi *(Allahu qoftë i kënaqur me të dy)* fjeti te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe gruaja e tij, Meimuna, fjetën në gjatësinë e jastëkut, ndërsa Ibn Abasi fjeti në gjerësinë e jastëkut.[1020] Kjo ndodhi gjatë verës, prandaj ata fjetën në *Huxhre* dhe jo në shtëpi, dhe mbi tokë e jo mbi shtrat.

Në shtëpi nuk kishte ndonjë shtrojë tjetër për të ndenjur, prandaj Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur ngrihej natën për të falur namaz nate, falej mbi shtrojën ku flinte bashkë me gruan e tij. Ai falej ndërsa Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ishte shtrirë mes tij dhe *kibles*. Kur ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* donte të bënte *sexhde*, e prekte lehtë me dorë që ajo të tërhiqte këmbët, e kur ai ngrihej, ajo i shtrinte sërish këmbët.[1021]

Mund të mendojë dikush që lexon këtë tregim se kjo ndodhte për shkak të ngushtësisë së vendit, por jo, arsyeja ishte ngushtësia e shtrojës.

[1019] Buhariu, 6242. Muslimi, 2157.
[1020] Buhariu, 4570. Muslimi, 763.
[1021] Buhariu, 382. Muslimi, 512.

Në shtëpi kishte pak orendi, vetëm aq sa ishin të domosdoshme për jetën e asaj kohe. Mes tyre, një hasër e vogël prej gjetesh palme, të cilin e quanin *khumra*[1022]: madhësia e saj ishte aq sa të mjaftonte për të vendosur fytyrën dhe duart e njeriut kur binte në sexhde mbi të.

Gjithashtu, në shtëpi kishte një *sehva*[1023] në mure (një ndarje e vogël e murit) ku zakonisht vendoseshin gjëra të vogla dhe një *raft*, që ishte një lloj rafti prej druri ku ruheshin hurmat ose elbi.

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndërroi jetë dhe në shtëpinë time nuk kishte asgjë që të mund ta hante një njeri, përveç gjysmës së një babune elbi në raftin[1024] tim. Unë hëngra prej saj për një kohë të gjatë, pa e vënë re sa është, por një herë kur e mata atë sa ka mbetur, ajo u mbarua."[1025]

Jeta në shtëpinë e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*

Kjo shtëpi profetike, me muret e saj të ngushta, me çatinë e ulët, me hapësirën e vogël dhe me pak orendi, ishte shtëpia që ndërtoi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në vitin e parë të Hixhretit për të banuar aty me më të dashurën e zemrës së tij, gruan e tij, Aishen e sinqertë, *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Dhjetë vite kaluan njëra pas tjetrës, gjatë tyre gjendja e tij ndryshoi, herë pati pak e herë pati shumë, herë ngushtohej jeta herë zgjerohej, megjithatë ai qëndroi në këtë shtëpi, pa e ndryshuar dhe pa i shtuar asgjë. Edhe pse Allahu ia hapi atij vendet dhe ia dha në pronësi tokat dhe kështjellat e Benu Nadir, ai nuk zgjodhi prej tyre as ndonjë kopsht për të banuar, as ndonjë fortesë për t'u ngritur mbi të tjerët.

Të gjitha pasuritë grumbulloheshin te ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ai i shpërndante ato në xhami, duke i ndarë me duart e tij mbi rrobat e njerëzve, pastaj kthehej në shtëpinë e tij

[1022] Buhariu, 379. Muslimi, 513.
[1023] Sehva është një hapje në mur si raft brenda murit, për të vendosur gjërat e vogla sidomos në muret prej balte në shtëpi ose në xhami ku vendosen librat e Kuranit.
[1024] Diçka e ngjashme me një ndarje të futur në mur. *"Fet'hu el Bari", 11/280.*
[1025] Buhariu, 3097. Muslimi, 2973.

dhe flinte mbi një shtrat të thjeshtë të gërshetuar me fije palme; kur flinte mbi të, i linte gjurmë në trupin e tij fisnik.

Nga Ibn Abasi *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)* përcillet se: "Umer bin el Hatabi hyri te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ai ishte shtrirë mbi një hasër që i kishte lënë gjurmë në trup. Atëherë, ai tha: 'O Pejgamber i Allahut, sikur të merrje një shtrat më të butë se ky?' Profeti *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "Ç'punë kam unë me dynjanë? Unë edhe dynjaja jemi si puna e një udhëtari që ecën në një ditë të nxehtë vere, e pastaj ndalet të pushojë nën hijen e një peme për pak kohë, pastaj çohet dhe e lë pas."[1026]

Vërtet, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i cili jetoi në këtë gjendje të thjeshtësisë dhe të sakrificës, nuk i ndaloi të mirat dhe as nuk i urdhëroi pasuesit e tij t'i shmangeshin atyre. Sepse mbi të zbriti fjala e Allahut: *"**Thuaj: "Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?"*** (El-A'raf: 32); *"**O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë dhe, nëse jeni adhurues të Allahut, falënderojeni Atë!"*** (El-Bekare: 172)

Prandaj, disa nga sahabët, Allahu qoftë i kënaqur me ta, e shfrytëzuan hapësirën që u kishte lejuar Allahu dhe kërkuan të mirat e furnizimit.

Por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i shmangej atyre dhe nuk i merrte, as nuk i ruante për vete, në mënyrë që të mos mendohej se kishte përfituar ndonjë shpërblim tokësor për thirrjen e tij, apo se kishte marrë ndonjë pjesë nga pasuria e njerëzve në këmbim të përcjelljes së mesazhit. Sepse shpallja e tij, ashtu si shpallja e të dërguarve para tij, ishte: *"**Thuaj: Unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi...**"* (El-Furkan: 57); ***"Ti nuk po kërkon prej tyre kurrfarë shpërblimi për këtë."*** (Jusuf: 104);*"**Thuaj: "Çfarëdo shpërblimi, që mund t'ju kem kërkuar, ai qoftë për ju. Shpërblimi im është vetëm tek Allahu; Ai është dëshmitar për çdo gjë."*** (Sebe: 47)

[1026] Ahmedi, 2744.

Prandaj, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* jetoi mes njerëzve, pastaj u largua për te Zoti i Lartësuar, pa u marrë njerëzve asgjë nga dynjaja e tyre dhe pa mbajtur për vete ndonjë pjesë të saj për t'u kënaqur në mënyrë të veçantë.

Po ashtu, dëshirat dhe mallëngjimet e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin të drejtuara atje, në banesat e tij të larta në Xhenet.

E përfytyroj gjendjen e tij si gjendjen e dikujt që po ndërton një pallat madhështor, afër përfundimit, ndërkohë që jeton në një shtëpi të vogël; shikimi i tij është i kthyer drejt pallatit që po e ngre dhe ku do të shpërngulet, e jo drejt shtëpisë së vogël ku banon përkohësisht dhe që së shpejti do ta lërë. Edhe nëse kjo shtëpi e vogël do të kishte nevojë për ndreqje apo shtesa, ai do të thoshte: "Lëreni, sepse ne do të shpërngulemi shpejt në shtëpinë tjetër."

E si të mos jetë kështu me pallatet e Xhenetit, që nuk i ka parë syri, nuk i ka dëgjuar veshi dhe nuk i kanë shkuar kurrë në mendje njeriut!

Xhamia e Pejgamberit[1027]

Sikur ta shihnim *el Kasva* - devenë e Pejgamberit, sal Allahu alejhi ve selem, duke ecur me hapa të shpejtë[1028], ndërsa Ebu Bekri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ishte pas tij duke e shoqëruar. Deveja po vinte nga Kuba dhe fiset e ensarëve kishin dalë në rrugë për ta pritur. Secili prej tyre dëshironte që ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të zbriste e të qëndronte te ai. Burrat e tyre kapnin frerët e devesë dhe thoshin: "Zbrit tek ne, o i Dërguar i Allahut, sepse tek ne ka mbrojtje, forcë dhe armë."

Por ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thoshte: "*Lëreni, sepse ajo është e urdhëruar.*"[1029]

[1027] Shiko: "*El Tearif bi el Mesxhid el Nebevij*", Sejjid Attar.
[1028] "*El Nihajetu*", 2/3.
[1029] "*El Muaxhemu el Evsat*", Taberani, 3544.

Kur deveja arriti te vendbanimet e Benu Malik bin Nexhar, kaloi nëpër një tokë të thatë[1030] që përdorej për tharjen e hurmave dhe u ul aty në gjunjë, ndërkohë që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ende mbi shalën e saj dhe nuk kishte zbritur. Pastaj ajo nisi të kthehej majtas e djathtas, sikur të kërkonte diçka ose të njihte diçka, pastaj u ngrit përsëri dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte mbi shpinën e saj, bëri një xhiro dhe u kthye sërish te vendi ku ishte ulur fillimisht. Aty u ndal përfundimisht, u qetësua,[1031] lëshoi një tingull[1032] karakteristik dhe goditi tokën me pjesën e poshtme të qafës së saj,[1033] sikur të thoshte: "Këtu është vendqëndrimi, kjo është zgjedhja." Dhe pikërisht vendi ku u ul deveja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, më pas u bë vendi i Minberit të tij në xhami.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e zgjodhi vetë vendin ku do të ulej deveja e tij, por priste zgjedhjen e Allahut, i Cili do t'ia caktonte vendin ku do të ndërtohej xhamia. Ashtu siç ia caktoi Allahu Ibrahimit *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* vendin e Qabes, po ashtu, ia caktoi Muhamedit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vendin e xhamisë, pikërisht aty ku u ul deveja e tij. Atëherë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zbriti dhe tha: "*Këtu është vendqëndrimi, me leje të Allahut.*"[1034]

Dhe e mrekullueshmja është se ky vend ndodhet në qendër të qytetit, e lagjet e tij e rrethojnë nga veriu e jugu, si edhe nga lindja e perëndimi; pra është si zemra dhe qendra e Medinës.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha njerëzve të fisit Benu Malik bin Nexhar: "*O Benu Nexhar! Më tregoni çmimin e këtij trualli tuajin.*" Ky truall ishte pronë e dy jetimëve që e kishin trashëguar. Familjarët e tyre thanë: "O i Dërguar i Allahut, ne nuk duam çmim për të, ai është për ty, dhe ne do t'i kënaqim jetimët." Por ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Jo, më tregoni çmimin!*" Ai nuk pranoi ndryshe, veçse që t'i caktohej çmimi dhe jetimëve t'u

---

1030 "*El Nihajetu*", 4/182.
1031 Zuri vend aty dhe nuk lëvizi që aty. "*El Nihajetu*", *4/239.*
1032 Një zë pa hapur gojën. "*El Nihajetu*", 2/220.
1033 Pjesa e kraharorit dhe harku i qafës së devesë. "*El Nihajetu*", 1/263.
1034 *Musannaf Abdu el Razzak, 9743*

jepej e drejta e tyre.[1035] Kështu, fillimi i vendosjes së tij në Medinë u bë shpallje për ruajtjen e të drejtave dhe kujdesin për jetimët e të dobëtit.

Projekti i parë që nisi Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, në Medinë ishte ndërtimi i xhamisë. Ndërtimi i xhamisë u bë në të njëjtën mënyrë dhe pamje si ndërtesat e Medinës: themelet prej guri, muret prej tulla balte të pjekura dhe argjilë, shtyllat nga trungjet e palmave, ndërsa çatia prej degëve të hurmave, gjetheve të palmës dhe një shtrese balte mbi to.

Pastaj filloi puna për ndërtimin e xhamisë dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thirri sahabët *(Allahu qoftë i kënaqur me ta)*. Më i madhi nxitës për ta ishte fakti që ai punonte vetë me ta dhe merrte pjesë në punë. Ai hoqi mantelin e tij për t'u dukur si punëtor mes tyre. Ata hodhën mantelet e tyre, shtrënguan rrobat dhe iu përveshën punës me zell.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbante dhe transportonte gurët së bashku me ta. Kur Esjed bin Hudair *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* e pa Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me gurë në duar, i tha: "*O i Dërguar i Allahut, le të ta mbaj unë atë për ty.*" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigj: "*Shko merr një tjetër.*"[1036]

Kjo ishte një punë ku morën pjesë muhaxhirët dhe ensarët, duke rikthyer kështu bashkimin dhe përzierjen midis elementeve të ndryshme të shoqërisë së re. Pamja e ndërtimit ishte një pamje e gëzueshme, sikur të ishte një festival i punës kolektive.

Amar bin Jasir *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* mbante dy tulla njëherësh, sepse ishte një djalë i fortë, ndërsa të tjerët mbanin vetëm nga një tullë. Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vinte tek ai, i pastronte pluhurin nga koka dhe i thoshte: "*Hajde-hajde djali i Sumejes! Një grup rebelësh do ta vrasë atë padrejësisht! Ai i thërret për në Xhenet, kurse ata e thërrasin për në zjarr.*" Amari thoshte: "*O Allah na ruaj nga sprovat! O Allah na ruaj nga sprovat!*"[1037]

Muri i xhamisë u ndërtua në disa faza. Së pari, u gërmua themeli, pastaj u ngrit me gurë tre krahë lartësi: një krah nën tokë

[1035] Buhariu, 428. Muslimi, 524.
[1036] "*Vefau el vefa*", El Semhudi, 1/256.
[1037] Buhariu, 447.

dhe dy mbi të, në mënyrë që rrjedha e ujit të mos ndikonte në themelet e ndërtesës. Mbi gurë ata ndërtuan me tulla balte dhe baltë, pastaj vendosën trungjet e palmave, të cilat kishin mbetur nga hapësira e tharjes së hurmave dhe nga trungjet e palmave të *domit*.[1038] Këto u vendosën për shtylla, të rreshtuara në anën e kibles së xhamisë. Kibla ishte nga veriu në drejtim të Bejtu'l Makdisit.

Lartësia e ndërtesës ishte e tillë që, nëse një burrë i gjatë do të shtrinte dorën, do të arrinte tavanin. Nga rrëfimet kuptohet se muret nuk arrinin deri te tavani plotësisht, por ishin pak më të ulët, duke lënë një hapësirë të hapur midis murit dhe tavanit që lejonte depërtimin e dritës dhe ajrit, rreth një krah lartësi - pra afërsisht gjysmë metri.

Sa i përket tavanit, degët e palmave u shtrinë mbi trungjet e palmave, pastaj u ndërthur me degë të tjera, mbi të vendosën gjethet dhe degët e palmës, duke krijuar një çati lloji si strehë, mbi të cilën u vendos një shtresë balte që mbulonte boshllëqet dhe mbronte nga nxehtësia dhe shiu. Nëse binte shi i rëndë dhe çatia nuk e mbante ujin, ai depërtonte në tokën e xhamisë.

Xhamisë i bënë tri hyrje: një në të djathtë, një në të majtë dhe një në drejtim të jugut, sepse kibla ishte në veri. Në dy anët e hyrjeve u vendosën kolona mbështetëse[1039], por hyrjet mbeteshin të hapura dhe pa dyer. Kështu, beduini hynte në xhami me devenë e tij dhe e lidhte[1040] aty, ndërsa qentë hynin e dilnin lirshëm, sepse xhamia nuk kishte dyer.[1041]

Toka brenda xhamisë u mbulua me rërë të imët nga lugina el Akik, sepse kjo lloj toke thith shiun dhe ruan dheun e tokës, duke parandaluar ngritjen e pluhurit. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndërtoi shtëpitë e tij në krahun lindor të xhamisë.

[1038] Palma e domit është një dru që i ngjason palmës, por ka disa trungje dhe jo vetëm një trung. Ai rritet në fshatrat e Medinës. Frytet e tij janë të forta dhe quhen *Mukil.* "*Nur el Nibras*", 4/91. "*Lisanu el Arab*", 12/218.

[1039] Në dy anët e hyrjes vendoseshin shtylla druri për të mbajtur derën, por këtu u vendosën prej guri pasi nuk do të vendosej derë në hyrje, "*Fet'h el Bari*", 1/157. "*Sherh Ebi Davud*", El Ajni, 2/356.

[1040] "*Musned Ebi Davud*", El Tajalijsi, 2449.

[1041] Buhariu, 174.

Pas një viti e gjashtë muajsh, kur kibla u kthye drejt Qabes, u mbulua me çati krahu jugor, ndërsa çatia e krahut verior mbeti ashtu dhe u përdor si strehimorë për të huajt. Ata që banuan në këtë hapësirë njiheshin si *Ehlu el Sufa* - banorët e strehimores.[1042]

Me ndërtimin e xhamisë, tashmë, muslimanët kishin vendin e tyre të sigurt për adhurim dhe qendrën e bashkimit të tyre të hapur me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Xhamia e Profetit u bë pamja e kundërt e mbledhjes së fshehtë në shtëpinë e Erkamit në Mekë.

Xhamia u bë qendra e Medinës dhe vendtakimi i banorëve të saj. Pesë kohët e namazit i bashkonin muslimanët pesë herë në ditë dhe imami i tyre ishte i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ata e dëgjonin Kuranin nga këndimi i tij në namaz dhe nga këndimi i tij për ta në xhami.

Në xhami mbaheshin hytbet e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, këshillat dhe mësimet e tij, si dhe kuvendet e tij ku njerëzit i drejtoheshin. Ai kishte zakonisht dy kuvende të rregullta në xhami: një në vendin e tij të faljes pas sabahut deri në lindjen e diellit dhe një tjetër në anën lindore të xhamisë në orët e paradites deri në kohën e pushimit para drekës.

Gjithashtu, Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, krahas hytbes së xhumasë, mbante këshilla të rastit në xhami për shokët e tij, të cilat shpesh ishin pas namazit të sabahut ose pas namazit të drekës.

Ndonjë i huaj që vinte në Medinë e gjente Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në xhaminë e tij, falej pas tij, ulej me Sahabët në kuvendin e tij. Kështu forcohej lidhja me fiset dhe lagjet, sepse kishte një vend ku ata mund të shkonin, të takonin Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, të falen me të, të ulen pranë tij dhe të shohin gjendjen e tij. Pastaj ktheheshin te populli i tyre, me një botëkuptim të plotë për Islamin si një program pune dhe një sistem jete.

Në këtë xhami u krijua edhe shkolla e parë për gratë, duke qenë se ato ishin të pranishme në xhami, merrnin pjesë në faljen e namazit me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*

[1042] Shiko temën: "I Dërguari dhe njerëzit e strehimores – *Sufa*".

dhe dëgjonin Kuranin nga këndimi i tij gjatë namazit. Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, theksoi që gratë të mos ndaleshin nga pjesëmarrja në xhami dhe në namaz, duke thënë për të gjitha gratë: *"Mos i ndaloni robërit e Allahut nga xhamitë e Allahut."*[1043]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i kushtonte vëmendje pjesëmarrjes së grave në xhami. Ndodhte që ai ta shkurtonte namazin sepse ndonjë grua kishte me vete fëmijën që qante, dhe ai thoshte: *"Unë e filloj namazin me dëshirën ta zgjat atë, por kur dëgjoj të qarën e fëmijës e shkurtoj namazin sepse nuk dua të mundoj nënën e tij."*[1044]

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përfundonte namazin, gratë ngriheshin për t'u larguar pas selamit, kurse ai qëndronte ulur pak më gjatë derisa të largoheshin gratë. Ibn Shihabi thotë: "Allahu e di më mirë, por unë mendoj se qëndrimi i tij ishte për t'u dhënë mundësi grave të largohen, para se të dilte ndonjë prej burrave që largoheshin."[1045]

Ndërsa prania e grave në faljet në xhami ishte një kurs trajnimi në kryerjen e obligimeve dhe në mësimin e Kuranit, të cilin kujdeseshin njësoj si burrat ashtu edhe gratë.

Krahas kësaj, kjo prani e grave në xhami ju jepte mundësinë të bëjnë pyetje, të kërkojnë sqarime dhe të japin përgjigje mbi atë që i pyeste Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Ebu Hurejra *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se *Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli për të falur namazin dhe eci deri te vendi ku ai falej, u kthye nga njerëzit. Ata ishin dy safa me burra dhe një saf me gra, ose dy safa me gra dhe një saf me burra. Ai tha: *"Nëse shejtani më bën të harroj diçka gjatë namazit, atëherë dikush nga burrat le të thotë SubhanAllah, ose dikush nga gratë të përplasë duart."*[1046]

Me pjesëmarrjen e tyre, gratë muslimane mësuan Kuranin dhe Sunetin, mësuan edukatën dhe dijen, dhe kjo i nxiti ato të jenë pjesëmarrëse aktive në bartjen e përgjegjësisë së fesë dhe punës për të.

[1043] Buhariu, 900.
[1044] Buhariu, 868. Muslimi, 470.
[1045] Buhariu, 837.
[1046] Ebu Davudi, 2174.

Dita e të Dërguarit[1047]

Në këtë *Sira* të përditshme, udhëtojmë së bashku me orët e ditës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ku ai lidh marrëveshjet e tij me jetën në çdo sekondë të saj: në shtëpinë e tij, në xhaminë e tij, në rrugicat e qytetit të tij, në shtëpitë e shokëve të tij, mbi hasrën e kuvendit, në sofrën e ushqimit dhe mbi shtratin e gjumit. Është sikur të jetojmë me të në thjeshtësinë e jetës madhështore, natyrshmërinë e jetës serioze dhe ekuilibrin mes veprimtarive të përditshme.

Historia nuk ka njohur ndonjë arritje të kryer nga ndonjë njeri më të madhe se ajo që u realizua nëpërmjet Pejgamberit njeri *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Dita e tij ishte ena kohore e atyre arritjeve madhështore që u kryen me duart e tij.

Rrezja e agimit çan errësirën e natës dhe ezani i Bilalit kumbon duke shpërndarë qetësinë e Medinës. Zgjohet i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, merr misvakun dhe pastron dhëmbët, pastaj thotë: *"Falënderuar qoftë Allahu, i Cili na dha jetë pas vdekjes, dhe tek Ai është kthimi."*[1048]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përgjigjet muezinit duke përsëritur fjalët e ezanit.[1049] Pastaj ngrihet; nëse ka nevojë për gusël, bën gusël, dhe nëse ka nevojë për abdes, merr abdes.

Mandej fal dy rekate sunet të sabahut - një namaz të shkurtë - në të cilin, pas sures Fatiha, në rekatin e parë këndon: ***"Kul: Ja ejuhel kafirunë!"***, dhe në rekatin e dytë: ***"Kul: HuvAllahu, Ehad."*** Nganjëherë këndon edhe sure të tjera.[1050]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ishte në ndonjë prej namazeve vullnetare më i kujdesshëm e më i rregullt sa në këto dy rekate (të sabahut). Ai thoshte: *"Ato janë më të dashura për mua se e gjithë dynjaja dhe ç'ka brenda."*[1051]

[1047] Përmbledhje nga libri *"El Jevmu el Nebevij – dita profetike"* të autorit.
[1048] Buhariu, 6312. Muslimi, 2711.
[1049] Buhariu, 611. Muslimi, 383.
[1050] Buhariu, 618. Muslimi, 726.
[1051] Muslimi, 725.

Pasi përfundonte këtë namaz, shtrihej në anën e djathtë derisa të vinte koha e ikametit për të falë farzin.[1052]

Kur mblidheshin njerëzit, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dilte nga shtëpia e tij për në xhami, falte sabahun dhe e zgjaste këndimin e Kuranit[1053] - ***"Këndo Kuran në agim; me të vërtetë, falja e mëngjesit është e dëshmuar."*** (El-Isra: 78)

Pasi e përfundonte namazin dhe jepte selam, qëndronte në vendin e tij, me fytyrën nga kibla, dhe thoshte: *"Estagfirullah - Kërkoj falje prej Allahut."* Pastaj e madhëronte Allahun me fjalë të përmbledhura, e lavdëronte Atë, e falënderonte dhe e lartësonte.

Më pas sahabët në anët e safave afroheshin dhe e rrethonin të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndërsa rrinte ulur në vendin e faljes, me fytyrë prej tyre dhe bisedonte me ta.

Ndonjëherë i pyeste: *"Kush prej jush ka parë ndonjë ëndërr, le ta tregojë që unë t'ia interpretoj."***[1054]** Ata ia rrëfenin ëndrrat e tyre dhe ai ua interpretonte.

Ndonjëherë ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregonte ndonjë ëndërr që kishte parë vetë, ua rrëfente dhe ua interpretonte atyre.[1055]

Po ashtu, ndonjëherë i këshillonte me një këshillë të shkurtë. Këshillat i kishte të herë pas hershme, por jo të përditshme, që të mos mërziteshin.

Në këtë kuvend, sahabët bisedonin në prani të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ai herë përfshihej në bisedë, herë i dëgjonte. Ndonjëherë ata rrëfenin për jetën e tyre në të kaluarën, për gabimet e marrëzitë që bënin atëherë, të cilat, tashmë, u dukeshin të shëmtuara pasi Allahu i nderoi me Islamin. Kur i kujtonin ato, qeshnin për padijen e tyre të dikurshme dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* buzëqeshte së bashku me ta.[1056]

[1052] Buhariu, 626. Muslimi, 736.
[1053] Ahmedi, 8366.
[1054] Muslimi, 2269.
[1055] Buhariu, 1386. Muslimi, 2285.
[1056] Muslimi, 670, 2322.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kujdesej për sahabët dhe pyeste për ata që mungonin, asnjëri nuk mungonte në vëmendjen e tij. Nuk ngrihej nga vendi i faljes, ku falte sabahun, derisa të lindte dielli. Pastaj ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkonte në shtëpi. E para gjë që bënte kur hynte në shtëpi, përdorte misvakun, për të freskuar gojën e tij[1057].

Përshëndeste familjen, me fjalët: "*Paqja qoftë mbi ju! Si jeni, o banorë të shtëpisë?*"

Ai hynte te gratë e tij, hynte te secila në dhomën e saj, i përshëndeste dhe lutej për to, pa qëndruar gjatë.

Pastaj ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kthehej përsëri në xhami. Atje falte namazin e përshëndetjes së xhamisë pranë shtyllës te Ravda fisnike. Më pas ulej në pjesën lindore të xhamisë, në Ravda, mbështetur tek muri i Huxhres së Aishes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*. Sahabët mblidheshin rreth tij dhe ky takimi ishte zakon, në mënyrë që kushdo që kërkonte të takonte Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në këtë kohë, të shkonte tek ai në xhami.

Ky ishte kuvendi i pritjes për delegacionet që vinin për ta takuar. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i priste në këtë kuvend në këtë orar të paradites.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shpërndante gëzimin, buzëqeshjen dhe vështrimin e tij në kuvendin e tij midis të gjithë sahabëve, derisa ata përfundimisht shpërndaheshin, secili duke menduar se ishte më me fat se të tjerët tek ai.

Ky takim mund të zgjaste, varësisht nga rrethanat dhe nevojat. Sahabët vinin në turne duke zëvendësuar njëri-tjetrin për të qenë pjesë e këtij kuvendi të bekuar, që të mos humbnin asnjë pjesë të dijes apo të gjërave të dobishme që ndodhnin aty.

Ndërkohë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kthehej në shtëpi për një sy gjumë të shkurtër të ditës, ose ndonjëherë e gjenin duke ecur në tregjet e Medinës për t'iu përgjigjur një ftese, për të vizituar dikë, ose për të kryer ndonjë nevojë të tij.

[1057] Muslimi, 253.

Ndonjëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në mëngjes shkonte për të kryer ndonjë punë të tij ose për të vizituar ndonjë nga të afërmit sahabët. Ai bënte shoqëri të këndshme me vizitorët, i përfshinte të gjithë me mirësinë dhe sjelljen e tij të mirë, madje edhe gratë dhe fëmijët e tyre.

Gjithashtu, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkonte tek muslimanët e dobët, kujdesej për ta dhe vizitonte të sëmurët e tyre për t'u dhënë përkujdesje dhe lutje.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkonte çdo të shtunë paradite, në këmbë ose hipur në deve, drejt Kubasë, dhe falej në xhami dhe takohej me banorët e Kubasë që vinin tek ai për t'i dhënë selam.

Gjithashtu, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkonte në kopshtet e Medinës për të qetësuar shpirtin.

Ndonjëherë shkonte para mesditës në shtëpi, nëse kishte ndonjë ushqim hante, nëse nuk kishte ngrënë mëngjesin. Kjo ishte ora e tij e qetësisë dhe privatësisë me familjen. Në këtë orar mund të vinin tek ai disa gra të besimtarëve për të pyetur rreth çështjeve të tyre fetare, të cilat nuk dëshironin t'i diskutonin para burrave në xhami. Pyetjet bëheshin pranë nënave të besimtarëve, të cilat ruanin për Umetin këto vendime të veçanta të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për çështje të grave. Gjithashtu, ndonjëherë në këtë orar e vizitonin disa nga sahabët e tij të veçantë për ndonjë çështje që lindte.

Pushimin e *kajlules* - drekës e bënte të shkurtër deri afërsisht në kohë të namazit të drekës. Këtë gjumë zakonisht e bënte në shtëpitë e tij dhe pranë grave të tij.

Ndonjëherë hynte dhe pushonte pranë Um Sulejmit ose motrës së saj, Umu Haram, të cilat ishin nga të afërmet e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.[1058]

Kur dielli arrinte mesditën, Bilali *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thërriste ezanin për namazin e drekës. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zgjohej nga gjumi i ditës, nëse ende flinte, dhe i përgjigjej muezinit duke përsëritur fjalët e ezanit.

[1058] Buhariu, 2788. Muslimi, 1912.

Nëse kishte nevojë, merrte abdes, pastaj falte katër rekate në shtëpinë e tij.[1059]

Ai thoshte: *"Në këtë orë hapen dyert e qiellit, dhe unë dua që në këtë kohë të ngjitet ndonjë vepër e mirë."*[1060]

Njëherë doli duke mbajtur Hasanin ose Husejnin[1061] dhe njëherë tjetër mbante mbi sup të tij Umamen,[1062] bijën e bijës së tij, Zejnebit. Sikur po i jepte një mësim njerëzimit mbi dashurinë dhe mëshirën ndaj fëmijëve.

Ai falte namazin e drekës menjëherë sa hynte koha e namazit.[1063] Pasi përfundonte namazin, kthehej nga sahabët; nëse kishte ndonjë çështje ose situatë emergjente, fliste me ta për atë gjë të rëndësishme që nuk mund të pritej deri pasdite.

Më pas *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kthehej në shtëpinë e tij, që ishte ngjitur me xhaminë, dhe falte dy rekate namaz sunet të drekës.[1064]

Pas këtij namazi, dilte tek sahabët; ndonjëherë qëndronte me ta deri në namazin e ikindisë, dhe ndonjëherë shkonte gjatë mesditës për të kryer ndonjë nevojë të muslimanëve.

Kur thirrej ezani për namazin e ikindisë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* priste derisa njerëzit të mblidheshin, pastaj dilte dhe falte namazin e ikindisë, zakonisht në fillim të kohës së tij.[1065] Ai këndonte gjatë këtij namazi rreth gjysmës së asaj që kishte kënduar në namazin e drekës.[1066]

Pasi përfundonte namazin, hynte tek gratë e tij dhe i vizitonte të gjitha, duke përfunduar tek ajo ku qëndronte atë ditë, dhe qëndronte aty. Ndonjëherë të gjitha gratë mblidheshin në shtëpinë e saj. Pas namazit të ikindisë, ai kalonte zakonisht kohën në shtëpinë e tij me gratë, ku bënte bashkëbisedime të ngrohta, mësime dhe pyetje shkencore. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut*

[1059] Buhariu, 1182.
[1060] Ebu Davudi, 1270.
[1061] "*El Sunen el Kubra*", Nesaiu, 1141.
[1062] Buhariu, 516. Muslimi, 543.
[1063] Buhariu, 495. Muslimi, 647.
[1064] Buhariu, 1165. Muslimi, 729.
[1065] Buhariu, 544. Muslimi, 611.
[1066] Ebu Davudi, 804.

qofshin mbi të) priste gjithçka me zemërgjerësi dhe durim, duke nxitur vigjilencën mendore, duke hapur horizonte të reja të menduarit dhe duke përdorur diskutimin dhe reflektimin si rrugë drejt bindjes dhe sigurisë shpirtërore.

Gjithashtu, ndonjëherë pas namazit të ikindisë, disa nga sahabët e thërrisnin për ndonjë çështje që dëshironin ta diskutonin pranë tij dhe ai u përgjigjej. Koha nga namazi i ikindisë deri në perëndim të diellit dhe fillimi i natës ishte koha e *dhikrit* lutjeve të mbrëmjes.

Nata e të Dërguarit[1067]

Dielli perëndon duke mbledhur rrezet e fundit të dritës dhe Bilali ngre zërin me ezanin e akshamit. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk vonohet shumë në shtëpi pas ezanit, por del për në namaz. Kur del, i gjen shokët e tij të shpërndarë pranë shtyllave të xhamisë duke falur nga dy rekate.[1068] Me të dalë ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, thirrej ikameti dhe falnin namazin e akshamit, të cilin e falte zakonisht në hyrje të kohës së tij.[1069] Ai largohej para se të binte errësira. Namazi dhe këndimi i tij në aksham ishin përgjithësisht të shkurtër,[1070] por ndonjëherë e zgjaste këndimin, edhe pse rrallë. Kështu, një herë kishte lexuar suren *Et-Tur*[1071] dhe një herë tjetër suren *El-Murselat*[1072].

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e kishte zakoni që të mbante bisedë me Sahabët pas namazit të akshamit, ashtu siç ndodhte pas namazeve të tjera, sepse njerëzit kishin nevojë të ktheheshin për darkën e tyre dhe për pushim. Pasi falej, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kthehej në shtëpi dhe aty falte dy rekate sunet të akshamit,[1073] pastaj hante darkë. Kjo ishte

[1067] Përmbledhje nga libri "*El Jevmu el Nebevij - dita profetike"* të autorit.
[1068] Buhariu, 503. Muslimi, 837.
[1069] Buhariu, 561. Muslimi, 636.
[1070] Ebu Davudi, 814.
[1071] Buhariu, 765. Muslimi, 463.
[1072] Buhariu, 4429. Muslimi, 462.
[1073] Buhariu, 1165. Muslimi, 729.

zakonisht koha e darkës në dimër. Shpesh, për darkë merrte me vete disa nga të varfrit e *Sufa*s, madje ndodhte që t'i merrte dhjetë prej tyre e t'i çonte në shtëpi për t'u ushqyer së bashku, sipas asaj që gjendej nga ushqimi në atë ditë.[1074]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i porosiste sahabët që të merrnin me vete në darkë të varfrit muslimanë. U thoshte: "*Kush ka ushqim për dy veta, le të marrë me vete edhe të tretin, e kush ka ushqim për katër veta, le të marrë edhe të pestin ose të gjashtin.*"[1075]

Pasi hanin darkën, sahabët largoheshin nga shtëpia e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndërsa i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndronte në shtëpi deri në ezanin e *jacisë*. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e pëlqente të flinte para *jacisë*, e as të mbante bisedë pas saj.[1076] Kur Bilali *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thërriste ezanin e *jacisë*, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e shpejtonte namazin menjëherë, por priste: nëse shihte se ata ishin mbledhur, falej më herët, e nëse vonoheshin, e shtynte.[1077] Atij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i pëlqente që *jacia* të shtyhej, po të mos kishte frikë se do të ishte e rëndë për njerëzit. Megjithatë, ishte prej atyre që e falte namazin më të lehtë,[1078] por gjithmonë të plotë.[1079]

Pastaj Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kthehej në shtëpinë e tij dhe falte dy rekate sunet të *jacisë*.[1080] Më pas rrinte pak kohë me familjen, bisedonte me ta dhe kalonte disa çaste shoqërimi para se të flinte. Ndonjëherë shkonte edhe te ndonjëri prej Sahabëve për të biseduar, por më shpeshherë tek Ebu Bekri dhe Umeri (*Allahu qoftë i kënaqur me ta*), për t'u marrë me çështje të muslimanëve. Pasi mbaronin, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kthehej në shtëpi, dhe ata e shoqëronin deri sa të hynte në *Huxhren* e tij.

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shtrihej për të fjetur thoshte: "*Falënderuar qoftë Allahu që na dha të*

[1074] Buhariu, 602.
[1075] Buhariu, 3581. Muslimi, 2057.
[1076] Buhariu, 771. Muslimi, 647.
[1077] Buhariu, 560. Muslimi, 646.
[1078] Ebu Davudi, 46.
[1079] Muslimi, 469.
[1080] Buhariu, 1165. Muslimi, 729.

hamë, na dha të pimë, na dha mjaftueshëm dhe na dha strehë. Sa njerëz janë që nuk kanë mjaftueshëm dhe as nuk kanë strehë."[1081]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e vendoste misvakun pranë kokës së tij, që ta përdorte sa herë të zgjohej. Nuk ndodhte të flinte ditën apo natën, e kur zgjohej, të mos fillonte me misvak. Gjuha e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk shkëputej nga *dhikri* sa ishte zgjuar.

Kur nata arrinte në mes, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zgjohej, fërkonte fytyrën e tij të bekuar me duart e tij për të larguar gjumin, merrte misvakun dhe pastronte gojën e tij të pastër e të bekuar. Pastaj drejtonte shikimin nga qielli, duke medituar në qetësinë e natës rreth madhështisë së Allahut në krijesat e Tij.

Më pas, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ngrihej dhe shkonte tek një enë uji që e kishte të varur, e zgjidhte lidhësen e saj, e mbushte një tas, merrte abdes të plotë, por duke kursyer ujin. Pastaj vishte rrobat *(izar dhe rida)*, bënte *dhikër* duke madhëruar Allahun, përpara se të fillonte faljen e namazit të natës *(tehexhud).*[1082]

Namazin e fillonte me lutje madhëruese për Zotin e tij, me mall dhe me dashuri për Të. Namazi i natës ishte namazi më i gjatë i tij: si në hapje me lavdërime, në këndim Kurani dhe në lutje. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* këndonte me një këndim të qetë, të ngadaltë dhe të bukur. Kur bënte ruku, e zgjaste shumë; kur binte në sexhde, po ashtu, e zgjaste.

Kështu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kalonte pjesën më të madhe të natës duke e ndarë ndërmjet këndimit me përkushtim, lutjes me përgjërim dhe lavdërimit shenjtërues, derisa të mbetej vetëm një e gjashta e natës.

Nga fundi i jetës së tij, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dilte natën vizitonte varret në *el Bekia*, u jepte selam banorëve të tyre dhe lutej për ta.[1083]

Kur kalonin orët e natës dhe nuk mbetej veçse pjesa e fundit e saj, një e gjashta e natës, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) shtrihej në shtratin e tij, për t'i dhënë pak pushim

[1081] Muslimi, 2715.
[1082] Buhariu, 138. Muslimi, 763.
[1083] Muslimi, 974.

trupit të tij fisnik dhe për ta përgatitur për namazin e sabahut dhe për punët e ditës me gjallëri e përkushtim. Kështu fillonte një ditë e re profetike, e parfumuar me frymën e pejgamberisë dhe e ndriçuar me dritën e shpalljes.

I Dërguari dhe ushqimi[1084]

Allahu i Madhëruar ka përmendur pejgamberët dhe ka përshkruar sjelljen e tyre, duke treguar se ata hanin ushqim dhe ecnin në tregje. Ai përmend Isain, birin e Merjemes, dhe nënën e tij, *(paqja e Allahut qoftë mbi ta)*, duke thënë: ***"Që të dy, hanin ushqim."*** (El-Maide: 75)

Kjo bëhet për të theksuar se të Dërguarit janë njerëz, me nevoja njerëzore dhe me natyra njerëzore, që t'u shërbejë njerëzve për t'i ndjekur ata.

Prandaj, në mënyrën e të vepruarit të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me ushqimin, do të gjejmë udhëzim dhe mësim.

1. Ushqimi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ushqim i ambientit ku jetonte dhe mënyra e tij e ushqyerjes ishte mënyra e atij ambienti. Ai hante atë që hanin arabët në pjesën perëndimore të gadishullit, në Mekë dhe Medinë. Ushqimi i tyre kryesor ishte gruri, thekra dhe hurmat. Frutat e tyre të freskëta ishin hurmat e njoma dhe rrushi. Gjella e tyre ishte mishi dhe gjalpi kur gjendeshin. Ndërsa ëmbëlsirat e tyre ishin mjalti dhe hurmat, si dhe ushqime të tjera të ngjashme. Në këtë shihet se ushqimi i tyre ishte i kufizuar, pa shumë larmi, i thjeshtë në përbërje dhe pa kombinime të sofistikuara. Madje, ushqimi më i shijshëm dhe më i preferuar ishte *therid* - bukë me mish. Në tryezë vendosej zakonisht vetëm një lloj ushqimi.

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hante këto lloje ushqimesh sepse ato ishin të thjeshta dhe të disponueshme në ambientin e tij. Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk e

[1084] Shih librin *"El Et'imetu ve el Eshribetu fi asri el Resuli"*, dr. Muhamed bin Faris el Xhemil.

privilegjonte veten me asgjë që t'i sillej atij veçanërisht nga vende të tjera. Po të donte mund ta bënte sikurse bëjnë mbretërit, të cilët sjellin ushqime të shtrenjta që nuk gjenden në vendet e tyre. Por ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hante atë që hanin njerëzit përreth tij dhe nuk e bënte veten të veçantë me asgjë përveç tyre.

2. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hante vetëm sa kishte nevojë dhe nuk e mbushte barkun. Për këtë arsye tha: *"Nuk mbush njeriu enë më të dëmshme se barku i tij; njeriut i mjaftojnë disa kafshatë, sa ta të mbajë kurrizin drejt. Nëse njeriu e kalon këtë, atëherë një e treta të jetë për ushqim, një e treta për pije, dhe një e treta për frymëmarrje."*[1085]

Xhabir bin Abdullahu thotë se isha ulur në shtëpinë time, kur aty pranë kaloi i Dërguari i Allahut (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Ai më bëri shenjë dhe unë u nisa drejt tij. Shkuam te një nga *Huxhre* e grave të tij, hyri brenda dhe më dha leje të hyja pas tij. Ai pyeti: *"A ka ushqim?"* Ato thanë: "Po!" Atëherë, sollën tre kulaçe, të cilët u vendosën mbi një gjë të ngritur mbi tokë.[1086] Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mori një kulaç dhe e vendosi përpara tij, mori një tjetër dhe e vendosi përpara meje, pastaj mori të tretën, e ndau në dy pjesë, një gjysmë përpara tij dhe një gjysmë përpara meje, dhe pyeti: *"A ka gjellë?"* Ato thanë: "Jo, vetëm pak uthull." Ai tha: *"Silleni, sa gjellë e mirë është uthulla."*[1087] Kjo ishte një vlerësim i asaj që ishte e pranishme, jo se ai e preferonte më shumë se ushqimet e tjera.

3. Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hante atë që ishte e pranishme dhe kurrë nuk shante ushqimin; nëse e pëlqente, e hante, e në të kundërt, e linte.[1088] Ai nuk ishte i dhënë pas ushqimeve të ndryshme apo shijeve të ndryshme. Kur hynte në shtëpi pyeste familjen e tij: *"A ka ndonjë ushqim?"* Nëse kishte diçka, e hante, dhe ndonjëherë pyeste: *"A ka ndonjë ushqim?"* dhe kur i thoshin

[1085] "*Xhamiu el Tirmidhi*", 2380.
[1086] "*El Nihajetu*", 5/11.
[1087] Muslimi, 2052.
[1088] Buhariu, 3563. Muslimi, 2064.

"jo", atëherë ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) thoshte: *"Atëherë, unë po agjëroj."*[1089]

4. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kaloi situata me mungesë ushqimi, aq sa ndonjëherë kalonin muaj pa ndezur zjarr në shtëpi për të gatuar; ushqimi i tyre kryesor ishte hurma, ujë dhe qumësht.[1090] Po ashtu, kaloi periudha kur ushqimi ishte i pakët saqë në shtëpi nuk kishte asgjë për t'u ushqyer.

Njëherë i erdhi një mysafir dhe ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dërgoi dikë te shtëpitë e grave të tij për të pyetur: *"A ka ndonjë ushqim?"* Ato të gjitha i thanë: *"Jo, pasha Atë që të dërgoi me udhë të drejtë, nuk kemi asgjë përveç ujit."*[1091]

Sa i përket lidhjes së një guri mbi bark, kjo ndodhi shumë rrallë tek Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe sahabët. Ndodhi një herë gjatë hapjes së hendekut.[1092] Ajo gjendje nuk ndodhi shpesh. Lidhja e gurit bëhej siç ishte zakon ndër arabë kur ishin të uritur dhe duhej të punonin, ata vendosnin një gur të sheshtë mbi bark për të mbështetur, ndërkohë që e shihnin si forcim për kurrizin e shpinës dhe për t'i ndihmuar gjatë punës.

Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) veproi kështu me sahabët, sepse ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i bashkohej gjendjes së tyre në uri dhe në punë.

Këto ishin situata të përkohshme dhe jo gjendje e përhershme. Shumica e tyre ndodhën në fillimet e Hixhretit, kur muhaxhirët erdhën dhe mbështetja e Medinës nuk ishte e mjaftueshme. Pas fitores mbi fisin Beni Nadir dhe më pas mbi Hajber, ushqimi u shtua aq sa ruhej në shtëpitë e grave të tij për vitin e ardhshëm.

Mund të ndodhte, gjithashtu, mungesë ushqimi në një periudhë të vitit, zakonisht në fillim të verës, kur frutat e vitit të kaluar ishin konsumuar dhe frutat e këtij viti ende nuk kishin pjekur. Kjo situatë ishte e njohur në vendet me palma në Gadishullin Arabik. Për shembull, emërtimi i fruteve të palmave me emrin *Besri* - hurmat e para që sapo kanë filluar të piqen dhe pastaj *Rutab* - për hurmat e

[1089] Ebu Davudi, 2455.
[1090] Buhariu, 2567. Muslimi, 2972.
[1091] Buhariu, 3798. Muslimi, 2054.
[1092] Buhariu, 4101. Muslimi, 2040.

njoma, tregojnë më së miri fillimin e verës dhe fillimin e pjekjes së frutave para se të ishin të gjitha të gatshme dhe të bollshme.

5. Nga mënyra e tyre e jetesës shihet se vaktet e përditshme të ushqimit ishin dy vakte: dreka dhe darka. Dreka hahej në mëngjes, në fillim të ditës, e cila në kohën tonë njihet si *mëngjes*.

Darka hahej në mbrëmje,[1093] pas ikindisë ose pas akshamit. Darka hahej pas ikindisë në verë kur dita është e gjatë kurse në dimër kur dita është e shkurtër darka hahej pas akshamit.

6. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) shmangte ushqimet me erë të fortë, si hudhra dhe qepa, prandaj nuk i hante, por nuk i ndalonte të tjerët që t'i hanin. Megjithatë, i këshillonte ata që i hanin këto ushqime të mos hynin në xhami, që të mos shqetësonin engjëjt dhe besimtarët me erën e tyre.[1094]

Xhabir bin Abdullahu thotë se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: *"Kush ka ngrënë hudhër ose qepë, le të qëndrojë larg nesh, ose le të qëndrojë larg xhamisë sonë, dhe le të ulet në shtëpinë e tij."*

Njëherë i sollën në sofër një pjatë me perime nga barishte dhe Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuhati erën e tyre. Kur pyeti për përbërjen e saj dhe i treguan se ishte nga barishtet, tha: *"afrojani"* - për dikë nga sahabët që ishte me të. Kur Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pa se ai nuk deshi ta hante, i tha: *"Ha, sepse unë takohem me (Xhibrilin) atë që nuk takohesh ti."*[1095]

7. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i shmangej asaj që nuk i pëlqente për shkak se nuk ishte mësuar me të. Ai nuk e hëngri mishin e *Dhab* që ia ofruan të pjekur. Kur Halidi e pyeti: "A është i ndaluar, o Pejgamber i Allahut?", ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: *"Jo, por ai nuk është ushqim i popullit tim, prandaj mua nuk më pëlqen."*[1096] Halidi e mori dhe e hëngri.

8. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ulur në tokë, sipas zakonit të arabëve në kohën e tij, ku nuk përdornin

---

[1093] Mbrëmja *Ashij* ka dy kuptime: I pari koha pas zenitit të diellit deri në perëndim. I dyti nga perëndimi i diellit deri në namazin e jacisë. "El *Nihajetu",* 3/242.

[1094] Buhariu, 853. Muslimi, 561.

[1095] Buhariu, 7359. Muslimi, 564.

[1096] Buhariu, 5391. Muslimi, 1946.

tavolina.[1097] Ata shtrinin ushqimin mbi *sufra*, një lloj shtroje për ushqim që mund të ishte prej lëkure, pëlhure ose hasër e rrumbullakët e endur nga gjethet e palmës së hurmës.

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) nuk hante i mbështetur, por ndreqej dhe qëndronte ulur para ushqimit të tij, në shenjë përulje para Zotit të Tij të Lartësuar, falënderim për Të dhe respekt ndaj ushqimit dhe atyre që e shtronin atë.[1098]

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hante me tre gishta dhe i lëpinte pasi të përfundonte së ngrëni.[1099] Nuk kishin peceta për të pastruar duart, dhe nuk ishte zakon që t'i lanin duart sa herë që hanin; ndonjëherë i lanin, ndonjëherë i fshinin me dheun dhe pastaj i shkundnin.

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e lante gojën pas çdo ushqimi të yndyrshëm. Ibn Abasi tregon se Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e lau gojën pasi piu qumësht dhe tha: *"Është i yndyrshëm."*[1100]

9. Një rregull tjetër për ngrënien është ai që Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ia mësoi Umer bin Ebi Selemes. Ai tregon: "Isha një djalë i vogël në prehër të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe dora ime shpesh shëtiste në enën e ushqimit. Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më tha: *'O djalosh, thuaj Bismilah, ha me dorën tënde të djathtë dhe ha përpara vetes.' Që atëherë ushqimi im ndoqi gjithmonë këtë rregull."*[1101]

10. Ushqimi ishte i bekuar në duart e Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe, për këtë arsye, ndodhën mrekulli të shumimit të ushqimit, të cilat u panë dhe u dëshmuan nga shumë sahabë.

Semura bin Xhundub tregon: "Ndërkohë që ishim me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, iu soll një enë me therid. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hëngri vetë

[1097] Fjala *Hivan* është tryezë ose tavolinë, diçka e ngritur mbi tokë mbi të cilën vendoset ushqimi për të ngrënë. Shih: "*El Nihajetu*", 2/89.
[1098] "*Zadu el Meadi*", 4/203.
[1099] Buhariu, 5456. Muslimi, 2031.
[1100] Buhariu, 211. Muslimi, 358.
[1101] Buhariu, 5376. Muslimi, 2021

dhe hëngrën njerëzit që ishin aty. Ata vazhduan të kalonin enën dorë më dorë dhe grup pas grupi deri pak para namazit të drekës. Çdo grup që erdhi aty hëngri nga ai ushqim, ngrihej ai grup dhe pastaj vinte grupi tjetër. Një njeri e pyeti: 'A e mbushte njeri atë enë vazhdimisht?' Ai tha: 'Nga toka jo, përveçse nëse po e mbushte dikush nga qielli.'"[1102]

Këto janë mrekulli dhe shenja të Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe, gjithashtu, një nder për sahabët e tij që të shtohet besimi, bindja dhe qëndrueshmëria e tyre. Ata ishin ata që besuan tek ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) dhe e pranuan të vërtetën, ndërsa e gjithë bota ishte e përkulur ndaj mosbesimit dhe larg së vërtetës. Këto mrekulli ndodhën para syve të tyre për t'i mbështetur, për t'i forcuar dhe si një dhuratë nga Allahu.

Sa i madh është dallimi mes kërkesës së tyre nga i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për lutje me besim dhe bindje, dhe kërkesës së dishepujve drejtuar Isait *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* për një tryezë nga qielli, ku thanë: ***"A mundet Zoti yt të na zbresë një sofër prej qielli?"*** (El-Maide: 112)

Prandaj, dhurata hyjnore për shokët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi si bekim dhe mirënjohje, ndërsa për dishepujt u shoqërua me paralajmërim: ***"Allahu u përgjigj: Unë do t'jua zbres sofrën. Por cilindo nga ju që nuk beson pas kësaj, do ta dënoj ashtu siç nuk kam dënuar askënd në botë."*** (El-Maide: 115)

11. Sa i përket pijes, burimet e ujit në Medinë kryesisht ishin të kripura. Megjithatë, kishte disa puse me ujë rrjedhës më pak të kripura se të tjerët. Uji për pije merrej nga këto puse, puset kryesorë ishin pusi Garas, pusi Haë, pusi Ruma dhe pusi El Sukja.

Për shkak të kripësisë së ujit, njerëzit zakonisht hidhnin në këtë ujë disa kokrra hurme ose ndonjë grusht rrushi të thatë, që të shndërrohej shija e kripur në shije të ëmbël. Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) i përgatitej uji i tillë me rrush të thatë. Ai e pinte këtë ujë përgjatë tre ditëve. Kur vinte mbrëmja e

[1102] Ahmedi, 20135.

tretë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pinte prej tij dhe u jepte edhe të tjerëve, nëse tepronte diçka e derdhte atë.[1103]

Uji vendosej në shakull për t'u ftohur. Kur donte të pinte ujë, ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) pinte ulur. Ai ndaloi pirjen e ujit në këmbë.[1104] Megjithatë, ka ndodhur që ai të ketë pirë në këmbë, siç ndodhi kur piu nga uji i Zemzemit.[1105]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e pinte ujin përnjëherë, por e pinte me pushime. Ai ndaloi të fryhet në enë,[1106] sepse enët e tyre ishin të përbashkëta.

12. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) hante me Sahabët dhe preferonte të ndante më pak për vete. Ngrënia së bashku forcon marrëdhëniet, krijon afërsi dhe lidhje, dhe ngjall dashamirësi dhe kënaqësi në shpirt. Për këtë arsye, ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) thekson se përgjigjja ndaj ftesë, është detyrë e muslimanit ndaj muslimanit.

Esjed bin Hudajr dhe Ubad bin Bishr ishin te Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*). Kur ata dolën, dikush i solli qumësht Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, dhe ai dërgoi dikë për t'i thirrur edhe ata për të pirë prej qumështit.[1107]

13. Shumica e enëve të gatimit ishin prej balte ose guri dhe quheshin *burma*, ndërsa pjatat e ngrënies ishin prej druri dhe quheshin *kas'a* dhe *sahfa*. Ena e pijes ishte prej druri ose balte, dhe quhej *kadeh*, nëse ishte prej lëkure quhej *rekva*. Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) kishte, gjithashtu, një gotë qelqi që ia dhuroi El Mukavkisi.[1108]

14. Të ngrënit ushqim për Pejgamberin (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ishte çështje besimi, duke besuar se vetëm Allahun është Furnizuesi i vërtetë. Ai nuk e hante mishin që nuk therej për Allahun ose nuk përmendej emri i Allahut.[1109] Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) gjithmonë e përmendte emrin e

[1103] Muslimi, 2004.
[1104] Muslimi, 2024.
[1105] Buhariu, 5617. Muslimi, 2027.
[1106] Tirmidhiu, 1887.
[1107] Muslimi, 302.
[1108] El Tahavi, "*Sherhu Mushkili el Athari*", 2570.
[1109] Buhariu, 2488. Muslimi, 1968.

Allahut në fillim të ngrënies[1110] dhe e falënderonte Allahun pas përfundimit të saj.[1111]

Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) udhëzon që njeriu të shpresojë shpërblim prej Allahut për punën që bën për të siguruar ushqimin si dhe për ushqyerjen e atyre që i ka nën kujdesin dhe përgjegjësinë e tij. Ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) tha: "*Çfarëdo që të shpenzosh për hir të Allahut, do të shpërblehesh për të, madje edhe për atë me të cilën ushqen gruan tënde.*"[1112]

Kur pinte, ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e falënderonte Allahun, dhe kur hante, sillte në mendje mirësinë e madhe të Allahut për ushqimin, i ka dhënë furnizim, i ka dhënë trup të shëndetshëm për të shijuar ushqimin dhe përfituar prej tij. Prandaj, ai (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) e mbyllte ngrënien me falënderime mirënjohëse të shumëllojshme ndaj Allahut të Lartësuar:

"*Falënderuar qoftë Allahu! Ai që ushqen dhe nuk ushqehet!*"

"*Falënderuar qoftë Allahu! Ai që na dha të hanë dhe të pimë, dhe që na bëri muslimanë!*"

"*Falënderuar qoftë Allahu! Ai që më dha këtë ushqim, më furnizoi me të pa forcën dhe pa fuqinë time!*"

Veshja e të Dërguarit[1113]

1. Veshja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ajo e mjedisit arab ku ai u rrit. Ai nuk u dallua nga populli i tij në këtë aspekt: veshja e tij para dhe pas shpalljes mbeti e njëjtë, pa ndryshim të veçantë.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk i urdhëroi njerëzit të braktisnin veshjen e tyre kombëtare për të adoptuar veshjen e tij, por e la çështjen e veshjes në varësi të zakoneve dhe traditave të çdo populli. Për këtë arsye, veshja e tij ishte e ngjashme me atë të arabëve të Mekës dhe Medinës, qofshin ata

[1110] Buhariu, 5376. Muslimi, 2022.
[1111] Buhariu, 5458.
[1112] Buhariu, 2742. Muslimi, 1628.
[1113] Shih: Muhamed Faris el Xhemil, "*El Libasu fi Asri el Resuli*", prej të cilit është përfituar.

muslimanë apo idhujtarë. Nuk kishte diçka në veshjen e tij që ta veçonte nga të tjerët apo që të tërhiqte vëmendjen mbi të.

Prandaj, ndjekja e Sunetit të tij në veshje nuk qëndron tek veshja ashtu siç vishej ai, por tek respektimi i traditës së përgjithshme të shoqërisë. Ai vishej siç vishej populli i kohës së tij dhe nuk u dallua prej tyre me diçka të veçantë që të tërhiqte vëmendjen.

Veshja e arabëve në kohën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* karakterizohej nga thjeshtësia, pa zbukurime dhe ndërlikime. Veshjet më të zakonshme të tyre ishin:

- ***Çallma*** mbi kokë; ndonjëherë nën të vishnin edhe një kapuç të lehtë, e cila i ngjan kapuçit të thjeshtë që përdoret ende sot në Gadishullin Arabik.
- ***Kamijs***, një këmishë që mbulonte tërë trupin dhe i ngjante rrobës së gjatë të njohur në vendet arabe.
- ***Izari***, rroba e poshtme që mbulon trupin nga beli deri poshtë gjunjëve, që lidhej rreth belit, e ngjashme me izarin e ihramit në Haxh.
- ***Rida*****,** rroba e sipërme, guna që hidhej mbi supe dhe mbi shpinë, e cila përbënte edhe një plotësim të hijeshisë. Në përdorim, ajo ngjan me *bisht*-in në vendet arabe ose me *sellham*-in në Marok.

Këto ishin veshjet më të zakonshme. Përveç tyre, përdoreshin edhe veshje të tjera sipas mundësive, si *xhybe*, *burnusi*, *kaba*, *hamijsa* e të ngjashme me to.[1114]

Rrobat që visheshin drejtpërdrejt mbi trup quheshin *shiar*, si *kamijs*-a dhe *izar*-i. Kur vishej një palë rroba të së njëjtës lloj, quheshin *hul-le*. Nëse kombinimi përbëhej nga dy rroba të ndryshme, si, për shembull, izar dhe rida, ose rida dhe kamijs, atëherë nuk quhej *hul-le*.

Në situata varfërie kishte njerëz që nuk kishin tjetër përveç *izar*-it dhe *rida*-së, ndoshta nuk gjenin tjetër përveç një cope të vetme me të cilin mbulonin trupin.

2. Tiparet e veshjes së arabëve në kohën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ndër veshjet e përdorura në atë

[1114] Burnusi: Çdo veshje që ka kapuç të bashkangjitur me të. Hamijsa: Një mantel i zi katërkëndësh, i zbukuruar me shenja. Shih: "*En-Nihaja*", 1/122, dhe "*Tajul-Arus*", 17/566.

kohë ishin edhe ato që thureshin nga vetë gratë dhe njerëzit e thjeshtë. Edhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka veshur prej tyre. Sehl trego se një grua erdhi te Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, me një *burda (mantel)* të thurur prej saj, me një shtesë të veçantë në skaj. Pyeti: "A e dini çfarë është "*burda?*" - "Është një mantel i thjeshtë!" - u përgjigjën ata. - "Po" - tha.

Gruaja tha: "E kam thurur me duart e mia dhe erdha të ta fal si dhuratë që ta veshësh." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, duke qenë i nevojshëm për të, e mori. Pastaj doli tek sahabët dhe e kishte veshur si *izar*.

Njëri prej tyre e pa dhe tha: "Sa e bukur është! O i Dërguar i Allahut, ma jep ta veshi unë." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "Po." Pastaj hyri në shtëpi, e palosi dhe ia dha atij.

Shokët i thanë atij njeriut: "Nuk bëre mirë! Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kishte veshur duke qenë i nevojshëm për të dhe ti ia kërkove, ndërkohë që e di se ai nuk ia kthen mbrapsht askujt që i kërkon." Ai u përgjigj: "Pasha Allahun, nuk ia kërkova që ta vesh, por vetëm që të bëhet qefini im."

Sahl *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë: "Dhe ajo, vërtet, u bë qefini i tij."[1115]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka veshur edhe rroba të thurura në Jemen, pasi shumica e veshjeve thureshin andej për shkak të afërsisë. Ai ka veshur, gjithashtu, rroba të punuara në Sham, si edhe veshje të prodhuara në Egjipt, të cilat ishin prej liri.

Veshjet e tyre ndonjëherë ishin të thjeshta, pa ngjyra, e ndonjëherë kishin ngjyrosje me vija në skaje - të gjelbra, të kuqe ose të zeza. Kur në përshkrime përmendet një mantel "i gjelbër" ose "i kuq", qëllimi është të tregohet për vijat e tij të ngjyrosura, e jo se i gjithë manteli ishte në atë ngjyrë.

3. Rrobat që i pëlqenin më shumë. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vishej shpesh me *kamijs*, e cila ishte edhe rroba më e dashur për të.[1116] Mëngët e saj nuk ishin të gjata e të gjera, por arrinin deri te kyçi i dorës pa e tejkaluar dorën.[1117]

[1115] Buhariu, 1277.
[1116] Ebu Davudi, 4025.
[1117] Ebu Davudi, 4027.

Izari i tij arrinte deri në mesin e kërcinjve dhe nuk e kalonte nyjën e këmbës.[1118]

Ndër ngjyrat e rrobave, më të dashurat për të ishin e bardha dhe *hibra* (një lloj rrobe e thurur me vija ngjyrash).[1119] Ai thoshte: "*Vishni rrobat e bardha, sepse ato janë më të mirat ndër rrobat tuaja; dhe në to qefinosni të vdekurit tuaj.*"

Sa për çallmën, ajo nuk ishte as e madhe, as shumë e vogël, por me madhësi të mesme, dhe e linte skajin e saj të varej mes shpatullave.

4. **Sandalet dhe këpucët e lëkurës.** Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vishej me sandale ose me këpucë të lëkurës (me shputë dhe pjesë që mbulonte këmbën). Më së shumti përdorte sandalet kur ishte në qytet, ndërsa këpucët e lëkurës i përdorte më shpesh gjatë udhëtimit, pasi këmbët kishin nevojë për mbrojtje nga të nxehtit dhe të ftohtit, si edhe nga gurët dhe gjembat e tokës.

I Dërguari, sal Allahu alejhi ve selem, kishte një palë këpucë lëkure që ia kishte dhuruar Dihja el Kelbi. Mugira ibn Shuabe tregon: "Dihja el Kelbi i dhuroi të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dy këpucë lëkure dhe një *xhybe*. Ai i veshi ato deri sa u grisën."[1120]

5. Ashtu siç hante nga ushqimi atë që i gjendej pa u munduar e pa kërkuar të tepruar, edhe veshte nga rrobat ato që i gjendeshin pa u munduar. Nuk kishte ndonjë shenjë të veçantë në veshjen e tij që ta njihnin prej saj. Për këtë arsye, kur ndonjë i huaj hynte në kuvendin e tij, pyeste: "Cili prej jush është i biri i Abdulmutalibit?" Atëherë, sahabët i tregonin me dorë dhe thoshin: "*Ky është ai i bardhi që është mbështetur.*"[1121] Pra, ata përshkruanin ndritshmërinë e tij, jo veshjen e tij, sepse ai vishej njësoj si ata. Madje, ai e ndalonte veshjen e rrobave që tregojnë famë, ato rroba që të bëjnë të dallohesh e të ekspozohesh kur i vesh.

Xhabir bin Ejubi transmeton se Salt bin Rashidi hyri te Muhamed bin Sirini, ndërsa kishte veshur një xhybe prej leshi, një *izar* prej leshi dhe një çallmë prej leshi. Muhamedi ndjeu neveri ndaj tij

---

[1118] Muslimi, 2086.
[1119] *Burda* **Hibrati**: Quhet kur është e zbukuruar me vija të ngjyrosura. Shih: "*En-Nihaja*".
[1120] Tirmidhiu, 1769.
[1121] Buhariu, 63.

dhe tha: "Më duket se disa njerëz veshin lesh e thonë: 'E ka veshur edhe Isai, biri i Merjemes.' Por më ka treguar një njeri, tek i cili nuk kam asnjë dyshim, se Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, ka veshur liri, lesh dhe pambuk. Dhe është më me vend që të ndiqet Syneti i Pejgamberit tonë (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*)."[1122]

Qëllimi i Ibn Sirinit me këtë është se disa njerëz mendojnë se veshja prej leshi është gjithmonë më e mirë se të tjerat dhe e kërkojnë atë duke privuar veten nga lloje të tjera rrobash. Po ashtu, ata i ndjekin vazhdimisht të njëjtat rroba, modele dhe mënyra veshjeje, duke i konsideruar të gabuar daljet prej tyre. Por e gabuar është kufizimi i vetes vetëm tek një lloj rrobe dhe ndjekja e rreptë e saj, duke mos lejuar liri në zgjedhjen e veshjes.

Rruga më e mirë është rruga e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që ai e praktikoi, urdhëroi dhe inkurajoi: udhëzimi i tij për veshjen është të vishet ajo që është e pranishme pa sforcim.

6. Ashtu siç shmangte nga ushqimi çdo gjë që kishte erë të keqe, po kështu, shmangte edhe nga veshja çdo gjë që lëshonte ose mbante erë të pakëndshme.

7. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte gjithmonë elegant në veshje. Kur vishte një rrobë, ajo dukej sikur ishte krijuar vetëm për të.

El Bera bin Azib rrëfen: "Pejgamberi ishte trup mesatar, me shpatulla të gjera. E pashë të veshur me një veshje të kuqe dhe nuk kam parë ndonjëherë diçka më të bukur se ajo."[1123]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vishte, gjithashtu, rroba të bukura dhe petka të hijshme e të pastra, me të cilat zbukurohej në raste të veçanta si festat, tubimet e rëndësishme dhe pritjen e delegacioneve.

Ibn Abasi tregon: "Unë e kam parë të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të veshur me rrobat më të bukura që mund të ishin."[1124]

[1122] Ebu el Sheih el Asbahani, "*Ahlaku el Nebij*", 329.
[1123] Buhariu, 3551. Muslimi, 2337.
[1124] Ebu Davudi, 4037.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* këshillonte për veshje dhe paraqitje të hijshme. Babai i Ebu el Ahvasit tregon se shkova te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe kur më pa si beduin të pakrehur dhe të pluhurosur, më pyeti: *"Çfarë pasurie ke?"* Unë iu përgjigja: "Allahu më ka dhënë nga çdo lloj pasurie." Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më tha: *"Kur Allahu i jep robit një mirësi, Ai e do që ajo të duket mbi të."*[1125]

8. Ndoshta nuk i jepej gjithmonë mundësia të vishte rrobat më të mira, prandaj i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vishte atë që gjendej. Enes bin Maliku tregon: "Po ecja me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, i cili kishte veshur një burde me jakë të ashpër nga Nexhrani. Erdhi një beduin, e kapi për jake dhe e tërhoqi me dhunë, aq fort sa pashë që jaka e ashpër la shenja në qafën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nga tërheqja e tij e fortë."

Kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vishte një rrobë të re, ia vinte emrin dhe falënderonte Allahun me fjalët: *"O Allah, Ty të takon lavdia, Ti ma dhe këtë rrobë; Ty të lutem të më japësh të mirën e saj dhe të mirën për të cilën është përgatitur, dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e saj dhe nga e keqja për të cilën është përgatitur."*[1126] Kur vishte *kamijs*-in, fillonte gjithmonë nga e djathta.[1127]

9. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vishte lloje të ndryshme të rrobave, por ai ndaloi disa lloje të veçanta të veshjes. Ai ndaloi arin dhe mëndafshin për burrat. Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) mori mëndafshin me dorën e majtë dhe arin me dorën e djathtë, pastaj i ngriti duart dhe tha: *"Këto të dyja janë të ndaluara për meshkujt e Umetit tim, ndërsa janë të lejuara për femrat e tyre."*[1128]

Gjithashtu, ndaloi veshjen e rrobave të gjata që tërhiqen zvarrë (isbal), prandaj *izar*-i dhe *kamijs*-i i tij ishin vetëm deri në kërci të këmbëve. Po ashtu, ndaloi veshjen që rrezikon zbulim të avretit.

[1125] Ibn Hibban, 5417.
[1126] Ahmedi, 11284. Ebu Davudi, 4020.
[1127] Tirmidhiu, 1766.
[1128] Ebu Davudi, 4057. Ibn Maxhe, 3595. "*El Sunen el Kubra*", 5144.

Mexhlisi profetik

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte mexhlise të rregullta dhe të përhershme, por kishte edhe mexhlise të rastit, kur ulej tek ata që i vizitonte ose kur paraqitej ndonjë nevojë me sahabët.

Mexhliset e tij të rregullta ishin:

1. Mexhlisi pas namazit të sabahut

Pas namazit të sabahut, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndronte në vendin e faljes dhe rreth tij uleshin sahabët. Ata bisedonin me të dhe ai bisedonte me ta. Shpeshherë u kërkonte të tregonin ëndrrat e tyre ose u tregonte atyre atë që kishte parë vetë.[1129] Gjithashtu, pyeste për ata që mungonin dhe interesohej për gjendjen e tyre.

Në këtë mbledhje, sahabët shpesh sillnin në kujtesë jetën e tyre të mëparshme në periudhën e injorancës, duke përmendur gabimet dhe marrëzitë e asaj kohe, të cilat pas Islamit u dukeshin të shëmtuara. Kur i përmendnin, ata qeshnin me padituri në e tyre, dhe i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* buzëqeshte me ta, sepse e qeshura e tij ishte gjithmonë buzëqeshje.[1130] Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndronte në këtë mexhlis derisa dielli të ngrihej e të shndriste bukur.[1131]

2. Mexhlisi i paradites - *Duha*

Nga mexhliset e tij të rregullta ishte edhe mexhlisi i paradites. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndronte në pjesën lindore të xhamisë, aty ku ndodhet *Ravda*, duke u mbështetur tek

[1129] Buhariu, 1386. Muslimi, 2275.
[1130] Muslimi, 670, 2322.
[1131] Ahmedi, 20968.

muri i *Huxhres* së Aishes *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, dhe aty mblidheshin Sahabët. Ky mexhlis ishte një zakon i njohur, kështu që kushdo që donte të takohej me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në këtë kohë vinte tek ai në xhami. Sahabët vinin me turne për të marrë pjesë në mexhlis, që të mos u shpëtonte asnjë informacion pa dëgjuar nga Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Sahabët mblidheshin nga të dyja anët e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, por askush nuk kishte vend të caktuar; çdo kush që arrinte i pari zinte vendin që gjente. Kur uleshin rreth tij, ata ulnin shikimin e tyre herë pas here dhe nuk e përqendronin shikimin tek ai, nga respekti dhe vlerësimi që kishin për të. Po ashtu, ata ulnin zërin dhe nuk flisnin me të ashtu si me njëri-tjetrin, duke treguar nderim, respekt dhe përulësi për urdhrin e Allahut, me të cilin Ai i kishte edukuar duke thënë: ***"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin..."*** (El-Huxhurat: 2)

Kur ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ulej me sahabët, bisedonte me ta dhe merrte pjesë në diskutimet mbi jetën e tyre dhe çështjet e kësaj bote. Zejd bin Thabiti rrëfen: "Unë isha fqinj i tij dhe, kur vinte shpallja, ai më thërriste që ta shkruaja. Kur flisnim për ahiretin, ai fliste me ne për të; kur flisnim për dynjanë, ai fliste me ne për të; dhe kur flisnim për ushqimin, ai fliste me ne për të."[1132]

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk e monopolizonte bisedën në mexhliset e tij; ai mund të fliste, mund të dëgjonte, mund të pyeste dhe mund të përgjigjej. Të gjithë ata që ndodheshin në mexhlis merrnin pjesë në bisedë dhe në mënyrë interaktive flisnin me të. Respekti dhe nderimi ndaj tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk i pengonte ata që të nisnin një bisedë ose të përfshiheshin në diskutim.

Ky ishte një mexhlis i dijes, këshillës dhe përkujtimit. Ai shërbente si një hapësirë e gjerë për misionin e predikimit dhe mësimit dhe shumica e hadithеve të transmetuara prej tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* janë nga bisedat e tij në këto mexhlise.

[1132] Taberani, "*El Muaxhemu el Evsatu", 8697.*

Por ai nuk ishte vetëm mexhlis i dijes dhe i këshillave; ai ishte një mexhlis plot jetë, energji dhe bashkëveprim me çështjet e jetës së përditshme.

Në mexhliset e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* silleshin edhe fëmijët e porsalindur të Medinës. Ai i lutej për ta, fërkonte qiellzën e gojës së tyre me një hurmë që e përtypte me gojën e tij të bekuar. Ai u vendoste emrat dhe i bekonte.[1133]

Në mexhliset e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* silleshin edhe frutat e para të hurmave, pasi hurma ishte fruti kryesor dhe ushqimi bazë i banorëve të Medinës. Ata gëzoheshin kur shihnin të parën e frutave dhe e sillnin tek Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai e merrte në dorë dhe lutej: "*O Allah, bekoi frutat tona, bekoje Medinën tonë, bekoji enët tona! O Allah, Ibrahimi është robi Yt, miku Yt dhe Pejgamberi Yt, po ashtu edhe unë jam robi Yt dhe Pejgamberi Yt! Ai t'u lut Ty për Mekën, kurse unë të lutem për Medinën ashtu siç t'u lut ai për Mekën, dhe një herë më shumë!*" Pastaj thërriste fëmijën më të vogël që ishte i pranishëm dhe ia jepte atë frut.[1134]

Në këtë mexhlis kishte, gjithashtu, hapësirë për argëtim të lehtë dhe shaka. Respekti dhe madhështia e mexhlisit profetik, si dhe nderimi ndaj Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, nuk i pengonin sahabët që të silleshin natyrshëm dhe të shijonin gëzimet e natyrshmërisë së jetës.

Ky mexhlis ishte i hapur në ajër të pastër, pa dyer e pa portier. Te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mund të vinte kushdo që dëshironte, qoftë i vogël apo i madh, burrë apo grua, vendas apo i huaj.

Duket se ky mexhlis shërbente edhe si një takim pritës për delegacionet që vinin. Udhëtarët zakonisht qëndronin jashtë qytetit gjatë natës dhe më pas hynin në qytet paradite, ku takonin Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në këtë mexhlis.

Nga këto delegacione ishin delegacioni i Mudarit dhe delegacioni i Abdu el Kajsit që erdhën tek ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nga Ahsa. Ka shumë mundësi që kjo të jetë po ajo

[1133] Buhariu, 6198. Muslimi, 2144.
[1134] Muslimi, 1373.

mbledhje ku Xhibrili *(paqja e Allahut qoftë mbi të)* erdhi tek ai në formën e një burri me rroba shumë të bardha dhe flokë të zezë, pa shenja udhëtimi dhe i panjohur për të gjithë. Ai pyeti për Islamin, besimin, përsosmërinë dhe shenjat e Kijametit.[1135]

Ky mexhlis shërbente, gjithashtu, si dhomë këshillimi për muslimanët për çdo çështje që u lindte. Aty merreshin vendime siç ishte dalja në Uhud, vendimi për të gërmuar hendekun dhe çështje të tjera që lindnin në jetën e tyre. Askush nuk konsultohej me njerëzit e tij sa konsultohej Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me sahabët.[1136]

Kjo ishte, gjithashtu, një nga shenjat e thjeshtësisë dhe përulësisë së Profetit, sal Allahu alejhi ve selem, larg mënyrave të arrogancës dhe mendjemadhësisë.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, gjithashtu, ndalonte sahabët që të ngriheshin për të, siç bëjnë mbretërit e kombeve të tjera për madhështi dhe mendjemadhësi. Ai thoshte: "*Mos u ngrihuni si ngrihen të huajt për të treguar madhështi ndaj njëri-tjetrit.*"

Kjo nuk ndalon ngritjen e zakonshme për të përshëndetur ose për të pritur dikë që vinte në mexhlis.

Prezenca e njerëzve në mexhliset e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte e larmishme si nga mosha si nga vendbanimi. Ishte i pranishëm i moshuari dhe i riu, adoleshenti dhe fëmija; muhaxhirët, ensarët dhe beduini; udhëtarët kalimtarë dhe banorët e qytetit.

Disa herë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* organizonte mexhlise të veçanta për gratë, ku ai ulej për t'u folur atyre. Ebu Said el Hudri tregon se gratë i thanë Pejgamberit (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*): "Burrat të kanë marrë gjithë kohën, prandaj na cakto një ditë të rrimë me ty." Ai u premtoi një ditë për t'i takuar dhe në atë ditë i këshilloi dhe u dha udhëzime. Ndër të tjera, u tha: "*Një gruaje që i vdesin tre fëmijë, ata do të jenë mburoja e saj nga zjarri.*" Një grua pyeti: "*Po dy fëmijë?*" Ai tha: "*Edhe dy.*"[1137]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kujdesej të ruante nderin e atyre që nuk ishin të pranishëm në mexhlis dhe mbronte

[1135] Buhariu, 50. Muslimi, 8.
[1136] Buhariu, 2711. Ibn Maxhe, 3836.
[1137] Buhariu, 101. Muslimi, 2633.

ata nga fjalët e liga që thuheshin pas shpine. Një ditë u soll para tij Abdullah bin Himar, i dehur dhe u dënua me rrahje aty në atë mexhlis. Pasi ai u largua, një nga të pranishmit tha: "*Mallkuar qoftë, sa shpesh sillet këtu për të njëjtën arsye!*". Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndërpreu dhe tha: "*Mos e mallkoni! Pasha Allahun, unë e di se ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij.*"[1138] dhe shumë raste të tjera të ngjashme, ndërsa unë pyes veten: Si do të ndikonin këto fjalë profetike në mbrojtje të atyre që nuk ishin aty, nëse do ta merrnin vesh? E unë jam i bindur se ato fjalë kanë arritur tek ta, ashtu si kanë arritur tek ne.

Me këtë mënyrë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ruante pastërtinë dhe respektin e mexhlisit, duke mos lejuar përgojimin apo të folurit për dikë që mungon, përveçse me fjalë të mira.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shpërndante gëzimin, buzëqeshjen dhe vështrimin e tij në kuvendin e tij midis të gjithë sahabëve derisa ata përfundimisht shpërndaheshin, secili duke menduar se ishte më me fat se të tjerët tek ai.[1139]

Kur i jepej ndonjë pije, ai pinte pastaj ua jepte edhe të tjerëve për të pirë dhe fillonte nga e djathta e tij, edhe sikur të ishte dikush më i madh ose më i respektuar në të majtë. Ndonjëherë i jepej ushqim, ndërsa ishte mes sahabëve, dhe ai ndante me të gjithë për të ngrënë së bashku. Semure bin Xhundub tregon se kohëzgjatja e mexhliseve profetike ishte e ndryshme, sipas rrethanave dhe temave që trajtoheshin. Kur dita i afrohej drekës, Pejgamberi (*paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*) ngrihej nga mexhlisi dhe asnjë nuk ngrihej prej tij pa thënë: "*Subhaneke Allahumma ve bihamdike, Eshhedu en la ilahe il-la Ente, estagfiruke ve etubu ilejke. - O Allah! Qofsh lavdëruar dhe falënderuar! Dëshmoj se nuk e meriton askush tjetër adhurimin përveç Teje. Kërkoj faljen Tënde dhe përpara Teje pendohem!*"

Kur e tha për herë të parë sahabët thanë: "*O i Dërguar i Allahut, kjo është një lutje që nuk e kemi dëgjuar më parë prej teje?*" Ai tha: "*Kjo është falënderim për atë që ka ndodhur gjatë mbledhjes.*"[1140]

[1138] Buhariu, 6780.
[1139] Tirmidhiu, "*El Shemail*", *319.*
[1140] Ebu Davudi, 4857-4859.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i mbyllte të gjitha mexhliset e tij në këtë mënyrë, qoftë ato të mësimit, të përkujtesës apo të lutjes.

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* e pyeti: "O i Dërguar i Allahut, të shoh se e mbyll mexhlisin, këndimin e Kuranit dhe faljen e namazit me këto fjalë?" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigj: "*Kush flet mirë, këto fjalë do të jenë vulë*[1141] *për të deri Ditën e Kijametit; dhe kush flet keq, këto fjalë do të jenë shlyerje për të.*"[1142]

Nëse mexhlisi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - aty ku nuk thuhet tjetër veçse mirësi, ku nuk përmendet tjetër veçse fjala më e pastër dhe më e bukur - mbyllet me falënderim dhe kërkim falje, atëherë mexhliset tona, ku dashje pa dashje flasim dhe dëgjojmë fjalë boshe, duhet të përkushtohemi për të kujtuar më shumë Allahun dhe për t'i kërkuar falje.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* rrallëherë ngrihej nga mexhlisi i tij pa u lutur për sahabët me këto fjalë: "*O Allah, dhuro na përulje ndaj Teje që të na ruajë nga mëkatet! Na mundëso adhurim që të na udhëheqë drejt Xhenetit! Na jep besim që të na lehtësojë fatkeqësitë e jetës! O Allah, ruaje dëgjimin tonë, shikimin tonë dhe fuqinë tonë gjatë gjithë jetës sonë dhe bëje trashëgimtar për ne! Na forco në betejën tonë kundër të padrejtëve! Na ndihmo kundër armikut tonë! Mos lejo që të dëmtohemi në besim! Mos lejo që dynjaja të bëhet shqetësimi ynë kryesor, e as që të shtyjë synimin tonë për dituri! Mos na lër në dorë të atyre që nuk kanë mëshirë!*"[1143]

Pas kësaj, sahabët shpërndaheshin nëpër punët e tyre ose nëpër shtëpi për të bërë pushimin e drekës - *kajlulen* para namazit të drekës.

Ndërkohë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kthehej në shtëpi për një sy gjumë të shkurtër të ditës, ose ndonjëherë e gjenin duke ecur në tregjet e Medinës për t'iu përgjigjur një ftese, për të vizituar dikë, ose për të kryer ndonjë nevojë të tij.

[1141] Shih: "*Lisanu el Arab", 8/232.*

[1142] Nesaiu, "*El Sunen el Kubra", 1268.*

[1143] Tirmidhiu, 3502. Nesaiu, "*El Sunen el Kubra", 10161.*

I Dërguari në rrugë

Medina përbëhej nga disa lagje të shpërndara: në pjesën e sipërme ndodheshin lagjet si Kuba dhe fisi Benu Salim bin Auf, ndërsa në pjesën e poshtme banonin fisi Benu Seleme dhe Benu Harithe. Çdo lagje ishte një bashkësi fisnore e një grupi prej ensarëve.

Shtëpitë ishin të shpërndara mes bahçeve, plantacioneve me hurma dhe kopshteve, ndërsa rrugët përshkonin hapësirat midis shtëpive brenda lagjes dhe midis lagjeve të ndryshme të Medinës.

1. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në rrugët e Medinës

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ecte nëpër rrugët e Medinës gjatë vizitave të shumta që u bënte lagjeve dhe fiseve të saj. Për këtë arsye, xhamitë dhe vendet e faljes së tij u përhapën në mbarë qytetin, sepse ai falej aty ku vizitonte njerëzit, në xhamitë e tyre.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* udhëtonte në këto rrugë herë mbi kafshë dhe herë në këmbë. Më shpesh ecte në dimër, ndërsa në verë më shumë përdorte kafshën, sepse pluhuri i Medinës në verë ishte i nxehtë përvëlues dhe gurët e saj sikur ishin prush i ndezur.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kalonte me thjeshtësi në mjetet e udhëtimit. Nga kafshët që ai përdori për hipje në rrugë ishin gomari, *ufejri*,[1144] mushka *dulduli*[1145] dhe deveja, *el kasvaja*.[1146]

Sa për distancat e afërta, ai i bënte në këmbë, siç ishte ecja mes shtëpive apo ndërmjet vendeve të afërta.

[1144] Buhariu, 2856. Muslimi, 30.
[1145] Buhariu, "*El Tarijhu el Kebijru", 5/149.*
[1146] Buhariu, 2731. Muslimi, 1218.

2. Ecja e tij në rrugë

Kur ecte, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ecte me vendosmëri dhe forcë, por larg çdo lloj qëndrimi të rëndë e të shtirur që shfaqin mendjemëdhenjtë. Ai e ngrinte hapin e tij, e shkëputste këmbë nga toka sikur të shkëputej fuqishëm prej saj, dhe ecte me një anim përpara[1147] sikur të zbriste një tatëpjetë.[1148] Kushdo që e shihte, e kuptonte se ai nuk ishte as i pafuqishëm e as dembel.

Kur kthehej, ai kthehej tërësisht nga ai që i drejtohej.[1149] Kur ecte bashkë me shokët e tij, ata ecnin përpara dhe anash tij, por jo prapa. Kjo ishte një shenjë e përulësisë së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: nuk dëshironte të ecte përpara shokëve dhe t'i linte ata të ecnin pas tij, siç bëjnë sundimtarët mendjemëdhenj. Ai nuk pranonte për shokët e tij as shenja poshtërimi e as nënçmimi, përkundrazi, ecte mes tyre dhe me ta.

3. Aroma dhe shkopi i tij në rrugë

Kur kalonte nëpër një rrugë, mbetej aty aroma e tij e këndshme. Ndonjëherë, teksa ecte, mbështetej mbi një shkop prej druri *selem* ose mbi një degë *palme*. Herë të tjera mbante në dorë një *urxhun* - degë që mban frutat e hurmës, ose një *mihxhen*[1150] - shkop me majë të përkulur. Mbajtja e shkopit ishte një zakon arab, sepse shpesh gjatë rrugës u duhej një mjet i tillë për çështje të ndryshme.[1151]

[1147] "*Jatekafëu*" do të thotë ta ngrejë këmbën nga toka dhe pastaj ta vendosë, pa e zvarritur si ecja e mendjemëdhenjve. Është sikur të zbresësh nga një shpat, pra ai e ngrinte këmbën me forcë dhe vendosmëri. Shih: "*Awn el-Ma'bud*".

[1148] Ebu Davudi, 143.

[1149] "*El Edebu el Mufredu", 1315.*

[1150] *Urxhun*-i është një degë e verdhë (e tharë) në të cilën ndodhen fijet ku lidhet tufa e hurmave. *Mihxhen*-i është një shkop që në majë ka një degëzim të lakuar, sikur të bashkoheshin dy degë në një majë. Shih: "*En-Nihaje", 3/203, 1/347.*

[1151] Buhariu, 125. Muslimi, 2794.

4. Thjeshtësia e tij në rrugë

Gjatë ecjes së tij, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* priste njerëzit që i drejtoheshin, ndalej për këdo që e ndalte dhe shkonte për të kryer nevojat e atij që kishte nevojë për të. Rreth kësaj është transmetuar se: "Robëresha nga robëreshat e Medinës e merrte për dore të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ai nuk do ta hiqte dorën nga dora e saj derisa ajo ta shpinte atje ku dëshironte nëpër Medinë, për të kryer punën e saj."[1152]

Në këtë shprehje ka një theksim të madh për përulësinë e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: përmendet "gruaja" në vend të "burrit", dhe "*robëresha*" në vend të gruas së lirë. Madje, përdoret shprehja e përgjithshme "*nga robëreshat*", pra cilado robëreshe që të ishte. Ndërsa fjala "*ku të dëshironte*" tregon çdo vend, madje edhe sikur nevoja e saj të ishte jashtë Medinës.[1153]

Adi bin Hatim el Tai *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon takimin e tij të parë me Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "Ndërsa po ecnim bashkë me Pejgamberin, një grua me një fëmijë e thirri: 'O i Dërguar i Allahut, kemi një nevojë prej teje.' Ata u mënjanuan me të duke biseduar, derisa unë u lodha duke qëndruar në këmbë. Unë mendova brenda meje: 'Dëshmoj se ky është i pastër nga feja ime dhe feja e Nuaman bin el-Mundhirit; sepse po të ishte mbret, nuk do të qëndronte me një grua dhe një fëmijë kaq gjatë. Kështu Allahu vendosi në zemrën time dashurinë për të!'."[1154]

5. Buzëqeshja e tij

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i buzëqeshte secilit që takonte. Xherir bin Abdullah *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Që kur u bëra musliman, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk më privoi kurrë nga takimi me të dhe nuk ndodhi kurrë që të më takonte pa më buzëqeshur."[1155]

[1152] Buhariu, 6072. Ibn Maxhe, 4177.

[1153] Shih: "*Fet'h el Bari", 10/490.* Shprehja *"e merrte për dore"* tregon shoqërimin, me butësia dhe përulje.

[1154] Taberani, "*El Ehadithu el Tivalu".*

[1155] Buhariu, 3035. Muslimi, 2475.

Xheriri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* mendonte se këtë buzëqeshje e bënte vetëm për të në mënyrë të veçantë, por në realitet ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* buzëqeshte kështu me të gjithë njerëzit.

6. Mirësjellja me fëmijët

Kur kalonte pranë fëmijëve, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i përshëndeste dhe i ledhatonte në fytyrë. Kur vizitonte ensarët, sapo arrinte tek shtëpitë e tyre, fëmijët e ensarëve rrethoheshin rreth tij; ai lutej për ta, ledhatonte kokat e tyre dhe i përshëndeste.[1156]

Një herë kaloi pranë shtëpive të fisit Benu Nexhar, ku e pritën vogëlushet e ensarëve. Ato filluan t'i bien dajreve dhe të këndojnë: "*Ne jemi vogëlushet e Benu Nexhar, oh, sa mirë është të kesh Muhamedin komshi!*" Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigj: "*Allahu e di sa shumë ju do zemra ime! O Allah! Bekoi ato!*"[1157]

7. Mirësjellja në përshëndetje

Kur takonte një nga shokët e tij, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përshëndeste i pari me selam, i jepte dorën dhe lutej për të. Kur i jepte dorën e dikujt, nuk e hiqte dorën e tij përpara se ta bënte vetë ai person.

Po ashtu, kur bisedonte me dikë, nuk shikonte anash, por e mbante fytyrën përballë derisa të ishte tjetri që e largonte.[1158]

8. Thjeshtësia dhe afërsia e tij

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ecte natyrshëm dhe lehtë, larg ngurtësisë dhe shtirjes së sforcuar. Ai bashkëbisedonte me butësi e përkëdhelje me ata që takonte gjatë rrugës. Një herë, ndërsa po kalonte në rrugën, pa një të ri duke rrjepur një dele.

[1156] Nesaiu, 10088.
[1157] Ibn Maxhe, 11899.
[1158] Ebu Davudi, 4794.

Kur pa se ai nuk dinte të rrjepë si duhet, iu afrua dhe i tha: "*Më lër të tregoj se si rripet, sepse po shoh që nuk di.*" Atëherë, futi dorën mes lëkurës dhe mishit, dhe e shtyri[1159] deri tek sqetulla, pastaj i tha: "*Ja, kështu bëhet, o djalosh!*" Dhe pastaj i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vazhdoi rrugën.[1160]

Me këtë mënyrë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndërtonte ura lidhjeje midis brezave, duke u përfshirë me ta në punët e tyre dhe duke marrë pjesë në detajet e jetës së tyre.

Sa herë mendoj! Si është ndjerë ky i ri, duke parë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* teksa vjen dhe përfshihet me të në një punë që ishte e tij dhe e ndihmon ta kryejë?

9. Afërsia dhe dashamirësia në rrugë

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bashkëbisedonte dhe tregonte ngrohtësi ndaj atyre që takonte në rrugë. Enesi *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pa disa fëmijë dhe gra që po vinin nga një dasmë, qëndroi për t'i përshëndetur dhe u tha: "*Vallahi, ju jeni njerëzit më të dashur për mua! Vallahi, ju jeni njerëzit më të dashur për mua! Vallahi, ju jeni njerëzit më të dashur për mua!*"[1161]

Sa thellë arrinte të depërtonte ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në jetën e njerëzve përmes këtyre veprimeve të thjeshta, por tërheqëse.

10-Udhëtimi në rrugë si mundësi për mësim dhe thirrje

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përdorte ecjen në rrugë si një mundësi për të mësuar dhe për t'i udhëzuar njerëzit në kohën dhe rrethanën e duhur. Mendoni për këtë skenë: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke ecur në treg mbi

[1159] "*El Nihajetu*", *2/104.*
[1160] Ebu Davudi, 185.
[1161] Buhariu, 3785. Muslimi, 2508.

një gomar me frerë të punuar me gjethe palme dhe një djalosh nga ensarët hipur bashkë me të mbi shpinën e kafshës.

Ky është Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* që zgjodhi të ishte njeri dhe rob i thjeshtë, dhe jo një mbret.

Ebu Talha Zejd bin Sehl *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Po rrinim në oborr dhe po bisedonim, kur erdhi i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai qëndroi përballë dhe tha: "Përse qëndroni ulur në rrugë? Mos qëndroni në rrugë!" Ne i thamë: "Ne nuk u ulëm aty për gjëra të këqija; ne thjeshtë po flisnim dhe po bisedonim për çështje tona." Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "Atëherë, respektoni të drejtat e saj: ulni shikimin, ktheni selamin dhe flisni mirë."[1162]

Ky hadith përcakton rregulla të përgjithshme për rrugën, të cilat sigurojnë bashkëpunimin midis njerëzve dhe ruajnë të drejtat e atyre që lëvizin dhe qëndrojnë në rrugë.

Nga rregullat që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përcaktonte për sjelljen në rrugë dhe për ruajtjen e pastërtisë së mjedisit: ai ndalonte kryerjen e nevojave personale në rrugë, për shkak të dëmit që mund t'u shkaktohet të tjerëve dhe ndotjes së ambientit. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Kujdes prej dy mallkimeve!"* Ata e pyetën: "Çfarë janë ato, o i Dërguar i Allahut?" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigj: *"Kryerja e nevojës në rrugë të njerëzve ose në hijen e tyre."*[1163]

Nga sjelljet që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* inkurajonte dhe i ftonte Sahabët t'i veprojnë ato është: Heqja e një pengese nga rruga. Këtë veprim e konsideroi bamirësi dhe një nga tiparet e besimit. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Islami ka shtatëdhjetë e ca - ose gjashtëdhjetë e ca - degë; më e larta është fjala 'Nuk ka zot tjetër përveç Allahut', dhe më e ulta është të heqësh një pengesë nga rruga."*[1164]

[1162] Muslimi, 2121.
[1163] Muslimi, 269.
[1164] Muslimi, 35.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, gjithashtu, tha: *"Një njeri ndërsa po ecte në rrugë pa një degë me gjemba. Ai e largoi degën nga rruga. Allahu e falënderoi për këtë vepër dhe ia fali mëkatet."*[1165]

Kështu, ecja e tij në rrugë ishte burim gëzimi dhe bekimi; udhëzimi i tij siguronte pastërti, higjienë dhe komunikim të mirë midis atyre që kalonin dhe që atyre qëndronin në rrugë.

I Dërguari dhe tregu

Ishte nga caktimi i Allahut që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të dilte me xhaxhain e tij, Ebu Talibin, kur ishte dymbëdhjetë vjeç, në udhëtimin tregtar drejt Shamit. Mund ta përfytyrosh një djalë dymbëdhjetëvjeçar që ecën bashkë me një karvan burrash tregtarë nga Meka, të cilët do të shkonin në Sham për të blerë e shitur, ndërsa gjithë bisedat e tyre rrotulloheshin rreth tregtisë. Ai i dëgjonte këto biseda dhe kështu ai po përgatitej për një ndërgjegje tregtare që tejkalonte moshën e tij dhe vitet e jetës që kishte kaluar. Prandaj ky udhëtim tregtar ishte si hyrje dhe përgatitje për një udhëtim tjetër dymbëdhjetë vjet më vonë, kur ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkoi përsëri në Sham me mallrat e zonjës Hadixhe.

Tregtari ka të bëjë me lloje të ndryshme njerëzish. Prandaj, tregtia për të *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte një lloj para përgatitjeje për misionin profetik. Kullotja e bagëtive ishte pjesë e jetës së pejgamberëve në fillim të jetës së tyre. Ajo shërbeu si një përgatitje për ta për drejtimin dhe kujdesin ndaj njerëzve. Tregtia, po ashtu, qe një përgatitje shtesë për pejgamberin Muhamed *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të mësuar mënyrën e marrëdhënies me lloje të ndryshme karakteresh.

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u kthye në Mekë me tregtinë e Hadixhes dhe më pas u martua me të, vazhdoi të punonte me pasurinë e saj dhe të tregtonte me të.

[1165] Buhariu, 652. Muslimi, 1914.

Kështu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pati një ndërgjegje tregtare të hershme.

Kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bëri Hixhret në Medinë, projekti i parë që ngriti ishte xhamia e tij; vendi i faljes, i diturisë dhe i mikpritjes, i cili përfshinte shumicën e veprimtarive thirrëse dhe arsimore. Ashtu siç ndërtoi xhaminë, po ashtu, ndërtoi edhe tregun.

Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi në Medinë, ekonomia ishte në duart e hebrenjve. Ndërsa ensarët *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* ishin bujq në arat dhe hurmat e tyre. Hebrenjtë ishin disa fise të ndryshme: fisi Benu Kajnuka banonin afër xhamisë së Pejgamberit dhe vendi i tyre ishte ai që banorët e Medinës sot e quajnë Tregu i Ushqimeve, afër tregut të hurmave.

Benu Kajnuka nuk ishin bujq, por zejtarë argjendarë dhe tregtarë. Ndërsa fisi Benu Nadir ishin njerëz të bujqësisë, të arave, por edhe të tregtisë e të pasurisë. Madje, pasuria e njërit prej tyre, Hujej bin Ahtab, ishte aq e madhe sa që thuhej se e kishte të mbledhur në lëkurën e një lope, plot me ar e argjend. Kjo pasuri ishte rritur te hebrenjtë e Benu Nadirit nga tregtia, kamata dhe bujqësia.

Kur i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* erdhi në Medinë, e pa të domosdoshme të çlirohej ekonomia e muhaxhirëve dhe e ensarëve nga monopoli i hebrenjve.

Muhaxhirët tregtonin në tregun e Benu Kajnukas. Muhaxhiri Abdurrahman bin Auf ishte tregtar, ai tregtoi aty dhe u bë me pasuri, madje me pasurinë që fitoi u martua. Kështu tregtia ndodhte në tregun e Benu Kajnukas.

Prandaj i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndërtoi një treg për banorët e Medinës, për disa dobi dhe interesa, ndër të cilat ishin:

1. Çlirimi i ekonomisë së Medinës nga monopoli i hebrenjve.

2. Përdorimi i energjive të Muhaxhirëve, të cilët në origjinë ishin tregtarë; kjo ishte një mundësi për të shpalosur aftësitë e tyre dhe për ta kthyer Medinën në një qendër tregtare.

Prandaj, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kërkoi nëpër vende të ndryshme të Medinës një vend të përshtat-

shëm për treg. Ai ndaloi në disa vende, por nuk i pa të përshtatshme, derisa iu afrua një burrë dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, kam gjetur për ty një vend për treg."

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Ma trego!"* Ai doli drejt anës perëndimore të xhamisë, në hapësirën mes Xhamisë së Gamames dhe Thenijjetu el Veda, në një vend që kalonte pranë fiseve Benu Zurejkut dhe Benu Saide. Aty ishte një tokë e Benu Saides. Kur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e pa, tha: *"Ky është tregu juaj"*[1166] dhe e shënoi atë vend me këmbën e tij të bekuar.

Pastaj kërkoi nga Benu Saide që ta dhuronin tokën për ndërtimin e tregut.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vendosi disa rregulla për këtë treg:

- Nuk do të jetë monopol.
- Nuk do të vendosen taksa.
- Nuk do të privatizohet asnjë pjesë e tij.
- Do të jetë një treg i hapur për të gjithë - ose sipas shprehjes sonë: një treg i lirë.

Ky vend njihet sot me emrin "Souq Al-Manakhah".

Sikur të mendonim për Medinën e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe ta përfytyronim atë kohë, do ta shihnim si një qytet të vogël, që nuk e përballonte të kishte një treg me aq hapësirë të gjerë. Atëherë, pse e përcaktoi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregun me këtë madhësi?

Duket sikur Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shihte të ardhmen e Medinës një qytet të mbushur me banorë, me popullsi të dendur dhe me tregje të lulëzuara. Ai e bëri këtë treg një treg të lirë, ku nuk kishte vend të veçantë për askënd. Kushdo që sillte mallin e tij dhe zinte një vend, kishte përparësi për atë vend; por kur mbaronte dita dhe e merrte mallin, përfundonte edhe e drejta e tij mbi atë hapësirë. Në këtë mënyrë, tregu u bë tërheqës për njerëzit e fshatrave dhe beduinët përreth Medinës.

[1166] Ibn Maxhe, 2233.

Në këtë treg u zhvilluan talentet tregtare të Muhaxhirëve; ata u shndërruan nga të mbështetur e të përkrahur në tregtarë të pasur, të begatë e bujarë, dhe kështu nuk qenë barrë për Medinën, por u kthyen në një forcë ekonomike aktive.

Ky treg që përcaktoi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në fillim të ardhjes së tij në Medinë, ishte tregu i parë i themeluar nga një Pejgamber. Me këtë, sikur ai të paraqiste për njerëzimin identitetin e Islamit: se Islami është fe dhe marrëdhënie dhe se përfshin të gjitha veprimtaritë e jetës.

Le të ndalemi pak me Pejgamberin në treg:

Së pari: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e vizitonte tregun rregullisht, duke ushtruar një lloj mbikëqyrjeje mbi mallrat dhe shitjet. Një herë ai kaloi pranë një grumbull drithi, futi dorën brenda dhe gishtat e tij ndjenë lagështi. I tha pronarit: *"Ç'është kjo, o pronari i drithit?"* Ai u përgjigj: "E ka lagur shiu, o i Dërguari i Allahut." Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: *"Pse nuk e vendose sipër drithit që ta shohin njerëzit? Kush mashtron, nuk është prej meje."*[1167]

Ky ishte një lloj kontrolli dhe mbikëqyrjeje të veprimtarive tregtare në treg.

Së dyti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e lidhte veprimtarinë ekonomike dhe marrëdhëniet tregtare me vlerat e muslimanëve dhe me mësimet e fesë së tyre.

Një nga Sahabët tregtarë të këtij tregu tregon se na quanin *matrapazë* (samasira), por kaloi pranë nesh i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe na quajti me një emër më të mirë, duke thënë: *"O ju tregtarë, shitja përzihet me betime dhe fjalë boshe, ndaj pastrojeni atë me sadaka."*[1168] Pra, jepni lëmoshë që ajo të bëhet pastrim për shitjen tuaj nga betimet apo fjalët boshe që mund të shpëtojnë nga gjuha juaj.

[1167] Muslimi, 102.
[1168] Ebu Davudi, 3326.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, gjithashtu, këshilloi: *"Tregtarët do të ringjallen në Ditën e Kijametit mëkatarë, përveç atij që i druhet Allahut, vepron me drejtësi dhe është i sinqertë."*[1169] Kështu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e lidhte tregtinë me devotshmërinë, drejtësinë dhe sinqeritetin.

Madje, njëherë, kur erdhi nga periferia e Medinës, e zgjodhi rrugën që kalonte nëpër treg, për t'u kujtuar njerëzve se e gjithë kjo botë është e pa vlerë tek Allahu, prandaj sa e meriton një mall që shet apo një produkt që shpenzon të betohesh rrejshëm për të, apo që të fitosh pasurinë e ndaluar? Sa e fuqishme dhe e përshtatshme është kjo këshillë në zemër të tregut!

Së treti: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kujdesej për lirinë ekonomike dhe funksionimin e tregut, duke u siguruar që ai të mos monopolizohej nga një grup i caktuar. Ai thotë: *"Tregun e monopolizon vetëm mëkatari."*[1170] Kur çmimet u rritën shumë, njerëzit i thanë: "O i Dërguari i Allahut, cakto çmimet për ne." Ai u përgjigj: *"Vetëm Allahu është ai që përcakton çmimet, Ai jep dhe Ai ndal, Ai është Furnizuesi. Unë shpresoj të dal para Zotit tim pa i bërë padrejtësi askujt në gjak apo pasuri."* [1171]

Po ashtu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaloi daljen përpara atyre që vinin nga jashtë Medinës për të shitur mallra, ushqime ose bagëti. Dikush prej tyre vjen dhe nuk e di sa kushton malli i tij në treg. Matrapazët u dalin përpara në rrugë, para se të hyjnë në Medinë. Ju ofrojnë t'i blejnë mallrat prej tyre. Matrapazët e blejnë mallin me çmimin që vendosin vetë e jo me çmimin e tregut. Shpesh blinin me çmim të ulët dhe më pas i shisnin me çmimin e tregut, duke përfituar nga njohja e çmimit të tregut. Prandaj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thekson: *"Lërini njerëzit të lirë, sepse Allahu i furnizon ata nëpërmjet njëri-tjetrit."*

Ky udhëzim profetik përmban shumë mësime të vlefshme, si:

1. Kjo masë siguronte mbrojtjen e atij që vinte në treg, që të mos dëmtohej nga matrapazët ndërmjetës që mund ta blinin mallin e tij me çmim të ulët dhe më pas ta shisnin me çmim të lartë.

[1169] Tirmidhiu, 1253.
[1170] Muslimi, 1605.
[1171] Ebu Davudi, 3451.

Ndërsa, nga ana tjetër, nëse pronari i pasurisë vinte vetë në treg do ta shiste mallin me çmimin që ai dëshiron. Në këtë mënyrë, malli i shtrenjtë bëhej më i lirë, sepse ai nuk do të kërkojë atë që kërkon tregtari që shfrytëzon rastin.

2. Nëse malli blihej jashtë Medinës, shitësi dorëzonte mallin dhe merrte çmimin dhe largohej. Ndërsa, nëse do të vinte vetë në treg dhe do ta shiste mallin aty, gjithashtu, do të blinte nevojat e tij nga tregu, dhe çmimi i mallrave që shiste do të përdorej për të blerë mallra të tjera. Kështu, rrotullimi i tregut dhe aktiviteti ekonomik do të ishin më i gjallë dhe më të balancuar.

Duhet theksuar se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ngriti tregun dhe e zgjeroi veprimtarinë ekonomike, por nuk ka asnjë transmetim të thotë se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ushtroi ndonjë aktivitet ekonomik që nga ardhja e tij në Medinë e deri në ndarjen nga kjo botë. Nuk ka asnjë rrëfim që tregon se ai ka shitur ndonjë mall personal. Çdo pasuri që kishte në dorë, e dha sadaka ose dhuratë. Asnjëherë nuk ka bërë shitje personale në tregun e Medinës dhe, megjithatë, ndezi dhe organizoi aktivitetin tregtar të drejtë.

Kështu, ai në mënyrë të balancuar, rregulloi jetën e njerëzve dhe fenë e tyre.

I Dërguari dhe trajtimi i kafshëve

Allahu e dërgoi Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* si mëshirë për botët. Ai është mëshirë për botën e njerëzve, të xhindëve, të kafshëve, të insekteve, për mjedisin dhe gjithçka që përbën ekuilibrin e jetës. Çdo gjë që solli ai synon të ngrejë jetën dhe të ruajë harmoninë e saj.

Mëshira dhe bamirësia që mëson ai nuk kufizohen vetëm te njeriu, por shtrihen edhe mbi kafshët, shpendët dhe krijesat e tjera të gjalla. Trajtimi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaj kafshëve nuk ndalet vetëm te butësia, por ngjitet në shkallën e mirësisë dhe bamirësisë ndaj tyre, duke e konsideruar këtë si një sadaka me të cilën njeriu afrohet tek Allahu.

Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, na tërhoqi vëmendjen se gjallëria dhe ndjeshmëria që Allahu ka vendosur në to i bëjnë ato të denja për mirësi dhe përkujdesje. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thotë: "*Për çdo mëlçi të njomur, ka shpërblim.*"[1172]

Njeriu e ka fuqinë mbi kafshët vetëm sepse Allahu ia ka nënshtruar dhe ia ka bërë të lehta për përdorim: ***"Ne bëmë që ato t'u nënshtrohen atyre, kështu që disa i shalojnë e prej disave ushqehen, prej disave pinë dhe nxjerrin dobi të tjera. Vallë, si të mos falënderojnë!"*** (Ja Sin: 72-73)

Prandaj prej falënderimit të Allahut për këtë mirësi është mirësjellja me kafshët dhe bamirësia ndaj tyre. Kujdesi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për të drejtat e kafshëve shfaqet qartë në disa aspekte, ndër të cilat:

Së pari: Ndalimi i torturimit të kafshëve

Hadithet e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* paralajmërojnë rreptësisht kundër keqtrajtimit të kafshëve, qoftë duke i lënë pa ushqim, duke i lodhur tej mase, duke u shkaktuar dhimbje, duke i sakatuar apo duke luajtur me jetën e tyre. Një sjellje e tillë është cilësuar ndër mëkatet e mëdha, për të cilat është përmendur mallkimi dhe paralajmërimi me dënimin e zjarrit.

Nga këto hadithe përmenden:

1. Fjalët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: "*Një grua u dënua për një mace, të cilën e mbajti të mbyllur derisa ajo ngordhi nga uria. Ajo përfundoi në zjarr për shkak të saj. Iu tha: nuk e ushqeve e as nuk i dhe të pijë kur e mbylle, e as nuk e le të lirë që të hante nga barishtet e tokës. E pashë atë* (macen) *duke e kafshuar gruan, herë nga këmbët e herë nga fytyra e saj.*"[1173]

2. Nga Xhabiri transmetohet se, njëherë, Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i kaloi para sysh një gomar i

[1172] Buhariu, 2363. Muslimi, 2244.
[1173] Buhariu, 2365. Muslimi, 2242. Nesaiu, "*El Sunen el Kubra", 1482.*

damkosur në fytyrë, dhe tha: *"A nuk ju ka arritur lajmi se unë e kam mallkuar atë që i damkos bagëtitë në fytyrë apo i godet ato në fytyrë?"*[1174]

3. Said bin Xhubejr tregon se Ibn Umeri pa disa djem të kurejshëve që kishin lidhur një zog për ta bërë shënjestër dhe godisnin me shigjeta, duke i premtuar pronarit të zogut çdo shigjetë që humbiste. Kur e panë Ibn Umerin, ata u shpërndanë. Ai tha: *"Kush e bëri këtë? Allahu e mallkoftë atë që e ka bërë! Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e ka mallkuar atë që merr një krijesë të gjallë si shënjestër* (tabelë qitjeje)*."*[1175] Gjithashtu, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaloi edhe vrasjen e kafshëve pa nevojë.

4. Nga Abdullah bin Amri transmetohet se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: *"Kushdo që vret një zog ose diçka më të madhe se ai pa të drejtë, Allahu do t'i kërkojë llogari për të."* E pyetën: "O i Dërguar i Allahut, cila është e drejta e tij?" Ai tha: *"Ta therë për ta ngrënë, e jo t'ia presë kokën e ta hedhë kot."*[1176]

Së dyti: Urdhri për butësi me kafshët gjatë therjes

Shikimi islam për kafshët është i balancuar: ato janë të lejueshme për t'u shfrytëzuar si mjet udhëtimi dhe si ushqim: ***"Ne bëmë që ato t'u nënshtrohen atyre, kështu që disa i shalojnë e prej disave ushqehen."*** (Ja Sin: 72)

Mirëpo, krahas lejimit të përdorimit, vjen edhe urdhri për bamirësi dhe butësi ndaj tyre, qoftë në përdorim, qoftë në therje.

Në këtë drejtim, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* na mësoi:

1. Shadad bin Evsi transmeton se dy gjëra i kam mësuar nga i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: *"Allahu e ka bërë mirësjelljen obligim në çdo gjë. Kur të luftoni, bëjeni në mënyrën më të mirë; kur të therni bagëtinë, therni në mënyrën më të mirë. Le ta mprehë secili prej jush thikën e tij dhe le t'ia lehtësojë kafshës që do ta therë."*[1177]

2. Kurretu bin Ijasi transmeton se një burrë i tha Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: *"O i Dërguar i Allahut, kur*

[1174] Muslimi, 2564.
[1175] Muslimi, 1958. Për fjalën shënjestër shih: *"Sherh el Nevevij ala Muslim", 1/114.*
[1176] Nesaiu, *"El Sunen el Kubra", 4349.*
[1177] Muslimi, 1955.

e ther delen, më kap një ndjenjë mëshire për të." - ose tha: "*Më vjen keq për delen që e ther*." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu përgjigj: "*Nëse e mëshiron delen, Allahu do të mëshirojë ty. Nëse e mëshiron delen, Allahu do të mëshirojë ty.*"[1178] Dije se me mëshirën dhe dhembshurinë tënde ndaj kësaj deleje, ti fiton mëshirën e Allahut. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e përsëriti këtë thënie për të theksuar domethënien dhe për të treguar se njeriu, me këtë sjellje, bëhet i denjë për mëshirën e Allahut.

Së treti: Urdhri për butësi ndaj kafshës gjatë përdorimit

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi që kafsha të përdoret me butësi: të mos ngarkohet me më shumë se ç'mund të mbajë, të mos lodhet tej mase në punë, të mos privohet nga ushqimi i saj, e as të përdoret për gjëra të panevojshme. Këtë e theksoi edhe më tepër kur e lidhi drejtpërdrejt me devotshmërinë dhe besimin, bamirësinë ndaj tyre e bëri shkak për shpërblim, ndërsa torturimin dhe lodhjen e panevojshme shkak për ndëshkim.

Abdullah ibn Xhaferi tregon: "Një ditë i Dërguari i Allahut, sal Allahu alejhi ve selem, më mori pas vetes mbi kafshën e tij. Ai më tha fshehtas disa fjalë, të cilat nuk ia kam treguar askujt. Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i pëlqente që nevojat e tij t'i kryente në vende të mbuluara, pas një muri apo mes palmave. Një ditë hyri në një kopsht të një njeriu nga Ensarët. Aty ishte një deve. Kur pa Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ajo nisi të rënkonte e t'i rridhnin lotët. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu afrua, e ledhatoi afër veshëve[1179] dhe ajo u qetësua. Pastaj tha: "*Kush është i zoti i kësaj deveje? Kujt i përket kjo deve?*" Një djalë nga Ensarët doli dhe tha: "Mua, o i Dërguari i Allahut." Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*A nuk i druhesh Allahut për këtë kafshë që Allahu ta ka dhënë në pronësi? Ajo sapo u ankua se ti e lë pa ushqim dhe e nget me vrap.*"[1180]

[1178] Ahmedi, 15592.
[1179] *Dhifru* i devesë janë rrëzë veshëve. Shih: "*El Nihajetu", 2/161.*
[1180] Ebu Davudi, 2549.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi që edhe gjatë udhëtimit mbi kafshë të tregohet butësi, duke i dhënë pjesën e saj të pushimit dhe të ushqimit. Kur udhëtohet në hapësira me kullosë, kafsha duhet lënë e qetë të ushqehet, pa ngutje e pa shpejtim, në mënyrë që të kullosë e të hajë nga bari dhe të mirat që Allahu ka nxjerrë nga toka.

Ndërsa në hapësirën e thatësirës, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi që të shpejtohet udhëtimi, sepse në tokë të varfër e të thatë kafsha nuk ka ç'të hajë, ndaj duhen ruajtur forcat e saj që të arrijë deri në vendin ku do të ushqehet e do të pushojë.

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Kur të udhëtoni në pranverë, jepuni kafshëve kohën e tyre të mjaftueshme të kullosin në tokë. E kur të udhëtoni në thatësirë, nxitoni udhëtimin, që të ruajnë energjinë, sepse ato nuk kanë gojë të ankohen.*"[1181]

Gjithashtu, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e ndaloi përdorimin e kafshëve në gjëra të panevojshme për njeriun, si, për shembull, t'i përdoren ato për podiume apo ulëse për ligjërata dhe biseda.

Arsyeja e ndalimit për ta përdorur kafshën si karrige apo si minber është se kjo e lodh atë pa asnjë nevojë dhe, nga ana tjetër, është një shenjë mendjemadhësie e fudullëkut, për të qëndruar apo të ulet në tokë.

Megjithatë, kjo nuk bie ndesh me faktin se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka mbajtur hytbe mbi kafshën e tij ditën e Arafatit dhe ditën e Kurbanit, apo mbi mushkën e tij ditën e *Karr*-it.[1182] Ai e bëri këtë për nevojë, për shkak të numrit të madh të njerëzve, në mënyrë që të mund t'i shihte dhe ta dëgjonin zërin e tij.

Edhe në këto raste, hytbet e tij ishin të shkurtra, jo të gjata, në mënyrë që të mos e lodhnin kafshën. Po ashtu, qëndrimi i tij mbi kafshë ditën e Arafatit për të bërë dua ishte një nevojë e veçantë, jo e përsëritur, për të qenë i dukshëm para njerëzve që e ndiqnin dhe që ta shihnin ata që ishin më larg.

[1181] Muslimi, 1926.

[1182] Dita e *Karr*-it (qëndrimit) është dita e 11-të e Dhulhixhes. Quhet kështu sepse hanxhinjtë qëndrojnë në Mina.

Pra, ky përjashtim i tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte për shkak të nevojës, njësoj siç është udhëtimi mbi kafshë.

Së katërti: Ndalimi i mallkimit dhe fyerjes së kafshëve

Ndalimi i mallkimit dhe fyerjes së kafshëve është një mënyrë për të ruajtur të drejtat e tyre dhe për t'i mbrojtur nga kapërcimi në keqtrajtim apo në lodhjen e panevojshme.

Imran bin Husajn tregon: "Ndodhi që i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte në një nga udhëtimet e tij dhe një grua nga ensarët ishte mbi një deve. Ajo u mërzit prej saj dhe e mallkoi. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e dëgjoi këtë dhe tha: "*Merrni atë që është mbi deve dhe lëreni devenë, sepse ajo është e mallkuar.*" Imrani tha: "*Sikur po e shoh tani, teksa ecte mes njerëzve, dhe askush nuk i afrohej.*"[1183]

Nëse mallkimi i një kafshe që nuk kupton dhe nuk ndjen është i ndaluar me këtë forcë të madhe, atëherë sa i ndaluar do jetë torturimi i saj ose ngarkimi me më shumë punë se ç'mund të përballojë.

Së pesti: Urdhri për mirësjellje ndaj kafshëve

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e bëri mëshirën ndaj kafshëve një nga shkaktarët e mëshirës së Allahut ndaj njeriut. Ai tha: "*Nëse e mëshiron delen, Allahu do të mëshirojë ty.*"[1184] Kurse mirësinë ndaj kafshëve shkak për të fituar mirësinë, mëshirën dhe faljen e Allahut për mëkatet. Për këtë e dëshmojnë fjalët dhe veprat e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

1. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbushte një enë me ujë për macen dhe pasi ajo pinte, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* merrte abdes me uji që mbetej."[1185]

2. Enes bin Maliku *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Për*

[1183] Muslimi, 2595.
[1184] Ahmedi, 15592. "*El Edebu el mufredu", 373.*
[1185] "*El Muaxhemu el Evsat", 7949.*

çdo pemë ose kulturë që mbjell muslimani prej së cilës ushqehet njeriu apo kafsha, ai do të marrë shpërblimin e sadakasë për të."[1186]

3. Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmeton se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Ndërkohë që një njeri po ecte në rrugë, e kapi një etje e madhe. Gjatë rrugës gjeti një pus. Ai zbriti në pus, piu ujë dhe, kur doli, pa një qen duke ngrënë dheun nga etja. Njeriu tha: 'Ky qen është po aq i etur sa isha unë.' Ai zbriti në pus, mbushi këpucët me ujë dhe i dha qenit për të pirë. Allahu e falënderoi për këtë dhe ia fali mëkatet."* Sahabët e pyetën: "*O i Dërguar i Allahut, a kemi shpërblim edhe për kafshët?"* Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Për çdo mëlçi të njomur, ka shpërblim."*[1187]

Nëse çuditesh, ke të drejtë të çuditesh: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po vendoste të drejta për kafshët, kurse njerëzit ende nuk njihnin as të drejtat e njeriut, e lëre më ato të kafshëve. Nëpër amfiteatrot e mëdha të Evropës, si në Koloseumin e Romës e të ngjashme me të, organizoheshin festime ku liroheshin bishat e egra mbi robërit, për t'i shqyer e për të bërë spektakël gjakatar për turmat.

Dhe ende sot, në disa vende të Evropës, ruhet kjo trashëgimi e shëmtuar, që quhet "lufta me dema", ku mbushen arenat me turma për t'u argëtuar duke parë si torturohen e theren me shpata këto kafshë të pafajshme, pa armë dhe të pambrojtura.

Ndërkohë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, në atë kohë të largët, shpallte të drejta për kafshët dhe e bënte mirësinë ndaj tyre pjesë të fesë. Muslimanët ndoqën këtë udhëzim profetik: në historinë e tyre u shfaqën vakëfe të posaçme për të ushqyer kafshët dhe zogjtë, për t'u kujdesur për to e për të qenë të butë me to. E gjithë kjo ndodhi shumë kohë përpara se qytetërimet e tjera të njihnin shoqata për mbrojtjen e kafshëve.

[1186] Buhariu, 2320. Muslimi, 1552.
[1187] Buhariu, 2363. Muslimi, 2244.

Kapitulli i Tetë:

Përmbyllja e librit

I Dërguari dhe vdekja

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregoi se vdekja është e frikshme dhe urdhëroi që ajo të përmendet shpesh. Ai tha: "*Kujtojeni shpesh shkatërruesin e kënaqësive: vdekjen.*"[1188]

Kujtimi i vdekjes dhe i udhëtimit drejt saj e vendos këtë botë në përmasën e saj reale dhe e zbeh varësinë e njeriut pas saj. Kush e përkujton vdekjen, përgatitet për të dhe e pret me punë të mira, pasi vdekja është kalim nga shtëpia e përkohshme në shtëpinë e amshimit, nga shtëpia e veprimit në shtëpinë e shpërblimit.

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi të vizitohen varrezat, duke thënë: "*Unë ju pata ndaluar nga vizita e varrezave, por tani më është lejuar të vizitoj varrin nënës sime. Vizitojini ato, sepse ato ju kujtojnë botën tjetër.*"[1189]

Vdekja është stacioni i parë drejt botës tjetër. Vdekja e çdo njeriu është një paralajmërues për të gjallët pas tij, se ky është udhëtimi që do ta përjetojnë edhe ata, dhe ky është fundi që ata presin.

Kur vizitonte varrezat, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thoshte: "*Paqja qoftë mbi ju, o besimtarë, muslimanë, banorë të këtyre vendbanimeve! Edhe ne, në dashtë Allahu, do t'ju bashkëngjitemi!*"

Udhëzime profetike për qëndrimin ndaj vdekjes:

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* na mëson disa udhëzime rreth përballjes me vdekjen, disa prej tyre janë:

1. Ndalimi i kërkimit të vdekjes: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaloi të shprehet dëshirë për vdekje ose të lutet njeriu për të, duke thënë: "*Askush prej jush të mos e kërkojë vdekjen për shkak të ndonjë fatkeqësie që e ka goditur. Por, nëse është i detyruar të lutet për të, atëherë le të thotë:* "*O Allah, më jep jetë përderisa jeta është më e mirë për mua, dhe më merr nëse vdekja është më e mirë për mua!*"[1190]

[1188] Ahmedi, 7925. Tirmidhiu, 2307.
[1189] Tirmidhiu, 1054.
[1190] Buhariu, 5671. Muslimi, 2680.

2. Pritja e vdekjes me falënderim ndaj Allahut: Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi që vdekja të pritet me lavdërim e falënderim ndaj Allahut, duke thënë: "*Me të vërtetë Allahu i Madhëruar thotë*: **"Robi im besimtar është në pozitë të lartë në çdo situatë. Ai më falënderon Mua, edhe kur Unë vendos të marr shpirtin e tij."**[1191]

3. Shpresa tek Allahu në momentet e fundit: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* porositi që njeriu të ketë mendim të mirë për Zotin e tij në çastet e fundit të jetës. Xhabiri tregon se e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) tri ditë para vdekjes së tij duke thënë: *"Askush të mos vdesë pesimist, por le të shpresojë tek Allahu i Madhëruar."*[1192]

4. Fjalët e fundit të besimtarit: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* udhëzoi që njeriu, në çastet e fundit të jetës, të shqiptojë si fjalë të fundit dëshminë: *"La ilahe il-lAllah - Nuk ka zot tjetër përveç Allahut."* Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: *"Cili do që fjalën e fundit të jetës e ka 'La ilahe il-lAllah', do të hyjë në Xhenet."*

Po ashtu, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi që ata që gjenden pranë njeriut në prag të vdekjes le ta thonë, dhe t'ia kujtojnë këtë fjalë, nëse i sëmuri nuk e thotë vetë: *"Kujtojani atyre që po vdesin fjalën La ilahe il-lAllah."*[1193]

5. Mëshira e Pejgamberit në çastet e vdekjes: Kur ndodhej pranë të vdekurve, i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* prekej thellë, zemra e tij butësohej dhe lotët i rridhnin në fytyrën e ndritur. Tregohet se kur iu soll nipi i tij i vogël, i cili po jepte shpirt dhe kraharori i tij rënkonte si *shen*[1194], Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu mbushën sytë me lot. Seadi e pyeti: "*O i Dërguari i Allahut, ç'është kjo?*" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigj: "*Kjo është mëshirë që Allahu e ka vendosur në zemrat njerëzve. Allahu i mëshiron ata njerëz që kanë mëshirë."*[1195]

[1191] Ahmedi, 8492.
[1192] Muslimi, 2877.
[1193] Muslimi, 917.
[1194] *Shen* quhet një shakull i vjetër i tharë që kur e lëviz kërcet, e shëmbëlleu zërin e kraharorit të fëmijës në prag të vdekjes me kërcitjen e shakullit kur e lëviz. Shih: *"El Nihajetu", 2/506.*
[1195] Buhariu, 1284. Muslimi, 923.

Po ashtu, kur hyri pranë të birit të tij, Ibrahimit, i cili ishte në prag të vdekjes, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qau dhe tha: "*Sytë lotojnë, zemra pikëllohet, por ne nuk themi gjë tjetër veç asaj që kënaq Zotin.*"[1196]

Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* merrte pjesë edhe në pikëllimet e shokëve të tij, duke u lutur për të vdekurin, duke ngushëlluar e mbështetur të gjallët. Kur erdhi pranë Ebu Selemes, të cilit i kishin mbetur sytë hapur pas daljes së shpirtit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia mbylli sytë dhe pastaj u lut: "*O Allah, fale Ebu Selemen! Ngrije në gradën e të udhëzuarve! Kujdesu për pasardhësit që ka lënë! Na fal ne dhe atë, o Zot i botëve! Zgjeroja dhe ndriçoja varrin e tij.*"[1197]

6. Fjalët e mira dhe lutja në raste vdekjeje: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* porositi që kur ndodh fatkeqësia e vdekjes, familjarët dhe të pranishmit të mos thonë gjë tjetër veç fjalëve të mira dhe të mos luten veçse me lutje të mira. Umu Seleme *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*Kur vizitoni të sëmurin ose kur gjendeni pranë të vdekurit, thoni vetëm fjalë të mira, sepse melekët e shoqërojnë lutjen tuaj me fjalën Amin.*"[1198]

Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, udhëzoi, gjithashtu, që kushdo që përjeton humbjen e një të dashuri ose të afërmi, të thotë: "*O Allah, më shpërble në këtë fatkeqësi dhe më jep në vend të saj diçka më të mirë!*" Umu Seleme tregon se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ka thënë: "*Atij që i ndodh një fatkeqësi le të thotë: Të Allahut jemi dhe te Ai do të kthehemi! O Allah prej Teje e pres shpërblimin për këtë fatkeqësi! O Allah, më shpërble për të, dhe më jep në vend të saj diçka më të mirë!*" Umu Seleme tregon se kur vdiq burri im, Ebu Seleme, unë e thashë këtë lutje, por sa herë që doja të thosha pjesën: "*Më jep në vend të saj diçka më të mirë!*", thosha me vete: '*E kush mund të jetë më i mirë se Ebu Seleme?' Megjithatë, e thashë lutjen deri në fund.*"

[1196] Buhariu, 1303. Muslimi, 2315.
[1197] Buhariu, 920.
[1198] Muslimi, 919.

7. Ngushëllimi i familjes së të vdekurit dhe kujdesi për ta: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëronte që familja e të ndjerit të ngushëllohej dhe të ndihmohej me ushqim, sepse ata në ato çaste janë të zënë me dhimbjen e tyre. Kur iu soll lajmi për vdekjen e Xhafer ibn Ebi Talibit, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Përgatitni ushqim për familjen e Xhaferit, sepse ata sot i ka rënduar pikëllimi.*"[1199]

8. Qarja për të vdekurin dhe kufijtë e saj: I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* lejoi të qarat për të vdekurin, por ndaloi vajtimin, ngritjen e zërit dhe shqyerjen e rrobave, duke thënë: "*Nuk është prej nesh ai që godet fytyrën, shqyen rrobat dhe thërret me thirrjet e injorancës së hershme.*"[1200]

Kjo, sepse një sjellje e tillë shpreh pakënaqësi dhe mospranim të caktimit të Allahut.

Megjithatë, Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, bëri të ditur se hidhërimi dhe pikëllimi janë ndjenja njerëzore të natyrshme, për të cilat njeriu nuk mban përgjegjësi. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Allahu nuk e dënon njeriun për lotët e syrit, as për hidhërimin e zemrës, por e dënon ose e mëshiron për këtë* (dhe bëri shenjë nga gjuha e tij)*.*"[1201]

Po ashtu, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndaloi zgjatjen e tepruar të pikëllimit dhe shfaqjen e gjatë të shenjave të zisë. Ai tha: "*Nuk është e lejuar për një grua që beson në Allahun dhe Ditën e Fundit të mbajë zi për të vdekurin më shumë se tri ditë, përveçse për burrin e saj, për të cilin ajo mban zi katër muaj e dhjetë ditë.*"[1202]

9. Respekti ndaj xhenazes: I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tregonte respekt për xhenazen, qoftë e muslimanit apo e jomuslimanit. Tregohet se kur po kalonte një xhenaze, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u ngrit në këmbë. Dikush i tha: "*Është xhenaze e një hebreu*." Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u përgjigj: "*A nuk është një njeri?*"

[1199] Ebu Davudi, 3132. Tirmidhiu, 1019. Ibn Maxhe, 1610.
[1200] Buhariu, 1294. Muslimi, 103.
[1201] Buhariu, 1304. Muslimi, 924.
[1202] Buhariu, 1280. Muslimi, 1486.

dhe qëndroi në këmbë derisa u largua nga sytë. Bashkë me të qëndruan edhe sahabët.[1203]

Po ashtu, Xhabir ibn Abdullahu tregon se një xhenaze kaloi pranë nesh dhe i Dërguari, sal Allahu alejhi ve selem, u ngrit në këmbë, e ne u ngritëm bashkë me të. Pastaj i thamë: "O i Dërguari i Allahut, ishte xhenazja e një hebreu." Ai tha: "*Vdekja është tronditje e madhe. Kur të shihni një xhenaze, ngrihuni në këmbë.*"[1204]

10. Namazi i xhenazes dhe lutja për të vdekurit: I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* falte namazin e xhenazes për sahabët dhe lutej sinqerisht për ta. Auf ibn Malik tregon: "I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* fali një xhenaze dhe unë mbajta mend nga lutja e tij këto fjalë: "*O Allah, fale atë, mëshiroje atë, falja gabimet, nderoje ardhjen e tij, zgjeroja vendbanimin, pastroje me ujë, borë dhe breshër, dhe pastroje nga mëkatet sikurse pastrohet rroba e bardhë nga ndotja. Jepi një shtëpi më të mirë se e tija...*" - Derisa dëshirova që të isha unë ai i vdekuri."[1205]

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte gjithmonë i kujdesshëm që të falte namazin e xhenazes për Sahabët. Ai thoshte: "*Kur të vdesë dikush mes jush mos më lini pa më lajmëruar, sa të jem në mesin tuaj, sepse falja ime është mëshirë për të.*"[1206]

Edhe nëse dikush varrosej pa dijeninë e tij, kur e merrte vesh, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shkonte tek varri i tij, i falte namazin dhe lutej për të. Ebu Hurejre tregon: "Një grua e zezë, që pastronte xhaminë, vdiq dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i fali namazin e xhenazes dhe tha**:** "*Këto varre janë të mbushura me errësirë për banorët e tyre, por Allahu i Madhëruar i ndriçon ato me namazin tim dhe lutjen time për ta.*"[1207]

11. Përcjellja e xhenazes në varreza dhe lutja te varri: Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e shoqëronte të vdekurin dhe priste derisa të varrosej. El-Bera transmeton: "Dolëm bashkë me të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*

[1203] Muslimi, 961.
[1204] Buhariu, 1311. Muslimi, 960.
[1205] Muslimi, 963.
[1206] Nesaiu, "*El Sunen el Kubra*", 2022.
[1207] Muslimi, 956.

në një xhenaze të një burri prej ensarëve. Arritëm te varri ndërkohë që ende nuk ishte hapur gropa anësore (lahdi). Atëherë, i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u ul dhe u ulëm edhe ne rreth tij. Pastaj ai tha: "*Kërkoni mbrojtje Allahut prej dënimit të varrit!" dhe e përsëriti dy ose tri herë."*[1208]

Dhe kur përfundonte varrimi i të vdekurit, ndalej pranë tij dhe thoshte: "*Kërkoni falje për vëllain tuaj dhe lutuni të jetë i qëndrueshëm, sepse tani, ai po merret në pyetje."*[1209]

12. Vizita e varrezave dhe lutja për të vdekurit. I Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i vizitonte varrezat e sahabëve dhe lutej për ta. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se sa herë që vinte radha ime që Pejgamberi (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) të qëndronte te unë, ai dilte në pjesën e fundit të natës te varrezat në el Bekia dhe thoshte: "*Es-Selamu Alejkum vendbanim i njerëzve besimtarë! Ju ka ardhur ajo që ju është premtuar dhe nesër do ta merrni shpërblimin tuaj. Me lejen e Allahut, ne do t'ju bashkëngjitemi. O Allah, fali banorët e Bekia el Garkadit!"*[1210]

I Dërguari drejt Zotit të Lartë

Takimi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* me vdekjen nuk erdhi papritur. Këtij takimi i parapriu një përgatitje hyjnore, për ta ngritur shpirtin e Pejgamberit për t'u ngjitur drejt Zotit të Lartë. Ajetet kuranore zbritën për të përgatitur Umetin për këtë ngjarjeje të madhe dhe të rëndë.

Pas betejës së Uhudit, Allahu i Madhërishëm shpalli fjalën e Tij: "***Muhamedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahut. Dhe Allahu do t'i shpërblejë falënderuesit.***" (Ali Imran: 144)

[1208] Ebu Davudi, 4753.
[1209] Ebu Davudi, 3221.
[1210] Muslimi, 974.

Këto fjalë i shtruan sahabët përballë një të vërtete të madhe: se vdekja e të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ishte e pamendueshme, por një çast që do të vinte gjatë jetës së tyre dhe për të cilin duhej të ishin të gatshëm.

Pastaj Allahu i Madhërishëm zbriti fjalën e Tij: "***Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi*** (i Mekës) ***dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.***" (En-Nasr: 1-3) Ibn Abasi thotë: "Ky ishte lajmi për fundin e jetës së të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, të cilin ia bëri të ditur Pejgamberit të Tij: "***Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi"*** (En-Nasr: 1) *e kjo ishte çlirimi i Mekës, prandaj*: "***Atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.***" (En-Nasr: 3)

Kështu, shpallja që për shumicën e muslimanëve ishte lajm i gëzimit për fitoren dhe përhapjen e Islamit, për Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte një lajm i qartë: koha e tij në këtë botë po afrohej drejt fundit dhe duhej të përgatitej për takimin me Zotin e Lartë.

Në muajin Ramazan të vitit të dhjetë të Hixhretit, Xhibrili erdhi te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për t'i përsëritur Kuranin dhe e përsëritën dy herë. Deri atëherë, kjo përsëritje bëhej vetëm një herë në vit. Ky ndryshim ishte një shenjë e qartë për Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* se exheli i tij në këtë botë po afrohej.

Dy herët e përsëritjes nuk ishin thjesht një këndim, por një tregues se shpallja kishte përfunduar, se misioni i kumtimit hyjnor ishte kryer dhe se detyra e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte përmbushur. Tani ai duhej të përgatitej për udhëtimin e madh - për t'u bashkuar me Zotin e Lartë dhe për të hyrë në vendbanimin më të lartë.

Kur erdhi Haxhi i Lamtumirës, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kuptoi se ishte takimi i fundit me Umetin e tij në atë vend të shenjtë. Ai i mblodhi njerëzit dhe u foli me fjalë prekëse dhe domethënëse: "*Mësoni prej meje ritet e Haxhit, sepse*

ndoshta nuk do t'ju takoj më pas këtij viti."[1211] Pastaj ai shtoi: "*Unë jam vetëm një njeri. Së shpejti do të vijë i Ngarkuari i Zotit tim dhe unë do t'i përgjigjem."*[1212]

Kur u sëmurë për herë të fundit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i pëshpëriti së bijës, Fatimes, se exheli i tij është afruar dhe se ai do të ndahej nga kjo botë në atë sëmundje.[1213]

Ankesat e para të kësaj sëmundjeje, në të cilën Allahu i mori shpirtin e tij, filluan në netët e fundit të muajit Safer. Ato zgjatën trembëdhjetë ditë.

Gjatë ditëve të para të saj, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vazhdoi t'u printe njerëzve në namaz. Kur u sëmurë rëndë dhe nuk mundi më të dilte në xhami, ai urdhëroi që Ebu Bekri *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* t'u printe njerëzve në namaz.

Shenja e parë e sëmundjes së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte një dhimbje e fortë koke që e goditi në krye. Pastaj u rëndua në shtëpinë e Mejmunes. Atëherë, ai kërkoi leje nga gratë e tij që të qëndronte në shtëpinë e Aishes, sepse nuk kishte më fuqi të lëvizte nga njëra te tjetra, dhe zemra e tij dëshironte që sëmundjen ta kalonte pranë saj.

Gratë i dhanë leje. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli me kokën e lidhur, i mbështetur në supet e El Fadl bin Abasit dhe Ali bin Ebi Talibit. Këmbët e tij mezi e mbanin dhe zvarriteshin në tokë derisa arriti në shtëpinë e Aishes.[1214]

Dhembja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u rëndua gjithnjë e më shumë.[1215] Namazi i fundit që ai fali me njerëzit ishte namazi i akshamit.

[1211] Nesaiu, "*El Sunen el Kubra", 3062.*

[1212] Muslimi, 2480.

[1213] Buhariu, 3623. Muslimi, 2450.

[1214] Muslimi, 418.

[1215] Ajo që duket – dhe Allahu e di më mirë – është se sëmundja e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kishte filluar edhe më herët, por jo me intensitet të madh dhe jo vazhdimisht. Më pas, ajo mori formën e etheve të malaries. Ndoshta kjo e kishte goditur kur qëndroi në vendin e Gadir Hum, gjatë kthimit nga Haxhi i Lamtumirës, pasi ai ishte një vend i njohur për sëmundje ngjitëse. Ndikimi i malaries u shtua edhe më shumë nga gjurmët e helmit të arsenikut që ndodhej në delen e helmuar nga e cila kishte ngrënë në Hajber. Megjithatë, këto janë thjeshtë disa hamendësime që përftohen nga

Më pas, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndjeu një lehtësim të përkohshëm në trupin e tij dhe doli, i mbështetur mes dy burrave, njëri prej të cilëve ishte El Abasi, ndërsa Ebu Bekri po u printe njerëzve në namaz. Kur Ebu Bekri e pa atë, deshi të tërhiqej për t'i lënë vendin, por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i bëri shenjë që të vazhdonte namazin.

Pastaj tha: "*Më ulni në krah të tij.*" Dhe ata e ulën Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në krah të Ebu Bekrit.

Ebu Bekri vazhdoi të printe në namaz, por duke ndjekur vetë namazin e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ndërsa njerëzit ndiqnin namazin e Ebu Bekrit. Ndërkohë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ulur.[1216]

Më pas, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* doli para njerëzve, i mbështetur tek El Fadli bin Abasi, me kokën e lidhur me një shall të zi dhe me një mbulesë të mbështetur mbi supet e tij. Ai u ngjit në minber, në të cilin më pas nuk u ngjit më kurrë. U ul, në minber, ndërsa njerëzit u mblodhën rreth tij. Filloi duke lavdëruar Allahun dhe duke e falënderuar Atë, pastaj kërkoi falje për ata që ranë dëshmorë në betejën e Uhudit.

Pastaj tha: "*Një rob u vu në zgjedhje nga Zoti i tij, midis jetës së kësaj bote - sa të donte prej saj - dhe asaj që është tek Ai, dhe ai zgjodhi atë që është tek Ai.*" Ebu Bekri shpërtheu në lot dhe filloi të thotë: "*Qoftë jeta jonë për ty, o i Dërguari i Allahut!*"

Ndërsa sahabët e tjerë nuk e kuptuan atë çka kuptoi Ebu Bekri dhe u habitën nga të qarët e tij, duke thënë: "*Çfarë ka ky plak që qan, ndërkohë që Allahu i ka dhënë një robi zgjedhje mes jetës së kësaj bote dhe asaj që është te Ai?!*"[1217]

Abu Saidi tregon: "Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte ai që ishte vënë për të zgjedhur, por Ebu Bekri ishte ai që e kuptoi më mirë atë. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Njeriu më fisnik me mua me shoqërinë e tij*

---

shenjat, pa pasur i dhënë deklaratë të prerë për to. (Shih: Mensur el Xhabiri, "*Tabijbin abre el zemen*").

[1216] Buhariu, 687. Muslimi, 418.

[1217] Buhariu, 467. Muslimi, 2382. *Huha*: Një derë e vogël, si një dritare e madhe, që ndodhet midis dy dhomave. Shih: "*El Nihajetu", 2/86.*

dhe pasurinë e tij, është Ebu Bekri. Po të kisha marrë dikë si mik të ngushtë, do ta kisha marrë Ebu Bekrin si mik të ngushtë, por mjafton miqësia islame. Asnjë derë të mos mbetet e hapur përveç derës së Ebu Bekrit."[1218]

Ai u la një amanet për ensarët, duke u thënë: *"Ju porosis për ensarët, sepse ata janë besnikët-mbështetësit e mi.*[1219] *Ata e përmbushën atë që morën përsipër, por ka mbetur ajo që i takon atyre; pranoni të mirat e tyre dhe falni gabimet e tyre."*[1220]

Më pas, ai zbriti nga minberi dhe kjo ishte hera e fundit që ata e panë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mbi të.

Hera e fundit që shokët e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e panë atë ishte ditën e hënë, kur fytyra e tij fisnike dhe e bekuar u ndriçua për ta. Ata u habitën kur shikuan se perdja e dhomës së tij po hapej dhe ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* qëndronte në derë duke i parë dhe duke buzëqeshur. Ai i pa të gjithë duke qëndruar, ashtu si i kishte mësuar, të mbushur me devotshmëri dhe respekt. Gëzimi shpërtheu në fytyrën e tij fisnike. Shokët e tij nuk panë ndonjë pamje më të mrekullueshme se sa fytyra e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke u shfaqur dhe duke buzëqeshur para tyre. Ata menduan se ai kishte dalë për të falur namazin me ta, por ai vetëm iu bëri shenjë që ta përfundonin faljen e tyre dhe pastaj uli përsëri perden e dhomës. Kjo ishte hera e fundit që ata e panë atë dhe hera e fundit që ai i pa ata.[1221]

Kur dita filloi të ngrihet lart, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* po i jepte lamtumirën kësaj bote dhe po derdhte frymën e fundit të jetës së tij, duke zgjedhur t'i bashkohej Zotit të Lartë dhe vendbanimit më të lartë. Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tha se para tij kishte një tas ose *rekva*[1222] enë me ujë dhe ai e fuste dorën në ujë dhe fshihte fytyrën e tij me të, duke thënë: *"Nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Vërtet vdekja ka dhimbje. O Allah, mi lehtëso dhimbjet e vdekjes!"*[1223]

[1218] Buhariu, 466. Muslimi, 2382.
[1219] Shih: *"En-Nihaja"*, 4/163.
[1220] Buhariu, 3799. Muslimi, 2510.
[1221] Buhariu, 680. Muslimi, 419.
[1222] *Rekva*: Enë e vogël prej lëkure përdoret për të pirë ujë me të, i ngjan një kove të vogël. Shih: *"Taxhu el Arus", 38/178.*
[1223] Ibn Maxhe, 1623.

Me gjithë dhimbjet dhe vështirësitë e momentit të vdekjes, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk u largua nga kujdesi për Umetin dhe misionin e tij. Ai shfrytëzoi frymën e fundit dhe çastet e fundit të jetës për të lënë amanete dhe këshilla për Umetin. Në sëmundjen e vdekjes, e pushtonte rëndesa dhe filloi të vendoste një pëlhurë të hollë mbi fytyrën e tij; kur e rëndonte, e hiqte nga fytyra dhe thoshte: "*Mallkimi i Allahut qoftë mbi çifutët dhe të krishterët, të cilët i kthyen varret e pejgamberëve të tyre në vende adhurimi.*" Aishja tha se me këtë ai paralajmëronte Umetin nga ajo që kishin bërë ata.[1224]

Dhe ndërsa ishte në dhimbjet e vdekjes, ai thoshte: "*Namazi, namazi! Dhe ato që keni në të djathtën* (besën) *tuaj!*" Ai mezi i shqiptonte këto fjalë me zë, por zemra e tij fliste me dashuri të thellë. [1225]

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, kur ishte i shëndetshëm, thoshte: "*Asnjë Pejgamberi nuk i është marrë shpirti para se ta shikojë vendin e tij në Xhenet, pastaj t'i jepet mundësia të zgjedhë.*" Kur u sëmur dhe vdekja iu afrua, kokën e kishte në prehrin tim. Atij i ra të fikët pastaj kur u përmend e drejtoi shikimin drejt çatisë, pastaj tha: "*O Allah! Unë zgjedh të bashkohem me Zotin e Lartë.*" Unë thashë në vetvete: "*Atëherë nuk do të jetojë pranë nesh*!" dhe kuptova se ishte po i njëjti bisedim që më parë na e tregonte, ndërsa ishte i shëndetshëm.[1226] Më pas, ai ngriti dorën dhe vazhdoi të thoshte: "*Me Zotin e Lartë…*" dhe dora e tij filloi të bjerë ngadalë.[1227]

Fjala e fundit që ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha ishte: "*O Allah, më fal mua dhe më bashko me Zotin e Lartë!*"

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* thotë se kur mora të shikoj, ai kishte dhënë shpirt.[1228] Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vdiq ndërkohë që ishte në praninë e saj, i mbështetur mbi kraharorin e saj.

Ajo *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tha: "*I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dha shpirt dhe kryet e tij ishte mbi*

[1224] Buhariu, 1390, 3453. Muslimi, 529.
[1225] Buhariu, 3453. Muslimi, 529. Ebu Davudi, 5156.
[1226] Buhariu, 4437. Muslimi, 2444.
[1227] Buhariu, 4449.
[1228] Muslimi, 2191.

kraharorin[1229] *tim nën qafën time. Kur u largua shpirti i tij, nuk kam ndjerë kurrë ndonjë erë më të mirë se ajo që la pas."*[1230]

Shpirti më i pastër në këtë botë u largua nga trup i tij dhe u ngjit tek Krijuesi i tij, i kënaqur dhe i pranuar. Njeriu më i nderuar për Allahun në këtë ekzistencë doli nga kjo botë ashtu si kishte ardhur në të, pa lënë pas pasuri, mall dhe as fëmijë tjetër përveç Fatimes *(paqja e Allahut qoftë mbi të)*. Ai la vetëm udhëzim dhe besim, një ligj të përjetshëm për të gjithë njerëzit dhe një trashëgimi të madhe dritëplotë.[1231]

Shkoi i Dërguari, por mbeti mesazhi. U shua thirrësi, por mbeti thirrja. Ndërroi jetë Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, por mbeti Umeti.

Ai u nda nga kjo botë pasi Allahu, nëpërmjet tij, e përsosi fenë, e plotësoi dhuntinë dhe e zgjodhi Islamin si fe për njerëzit: "***Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj.***" (El-Maide: 3)

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndërroi jetë pasi përcolli mesazhin, përmbushi amanetin dhe e la Umetin e tij në një rrugë të ndriçuar e të qartë.

Bota e gjerë e të Dërguarit[1232]

Bota e njeriut, në të cilën ai jeton, zgjerohet ose ngushtohet sipas gjerësisë ose ngushtësisë së dijes së tij. Allahu i Madhërishëm ia lehtëson atij shkaqet e dijes dhe sa më shumë që i mundësohen ato, aq më e madhe bëhet dija e tij. Dija më madhështore dhe më fisnike është shpallja e Allahut të Lartësuar, të cilën pejgamberët e mësojnë drejtpërdrejt ose nëpërmjet melekëve të Tij, ndërsa njerëzit e tjerë e mësojnë përmes thirrjes së pejgamberëve.

[1229] Shih: "*Umdetu el Kari", 18/70.*

[1230] Ahmedi, 24905. Buhariu, 1389. Muslimi, 2443.

[1231] Përmbledhje nga libri me titull "*El Siretu el Nebevijetu el sahihatu fi dav'i el Kur'ani ve el Suunneti", 2/594,* Muhamed Ebi Shejbe, Allahu e mëshiroftë.

[1232] Origjina e artikullit është një bisedë këshilluese me shejhun tim, Xhafer Shejh Idris, dhe ajo që kam shkruar është një formulim i idesë së tij. Kjo është një përmbledhje e shkurtuar nga hyrja e tij në artikullin: "*Alemu el Nubuvveti el Rahijb*".

Dhe meqë të dërguarit e Allahut janë krijesat më të dashura të Allahut, është e natyrshme që Ai t'u japë atyre dije për Vetveten dhe për krijesat e Tij atë që nuk ia ka dhënë askujt tjetër, si dhe t'u japë shkaqe e mjete të dijes që nuk ia ka dhënë ndonjë krijese tjetër.

Muhamedi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është më i dashuri i të dërguarve të Allahut tek Allahu, prandaj ai ishte më i dituri prej tyre për Të dhe për krijesat e Tij. Si rrjedhojë, bota e tij në të cilën jetonte ishte bota më e gjerë dhe horizontet e tij kozmike ishin më të mëdha se perceptimet e njerëzve. Vizioni i tij për botën e kalonte këtë botë të dukshme dhe vështrimi i tij ndaj së kaluarës dhe së ardhmes ishte një shikim ku kapërceheshin pengesat e kohës dhe mbulesat e së fshehtës.

Allahu e ngre në shkallë të lartë një njeri të thjeshtë nga të dashurit e Tij: **"Kur ta dua robin Tim, Unë bëhem dëgjimi i tij me të cilin dëgjon, shikimi i tij me të cilin sheh, dora e tij me të cilën vepron dhe këmba e tij me të cilën ecën. Nëse më lutet, Unë i përgjigjem; nëse kërkon mbrojtje tek Unë, Unë e mbroj. Unë nuk hezitoj për ndonjë gjë që bëj, aq sa hezitoj t'i marr shpirtin një besimtari: ai e urren vdekjen, ndërsa Unë e urrej që ta mërzis atë."**[1233] Nëse Allahu e bën këtë për njerëzit e thjeshtë në momentin kur ata fitojnë kënaqësinë dhe dashurinë e Tij, çfarë mund të themi për të dërguarit e Tij, të cilët janë më të mirët dhe më fisnikët e krijesave? E çfarë mund të themi, vallë, për prijësin dhe zotërinë e pejgamberëve, njeriun më të mirë dhe më të dashur tek Allahu, më të afërmin nga të gjitha krijesat ndaj Tij, qofshin engjëjt apo të dërguari? Atij që i janë dhënë gradat dhe pozitat e larta, si: *Vesile, Fadile, derexhe el Alije el Refia, Mekamu Mahmud?!*

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* jetonte në një botë më të gjerë se çdo botë njerëzore dhe Allahu ia kishte lehtësuar atij nga mjetet dhe burimet e dijes atë që nuk ia kishte lehtësuar askujt tjetër.

[1233] Buhariu, 6502.

Burimet kryesore nga të cilat ai mori diturinë e tij ishin:

Së pari: Natyra e tij e pastër dhe zemra e tij e mirë dhe e arsyeshme.

Së dyti: Kurani që Allahu ia shpalli dhe Syneti që Ai ia dha.

Së treti: Shqisat e tij të dalluara, vëzhgimi i tij i hollë dhe dhuntitë me të cilat e pajisi Allahu, e që bënë që këto dije të japin frytet e tyre deri në shkallën më të lartë. Falë këtyre dhuntive, të Dërguarit të Allahut iu bashkuan lloje të ndryshme të dijes, gjë që nuk i është dhënë asnjë njeriu para tij e as pas tij.

Së katërti: Ato që Allahu i zbuloi prej perdeve të padukshme dhe e bëri të shohë prej të fshehtave. Atij iu shfaqën horizonte nga kozmosi, nga bota e padukshme dhe nga ngjarjet e së ardhmes, që nuk i janë zbuluar ndonjë njeriu tjetër - si ato që pa natën e *Israsë* dhe *Mi'raxhit*, dhe shpalljet që mori mbi të ardhmen e kësaj bote dhe gjendjet e botës tjetër - gjëra të cilat askush tjetër nuk i ka parë dhe as dijet e askujt tjetër nuk i kanë përfshirë.

Nga gjerësia e dijes së tij dhe botës së tij mund të përmendim:

1. Dija për Allahun

Dija më fisnike dhe më madhështore e tij ishte dija për Allahun e Madhëruar. I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte më i dituri nga të gjitha krijesat për Allahun. Midis dijes për Të dhe përkushtimit ndaj Tij ekziston një lidhje e fortë. Meqenëse i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte njeriu më i përkushtuar ndaj Allahut, Ai e deshi atë dhe e bëri këtë dashuri thelbin e lidhjes mes Tij dhe të Dërguarit të Tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Kjo dashuri arriti majën, duke e bërë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* mik të ngushtë të Allahut (*halilullah*), që është shkalla më e lartë e dashurisë.

Për hir të kësaj miqësie të ngushtë të Allahut të Madhëruar për Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, Allahu përcaktoi disa dispozita:

- E bëri ndjekjen e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* provë të dashurisë së njeriut për Allahun. Për këtë, Allahu i Madhërishëm thotë: "***Thuaju*** (o Muhamed)***: "Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë."*** (Ali Imran: 31)
- E bëri bindjen ndaj Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* bindje ndaj Allahut. Për këtë, Allahu i Madhërishëm thotë: "***Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjanë, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre."*** (En-Nisa: 80)
- E bëri kusht për besimin që dashuria ndaj tij të vihej përpara dashurisë për çdo gjë tjetër. Për këtë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thotë: "*Asnjëri prej jush nuk beson derisa unë të jem më i dashur për të se babai i tij, fëmija i tij dhe gjithë njerëzit e tjerë.*"[1234]

Gjithashtu, Allahu i Madhërishëm i dha gradat dhe pozitat e larta. I dha *vesilen* - që është grada më e lartë në Xhenet - i dha *makam mahmud* vendin e lavdëruar. Kështu, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u bë zotëria i bijve të Ademit. Dhe nëse bijtë e Ademit janë krijesat më fisnike, atëherë Muhamedi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është pa dyshim më fisniku i tyre.

Kurse frytet e kësaj dashurie, në jetën e tij tokësore, është fakti se e gjithë jeta e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u bë pasqyrë e saj: ai e donte çdo gjë që donte Allahu dhe e urrente çdo gjë që urrente Allahu.

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte vazhdimisht i lidhur me Allahun - një lidhje që nuk e ndërpriste as gjumi. Gëzimi i syve të tij ishte në namaz, pasi namazi e forcon lidhjen e robit me Zotin e tij, sidomos në sexhde.

[1234] Buhariu, 15.

Madje, edhe pse Allahu ia kishte falur atij mëkatet e kaluara dhe të ardhshme, ai qëndronte në namaz derisa i ënjteshin këmbët. Dhe kur pyetej për këtë, ai thoshte: *"A të mos jem një njeri mirënjohës?"*

2. Zbulimi i dijeve që nuk iu zbuluan askujt tjetër

Nga gjerësia e dijes dhe e botës së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte edhe njohja e atyre dijeve që nuk iu treguan askujt tjetër përveç tij.

Ndër këto janë:

a) Ai u ngjit në *meleu'leala* (botën më të lartë engjëllore) dhe ngritja e tij në një shkallë ku nuk ka mbërritur askush tjetër përveç tij. Ai u ngjit deri te *Sidretu'l-Muntehà* dhe e pa Xhenetin me sytë e tij. Pa pallatet, lumenjtë dhe dheun e tij. Në hadithin e Israsë thuhet: *"Pastaj më futën në Xhenet dhe aty pashë litarë margaritarësh dhe dheu i tij ishte misk."*[1235]

Ai pa lumin e *Kevtherit* që ia dhuroi Allahu. Ai pa pallatin e tij në Xhenet, të ngjashëm me retë në qiell.

b) Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* iu paraqit Xheneti gjatë namazit të eklipsit të diellit, saqë ai zgjati dorën për tek ai. Po ashtu, pa Zjarrin, ku një pjesë e tij përpinte tjetrën, dhe pa të dënuarit në të. Pa Amr ibn Luhajin, njeriun e parë që solli idhujt në Arabi. [1236] Atë e pa duke u tërhequr në zjarr prej zorrëve të veta.

c) Ai pa engjëjt. Pa Xhibrilin në Mekë në formën e tij me të cilën e kishte krijuar Allahu, duke mbuluar horizontin me gjashtëqind palë krahë. Pa edhe rojtarët e çdo qielli kur Xhibrili u kërkonte leje për të hapur portat e qiejve për të, natën e Mi'raxhit.

ç) Ai pa të dërguarit e Allahut që kishin ardhur para tij. I pa ata në Bejtu'l Makdis, kur u bëri udhëtimin e Israsë dhe u fal si imam i tyre. I pa edhe banesat e tyre në qiej gjatë ngjitjes: në qiellin e parë pa Ademin, alejhi selam, në të dytin pa Jahjanë dhe Isain,

[1235] Buhariu, 349. Muslimi, 163.
[1236] Buhariu, 3521. Muslimi, 901.

alejhimu selam, në të tretin pa Jusufin, alejhi selam, në të katërtin pa Idrisin, alejhi selam, në të pestin pa Harunin, alejhi selam, në të gjashtin pa Musain, alejhi selam, dhe në të shtatin pa Ibrahimin, alejhi selam.

3. Skenat e botës tjetër dhe hollësitë e gjendjeve të saj

I Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përshkroi skena të botës tjetër dhe gjendjen e njerëzve kur do të ringjallen nga varret e tyre dhe do të dalin përpara Zotit.

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se e dëgjova të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) duke thënë: "*Njerëzit do të mblidhen Ditën e Kijametit të zbathur, të zhveshur dhe të pa rreth prerë.*" Unë i thashë: "O i Dërguar i Allahut, burrat dhe gratë bashkë, do ta shohin njëri-tjetrin?" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Oj Aishe! Çështja do të jetë shumë më e rëndë se sa që të shohin njëri-tjetrin.*"

Nga Ebu Hurejre *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* përcillet se ka thënë: "Ishim me Pejgamberin, sal Allahu alejhi ve selem, në një ftesë. Atij iu soll pjesa e parakrahut (e deles), e cila i pëlqente dhe ai kafshoi prej saj një kafshatë. Pastaj tha: "*Unë jam zotëria i njerëzimit në Ditën e Kijametit. A e dini pse? Allahu do t'i mbledhë të gjithë njerëzit, të parët dhe të fundit në një vend të vetëm. Zërin e thirrësit do ta dëgjojnë të gjithë dhe shikimi do t'i përfshijë të gjithë. Dielli do t'u afrohet. Atëherë disa njerëz do të thonë: 'A nuk e shihni në ç'gjendje jeni? A nuk e shihni se ç'ju ka kapluar? A nuk po shikoni për dikë që të ndërmjetësojë për ju tek Zoti juaj?' Atëherë, disa do të thonë: '*(Le t'i drejtohemi) *babait tuaj Ademit.' Kështu ata do t'i shkojnë Ademit, por ai do t'u thotë: 'Zoti im është zemëruar sot me një zemërim që nuk ka qenë kurrë më parë dhe nuk do të jetë më pas. Kurse unë kam hallin e vetes time, unë kam hallin e vetes time! Shkoni tek dikush tjetër!'*

Ata do të shkojnë tek Nuhu, pastaj tek Ibrahimi, pastaj tek Musai, pastaj tek Isai - duke iu kërkuar ndërmjetësim tek Zoti i tyre - por secili do të përgjigjet njësoj.

Pastaj do të shkojnë tek i Dërguari i Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dhe do t'i thonë: "*O Muhamed, ti je i Dërguari*

i Allahut dhe vula e pejgamberëve. Allahu ta ka falur ty atë që ke bërë më parë dhe atë që do të bësh më pas. Ndërmjetëso për ne tek Zoti yt! A nuk e sheh gjendjen në të cilën jemi?" Unë ju them: "Unë jam për këtë!" Dhe do të shkoj poshtë Arshit dhe do të bie në sexhde para Zotit tim të Madhëruar. Pastaj Allahu do të më mësojë disa lavdërime dhe madhërime për Të, që nuk ia ka mësuar askujt më parë. Pastaj do të më thuhet: "O Muhamed, ngrije kokën! Kërko, do të të jepet! Ndërmjetëso, do të pranohet ndërmjetësimi yt!"[1237]

4. Dimensionet e kohës dhe të hapësirës

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pa të ardhmen e Umetit të tij dhe në ditët ardhshme. Ai pa të ardhmen e fesë me të cilën ai u dërgua. Ai tha: "*Nuk do të mbetet mbi faqen e dheut asnjë shtëpi qyteti as shtëpi fshati, pa hyrë fjala e Islamit në të. lartësohet ai që e përqafon dhe poshtërohet ai që e kundërshton. Ose do të bëhen pjesë e tij, ose do t'i nënshtrohen ligjit të tij.*"[1238]

Ai, gjithashtu, pa fitnet që do ta godasin Umetin e tij si shtrëngatat e shiut dhe pa vendet ku do të ndodhin. Nga Usama *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* transmetohet se ka thënë se Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, u ngjit mbi një kodër dhe tha: *"A e shihni atë që shoh unë? Unë po shoh fitnet që do të bien nëpër shtëpitë tuaja, siç bie shiu.'"*[1239]

5. Bota e kafshëve

Ashtu siç i mësoi Allahu Davudit dhe Sulejmanit gjuhën e shpendëve, po ashtu, i mësoi edhe Pejgamberit tonë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nga gjendjet e shpendëve dhe kafshëve gjëra që nuk i dinte askush tjetër.

Një herë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* hyri në kopshtin e një burri nga ensarët dhe aty ishte një deve. Sapo e pa Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, ajo nisi të rënkonte dhe sytë iu mbushën me lot. Atëherë, i Dërguari *(paqja*

[1237] Buhariu, 2340. Muslimi, 194.
[1238] Ahmedi, 23814.
[1239] Buhariu, 3597. Muslimi, 2885.

dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i tha pronarit të saj: "*Ajo sapo u ankua se ti e lë pa ushqim dhe e nget me vrap.*"[1240]

Po ashtu, kur një zog i vogël nisi të fluturonte i shqetësuar rreth tij, ai tha: "*Kush e ka shqetësuar këtë?*" Një burrë nga ensarët tha: "Unë, o i Dërguari i Allahut, mora vezët e saj ose zogjtë e vegjël." Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e urdhëroi t'ia kthente përsëri.[1241]

6. Bota e sendeve të pajeta

Ashtu siç Allahu i kishte urdhëruar malet që të madhërojnë Allahun me *tesbih* bashkë me Davudin *(paqja e Allahut qoftë mbi të)*, po ashtu, malet, gurët dhe pemët i përuleshin Pejgamberit tonë *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai thoshte: "*Unë e njoh një gur në Mekë që më përshëndeste para se të shpallem Pejgamber; dhe unë e njoh edhe sot.*"[1242]

Kur mbante hytben e xhumasë mbështetej te një trung palme, ndërsa pasi iu ndërtua minberi dhe qëndronte mbi të, u dëgjua nga ai trung një rënkim si rënkimi i devesë së ngarkuar. Atëherë, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* zbriti, u afrua dhe e përqafoi dhe atëherë trungu e ndryshoi rënkimin në një zë si dihatja e fëmijës kur fillon e pushon të qarat. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Ai po qante ngaqë më parë hytbeja mbahej pranë tij.*"[1243]

Po ashtu, kur u ngjit në malin Uhud së bashku me Ebu Bekrin, Umerin dhe Uthmanin, mali nisi të dridhej dhe Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* i tha: "*Qëndro, o Uhud, sepse mbi ty është një Pejgamber, një Siddik* (besnik) *dhe dy shehidë* (dëshmorë)*!*"[1244]

Për këtë mal Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Ky është Uhudi, një mal që na do dhe e duam.*"[1245]

[1240] Ebu Davudi, 2549.
[1241] Ebu Davudi, 2675.
[1242] Muslimi, 2277.
[1243] Buhariu, 3584.
[1244] Buhariu, 3675.
[1245] Buhariu, 4422. Muslimi, 1392.

Nga këto skena kuptojmë se bota e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në mbretërinë e Allahut është jashtëzakonisht e gjerë. Horizontet e tij të perceptimit shkojnë përtej asaj që kap mendja njerëzore, duke u shtrirë deri në botën e lartë mbi qiej dhe në botën tjetër. Po ashtu, bota e tij në përmasat e kohës përfshin të kaluarën e largët dhe shekujt e ardhshëm, derisa ai pa të ardhmen e fesë së tij, pushtetin e Umetit të tij, betejat e fundit të kohës dhe çastin e mbarimit të botës, kur do t'i fryhet Surit. Atë ditë, i pari që do ta dëgjojë fryrjen do të jetë një burrë që po riparonte[1246] vendin për të pirë ujë devetë e tij dhe ai do të bjerë pa ndjenja, e bashkë me të do të bjerë mbarë njerëzimi.[1247]

7. Shikimi i vendlindjeve dhe vendperëndimeve të tokës

Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* pa anët dhe skajet e tokës dhe tha: *"Allahu ma afroi tokën, e unë pashë lindjet dhe perëndimet e saj. Mbretëria e Umetit tim do të arrijë deri atje ku më është treguar prej saj. Mua më janë dhënë dy thesaret: i kuqi dhe i bardhi."*[1248]

Ai pa pallatet e Medainit (*kryeqendra e Persisë*), pa pallatet e Shamit dhe pa pallatin e San'asë.

Kjo tregon gjerësinë e botës së Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në hapësirë dhe në kohë. Po, ky është dallimi dhe privilegji, që e bëri Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* të jetë kufiri mes botës së dukshme dhe botës së padukshme, të jetë logjika e humanizmit për tërë njerëzimin. Ky është dallimi i mesazhit të tij: i përsosur dhe i plotë në fe dhe në moral, me përmasë universale dhe të përjetshme, me shtet dhe shoqëri, me qytetërim dhe me fe. Për këtë arsye, *Sira* e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* dallon nga biografitë e të gjithë prijësve, reformatorëve, të mëdhenjve dhe të dërguarve të tjerë.[1249]

[1246] "*El Nihajetu*", *4/277.*
[1247] Muslimi, 2940.
[1248] Muslimi, 2889.
[1249] Marrë nga parathënia e dr. Muhamed Imare, "*El Nur el Halid*", *9.*

Shenjat e pejgamberisë nga Sira e tij[1250]

Mrekullia më e madhe dhe e përjetshme e Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte Kurani Famëlartë – mrekullia nëpërmjet së cilës u shpall sfida e cila ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë përgjatë brezave dhe kohërave.

Mirëpo, dëshmitë e pejgamberisë janë më të shumta se sa mrekullitë. Ato nuk kushtëzohen të jenë medoemos shenja jashtëzakonisht të mbinatyrshme. Madje, edhe mrekullitë që ndodhën për Pejgamberin, sal Allahu alejhi ve selem, - si shtimi i ushqimit, burimi i ujit nga gishtat e tij, apo lavdërimi i gurëve në dorën e tij dhe të tjera të ngjashme - ndodhën para besimtarëve që t'u shtohej imani, e jo para jobesimtarëve si sfidë kundër tyre.

Ndër dëshmitë më të qarta të pejgamberisë së tij ishte vetë jeta e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, e cila në tërësi dëshmonte se ishte jetë e një Pejgamberi. Kjo u shfaq qartë për Sahabët që e njohën nga afër, sepse për ata ishte e dukshme se kush jetonte me atë gjendje nuk mund të ishte thjesht një pretendues i pejgamberisë, as shpifës ndaj Zotit të tij.

Abdullah bin Selami tregon ardhjen e Pejgamberi në Medinë: "Kur erdhi i Dërguari *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, njerëzit dolën me ngut drejt tij dhe unë isha ndër ata që dolën. Sapo e pashë fytyrën e tij, e kuptova se ajo nuk ishte fytyrë gënjeshtari."[1251]

Pra, vetë tiparet e tij tregonin për sinqeritetin; nuk ishte fytyra e tij fytyrë mashtruesi, as gjendja e tij gjendje e një pretenduesi të rremë.

Ndër këto dëshmi është edhe hadithi i Thumame bin Uthalit, i cili kërcënonte të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* sa ishte ende në Jemame. Kur u kap rob dhe u soll te Pejgamberi, sal Allahu alejhi ve selem, ai urdhëroi që ta lidhnin në xhami për

[1250] Shih librin *"El Edil-letu el Aklijetu ala nubuvveti hajri el Berijjeti"* të dr. Abdu el Muhsin bin Ziben el Mutejri, prej të cilit kam përfituar në këtë pjesë të studimit.
[1251] Ahmedi, 23784.

tre ditë. Në këtë kohë nuk iu bë asnjë e keqe dhe as nuk u keqtrajtua. Tre ditë me radhë Thumame vëzhgonte Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*: shikonte se si falte namazin, dëgjonte recitimin e tij të Kuranit, sodiste marrëdhënien e tij me shokët dhe mënyrën si rrinte në kuvend me ta.

Gjatë këtyre ditëve Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk i ofroi Islamin me urdhër apo me fjalë të drejtpërdrejta, por ia paraqiti me një mënyrë praktike, të gjallë, që ai vetë ta shihte. Pas tre ditësh, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi që të zgjidhej dhe të lirohej. Pasi doli nga xhamia dhe mori lirinë e tij, Thumame u kthye përsëri te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* duke shpallur Islamin dhe duke dëshmuar shehadetin përpara tij.

Ai tha: "Pasha Allahun, nuk kishte mbi tokë fytyrë më të urryer për mua se fytyra jote, por tani fytyra jote është bërë fytyra më e dashur për mua. Pasha Allahun, nuk kishte fe më të urryer për mua se feja jote, por tani feja jote është bërë feja më e dashur për mua. Pasha Allahun, nuk kishte vend më të urryer për mua se vendi yt, por tani vendi yt është bërë vendi më i dashur për mua."[1252]

Pra, çfarë ishte ajo që e bindi Thumamen dhe e bëri ta dojë Pejgamberin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* më shumë se çdo njeri tjetër? Ishte jeta dhe sjellja e tij, të cilat ai i pa dhe i përjetoi brenda tre ditësh.

Kur Herakliu e pyeti Ebu Sufjanin për të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, njëmbëdhjetë pyetjet që ai bëri nuk kishin të bënin me ndonjë mrekulli të jashtëzakonshme, por ishin pyetje mbi gjendjen dhe *Sira*-n e tij. Ndër to: "A e keni akuzuar ndonjëherë për gënjeshtër para se të thoshte atë që tha? A ka pasur ndonjë mbret nga etërit e tij? A e pasojnë ata që janë fisnikët e popullit apo të dobëtit? A shtohen apo pakësohen ndjekësit e tij? A kthehet ndonjëri i zemëruar pas hyrjes në fenë e tij? A tradhton?..." - dhe të tjera të ngjashme.

Pastaj, duke u nisur nga këto përgjigje, Herakliu nxori përfundimin mbi vërtetësinë e pejgamberisë së tij dhe i tha Ebu Sufjanit:

[1252] Buhariu, 4372. Muslimi, 1764.

"Nëse ajo që the është e vërtetë, së shpejti do të zotërojë vendin ku shtrihen këmbët e mia. Sikur të shpresoja se do të mund të shkoja tek ai, do të përballoja çdo vështirësi për ta takuar. Dhe sikur të isha pranë tij, do t'ia laja këmbët."[1253]

Kur njeriu lexon një pjesë të kësaj *Sire* fisnike, nuk mund ta shmangë nga vetja bindjen e palëkundur se ajo nuk mund të jetë tjetër veçse biografia e një Pejgamberi që transmeton vetëm fjalën e Allahut, Zotit të Tij.

E vërteta ka një forcë pushtuese që depërton përtej perdeve të fshehjes dhe lexohet qartë edhe mes rreshtave. Për këtë arsye, shumë prej atyre që Allahu ua hapi zemrat për Islamin nuk i kërkuan të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ndonjë dëshmi tjetër për atë që thoshte. Disa ishin prej të afërmve të tij që e njohën nga madhështia e *Sira*-s së tij, ndërsa disa të tjerë ishin të huaj që e njohën nga shenja e ndritshme e së vërtetës në fytyrën e tij.[1254]

Nëse shohim me vëmendje *Sira*-n e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, gjejmë se ajo është dëshmi e qartë për vërtetësinë e pejgamberisë së tij në të gjitha etapat e jetës.

E para: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* jetoi mes kurejshëve për dyzet vjet para shpalljes. Shoqëria e kurejshëve ishte një shoqëri fisnore e mbyllur, ku gjendja dhe jeta e askujt nuk mbetej e panjohur. Por kur ai shpalli pejgamberinë dhe kurejshët shpallën armiqësinë ndaj tij, ata nuk gjetën qoftë edhe një rast të vetëm nga jeta e tij e mëparshme për ta përmendur si njollë kundër tij. Përkundrazi, megjithëse ai kishte shumë cilësi të larta, më e njohura ndër ta ishte: "I Sinqerti" dhe "i Besuari" - dy virtyte themelore që tregojnë qartësisht vërtetësinë e pejgamberisë së tij.

Për këtë arsye, Herakliu tha: "E di mirë që ai që nuk ka gënjyer kurrë ndaj njerëzve, nuk do të gënjejë ndaj Allahut."

Ndërsa El Nadr bin Harith u tha kurejshëve: "Pasha Zotin, ka zbritur mbi ju një çështje për të cilën nuk gjeni asnjë rrugëdalje. Muhamedi jetoi mes jush si një djalosh i ri, më i pëlqyeri ndër ju,

[1253] Buhariu, 7. Muslimi, 1773.
[1254] "*El Nebeu el Adhijm", 64.*

më i vërteti në fjalë dhe më i besuari në amanet. E pastaj, kur patë në mollëzat e faqeve të tij thinjat dhe ju solli atë që ju solli, thatë: 'Magjistar!' Jo, pasha Zotin, ai nuk është aspak magjistar…"[1255]

Kështu, jeta e tij para shpalljes është ndër dëshmitë më të forta për vërtetësinë e Pejgamberisë së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

E dyta: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte i njohur për cilësitë e tij fisnike edhe para shpalljes, por nuk u njoh kurrë për konkurrim për pushtet apo përpjekje për të marrë drejtimin e popullit të vet. Asnjëherë nuk është përmendur se ai mori pjesë në mbledhjet e *Dar el Nedve*, këshilli më i lartë i kurejshëve. Madje, kur kurejshët ia ofruan pushtetin dhe mbretërimin mbi ta, ai refuzoi prerazi. Kjo tregon qartë se misioni i tij nuk ishte një thirrje për interesin personal, por një thirrje për udhëzimin e njerëzve drejt së vërtetës.

E treta: Kur zbriti shpallja për herë të parë në shpellën Hira, ai u kthye i tronditur dhe i frikësuar, derisa i dridheshin gjymtyrët, duke thënë: *"Më mbuloni! Më mbuloni!"* Dhe i tha gruas së tij, Hadixhes: "*Pata frikë për veten time.*"[1256] Kjo është dëshmi se ai nuk e kishte pritur, as e kishte shpresuar pejgamberinë, e aq më pak ta kishte paramenduar. Sepse po të ishte një pretendues, ai do të kthehej i gëzuar dhe do të dilte me zë të lartë duke shpallur nëpër kuvendet e kurejshëve.

E katërta: Kur ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shpalli hapur thirrjen e tij dhe iu drejtua fiseve të kurejshëve, i pari që iu kundërvu ishte xhaxhai i tij, Ebu Lehebi. Fakti që një i afërm i tij e mohoi dhe e kundërshtoi, si dhe fakti që fisi i tij nuk u ngutën për t'iu përgjigjur menjëherë thirrjes, tregon qartë se kjo nuk ishte një garë për pushtet mes Beni Hashimit dhe fiseve të tjera të kurejshëve.

E pesta: Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u shpall Pejgamber në Mekë, në një luginë të thatë e pa të mbjella, në një vend të izoluar në skajin e Gadishullit Arabik. Megjithatë, ai e shpalli mesazhin e tij që në fillim si një thirrje universale për të

[1255] "*Sijretu Ibn Hisham", 1/299.*
[1256] Buhariu, 2. Muslimi, 160.

gjithë njerëzit e botës. A mundet, vallë, një njeri, sado imagjinatë të ketë, të mendojë se një zë që thirret nga Meka do të arrijë të dëgjohet nga i gjithë njerëzimi? Sidomos në një kohë kur komunikimi dhe përhapja e lajmit ishte aq e vështirë! Kjo siguri dhe ky vizion nuk mund të shpjegohet me standarde njerëzore, përveçse si shpallje hyjnore nga Allahu i Madhërishëm.

E gjashta: Analfabetizmi i Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ai nuk lexoi kurrë një shkrim, e as shkroi ndonjëherë me dorën e tij. Megjithatë, ai solli një dije të pakufishme, të cilën nuk e zotërojnë as dijetarët më të mëdhenj. Kjo tregon qartë se burimi i diturisë së tij nuk ishte trashëgimi e librave të shkruar para tij, por shpallja hyjnore që i vinte nga Allahu. Për këtë, i Lartësuari thotë: "***Para këtij, ti*** (Muhamed) ***nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e së pavërtetës do të dyshonin***." (El-Ankebut: 48)

E shtata: Sprovat dhe vështirësitë që kaloi Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* do të tronditnin vendosmërinë e çdo njeriu, do të fshihnin shpresën dhe do të ushqenin dëshpërimin. Megjithatë, ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte gjithmonë i mbushur me siguri dhe qëndresë të palëkundur në këto vështirësi.

Një herë iu ankuan Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për vështirësitë: "A nuk po kërkon ndihmë për ne!? A nuk po lutesh për ne!?" Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* tha: "*Allahu do ta plotësojë këtë fe, derisa kalorësi të udhëtojë nga San'aja deri në Hadrameut pa ju frikësuar askujt përveç Allahut ose ujkut për delet e tij! Por ju nguteni!*"[1257]

Në shpellë, ndërsa kurejshët ishin përreth duke e kërkuar, ai i thotë shokut të tij: ***"Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!"*** (Et-Teube: 40)

Gjatë udhëtimit të Hixhretit, ai i dha lajmin e mirë Surakas, i cili kishte dalë për ta ndjekur se së shpejti do të vishte stolitë e perandorit të Persisë, Kisrasë.[1258]

[1257] Buhariu, 3612.

[1258] Buhariu, 3906. Ibnu Abdu el Berru, "*El Istijabu", 2/148.*

Në kulmin e frikës ditën e Betejës së Ahzabit, ai i dha lajmin e mirë Sahabëve për çlirimin e pallateve të Persisë, të Shamit dhe të Jemenit.[1259]

Kjo siguri dhe qetësi në kohë vështirësish dhe rreziqesh nuk mund të vijë tjetër veçse nga shpallja hyjnore dhe ndihma e Allahut.

E teta: Në Betejën e Uhudit, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u godit rëndë; i vdiq xhaxhai, ranë dëshmorë shokët e tij dhe u thye njëri nga katërshja e dhëmbëve të tij[1260] - gjaku i tij rridhte në fytyrë - një pamje që do të mbillte zemërim dhe mllef në çdo zemër njerëzore.

Megjithatë, Kurani i shpallet menjëherë duke i thënë: ***"Ti nuk ke asgjë në dorë, nëse do t'ua pranojë Ai pendimin apo do t'i dënojë, se ata janë vërtet keqbërës."*** (Ali Imran: 128)

Kjo nuk mund të vijë nga një njeri i thjeshtë, i ri në betejë dhe i prekur nga humbja dhe dhimbja. Por ky ajet ishte lajm i mirë për pendimin e Allahut për ta. Falë këtij shpëtimi hyjnor, komandantët e ushtrisë së politeistëve në Uhud, përfshirë Ebû Sufjanin, Halid bin el Velidin dhe Ikrime bin Ebi Xhehlin, u kthyen në Islam.

E nënta: Adhurimi i fshehtë, i cili është i njohur nga hadithet që transmetohen prej tij, tregon thellësinë e besimit të tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Ibën Abasi tregon se një natë fjeta te Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në shtëpinë e tij te tezja ime, Meimunja. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* u ngrit natën për të falur namazin e natës, kur të gjithë të tjerët flinin. Ky adhurim i fshehtë nuk mund të bëhet nga një pretendues; vetëm ai që ka siguri të plotë në Allahun e kryen me këtë përkushtim.

Aishja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)* tregon se një natë e kërkova Pejgamberin, sal Allahu alejhi ve selem. Mendova se kishte shkuar te ndonjë nga gratë e tij, por e gjeta duke u falur, në ruku a në sexhde, duke thënë: "*Subhaneke ve bihamdike, la ilaha il-la ente - Lavdëruar dhe falënderuar qofsh! Nuk ka zot tjetër përveç Teje!*" Unë thashë: "Për ty qoftë jeta ime! Ku e kam mendjen unë e ku e ke mendjen ti!"

[1259] Ahmedi, 18694.

[1260] Katërshja janë dhëmbët anësorë pas dhëmbëve prerës lart edhe poshtë. "*Sherh el Nevevij ala Muslim", 12/481.*

Ajo tregon edhe një rast tjetër: "Një natë më doli gjumi dhe kërkova në dyshek për të Dërguarin e Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur dora ime ndeshi në shputat e këmbëve të tij, ndërsa ai ishte në sexhde, duke thënë: "*Allahumme inni eudhu bi ridaka min sakhatike ve bi muafatike min ukubetike… - O Allah, kërkoj mbrojtje te dashuria Jote nga zemërimi Yt! Kërkoj faljen Tënde nga ndëshkimi Yt! Të kërkoj mbrojtje Ty prej Teje, Unë nuk mund t'i numëroj dhuntitë e Tua! Unë nuk di të falënderoj Ty siç e falënderon Ti veten Tënde!*"[1261]

Këto adhurime të fshehta nuk mund të jenë veprim i dikujt që mundohet të duket i devotshëm para njerëzve; ato tregojnë se ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte më i përkushtuar se çdo kush tjetër ndaj asaj që ai vetë fton.

E dhjeta: Rasti i vdekjes së djalit të tij, Ibrahimit. Kur ai vdiq, ndodhi që përkoi me eklipsin e diellit, prandaj njerëzit thanë se dielli u errësua për shkak të vdekjes së Ibrahimit, bazuar në një besim pagan që mendohej se dielli errësohet për ndonjë ngjarje të madhe, lindje apo vdekje e një njeriu të madh. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, duke përballuar pikëllimin e tij, u ngrit për t'i korrigjuar në këtë keqkuptim: "*Eklipsi i diellit dhe i hënës nuk ndodhin për vdekjen e dikujt prej njerëzve. Por ato janë dy shenja nga shenjat e Allahut. Kur ti shihni ato, shpejtoni për në xhami dhe faluni derisa të përfundojnë.*"[1262]

Nëse ai do të kishte qenë një pretendues, kjo do të ishte mundësia e përsosur për të forcuar pretendimin e tij duke përdorur këtë ngjarje, por shenjat e Pejgamberisë së tij të vërtetë ishin aq të qarta sa nuk pati nevojë të përdorte këto keqkuptime njerëzore; ai i hodhi poshtë dhe e sqaroi ligjërisht dhe shpirtërisht këtë besim të gabuar.

E njëmbëdhjeta: Ekuilibri në jetën e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* - dhe kjo është një nga mrekullitë e jetës së tij. Shumë rrallë ndodh që të gjesh një njeri të shquar dhe të dalluar në një fushë të jetës, pa ndikuar kjo në fusha të tjera të jetës. Ndonjëherë, njeriu shquhet për dituri, por ajo është arritur në kurriz të marrëdhënieve publike apo marrëdhënieve sociale. Ndonjëherë mund të gjesh një udhëheqës të madh, por përkushtimi ndaj

[1261] Muslimi, 486.
[1262] Buhariu, 1041. Muslimi, 904.

udhëheqjes ka shkaktuar mangësi në aspektin shkencor apo në moralin e tij në marrëdhënie me të tjerët.

Por Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ka asnjë mangësi në asnjë aspekt të jetës së tij. Në çdo fushë - si i Dërguar, si predikues, si mësues, si bashkëshort, si baba, si udhëheqës, si shok, si luftëtar dhe si i paqësor - ai është i plotë dhe i balancuar.

Ky ekuilibër dhe ky kompletim i të gjitha anëve të jetës nuk mund të arrihet nga aftësitë njerëzore, përveçse me mbështetje dhe ndihmë të drejtpërdrejtë nga Allahu.

E dymbëdhjeta: Mosdhënia pas pasurisë - Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* e kaloi jetën e tij me një qëndrim të thjeshtë ndaj pasurisë dhe kënaqësive materiale. Kur hyri në Medinë, ai jetoi me pak, ndërtoi shtëpinë e tij aty me një dhomë të vetme dhe një oborr të vogël, gjithçka ishte e thjeshtë dhe e kufizuar.

Kur Allahu i Madhërishëm ia shtoi pasuesit dhe ia dërgoi pasurinë, shtëpia dhe mobilimi i tij nuk ndryshuan. Ai nuk ruante për vete asgjë nga pasuritë e kësaj bote, por i shpërndante mes të tjerëve, duke u kthyer në shtëpinë e tij të parë, ku jetoi dhe vdiq, ndërkohë që dashuria e tij ishte gjithnjë për botën tjetër.

Madje, Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* urdhëroi edhe familjen e tij të jetonte me këtë masë të thjeshtë të jetës. Ai i lejoi nënat e besimtarëve të zgjedhin mes jetesës me të në këtë gjendje të thjeshtë dhe të fitojnë Xhenetin ose të përfitonin nga pasuria e botës dhe të dilnin, por ato të gjitha zgjodhën të qëndronin me të.

Kur e bija, Fatimja *(Allahu qoftë i kënaqur me të)*, i kërkoi një shërbëtor nga robërit e luftës, ai u përgjigj: "*A t'ju tregoj për diçka më të mirë se ajo që kërkoni? Kur të shtriheni për të fjetur, kujtojeni Allahun me këto fjalë: SubhanAllah 33 herë, Elhamdu Lil-lah 33 herë, Allahu Ekber 33 herë - kjo është më e mirë për ju se një shërbëtor.*"[1263]

E trembëdhjeta: Gjendja e tij me gratë e tij. Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* vdiq duke pasur nëntë gra, të cilat ishin nga fise të ndryshme dhe në moshë të ndryshme. Edhe pse disa prej tyre ishin bija të armiqve të tij, asnjëra nuk ka thënë qoftë edhe diçka nga jeta e tij private që nuk paraqet përsosmërinë

[1263] Buhariu, 1127. Muslimi, 775.

e tij si njeri. Ato jetonin me të në atë mënyrë të thjeshtë, jo si gratë e mbretërve. Saqë ndodhi që të ankohen për këtë mënyrë jetese, por këtu u shpall ajeti që e urdhëron Pejgamberi t'ju ofrojë mundësinë e zgjedhjes. Këtu ato të gjitha pa përjashtim zgjodhën ahiretin mbi këtë botë, duruan këtë gjendje, por qëndruan me të gjatë jetës së tij, të etura për t'u ribashkuar me të në Xhenetin e premtuar."

E katërmbëdhjeta: Qëndrimi larg përfitimeve personale. Ai ndalonte çdo lavdërim të ekzagjeruar ndaj tij që tejkalonte statusin dhe vendin e tij. Ai thoshte: *"Mos më lavdëroni siç lavdëruan të krishterët birin e Merjemit, sepse unë jam rob si ju, prandaj thoni: Robi i Allahut dhe i Dërguari i Tij."*[1264]

Dhe kështu, kushdo që lexon jetën e këtij Pejgamberi të nderuar dhe gjendjet e përditshme në jetën e tij, arrin në një bindje të palëkundur se kjo është gjendja e një Pejgamberi të nderuar, jo e një pretenduesi apo përfituesi. Do të kuptojë se mënyra e tij e jetesës është dëshmi e sinqeritetit të tij dhe tregues i pejgamberisë së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Vështrim i përgjithshëm mbi jetën profetike

Duke shqyrtuar këto gjendje të ndryshme të jetës së gjerë të Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, na shfaqen përmes tyre disa tregues të përgjithshëm, përfshirë:[1265]

1. Shihni në jetën e tij përmbushjen e fjalëve të tij: *"Gëzimi im është vendosur në namaz."*[1266] Namazet shtriheshin përgjatë gjithë ditës dhe natës së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*. Nga namazi, ai duket sikur merrte forcë, vendosmëri dhe mprehtës. Namazi për të ishte kënaqësia e tij më e madhe, aq sa nga përmallimi i thellë për të thoshte: *"Na gëzo me të, o Bilal!"*[1267]

[1264] Buhariu, 3445.
[1265] Përmbledhje nga libri i autorit, *"El Jevmu el Nebevij"*.
[1266] Nesaiu, *"El Sunen el Kubra", 3939.*
[1267] Ebu Davudi, 4985, 4986.

Ibn el Kajimi përmend se totali i namazeve të tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjatë ditës dhe natës, ishte dyzet rekate, të cilat ai i ruante me kujdes: shtatëmbëdhjetë farz, dhjetë ose dymbëdhjetë sunet dhe njëmbëdhjetë ose trembëdhjetë rekate gjatë natës; gjithsej dyzet. Çfarë tejkalonte këtë numër ishte jashtë rregullit të përhershëm, si namazi i Duhasë, namazi kur vizitonte dikë, përshëndetja e xhamisë dhe të ngjashme. Besimtari duhet që të vazhdojë këtë rit të përhershëm deri në vdekje; sa shpejt përgjigjet Allahu dhe sa shpejt hapet dera për atë që troket aty dyzet herë çdo ditë e natë![1268]

2. Namazi i natës ishte namazi më i thellë në prezencë shpirtërore dhe kënaqësi në lutje; ai ishte një gjendje e thellë e përkushtimit dhe përjetimit të devotshmërisë.

3. Më habit fakti që ky Pejgamber, i cili mori lajmin e Allahut se i është falur çdo mëkat i kaluar dhe i ardhshëm, ishte ai që kërkonte falje më shumë se të gjithë. Ai e fillonte çdo mëngjes me njëqind herë *Istigfar* - kërkim falje. Në çdo mexhlis i numërohej më shumë se njëqind herë të thotë: *"O Zot, më fal mua! Më kthe drejt Teje! Ti e pranon kthimin! Ti je Falës i Madh!"*[1269] Ai pastaj i kërkonte falje Zotit me përgjërim dhe përulje, gjatë namazit të natës: *"O Allah, më fal për ato që kam bërë dhe për ato që kam lënë pa bërë, për ato që kam fshehur dhe për ato që kam shfaqur! Ti je Ai që çon përpara dhe Ti je Ai që lë pas! Nuk ka Zot tjetër përveç Teje!"*[1270]

4. Përkushtimi në dhikër. Aq i lidhur ishte me përmendjen e Allahut saqë duket sikur jeton në një gjendje dashurie dhe malli të përhershëm për Të. Përmendja e Allahut ishte fjala e parë që shqiptonte kur zgjohej dhe e fundit kur shtrihej për të fjetur. Gjuha e tij ishte gjithmonë e njomë me përmendjen e Allahut mes këtyre kohëve.

[1268] *"Zadu el Mead", 1/327.*
[1269] Tirmidhiu, 3434.
[1270] Buhariu, 1120.

5. Ekuilibri në kryerjen e detyrave dhe balancimi i aktivitetet e jetës; kryerja e adhurimeve, kumtesa e mesazhit, përmbushja e detyrave ndaj familjes, marrëdhënia me shokët, kujdesi për veten dhe detyrat e tjera - të gjitha këto ecnin njëkohësisht dhe në mënyrë të balancuar pa lënë asgjë jashtë kujdesit dhe vëmendjes, qoftë ajo çështje e veçantë apo e përgjithshme, e drejtë apo detyrë. Kjo ishte një gjithëpërfshirje e balancuar e zbatimit në praktikë e asaj që vetë porositi: "*Trupi yt ka të drejtën e tij, syri yt ka të drejtën e tij, gruaja jote ka të drejtën e saj, vizitori yt ka të drejtën e tij, fëmija yt ka të drejtën e tij, shoku yt ka të drejtën e tij.*"[1271] Dhe ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ia dha secilit të drejtën e tij.

6. Jeta e tij ishte e ngarkuar dhe e pasur, por nuk ishte e tensionuar apo e trazuar; pavarësisht ngarkesës së detyrave, ai ruante qetësinë dhe paqen e shpirtit. Kur e shikon në ndonjë gjendje, mendon se nuk ka qenë i angazhuar me ndonjë punë më përpara as nuk ka ndonjë angazhim më pas. Ky është një qëndrim i baraspeshuar i shpirtit, që përfshin punët pa u tronditur dhe pa u tensionuar.

7. Jeta e tij ishte e organizuar, por jo monotone. Një jetë e sistemuar, por me fleksibilitet për t'iu përshtatur situatave dhe nevojave. Koha e namazit ishte e caktuar. Namazi sistemonte edhe veprimtaritë e tjera. Ndërsa mexhliset mund të zgjasnin ose shkurtoheshin sipas nevojës.

8. Thjeshtësi dhe natyrshmëria e jetës. Ai gëzohej me të tjerët, ndante lumturinë dhe emocionet. Kjo natyrshmëri në bashkëpunim dhe në marrëdhënie me njerëzit thyente çdo barrierë midis tij dhe njerëzve. Ai bisedonte çiltër me njerëzit dhe ata bisedonin lirshëm me të. Pranë Pejgamberit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ata ndiheshin si fëmijë pranë një babai të dashur.

9. Gëzimi dhe kënaqësia ishin të pranishme në familje dhe në shtëpi; ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishte gjithmonë i buzëqeshur dhe i qeshur, por ato ishin të pranishme edhe në mexhliset, aty kishte hapësirë dhe gatishmëri për biseda, shaka, lojëra.

[1271] Buhariu, 1968, 1975. Muslimi, 1159.

10. Fuqia e marrëdhënieve emocionale bashkëshortore dhe plotësim i këtyre emocioneve, të cilat shfaqen përmes ndihmës në punët e shtëpisë, dhënies së gotës, dhënies së ushqimit, bisedave të mbrëmjes, vizitave ditore, komunikimi i ngrohtë, intimitetit bashkëshortor.

11. Të kuptuarit e natyrës dhe nevojave të njerëzve, madje edhe gjatë faljes së namazit të tij. Kur falej me njerëzit ai e shkurtonte namazin më shkurt se të gjithë, edhe pse kur falej vetëm ai e zgjaste më shumë se të gjithë. Kur hynte në namaz, edhe pse dëshironte ta zgjaste, e shkurtonte atë për shkak se dëgjonte të qarat e fëmijëve dhe nuk i pëlqente të mundonte nënat e tyre.[1272]

12. Jeta e tij ishte e lumtur. Nga gjendjet e ndryshme të jetës së tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* shihet qartë se jeta e tij ka qenë një jetë e mirë dhe e lumtur.

Lumturia e tij në besim ishte një horizont i lartë që askush para tij nuk e kishte arritur, sepse ai ishte njohësi më i mirë për Zotin, prandaj ishte më i binduri dhe më besimtari. Kënaqësia e tij në adhurime dhe shijimi i tij për ëmbëlsinë e besimit nuk mund të krahasohet me asnjë kënaqësi prej kënaqësive të kësaj jete.

Ndërsa lumturia në jetën tokësore shfaqej në çdo moment të jetës së tij, e shikon se si ai e shijon këtë lumturi me mirënjohjen e tij të thellë ndaj Allahut, pasi Ai e mbrojti nga brengat dhe pikëllimet, e mbrojti nga sëmundjet e këqija. Prandaj ai jetoi i shëndetshëm fizikisht dhe shpirtërisht.

Ai ishte i lumtur me ata që e rrethonin dhe me ata që ishin pranë tij.

Pastaj jetoi një jetë në të cilën vinin njëra pas tjetrës arritjet madhore. E një nga lumturitë më të mëdha të jetës është arritja e suksesit, e më pas arritja e qëllimit më të lartë të tij në jetë: përcjellja e mesazheve të Allahut dhe hyrja e njerëzve në fenë e Tij grupe-grupe.

Unë nuk mund ta përfytyroj dot lumturinë e zemrës së të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* kur shihte se si shtohej turma e besimtarëve në xhaminë e tij. Madje, as ndjenjat e mia nuk mund t'i përshkruaj vetëm duke imagjinuar emocionet e

[1272] Buhariu, 868. Muslimi, 470.

tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjatë Haxhit të Lamtumirës, kur dëgjonte ata njerëz të ardhur nga të gjitha anët e Gadishullit Arabik, duke thënë me një zë: "*Dëshmojmë se ti e ke përcjellë, e ke këshilluar dhe e ke përmbushur detyrën tënde!*"

E gjithë kjo ishte një pjesë e dhuratave të mëdha të Allahut për të, ditën kur i tha: ***"E, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur..."*** (Ed-Duha: 5)

13. Ai i shijonte kënaqësitë e jetës dhe falënderonte Allahun për çdo dhuratë; çdo ushqim, pije, dhe gjumë ishte një moment i përjetuar me kënaqësi dhe mirënjohje.

Në jetën e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* gjen një shijim të kënaqësive të jetës, një ndjesi të bukurisë së asaj që sheh, një ëmbëlsi të asaj që shijon dhe një mirënjohje të thellë ndaj Allahut për këtë mirësi. Në çdo gllënjkë që pinte dhe në çdo kafshatë që hante, ai shijonte atë kënaqësi me një mirënjohje të madhe ndaj Allahut: "*Falënderuar qoftë Allahu! Falënderime të shumta, të bukura dhe të bekuara! Përveç Teje, o Zoti ynë! askush nuk na mjafton, nuk na strehon dhe nuk na pasuron! Falënderuar qoftë Allahu i Cili na ushqen dhe nuk ushqehet, i Cili na me mirësinë e Tij na udhëzoi, që na ushqeu dhe na dha të pimë!*"

Në zgjimin e tij nga gjumi, ndiente mirësinë e Allahut mbi të pas një pushimi që shumë sy të pagjumë e dëshirojnë, e pastaj zgjohej me shëndet dhe gjallëri, duke kujtuar mirësinë e Dhuruesit të mirësive: "*Falënderuar qoftë Allahu, i Cili na dha jetë pas vdekjes, dhe tek Ai është kthimi.*"[1273]

Nëse kjo është gjendja e tij në ushqimin e zakonshëm dhe gjumin e zakonshëm - gjëra të cilat zakoni shpesh ua zbeh shijen dhe ndjesinë e mirësisë - atëherë si do të ishte shijimi i tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për mirësitë e tjera të reja dhe të shumta që i përsëriteshin? Me të vërtetë, ndien se ai ndalej te çdo mirësi për ta shijuar plotësisht.

Nëse ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* na e drejton shikimin tonë të brendshëm drejt asaj që ne jemi mësuar ta shohim

[1273] Buhariu, 6312. Muslimi, 2711.

aq shumë saqë mezi e ndiejmë. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* thotë: *"Kush zgjohet i sigurt në shtëpinë e tij, i shëndoshë në trupin e tij, e ka ushqimin e ditës së tij, është sikur i është dhuruar e gjithë bota."*[1274] Atëherë, si ka qenë shijimi i tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* për këtë dhe më shumë se kaq?

Ndjenja e mirësive, shijimi dhe vlerësimi i tyre në shpirt shton hapësirën e lumturisë me to; e bën jetën më të gëzueshme, më të freskët e të bukur; e bën shpirtin më të qetë, më të kënaqur dhe më mirënjohës ndaj Dhuruesit të madh, ndaj Bujarit që kjo është dhurata e Tij. Kështu mirësia sjell mirësi të tjera, jeta bëhet më e gjerë, më e re dhe më e ndritshme, siç thotë Allahu i Madhërishëm: ***"Dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!"*** (Ed-Duha: 11)

14. Jeta e tij ishte e pasur me përvojë dhe përballim të dhimbjeve; nga fëmijëria me jetimëri, dhimbjet pas shpalljes, humbjet e të dashurve dhe sfidat e tjera, ai i tejkaloi të gjitha me forcë dhe balancë.

Kur e sheh jetën pejgamberike plot ngjarje dhe ndërveprimin e tij aktiv me jetën, mendo sasinë e dhimbjeve dhe pikëllimeve që Pejgamberi *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* përjetoi dhe pastaj i kapërceu.

Ditë e parë të jetës e gjeti veten jetim. Një jetimëri e përsëritur, nga babait te nëna, pastaj gjyshi. Pas shpalljes së tij Pejgamber, u përball me sfidat e popullit të tij. Pikëllimi për humbjen e gruas së tij, Hadixhes, më të dashurës prej njerëzve për të. Pikëllimi nga vdekja e djemve dhe bijave të tij në jetën e tij. Detyrimi të ndahet nga vendlindja e tij, më e dashura prej vendeve për të; u godit nga humbjet në familjen dhe shokët e tij në Uhud. U lëndua nga ngjarja e *Ifkut* - shpifja ndaj Aishes, dhe nga sprova të tjera e dhimbje të shumta që e shoqëruan jetën e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*.

Megjithatë, përkundër gjithë kësaj, ai gëzonte një aftësi të madhe e të mrekullueshme për të kapërcyer ndjenjat negative, si

[1274] Tirmidhiu, 2346.

dhe një zotësi të lartë për ta rifilluar jetën me energji të re dhe për të bashkëvepruar pozitivisht me çdo çast të saj.

Kur sheh këtë rrjedhë të madhe në çdo ditë të jetës së tij, gati thua: Kjo është jeta e një njeriu që s'e ka prekur asnjë vështirësi dhe asnjë sprovë.

Por jo - ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* nuk ishte ashtu. Ai i kapërcente dhimbjet dhe nuk i mbante gjallë brenda vetes. Për çdo çast të jetës së tij kishte një projekt, një arritje dhe një gëzim. Ishte jetë e rrjedhshme dhe e re, jetë siç duhet të jetë jeta.

15. Udhëtimi me Pejgamberin në jetën e tij ushqen dashurinë dhe nderimin në zemrat tona; shokët e tij e donin dhe e nderonin maksimalisht, sepse çdo veprim i tij rriste dashurinë dhe respektin. Ai ishte gjithnjë më i dashur për ta, sa më shumë që e njihnin.

Udhëtimi me të Dërguarin *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* në gjendjet e tij të ndryshme është një burim që e shton dashurinë e madhe për të në zemrat tona. Për këtë arsye, shokët e të Dërguarit të Allahut *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* ishin njerëzit më të dashuruar pas tij dhe më të përsosurit në vlerësimin ndaj tij; sepse çdo gjest i jetës së tij që shihnin, e mbushte zemrën e tyre me dashuri dhe vlerësim. Jeta e tij *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, me të gjitha hollësitë e saj, ishte jetë tërheqëse dhe magjepsëse.

Edhe pse ne na mungoi mundësia të shohim atë që ata panë, nuk na mungon mundësia të dimë për të dhe ta mësojmë. Dhe sa më shumë që ushqehesh nga ajo që panë e dëgjuan Sahabët prej të Dërguarit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, aq më shumë gjallërohet zemra jote me dashuri për të, ashtu siç gjallëroheshin zemrat e tyre. Ai *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)* është ai për të cilin, sa më shumë që e njeh, aq më shumë e do.

Përfundim dhe lutje:

O Allah, ne i besuam Pejgamberit Tënd, Muhamedit *(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)*, e deshëm dhe e ndoqëm pa e parë kurrë! O Allah, mos na privo nga shikimi i tij në Ditën e Kijametit,

na mblidh nën shoqërinë e tij, na dhuro ndërmjetësimin e tij, na bëj të arrijmë tek burimi i tij dhe na mundëso shoqërimin e tij në kopshtet e larta të Xhenetit Firdeus!

O Zoti ynë, ne kemi besuar në atë që ke zbritur dhe e kemi ndjekur të Dërguarin; prandaj na shkruaj bashkë me dëshmitarët!

Një salavat i sinqertë:

O Allah, dërgo salavate mbi Muhamedin dhe mbi familjen e Muhamedit, ashtu siç ke dërguar mbi Ibrahimin dhe mbi familjen e Ibrahimit dhe bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, ashtu siç ke bekuar Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit! Vërtet, Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar!

ABDULVEHAB TUREJRI

JETA PROFETIKE

Sikur të jetoje me të

Sa më e madhe të jetë njohja e njeriut për Zotin e tij, aq më e madhe bëhet mirënjohja ndaj Tij, më e bukur bëhet pritja e begative dhe mirësive të Tij, dhe për çdo begati e ndien thellë fjalën: **"Çdo mirësi që keni, është nga Allahu."** (En-Nahl: 53)

Përjeton ndjesinë e begative të shumta, të llojllojshme dhe të pandërprera: **"Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni dot. "** (Ibrahim: 34) Ndien se është i pafuqishëm të falënderojë siç duhet për këto begati dhe e pranon mangësinë e tij për t'ia dhënë hakun secilës: *"Të shpreh mirënjohjen time për mirësinë Tënde ndaj meje, e pranoj mëkatin tim. Më fal mua!"*(Buhariu)

Nëse kjo vlen për njeriun e thjeshtë, atëherë ç'mund të themi për të Dërguarin (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), njeriun që e njeh më mirë se çdo kush tjetër Zotin e tij, si vepronte ai, kur i shihte dhe i përjetonte begatitë e Allahut!

Si ishte gjendja e tij me begatitë? Si i shijonte ato? Si fliste për to?

Ndër gjërat e para që iu shpallën në fillim të misionit profetik ishte Surja el Duha, e cila përfundon me këtë Ajet madhështor: **"Dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!"** (Ed-Duha: 11)

Ky udhëzim iu dha të Dërguarit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) që në fillim të shpalljes, sepse ishte udhëzim për një çështje që do ta shoqëronte përgjatë gjithë misionit të tij dhe gjithë jetës.

ISBN 978-608-216-277-5